

Myrtlefield
EXPOSITIONS

BOTUAR NE SHQIPË NGA
MISIONI UNGJILLOR

Pasuritë e Urtësisë Hyjnore

Përdorimi i Dhiatës së Vjetër nga Dhiata e Re



DAVID GOODING

AEM-Misioni Ungjillor

AEM
Misioni Ungjillor

**Pasuritë e
Urtësisë Hyjnore**

Shtjellimet biblike Myrtlefield

Shtjellimet Biblike Myrtlefield ofrojnë ekspertizë në rrjedhën logjike dhe kuptimin e shkrimeve biblike, të motivuara prej devotshmërisë ndaj Zotit që e zbulon vetveten në Shkrime. Këto vepra janë akademike, tërheqëse dhe mund të përdoren nga të gjithë; secili libër i drejtohet mendjes dhe zemrës së lexuesit për të rritur besimin në Perëndinë dhe për të nxitur bindjen ndaj Fjalës së tij. Mësuesit, predikuesit dhe të gjithë studentët e Biblës do të kuptojnë se qasja ndaj Shkrimeve në këto vëllime është edhe udhëzuese, edhe pasuruese.

The Riches of Divine Wisdom (Përdorimi i DH.V nga DH.R)

According to Luke (Ungjilli i tretë)

In the School of Christ (Gjoni 13–17)

True to the Faith (Veprat e Apostujve)

An Unshakeable Kingdom (Letra e Hebrenjve)

Libra të tjerë nga David Gooding:

The Bible and Ethics (me John Lennox)

Christianity: Opium or Truth? (me John Lennox)

Definition of Christianity (me John Lennox)

How to Teach the Tabernacle

Key Bible Concepts (me John Lennox)

Windows on Paradise (Ungjilli i Lukës)

Pasuritë e Urtësisë Hyjnore

Përdorimi i Dhiatës së Vjetër nga Dhiata e Re

David Gooding

**Botoi në shqip
AEM-Misioni Ungjillor**

AEM
Misioni Ungjillor

Të drejtat e Autorit

David Gooding rezervon të drejtat përmes Copyright, Designs and Patents Act, 1988, për t'u njohur si autor i këtij materiali.

© Myrtlefield Trust, 2013.

Të gjitha të drejtat rezervohen. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet apo transmetohet, në asnjë formë elektronike, mekanike, fotokopjimi, regjistrimi ose forma të tjera që nuk citohen, pa lejen paraprake nga Botuesi.

Për përmbajtjen në gjuhën shqipe këto të drejta duhet të konfirmohen nga AEM-Misioni Ungjillor, Rruga e Barrikadave, Nr. 125, Tiranë.

Kopertina: Ben Bredeweg.

Imazhet në kopertinë: Imazhe Public Domain të Codex Vaticanus, Leningrad Codex nga Jeremia 31 dhe Hebrenjve 8, dhe Apostulli Pal nga Rembrandt, 1635.

Publikuar për herë të parë në origjinal 2013.
Publikuar nga The Myrtlefield Trust, 180 Mountsandel Road,
Coleraine, N Ireland, BT52 1TB.
Web: www.myrtlefieldhouse.com
Email: info@myrtlefieldhouse.com
ISBN: 978-1-874584-20-9 (hbk.)
ISBN: 978-1-874584-21-6 (pbk.)
ISBN: 978-1-874584-22-3 (PDF)
ISBN: 978-1-874584-23-0 (Kindle)
ISBN: 978-1-874584-24-7 (EPUB pa DRM)

Publikuar në gjuhën shqipe në Korrik 2021 nga AEM-Misioni Ungjillor:
Adresa: Rruga e Barrikadave, Nr. 125, Tiranë 1012.
Email: office@aemission.al
Web: www.aemission.al
ISBN: 978-99927-959-6-5 (shtyp)
ISBN: 978-99927-959-7-2 (e-book)

*Për Stewart dhe Barbara Hamilton,
ndihmësit e mi.*

Përmbajtja

Pjesa e Parë	Marrëdhënia e Përgjithshme e Dhiatës së Re me Dhiatën e Vjetër	
1.	Një Çështje Historike: Varësia e Dhiatës së Re nga Dhiata e Vjetër	20
2.	Vijimësi dhe Shkëputje: Dhiata e Re nuk është thjesht një vijim i Dhiatës së Vjetër	36
3.	I Gjithë është i Dobishëm: Qëndrimi i Dhiatës së Re ndaj Dhiatës së Vjetër	54
4.	Qëllimi i Kujt?: Qëndrimi i Dhiatës së Re për Synimin e Autorit në Dhiatën e Vjetër	74
5.	Përfundime dhe çështjet e ngritura:	92
Pjesa e Dytë	Kategori konceptesh të Dhiatës së Re për të interpretuar Dhiatën e Vjetër	
	<i>Kategoria e Parë - Perspektiva profetike</i>	
6.	Interpretimi i profecisë së Dhiatës së Vjetër nga Krishti	100
7.	Koncepti i përmbushjes	112
	<i>Kategoria e Dytë - Koncepte ligjore</i>	
8.	Jurisprudenca: Precedent dhe Analogji Ligjore: Shembuj të Romakëve 3–4	132
9.	Rrjedhimi ligjor, paradigma ligjore, synimi i ligjit	152
10.	Interpretimi i besëlidhjeve ligjore	189

Kategoria e Tretë - Figura letrare

11. Citate dhe referime	190
12. Krahase formale, Krahase të thjeshta dhe Metafora	196
13. Aluzione të drejtëpërdrejtë	210
14. Aluzione të tërthorta	228
15. Interpretimi alegorik, apo jo?	242

Kategoria e Katërt - Tipare të nënkuptuara

16. Kuptime të shumëfishta	266
17. Rrjedha logjike e mendimit dhe heshtja e qëllimshme	276
18. Koherenca e brendshme si bazë për predikimin shtjellues	282

Kategoria e Pestë - Hije tipologjike

19. Tabernakulli si hije e gjërave qiellore	302
20. Tabernakulli si hije e gjërave që do të vinin në të ardhmen	322
21. Tabernakulli si çelës për interpretimin e Zbulesës	342

Pjesa e Tretë Udhëzime për interpretimin tonë të rrëfenjave të Dhiatës së Vjetër

22. Nevoja për udhëzime: Qëllimi i pjesës së tretë	354
23. Sakrifikimi i Isakut prej Abrahamit	358
24. Ndodhia e Davidit dhe Goliathit	386
25. Rasti i gabaonitëve	398
Fjala përmbyllëse: Dëshmia personale e Frymës së Shenjtë	416
Shtojca	422
Manual Studimi	430
Bibliografia	448
Botime nga David Gooding	450

Tabelat

Tabela 1. Tre ndarjet e Kanunit hebraik	39
Tabela 2. Një krahasim mes Numrave 21 dhe Gjonit 3 rreth historisë së gjarprit	220
Tabela 3. Aluzionet për Eksodin tek Ungjilli i Gjonit	250
Tabela 4. Çlirimi i Izraelit dhe i botës	256
Tabela 5. Fjalët hebraike të përdorura në përshkrimin e thuprës së Aaronit	425
Tabela 6: Krahase të përkthimeve shqip i fjalëve hebraike të përdorura në përshkrimin e Shandanit. Shën. përk]	427

Shkurtime

ESV	English Standard Version
EBC	Expositor's Bible Commentary
KJV	Versioni King James (i Autorizuar)
LXX	Septuagint
MT	Teksti Masoretik
NASB	New American Standard Bible
NEB	New English Bible
NIV	New International Version
RV	Revised Version
TSF	Bashkësia teologjike e Studentëve
TWOT	Theological Wordbook of the Old Testament
ZAW	Zeitschrift für die Alttestamentliche Wissenschaft (Revista e studimeve akademike të Dhiatës së Vjetër)

Parathënie

Prej shumë vitesh David Gooding ka patur një shërbesë të jashtëzakonshme mësimdhënieje dhe predikimesh në Mbretërinë e Bashkuar dhe në botë. Prej dëgjimit të shtjellimeve të tij për Biblën, mijëra njerëzve iu është ngjallur edhe më shumë interesi për të. Mua personalisht më la mbresa të pashlyeshme kur, në fillimet e viteve 1960, e kam dëgjuar të flasë në një seri rreth librit të Veprave. Ishte koha kur po u kushtohej një vëmendje më e madhe rrjedhës së mendimit dhe zhvillimeve narrative në tekstet biblike, që ishte e vështirë t'i dalloje për shkak të vendosjes së numrave në vargjet e tekstit (ndonëse i dobishëm) në Versionin e Autorizuar, dhe në përkthimet e tjera të Biblës përgjithësisht.

Në vitet e fundit ka patur një program të vazhdueshëm për përkthimin e veprave të tij në gjuhë të ndryshme. Te Pasuritë e Urtësisë Hyjnore autori paraqet ide të çmuara për bashkëveprimin e të dy Dhiatave, duke i kushtuar vëmendje të veçantë mënyrës në të cilën Dhiata e Vjetër citohet dhe interpretohet në Dhiatën e Re.

Siç edhe vërehet shpesh, Dhiata e Vjetër ishte Bibla e Zotit të Kishës dhe, për më tepër, në versionin e saj greqisht i cili njihet gjerësisht si "Septuaginti", ajo ishte Bibla e apostujve dhe e kishës së hershme. Qartazi, në përdorimin e Dhiatës së Vjetër prej shkrimtarëve të Dhiatës së Re, ka të dhëna të rëndësishme për mënyrën si duhet ta shohim dhe interpretojmë të njëjtën Dhiatë të Vjetër dhe shoqëruesen e saj më të re. Ky studim e nxjerr këtë gjë në dritë në mënyrë mbresëlënëse. Fama ndërkombëtare e David Gooding si akademik mbështetet në veprën e tij themelore

për 'Septuagint-in', i cili është edhe dëshmi parësore për formën e hershme të tekstit hebre të Dhiatës së Vjetër, edhe rezerva më e hershme e interpretimit biblik hebraik, vetëm se vjen i dyti pas vetë zhvillimit të traditës biblike.

Shumë gjëra pikasin në këtë vëllim, por unë do të nxjerr në pah vetëm disa. Së pari, reflektohet vlerësimi i lartë i autorit për Shkrimin, gjë që tregon se po ndjek shembullin e Zotit dhe të apostujve të tij. Sepse do të ishte gjë e çuditshme të përbuzje tekstin në studimin akademik dhe gjatë orës së leksionit, dhe pastaj të kërkoje prej tij drejtim dhe ndihmë në një sfond dhe moment tjetër. Së dyti, ky vëllim është shkruar me modesti 'në gjuhën e njeriut të thjeshtë' dhe duhet të jetë i kuptueshëm për një publik të gjerë. Së treti, përfshin një numër 'shembujsh të gatshëm' që e ndihmojnë lexuesin hap pas hapi përmes procesit të hetimit, krahasimit dhe ballafaqimit të teksteve, një progresion harmonik përmes të cilit kuptimet dhe domethëniet e arsyeshme bëhen të qarta. Së katërti, na tregohet sesi parimi interpretativ 'Krishti në të gjitha Shkrimet', nëse zbatohet si duhet, nuk e kufizon Dhiatën e Vjetër brenda një game të ngushtë paralelesh dhe parashikimesh kristologjike. Diskutimi i ngjarjes së Davidit dhe Goliathit e ilustron këtë më së miri. Së pesti, prirja e autorit për 'narratologjinë' – studimin e strukturës dhe funksionit të rrëfenjës (e evidentuar qoftë në shkrimet e tij akademike apo në ato për një publik të gjerë), gjen shprehje të plotë në këta kapituj. Le të mos harrojmë që një pjesë e madhe e Biblës është e shprehur në rrëfenja.

Në këtë studim të gjerë hasim tipologjinë, alegorinë dhe "përmbushjen", si edhe nivelet e ndryshme në të cilat përmbushja ka ndodhur. Ne paralajmërohem që një besnikëri kokëforte qoftë ndaj leximit letrar-historik, qoftë ndaj atij tipologjik rrezikon t'ia zbehë vlerat Shkrimit. Dhe, edhe pse na duhet ta fillojmë gjithmonë bashkëveprimin tonë me tekstet në nivelin letrar-historik (apo gramatiko-historik), shpesh ky është vetëm hapi i parë në shpalosjen e asaj që ato duan të thonë (lexoni diskutimin për Melkisedekun dhe për simbolizmin e pasur të tabernakullit, apo 'Çadrës së Mbledhjes'). Në përfundim, siç edhe e ilustron më së miri kapitulli mbi mashtrimin e gabaonitëve te Jozueu 9, leximi i një rrëfenje brenda kontekstit të saj më të gjerë mund

të ndryshojë në mënyrë domethënëse perspektivën tonë rreth ngjarjes, supozimeve të saj bazë dhe mesazhit që do të përcjellë.

David Gooding e prezanton këtë vëllim të shkëlqyer si një lloj manuali mbi interpretimin e Shkrimit dhe mbi mënyrën sesi studimi i bashkëveprimit të dy Dhiatave mund të shërbejë për të formuar përpjekjet tona në interpretim dhe shtjellim. Ky libër është një manual për 'gërmimin biblik', një manual në të cilin lexuesit do të zbulojnë për kënaqësinë e tyre të madhe xeherorë eksegjeze, dhe ide që do t'i shtyjnë të dëshirojnë që edhe ata vetë të zbulojnë në leximin e tyre të tekstit biblik.

Robert P. Gordon
Regius Professor of Hebrew Emeritus
Unitversiteti i Kembrixhit

Prolog nga autori

Ky libër është shkruar nga një student i Shkrimeve për të ndarë me bashkëstudentët e tjerë gëzimin e të hulumtuarit të Fjalës së Perëndisë, dhe të të zbuluarit të pasurive shpirtërore që një studim i hollësishëm i përmbajtjes së saj mund të nxjerrë në dritë. Teza e saj e veçantë është që ndërveprimi mes dy Dhiatave, kur e shqyrton nga afër, shpesh nxjerr në dritë thellësi kuptimesh që mund të mbeteshin të pazbuluara nëse të dy Dhiatat lexohen thjesht ndaras, pa një studim serioz të lidhjeve të tyre.

Përdorimi i Dhiatës së Vjetër nga Dhiata e Re është një temë shumë e studiuar në të shkuarën; dhe në dekadat e fundit hulumtimi i saj në qarqet akademike ka prodhuar një lumë botimesh. Ky libër nuk ka për qëllim që të kontribuojë në debatin akademik; ja pse nuk ka fare bashkëveprim me vepra akademike në faqet e tij. Lexuesit, që nuk kanë dijeni për gamën e gjerë të botimeve akademike të ditëve tona rreth kësaj teme, ndërgjegjësohen për ekzistencën e tyre dhe u bëhet thirrje që të njihen me to.

Ndërkaq, ky libër parashtrohet një detyrë më të thjeshtë, më të ngushtë dhe praktike. Ai u drejtohet mësuesve, predikuesve dhe studentëve të Biblës që, ndonëse mund të mos jenë akademikë, tërhiqen prej Dhiatës së Vjetër dhe sidomos prej rrëfenjave të saj, dhe dëshirojnë ta kuptojnë atë më mirë dhe të mbështesin mësimet dhe predikimet e tyre mbi të. Por e gjejnë veten përballë një dileme.

Në mënyrë instiktive ata ndihen të tërhequr ndaj interpretimit tipologjik të Dhiatës së Vjetër. Në fund të fundit, a nuk e interpreton vetë Dhiata e Re Dhiatën e Vjetër tipologjikisht

disa herë? Por gjithashtu ata janë të vëmendshëm për teprimet fantastike që interpretuesit tipologjikë (jashtë Dhiatës së Re) shpesh kanë përdorur, të cilët kritikohen gjerësisht (me të drejtë) prej komentuesve profesionistë. Prandaj, ata ndihen të detyruar t'i nënshtrohen rregullit të përgjithshëm që nuk duhet të trajtojmë ndonjë gjë në Dhiatën e Vjetër si 'tip', përderisa Dhiata e Re na e thotë këtë qartazi. Përkrahësit e këtij rregulli argumentojnë se apostujt e Dhiatës së Re e kishin autoritetin që të shpallnin një person, një gjë, një institucion apo ngjarje në Dhiatën e Vjetër si tip. Por ne, duke mos qenë apostujt të frymëzuar në mënyrë hyjnore, nuk duhet të përpiqemi t'i imitojmë ata në këtë punë; sepse nuk kemi autoritet për të deklaruar që diçka është një tip, nëse Shkrimi nuk e thotë vetë këtë.

Në ditët e sotme ky rregull nuk ndiqet dhe aq shumë si dikur. As nuk pranohet unanimisht edhe brenda vetë qarqeve akademike të teologjisë. Por studentët, predikuesit dhe mësuesit që unë kam parasysh e ndiejnë peshën e tij dhe druhen se mos bien në të njëjtat teprime për të cilat është akuzuar shpesh interpretimi tipologjik. Kjo është një anë e dilemës së tyre.

Nga ana tjetër, rregulli themeltar që interpretimi i çdo gjëje në Dhiatën e Vjetër duhet të fillojë prej domethënies së saj të fjalëpërfjalshme, historike, ashtu siç e kuptonin lexuesit e parë, është i pakundërshtueshëm. Por, kur prej tij nxjerrim konkluzionin, siç ndodh disa herë, që nuk mund të përfitohet më shumë se kaq prej tekstit pa rrezikuar saktësinë e interpretimit, kjo gjë i lë shumë studentë të Biblës të pakënaqur. Sepse kështu për ta, pjesë të konsiderueshme të Dhiatës së Vjetër shndërrohen vetëm në fakte të thata ose kuriozitete historike. Ata i përthithin këto fakte, por pastaj pyesin veten: "Po pastaj? Pse u dashkan të njihen këto fakte?" Ata e kanë të vështirë të shquajnë në to ndonjë mësim për veten dhe ndjehen, me të drejtë, dyshues për përpjekjet arbitrare për t'i përditësuar këto histori të lashta, dhe për t'i bërë të kohës duke "i kontekstualizuar" në situata shumë të ndryshme të botës tonë moderne. Sepse në përpjekje të tilla, mësues të ndryshëm kanë nxjerrë interpretime shumë të ndryshme po aq arbitrare sa tipologjia e tepruar në ekstremin tjetër. Gjatë gjithë kohës mësuesit, predikuesit dhe studentët tanë nuk mund të harrojnë që Dhiata e Re pohon se "të gjitha

gjërat që u shkruan në të kaluarën [d.m.th. në Dhiatën e Vjetër] u shkruan për mësimin tonë, që me anë të këmbënguljes dhe të ngushëllimit të Shkrimeve, të kemi shpresë" (Rom 15:4). Atëherë, si mund të jetë i drejtë një parim interpretimi që shërben për të vështirësuar kaq shumë dallimin e mësimave të vlefshme të një pjese të madhe të rrëfenjave të Dhiatës së Vjetër, të cilat "u shkruan për mësimin tonë"? Kjo përbën anën tjetër të dilemës.

Ky libër ka për qëllim, atëherë, të japë një kontribut për zgjidhjen e të dyja këtyre pjesëve të kësaj dileme. Ndërsa studiojmë me hollësi mjetet e shumta që Dhiata e Re përdor për të nxjerrë mësim prej Dhiatës së Vjetër, një fakt themeltar del shumë shpejt në pah: ideja se një interpretim i një pasazhi të Dhiatës së Vjetër duhet të jetë ose i drejtëpërdrejtë-historik, ose tipologjik, është shumë feminare. Për më tepër, shqyrtimi i këtyre mjeteve të shumta interpretative do të nxjerrë në dritë parime të tjera të interpretimit të Dhiatës së Vjetër, të cilat do të na drejtojnë në studimin tonë të vazhdueshëm të asaj që "u shkrua në të kaluarën".

Autori nuk ka iluzione: ky libër as nuk do të përmendë, jo më të diskutojë, shumë fusha kryesore që i takojnë realisht studimit të hermeneutikës biblike. Por ai shpreson që lexuesit e tij do të ndiejnë se edhe kjo pak ndihmë që po u ofrohet, është më mirë se hiç fare.

David Gooding
Belfast, 2013

Falënderime

Këtë libër e kisha menduar ta shkruaja prej një kohe të gjatë. Disa dekada të shkuara temat e tij madhore i dhashë si leksione në Spanjë dhe u përkthyen atje prej z. Eric Bermejo. Shumë më vonë një version i përditësuar dhe i zgjeruar u përkthye dhe u botua në rusisht prej bujarisë së z. Michael Middleton nga Cambridge. Qysh atëherë unë i kam risistemuar dhe u kam shtuar atyre edhe më, që u shtypën më vonë prej znj. Barbara Hamilton me efikasitetin dhe saktësinë që e karakterizon. Edhe pas këtyre gjërave, ky libër as nuk do të ishte botuar në anglisht nëse nuk do të nxitesha prej profesor Arthur Williamson dhe prej punës së madhe redaktuese të bërë me shumë entuziazëm nga dr. Joshua Fitzhugh dhe z. Peter Whyte. Këtyre, dhe të gjithë të tjerëve, unë u ofroj mirënjohjen time të sinqertë.

ἡ πολυποίκιλος σοφία τοῦ θεοῦ
Dituria e shumëllojshme e Perëndisë
—Efesianëve 3:10

ταῦτα δὲ τυπικῶς συνέβαινε ἐκείνοις,
ἐγράφη δὲ πρὸς νοουθεσίαν ἡμῶν,
εἰς οὓς τὰ τέλη τῶν αἰώνων κατήντηκεν.
Të gjitha këto gjëra u ndodhën atyre si shembull,
dhe janë shkruar për paralajmërimin tonë,
për ne që jemi në mbarim të epokës.
—1 Korintasve 10:11

Konspekt

Plani dhe Shembulli

Dhiata e Re kudo brenda saj shpall që i detyrohet Dhiatës së Vjetër, madje që varet nga ajo, dhe njeh autoritetin e saj hyjnor. Të krishterët e parë e mësuan ungjillin e tyre sipas termave të saj: “Krishti vdiq për mëkatet tona sipas Shkrimeve” (1 Kor 15:3).

Ndoshta është për të ardhur keq që kanuni i librave të krishterë në versionin latin u quajt “Testamenti i Ri”, dhe, prej kësaj, kanuni hebre “Testamenti i Vjetër”. Në kohët moderne fjala “testament” përmendet zakonisht në frazën “amaneti i fundit dhe testamenti”. Prandaj nuk ka shumë kuptim që të mendosh për kanunin hebre si “Amaneti i Fundit dhe Testamenti i Vjetër” dhe për kanunin e krishterë si “Amaneti i Fundit dhe Testamenti i Ri.”

Fjala latine *testamentum* (shqip – testament, dhiatë) në këtë kontekst biblik është një përkthim i një fjale greke (διαθήκη), që ka disa kuptime. Sigurisht që do të thotë edhe “një amanet të fundit apo testament” dhe përdoret në këtë kuptim, p.sh, tek Hebrenjve 9:16-17. Autori atje argumenton që një testament nuk ka fuqi nëse personi që e ka bërë rron ende. Prandaj të gjitha bekimet që Krishti na ka lënë si vullnetin e tij të fundit, vareshin prej vdekjes së tij për të hyrë në fuqi.

Διαθήκη (Dhiata), sidoqoftë, do të thotë në thelb “një rregullim” i punëve të dikujt. Prandaj, ajo mund të marrë kuptimin “besëlidhje” - dhe në shumicën e rasteve në Shkrime këtë kuptim merr. Është fjala që përdoren përkthyesit e lashtë hebrenj të Dhiatës së Vjetër nga hebraishtja në greqisht (Septuagint) për besëlidhjen që Perëndia bëri me Izraelin në Sinai (Eksodi 24); dhe, po ashtu, te Jeremia 31:31, ku Perëndia premton të bëjë një besëlidhje të re me shtëpinë e Judës dhe Izraelit për të zëvendësuar besëlidhjen e Sinait. Është gjithashtu fjala që përdoret te Luka 22:20 ku Zoti ynë, kur u dha kupën dishepujve të tij, tha: “Kjo kupë është besëlidhja e re në gjakun tim.” Po ashtu ajo përdoret edhe te Hebrenjve 8:6 ku thuhet që besëlidhja e re ka hyrë në fuqi, dmth, ka hyrë në ligj duke zhbërë besëlidhjen e Sinait që po vjetërohej dhe po tretej (8:13).

Prandaj, në vend që ta quajmë kanunin hebre “Dhiata e Vjetër” a nuk do të ishte më mirë ta quanim “Besëlidhja e Vjetër”? Jo, sepse kjo do të ishte e pasaktë dhe do të linte vend për keqkuptime. Besëlidhja që quhet me të drejtë ‘e vjetër’ dhe ‘jashtë përdorimit’ është, siç e kemi vënë re, besëlidhja që Perëndia bëri me Izraelin dhe Judën kur i zuri përdore për t’i nxjerrë jashtë Egjiptit (Jer 31:31; Heb 8:9). Kështu, ajo nuk hyri në fuqi deri mbi 400 vjet pas Abrahamit, pa përmendur ata që jetuan para Përmbytjes. Abrahami nuk jetoi nën atë; dhe besëlidhja që Perëndia bëri me Abrahamin dhe pasardhjen e tij, duke u garantuar trashëgiminë e një toke, ishte një lloj besëlidhjeje plotësisht tjetër nga ajo e Sinait. Aq shumë ndryshe qenë ato, sa që Dhiata e Re proteston se do të ishte e jashtëligjshme të imponoheshin kushtet e besëlidhjes së vjetër tek besëlidhja e Perëndisë me Abrahamin (Gal 3:15–18).

Por ndërsa besëlidhja e vjetër është vjetëruar, parimi mbi të cilin Abrahami u justifikua (Zan.15:6) nuk është vjetëruar po ashtu. Ai që gjithmonë i pavaruar nga besëlidhja e vjetër. Ai ende është në fuqi dhe gjithmonë do të mbetet (Rom 4:1–8). Prandaj nuk do të ishte e drejtë që të quhej një libër që përfshin Zanafillën, “Besëlidhja e Vjetër”.

Si t’i drejtohem atëherë kanunit hebre? Emërtimi “Dhiata e Vjetër”, siç e kemi parë, nuk është më i miri. Por të përpiqesh ta ndryshosh atë brenda botës së krishterë, në këtë fazë të

popullaritetit të tij, do të ishte pedantizëm. Mjafton që të dimë se pse nuk është i mjaftueshëm; dhe pastaj gjatë bisedave me miqtë hebrej do të ishte më mirë të përdorej emërtimi i tyre Tanakh.¹

Në të njëjtën kohë, nëse Dhiata e Re shpall që një pjesë e Dhiatës së Vjetër tani është vjetëruar, çfarë do të thotë kjo? A do të thotë që të krishterët mund të shpërfillin pjesë të mëdha të Dhiatës së Vjetër, duke i quajtur si të padobishme dhe të papërshtatshme tani nga ana shpirtërore? Cila është marrëdhënia e përgjithshme e Dhiatës së Re me të Vjetrën?

Plani i këtij libri

Pjesa e parë—marrëdhëniet e përgjithshme

Ne do të fillojmë të hetojmë atë që Dhiata e Re vetë thotë rreth kësaj teme; dhe do ta bëjmë këtë nën 4 krerë:

1. Një çështje historike: varësia e Dhiatës së Re nga Dhiata e Vjetër
2. Vijimesi dhe shkëputje: Dhiata e Re nuk është thjesht një vijim i Dhiatës së Vjetër
3. I gjithë është i dobishëm: qëndrimi i Dhiatës së Re ndaj Dhiatës së Vjetër
4. Qëllimi i kujt? Qëndrimi i Dhiatës së Re për synimin e Autorit në Dhiatën e Vjetër

Për rrjedhojë, dy gjëra dalin në pah. Mbi autoritetin e Dhiatës së Re:

1. *Dhiata e Vjetër është e vlefshme në vetvete.* Ajo që e frymëzuar nga Perëndia dhe ende është. Nuk ka pushuar së qeni e tillë që nga ardhja e Dhiatës së Re. Duke qenë se Perëndia, i cili ua foli atë fillimisht etërve përmes profetëve, ende ua flet atyre që dëgjojnë, cili besimtar do të guxonte të bënte një vesh shurdh ndaj saj?

¹ Një akronim hebraik për "Ligjin, Profetët dhe Shkrimet e tjera" (shih [Tabelën 1](#))

2. *Dhiata e Vjetër është e dobishme në tërësinë e saj.* Kjo është rrjedhojë e faktit që është e frymëzuar në mënyrë hyjnore. Dhiata e Re thotë se "të gjitha gjërat që u shkruan në të kaluarën u shkruan për mësimin tonë, që me anë të këmbënguljes dhe të ngushëllimit të Shkrimeve, të kemi shpresë" (Rom 15:4), prandaj cili do ta linte t'i shpëtonte nga duart, duke mos i marrë seriozisht udhëzimet e Dhiatës së Vjetër?

Është një fakt i pakundërshtueshëm që, gjatë shekujve të shkuar, besimtarët janë nxitur prej leximit të Dhiatës së Vjetër. Psalmet kanë ngushëlluar zemrat e tyre. Profecitë mesianike kanë përforcuar besimin e tyre. Ata kanë ndjerë forcën e denoncimeve të profetëve kundër korrupsionit fetar, tregtar, shoqëror dhe politik. Ata janë drejtuar nga urtësia e pasur, praktike e Fjalëve të Urta; mësuan shenjtërinë dhe gëzimin e dashurisë martesore – si të ndryshme prej formave të shthurjes seksuale – prej Kantikut; janë kthjelluar prej urtësisë së librit të Predikuesit, urtësi që tregon zhgënjimin e saj me botën; dhe bëmat e burrave dhe grave të besimit kanë ndezur në ta besim dhe kurajo.

Megjithatë duhet pranuar që, për shumë besimtarë, ka fusha të vështira në Dhiatën e Vjetër, madje edhe në rrëfimet historike të saj që në pamje të parë duken të drejtpërdrejta. Çfarë mësime, vallë, duhet të nxjerrim prej metodës së Jakobit për shtimin e kopesë së tij (Zan 43-30:29)? Apo prej masakrës së sikemitëve prej djemve të tij (Zan 34)? Si mundet që gruaja e Davidit të mbante një idhull në shtëpinë e tij (1 Sam 19:11-17)? Por për gënjeshtër të përsëritura të Davidit ndaj Akishit (1 Sam 27:7-12)? Duke qenë se Davidi që i vajosuri i Zotit, si ka mundësi që nuk e kontrollonte dot Joabin: në rastin e vrasjes së Abnerit, në shtysën që i dha për të kthyer Absalomin, në vrasjen e Absalomit duke thyer urdhërat e Davidit, në vrasjen e Amasës, dhe në rimarrjen e komandës së ushtrisë së Davidit pasi Davidi e kishte shkarkuar? Si ka mundësi që e vetmja herë që Davidi këmbënguli që të bëhej e tija me Joabin, ishte kur Davidi e shpërfilli këshillën e Joabit për të mos numëruar popullin, dhe pati një katastrofë (2 Sam 24:2-4)? Si të trajtojmë, vallë, kapitujt e fundit të zyrtë, për të mos thënë makabër, të librit të Gjyqtarëve (kap. 18-21)? Po në listat e pafundme të

gjenealogjive të Kronikave, ku të shohim për të marrë nxitjen dhe shpresën e premtuar?

Nuk po themi se nuk gjendet nxitje madje edhe në pasazhe të tillë në Dhiatën e Vjetër. As nuk po hedhim dyshim mbi shanset që ta zbulojmë. Aspak! Ne kemi siguri prej Perëndisë që është aty e pranishme, por ky është një pohim që nëse ne për veten tonë do fillojmë ta lexojmë, interpretojmë dhe zbatojmë Dhiatën e Vjetër pa ndonjë udhëzim prej Dhiatës së Re kemi marrë përsipër një detyrë të vështirë. Fatmirësisht nuk jemi vetëm në këtë punë. Dhiata e Re e ka bërë këtë para nesh; dhe ne mund të studiojmë dhe të mësojmë prej kategorive të koncepteve që ajo përdor kur interpreton Dhiatën e Vjetër, dhe prej shumë metodave që ajo përdor për të vjelë pasurinë e saj.

Pjesa e dytë—kategori konceptesh të Dhiatës së Re.

Hetimi ynë do të zhvillohet më tej përmes pesë kategorive. Secila prej tyre përmban në vetvete një numër të caktuar perceptimesh, konceptesh, metodash apo tiparesh që Dhiata e Re përdor në interpretimin e saj të së Vjetrës.

Kategoria e parë—Perspektiva profetike

Ne do të fillojmë duke u fokusuar në dy ardhjet e Krishtit. Së pari në domethënien e deklaratave që Zoti ynë Jezus ka bërë se Dhiata e Vjetër parashikoi dy ardhje të tij, dhe pastaj në lidhjet që këto dy ardhje kanë me problemin e së keqes. Më pas duhet të trajtojmë në përgjithësi konceptin e “përmbushjes” ashtu si Dhiata e Re e kupton atë, qoftë në kuptimin parësor si përmbushje të parashikimeve, qoftë si shprehje përfundimtare dhe më e lartë e parimeve themeltare.

Kategoria e dytë—Koncepte ligjore

Në disa raste Dhiata e Re vepron si një jurist. Ajo citon një pasazh nga Dhiata e Vjetër, pohon se ky është një nen ligjor, dhe këmbëngul që zbatimi i tij i saktë për ne varet nga interpretimi strikt i kushteve të saj sipas praktikës ligjore të shëndoshë.

Kështu do të jemi duke shqyrtuar trajtimin që Dhiata e Re i bën Precedentëve ligjorë, Rrjedhimeve ligjore, Paradigmave ligjore, Qëllimit dhe Interpretimit të Besëlidhjeve ligjore. Sepse siç edhe do ta shohim, Dhiata e Re vetë këmbëngul për bazën ligjore të shpëtimit tonë si të krishterë.

Kategoria e tretë—Figura letrare

Nuk është për t’u çuditur, por Dhiata e Re përdor një gamë mjetesh që janë qartësisht të natyrës letrare. Një nga mjetet e saj më të lehta për ta dalluar dhe më shpesh i përdorur është citimi i profecive mesianike. Në raste të tjera ajo citon një varg apo pasazh nga Dhiata e Vjetër, dhe pohon që ai është autoritar në formimin e doktrinës teologjike që Dhiata e Re po shpall.

Por ka edhe raste që vihen më pak re kur ajo përdor një krahasim apo metaforë që në fakt mbështetet në ndonjë ndodhi apo praktikë të Dhiatës së Vjetër. Kjo do të thotë se për të shijuar plotësisht domethënien e krahasimit apo metaforës, lexuesit do t’i duhet të dijë hollësisht sfondin e tyre të Dhiatës së Vjetër, përndryshe forca e krahasimit apo e metaforës do të humbasë. Po ashtu, përdorimi i saj i krahasimeve dhe aluzioneve, qofshin të drejtpërdrejta apo të tërthorta, mund të kërkojë nga ana jonë të hetojmë hollësisht një pjesë nga Dhiata e Vjetër. Kur u shtojmë këtyre edhe përdorimin e asaj që disa e quajnë me përbuzje ‘interpretim alegorik’ (nëse ata kanë të drejtë për këtë ose jo do ta shohim më vonë), ne do të fillojmë të çmojmë gamën e figurave letrare që Dhiata e Re përdor.

Kategoria e katërt—Tipare të nënkuptuara

Dhiata e Re pranon gjithashtu disa rrjedhime që dalin nga mënyra si Dhiata e Vjetër është shkruar. Ajo pranon, p.sh, që një mësim, person apo ngjarje në Dhiatën e Vjetër mund të ketë më shumë domethënie sesa në vetëm një nivel pa e kundërshtuar vetveten. Ajo pranon gjithashtu rrjedhimet logjike të një pasazhi apo heshtjet e qëllimshme brenda rrëfenjave të veçanta. Herë të tjera ajo përdor koherencën e brendshme të nënkuptuar të Dhiatës së Vjetër si bazë për shtjellimin e saj. Me fjalë të tjera,

vepron si një predikues. Së pari citon plotësisht një pasazh nga Dhiata e Vjetër. Pastaj i kthehet atij hap pas hapi, dhe jo vetëm që shtjellon çdo fjalë apo fjali, por edhe i bën thirrje lexuesve të saj për t'i zbatuar rrjedhojat praktike të saj me fjalë të zjarra. Në secilin rast Dhiata e Re vë në dukje domethënien e këtyre tipareve të nënkuptuara, dhe i përdor ato ndërsa shtjellon kuptimin e Dhiatës së Vjetër.

Kategoria e pestë—Hije tipologjike

Ne do të përfundojmë studimin tonë të këtyre kategorive të koncepteve, duke hetuar interpretimin që Dhiata e Re i bën tabernakullit si një tip. Së pari do të shqyrtojmë interpretimin e saj të tabernakullit si një hije të atyre që letra e Hebrenjve i quan “gjëra qiellore”, d.m.th, zbulesa e Perëndisë për realitetet e mëdha dhe të përjetshme përmes tabernakullit. Së dyti do të shqyrtojmë interpretimin që Dhiata e Re i bën tabernakullit si një hije e përfitimeve të lavdishme që kemi tani prej Zotit Jezus Krisht, si “hijen e të mirave që kishin për të ardhur”, siç Hebrenjve 10:1 e thotë. Pastaj do të shohim një rast të veçantë në interpretimin e Dhiatës së Re të tabernakullit dhe të shqyrtojmë përdorimin që Zbulesa i bën simbolizmit të tabernakullit.

Pjesa e tretë—Udhëzime

Në fund të këtij libri, ne do të sugjerojmë disa hapa praktikë që mund të marrim kur Dhiata e Re nuk jep ndonjë udhëzim të menjëhershëm në lidhje me mënyrën se si duhet të interpretohet një rrëfenjë e Dhiatës së Vjetër. Pasi të kemi studiuar parimet e interpretimit të Dhiatës së Vjetër të pranishme në shtjellimin që Dhiata e Re u bën atyre, dhe duke i përdorur ato si pikënisje, ne do të jemi më të pajisur për të formuluar udhëzime për studimin tonë të mëtejshëm. Por ka edhe një çështje tjetër paraprake që duhet të shqyrtojmë.

Shembulli

Tashmë duhet që ta keni marrë me mend se ky libër mbështetet mbi supozimin që qoftë Dhiata e Vjetër, qoftë Dhiata e Re janë

Fjala e frymëzuar dhe autoritare e Perëndisë. Në këtë gjë ajo ndjek shembullin e Zotit tonë, Jezus, prandaj, për të përgatitur veten për studimin që vijon, le të kujtojmë me nderim qëndrimin personal të Zotit tonë ndaj Dhiatës së Vjetër, siç na prezantohet në Dhiatën e Re. Sepse në këtë çështje ai është shembulli ynë i përsosur.

Qëndrimi që Krishti mbajti ndaj Dhiatës së Vjetër

Të katër ungjijtë na e bëjnë të ditur pa asnjë hije dyshimi se cili ishte qëndrimi i Zotit tonë ndaj asaj që tani i quajmë Shkrime të Dhiatës së Vjetër: ai i respektonte ato, i lexonte, i njihte hollësisht, u bindej atyre, i citonte, i shtjellonte, i predikonte—me një fjalë, ai i donte ato.

Termi i përgjithshëm që Krishti përdori për t’iu referuar Biblës së kohës së tij ishte ose “Shkrimi” (veçanërisht kur citonte një varg apo pasazh të caktuar), ose numri shumës i tij, “Shkrimet” (duke përmendur një grup pasazhes apo të gjithë Dhiatën e Vjetër). Këto terma tregojnë që ai e vlerësonte Dhiatën e Vjetër si fjalën e shkruar të Perëndisë, dhe, për rrjedhojë, të veshur me autoritet hyjnor. Është për të marrë shembull që, ndonëse ai qe Biri i Perëndisë, në miqësi të pandarë me Atin dhe vazhdimisht plot me Frymën e Shenjtë dhe i udhëhequr nga Fryma, ai nuk u mbështet vetëm në komunikimet shpirtërore drejtpërdrejt prej Perëndisë, por u drejtua gjithashtu gjatë gjithë jetës dhe shërbesës së tij prej Fjalës së shkruar të Perëndisë.

Gjatë tundimit, para se të niste shërbesën e tij publike, ai kundërshtoi joshjet e djallit duke cituar tre vargje nga Shkrimet, duke prezantuar secilën përmes një formule autoritare, “Është shkruar” (Mat 4:4, 7, 10).²

Pastaj, në fillim të shërbesës së tij publike, ai zgjodhi të shpallte programin e misionit të jetës së tij, duke hyrë në sinagogën e qytetit të tij, Nazaretit, dhe, duke qëndruar në këmbë përballë gjithë asamblesë, filloi të lexonte. Iu dha një pergamen i profetit Isaia që ai e mori, e shpalosi dhe gjeti pjesën:

² Koha e kryer në greqisht e përdorur në këto vargje (γέγραπται) do të thotë “është shkruar dhe mbetet e shkruar”. Krahasoni të njëjtën kohë të përdorur tek Gjoni 19:22.

Fryma e Zotit, Zoti është mbi mua, sepse Zoti më ka vajosur për t'u dhënë një lajm të mirë të përlurur; ... të shpall vitin e hirit të Zotit. (Isa 61:1-2)

Pastaj ai e lexoi këtë pasazh prej pergamentës publikisht. Pasi e mbaroi, e mbylli pergamenën, ia ktheu shërbyesit dhe u ul. Pastaj kur të gjithë të pranishmit ngulën sytë mbi të ai filloi të thotë: “Sot ky Shkrim u përmbush në veshët tuaja” (Luka 4:16-21). Ai nuk mund ta bënte më të qartë që puna e jetës së tij ishte përshkruar me hollësi në fjalën e shkruar të Perëndisë.³

Po ashtu, në fund të jetës së tij mbi dhë, në kopshtin e Gjetsemanisë, pak orë para vdekjes së tij, ai qortoi Pjetrin që kishte nxjerrë shpatën për të ndaluar arrestimin e tij. Ai vetë, tha ai, edhe në atë moment, mund të kishte shmangur arrestimin dhe kryqëzimin nëse do e donte këtë gjë. Pse nuk bëri ai kështu? Ai dha këtë arsye:

“A kujton ti, vallë, se unë nuk mund t'i lutem Atit tim, që të më dërgojë më shumë se dymbëdhjetë legjione engjëjsh? Po atëherë sido të përmbusheshin Shkrimet, sipas të cilave duhet të ndodhë kështu?” (Mat 26:53-54).

Kjo deklaratë pohon se zgjedhja që ai bëri ishte prej vullnetit të tij të lirë: ai mund të zgjidhte kështu ose ashtu. Por siç veproi gjatë gjithë jetës dhe shërbesës së tij, edhe tani përballë arrestimit dhe kryqëzimit ai, në lirinë e tij, zgjodhi të qeverisej prej fjalës së shkruar të Perëndisë.

Qëndrimi i Krishtit ndaj atyre që shpërfillën apo shkelën fjalën e shkruar

Duke ditur, atëherë, bindjen personale të Krishtit që Dhiata e Vjetër ishte fjala e shkruar e Perëndisë, dhe për shkak të devocionit dhe bindjes së tij personale ndaj saj, nuk duhet të çuditemi që shpesh ai qortonte ashpër kundërshtarët e tij fetarë. Ai e bëri këtë sidomos kur kritikën e tyre ndaj tij zbuluan faktin që ata as nuk i kishin lexuar thëniet përkatëse të Shkrimit,

³ Ai gjithashtu pohoi se ishte Mesia i parashikuar nga Isaia.

apo, në rast se i kishin lexuar, nuk kishin marrë mundimin të mendonin për kuptimin dhe zbatimin praktik të tyre:

“A nuk keni lexuar vallë çbëri Davidi, kur pati nevojë...?” (Marku 2:25, citon 1 Sam 21:1-6)

“A nuk keni lexuar kurrë në Shkrimet: “Guri, që ndërtuesit e nxorën të papërdorshëm, u bë guri i qoshes...” (Mat. 21:42, citon Ps 118:22)

“Shkoni dhe mësoni çdo të thotë: “Unë dua mëshirë dhe jo flijime.” (Mat. 9:13, citon Osean 6:6)

“A nuk është pikërisht për këtë që jeni në gabim, sepse nuk i njihni as Shkrimet as pushtetin e Perëndisë?... a nuk keni lexuar në librin e Moisiut se si foli Perëndia nga ferrishta...” (Marku 12:24-26, citon Eks 3:2-6)

Për Krishtin Shkrimet qenë fjala e shkruar e Atit të tij dhe tempulli i Jerusalemit që shtëpia e Atit të tij. Në një rast ai u zemërua shumë me të drejtë kur pa që farisenjtë kishin shpikur një ligj fetar që kundërshtonte një urdhërim të qartë të Perëndisë në ligjin e Moisiut:

“Keni lënë pas dore urdhërimin e Perëndisë, pra, dhe ju i përmbaheni traditës së njerëzve... Ju jeni të shkathët për të anuluar urdhërimin e Perëndisë, për të zbatuar traditën tuaj. E në fakt Moisiu tha... Por ju thoni...” (Marku 7:8-11)

Po ashtu, në një rast tjetër të ngjashëm, ai qortoi ashpër priftërinjtë në Jerusalem sepse kishin lejuar praktika tregtare në tempull që binin ndesh me etosin themeltar të shtëpisë së Atit të tij:

Pastaj Jezusi hyri në tempullin e Perëndisë, i dëboi të gjithë ata që shisnin dhe blinin në tempull dhe përmbysi tryezat e këmbyesve të parave... Dhe u tha atyre: “Është

shkruar: “Shtëpia ime do të quhet shtëpi lutjeje”, por ju e keni kthyer në një shpellë kusarësh”. (Mat 21:12–13, citon Isaian 56:7)

Pasi kemi lexuar këto mund t’i bëjmë një pyetje vetes se çfarë do të thoshnim nëse Krishti do të na drejtonte pyetjen: a nuk e keni lexuar ndonjëherë këtë apo atë pasazh nga Dhiata e Vjetër? A do të mund t’i përgjigjeshim dot atij: Po, e kemi lexuar dhe po përpiqemi të jetojmë në dritën e saj?

Krishti: tema më e rëndësishme e të gjithë Dhiatës së Vjetër

Librat e kanunit të shkrimeve hebraike janë organizuar në 3 grupe: Tora, Nebihimët dhe Kethubimët (Shih [Tabelën 1](#)). Zoti ynë citoi lirisht nga të gjitha këto 3 grupe për një gamë të gjerë temash. Por ai bëri më shumë se kaq. Ai pohoi që të gjitha këto grupe në vende të ndryshme flisnin për të. Kështu, p.sh, ai iu tha disa prej bashkëkohësve të tij: “Në qoftë se ju do t’i kishit besuar *Moisiut*, do të më besonit edhe mua, sepse ai ka shkruar për mua. Por në qoftë se ju nuk u besoni shkrimeve të tij, si do t’u besoni fjalëve të mia?” (Gjoni 5:46-47), dhe Moisiu shkroi të pesë librat e grupit të parë.

Një herë tjetër, për dobinë e dy udhëtarëve rrugës për në Emaus, ai filloi, “duke zënë fill nga *Moisiu* dhe nga gjithë *profetët*, ai u shpjegoi atyre në të gjitha Shkrimet gjërat që i takonin atij” (Luka 24:27), domethënë prej grupit 1 dhe 2 të kanunit hebre përkatësisht. Më vonë atë ditë ai iu shfaq apostujve në një dhomë në Jerusalemin; dhe në atë rast iu tha:

“Këto janë fjalët që unë ju thoja kur isha ende me ju: se duhet të përmbushen të gjitha gjërat që janë shkruar lidhur me mua në *ligjin e Moisiut*, në *profetët* dhe në *psalmet*.” (Luka 24:44)

Këtu ai përmend me emër të tre grupet e kanunit hebraik. Ata të tre folën për të herë pas here; dhe ai, prej natyre, ishte tema e tyre më e rëndësishme.

Grupi 1	Grupi 2	Grupi 3
Torah përmban 5 librat e parë. Ajo përmendet në Dhiatën e Re si “Ligji”, apo “Ligji i Moisiut”, apo thjesht “Moisiu”.	Nebiim = Profetët kanë dy pjesë:	K ^e thubim = Shkrimet Disa herë Dhiata e Re i referohet të gjithë këtij grupi si “Psalmet”, sepse libri i Psalmeve është i pari në grup dhe është libri më i gjatë i grupit. Shih p.sh Luka 24:44.
Zanafilla, Eksodi, Levetiku, Numrat, Ligji i Përtërirë	A. ‘Profetët e hershëm’, të quajtur edhe libra historikë, Jozueu, Gjyqtarët, 1 & 2 Samueli, 1 & 2 Mbretërve. B. ‘Profetët e vonë’: Isaia, Jeremia, Ezekiel, & të dymbëdhjetët: Osea, Joel, Amos, Abdia, Jona, Mikea, Nahumi, Habakuk, Sofonia, Hagai, Zakaria, Malakia	Psalmet, Fjalët e Urta, Jobi, Kantiku i Kantikëve, Ruthi, Vajtimet, Predikuesit, Esteri, Danieli, Ezdra, Nehemia, 1 & 2 Kronikave.

Tabela 1. Tre ndarjet e Kanunit hebraik

Krishti: përmbushësi i Dhiatës së Vjetër

Krishti, pra, pohoi që të tri pjesët e Dhiatës së Vjetër hebraike folën për të. Por ai tha më shumë se kaq: ai pohoi se ishte përmbushësi i Dhiatës së Vjetër. Jo se thjesht një sërë gjërash që i ndodhën atij, apo të tjerët i bënë atij, plotësuan disa profeci të Dhiatës së Vjetër – ndonëse kishte shumë gjëra që u plotësuan në mënyrë të tillë, por ai vetë, qëllimisht dhe me paramendim, vendosi të plotësojë Dhiatën e Vjetër.

Për shembull, në fillim të shërbesës së tij publike ai shpalli që qëllimi i ardhjes së tij ishte të përmbushte Ligjin dhe Profetët:

“Mos mendoni se unë erdha për të shfuqizuar ligjin ose profetët; unë nuk erdha për të shfuqizuar, po për të plotësuar. Sepse në të vërtetë po ju them: Deri sa qielli dhe toka të kalojnë, asnjë jotë a asnjë pikë e ligjit nuk do të kalojnë, para se të plotësohet gjithçka.” (Mat 5:17–18)

Po ashtu, në vizitën e tij të fundit në Jerusalem ai qëllimisht vendosi të plotësonte një profeci të Zakarias. Zakaria kishte profetizuar ardhjen e Mbretit – Mesia në Jerudalem:

“Ngazëllo me të madhe, o bijë e Sionit, lësho britma gëzimi, o bijë e Jerusalemit! Ja, mbreti yt po të vjen; ai është i drejtë dhe sjell shpëtimin, i përlurur dhe i hipur mbi një gomar, mbi një gomar të ri.” (Zak. 9:9)

Prandaj, kur në vizitën e tij të fundit Krishti mbërriti në rrethinat e Jerusalemit, ai qëllimisht dërgoi dy nga dishepujt e tij drejt një fshati fqinj për të marrë hua një gomar. Kur ia sollën, ai i hipi dhe e ngau në qytet. Ai pohoi kështu që të ishte Mbreti-Mesia i tyre që po vinte zyrtarisht në kryeqytetin e tij tokësor, Jerusalemin; dhe turmat e qytetarëve të zakonshëm, duke ndjerë se çfarë po ndodhte, iu përgjigjën me gëzim:

“Hosana Birit të Davidit! Bekuar qoftë ai që vjen në emër të Zotit! Hosana në vendet shumë të larta!”... “Ky është Jezusi, profeti nga Nazareti i Galileë.” (Mat 21:1–11)

E njëjta turmë u nxit më vonë nga drejtuesit e saj të kërkonin me zë të lartë kryqëzimin e tij. Por pas ringjalljes së tij ai u zbuloi dishepujve se vuajtjet dhe vdekja e tij nuk provonin që ishte një Mesia i rremë; por, përkundrazi, ato vërtetuan pohimin e tij:

“O budallenj dhe zemërngathët për të besuar gjithçka që kanë thënë profetët! Por a nuk duhej që Krishti të vuajë gjëra të tilla që të hyjë kështu në lavdinë e tij?” Dhe, duke zënë fill nga Moisiu dhe nga gjithë profetët, ai u shpjegoi atyre në të gjitha Shkrimet gjërat që i takonin atij. (Luka 24:25–27)

Krishti: ai që do të themelonte besëlidhjen e re

Atëherë, Krishti, pohoi që qëllimi i ardhjes së tij ishte të përmbushte Ligjin dhe Profetët. Por përmes një prej atyre profetëve, domethënë Jeremias, Perëndia premtoi që ai do të bënte një ditë një besëlidhje të re me shtëpinë e Izraelit dhe shtëpinë e Judës (31:31–34); dhe në darkën e fundit, në prag të kryqëzimit të tij, Krishti u shpalli apostujve të tij që përmes vdekjes së tij ai do të themelonte atë besëlidhje të re: “Kjo kupë është besëlidhja e re në gjakun tim, që është derdhur për ju.” (Luka 22:20)

Tani, në specifikimin e kushteve të kësaj besëlidhjeje të re, Perëndia tha specifikisht përmes Jeremias që besëlidhja e tij e re do të ishte e ndryshme në shumë drejtime prej besëlidhjes së vjetër. Ajo do të qe:

...jo si besëlidhja që kam vendosur me etërit e tyre ditën kur i zura për dore për të nxjerrë nga vendi i Egjiptit, sepse ata e shkelën besëlidhjen time... (Jer 31:32)

Sidoqoftë, ajo besëlidhje e vjetër qe bërë nga Perëndia me Izraelin mbi bazën e ligjit të dhënë nga Perëndia përmes Moisiut në Sinai. Dhe ky fakt na kthen tek pyetjet që ky libër presupozon të diskutojë: nëse besëlidhja e vjetër u mbështet mbi ligjin, dhe Krishti erdhi të përmbushë ligjin, si mundet që besëlidhja e re të jetë në thelb e ndryshme prej së vjetrës, pa e shfuqizuar ligjin? Cili është qëndrimi i Dhiatës së Re ndaj Ligjit, Profetëve dhe Psalmeve dhe si e interpreton Dhiatën e Vjetër në përgjithësi? Çfarë parimesh dhe metodash të interpretimit përdor ajo? Dhe si i justifikon ajo dallimet mes vetes dhe Dhiatës së Vjetër?

Këto nuk janë pyetje që të krishterët mund t'i shmangin sepse ato merren me vetë themelet e ungjillit. Të krishterët e të gjithë shekujve i kanë diskutuar ato dhe i diskutojnë ende. Disa prej përgjigjeve janë të lehta për t'u kapur. Disa kërkojnë shumë arsyetim rigoroz. Për rrjedhojë, ne mund edhe të tundohemi të pëlqejmë një rrugë më të drejtpërdrejtë drejt gjërave shpirtërore, dhe të shmangim studimin rigoroz të Shkrimeve. Por nëse është kështu, le të kujtojmë se çfarë vetë Zoti ynë ka thënë për ne:

“Fjalët që po ju them janë frymë dhe jetë.” (Gjoni 6:63)

Dhe këto fjalë janë shkruar për ne në Dhiatën e Re. Kështu, pra, që përkushtimi ndaj Krishtit do të thotë, siç ai vetë u tha dishepujve të tij, të mbash fjalën e tij, d.m.th ta çmosh si një thesar, ta kuptosh dhe t'i bindesh. Në të vërtetë, kjo është një prej mënyrave që ai shfaq veten për ne (Gjoni 14:21-24).

Për më tepër, apostulli Pjetër thekson se ishte Fryma e Krishtit që, përmes profetëve të Dhiatës së Vjetër, dëshmoi që më përpara për vuajtjet e Krishtit, lavditë që do të pasonin dhe përfitimet që do të vinin prej tyre për ne (1 Pjetri 12:1-10). Dhe është Fryma e Perëndisë që merr prej gjërave të Krishtit dhe na i kumton neve (Gjoni 16:14).

Prandaj, Fryma e Shenjtë na bën thirrje që ne të jemi të pjekur në intelekt dhe jo foshnje (1 Kor 14:20). Ne duhet ta duam Zotin Perëndinë tonë me gjithë mendjen tonë si edhe me gjithë zemrën, shpirtin dhe forcën tonë (Mat 22:37). Ne duhet të jemi gati të përdorim plotësisht mendjen që na ka dhënë Perëndia për të kuptuar fjalën e tij, por mbi të gjitha, le të lutemi që Krishti do të bëjë për ne atë që bëri për dishepujt e tij pas ringjalljes së tij:

Atëherë ua hapi mendjen, që të kuptonin Shkrimet.
(Luka 24:45)

Pa këtë ndihmë, mendja jonë do të jetë duke u munduar kot.

PJESA E PARË

Marrëdhënia e Përgjithshme e Dhiatës së Re me Dhiatën e Vjetër

1

Një Çështje Historike

*Varësia e Dhiatës së Re nga
Dhiata e Vjetër*

Ne do të fillojmë duke ngritur disa pyetje paraprake që janë tepër të thjeshta: pse, para së gjithash, Dhiata e Re e citon kaq shpesh Dhiatën e Vjetër? Së dyti, a duhet të vrasim mendjen shumë për të shqyrtuar të gjitha këto citime të Dhiatës së Vjetër? A nuk është e mundur që të kuptojmë mesazhin kryesor të Dhiatës së Re duke e lexuar si një libër të plotë në vetvete, duke anashkaluar të gjitha referencat e saj të së Vjetrës?

Nga një anë, sigurisht do të ishte e mundur ta lexonim Dhiatën e Re në këtë mënyrë të thjeshtë dhe sipërfaqësore, dhe prapë të përfitonim prej saj diçka të madhe dhe të përjetshme. Ka shumë mundësi që vjedhësi, i cili po vdiste përkrah kryqit të Krishtit, e njihte shumë pak Dhiatën e Vjetër (po ashtu Dhiata e Re ende nuk ishte shkruar), kur ai i kërkoi mëshirë me lutje Krishtit. Krishti iu përgjigj atij duke thënë vetëm një fjali të shkurtër; por aq mjaftonte për këtë person që po vdiste që të ishte i sigurt për shpëtimin. Ai vdiq i sigurt se Perëndia e kishte falur dhe pranuar atë, dhe se ai, po atë ditë, do të ishte me Krishtin në parajsë (Luka 23:39–43).

Mund të supozojmë që ka patur shumë njerëz në të

kaluarën të cilët, gjithashtu nuk kanë ditur gjë tjetër prej Biblës, përveçse, le të themi, thënies së famshme të Zotit tek Gjoni 5:24. Por megjithatë, në atë varg të frymëzuar kanë dëgjuar zërin e Krijuesit të tyre, dhe kanë besuar në Birin e tij, Jezus Krisht. Me këtë si themel, ata kanë udhëtuar gjatë jetës duke patur paqe me Perëndinë (Rom 5:1), të lumtur që kanë jetë të përjetshme dhe të sigurt që do të jenë përjetësisht me Krishtin në shtëpinë qiellore të Atit (Gjoni 14:1–3).

Megjithatë vetë Dhiata e Re na tregon (si provë të kësaj lexoni Heb. 5:7-14) që, nëse duam të kemi një kuptim sa më të plotë të ungjillit, duhet të njohim edhe më shumë e më mirë se kush është Jezus Krishti, se çfarë ka bërë, çfarë po bën, dhe çfarë do të bëjë ende për shpëtimin tonë; sepse këto gjëra janë vetë ungjilli. Por pa patur njëfarë njohjeje të historisë që Dhiata e Vjetër dokumenton, nuk do të arrijmë t'i kuptojmë këto gjëra aq sa mundet, dhe aq sa duhet. Arsyeja për ta bërë këtë, kur ta kuptojmë, do të na çojë si rrjedhojë te një çështje tjetër e një rëndësie jetike.

Disa të vërteta

Ungjilli i krishterë nuk është një antologji thëniesh abstrakte të vërteta siç janë ligjet e matematikës. Ndonëse, natyrisht, që në zemër të ungjillit qëndron dikush që pohon se është e vërteta (Gjoni 14:6). Ungjilli as nuk është një lloj filozofie e ngritur përmes një argumentimi racional mbi natyrën e universit që na rrethon dhe mbi përvojën tonë njerëzore brenda tij. Vlefshmëria e një lloj filozofie të tillë do të mbështetej, jo mbi disa ngjarje historike të caktuara, por mbi vërtetësinë e aksiomave të saj dhe mbi koherencën e tyre si një sistem arsyetimi. Ungjilli i krishterë është, aq më pak, një lloj misticizmi i mbështetur mbi spekulime teozofike, johistorike që mund t'i përfitosh përmes manipulimit psikologjik të vetes.

Ungjilli i krishterë është i lidhur pazgjidhshmërisht me historinë. Në qendër të tij është figura historike, Jezusi i Nazaretit, që u lind prej një virgjëreshe në një periudhë të caktuar historike (kur Cezar Augusti ishte perandor në Romë dhe Herodi i Madh ishte mbret në Jude), dhe në një vend të caktuar, Betlehemin e

Judesë; që jetoi dhe mësoi në një vend të caktuar (Palestinë); që u kryqëzua dhe u varros në një kohë të veçantë (kur Ponc Pilati ishte prefekti romak në Jude, dhe Cezar Tiberi ishte perandor në Romë); që tri ditë më pas u ngjall prej së vdekurish dhe dyzet ditë më vonë u ngjit në qiell.

Por përmasa historike e Besimit shkon edhe përtej kësaj. Ungjilli nuk zuri rrënjë për herë të parë në histori kur Krishti hyri në botën tonë. Ai që rrënjosur në histori shekuj të tërë para se ai të lindte. Fakti që Perëndia e përgatiti rrugën për ardhjen e Krishtit prej shumë shekujsh, është pjesë themelore e ungjillit të krishterë. Ai e bëri këtë duke paralajmëruar paraprakisht shumë herë për ardhjen e tij përmes një zinxhiri profetësh, duke specifikuar metodën dhe vendin e lindjes së tij, mesazhin që do të shpallte dhe shlyerjen që ai do të bënte për mëkatet njerëzore – dhe këto paralajmërime, premtime dhe përshkrime i la me shkrim për ne në ato që të krishterët tani i quajnë libra të Dhiatës së Vjetër. Pas kësaj ato u kopjuan dhe u shpërndanë për t'u lexuar dhe studiuar gjatë shekujve të tërë derisa Krishti u lind (shih, për shembull, Jer 36:1–32; Dan 9:2).

Prandaj është fare e kuptueshme që apostulli Pal, në shtjellimin e tij madhor të ungjillit, të prezantojë Zotin Jezus Krisht duke theksuar tre fakte historike që kanë secila një rëndësi të madhe themeltare:

1. Fakti që ungjilli që premtuar prej Perëndisë para se Krishti të vinte, përmes profetëve në Shkrimet e Shenjta (d.m.th. Dhiata e Vjetër) – (Rom 1:1–2).

2. Fakti që Krishti u lind prej pasardhjes së Davidit sipas mishit (Rom.1:3), ndërkohë që Davidi kishte qenë mbret i Judesë rreth vitit 1000 para Krishtit.

3. Fakti i ringjalljes së Krishtit që e shpalli me fuqi atë të ishte Biri i Perëndisë (Rom 1:4).

Për të vlerësuar forcën dhe domethënien e dy prej tri fakteve të para, duhet të lexojmë tërësisht Dhiatën e Vjetër. Por jo vetëm kaq, sepse në përmbledhjen tjetër që Pali i bën ungjillit (1 Kor. 15:1-4) ai pohon që qoftë vdekja e Krishtit, qoftë ringjallja e tij ngjanë sipas Dhiatës së Vjetër. Fjalët e tij janë:

1. “Krishti vdiq për mëkatet tona sipas Shkrimeve”

2. “Ai u varros”

3. “Ai u ngjall të tretën ditë sipas Shkrimeve”

Për të krishterët e hershëm fakti që vdekja e Krishtit si edhe ringjallja e tij ishte parathënë në Dhiatën e Vjetër, përbënte në realitet një themel të fortë për besimin e tyre personal. Le të mbajmë parasysh dy dishepujt në tregimin e famshëm të Lukës (Luka 24:13–35). Tri ditë pas kryqëzimit të Krishtit ata po ktheheshin në shtëpitë e tyre në fshatin e Emausit kur një i huaj u bashkua me ta në rrugëtim. Ata hapën zemrat me të dhe rrëfyer zhgënjimin e tyre të thellë. Ata qenë të bindur se Jezusi i Nazaretit ishte Mesia i dërguar prej Perëndisë për të çliruar Izraelin prej sundimtarëve shtypës të Romës imperialiste. Por tri ditë më parë gjërat kishin shkuar keq në Jerusalem; dhe në vend që të rekrutonte dhe të drejtonte forca izraelite drejt fitores, Jezusi as nuk u përpoq që të rezistonte, por e lejoi veten të arrestohej, dënohej, torturohej dhe kryqëzohej.

Dishepujt qenë ende të tronditur. Vërtet, kishte disa gra të krishtera, siç thanë, që u kishin treguar se panë një vizion engjëjsh të cilët pohonin se Krishti që i gjallë (24:23); por ky raport nuk kishte larguar zhgënjimin e tyre të thellë – dhe kjo për arsye të drejta. Sipas asaj që ata kuptonin prej Dhiatës së Vjetër, Shpëtimtari dhe Çlirimtari i premtuar i Izraelit që paracaktuar të ishte një Mbret – I vajosur fitimtar sipas modelit të mbretit David. Prandaj, një mesia që e lejonte veten të vritej prej armiqve të tij ishte një kontradiktë. Për rrjedhojë, ai nuk mund të ishte realisht Mesia. Prandaj llafet e grave për ringjalljen e tij nuk kishin asnjë vlerë. Mesia i vërtetë nuk do të kishte pasur nevojë për një ringjallje, sepse atë nuk do të mund ta kishin vlarë dot para së gjithash.

Natyrisht, gabimi i tyre themeltar nuk që se ata nuk e kishin lexuar Dhiatën e Vjetër. Ata e kishin lexuar; por e kishin lexuar me copa, duke parë atë që donin dhe duke mbyllur sytë para asaj që nuk donin të shihnin. Ata ishin përqendruar në pasazhet që tregonin se Shpenguesi i Izraelit do të ishte një Mbret – Mesia fitimtar, si Davidi; por kishin anashkaluar pasazhet që thanë, po aq qartë, që ai, si Shërbëtor i Zotit, do të vuante si një sakrificë për mëkatet e Izraelit, dhe ato të botës (krh. Isa 53).

I huaji i qortoi me mirësjellje, por rreptë: “O budallenj dhe

zemërngathët për të besuar gjithçka që kanë thënë profetët!"; pastaj duke u bërë një përmbledhje të të gjithë Dhjatës së Vjetër, ai theksoi se, për të përmbushur të gjitha gjërat që profetët kishin parathënë, Mesia duhet të vuante së pari dhe pastaj, vetëm pastaj, do të hynte në lavdinë e tij (Luka 24:13–27).

Pas kësaj, si ardhja e një dallge të fuqishme, zemrat e tyre i pushtoi besimi. Nëse vuajtjet dhe vdekja e Jezusit që sipas Shkrimeve, do të thoshte se fakti që ai kishte vuajtur ishte provë e fortë, jo që ai nuk ishte Mesia, por që ai ishte. Por nëse Shkrimet dëshmojnë që Mesia jo vetëm do të vdiste, por edhe do të ngjallej, ndoshta ata duhet t'u kishin vënë veshin grave të krishtera dhe të hetonin evidencën që Jezusi që aktualisht i gjallë.

Gjatë vaktit të darkës në të njëjtën ditë ata zbuluan se i huaji që vetë ai.

Kështu, Perëndia kishte përgatitur gjërat për ardhjen e Birit të tij duke dhënë paralajmërime paraprake të profetët për vendlindjen e tij, kohën e lindjes së tij, jetën, vdekjen shlyese, ringjalljen, lartësimin, shërbesën kryepërfetërore dhe ardhjen e dytë. Por kishte edhe më shumë se kaq: sepse në një farë kuptimi, jo vetëm që ka patur paralajmërime të hershme, por e gjithë historia e kombit të Izraelit ishte një përgatitje për ardhjen e Krishtit.

Tri epokat e mëdha në zhvillimin shpirtëror të kombit

Këto i shohim tek Ungjilli i Mateut. Në hyrjen e tij ai e prezanton Jezus Krishtin si birin e Davidit, bir i Abrahamit. Qartazi, Mateu nuk po sugjeron që të vëmë re, pa i kushtuar rëndësi, se rastisi që të ishin dy burra të quajtur David dhe Abraham, mes shumë të tjerëve në linjën gjenealogjike të Krishtit, pa vrarë mendjen më tej se kush janë ata. Këta burra qenë personazhe me peshë në kohën e tyre: njëri ishte themeluesi i një kombi unik në kronikat e historisë botërore; dhe tjetri ishte themeluesi i dinastisë mbretërore të këtij kombi. Duke na treguar që Jezus Krishti është bir i Abrahamit dhe bir i Davidit, Mateu nuk po na thotë

vetëm se ai ka rrjedhur fizikisht prej tyre: ai po pohon që Jezus Krishti është trashëgimtar i asaj që ata ishin dhe përfaqësonin, dhe i besëlidhjeve që Perëndia bëri me ta (shih Zanafilla 15; 2 Samueli 7). Dhe nuk do të jetë e mundur ta kuptojmë të gjithë këtë pa studiuar pasazhet e gjatë të Dhiatës së Vjetër.

Për më tepër, duke hapur Ungjillin e tij me një gjenealogji të hollësishme të Krishtit siç edhe ka bërë në të vërtetë, Mateu nuk mjaftohet thjesht duke hartuar një listë individësh në një zinxhir biologjik të pasardhjes së Krishtit që nga Abrahami, sepse Mateu i ndan brezat që nga koha e Abrahamit të Krishti në tre grupe të mëdha të barabartë (Mat 1:17):

1. Nga Abrahami të Davidi mbret (1:1–6);
2. Nga Davidi të mërgimi në Babiloni (1:6–11);
3. Nga mërgimi të lindja e Krishtit (1:12–17).

Kjo njëherazi na thotë që parapërgatitja e Izraelit prej Perëndisë për ardhjen e Krishtit nuk u realizua përmes thjesht një sekuence lindjesh monotone dhe të ngjashme. Brenda shekujve që rrodhën prej Abrahamit deri të Krishti, pati tri epoka të mëdha, lehtësisht të dallueshme në përvojën dhe edukimin shpirtëror të kombit. Dokumentimi i tyre në Dhiatën e Vjetër tregon që secila epokë filloi me një shpresë të madhe dhe të lavdishme të cilën Perëndia ia dha popullit të tij, për t'i motivuar dhe fuqizuar ata që të vazhdonin në të ardhmen me një pritje të sigurt për gjëra më të mëdha edhe më të mira në ditët që do të vinin. Natyrisht, secila epokë kishte anën e saj të errët. Ashtu si edhe një fëmijë i kupton pak pasojat e pafundme të mëkatit, por i zbulon ato vetëm duke i provuar vetë ndërsa rrihet me jetën, po ashtu edhe kombi i Izraelit – dhe natyrisht të gjitha kombet e tjera gjithashtu – iu desh të mësonin prej përvojës shkallën e fortësisë së helmit të mëkatit (që nuk çrrënjëset kollaj në dukje) në jetët e individëve, familjeve, kombeve, institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare, që damkos përparimin njerëzor dhe pengon shpresat dhe përpjekjet tona më të mira.

Por nxënia e këtij mësimi ishte në vetvete një përparim drejt ardhjes së Krishtit; sepse si mundej ndryshe Izraeli të kuptonte që e vetmja shpresë do të ishte ardhja e një Shpëtimtari hyjnor i cili është më shumë se njerëzor?

Në të njëjtën kohë Perëndia mbajti gjallë, forcoi dhe zgjeroi në mënyrë progresive shpresën e Izraelit, jo vetëm duke dhënë paralajmërime, parashikime dhe profeci të ardhjes së Shpenguesit, por gjithashtu duke i dhënë formë historisë që t'u jepte atyre vazhdimisht shembuj të përkohshëm, hije, tipe, prototipe, ilustrime, dhe koncepte të asaj sesi do të ishte Shpenguesi, dhe çlirimi që ai do të sillte. Në këtë mënyrë, Perëndia edukoi popullin e vet, zgjeroi dhe rafinoi konceptet e tyre, u dha kritere përmes të cilave ata mund vlerësonin një ditë pohimet e Jezus Krishtit që ishte bir i Abrahamit, bir i Davidit, Bir i Perëndisë, Bir i Njeriut, Qengji i Perëndisë që heq mëkatën e botës, prifti i përjetshëm sipas rendit të Melkisedekut.

Me këtë në mendje, le të rishikojmë shkurtimisht tri periudhat e historisë së Izraelit për të cilat flet sistemimi që Mateu i ka bërë gjenealogjisë së Krishtit. Ndërsa do e bëjmë këtë, do të shohim që secila periudhë ka një trajektore të ndryshme; asnjëra prej tyre nuk riprodhon atë që ka bërë tjetra më parë.

Trajektorja e periudhës së parë: Nga Abrahami te Davidi (Mat. 1:2–6)

Periudha e parë filloi kur Perëndia thirri Abrahamin të linte kulturën e tij lokale pagane për të themeluar një komb të ri, të dallueshëm si një dëshmitar për Perëndinë e vetëm dhe të vërtetë, dhe si një protestë kundër interpretimeve idhujtare të universit që ishin të pranishme gjithandej (shih Joz 24:2–3; Isa 41:8–10; 43:1, 10–12). Kështu filloi pozicioni i famshëm i Izraelit për monoteizmin. Është e vërtetë që pasardhësit e Abrahamit, shpesh në vijim, bënë me vepra kompromise me politeizmin, saqë për t'i shëruar prej tij, Perëndia duhet ta syrgjynoste kombin në Babiloni dhe të shkatërronte tempullin e Jerusalemit. Por monoteizmi nuk u braktis plotësisht asnjëherë: një linjë e gjatë profetësh izraelitë u kujdesën që kjo të mos ndodhte. Kur më në fund kombi u kthye në vendin e Palestinës, realisht ishte shëruar tërësisht prej idhujtarisë; dhe kur në ditët e tij Jezus Krishti hyri në tempullin e Jerusalemit, nuk gjeti asnjë idhull brenda oborreve apo mureve të tij. Judaizmi ortodoks nuk u

kthye më pas në politeizëm.

Kështu që duhej të kalonin shekuj që Perëndia të rrënjoste në Izrael monoteizmin; por që një përgatitje e pashmangshme për ardhjen e Krishtit. Çfarë kuptimi do të kishte që të shpallej Jezusi si Biri i Perëndisë, nëse askush nuk e dinte se kush ishte Perëndia, dhe ende besonin në qindra perëndi dhe perëndesha – të mëdha dhe të vogla – dhe gjithashtu në njerëz të hyjnizuar, secili me bijtë dhe bijat e tyre imagjinare, po aq imoralë sa vetë njerëzit që i kishin krijuar sipas imazhit të tyre?

Pasi ia zbuloi veten Abrahamit, pasi e thirri të linte familjen e tij, dhe e solli në Kanaan, Perëndia e përmbledhi qëllimin e tij shekullor për Abrahamin dhe pasardhjen e tij duke i bërë një premtim të katërfishtë:

1. Një tokë të premtuar për veten dhe farën e tij për trashëgimi (Zan 12:1; 13:14–18; 15:7–9, 18–21).
2. Pasardhës të shumtë si rëra e detit dhe si yjet (Zan 12:2; 13:16; 15:5; 22:17).
3. Bekime mbi të dhe farën e tij, me qëllim që përmes farës së tij të gjitha kombet e tokës të bekohen (Zan 12:3; 22:18).
4. Mbretër do të dilnin prej tij (Zan 17:16).

Vini re, atëherë, trajektoren e plotësimit të këtyre premtimeve.

Pasardhja e Abrahamit nuk ishte shumë me shumë se një fis me rreth 70 anëtarë (Zan 46:8–27) kur ata panë me sytë e tyre një përmbushje të hershme të premtimit nr.3: në providencën e Perëndisë, biri i Jakobit, Jozefi, përmes një periudhe vuajtjesh të pamerituara, dhe pa dëshirë për t'u hakmarrë, u bë shpëtimtari ekonomik jo vetëm i Egjiptit, por edhe i të gjitha fiseve të vogla dhe kombeve që i rrethonin (Zan 41).

Kjo ishte një përmbushje reale, megjithëse e pjesshme, e premtimit. Por jo vetëm kaq: ajo do të ishte një prototip i përmbushjes së madhe finale, kur pasardhësi i Abrahamit, njeriu – Jezus Krisht – si pasojë e vuajtjeve të tij të pamerituara (1 Pjet 2:21–25; Heb 2:9–10), do të kurorëzohej me lavdi dhe nder, dhe do të shpallej moralisht i denjë për të marrë fuqi, pasuri, dituri, pushtet, nder, lavdi dhe bekim, dhe të administrojë universin për lavdi të Perëndisë, si edhe për bekimin e racës njerëzore.

Nga vetë natyra e tyre, prototipat janë të përkohshëm; por pas vdekjes së Jozefit farefisi i tij që jetonte tani në Egjipt, u transformua në një komb të veçantë. Premtimi nr. 2 që duke u përmbushur; por për pjesën më të madhe të 400 vjetëve ata iu nënshtruan skllavërisë – siç edhe i kishte treguar Perëndia Abrahamit se do të ndodhte (Zan 15:13–16). Por megjithatë, qëllimet e Perëndisë po përparonin, dhe ai dërgoi Moisiun te Faraoni skllavërues me një kërkesë të pafuzueshme “Lëre popullin tim të shkojë me qëllim që të më shërbejë.” (Eks 8:1).

Ai mesazh i prerë ka jehuar në të gjithë shekujt dhe ka frymëzuar luftën e të shtypurve për liri. Por ai ka një kuptim më të gjerë. Sepse nuk ishte thjesht një luftë për emancipim shoqëror dhe politik prej një skllavërie. Në atë kohë vetë Izraeli duhej të mbrohej prej engjëllit të gjykimit të Perëndisë – kështu që ai u çlirua përmes gjakut të Qengjit të Pashkës (Eks 12).

Kështu që për Izraelin ishte një përvojë reale, historike e shpengimit të Perëndisë. Por që shërbente gjithashtu si një prototip tjetër i një shpengimi më të madh prej një skllavërie më të madhe e cila do të sigurohej prej gjakut të Krishtit, Qengjit tonë të Pashkës (shih 1 Kor 5:7; 1 Pjet 1:18–20).

Moisiu më pas i nxori izraelitët prej Egjiptit, dhe Jozueu i çoi më në fund në trashëgiminë e tyre të premtuar, në kohën e duhur sipas premtimit nr.1 (shih Zan 15:13–16). Rreth 400 vjet më vonë trajektorja e periudhës së parë realizoi qëllimin e saj madhor: Davidi, biri i Jeseut, i vajosuri i Zotit, u kurorëzua mbret, fillimisht mbi dy fiset, dhe pas shtatë vjetësh mbi të gjithë Izraelin (2 Sam 5:1–5). Premtimi nr.4 kishte filluar të plotësohej.

Izraeli kishte ndryshuar shumë që nga koha kur Perëndia për herë të parë i bëri premtimet e tij Abrahamit; dhe, historikisht, kjo ishte vërtet një kohë e realizimit të shpresave, të përparimit, të arritjeve, të suksesit dhe përmbushjeve. Izraeli nën Davidin ishte çliruar prej të gjithë armiqve të tij, dhe tani ishte një komb i bashkuar dhe i ndërgjegjësuar për këtë, sovran në vendin e tij, me një mbret të vetin, në gjendje të mbante kokën lart si një komb i lirë mes gjithë kombeve të tjera.

Davidi, luftëtari i tyre heroik dhe guximtar, i pëlqyer shumë si mbret dhe me dell poetik gjenial, kishte fituar respektin e monarkive fqinjë; dhe në dijeninë e tij ose jo, la një emër të

paharrueshëm në histori. Miliona njerëz këndojnë psalmet e tij edhe sot.

Për më tepër, në Davidin Perëndia i kishte dhënë Izraelit – dhe kombeve përreth – një prototip, një lloj hijeje reale por të dobët, një grimë, fillimet e një ideje sesi Krishti, Biri i Davidit, do të ishte, dhe çfarë do të bënte kur të vinte një ditë. Por kuptohet atëherë që Davidi nuk ishte vetë Krishti. Në shumë drejtime Krishti duhet të ishte – dhe do të ishte – shumë i ndryshëm prej Davidit; sepse një Krisht që do të ishte thjesht një kopje e Davidit, apo qoftë edhe një version i zmadhuar i Davidit, nuk do të ishte zgjidhja finale për problemet e racës njerëzore.

Perandoria e Davidit ishte shumë e vogël në krahasim me fuqitë botërore të kohës së vet; dhe ai sigurisht nuk mundi të vendoste paqen në botë. Davidi e ngriti perandorinë e tij me shpatë dhe ushtë, me gjak dhe, me raste, me barbarizma (krh. p.sh. 2 Sam 12:31). Përvoja e shekujve të shkuar na ka treguar se një sundimtar që mundohet të arrijë sundim botëror duke përdorur ushtën dhe shpatën, apo bombat atomike dhe raketat ndërkontinentale, nuk mund të jetë asnjëherë shpëtimtari i botës, aq më pak të mund të themelojë mbretërinë e Perëndisë në botë.

Për më tepër, megjithëse që aq i fuqishëm sa ishte, Davidi, si çdo sundues tjetër njerëzor, e pati karakterin e tij të njollosur nga epshi, teprimet dhe vrasjet (shih. 2 Sam 11). Davidi e kuptoi këtë dhe e rrëfeu (Ps 51); dhe në Psalmin e tij profetik 110 këndoi për një bir të ardhshëm, të ndryshëm nga vetja e tij që ndonëse pasardhës i tij, do të ishte Zoti i tij. Ky Bir do të ishte moralisht i denjë për të qenë i ftuar prej Perëndisë të ulej në të djathtën e Perëndisë, dhe të caktohej prej Perëndisë për të qenë një prift përjetë sipas rendit të Melkisedekut (Ps 110:1, 4).

Kështu, koncepti që Izraeli do të kishte për Mbretin e ardhshëm do të zgjerohej.

Trajektorja e periudhës së dytë: nga Davidi te mërgimi në Babiloni (Mat 1:6–11)

Në fillim të sundimit të tij Davidi pushtoi qytetin e jebusitëve, Jerusalemin, dhe e caktoi si qytetin e tij mbretëror dhe kryeqytetin

e 12 fiseve të Izraelit të sapobashkuar (2 Sam 5:4–10).

Ai bëri më shumë se çfarë mund të kuptonte. Disa mijëra vite më vonë Jezus Krishti, bir i Abrahamit, bir i Davidit, njeriu që ishte Perëndi, do të hynte duke kalëruar në atë qytet, si mbreti i shumëpritur i Sionit (Zak 9:9; Mat 21:1–11). Një javë pas kësaj, jashtë vetë mureve të qytetit, ai do të ofronte veten para Perëndisë si Qengji i Perëndisë që do të hiqte mëkatën e botës (Gjoni 1:29). Që atëherë, duke filluar nga Jerusalemi, një mesazh pendese dhe faljeje në emrin e tij është shpërndarë në të gjithë botën (Luke 24:47). Miliona e kanë besuar atë, dhe ndonëse ka miliona të tjerë që nuk e besojnë, prapë Jerusalemi ka ngeluar ende zemra jo vetëm e izrealitëve, por edhe e gjithë botës hebraike kudo, si edhe një qytet i shenjtë për milionat e Islamit, edhe një qendër trazirash politike për kombet e botës.

Por të kthehemi tek fillimi i periudhës së dytë. Ashtu si periudha e parë, ajo filloi me një premtim madhështor prej Perëndisë: Davidi do të kishte një bir që do të lejohej të ngrinte një shtëpi për emrin e Perëndisë; dhe Perëndia premtoi ta bënte të qëndrueshëm për gjithnjë fronin dhe dinastinë mbretërore të Davidit. Kuptohet se ky premtim qe pjesërisht i kushtëzuar. Nëse pasardhësit e Davidit do të silleshin keq Perëndia do t'i disiplinonte; por edhe ndonëse kjo mund të ishte e rëndë Perëndia kurrë nuk do ta zhbënte përherë apo plotësisht dinastinë e Davidit (2 Sam 7:12–16).

Për pasojë, kjo periudhë e dytë lulëzoi në një epokë shkëlqimi, paqeje dhe bollëku. Salomoni, biri i Davidit, u bë i famshëm ndërkombëtarisht për urtësinë e tij (1 Mbr 4:29–34; 10:1–25). Nën atë, feja mbërriti në maja të larta: ai ndërtoi një tempull të përhershëm që Perëndisë i pëlqeu ta vizitonte me renë e lavdisë së tij, dhe e caktoi si një qendër ndihme për të mbajtur gjallë Izraelin gjatë shekujve, dhe t'i mëkëmbte nëse ata do të gabonin udhë (1 Mbr. 8:22–53). Politikisht, ata nuk u kërcënuan as nga ndonjë armik apo fatkeqësi (1 Mbr. 5:4). Ekonomikisht, pati një begati të jashtëzakonshme (1 Mbr. 4:20, 25; 10:27). Dukej si një kohë e artë, dhe në të vërtetë ishte.

Por ishte diçka më shumë: sepse ajo shërbeu si një prototip i hershëm, një hije e epokës së ardhshme mesianike kur nën

sundimin e një “më të madhi se Salomoni” (Mat 12:42), do të përmbushej vizioni i paqes botërore të Isaiaas:

Në ditët e fundit do të ndodhë që mali ku ndodhet shtëpia e Zotit do të vendoset në majën e maleve ...dhe këtu do të vërshojnë tërë kombet. ... Do të farkëtojnë shpatat e tyre duke i kthyer në plugje dhe heshtat e tyre në drapinj; një komb nuk ka për të ngritur shpatën kundër një kombi tjetër dhe nuk do të mësojnë më luftën. (Isa 2:1–4) Zoti i ushtrive do të përgatisë tërë popujve mbi këtë mal një banket ... Do të shkatërrojë përgjithnjë vdekjen; Zoti, Zoti, do të thajë lotët nga çdo fytyrë,... (25:6–8)

Nuk ka nevojë ta themi se koha e artë e Salomonit la shumë për të dëshiruar në krahasim me epokën e ardhshme mesianike; dhe patjetër që ajo nuk zgjati. Afër fundit të sundimit të tij, vetë Salomoni ra në marrëzi të pështirë, u kompromentua shumë me fetë idhujtare të grave të tij të shumta (1 Mbr. 11:1–13), dhe e detyroi kombin të bënte punë angari të shumta (1 Mbr. 12:1–4). Si rrjedhojë, menjëherë pas vdekjes së tij, 10 prej fiseve braktisën shtëpinë e Davidit dhe ngritën një komb të pavaruar nën një mbret tjetër. Ai mbret shumë shpejt braktisi tempullin e Zotit në Jerusalemin, dhe i udhëhoqi 10 fiset drejt një adhurimi idhujsh dhe në fund fare plotësisht pagan (1 Mbr. 12:25–33). Asnjë prej mbretërve që erdhën pas atij nuk u pendua për idhujtarinë e tyre (shih 2 Mbr. 15:9, 18, 24, 28); dhe në fund, Perëndia lejoi asirianët të shpërngulnin shumicën e popullsisë në Asiri (2 Mbr. 17).

Disa prej mbretërve të linjës së Davidit që sunduan mbi dy fiset e mbetura qenë njerëz më të mirë; dhe disa nga ata si Asa, Jozafati, Joasi, Ezekia dhe Josia, nxitën zgjime të mëdha të fesë së vërtetë. Por përfundimisht, edhe mbretërit e Judës e drejtuan popullin në prag të apostazisë, larg prej Perëndisë së vërtetë dhe të gjallë. Në fund fare Perëndia nuk mund ta toleronte më gjatë (2 Kro. 36:11–21). Ai bëri atë që shumë hebrej nuk e kishin menduar se do të ndodhte (Jer 7:1–34): Ai lejoi ushtritë e Nebukadnetsarit, mbretit të Babilonisë, të shkatërronin tempullin e famshëm të Perëndisë në Jerusalemin, të plaçkisnin Jerusalemin, qytetin e Davidit, dhe të pezullonte linjën e gjatë mbretërore të Davidit.

Ishte një goditje e madhe për shumë judenj (Ps. 89); por ishte një pjesë shumë e rëndësishme e edukimit të vazhdueshëm të kombit dhe përgatitjes për ardhjen e Mesisë, Birit të Davidit. Izraeli dhe Juda duhej të mësonin se të qenit populli i zgjedhur i Perëndisë, për të qenë dëshmitarë të të vetmit Perëndi të vërtetë, nuk ishte një lloj anshmërie që do t'u lejonte atyre të mëkatonin me imunitet (krah. Amos 3:1–2). Ata duhet të mësonin se feja formale, lutjet hipokrite, ritualet boshe të ngjashme me bestytni, ndërtesat e shenjta dhe institucionet e respektuara, nuk mund të ishin si ryshfet për Perëndinë për të bërë një sy qorr ndaj imoralitetit publik dhe privat, korrupsionit tregtar dhe politik, dhe shtypjes së të varfërve (shih Isa 1:1–31). Disiplinimi i Perëndisë ishte i ashpër; por ata duhej të përballeshin me seriozitetin e mëkatit. Nëse jo, a do ta ndjente ndonjëherë kombi nevojën për një shpëtimtar për mëkatet e veta kur Perëndia do ta dërgonte atë një ditë?

Kështu që në këtë pikë të edukimit të kombit duhej dhënë edhe një mësim tjetër. Thellësia e mëkatit, në të cilin ishte zhytur kombi, e bënte të kuptueshme që ata nuk mund të mëkëmbeshin thjesht prej një force ushtarake të ndonjë heroi ushtarak si Mbreti David. Shlyerja e mjaftueshme për mëkatet e kombit duhej bërë. Dhe një ditë ajo do të bëhej, tha Isaia (kap.53) nga një person që e portretizoi si Shërbëtorin vuajtës të Perëndisë. Mënyrën sesi ky person do të lidhej me Mbretin – Mesia të premtuar, fitimtar të pasardhjes së Davidit, Isaia nuk na e thotë me hollësi. Historia vetë do ta qartësonte këtë.

Por ndërkaq profeti Jeremia i cili denoncoi mëkatet e mbretërve dhe popullit, dhe paralajmëroi për syrgjynosjen e afërt dhe të pashmangshme, shpalli, sidoqoftë, në emrin e Perëndisë, se Perëndia një ditë do të mëkëmbte kombin në vendin e tyre, do të rindërtonte tempullin dhe qytetin e Jerusalemit, dhe do t'u dërgonte një Bir të Davidit për t'u ulur në fronin e Davidit (Jer 30:1–22; 33:1–26). Kështu u mbajt gjallë shpresa e kombit. Pavarësisht gjendjes së ulët të tyre, ata ishin tani më afër ardhjes së Krishtit se më parë.

Trajektorja e periudhës së tretë: Nga mërgimi te lindja e Krishtit (Mat 1:12–16)

Me fjalë shprese të Jeremiës që tingëllonin në veshët e tij, një princ i ri judeas me emrin Daniel u syrgjynos nga trupat e Nebukadnetsarit në Babiloni (Dan 1:1–7). Jeremia kishte thënë që syrgjynosja e kombit të tij në Babiloni do të zgjaste 70 vjet, dhe pastaj Perëndia do të mëkëmbte kombin në tokën e tij (Jer 25:11–12; 29:10–14). Danieli nuk e harroi këtë premtim (Dan. 9) që u përmbush në fund nën sundimin e Kirit, mbretit të Persisë (2 Kron. 36:22–23; Ezdra 1:1–11). Nën udhëheqjen e Zerobabelit dhe Jeshuas u rindërtua tempulli në Jerusalem (shih Ezdra 3:1–6:22); dhe nën mbikëqyrjen e Nehemias u ngritën muret e qytetit (shih Neh 1:1–13:31). Por në atë kohë nuk u vendos ndonjë nga linja e Davidit në fron; kombi i kthyer në tokën e tij që ende nën kontrollin e mbretërve të Persisë, dhe pas asaj nën grekun Aleksandër dhe pasardhësve të tij, Ptolemaidë dhe Seleucidë.

Kjo nuk do ta kishte habitur Danielin. Një karrierë e gjatë në poste të larta, në shërbimin civil perandorak, fillimisht të Babilonisë dhe më pas atë të Persisë, e kishte bindur që Mesia i Perëndisë nuk mund të kufizohej vetëm në zgjidhjen e problemeve të Izraelit të vogël, dhe të ishte mbret i një shteti sa një shami xhepi në Lindjen e Mesme. Për të qenë i denjë për Perëndinë, Krijuesin dhe Zotin Sovran të universit, Mesia duhej të zgjidhte problemet e të gjithë botës duke përfshirë ato të supershteteve mbizotëruese.

Për më tepër ai pa që problemet e botës nuk do të zgjidheshin në mënyrë përfundimtare prej një gare ndërkombëtare armësh, në fund të së cilës një supershtet botëror do të nënshtrohte të gjitha shtetet e tjera (Dan 2:25–45; 7:1–12). Mesia, Mbreti i Mbretërve, sundimtari i princave të dheut, siç e pa Danieli në vizionin e tij, sigurisht që do të që njerëzor: jo vetëm Bir i Davidit, por edhe Bir i Njeriut (Dan 7:9–14). Por kur ai do të sundonte të gjithë botën, si vetë Perëndia, do të zbriste me retë e qiellit (7:13–14; krh. Luka 21:27; 22:69–70; Zbu 1:5–7); sepse në fakt do të ishte Perëndia i mëshiruar.

Po, kur më vonë në periudhën nr.3, në vitin 167 para Krishtit, Perandori Seleucidë, Antioku IV Epifani, nxiti një përndjekje

fetare mizore të hebrenjve, makabenjtë, në sytë e tyre i qëndruan besnikë Perëndisë duke rrëmbyer armët, dhe përmes një lufte guerile dhe taktikave të shkëlqyera të betejave, ia dolën në fund të fitonin lirinë dhe pavarësinë politike të Izraelit. Kështu filloi e ashtuquajtuara dinasti hasmoneane, që zgjati deri më 37 para Krishtit, dhe në një fazë të caktuar mëkëmbi kufijtë e Izraelit deri afër atyre që kishin qenë në kohën e Davidit. Por mbretëria e tyre, e mbështetur në zhdërvjelltësi ushtarake dhe disa herë mbi dhunë të pastër, degjeneroi vetë në mizori, intriga dhe korrupsion; që sollën rrënimin e saj para fuqisë së Romës perandorake.

Sërish, Danieli nuk do të ishte çuditur. Kjo përpjekje, ai kishte thënë (Dan 11:34), të themeloje mbretërinë e Perëndisë me forcën e armëve, do të kishte pak fuqi dhe do të prishej prej ndjekësve të rremë të tij. Por ky dështim duhej ta kishte paralajmëruar Izraelin për kotësinë e të supozuarit që ata mund të themelonin mbretërinë e Perëndisë së Plotfuqishëm mbi tokë me forcën e armëve, dhe duhet t'i kishte shtyrë ata në përfundimin e pashmangshëm se Danieli kishte patuar të drejtë: vetëm Mesia, prej fuqisë së tij mbinatyrore, mund të shpëtonte Izraelin dhe botën (Dan. 2:7). Izraeli duhej të priste për ardhjen e tij.

Por tani, trajektorja e periudhës së tretë po mbërrinte drejt fundit. Shekuj të tërë përgatitjesh po u afronte fundi. Kishte mbërritur koha që të vinte në botën tonë fara e Abrahamit, Qengji i Pashkës së Moisiut, Biri i Davidit, ai që ishte më i madh se Salomoni, Shërbëtori i vuajtur i Isaias, Biri i Njeriut i Danielit.

Dhe Perëndia dërgoi Birin e tij.

...

Pyetjet e studimit për këtë kapitull mund t'i gjeni në faqen 432.

2

Vijimësi dhe Shkëputje

*Dhiata e Re nuk është thjesht
një vijim i Dhiatës së Vjetër*

Parathënia e Ungjillit të Mateut na tregoi shumë qartë që ungjilli i Zotit tonë Jezus Krisht në Dhiatën e Re ishte qëllimi tek i cili të drejton Dhiata e Vjetër. Duke qenë kështu, mund të presim që Dhiata e Re të shfaqë gjëra të rëndësishme që vijnë dukshëm nga e Vjetra. Dhe ashtu bën ajo. Le të shqyrtojmë disa prej tyre para se të shqyrtojmë disa dallime të tjera të rëndësishme, dhe mënyrën në të cilën Dhiata e Re i justifikon ato.

Vijimësia mes të Vjetrës dhe të Resë

Është i njëjti Perëndi që po flet

Perëndia që flet në Dhiatën e Re është pikërisht i njëjti Perëndi si Ai që foli në të Vjetrën. Këtë Dhiata e Re e deklaron qartazi:

Perëndia, mbasi u foli së lashti shumë herë dhe në shumë mënyra etërve me anë të profetëve, së fundi, këto ditë na ka folur me anë të Birit, të cilin e bëri trashëgimtar të të gjitha gjërave, me anë të të cilit e krijoi dhe gjithësinë. (Heb. 1:1-2)

Duke qenë të rritur me një monoteizëm madhështor, dhe duke iu dashur të luftonin me shumë guxim për besimin e tyre kundër politeizmit me një çmim të madh, hebrenjtë nuk e kanë kuptuar gjithmonë besimin e krishterë. Ata kanë menduar që duke deklaruar se Jezusi është Biri i Perëndisë, Dhiata e Re i është kthyer politeizmit. Patjetër që nuk është kështu. Dhiata e Re këmbëngul, siç bën edhe e Vjetra, se “ka vetëm një Perëndi” (1 Tim 2:5); dhe me këtë bien dakord të gjitha kredot madhore të kishës së krishterë.

Shpesh ka njerëz që mendojnë se Perëndia i Dhiatës së Re është disi më i dashur dhe më i mirë sesa Perëndia i ashpër i së Vjetrës. Kjo përshtypje është e pabazuar. Le të flasë Dhiata e Vjetër në fillim për të përshkruar dashurinë e Perëndisë, siç edhe ajo e përmban:

Zoti është i mëshirshëm dhe zemërbutë, i ngadalshëm në zemërim dhe i madh në mirësi. Ai nuk grindet përjetë dhe nuk e ruan zemërimin gjithnjë. Ai nuk na trajton siç e meritojnë mëkatet tona dhe nuk na dënon në bazë të fajëve tona. Sepse sa të lartë janë qiejtë mbi tokën, aq e madhe është mirësia e tij ndaj atyre që kanë frikë prej tij. Sa larg është lindja nga perëndimi, aq shumë ai ka larguar nga ne fajet tona. Ashtu si një baba është i mëshirshëm me bijtë e tij, kështu është i mëshirshëm Zoti me ata që kanë frikë prej tij. Sepse ai e njeh natyrën tonë dhe nuk harron që ne jemi pluhur. ... Por mirësia e Zotit vazhdon nga përjetësia në përjetësi për ata që kanë frikë prej tij.... (Ps 103:8-17)

Dhiata e Re thotë të njëjtën gjë:

Perëndia është dashuri... Në këtë është dashuria: jo se ne e kemi dashur Perëndinë, por që ai na ka dashur ne dhe dërgoi Birin e tij për shlyerjen e mëkateve tona. (1 Gjonit 4:8,10) Po ti rrëfejmë mëkatet tona, ai është besnik dhe i drejtë që të na falë mëkatet dhe të na pastrojë nga çdo paudhësi. (1 Gjonit 1:9) Unë do të jem i mëshirshëm për paudhësitë e tyre dhe nuk do të kujtoj më mëkatet e tyre dhe keqbërjet e tyre. (Heb 8:12)

Nga ana tjetër, Dhiata e Vjetër përdor pa rezerva një

gjuhë të ashpër për të përshkruar zemërimin e shenjtë dhe të vazhdueshëm të Perëndisë kundër mëkatit: “Perëndia është një gjykatës i drejtë dhe një Perëndi që zemërohet çdo ditë me keqbërësit.” (Ps 7:11)

Por edhe Dhiata e Re është po aq e rreptë në këtë drejtim:

Sepse zemërimi i Perëndisë zbulohet nga qielli për çdo pabesi e padrejtësi të njerëzve, që mbysin të vërtetën në padrejtësi,... ata, ndonëse e kanë njohur dekretin e Perëndisë sipas të cilit ata që bëjnë gjëra të tilla meritojnë vdekjen, jo vetëm i bëjnë, por miratojnë edhe ata që i kryejnë. (Rom 1:18, 32)

Parimi themeltar i shlyerjes mbetet i njëjtë

‘është gjaku që bën shlyerjen e fajit për jetën.’, thotë Dhiata e Vjetër (Lev 17:11).

‘në të cilin kemi shpengimin me anë të gjakut të tij, faljen e mëkateve sipas pasurisë së hirit të tij’, thotë Dhiata e Re (Ef 1:7).

Kushti thelbësor sipas të cilit një person shfajësohet mbetet i njëjtë

Kushti sipas të cilit ne mund të bëhemi të drejtë me Perëndinë dhe të pranojemi prej tij është parashtruar kështu në Dhiatën e Vjetër:

ai (Abrahami) i besoi Zotit, që ia vuri në llogari të drejtësisë. (Zan. 15:6)

Dhiata e Re bie dakord. Në fakt, ajo citon të njëjtin varg, dhe shpall që ne mund dhe duhet të shfajësohemi para Perëndisë mbi të njëjtin themel si edhe Abrahami:

Ne, pra, konkludojmë se njeriu është i shfajësuar nëpërmjet besimit pa veprat e ligjit. Në fakt, çfarë thotë Shkrimi? “Por Abrahami i besoi Perëndisë dhe kjo iu numërua për drejtësi.” (Rom 3:28; 4:3)

Besnikëria e Perëndisë ndaj Izraelit mbetet e njëjtë

Besnikëria e Perëndisë ndaj kombit të Izraelit, që e ai zgjodhi dhe e thirri për të plotësuar një rol të veçantë në kohët e Dhiatës së Vjetër, mbetet e pandryshuar.

Por ti, Izrael, shërbëtori im, Jakob që kam zgjedhur, pasardhës i Abrahamit, mikut tim, ty që të mora nga skajet e tokës, që të kam thirrur nga cepat më të largëta të saj dhe të kam thënë: “Ti je shërbëtori im, të kam zgjedhur dhe nuk të kam hedhur poshtë (Isa 41:8–9)

Dhiata e Re kundërshton kategorikisht çdo sugjerim që Perëndia e ka braktisur plotësisht dhe përfundimisht Izraelin:

Unë, pra, them: A thua Perëndia e hodhi poshtë popullin e vet? Aspak... Perëndia nuk e hodhi poshtë popullin e vet, të cilin e njohu që përpara. Unë them, pra: Mos u penguan, që të rrëzohen? Aspak; por me anë të rrëzimit të tyre u erdhi shpëtimi johebrenjve... i ka ndodhur një ngurtësim një pjese të Izraelit deri sa të ketë hyrë tërësia e johebrenjve, dhe kështu mbarë Izraeli do të shpëtohet ... (Rom 11:1, 2, 11, 25–26)

Tema madhore është e njëjtë

Në vazhdim të këtyre shembujve të vijimësisë, duhet të kujtojmë gjithashtu, pohimin kryesor të Dhiatës së Re që Krishti përfaqëson subjektin madhor të së Vjetrës. “Moisiu ... shkroi për mua”, tha Krishti (Gjoni 5:46). “Dhe, duke zënë fill nga Moisiu dhe nga gjithë profetët, ai (d.m.th Zoti i ngjallur) u shpjegoi atyre në të gjitha Shkrimet (e Dhiatës së Vjetër) gjërat që i takonin atij. (Luka 24:27). Sipas Dhiatës së Re, Krishti është trashëgimtari i specifikuar në besëlidhjen e bërë nga Perëndia me Abrahamin (Zan 15:18; Gal 16–3:15). “Tani unë po ju them se Jezu Krishti u bë shërbëtor i të rrethprerëve për të vërtetën e Perëndisë, për të vërtetuar premtimet e dhëna etërve” (Rom 15:8). “Për të bënë dëshmi të gjithë profetët, që kushdo që beson në të merr faljen e mëkateve me anë të emrit të tij” (Veprat 10:43).

Atëherë Krishti – le ta përsërisim këtë – është subjekti kryesor i Dhiatës së Vjetër dhe çelësi për interpretimin e saktë të saj.

Shkëputjet mes së Vjetrës dhe së Resë

Por nëse ka një vijimësi të fortë dhe thelbësore mes Dhiatës së Vjetër dhe asaj të Re, ka edhe shkëputje shumë domethënëse dhe të rëndësishme. Le të marrim në konsideratë disa anë të kësaj çështjeje që e provojnë këtë.

Besëlidhja e themeluar nga Krishti është e ndryshme

Besëlidhja e re që Krishti themeloi (Luka 22:20; 1 Kor 11:25) nuk është një vijimësi apo një modifikim, ose një version i dytë, i përmirësuar i besëlidhjes së vjetër. Edhe Jeremia, profeti i Dhiatës së Vjetër, e parashikoi këtë dhe profetizoi që do të vinin ditë, thotë Zoti, “në të cilat do të vendos një besëlidhje të re me shtëpinë e Izraelit dhe me shtëpinë e Judës; jo si besëlidhja që kam vendosur me etërit e tyre ...” (Jer 31:31–32). Dhiata e Re komenton më tej: “...edhe ajo që vjetrohët dhe plaket është afër prishjes.” Heb 8:13; shih edhe 2 Kor 3). Kështu që besëlidhja e vjetër nuk vazhdon në të renë në një formë të përmirësuar: është zhdukur përgjithmonë.

Sakrifica e Krishtit është e ndryshme

Sakrifica e Krishtit, mbi të cilën është themeluar besëlidhja e re, nuk është një sakrificë tjetër që u është shtuar mijërave që u ofruan në kohët e Besëlidhjes së Vjetër. Nuk është as sakrifica e fundit dhe as më e mira në atë seri sakrificash: as nuk është pjesë e asaj serie fare. “Ato sakrifica ishin hije të gjërave të mira që do të vinin.” (Heb 10:1); sakrifica e tij ishte realiteti i mrekullueshëm që po afrohej. Mes hijes së gjërave, dhe vetë atyre gjërave, ka shumë ndryshim në kategori. Sakrifica e tij nuk ishte më e mira e të gjitha hijeve!

Sakrificat e Dhiatës së Vjetër qenë të kafshëve; ai sakrifikoi vetveten. Gjaku i tyre nuk i hoqi kurrë mëkatet (Heb.10:4); gjaku

i Tij po (Heb 9:14). Ato sakrifica “që jepeshin nuk mund ta bënin të përsosur në ndërgjegje atë që e kryente shërbesën hyjnore” (Heb 9:9); dhe, prandaj ato duhet të ofroheshin vazhdimisht dhe në mënyrë të përsëritur (Heb 10:1–3). Në të kundërt sakrifica e tij “i bëri të përsosur për gjithnjë ata që shenjtërohen.” (Heb 10:14); dhe, për rrjedhojë, ai është fronëzuar dhe procesi i të sakrifikuarit për të fituar faljen e mëkateve është përfunduar (Heb 9:15–26; 10:17–18).

Priftëria e Krishtit është e ndryshme

Krishti është një prift, por jo thjesht një prift tjetër në vijën e pasardhësve të Aronit. Ai as nuk ishte prifti më i madh dhe më i mirë në serinë e priftërinjve të rendit të Dhiatës së Vjetër. Ai nuk i përkiste atij rendi fare. Vetë Dhiata e Vjetër do ta kishte ndaluar atë të shërbente si një prift në tempullin e Jerusalemit. Me urdhër të vetë Perëndisë priftëria që e kufizuar vetëm për fisin e Levit, ndërsa Zoti ynë që prej fisit të Judës (Heb 7:13–14).

Krishti është prift i një rendi tjetër, atij të Melkisedekut. Priftëria e tij është sipas modelit të Melkisedekut (Ps 110:4; Heb 6:20–7:28); por ai nuk e përfitoi këtë priftëri duke patur prejardhje gjaku nga fara e Melkisedekut, ashtu si priftërinjtë aronikë përfitonin të tyren duke qenë nga pasardhësit e Aronit. Krishti e fitoi priftërinë e tij duke qenë i caktuar direkt dhe personalisht prej Perëndisë, i shoqëruar nga një betim hyjnor, mbi bazën e të qenit Biri i Perëndisë si edhe qenie njerëzore (Heb 5:5–6; Ps 110:4; Heb 7:20–22). Duke qenë se ai jeton në fuqinë e jetës së përjetshme, askush nuk mund ta zëvendësojë atë në ofiqin priftëror që ka (Heb 7:23–24).

Roli i Krishtit si profet është i ndryshëm

Krishti nuk ishte thjesht një profet më shumë në një vijë të nderuar profetësh të Dhiatës së Vjetër. Natyrisht që Krishti quhet profet herë pas here në Dhiatën e Re. Veprat, p.sh, thotë që Krishti është “si profeti Moisi” që vetë Moisiu tha se Perëndia do të ngrinte për Izraelin një ditë (Vep 3:22; 7:37; krhs Lip 18:15).

Gjithashtu Dhiata e Re e veçon Krishtin qartazi nga profetët e Dhiatës së Vjetër. Ata ishin një grup i dallueshëm: *profetët*; Krishti

i takonte një kategori tjetër, që vetëm atij i përket. Hebrenjve 1:1-2 përdor gjuhë të saktë për të dalluar mes profetëve nga një anë, dhe Birit të Perëndisë nga ana tjetër: “Perëndia, mbasi u foli së lashti ... me anë të profetëve, së fundi, këto ditë na ka folur me anë të Birit...” Dhe përshkrimi i Birit që e shoqëron këtë citim tregon se sa i ndryshëm është ai nga profetët:

... me anë të Birit, të cilin e bëri trashëgimtar të të gjitha gjërave, me anë të të cilit e krijoi dhe gjithësinë. Ai, duke qenë shkëlqimi i lavdisë së tij dhe vula e qenies së tij dhe duke i mbajtur të gjitha me fjalën e fuqisë së tij, mbasi e bëri vetë pastrimin nga mëkatet tona, u ul në të djathtën e Madhërisë në vendet e larta, (Heb 1:2–3)

Puna e Frymës së Shenjtë është e ndryshme

Ardhja e Frymës së Shenjtë për Rrëshajët dhe pagëzimi i besimtarëve në trupin e Krishtit (Gjoni 1:33; Veprat 1:4–5; 2:1–4; 1 Kor 12:13) nuk qe një përsëritje në një shkallë të madhe e asaj që ka qenë vazhdimisht duke ndodhur gjatë shekujve të mëparshëm. Ishte diçka unike në historinë e shpëtimit. Ishte profetizuar në Dhiatën e Vjetër (Joeli 2:28–29; Veprat 2:1–18); por nuk mund të ndodhte, dhe nuk ndodhi, përderisa Krishti të përlëvdohej (Gjoni 7:39) dhe të qe larguar (Gjoni 16:7) – në fakt duhet të ndodhte 10 ditë pasi ai u ngjiti në qiell (Veprat 1:4–5, 8; 2:1). Askund në të gjithë Dhiatën e Vjetër nuk përmendet diçka e barasvlefshme me Trupin e Krishtit.

Për më tepër, bashkimi i hebrenjve dhe grekëve në Trupin e Krishtit nuk u arrit thjesht duke shtuar ca si shumë besimtarë johebrenj në një trup ekzistues hebrenjsh. Ajo që Krishti ka bërë, sipas Efes 2:14–15, është që ai ka marrë nga hebrenjtë dhe johebrenjtë, dhe nga të dy ka krijuar në veten e tij *një* njeri të ri. Dhe kjo, sipas Palit (Efes. 3:1–13), ishte një mister që nuk iu bë i njohur brezave të mëparshëm, por iu zbulua për herë të parë Palit dhe apostujve e profetëve të krishterë.

Shtëpia e Perëndisë është tjetër

Tempulli i krishterë i Perëndisë nuk është një kopje, as një version i zmadhuar apo i përmirësuar i tabernakullit të Moisiut

(Eks 25–31), as nuk është një përshtatje e tempujve të Salomonit, Ezdras dhe Herodit të Madh. Është një lloj tempulli tjetër, një shtëpi frymërore, e ngritur me gurë të gjallë, mbështetur mbi Krishtin që është guri i themelit (1 Pjet 2:4–7; 1 Kor 3:11, 16–17; krhs. Gjoni 2:19–22). Në kohën e Dhiatës së Vjetër besimtarët e zakonshëm, duke mos qenë priftërinj, nuk u lejuan brenda tempullit; dhe madje as edhe në kohën e tij Krishti nuk do të lejohej. Tani në Krishtin, besimtarët *përbëjnë* tempullin e Perëndisë, dhe vetë janë një priftëri e shenjtë, që ofrojnë sakrifica frymërore, të pranueshme për Perëndinë përmes Jezus Krishtit (1 Pjet 2:5).

Trashëgimia është e ndryshme

Trashëgimia që Perëndia na jep përmes Krishtit nuk prishet, është pa njolla dhe nuk vyshket, dhe është ruajtur në qiell për ne (1 Pjet 1:3–4) prandaj nuk është thjesht një version më i madh i trashëgimisë që Perëndia i dha Izraelit përmes Jozueut (Joz 1:1–4; Heb 4:8–9). Ajo ndryshon, qoftë në vendndodhje, qoftë në llojin e saj.

Armatimi i të krishterëve është i ndryshëm

Armët e luftës sonë të krishterë nuk janë prej mishi (2 Kor. 10:4). Krishti i ndaloi rreptësisht ndjekësit e tij të luftojnë me shpata për ta mbrojtur atë, apo për të ngritur mbretërinë e tij (Gjoni 18:36; Mat 26:51–52). Kjo i ndalon të krishterët për të bërë luftë të ngjashme me atë të Dhiatës së Vjetër, siç bënë Jozueu dhe Davidi, për të mbrojtur apo përhapur mbretërinë e Perëndisë dhe ungjillin e krishterë.

Si i shpjegon vetë Dhiata e Re këto shkëputje

Tani shtrohet një pyetje e rëndësishme. Nëse Dhiata e Re pranon Shkrimet e Dhiatës së Vjetër si Fjalën e frymëzuar dhe autoritare të Perëndisë, siç edhe bën realisht (shih, për shembull, 2 Tim 3:15–17), dhe nëse po ashtu i quan institucionet e lashta fetare të Izraelit si të caktuara prej Perëndisë, atëherë si mund të justifikojë këto, apo çdo shkëputje thelbësore midis vetes dhe

Dhiatës së Vjetër?

Përgjigjet që Dhiata e Re u jep këtyre pyetjeve janë të shumëfishta.

Dhiata e Vjetër kishte deklaruar se këto ndryshime do të ndodhnin

Besëlidhja e Re

Qe profeti Jeremia, siç edhe e thamë më sipër, që shpalli i pari se do të vinin ditët kur Perëndia do të hiqte besëlidhjen e vjetër, dhe do të themelonte besëlidhjen e re në vendin e saj (Jer 31:31–34; Heb 8:6–13).

Sakrifica e vetvetes e bërë nga Krishti

Ishte zëri i Mesisë përmes Davidit, psalmistit, që shpalli i pari se sakrifica e kafshëve, e porositur nga ligji i Dhiatës së Vjetër, nuk mund të kënaqë Perëndinë, dhe që vendi i tyre do të zihej përfundimisht prej Mesisë që do të vinte në botë për të bërë vullnetin e Perëndisë (Ps 8–40:6; Heb 10–10:5).¹

Priftëria melkisedekase e Krishtit

Sigurisht që ishte Perëndia i cili themeloi vijën priftërore të levitasve në kohën e Moisiut; dhe ishte Perëndia që i gjykoi në vend Koreun, Dathanin dhe Abiramin kur ata debatuan për ofiqin kryepriftëror të Aronit; dhe po ashtu Perëndia goditi mbretin Uzia me lebër kur uzurpoi ofiqin priftëror dhe hyri në tempull për të djegur temjan (Eksodi 28–29; Levetiku 8–9; Numrat 16–18; 2 Kron 26:16–21). Por po ashtu ishte vetë Perëndia që në Dhiatën e Vjetër (Ps 110:4) foli për vajosjen e zotit të Davidit në një priftëri tjetër sipas rendit jo të Aronit, por të Melkisedekut. Dhe duke bërë këtë, Dhiata e Re thekson që vetë Perëndia e ndryshoi ligjin në lidhje me priftërinë levetike

¹ Fjalët në hebraisht të Ps 40:6 lexohen ‘... më ke shpuar veshët’. Për të përkthyer në greqisht fuqinë e kësaj metafore, Septuaginti e ka përshtatur në mënyrë të gjallë me shprehjen ‘... përgatite për mua një trup.’ Fryma e Shenjtë zgjodhi që të përdorë këtë përshtatje tek Heb. 10:5, si një version më të lehtë për t’u kuptuar nga lexuesit e Dhiatës së Re.

që ai vetë e themeloi fillimisht (Heb 7:12).

Tabernakulli qiellor krahas atij tokësor

Për këtë Dhiata e Re argumenton kështu: vetë Dhiata e Vjetër pranon se Tabernakulli që ngriti Moisiu (sipas të cilit të gjithë tempujt në Jerusalem u modeluan) ishte vetëm një kopje dhe hije e gjërave qiellore, i ngritur sipas modelit që iu tregua Moisiut në Malin Sinai (Eks 25:40; Heb 8:5). Tani, siç edhe e kemi vënë re, sipas ligjit të Dhiatës së Vjetër, Krishti nuk mund të shërbente si prift në tempullin e Jerusalemit (Heb 8:4). Në fakt, nuk ishte qëllimi i Perëndisë që kjo të ndodhte ndonjëherë. Kur sakrifica e tij u përfundua, dhe ai u ngjall prej së vdekurish, ai nuk hyri në shenjtëroren e shenjtërore të ndërtesës së tempullit në Jerusalem. Ai u thirr prej Perëndisë për t’u ulur në të djathtën e Perëndisë, siç edhe e kishte thënë se do të ndodhte (Psalmi 110:1). Tempulli i Jerusalemit, duke qenë vetëm një kopje dhe hije e asaj që ishte e vërtetë, nuk do ishte një vend mjaft i mirë ku ai të shërbente. ‘Sepse Krishti nuk hyri në një shenjtërore të bërë me dorë, që është vetëm shëmbëllesë e asaj të vërtetë, por në vetë qiellin për të dalë tani përpara Perëndisë për ne’ (Heb 9:24). Dhe prapë:

Dhe pika kryesore e atyre gjërave që po themi është kjo: ne kemi një kryeprift të tillë, i cili qëndron në të djathtën e fronit të Madhërisë në qiejt, shërbenjës i shenjtërores dhe të tabernakullit të vërtetë, të cilin e ngriti Perëndia e jo njeriu. (Heb 8:1–2)

Dhiata e Vjetër që shkollë përgatitore

Për të shpjeguar dallimet mes mënyrës sesi Perëndia e trajtoi popullin e tij në kohët e Dhiatës së Vjetër dhe mënyrës sesi ai e trajton tani që Biri i Perëndisë ka ardhur, Dhiata e Re përdor një analogji (Gal 4:1–7). Një fëmijë i lindur në një familje të pasur romake njihet si i biri i dikujt thjesht sepse qe lindur prej tij, dhe qe njohur publikisht nga i ati si i tillë. Por për sa kohë që i biri ishte i vogël, praktikisht trajtohej njësoj si një skllav. Për hatër të arsimimit dhe sjelljes së tij, babai e besonte fëmijën në duart e kujdestarëve dhe njerëzve të besuar që vetë mund të

ishin skllëvër. Fëmija nuk kishte liri; ai duhej që t'u bindej atyre. Ata do të garantonin që ai shkonte në shkollë, bënte detyrat dhe sillej mirë. Dhe kishin lirinë nga babai i tij për të ndëshkuar fëmijën nëse ai sillej keq.

Por e gjitha kjo ndryshonte kur fëmija mbërrinte moshën e pjekurisë, kur nuk qe më fëmijë, por i rritur. Tani ai nuk ishte më nën kujdestarët dhe njerëzit e besuar; ai qe biri i rritur i babait që pritej të ishte i gatshëm që të tregonte me anë të sjelljes së tij, frymën dhe karakterin e babait të vet.

Këtë analogji Pali e zbaton për veten dhe bashkëbesimtarët e tij të krishterë për të shpjeguar dallimin që bëri kryqi i Shpengimtarit dhe ardhja e Frymës së Shenjtë për fuqizimin dhe motivimin e sjelljes së të krishterit: një besimtar nuk është më i motivuar si një skllav prej frikës së ndëshkimeve të ligjit, por ai është i drejtuar nga Fryma (Rom 8:14–17).

Kështu edhe ne, sa ishim të mitur, ishim të robëruar nën elementet e botës, por, kur u mbush koha, Perëndia dërgoi Birin e tij, të lindur prej gruaje, të nënshtuar ligjit, që të shpengonte ata që ishin nën ligj, që ne të fitojmë birërinë. Dhe, duke qenë se jeni bij, Perëndia dërgoi Frymën e Birit të tij në zemrat tuaja që thërret: Abba, Atë! Prandaj ti nuk je më shërbëtor, por bir; dhe në qoftë se je bir, je edhe trashëgimtar i Perëndisë me anë të Krishtit. (Gal 4:3–7)

Dikush mund të ketë dyshime për faktin sa i përshtatshëm është aplikimi i analogjisë fëmijë/i rritur për përvojën frymërore të kombit të Izraelit, dhe aq më pak për përvojën fetare të johebrenjve. Por këtë analogji e përdor edhe vetë Perëndia në Dhiatën e Vjetër: “Kur Izraeli ishte fëmijë, unë e desha dhe nga Egjipti thirra birin tim...Unë vetë i mësova Efraimit të ecë, duke e mbajtur nga krahët.” (Ose 11:1–3) Ndonëse largimi prej Egjiptit i Izraelit ndodhi 400 vjet pas Abrahamit, Perëndia ende i referohet kombit si fëmija e tij shpirtëror. Ajo që Dhiata e Re thekson është se, e krahasuar me epokën e re e inaguruar prej ardhjes së Frymës së Shenjtë, përvoja e të gjithë epokave të mëparshme ishte thjesht fëmijëri dhe adoleshencë. Kjo na shpie tek përgjigjja tjetër e Dhiatës së Re për pyetjen sesi mund të justifikojë shkëputjet e saj thelbësore nga Dhiata e Vjetër.

Ardhja e Birit të Perëndisë inaguroi një epokë të re

Dhiata e Re pohon se me ardhjen e Birit të Perëndisë në botë, dhe aq më tepër me ringjalljen e lartësimin e tij dhe me ardhjen e Frymës së Shenjtë, një epokë e re ka zbardhur në mënyrën si Perëndia trajton njeriun.

Sipas Hebrenjve 1:2 (po ta përkthejmë fjalë për fjalë) Krishti u lind “në ditët e fundit”, që do të thotë, në fund të kohës kur Izraeli ishte në qendër të planit që Perëndia ishte duke shpalosur për botën. Po ashtu, Hebrenjve 9:26 (po ashtu i përkthyer fjalë për fjalë) komenton që Krishti u shfaq në botën tonë për të hequr mëkatën, duke sakrifikuar veten “në fund të shekujve”. Me fjalë të tjera: vdekja shlyese e Krishtit ishte qëllimi, dhe për këtë arsye, edhe përfundimi i të gjithë epokave të mëparshme. 1 Pjetrit 1:19-20 thotë të njëjtën gjë: Krishti, Qengji i Perëndisë, përmes gjakut të të cilit ne jemi shpenguar, ishte “paranjohur përpara krijimit të botës, por të shfaqur kohët e fundit për ju...”

Me ringjalljen dhe lartësimin e Krishtit dhe ardhjen e Frymës së Shenjtë filloi një epokë e re. Nisja e saj u shënua prej shfaqjeve të veçanta të Frymës së Shenjtë në ditën e Rrëshajëve, e përshkruar nga Pjetri si “kjo është ajo që ishte thënë nëpërmjet profetit Joel - Dhe në ditët e fundit do të ndodhë, thotë Perëndia, që unë do të përhap nga Fryma ime mbi çdo mish...” (Veprat 2:16–17). Kështu filloi epoka që do të përfundonte me ardhjen e ditës së madhe dhe të lavdishme të Zotit (Veprat 2:20) kur Zoti Jezus do të kthehej pas katastrofave kozmike “duke ardhur mbi një re, me fuqi dhe lavdi të madhe” (Luka 21:27) për të bërë gjykimin e Perëndisë mbi të korrën e madhe të Perëndisë, dhe duke mposhtur të keqen (2 Sel 2:3–12).

Qëllimet e Perëndisë

Dhiata e Re na informon në lidhje me ndryshimet në strategjitë dhe taktikat që u bënë të domosdoshme prej qëllimeve të Perëndisë për epokën e krishterë, dhe nuk i merr thjesht si të mirëqena.

Përhapja e ungjillit mes kombeve të johebrenjve

Para kryqëzimit, kur Krishti dërgoi apostujt e tij në misionin e tyre ungjillizues, ai i porositi ata: “Mos shkoni ndër paganë dhe mos hyni në asnjë qytet të samaritanëve, por shkoni më mirë te delet e humbura të shtëpisë së Izraelit.” (Mat 10:5–6). Sërisht, në një rast tjetër, ai komentoi për misionin e tij: “Unë nuk jam dërguar gjetiu, përveç te delet e humbura të shtëpisë së Izraelit” (Mat 15:24). Në dallim të plotë me mandatin e shkuar të tij, është ajo që ndodhi pas ringjalljes. Tani ai i urdhëron apostujt e tij: “Mua më është dhënë çdo pushtet në qiell e në tokë. Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt [johebrenj] ... Dhe ja, unë jam me ju gjithë ditët, deri në mbarim të botës.” (Mat 28:18–20).

Isaia profetizoi në kohën e tij që Mesia, filizi nga trugu i Jeseut (babai i mbretit David), do të bëhej qendra e vëmendjes për johebrenjtë. Ata do të shpresonin tek ai, dhe ai do të sundonte mbi ta (shih Isa 11:10; 49:6; Veprat 13:47; Rom 15:12). Është një fakt i pamohueshëm i historisë që, në këtë epokë, qysh nga Rrëshajët, miliona johebrenj janë tërhequr prej Jezus Krishtit dhe kanë besuar në këtë bir hebre të Davidit. Kjo, siç edhe e kemi thënë, ka qenë profetizuar në Dhiatën e Vjetër nga Isaia shtatë qind vite para se Krishti të lindej. Por asgjë e tillë nuk ndodhi në epokat e shkuara para Rrëshajëve.

Anullimi i rregullave ushqimore dhe pastrimit ceremonial të Dhiatës së Vjetër

Prej shumë shekujsh këto ligje shërbyen si një gardh për të ndaluar shoqërimin e tepërt mes hebrenjve dhe johebrenjve, dhe në këtë mënyrë të mbronin Izraelin, aq sa mundej, prej prishjes së shoqërisë pagane. Por, siç mësoi Krishti, këto praktika të jashtme nuk merreshin me burimin e ndotjes që është zemra e njeriut. Ai i shfuqizoi ato (Marku 7:1–23).

Me ardhjen e Frymës së Shenjtë, një fuqi e re u bë e disponueshme për të gjithë, për të pastruar zemrat e njerëzve dhe për t'i mbrojtur, pavarësisht se me kë shoqëroheshin. Prandaj nëse të krishterët e hershëm do dilnin prej qarqeve të tyre të ngushta hebrease, dhe të përhapnin ungjillin mes johebrenjve,

u duhej që të përziheshin nga ana sociale me johebrenjtë. Me një mësim demonstrativ, Perëndia i liroi ata për ta bërë këtë (Veprat 10).

Ndryshimi në qëndrimin ndaj rrethprerjes

Rrethprerja nuk ka qenë, edhe për hebrenjtë, e domosdoshme për shpëtimin. Ajo ishte për Abrahamin një vulë e drejtësisë që ai e fitoi prej besimit (Rom 4:9–11); dhe për pasardhësit e tij ishte një shenjë e jashtme e prejardhjes nga gjaku i Abrahamit (Zan 17), dhe përkushtimit të tyre për të mbajtur ligjin e Perëndisë (Rom 2:23–29). Prandaj, nën besëlidhjen e vjetër, çdo mashkull johebre që donte të bëhej pjesë e popullit të Perëndisë duhej të rrethpritej.

E gjitha kjo ndryshoi nën besëlidhjen e re. Ende konsiderohej si mësim plotësisht i rremë të thoshe që rrethprerja që e domosdoshme për shpëtimin qoftë të hebrenjve, qoftë të johebrenjve (Veprat 15:1–11). Por tani rrethprerja nuk që e detyrueshme as për hebrenjtë dhe as për johebrenjtë, edhe pasi të shpëtoheshin (Gal 5:1–6); dhe aspak e domosdoshme për të qenë pjesë e popullit të Perëndisë.

Ndryshimi në mënyrën e adhurimit

Në ditët e Dhiatës së Vjetër izraelitët u lejuan që të kishin vetëm një tempull; dhe ky tempull ishte në Jerusalem. Sigurisht që ata kishin shumë sinagoga kudo në Palestinë dhe diasporë, ku lexonin Shkrimet dhe i këndonin lavde Perëndisë. Por nuk pati asnjë prift që të shërbente në sinagogë dhe as nuk u ofruan sakrifica atje. Nëse një hebre donte t'i ofronte sakrifica Perëndisë, duhet që të shkonte në tempullin e Jerusalemit²; ndërsa samaritanët që refuzuan tempullin e Jerusalemit, dhe kishin ndërtuar një për vete mbi malin Gerizim u konsideruan, jo vetëm prej hebrenjve, por edhe nga vetë Krishti, se ishin në mosbindje nga padija (Gjoni 4:22).

Krishti e ndryshoi këtë; dhe është e rëndësishme të vëmë re

2 Këtu mund të shohësh që Perëndia i Izraelit ndryshonte shumë prej perëndive pagane. Zeusi, apo si e quanin romakët, Jupiteri, kishte qindra tempuj kudo në botën romake dhe ishte po kështu me perënditë dhe perëndeshat e tjerë në kohën e Krishtit.

në cilin drejtim ai e ndryshoi. Ai nuk zbuti rregullat e Dhiatës së Vjetër dhe nuk i lejoi njerëzit që nga ajo kohë të ndërtonin tempuj dhe të ofronin sakrifica kudo që t'u pëlqente. Ai hoqi edhe konceptin e një tempulli material dhe ofrimit të sakrificave mbi altarë materialë në vende të veçanta të shenjta, dhe themeloi një formë më të lartë adhurimi. Kur një grua nga Samaria i tha (Gjoni 4:20):

Etërit tanë adhuronin mbi këtë mal, dhe ju (hebrenjtë) thoni se në Jerusalem është vendi ku duhet të adhurojmë,

[Krishti u përgjigj:] O grua, më beso: vjen ora që as mbi këtë mal as në Jerusalem nuk do të adhuroni Atin. . . . Por vjen ora, madje ajo ka ardhur, që adhuruesit e vërtetë ta adhurojnë Atin në frymë dhe në të vërtetën, sepse të tillë janë adhuruesit që kërkon Ati. Perëndia është Frymë, dhe ata që e adhurojnë duhet ta adhurojnë në frymë dhe në të vërtetën. (Gjoni 4:21, 23–24)

Në epokën e krishterë tempulli i vërtetë është trupi i Zotit Jezus (Gjoni 2:19–21), trupi i çdo besimtar individualisht (1Kor 6:19), çdo bashkësi lokale e besimtarëve (1 Kor 3:16–17), dhe bashkësia e të gjithë besimtarëve nga Rrëshajët deri në kthimin e dytë të Krishtit (Ef 2:21–22; 1 Pjet 2:4–5).

Vlerësimi i strategjive dhe taktikave të Perëndisë nga Stefani

Tani vetë Dhiata e Re na thotë që kur hebrenjtë dëgjuan për herë të parë të krishterët e hershëm që thoshin se me ringjalljen dhe lartësimin e Krishtit, dhe ardhjen e Frymës së Shenjtë, Perëndia inaguroi një epokë të re, në të cilën shumë prej zakoneve fetare të epokave të shkuara do të ndërpriteshin, ata e konsideruan këtë ide që të ishte jo vetëm revolucionare, por blasfemuese (shih Veprat 6:8– 7:60). Në të vërtetë, kaq e madhe qe përbuzja e tyre ndaj kësaj ideje, sa që ata ekzekutuan Stefanin, martirin e parë të krishterë, që guxoi ta predikonte.

Në mbrojtje të vetes Stefani demonstroi që çdo hebre që e njihnte Dhiatën e Vjetër duhet ta kishte kuptuar se, edhe në të

shkuarën, kishte patur epoka të ndryshme në marrëdhënien e Perëndisë me Izraelin në kohët e Dhiatës së Vjetër; secila me strategjitë dhe taktikat e saj specifike.

Për të filluar të gjithë procesin, tha Stefani, Perëndia thirri Abrahamin prej paganëve, e solli në Kanaan dhe e urdhëroi atë që të jetonte në tokën e Kanaanit si një nomad (Veprat 7:2–8). Ai i tha atij që pasardhësit e tij do të qenë të huaj në periudhën që do të vinte në një tokë të huaj për 400 vjet (7:6–7); por në atë moment ata do të qenë nomadë në Kanaan (shih Zan 26:2–3). Kjo ishte *epoka e parë*.

Epoka e dytë filloi kur Perëndia dërgoi nipërit e Abrahamit dhe familjet e tyre në drejtim saktësisht të kundërt, sërish midis paganëve, për të jetuar në Egjipt, jo më si nomadë, por në shtëpi (Veprat 7:9–16).

Pastaj, pas disa shekujve, erdhi një *epokë e tretë* që e përmbysi sërish situatën. Përmes Moisiut Perëndia i çliroi izraelitët nga Egjipti dhe i drejtoi të jetonin në çadra dhe të ndërtonin një çadër të lëvizshme për Perëndinë, ndërsa po kalonin shkretëtirën për në tokën e Kanaanit (7:17–44).

Epoka e katërt filloi kur ata hynë në Kanaan me Jozueun, pushtuan tokën dhe u vendosën atje si banorë të përhershëm në vendin e vet. Por për disa qindra vite Perëndia nuk do t'i lejonte të ndërtonin për të një tempull të përhershëm dhe të palëvizshëm (7:45–46).

Duhet që të vinte *epoka e pestë* me kurorëzimin e Salomonit në fronin e Davidit që Perëndia të lejonte të ndërtohej një tempull i palëvizshëm (7:47–50).

Stefani e mbylli analizën e tij të historisë së Izraelit në këtë pikë. Por ai mund të kishte vazhduar, po të donte, të përmendte edhe dy epoka të tjera të dallueshme: *e gjashta*, pas shkatërrimit të Jerusalemit dhe tempullit nga Nebukadnetsari, kur prej vetë vullentit të Perëndisë hebrenjtë duhet të jetonin në mërgim pa patur fare ndonjë tempull; dhe *e shtata* kur një pakicë e kombit, e nxitur prej perandorit, Kirit, u kthye në Palestinë dhe ndërtoi tempullin dhe muret e qytetit të Jerusalemit.

Sipas arsytimit të Stefanit, me ardhjen e Jezus Mesisë, vdekjen, ringjalljen dhe lartësimin e tij, dhe ardhjen e Frymës së Shenjtë, Perëndia kishte themeluar *një epokë të re tjetër*.

Paraardhësit e tyre, shtoi ai, sa herë që Perëndia u dërgonte një udhëheqës, si Jozefi apo Moisiu për t'i udhëhequr në epokën tjetër, gjithmonë si fillim e kishin refuzuar drejtuesin e tyre. Prandaj ata nuk duhej, tha Stefani, të përsëritnin modelin dhe të refuzonin Jezusin. Sepse refuzimi për të ecur përpara, kur Perëndia sjell një epokë tjetër, do të thotë të ndahesh prej Perëndisë së gjallë.

Përfundim: Një pyetje e lidhur me çështjen

Kur e heton, Dhiata e Re shfaq një vijimësi të qartë me Dhiatën e Vjetër. Sidoqoftë, ajo nuk është *thjesht* një vazhdimësi e së Vjetrës, sepse ajo shfaq edhe një numër shkëputjesh po ashtu. Siç edhe e kemi parë, Dhiata e Re shpjegon me kujdes si këto shkëputje lindin prej strategjive dhe taktikave të vazhdueshme të Perëndisë ndërsa ai plotëson planin e tij. Kjo të shpie te një pyetje tjetër e fundit shumë e rëndësishme: a do të thotë prania e këtyre shkëputjeve se pjesë të mëdha të Dhiatës së Vjetër nuk janë më të aplikueshme për ne, dhe se ato nuk kanë çfarë të na thonë?

Krishti na e ka ndaluar të bëjmë luftë të armatosur që ka për qëllim të përparojmë apo mbrojmë mbretërinë e tij. A do të thotë kjo që historitë e luftës së Izraelit në librat e Jozueut, Gjyqtarëve, 1 dhe 2 Samuelit, 1 dhe 2 Mbretërve dhe 1 dhe 2 Kronikave nuk kanë se çfarë të na mësojnë dhe që ne mund t'i anashkalojmë ato pa humbur diçka?

Sërish, besëlidhja e re e nxori jashtë loje tabernakullin, ofertat dhe priftërinë e Izraelit. A do të thotë kjo që kapitujt e gjatë tek Eksodi, Levetiku dhe Numrat, të cilët përshkruajnë këto institucione të lashta, nuk duhet të zgjojnë ndonjë interes te ne, përveçse atë të një historiani dhe koleksionisti antikash?

Përgjigja për të gjitha këto është jo. Nuk do të thotë aspak këtë gjë. E kundërta është e vërteta. Dhiata e Re pohon qartësisht:

I gjithë Shkrimi (d.m.th Shkrimet e Dhiatës së Vjetër) është i frymëzuar nga Perëndia dhe i dobishëm për mësim, bindje, ndreqje dhe për edukim me drejtësi, që njeriu i Perëndisë të jetë i përkryer, tërësisht i pajisur për çdo

vepër të mirë. (2 Tim 17–3:16)

Arsyeja se pse është kështu, nëse është e vërtetë gjithë ajo që kemi thënë për shkëputjet mes Dhiatës së Vjetër dhe së Re, është një temë për kapitullin tjetër — dhe në të vërtetë, për pjesën tjetër të këtij libri.

...
Pyetjet e studimit për këtë kapitull mund t'i gjeni
në faqen 432.

3

I Gjithë është i Dobishëm

*Qëndrimi i Dhiatës së Re ndaj
Dhiatës së Vjetër*

Në këtë kapitull ne nuk do të hetojmë nëse Krishti dhe apostujt e tij besuan apo jo në frymëzimin dhe autoritetin hyjnor të Dhiatës së Vjetër. Këtë e marrim si të mirëqenë; sepse në dy pasazhe të dallueshme në Dhiatën e Re kjo bindje është deklaruar qartësisht, dhe kudo tjetër është lënë e nënkuptuar. Duke e pranuar këtë si fakt themelor, ne do të nisim të hetojmë sesi bindja e Dhiatës së Re për frymëzimin dhe autoritetin hyjnor të Dhiatës së Vjetër ndikon interpretimin dhe zbatimin që ajo i bën Dhiatës së Vjetër.

Dhiata e Vjetër është e dobishme për një larmi qëllimesh shpirtërore

Pasazhi i parë nga dy të dallueshmit që përmenda më sipër është 2 Timoteut 17–3:14. Në lidhje me Shkrimet e Dhiatës së Vjetër aty thuhet: “I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia”; dhe prej këtij fakti nxirret konkluzioni i dukshëm dhe logjik që Dhiata e Vjetër është e gjitha e dobishme.

Pasazhi i dytë që është i dallueshëm është 2 Pjetrit 1:20-21.

Aty thuhet që burimi dhe nxitësi i të gjithë profecisë biblike nuk është profeti që e shprehu atë, por Perëndia; dhe mbi bazën e kësaj pohon se përmbushja e profecisë së Dhiatës së Vjetër është absolutisht e sigurt.

Për ungjillëzimin e krishterë

Si fillim, le të përqëndrohemi mbi të parin e këtyre dy pasazheve. Pasazhi që pohon qartazi se i gjithë Shkrimi i Dhiatës së Vjetër është i dobishëm, është një pjesë e letrës së dytë të Palit për bashkëpunëtorin e tij të ri, Timoteun:

Por ti qëndro në ato që mësove dhe u binde plotësisht, duke e ditur prej kujt i mësove, dhe se që nga fëmijëria i njeh Shkrimet e shenjta, të cilat mund të të bëjnë të ditur për shpëtimin me anë të besimit që është në Krishtin Jezus. I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia dhe i dobishëm për mësim, bindje, ndreqje dhe për edukim me drejtësi, që njeriu i Perëndisë të jetë i përkryer, tërësisht i pajisur për çdo vepër të mirë. (2 Tim 3:14–17)

Nga kjo ne shohim menjëherë që Dhiata e Vjetër është e dobishme për ungjillëzimin e krishterë.

Njerëzit prej të cilëve Timoteu kishte mësuar si fëmijë Shkrimet e Dhiatës së Vjetër qenë mamaja dhe gjyshja nga ana e mamasë së tij (2 Tim 1:5); dhe kjo na kujton një fakt të rëndësishëm. Në botën e lashtë të hebrenjve, mësimi i fëmijëve për Shkrimet e Shenjta nuk iu besua thjesht leximit formal dhe publik në singagogë dhe predikimeve të bëra çdo Shabat (krh. Veprat 27, 16–13:14; Luka 30–4:16). Përgjegjësinë parësore për t’u mësuar Biblën fëmijëve e kishin prindërit e tyre. Babai i Timoteut qe grek; por mamaja e tij qe hebrease (dhe për këtë arsye, sipas përlllogaritjes të ligjit fetar hebre, edhe gjyshja nga ana e mamasë); kështu ato kishin bërë për Timoteun atë që Dhiata e Vjetër i kishte porositur se duhej të bënin:

Dhe këto fjalë që sot po të urdhëroj do të mbeten në zemrën tënde; do t’ua ngulitësh bijve të tu, do të flasësh për to kur rri ulur në shtëpinë tënde, kur ecën rrugës, kur ke rënë në shtrat dhe kur çohesh . . . (LiP 6:6–7)

Kjo rezultoi për Timoteun që Dhiata e Vjetër të bëhej për të një përfitim i jashtëzakonshëm dhe i përjetshëm: e bëri atë të ditur, siç shprehet Pali, për shpëtimin. E bëri të ndërgjegjshëm për faktin se kishte nevojë të shpëtohej, dhe që Perëndia kishte premtuar të dërgonte një Shpëtimtar që do të vdiste si një flijim mëkati për njerëzimin; dhe kështu kjo e përgatiti atë të pranonte Zotin Jezus si këtë Shpëtimtar dhe të besonte tek ai.

Një gjë e ngjashme ndodhi edhe me kancelarin johebre të Etiopisë (Veprat 8). Pasi bleu një pergamenë të profecisë së Isaisë në Jerusalemin, ai ishte duke lexuar deri sa arriti kapitullin e saj të 53-të, dhe po vriste mendjen se kush mund të ishte ky që do të mbartte mëkatin, të cilin profeti e kishte përshkruar me kaq shumë ngjyra, kur ungjilltari Filip e takoi atë dhe e udhëhoqi te besimi në Krishtin.

Në të vërtetë, Veprat e Apostujve na tregojnë sesi të gjithë predikuesit e hershëm të krishterë e përdorën Dhiatën e Vjetër gjerësisht në ungjillëzimin e tyre qoftë të hebrenjve, qoftë të grekëve.

Por mund të shohim, nga përdorimi që Dhiata e Re i bën Dhiatës së Vjetër, se ajo është e dobishme edhe në një mënyrë tjetër domethënëse.

Për të ndërtuar doktrinë

Doktrina e krijimit (Zan 1:1–2:3)

Elementi dallues i doktrinës biblike të krijimit është menduar prej kohësh të mbështetet në këmbënguljen e saj në “tjetërqenien” e plotë të Krijuesit, apo duke përdorur termin biblik, në shenjtërinë e Krijuesit. Ai nuk është, siç ndodh në kozmologjitë e shumta pagane, pjesë e lëndës së universit; as nuk është i nënshtruar ndaj ndonjë parimi final apo ndaj ndonjë fuqie të quajtur Fat. Ai është vetëekzistues dhe i plotfuqishëm.

Por vetëm duke kuptuar teorinë moderne të informacionit, ne jemi ndërgjegjësuar për të vërtetën elokuede të versionit të krijimit të paraqitur në Dhiatën e Vjetër. Tani e dimë që sistemi biokimik, si ADN-ja p.sh., është një kod që mbart informacion; dhe është ky informacion, dhe jo individualisht lëndët kimike që e transmetojnë atë në çdo kohë, që mbijeton nga një brez

në tjetrin. Edhe nga një këndvështrim shkencor po fillohet të kuptohet që “lënda e parë” e universit nuk është material, por informacion.

Zanafilla 1, me frazën e saj të përsëritur “dhe Perëndia tha”, ka këmbëngulur gjatë shekujve që Perëndia e krijoi universin përmes fjalës së tij, duke e urdhëruar në ekzistencë dhe duke vulosur mbi materie informacionin e nevojshëm për zhvillimin e saj.

Dhiata e Re pranon dhe përsërit këtë doktrinë të krijimit: “Me anë të besimit ne kuptojmë se bota është ndërtuar *me fjalën e Perëndisë, ...*” (Heb 11:3) “Në fillim”, thuhet aty, “ishte Fjala” (Gjonit 1:1).

Veç kësaj, ishte Dhiata e Vjetër që mësoi e para doktrinën e njeriut të cilën Dhiata e Re e përvetëson dhe e zhvillon, domethënë që njeriu është krijuar në imazhin e Perëndisë (Zan 1:26; 9:6; Kol 3:10). Ishte po ashtu Dhiata e Vjetër që shprehu e para idealin e martesës, të themeluar nga Krijuesi, që Zoti Jezus ua kujtoi dishepujve të tij (Mat. 19:3–6).

Doktrina e rënies në mëkat (Zanafilla 3)

Kur Dhiata e Re shpjegon se çfarë nuk është në rregull me racën njerëzore, nuk paraqet ndonjë diagnozë të re nga ana e vet: ajo citon rënien e njeriut në mëkat siç përshkruhet te Zanafilla, ndonëse vazhdon, patjetër, të na drejtojë te shpengimi më i mirë që Perëndia e ka bërë të mundur për njerëzimin përmes Krishtit:

Mirëpo hiri nuk është si shkelja; nëse në fakt për shkak të shkeljes së një njeriu të vetëm (d.m.th Adamit) vdiqën shumë, shumë më tepër hiri i Perëndisë dhe dhurata me anë të hirit e një njeriu, Jezu Krishtit, i teptoi për shumë të tjerë. ... Në fakt, në qoftë se prej shkeljes së këtij njeriu të vetëm vdekja mbretëroi për shkak të atij njeriu, akoma më shumë ata që marrin bollëkun e hirit dhe të dhuratës së drejtësisë do të mbretërojnë në jetë me anë të atij njeriu, që është Jezu Krishti. ... Në fakt, ashtu si nga mosbindja e një njeriu të vetëm të shumtët u bënë mëkatarë, ashtu edhe nga bindja e një të vetmi të shumtët do të bëhen të drejtë. (Rom 5:15, 17, 19)

Doktrina e shlyerjes zëvendësuese

Kjo doktrinë nuk u shpik prej Dhiatës së Re që të interpretonte domethënien e vdekjes së Krishtit. Parimi i shlyerjes zëvendësuese u ilustrua shumë fort në ritualet e sakrificave të Dhiatës së Vjetër (p.sh. Lev 1:4) dhe u shpreh qartësisht në profecinë e famshme të Isaisë: “Ne të gjithë endeshim si dele; secili prej nesh ndiqte rrugën e vet, dhe Zoti bëri që të bjerë mbi të paudhësia e ne të gjithëve.” (Isa 53:6). Duke përdorur konceptet dhe gjuhën e Shërbëtorit të Përvuajtur të Isaisë, Zoti ynë e përshkroi vdekjen e vet kështu: “Biri i njeriut erdhi ...për të dhënë jetën e tij si çmim për shpengimin e shumë vetave” (Marku 10:45). Pali po ashtu e përsërit këtë fakt: “Krishti Jezus, ... e dha veten si çmim [greqisht: ἀντίλυτρον] për të gjithë” (1 Tim 2:5–6).

Doktrina e jetës pas vdekjes dhe ringjallja përfundimtare e trupit

Kjo nuk ishte një doktrinë e përmendur shpesh apo e zhvilluar me detaje në Dhiatën e Vjetër. Duhej, siç thekson Dhiata e Re, që Krishti të nxirrte në pah jetën dhe pavdekësinë me anë të ungjillit përmes vdekjes dhe ringjalljes së tij (2 Tim 1:10). Por për ata që kishin sy për të parë doktrina ishte e nënkuptuar në Dhiatën e Vjetër, siç ua tregoi Krishti edhe saducenjve. Saducenjtë nuk besonin në ndonjë jetë pas vdekjes dhe as në ringjalljen e trupit (shih Veprat 23:8); dhe në një rast ata e konfrontuan Krishtin me atë që, sipas supozimeve të tyre, do të ishte një rrjedhojë absurde për ish-bashkëshortët dhe ish-bashkëshortet nëse doktrina e ringjalljes do të ishte e vërtetë (Mat 22:29–32).

Përgjigjja e Zotit tonë i vuri në bankën e të akuzuarve në mënyrë të dyfishtë: “Ju gaboni, sepse nuk njihni as Shkrimet dhe as fuqinë e Perëndisë.” Para së gjithash, fuqia e Perëndisë nuk është e kufizuar vetëm në formimin e trupave të ringjallur të ngjashëm në çdo drejtim me gjendjen që kishin në këtë jetë. Fuqia e Perëndisë do të ndryshojë trupat tanë të tanishëm saqë, ndërsa akoma do të jenë realisht njerëzorë, martesat nuk do të jetë e nevojshme. Në atë botë ku nuk ka vdekje, plakje apo kalbje, riprodhimi nuk do të jetë i nevojshëm për të mbajtur në ekzistencë njerëzimin e shpënguar (shih Fil 3:21; 1 Kor 15:35–

49).

Por për të mbështetur faktin e thjeshtë të ngjalljes së të vdekurve, Zoti ynë përmendi deklaratën e Perëndisë të bërë Moisiut nga shkurrja që digjej (Eks.3:1–15). Në atë rast i përjetshmi UNË JAM e identifikoi dhe e përshkroi veten për Moisiun si “Perëndia i Abrahamit, Perëndia i Isakut dhe Perëndia i Jakobit”. Tani, dukshëm, UNË JAM-I, që rron gjithmonë, nuk e identifikon veten përmes marrëdhënieve me qenie që janë të vdekura, që janë bërë pluhur, tërësisht të zhdukura nga ekzistenca, që do të mbeten kështu përjetësisht, dhe përfundimisht do të fshihen nga kujtesa e çdokujt. Kur i përjetshmi hyn në marrëdhënie me një qenie njerëzore, dhe “e njëj” atë (krh. 1 Kor 8:3; Gjoni 17:2–3), vetë marrëdhënia është e përjetshme. Siç u shpreh edhe vetë Krishti: “Perëndia nuk është Perëndia i të vdekurve, por i të gjallëve” (Mat 22:32).

Për këshillë dhe ndihmë

Sipas Dhiatës së Re, Dhiata e Vjetër është gjithashtu e dobishme për të udhëhequr sjelljen e vërtetë të krishterë dhe për të kundërshtuar tundimet e djallit.

Shembulli i Krishtit

Shembulli më i lartë është ai që jep vetë Krishti. Ai iu përgjigj të tria tundimeve të Satanit duke cituar Dhiatën e Vjetër si fjala e padiskutueshme, autoritare e Perëndisë (Mat 4:4, 7, 10):

<i>Është shkruar:</i>	Njeriu nuk rron vetëm me bukë, por me çdo fjalë që del nga goja e Perëndisë. (Lip 8:3)
<i>Është shkruar:</i>	Mos e tundo Zotin, Perëndinë tënd. (Lip 6:16)
<i>Është shkruar:</i>	Adhuro Zotin, Perëndinë tënd, dhe shërbeji vetëm Atij. (Lip 6:13)

Paralajmërim për Izraelitët

Apostulli Pal i qortoi korintasit gjithashtu duke cituar shembuj

nga Dhiata e Vjetër të sjelljeve të këqija nga ana e izraelitëve, ndërsa ishin në shkretëtirë, dhe i përdori ato si paralajmërime për të krishterët që të mos sillen në të njëjtën mënyrë (1 Kor 10:1–13).

Dashuria që drejton sjelljen e të krishterëve

Sipas Krishtit, dhe të paktën disa prej bashkëkohësve hebrenj të tij, urdhërimet e shumta dhe të hollësishme të ligjit të Dhiatës së Vjetër mund të përmblihdeshin në dy porosi të përgjithshme (shih Luka 28–10:25; Mat 40–22:34):

“Duaje Zotin, Perëndinë tënd me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd dhe me gjithë mendjen tënde” (Lip 6:5) [dhe] “Duaje të afërmin tënd porsì vetveten” (Lev 19:18)

Në të njëjtën frymë, apostulli Pal i bën thirrje bashkëbesimtarëve të krishterë të duan njëri-tjetrin dhe të përmbushin ligjin:

Ai që e do tjetrin e tij e ka përmbushur ligjin. Sepse urdhërimet: Mos shkel kurorë, mos vrit, mos vidh, mos thuaj dëshmi të rreme, mos lakmo, dhe në pastë ndonjë urdhërim tjetër, përmblihdhen në këtë fjalë: Duaje të afërmin tënd porsì vetveten! Dashuria nuk i bën keq të afërmit; dashuria, pra, është përmbushja e ligjit. (Rom 13:8–10)

Mëshirë për të tjerët

Për më tepër, Krishti u bëri thirrje bashkëkohësve të tij të mbanin ekuilibrin delikat të moralit të rrënjësuar në Dhiatën e Vjetër. Disa prej tyre qenë të fiksuar për ritualet e Dhiatës së Vjetër, por ishin të pamëshirshëm në kritikën e tyre ndaj të tjerëve. Krishti korrigjoi çekuilibrin e tyre grotesk duke cituar preferencat e vetë Perëndisë të shprehura në Dhiatën e Vjetër: “Tani shkoni dhe mësoni çdo të thotë: “Unë dua mëshirë dhe jo flijime” [Osea 6:6]; Sepse unë nuk erdha për të thirrur në pendim të drejtët, por mëkatarët” (Mat 9:13).

Dhe sërish: “Dhe, po të dinit se çfarë do të thotë: “Unë dua mëshirë dhe jo flijime”, nuk do të kishit dënuar të pafajshmit.” (Mat 12:7).

Të forcojë shpresën tonë të krishterë

Veç kësaj, sipas Dhiatës së Re, Dhiata e Vjetër është gjithashtu e dobishme për të mbajtur gjallë dhe për të formuar shpresën tonë të krishterë. Duke folur në përgjithësi për Shkrimet e Dhiatës së Vjetër, Pali thotë:

Sepse të gjitha gjërat që u shkruan në të kaluarën u shkruan për mësimin tonë, që me anë të këmbënguljes dhe të ngushëllimit të Shkrimeve, të kemi shpresë. (Rom 15:4)

Në vizionin e tij të mirënjohur, të dokumentuar në kapitullin 7 të kujtimeve të tij, profetit Daniel iu dha mundësia të sodiste zgjidhjen përfundimtare të Perëndisë për atë që duket një cikël i pafund dhune dhe shkatërrimi të sjellë në botë prej rivalitetit të egër mes blloqeve të fuqive politike:

Unë shikoja disa vegime nate, dhe ja mbi retë e qiellit po vinte dikush që i ngjante një Biri njeriu; ai arriti deri te i Lashti i ditëve dhe iu afrua atij. Atij iu dha sundimi, lavdia dhe mbretëria, me qëllim që gjithë popujt, kombet dhe gjuhët të shërbenin; sundimi i tij është një sundim i përjetshëm që nuk do të kalojë, dhe mbretëria e tij është një mbretëri që nuk do shkatërrohet kurrë”. (Dan 7:13–14)

Tani, në ungjijtë, Zoti ynë e identifikoi veten me këtë Bir Njeriu që Danieli e pa të zbriste me retë e qiellit. Duke bërë këtë, ai u tregoi qoftë miqve të tij (Mt 24:30), qoftë gjykatësve të tij armiqësorë (Mat 26:64) që bota do ta shohë kështu atë kur të kthehet me fuqi dhe lavdi të madhe për t’i dhënë fund të keqes, dhe për të ngritur mbretërinë e Perëndisë mbi dhë. Në këtë mënyrë, përmes interpretimit të Zotit tonë të kësaj profecie të Dhiatës së Vjetër, shpresa jonë e krishterë është edhe e formuar, edhe e mbajtur gjallë.

Dokumentimi historik i institucioneve dhe ritualeve të Dhiatës së Vjetër, që tani kanë dalë nga përdorimi, ende është i dobishëm për ne

Atëherë, deri tani ka qenë e lehtë të provosh që Dhiata e Re përdor disa pjesë të Dhiatës së Vjetër në mënyrë të dobishme. Por çfarë mund të themi për ato institucione dhe rituale, si priftëria aronike dhe sistemi i saj i sakrificave të kafshëve, që Dhiata e Re shpall se tani kanë dalë nga përdorimi? Librat e Eksodit, Levitikut dhe Numrave që janë në Dhiatën e Vjetër, të cilat i përshkruajnë këto institucione dhe rituale me hollësi të madhe dhe dokumentojnë krijimin e tyre prej Perëndisë, janë pjesë e pamohueshme e Shkrimit për të cilin Pali thotë “I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia.” Në fakt për hebrenjtë, këto libra janë të përfshirë në Tora, që për ta ishte pjesa më e rëndësishme dhe më e shenjtë e Dhiatës së Vjetër.

Atëherë, a mundet Dhiata e Re të pretendojë me seriozitet që dokumentimi i këtyre institucioneve dhe ritualeve të dala jashtë përdorimit është i dobishëm për ne në këtë epokë të tanishme? Po, mundet – dhe e bën; vetëm që tani ne duhet të përgatitemi të zbulojmë se çfarë kuptimi dhe domethënie kanë ato në nivele të ndryshme dhe të dallueshme.

Niveli 1 – Domethënia e tyre për njerëzit që jetuan në kohët e Dhiatës së Vjetër

Libri që merret më shumë në Dhiatën e Vjetër me sakrificat, priftërinë, ligjet ceremoniale, pastërtinë morale dhe festat fetare është patjetër, Levitiku. Nuk ka dyshime se cila është tema mbizotëruese që përshkon të gjithë tematikën e tij të shumëllojshme. Në rrjedhën e 27 kapitujve të tij fjala “i shenjtë” shfaqet rreth 90 herë. Ky, pra, është një dokument që regjistron sistemin e përdorur nga Perëndia për të edukuar Izraelin e lashtë në mësimin e asaj se çfarë është shenjtëria dhe sesi mund të fitohet; dhe ne shumë shpejt do ta shohim se ajo që është në zemër të këtij mësimi historik për shenjtërinë, ende është i dobishëm për ne.

Është e vërtetë që, për disa njerëz, Levitiku është parë

si një libër i neveritshëm, për shkak të fokusit të tij në pjesët e brendshme të kafshëve, në sëmundjet dhe infeksionet e sikletshme, apo në hollësitë ligjore në lidhje me sjelljen seksuale të njerëzve. Për ta, kjo ngjan si përpikmëri fetare e tepërt; dhe prandaj ata pohojnë një preferencë për atë që e shohin si parimin më të gjerë, më të përzemërt dhe të përgjithshëm të dashurisë të shprehur në Dhiatën e Re. Por ata harrojnë faktin që është pikërisht ky libër i Levitikut që shpalos parimin themeltar: “Do ta duash të afërmin tënd si veten tënde” (Lev 19:18). Mbetet fakt që dashuria pa shenjtëri nuk është dashuri e vërtetë; dhe e kundërta, shenjtëria pa dashuri nuk është shenjtëri e vërtetë.

Në zemër të programit të Levitikut për të edukuar në shenjtëri qëndron vetë karakteri i Perëndisë. E lidhur me rreth 40 urdhërime qëndron fraza “Unë jam ZOTI”, që u kujton njerëzve se kush po i cakton këto standarde të sjelljes. Herë pas here, Zoti i kujton Izraelit që të mos përdhosë emrin e shenjtë të Perëndisë apo gjërat e shenjta të Perëndisë. Pesë herë rresht gjatë rrjedhës së librit përshkruhet arsyeja pse kërkohet që Izraeli të jetë i shenjtë: “Jini të shenjtë, sepse unë jam i shenjtë” (Lev 11:44, 45; 19:2; 20:7, 26); dhe gjashtë herë Zoti i kujton Izraelit (20:8; 21:8, 15, 23; 22:9, 16) se cili është nxitësi i shenjtërisë së tyre “Unë jam Zoti, Perëndia juaj që ju shenjtëron.” Përveç asaj që pas pak do të zbulojmë për domethënien e sakrificave, është tashmë e qartë që mesazhi kryesor i Levitikut akoma i flet edhe së tashmes tonë si të krishterë: sepse Dhiata e Re përsërit nxitjen e tij qendrore me fuqi të plotë:

Si bij të bindur, mos iu përshtatni lakmive të mëparshme kur ishit në padijen tuaj, por ashtu si është i shenjtë ai që ju thirri, të jini edhe ju të shenjtë në gjithë sjelljen tuaj, sepse është shkruar: Jini të shenjtë, sepse unë jam i shenjtë. (1 Pjet 1:14–16)

Por le të shohim se cili ishte funksioni i sakrificave në lidhje me temën qendrore dhe qëllimi i Levitikut.

Leviticu 1:1–6:7 i drejtohet popullit, duke i informuar ata për llojet e ndryshme të sakrificave që duhet të ofrojnë ndërsa i afrohen Perëndisë. Leviticu 6:8–7:38 u drejtohet priftërinjve, dhe parashtron rregullat e hollësishme që duhet të ndjekin

për të mbajtur në punë këtë sistem të ndërlikuar sakrificash. Nuk duhet të na habisë fakti që fjalët “i shenjtë” apo “shumë i shenjtë” janë përdorur një duzinë herësh në këta 7 kapituj: sepse këto sakrifica merren po ashtu me zhvillimin e shenjtërisë së popullit.

Dhe është e lehtë ta kuptosh si ndodh kjo. Nëse izraelitët – apo bie fjala çdokush tjetër – do të bëheshin të shenjtë, nevoja e tyre e parë do të ishte të ndërgjegjësoheshin për shenjtërinë e Perëndisë dhe njëherazi për mëkatshmërinë e tyre individuale dhe kombëtare. Kështu, përmes praktikës së përditshme, u rrënjos në ta se aq e madhe ishte mëkatshmëria e tyre, sa që nuk mund t’i afroheshin pranisë së Perëndisë pa një sakrificë fajëshlyese, dhe pa derdhje gjaku.

Natën e çlirimit prej Egjiptit secila familje hebrease u shpëtua nga gjykimi i Perëndisë përmes gjakut të qengjit të Pashkës (Eksodi 12:21–23). Por tani Perëndia, prej hirit të tij, kishte bërë që reja e pranisë së tij të banonte në tabernakull, prandaj ata duhet të kishin një ndërgjegjësim më të zhvilluar, më të thellë dhe më të detajuar për mëkatën. Kjo atëherë, u fitua duke u mësuar atyre që, për aspekte të ndryshme të mëkatit, kishin nevojë për sakrifica të ndryshme.

E para në radhë ishte një sakrificë e quajtur në hebraisht *עֹלָה* (*ōlāh*, ofertë që ngjitet), por në greqisht *ὁλοκαύτωμα* (*holokautōma*), për shkak se tipari dallues i kësaj sakrifice ishte që e gjitha ajo (përveç lëkurës) duhej të digjej në altar për Perëndinë (Lev 1:9). Me ofertat e tjera një pjesë e konsiderueshme i jepej priftit në detyrë (shih Lev 10–7:1 ;6:26); kurse në të tjerat, një pjesë e konsiderueshme e kafshës i kthehej ofruesit dhe konsumohej në një vakt miqësie mes Perëndisë, adhuresit, familjes dhe miqve të tij (Lev 20–7:15).

Por kjo nuk ndodhte me *holokautōma*, apo ofertën e djegur: e gjitha (përveç lëkurës, shih Lev 7:8) duhej që t’i ofrohej Perëndisë. Në këtë drejtim, kjo ofertë e parë dhe më e rëndësishme i ngjante urdhërimit të parë dhe më të madh. “Ti do ta duash, pra, Zotin, Perëndinë tënd, me *gjithë* zemër, me *gjithë* shpirt dhe me *tërë* forcën tënde.” (Lip 6:5). Me shikim të parë, pa e menduar mirë, ne mund të hamendësojmë që izraelitët ishin nxitur të bënë këtë ofertë të veçantë thjesht për të treguar shkallën e përkushtimit

të tyre real ndaj Perëndisë. Por kjo nuk është një gjë që shpjegon mjaftueshëm domethënien e saj. Çdo izraelit që i porositur ta ofronte, me qëllim që të pranohej në vend të tij, «për të shlyer dënimin në vend të tij.» (Lev 1:4).

Mbetet fakt që asnjë izraelit (përveç Krishtit) nuk i plotësoi kushtet e ligjit të Perëndisë, për të dashur Perëndinë me *gjithë* zemrën, mendjen, shpirtin dhe forcën e tij; dhe kuptimi i kësaj oferte mbi çdo tjetër ishte ky: që të mos të doje Zotin me *gjithë* zemrën, mendjen, shpirtin dhe forcën tënde, është një mëkat që duhej shlyer.

Sot jetojmë në një kohë kur këto sakrifica të Dhiatës së Vjetër nuk janë më në përdorim. Por ne duhet të marrim ende mësimin që kjo ofertë parësore transmetonte. Shumë prej nesh kanë një ide të pamjaftueshme se çfarë është mëkati. Ne mendojmë që, për sa kohë që nuk jemi duke bërë gjëra negative si gënjeshtër, mashtrim, kurorëshkelja, vrasja dhe kështu me radhë, sjellja jonë duhet të jetë e pranueshme para Perëndisë. Por për sa i përket dashurisë tonë për Perëndinë, sipas Krishtit, ne jemi të vakët (Zbul 16–3:15). Ne nuk jemi të ftohtë – nuk jemi kundër Perëndisë; por ne nuk jemi, sidoqoftë, as të ngrohtë – nuk e duam Zotin Perëndinë tonë me gjithë zemrën, mendjen, shpirtin dhe forcën tonë – por ngelemi të vetëkënaqur dhe nuk e dimë se, duke mos e dashur Perëndinë kështu, do të thotë se po thyejmë urdhërimin e parë dhe më të madh. Kjo është rrënja e çdo mëkati tjetër. Ja pse, natyrisht, kemi nevojë për sakrificën, jo të kafshëve, por të Krishtit për të bërë shlyerjen për ne.

Kishte patjetër shumë sakrifica të tjera në Dhiatën e Vjetër, secila me diagnozën e vet të nevojës njerëzore para Perëndisë. Le të kënaqemi për tani duke parë shkurtimisht dy të tjera prej tyre: ofertën për mëkatën (Lev 4:1–35) dhe ofertën për fajet (Lev 5:1–6:7).

Rregullorja për ofertën e mëkatit nuk përmend mëkate specifike; por ato e përcaktojnë madhësinë e ofertës së domosdoshme sipas personit që e kreu mëkatën. Nëse një qytetar i thjeshtë mëkatoi, ai apo ajo duhej të sillte një dhi apo qengj (Lev 4:27–28, 32). Nëse një ndër krerët mëkatonte, ai duhet të sillte një cja (Lev 23–4:22). Kafshët meshkuj kishin një vlerë më të madhe se ato femra për shkak se ata shtonin tufën. Nëse

i gjithë populli mëkatonte, duhej të ofronin një dem të vogël (Lev 4:13–14); dhe nëse një prift i vetëm mëkatonte në detyrat e tij si përfaqësues i popullit, ai duhet të ofronte një dem të vogël, ashtu si bënte i gjithë populli për mëkatën e tij (Lev 4:2–3).

Parimi pas këtyre shkallëzimeve është i qartë. Për çdo mëkat: pesha e tij caktohej sipas statusit të personit që e kryente atë. Nëse një qytetar i thjeshtë vjedh kuletën e dikujt, kjo gjë është një gjë e keqe; nëse një gjykatës që dënon të tjerët për vjedhje apo një qeveritar që nxjerr ligje kundër vjedhjes, vjedh vetë kuletën e dikujt, është një mëkat dhe skandal më i madh.

Ndonëse sakrificat e Dhiatës së Vjetër tani kanë dalë jashtë përdorimit, i njëjti parim, që dikur ishte në themel të ofertave të mëkatit, mbetet në fuqi për të bërë një vlerësim modern të seriozitetit të mëkatit. Dhiata e Re e njeh dhe e zbaton këtë: “Vëllezër të mi, mos u bëni shumë mësues”, thotë Jakobi (3:1), “duke ditur se do të kemi një gjykim më të ashpër”; më të ashpër – sepse duke mësuar të tjerët ne pretendojmë të jemi ekspertë të moralit, dhe nxisim të tjerët të mos mëkatojnë; nëse, pastaj, ne bëjmë çfarë u themi të tjerëve të mos e bëjnë, serioziteti i mëkatit është rritur.

Rregullat për ofertat e fajit (Lev 5:1–6:7), nga ana tjetër, ndajnë sakrificat e kërkuara dhe kompensimin që duhet të paguhet sipas dëmit që shkelja ka shkaktuar (ndonëse Lev 5:7 lë hapësirë për njerëzit që nuk plotësojnë dot të gjitha kushtet). Prapëseprapë, parimi pas rregullave është i qartë: në lidhje me dëmin që mëkati shkakton, dëmtimi mbetet i njëjtë, pavarësisht se kush e bën mëkatën. Nëse një shofer i pakujdesshëm shkakton një aksident në të cilin vdesin tre njerëz, dëmi i bërë është i njëjtë, pavarësisht se kush ka qenë shoferi.

Përsëri, ky vlerësim i seriozitetit të mëkatit ka vlefshmëri të përhershme. Kjo është një nga aspektet më të frikshme të mëkatit: potenciali që ka për të bërë një dëm të pakthyeshëm fizik, psikologjik dhe shpirtëror te të tjerët.

Atëherë, mësimet e dhëna nga sakrificat e Dhiatës së Vjetër në atë që e kemi quajtur Niveli 1, qenë padyshim Shkrime të frymëzuara nga Perëndia dhe janë ende të dobishme për ne. Por le të vazhdojmë te mësimet e dhëna në nivelin tjetër.

Niveli 2 – Vetë pamjaftueshmëria e sakrificave të Dhiatës së Vjetër na ndihmon, përmes kontrastit, të kuptojmë më qartësisht përsosmërinë e sakrificës së Krishtit

E kemi prekur këtë çështje në Kapitullin 2 dhe nuk kemi pse të përsërisim këtu çfarë është thënë atje. Por duhet që të vëmë re se vetë prania e velit të dytë në tabernakullin e Dhiatës së Vjetër, dhe në tempujt pasues, që përcaktuar qëllimisht prej Frymës së Shenjtë për të tërhequr vëmendjen te pamjaftueshmëritë e sakrificave dhe ritualeve të Dhiatës së Vjetër, dhe kështu të na bëjë të perceptojmë, qoftë intelektualisht, qoftë në përvojën tonë personale, epërsinë e lavdishme të sakrificës së Krishtit (Heb 9:8–12; 10:19–22).

Madje edhe hyrja në ndarjen e parë të tabernakullit, Vendit të Shenjtë, ishte e penguar për izraelitët e zakonshëm pavarësisht sakrificave të tyre personale apo ato kombëtare; hyrja që e rezervuar për priftërinjtë. Por edhe ata nuk qenë të lejuar të hynin në Vendin e Shenjtë brenda Velit, të ashtuquajturin Shenjtërorja e Shenjtërores, apo Vendi Shumë i Shenjtë. Vetëm kryepriifti mund të hynte atje; por madje edhe ai që paralajmëruar të mos hynte atje në çdo kohë përveç Ditës së Shlyerjes së mëkateve një herë në vit (Lev 16).

Problemi ishte se dhuratat dhe sakrificat që ofronin njerëzit nuk mund të pastronin plotësisht ndërgjegjen (Heb 9:9). Çdo herë që ata ofronin sakrificat e caktuara me pendesë dhe besim të vërtetë, ata faleshin (Lev 6:7) për atë mëkat të caktuar. Por çdo vit në Ditën e Shlyerjes së mëkateve, çështja e mëkateve të popullit rikujtohej sërish. Nuk kishte ndonjë zgjidhje finale për atë; asnjëherë njerëzit nuk fitonin një pastrim të plotë ndërgjegjeje të atillë, sa t'i mundësonte ata të hynin në Vendin Shumë të Shenjtë në tabernakullin tokësor, aq më pak për të hyrë në Vendin Shumë të Shenjtë në qiell (Heb 9:9–10).

Është shumë e dobishme që të mos e harrojmë këtë, sepse na ndihmon të kuptojmë lavdinë e jashtëzakonshme të asaj që Krishti ka bërë për ne. Si kryepriifti ynë, ai “hyri një herë e përgjithmonë në shenjtërore me gjakun e vet, dhe fitoi një shpëtim të amshuar.” (Heb 9:12). Për më tepër, që të mos kishte më dyshime, vendi i shenjtë për të cilin flasim është përkufizuar

më tej kështu: “Krishti nuk hyri në një shenjtërore të bërë me dorë,... por në vetë qiellin për të dalë tani përpara Perëndisë për ne” (Heb 9:24). Dhe për rrjedhojë edhe ne, siç na thuhet (Heb 10:19–22), kemi guxim të hyjmë në vendin e shenjtë prej gjakut të Jezusit, dhe jemi nxitur të përdorim këtë guxim të dhënë prej Perëndisë për t’iu afuar atij me një zemër të vërtetë përmes rrugës së re dhe të gjallë që ai ka hapur për ne (Heb 10:20, 22).

Në këtë nivel të interpretimit, atëherë, lavdia e veprës së Krishtit konsiston plotësisht në dallimin mes sakrificës së tij dhe sakrificave të Dhiatës së Vjetër, si në lidhje me vetë sakrificën e tij, ashtu edhe në lidhje me rezultatet që joi ka arritur për ne. Nisur nga kjo, Dhiata e Re këmbëngul që sakrifica e tij nuk është një vazhdimësi apo as edhe një zhvillim i sistemit të Dhiatës së Vjetër, por fundi i tij. Prandaj nuk ka më asnjë proces të vlefshëm për të ofruar sakrifica, as si ajo e Krishtit, për të fituar faljen e mëkateve (Heb 10:18). Kryerja e sakrificës së tij mbi kryq bën që të mos nevojiten dhe as të mos lejohen më sakrifica të tilla.

Pasi të kemi kuptuar këtë dallim shumë të rëndësishëm, ne jemi gati të vazhdojmë në nivelin tjetër të interpretimit të sakrificave të Dhiatës së Vjetër.

Niveli 3 – Domethënia e sakrificave të Dhiatës së Vjetër si hije e gjërave të mira të ardhshme.

Sipas Dhiatës së Re, tabernakulli i lashtë, priftëria e lidhur me të dhe sistemi i sakrificave të tij kishin një funksion të dyfishtë. Në radhë të parë këto shërbenin si “kopje” të gjërave qiellore (Heb 8:5; 9:23); dhe kështu, përmes simboleve dhe riteve simbolike, ato paraqitën të vërteta dhe parime të përzetshme në nivelin e të kuptuarit të atyre njerëzve në ata shekuj të shkuar. Njerëzit ende përdorin këtë lloj gjëje me fëmijët. Ata i bëjnë të kuptueshme të vërtetat abstrakte të matematikës për mendjen e fëmijës duke përdorur gogla me ngjyra të ndryshme apo tulla druri të madhësive të ndryshme.

Por përveçse si kopje e gjërave qiellore tabernakulli, priftëria e tij dhe sakrificat i shërbyen një funksioni tjetër, edhe nëse shumë prej zraelitëve të lashtë të atyre kohëve e dinin këtë apo jo: ato shërbyen si “hija e të mirave që kishin për të ardhur” (Heb 10:1),

d.m.th si hije e personit të Krishtit dhe veprës shpenguese të tij.

Si të tilla, këto hije plotësuan funksionin e tyre kur Krishti erdhi më në fund: ato i ndihmuan njerëzit ta identifikonin Krishtin. Njerëzit thjesht duhet ta përputhnin atë me hijet e dhëna prej Zotit për të zbuluar, dhe për të qenë të sigurt, se ai ishte realiteti i madh për të cilin ato ishin thjesht hije. Këto hije ende mund ta përmbushin këtë funksion për ne. Sepse edhe ne mund të studiojmë tabernakullin e lashtë dhe sistemin e tij të sakrificave, t’i krahasojmë ato me personin dhe veprën e Krishtit, dhe, duke parë ngjashmëritë e jashtëzakonshme, të bindemi se, mes gjithë udhëheqësve fetarë të botës, vetëm Krishti del në pah si Qengji i Perëndisë i paranjohur para krijimit të botës.

Por hijet e Dhiatës së Vjetër mund të na shërbejnë më shumë sesa si mjete identifikimi për Shpëtimtarin. Le të përdorim një analogji. Nëse do planifikoj të vizitoj një galeri arti të famshme në fund të vitit, do bëja mirë të blija një shpjegues me figura dhe ta studioja me hollësi para se të hyj në atë galeri. Natyrisht do kuptohej nga ana ime që riprodhimet me ngjyra në atë shpjegues nuk vlejnë të krahasohen me shkëlqimin e vetë kryeveprave kur t’i shoh ato aty brenda. Riprodhimet e botura janë thjesht “hije” të “realiteteve” që unë pres t’i shoh. Nga ana tjetër, kryeveprat e mëdha që do të shoh një ditë do të jenë kaq të mbushura me hollësi domethënëse, sa që ka shumë të ngjarë se me shikimin e parë do më shpëtonin prej syve shumë detaje nëse nuk do t’i kisha studiuar “hijet”, dhe të paralajmërohesha prej tyre në lidhje me atë që duhej të kërkoja të shihja te kryeveprat.

Kështu është edhe me hijet e Dhiatës së Vjetër. Një studim i hollësishëm i tyre mund të na paralajmërojë për të parë domethënien në personin dhe veprën e Krishtit që, përndryshe, mund të na shpëtojë nga mendja. Le të marrim një shembull sesi Dhiata e Re përdor një hije të Dhiatës së Vjetër për të na ndihmuar të dallojmë disa detaje të këndshme të veprës së Krishtit.

Tre shfaqjet e kryepriftit të Izraelit.

Te Hebrenjve 9:23-28 shkrimtari po diskuton pastrimin e “kopjeve të gjërave në qiell”, domethënë pastrimin e tabernakullit të lashtë

që bëhej çdo vit në Ditën e Shlyerjes së fajeve (Lev 16:16–19); dhe ai krahason dhe kontraston atë pastrim të kopjeve me pastrimin e Krishtit të vetë gjërave qiellore. Siç edhe mund të pritej, ai kontraston pastrimin e përsëritur të kopjeve prej kryepriftit të Izraelit, me pastrimin e përhershëm të gjërave qiellore prej vetë Krishtit. Dhe ai kontraston gjithashtu tabernakullin e bërë nga duart e njerëzve, në të cilin hynte kryeprifti i Izraelit Ditën e Shlyerjeve të mëkateve, me vetë qiellin në të cilin Zoti ynë hyri pas vdekjes, ringjalljes dhe lartësimit të tij. Por pas kësaj ai bën një krahasim të gjallë dhe shumë edukativ mes tre “shfaqjeve të kryepriftit të Izraelit dhe tre shfaqjeve të bëra nga Krishti. Le t’i prezantojmë ato formalisht.

Në Ditën e Shlyerjes së mëkateve, kryeprifti i Izraelit duhej të bënte së pari shlyerje për veten (Lev 14–11 ,16:6); natyrisht që nuk gjen ndonjë gjë homologe me këtë në sakrificën që Krishti bëri mbi kryq. Tre shfaqjet rituale të kryepriftit të Izraelit, në të cilat ne jemi të interesuar, janë ato që ai bënte në lidhje me dy cjeptë që qenë ofertë për mëkatin e popullit (Lev 10–7 ,16:5).

Shfaqja 1 (Lev 16:15): kryeprifti dilte prej tabernakullit dhe shihej nga të gjithë njerëzit para altarit të madh në oborr. Aty ai therte cjamin e parë dhe mbledhte gjakun në një enë.

Shfaqja 2 (Lev 16:15–16): pastaj fshihej prej syve të popullit duke shpënë gjakun në Vendin Shumë të Shenjtë pas velit. Kështu ai “paraqitej në praninë e Perëndisë” për popullin dhe në emër të tij si përfaqësuesi i tyre, dhe spërkaste gjakun mbi dhë para kapakut të pajtuesit mbi arkë, froni simbolik i Perëndisë.

Shfaqja 3 (Lev 16:18–22): tani ai dilte prej tabernakullit sërish dhe shfaqej për një herë të dytë para popullit për t’u marrë me cjamin e dytë si ofertë mëkati për popullin. Ai rrëfente mbi kokën e tij mëkatet e kombit, dhe pastaj cjami çohet prej dikujt të caktuar për këtë punë në një vend të shkretë, dhe braktisej aty.

Ja, pra, tre shfaqjet rituale nga kryeprifti i Izraelit. Por në krah të tyre autori paraqet tre shfaqjet e Zotit tonë.

Tre shfaqjet e Krishtit

Shfaqja 1: “por tani, vetëm një herë, në fund të shekujve Krishti u shfaq për të prishur mëkatin me anë të flijimit të vetvetes.” (Heb

9:26), në sytë e gjithë qiellit, tokës dhe ferrit.

Shfaqja 2: ‘Krishti ... hyri ... në vetë qiellin për të dalë tani përpara Perëndisë për ne’ (Heb 9:24) — dhe Perëndia, që e di që Krishti paraqitet si përfaqësuesi ynë, duke pranuar atë, ka pranuar të gjithë ata që ai përfaqëson.

Shfaqja 3: ‘kështu edhe Krishti ... do të duket për së dyti pa mëkat për ata që e presin për shpëtim.’ (Heb 9:28). Që do të thotë se, në ardhjen e tij të dytë, Krishti (që bëri sakrificën e tij për mëkatet tona, la këtë botë dhe tani ka dalë në prani të Perëndisë për ne), do të lërë qiellin (1 Sel 4:16), dhe do t’i shfaqet popullit të tij që pret për të. Ndryshe nga kryeprifti i Izraelit në shfaqjen e tij të dytë para popullit, Krishti, në dukjen e tij të lavdishme (Titus 2:13), “do të shfaqet pa mëkat” d.m.th pa patur nevojë të bëjë një ofertë tjetër për mëkatin përderisa oferta e tij u përfundua në Kalvar. Ai do të shfaqet “për shpëtim” d.m.th për shpengimin e trupave tanë (Rom 8:23), dhe do të mbledhë bashkë të shpenguarit e tij në shtëpinë qiellore të Atit (Gjoni 14:1–3).

Prandaj hija e Dhiatës së Vjetër na tregon jo vetëm për faktin që Krishti është shpenguesi ynë, por na tërheq vëmendjen që të shohim tre fazat madhore të këtij shpengimi: mishërimin e tij dhe sakrifikimin e tij në botën tonë; shërbesën e tij të tashme në praninë e Perëndisë për ne; dhe ardhjen e tij të dytë për të cilën ne presim për të plotësuar shpëtimin tonë dhe shpengimin e trupave tanë. Nga këto tri shfaqje ndoshta e dyta është më ngushëlluesja. Nuk është gjë e vogël të dish që përfaqësuesi ynë, që në këtë çast ka dalë për ne në praninë e Perëndisë, është pranuar nga Perëndia dhe së bashku me të, të gjithë ata që ai përfaqëson.

...

Pyetjet e studimit për këtë kapitull mund t’i gjeni në faqen 432.

4 Qëllimi i Kujt?

Qëndrimi i Dhiatës së Re për Synimin e Autorit në Dhiatën e Vjetër

Lexuesit e Dhiatës së Re kanë komentuar shpesh për ndryshimin e madh që ndodhi me dishepujt e Krishtit në kapitujt hyrës të Veprave të Apostujve. Disa javë më parë ata qenë fshehur pas dyerve të mbyllura në një dhomë të sipërme në Jerusalem, të frikësuar se autoritetet, që sapo e kishin kryqëzuar Mësuesin e tyre nën akuzën e blasfemisë dhe revoltës, mund të ishin duke i kërkuar edhe ata për t'i dënuar me të njëjtin fat. Por papritur ata dolën në rrugët e Jerusalemit dhe në tempull duke u predikuar hapur turmave që Jezusi ishte Mesia, dhe duke i akuzuar autoritetet për vrasjen e tij nën maskën e ligjit. Shpjegimi që ata dhanë për këtë transformim të habitshëm – dhe patjetër që kjo kërkon një farë shpjegimi – ishte që Krishti qe ngjallur prej së vdekurish dhe që e kishin takuar atë për një periudhë dyzet ditore. Ata më pas kishin dëshmuar ngjitjen e tij në qiell dhe kishin marrë Frymën e Shenjtë të dërguar në emrin e tij.

Por një ndryshim tjetër rrënjësor duket tek apostujt brenda

kapitujve të parë të Veprave dhe ky është një lloj kuptimi i ri i Dhiatës së Vjetër. Mendoj që nuk do të jemi duke e tepruar po të themi për apostujt, në bazë të asaj që shkruhet në ungjijtë, se para kryqit ata kishin qenë të avashtë në përvetësimin e asaj që Krishti u mësoi. Kur ai i paralajmëroi për kryqëzimin e tij në Jerusalem, Pjetri madje e qortoi atë sesi i shkoi ndër mend një gjë e tillë; dhe apostujt e tjerë po ashtu nuk mund të kuptonin se për çfarë po fliste (Mat 16:21–23; Luka 9:45; 18:31–34). Kur ai vdiq, ata qenë të rrënuar emocionalisht.

Por, ja, menjëherë pas lartësimit, shohim që Pjetri po citon Shkrim pas Shkrimi. Ai citon Psalmet 69:25 dhe 109:8 si profeci për Judë Iskariotin, tradhëtarin, dhe se çfarë duhet të bënin tani për vendin bosh në grupin e apostujve (Vep. 1:20–26). Ai citon profecinë e Joelit 2:28–32 për të identifikuar fenomenin e Rrëshajëve; ai citon Psalmet 16:8–11 dhe 110:1 si profeci të ringjalljes dhe të lartësimit të Krishtit (Veprat 2:17–36). Edhe kur i nxorën për hetim para Këshillit Suprem (Vep. 4:1–21), Pjetri dhe Gjoni i habitën pjesëtarët e jurisë. Ishte e dukshme që ata ishin të pashkolluar, peshkatarë me profesion, pa arsimim formal në ndonjë prej seminareve rabinikë (Vep. 4:13); por ja që po citonin Shkrimet e Dhiatës së Vjetër me një saktësi çuditërisht të madhe (gjë që për priftërinjtë qe shqetësuese) përballë vetë ekspertëve fetarë. Ata pohonin se Jezusi vetë ishte guri që, sipas Psalmi 118:22, u refuzua nga ndërtuesit, por i bërë nga Perëndia gur i qoshes; dhe ata pohuan se kryepriifti, priftërinjtë e lartë dhe këshilli i tyre, qenë këta ndërtues që e refuzuan atë.

Këshilli i ndaloi që të predikonin apo mësonin më tej në emrin e Jezusit dhe i kërcënoi ata me ndëshkime nëse thyenin këtë dekret. Po ata nuk e përfillën dekretin. Psalmi 2, siç e vëzhguan bashkarisht, ishte një profeci që tregonte për përpjekjet e orkestruara të paganëve, Pilatit dhe Herodit së bashku me pleqtë e Izraelit për të hequr qafe Jezusin; por aty profetizohej edhe reagimi i Perëndisë për kundërshtimin e tyre: Perëndia do të caktonte mbretin e tij mbi malin e tij të shenjtë Sion. Apostujt deklaruan që ata e kishin parë të përmbushej para syve të tyre kjo gjë në kryqëzimin, ringjalljen dhe lartësimin e Krishtit; dhe të siguruar prej këtij psalmi se Perëndia do të vazhdonte të përligjte Birin e tij, ata vazhduan të predikonin (Vep. 4:18–31).

Këshilli, që e kishte të pamundur të kuptonte sesi këta peshkatarë, biblikisht të paarsimuar, kishin zhvilluar një njohje dhe interpretim të atillë të Shkrimit, konstatuan me njëri-tjetrin se ata kishin qenë me Jezusin (Vep 4:13). Këtu ata nuk gabuan; sepse Luka na tregon që Zoti i ngjallur kaloi pjesën më të madhe të 40 ditëve pas ngjalljes së tij duke hapur mendjet e apostujve që ata të kuptonin Shkrimet, dhe duke u interpretuar atyre pjesë brenda Shkrimeve, që nga Pentatuku e në vazhdim, të cilat flisnin për veten e tij (Luka 24:27, 44–47; Vep 1:3).

Ky interpretim kristologjik i Dhiatës së Vjetër rrjedh atëherë prej vetë Krishtit. Ai është i pranishëm kudo brenda Veprave dhe pjesës tjetër të Dhiatës së Re. Por ai përshkon edhe katër ungjijtë; sepse ndërsa ungjilltarët pas ngjalljes dhe lartësimit kthyen kokën pas mbi jetën dhe shërbesën e Krishtit para se të kryqëzohej, ata tani panë me sy të ndriçuar sesi kjo ishte një përmbushje e Dhiatës së Vjetër.

Sidoqoftë, disa e kanë ende të vështirë këtë interpretim kristologjik.

Një problem hermeneutik në dukje dhe tri çështje që ngrihen prej tij

Është e pamohueshme që ka vende në Dhiatën e Re ku një shkrimtar citon një varg prej Dhiatës së Vjetër dhe e lidh atë me Krishtin kur me shikim të parë mund të duket, sipas parimeve normale të eksegjezës, që vargu nuk ka të bëjë fare me Krishtin. Disa herë një shkrimtar i Dhiatës së Re e përmend një profeci të Dhiatës së Vjetër për të mbështetur, le të themi, doktrinën e krishterë të hyjnisë së Zotit Jezus kur është e pamundur që vetë profeti i Dhiatës së Vjetër të kishte patur si synim të shprehte apo të mbështeste ndonjë doktrinë të tillë ose madje ta kishte kuptuar.

Një shembull i kësaj është profecia e thënë nga profeti Nathan për Mbretin David dhe e dokumentuar prej autorit të 2 Samuelit (kushdo qoftë ai; vetë profeti Samuel kishte vdekur në atë kohë). Profecia kishte të bënte me të ardhmen e dinastisë mbretërore të Davidit:

Kur ti kesh mbushur ditët e tua dhe të jesh duke pushuar bashkë me etërit e tu, unë do të ngre mbas teje pasardhësit e tu që do të dalin nga barku yt dhe do të vendos mbretërinë tënde. Ai do të ndërtojë një shtëpi në emrin tim dhe unë do ta bëj të qëndrueshëm për gjithnjë fronin e mbretërisë së tij. Unë do të jem për të një baba dhe ai një djalë për mua; kur do të bëjë ndonjë të keqe, unë do ta dënoj me shufra njeriu dhe me goditje të bijve të njerëzve, por mëshira ime nuk do të largohet, ashtu siç ia kam hequr Saulit, që e kam hequr nga detyra para teje. Shtëpia jote dhe mbretëria jote do të bëhen të qëndrueshme për gjithnjë para meje, dhe froni yt do të jetë i qëndrueshëm për gjithnjë. (2 Sam 7:12–16)

Tani vetë Dhiata e Vjetër dokumenton (1 Mbr 5:5; 8:17–20; 1 Kr 22:9–10; 28:5–7; 2 Kr 6:8–10) që pasardhësi direkt i Davidit, Salomoni, ishte ai që ndërtoi shtëpinë e Zotit në Jerusalem; dhe që Davidi dhe Salomoni bashkë besuan se premtimi i Perëndisë “unë do të jem për të një baba dhe ai një djalë për mua” që përmbushur në Salomonin. Davidi tha “Ai [Zoti] më tha: Do të jetë biri yt Salomon ai që ka për të ndërtuar shtëpinë time ... sepse kam zgjedhur atë si djalë tim, dhe unë do të jem për atë si një baba.” (1 Kr 28:6).

Sidoqoftë, në Dhiatën e Re, shkruesi i Hebrenjve (1:5) citon të njëjtën deklaratë “unë do të jem për të një baba dhe ai një djalë për mua” dhe e lidh atë jo me Salomonin, por me Krishtin. Përveç kësaj, ai e citon atë bashkë me një numër deklaratash të tjera të nxjerra nga Dhiata e Vjetër, për të mbështetur pohimin e tij që Dhiata e Vjetër dëshmonte se Mesia do të jetë Biri i të Atit në sensin tri-unitarian (Heb 1:5–13).

Problemi hermeneutik është lehtësisht i dukshëm. Profeti Nathan, nuk mund të kishte bërë një pohim të tillë duke nënkuptuar një përkufizim tri-unitarian, kur ai shprehu fillimisht këtë profeci për Davidin. Në të njëjtën kohë shkrimtari i Hebrenjve nuk do të kundërshtonte që kjo deklaratë, siç u shpreh fillimisht nga Nathani, kishte të bënte me Salomonin. Natyrisht ai nuk do të kishte dëshirë të pohonte se pjesa tjetër e profecisë, “kur do të bëjë ndonjë të keqe, unë do ta dënoj” i referohej Krishtit; sepse dukshëm ka parasysh Salomonin dhe

pasardhësit e tjerë të Davidit, por jo Mesian. Duke qenë kështu, kuptohet që shkrimtari i Hebrenjve mendonte se deklarata, “unë do të jem për të një baba dhe ai një djalë për mua”, mbartte dy kuptime: një kuptim të pjesshëm që lidhet me Salomonin dhe një kuptim më të plotë që lidhet me Krishtin.

Ngrihen tri pyetje:

1. Si mund ta justifikonte autori i Hebrenjve kuptimin që i vesh deklaratave të Nathanit, të cilin vetë Nathani nuk e synonte?
2. Si mund ta justifikonte nxjerrjen e kësaj thënieje jashtë kontekstit në të cilin u tha – nëse ka vepruar realisht ashtu – dhe si mund ta justifikonte pohimin se Krishti e përmbushi atë?
3. Së fundi, prej cilit parim hermeneutik mundet shkrimtari i Hebrenjve të justifikojë pohimin e tij që një deklaratë në Dhiatën e Vjetër mund të ketë jo një, por dy kuptime?

Përgjigjandaj këtyre tri pyetjeve gjendet në bindjen që Dhiata e Re ka për frymëzimin hyjnor të Dhiatës së Vjetër. Por nuk është çështja thjesht e bindjes së Dhiatës së Re për frymëzimin hyjnor, por më shumë i kuptuari i asaj që (për mungesë të një shprehjeje më të mirë) mund ta quajmë “mekanizmi” i frymëzimit hyjnor.

Origjina e profecisë hyjnore dhe çështja e synimit

Le të kujtojmë deklaratën e dytë prej dy deklaratave më të njohura të Dhiatës së Re për frymëzimin hyjnor që përmendëm në fillim të kapitullit të fundit:

Sepse asnjë profeci nuk ka ardhur nga vullneti i njeriut, por njerëzit e shenjtë të Perëndisë kanë folur, të shtyrë nga Fryma e Shenjtë. (2 Pjet 1:21)

Vargu përmban dy deklarata, një negative dhe një pozitive. Deklarata negative shpreh atë çfarë nuk ka qenë kurrë burimi i nxitjes për profecinë e vërtetë. Deklarata pozitive shpjegon se çfarë ka qenë burimi i vërtetë i profecisë dhe me çfarë fuqie transmetuese dhe udhëzuese u fuqizuan qenie të thjeshta

njerëzore për të shprehur mesazhe që, në fakt, vinin prej Perëndisë. Le të shqyrtojmë secilën prej tyre me radhë.

Deklarata negative

Sepse asnjë profeci nuk ka ardhur nga vullneti i njeriut [për ne]. (2 Pjet 1:21)

Nuk ndodhte që kur një profet përballej me një situatë, duke u mbështetur te përvoja e tij, vlerat e tij morale dhe intuita teologjike, të vendoste të nxirrte një parashikim, dhe duke u ndierë i sigurt se Perëndia do t’ia plotësonte, ia vishte parashikimin Perëndisë. Asnjë profeci e vërtetë nuk erdhi në këtë mënyrë.

Një ilustrim i mrekullueshëm i kësaj është dhënë prej vetë profecisë te 2 Samueli 7 që kemi qenë duke e diskutuar. Situata është si më poshtë. Mbreti David tani ishte vendosur në fron dhe po banonte në një pallat të përhershëm, të bukur dhe të ndërtuar posaçërisht për të. Arka e Perëndisë, nga ana tjetër, ishte strehuar ende në një çadër të transportueshme, e mbuluar thjesht me perde. Prandaj Davidi thirri profetin Nathan dhe i hapi zemrën duke i shprehur dëshirën për të ndërtuar për Perëndinë një shtëpi të lavdishme dhe të përhershme. Nathani, duke vepruar me kokën e vet, e miratoi atë menjëherë. Motivet e Davidit qenë të lavdërueshme (vetë Perëndia më pas tha kështu, shih 1 Mbr 8:18), dhe projekti i propozuar qe madhështor. Pa u konsultuar me Perëndinë (sepse në një situatë të tillë ai nuk ndjeu ndonjë nevojë), Nathani e mbështeti Davidin: “Shko, bëj gjithçka ke në zemër, sepse Zoti është me ty” (2 Sam 7:3).

Por Nathani e kishte gabim: Zoti nuk qe aspak me Davidin në këtë plan; dhe atë natë Perëndia mori iniciativën dhe i dha Nathanit mesazhin e vet për t’ia përçar Davidit, i cili ishte tërësisht i ndryshëm nga ai i Nathanit. Thelbi i mesazhit të Perëndisë (2 Sam 7:5–13) ishte që Davidi dhe Nathani bashkë (edhe pse kishin motivet më të mira), kishin vepruar me iniciativën e tyre dhe kishin hyrë në të drejtat e posaçme të Perëndisë. Kur Perëndia e nxori Izraelin nga Egjipti, vetë Perëndia kishte marrë iniciativën dhe kishte ftuar Izraelin që

t'i ndërtonte atij një tabernakull që ai të mund të banonte mes tyre. Që atëherë, ai kishte qenë i kënaqur të banonte në këtë çadër të transportueshme duke shkuar nga një vend në tjetrin me Izraelin, dhe nuk i kishte kërkuar askujt ndonjëherë t'i ndërtonin një shtëpi të përhershme të palëvizshme në një vend të caktuar. Kur të vinte koha për këtë, do të ishte vetë Perëndia dhe jo Davidi, dhe aq më pak Nathani, që do të merrte iniciativën dhe të urdhëronte të bëhej (2 Sam 7:4-7). Dhe kur Perëndia vendosi të ndërtohej shtëpia e përhershme, Ai kishte për qëllim të urdhëronte një bir të Davidit, jo vetë Davidin ta ndërtonte atë.

Atëherë kontrasti mes mesazhit të parë të Nathanit për Davidin dhe atij të dytë është udhëzues. I pari u përcoll te Davidi prej vullnetit të Nathanit; realisht nuk ishte një profeci e vërtetë, e frymëzuar prej Perëndisë – ndonëse Perëndia e frymëzoi autorin e 2 Samuelit për ta dokumentuar atë që të na jepte një mësim. Mesazhi i dytë i Nathanit, në kontrast me këtë, erdhi prej Perëndisë, me iniciativën e Perëndisë; Nathani ishte thjesht zëdhënësi i Perëndisë.

Dhe kjo, tani, është pika që do të ngrejë pjesa e dytë e deklaratës së spikatur të Dhiatës së Re për “mekanizmat” e profecisë së Dhiatës së Vjetër.

Deklarata pozitive

... njerëzit ... kanë folur, të shtyrë nga Fryma e Shenjtë...
(2 Pjet 1:21)

Kjo deklaron që e gjithë profecia e vërtetë e Dhiatës së Vjetër e pati origjinën nga Perëndia dhe erdhi prej Perëndisë. Qeniet njerëzore e shprehën atë; por ata shprehën thjesht atë që dëgjuan së pari të thotë Perëndia. Dhe për të garantuar se u përçuan saktësisht dëgjuesve të tyre atë që Perëndia foli, ata u drejtuan në ligjërimin e tyre prej Frymës së Shenjtë.

Kjo nuk do të thotë që për të garantuar këtë, Perëndia duhej të anashkalonte mendjen e profetit ose të ndrydhte personalitetin e tij. Po të njohësh mirë shkrimet e Profetëve Madhorë, p.sh. Isaia, Jeremia dhe Ezekieli, do të kuptosh se secili prej tyre pati stilin e tij të dallueshëm individual; por Perëndia, jo ata, ishte

autori i profecive që ata transmetuan.

Një muzikant i zoti që dëshiron të luajë një melodi që e ka kompozuar vetë, mund ta luajë atë në një piano apo violinë apo klarinetë. Në cilindo instrument që ai dëshiron ta luajë, vija melodike do të jetë e njëjtë. Nga ana tjetër, ai nuk ka pse dhe as nuk do të përpiqet të shtypë karakteristikat e dallueshme të instrumentit që ai zgjedh, por do t'i shfrytëzojë ato deri në maksimum. Sidoqoftë është fakt i pamohueshëm që instrumenti i zgjedhur as nuk kompozon, as nuk përzgjedh vijën melodike dhe as nuk merr iniciativën për ta luajtur atë: vetëm muzikanti i bën të gjitha ato.

Atëherë, në kuptimin e ngushtë të fjalës, nuk ishte Nathani autori i profecisë që i transmetoi Davidit: Perëndia qe; dhe ky fakt është theksuar dy herë në tekst:

Tani do t'i thuash kështu shërbëtorit tim David; Kështu thotë Zoti i ushtrive . . . (2 Sam 7:8)

Përveç kësaj Zoti të shpall se ka për të të ndërtuar një shtëpi... (2 Sam 7:11)

Duke qenë kështu, kur vlerësojmë kuptimin e plotë të deklaratave të ndryshme në profeci, do të jetë gabim kategorie të ngulësh këmbë që kuptimi i tyre të kufizohet vetëm tek ajo që Nathani kuptoi. Sa për atë që kuptoi Nathani, sigurisht që ajo sa kuptoi, ishte e vërtetë në vetvete: por ajo qe e kufizuar nga konteksti i saj i ngushtë dhe prej përshtypjeve të përgjithshme (ndonëse të vërteta) për të ardhmen që ai kishte patur prej profecive të tjera dhe prej kësaj të fundit. Por nuk ishte kështu me Perëndinë! Kur ai i foli Davidit përmes Nathanit, e gjithë historia botërore e ardhshme qe para syve të tij me gjithë hollësitë e saj (krh. Isa 42:9; 46:9-10), dhe sigurisht të gjitha detajet e dinastisë së ardhshme mbretërore të Davidit. Prandaj, atë që ai i tha Davidit e tha në dritën e asaj paranoje. Nuk duhet të na çudisë, pra, nëse rrjedhimet e asaj që Perëndia tha më vonë u kuptuan si diçka që shkonte përtej asaj që Nathani kishte kuptuar apo synonte të thoshte.

E ardhmja e dinastisë së Davidit siç u profetizua dhe çështja e kontekstit

Ne tani sa kemi filluar t'i përgjigjemi pyetjes së parë që menduam t'i drejtojmë shkrimtarit të Hebrenjve. Por kishte një të dytë: si mund ta justifikonte shkëputjen e kësaj thënieje - "Unë do të jem Atë dhe ai do të më jetë Bir" – jashtë kontekstit të saj dhe t'ia vishte Krishtit? Ne tani do të fillojmë t'i përgjigjemi kësaj pyetje të dytë duke hetuar të gjithë kontekstin në të cilin Perëndia e bëri këtë deklaratë. Pastaj mund të vendosim nëse shkrimtari i Hebrenjve e ka nxjerrë këtë deklaratë prej kontekstit të saj apo jo.

Gjëja e parë që duhet të na bëjë përshtypje, nëse e lexojmë të gjithë profecinë, është që ajo prek jo vetëm Davidin, apo vetëm pasardhësin e tij direkt, Salomonin, por të gjithë dinastinë mbretërore të ardhshme, dhe madje të përjetshme, të Davidit.

Shtëpia jote dhe mbretëria jote do të bëhen të qëndrueshme për gjithnjë para meje, dhe froni yt do të jetë i qëndrueshëm për gjithnjë (2 Sam 7:16)

Vetë Davidi e kuptoi këtë; sepse në lutjen e tij të mëpasme ai u shpreh:

O Zot, sepse ti ke folur edhe për shtëpinë e shërbëtorit tënd për një të ardhme të largët. (2 Sam 7:19)

Ne që jetojmë në një periudhë historike të mëvonshme e kuptojmë në retrospektivë atë çka Nathani, që i transmetoi këtë premtim Davidit në emër të Perëndisë, nuk mund ta dinte; domethënë që rreth 400 vjet pasi Perëndia bëri këtë premtim, perandori babilonas do të plaçkiste Jerusalemin, do të shkatërronte tempullin dhe do të ndërpriste përkohësisht dinastinë davidike. Pyetja urgjente tani nuk është "A e dinte Nathani këtë?", por "A e dinte Perëndia këtë në kohën kur ai po i bënte një premtim Davidit për një dinasti të përherëshme?"

Patjetër që Perëndia e dinte këtë; në të vërtetë në vetë profecinë, të shprehur përmes Nathanit, ai e paralajmëroi "farën" e Davidit që nëse bënte paudhësi, ai do ta ndëshkonte

atë me thupra njerëzish dhe me fshikuj të dhëna nga njerëzit (2 Sam 7:14), që ishte saktësisht gjuha që Perëndia përdori më vonë përmes profetit Isaia kur ai shpalli sulmin e afërt të asirianëve mbi Izraelin dhe pastaj mbi Judën (krh. Isa 10:5–15).

Duke qenë se këto gjëra qëndrojnë kështu, pyetja tjetër e pashmangshme është: "A e dinte Perëndia, kur po i bënte këtë premtim Davidit, se çfarë do t'i duhej në fund fare të bënte për të siguruar plotësimin e premtimit të tij për një dinasti të përherëshme të Davidit?"

Sërish përgjigja është: patjetër që Perëndia e dinte; ai e parapa mëkatshmërinë e vazhdueshme dhe degjenerimin e pasardhësve të Davidit; por ai gjithashtu pa që e vetmja mënyrë për të siguruar përmbushjen e premtimit për një dinasti të përherëshme për Davidin do të ishte lindja e Birit të Perëndisë në pasardhjen e Davidit. Dhe kështu ndodhi kur Gabrieli i shpalli më në fund Marisë:

Dhe ja, ti do të mbetesh shtatzënë dhe do të lindësh një djalë, dhe do t'ia vesh emrin Jezus. Ai do të jetë i madh dhe do të quhet Biri i Shumë të Lartit; dhe Zoti Perëndi do t'i japë fronin e Davidit, atit të tij; dhe do të mbretërojë mbi shtëpinë e Jakobit përjetë, dhe mbretëria e tij nuk do të ketë kurrë të sosur... prandaj i shenjtë që do të lindë prej teje do të quhet Bir i Perëndisë. (Luka 1:31–33, 35)

Gabrieli nuk po shpallte një skemë urgjence që Perëndia sapo e kishte menduar kur zbuloi, për çudinë e tij, dobësinë e mbretërve thjesht vdekatarë!

Në të vërtetë, shekuj para kësaj shpalljeje, Perëndia e kishte bërë publike zgjidhjen e këtij problemi:

Sepse na ka lindur një fëmijë, një djalë na është dhënë. Mbi supet e tij do të mbështetet perandoria dhe do të quhet Këshilltar i admirueshëm, Perëndi i fuqishëm, Atë i përjetshëm, Princ i paqes. Nuk do të ketë të sosur rritja e perandorisë së tij dhe paqja mbi fronin e Davidit dhe në mbretërinë e tij, për ta vendosur pa u tundur dhe për ta përforcuar me anë të mënçurisë dhe të drejtësisë, tani dhe përjetë. Këtë ka për të bërë zelli i Zotit të ushtrive. (Isa 9:6–7)

Prandaj të mendosh që, kur Perëndia bëri premtimin e tij për një shtëpi të përhershme të Davidit, nuk e pati akoma në mendje ardhjen përfundimtare të Birit të tij, do të ishte të besojë të pabesueshmen. Për atë që takon Perëndisë, premtimi i tij për Davidin përmes Nathanit kërkonte, dhe për këtë arsye nënkuptonte, dërgimin përfundimtar të Birit të tij. Dhe kjo do të thotë që shkrimtari i Hebrejve, duke cituar një deklaratë prej kësaj profecie dhe duke e aplikuar atë për Birin e Perëndisë, së paku nuk është duke e nxjerrë totalisht jashtë kontekstit të saj fillestar të synuar prej së larti, sado pak që Nathani të mund ta kishte kuptuar domethënien e profecisë.

Por tani ne duhet të konsiderojmë një dimension tjetër për interpretimin që Dhiata e Re i bën së Vjetrës ndërsa fillojmë t'i përgjigjemi pyetjes tonë të tretë.

Epërsia, bindja, profecia origjinale dhe çështja e kuptimit të dyfishtë

Epërsia e retrospektivës

Shkruesit e Dhiatës së Re kishin një epërsi të dallueshme në krahasim me Nathanin dhe me të gjithë profetët e tjerë të Dhiatës së Vjetër: ata jetuan pas ringjalljes dhe lartësimit të Zotit Jezus. Edhe gjatë jetës së tij mbi dhë, dishepujt e tij e kishin rrëfyer atë si Mesian, Birin e Perëndisë së gjallë (Mat 16:16) dhe për këtë arsye edhe Birin e Davidit (Mat 20:30). Por që ringjallja e tij që e vulosi këtë çështje për ta dhe i bëri ata edhe më të ndërgjegjshëm për domethënien e plotë të termit “Biri i Perëndisë” si aplikohet tani për Zotin Jezus (shih Rom 1:3–4). Ata tani shihnin pas te profecitë dhe historitë e Dhiatës së Vjetër nga këndvështrimi i dëshmisë së tyre okulare të përmbushjeve madhore të këtyre profecive dhe historive. Në këtë dritë ishte e pashmangshme që ata të dallonin që kuptimi i synuar dhe shtrirja e profecive të Perëndisë në Dhiatën e Vjetër, shpesh ishte shumë më e gjerë sesa shumë njerëz e kishin kuptuar këtë në kohën e tyre.

Tashmë në ditën e Rrëshajëve Pjetri, për shembull, po argumentonte që fjalët e Davidit, “ti nuk do të lejosh që i Shenjti yt të shohë kalbjen” (shih Ps 16:8–11), nuk mund t'i referoheshin

vetë Davidit, përderisa trupi i vdekur dhe varri i tij qenë ende në Jerusalem në kohën e Pjetrit, dhjetë shekuj pas vdekjes së Davidit. Në mënyrë të pakundërshtueshme, vetë Davidi e kishte parë kalbjen. Por Davidi, sipas argumentimit të Pjetrit, që një profet. Gjithashtu ai e dinte që Zoti i kishte bërë një betim se, nga fryti i ijëve të tij, ai do të caktonte dikë mbi fronin e tij (Ps 132:11). Pjetri arriti në përfundimin që kur Davidi u shpreh me këto fjalë, “ti nuk do të lejosh që i Shenjti yt të shohë kalbjen”, ai po parathoshte me profeci ringjalljen e birit të tij, Mesias (Veprat 2:25–31).

Po ashtu Jakobi, në kuvendin e apostujve dhe pleqve në Jerusalem (Veprat 15:13–18), kur dëgjoi për numrin e pakrahasueshëm të johebrejve që ishin kthyer në besimin e Mesias, Birit të Davidit, pa në këtë ngjarje të jashtëzakonshme përmbushjen e premtimit të Perëndisë përmes profetit Amos: “Atë ditë do të ngre përsëri tabernakullin e Davidit [d.m.th, shtëpinë mbretërore të Davidit] që ka rënë (Amos 9:11–12).

Me të njëjtën retrospektivë, autori i Hebrejve do të ketë studiuar premtimin e Perëndisë për Davidin përmes Nathanit në lidhje me mbarëvajtjen e dinastisë së tij mbretërore.

Por tani duhet të marrim në konsideratë një mënyrë tjetër sesi Dhiata e Re interpreton të Vjetrën.

Bindja që Dhiata e Vjetër është fjala e gjallë e Perëndisë

Kjo është mënyra si shkrimtarët e Dhiatës së Re vlerësojnë Dhiatën e Vjetër. Shkruesi i Hebrejve, p.sh., mbasi citoi Psalmin 95:7–11 dhe e komentoi gjerësisht, vëzhgon: “fjala e Perëndisë është e gjallë dhe vepruese, më e mprehtë se çdo shpatë me dy tehe ...” (Heb 4:12). Për të, dhe për të gjithë shkrimtarët e tjerë të Dhiatës së Re, Dhiata e Vjetër nuk ishte thjesht një kronikë e gjërave të shkuara dhe të mbaruara, e deklaratave hyjnore të bëra shekuj më parë që tani janë të vdekura dhe të padobishme për ne. Kur ata lexonin shkrimet, besonin që ishte Perëndia i gjallë që po u fliste në të vërtetë atyre dhe që dëshironte që ata të dinin çfarë kishte bërë dhe u kishte thënë ai të tjerëve në kohët e shkuara. Dhe kështu, të gjithë të krishterët e vërtetë duhet ta lexojnë ende Dhiatën e Vjetër me bindjen që nëse Perëndia do të

hapte qiejt dhe do të na fliste direkt, ai ende do të na thoshte atë që thotë në Dhiatën e Vjetër dhe të Re.

Atëherë kjo do të thotë se ndërsa shkrimtari i Hebrenjve lexonte profecinë e Nathanit, ai do ta lexonte sikur po dëgjonte zërin e Perëndisë së gjallë që i fliste atij (shkruesit të Hebrenjve), dhe i kërkonte të dëgjonte atë që ai po i thoshte Davidit për mirëmbajtjen e dinastisë së Davidit dhe gjërave që ai duhet të bënte për këtë qëllim.

Mendoni pak për dinamikat e kësaj situatë. Perëndia po ritregonte atë që ai i kishte thënë Davidit për mirëmbajtjen e dinastisë së tij përmes birit të Davidit, Salomonit, dhe që e kishte thënë duke ditur plotësisht çfarë do bënte një ditë përmes birit të Davidit, Jezus Krishtit. Të gjithë këtë po e përsëriste për dobinë e shkruesit të Hebrenjve që tashmë e dinte se çfarë Perëndia kishte bërë kohët e fundit përmes birit të Davidit që ishte gjithashtu edhe Biri i Perëndisë.

Një situatë e ngjashme gjendet te Galatasve 3:8 “Dhe Shkrimi, duke parashikuar se Perëndia do t’i shfajësonte kombet me anë të besimit, ia dha më përpara Abrahamit lajmin e mirë: Të gjitha kombet do të bekohen në ty”. Ky citat është marrë prej vetë fjalëve të Perëndisë drejtuar Abrahamit (Zan 12:3). Nuk është e thënë se në atë kohë, Abrahami do ta kishte kuptuar që ky bekim do të përfshinte shfajësimin e johebrejve me anë të besimit si vetë Abrahami. Por kur Pali lexoi Zanafillën 12:3, ishte e qartë për të që, edhe kur Perëndia po i fliste Abrahamit për bekimin e johebrejve përmes tij, Perëndia tashmë kishte paraparë që johebrejtë do të shfajësoheshin përmes besimit siç ndodhi me Abrahamin; dhe për këtë arsye, ky bekim i veçantë u përfshi dhe që nënkuptuar prej premtimit të Perëndisë.¹ Një analogji e thjeshtë (jo e përsosur) mund të na ndihmojë të kuptojmë dinamikën e situatave si kjo. Një vajzë e vogël katër vjeçe futet në zyrën e babait dhe i thotë në mënyrë feminare: “Mami tha që teze Matilda do të vijë nesër dhe do të rrijë me ne për një muaj.” Edhe pse e vogël, vajza ka mjaft vite për të kuptuar çdo fjalë në fjali, dhe përdor çdo fuqi mendore të saj

¹ Frazë “shkrimi kishte parashikuar” do të thotë të thuash me fjalë të tjera që “Perëndia kishte parashikuar”.

për t’i thënë babait të njëjtat fjalë që mamaja i pati thënë. Por mamaja e di që babai do të nënkuptonte më shumë se e bija e saj e vogël në përmbajtjen e mesazhit. Sepse qoftë mami apo babi e dinë se çfarë karakteri ka teze Matilda dhe prirjen e saj për t’u prishur harmoninë familjare përmes sjelljes së saj eksentrike dhe kërkesave të paarsyeshme!

Kështu Perëndia e dinte që, kur përmes Shkrimit ai përsëriste për dobinë e shkruesit të Hebrenjve atë çfarë profetizoi fillimisht për Davidin përmes Nathanit, shkruesi i Hebrenjve do të nënkuptonte më shumë nga përmbajtja e profecisë sesa kuptoi Nathani apo Davidi ndonjëherë.

Tri pika të dukshme dhe thelbësore në profecinë origjinale

Ndërsa shkruesi i letrës së Hebrenjve dëgjoi profecinë e Nathanit, ai do të kishte dalluar tri pika të dukshme.

Premtimi i Perëndisë për ta bërë dinastinë e Davidit të përhershme

Nuk do të ishte vështirë për ta kuptuar apo besuar këtë; as nuk ishte e nevojshme që ai të shpikte ndonjë tipologji apo të përdorte alegori për ta interpretuar këtë. Jezus Krishti që realisht dhe fizikisht ‘nga shtëpia dhe fisi i Davidit’ (Luka 1:27; Rom 1:3; 2 Tim 2:8). Tani Perëndia e kishte bërë atë edhe Zot edhe Krisht. Ai ishte ngjallur prej së vdekurish, dhe që i gjallë “në bazë të fuqisë të jetës së pashkatërrueshme” (Heb 7:16; Rev 1:18). Premtimi i Perëndisë i bërë Davidit që i siguroi kështu përjetësisht.

Programi i Perëndisë për të ndërtuar një shtëpi në emrin e tij

Sugjerimi i Davidit që të kishte leje për ta ndërtuar nuk u pranua. Programi i Perëndisë që:

1. Zoti do t’i ndërtonte Davidit një shtëpi (d.m.th dinasti).
2. Por djali i Davidit, që ende nuk kishte lindur, jo Davidi, do të ndërtonte shtëpinë e Zotit.

Autori i letrës së Hebrenjve ndoshta ka buzëqeshur kur

dëgjoi që Perëndia deklaroi se ky ishte qëllimi i tij. Sigurisht që biri i Davidit, Salomoni, do të ndërtonte shtëpinë e Zotit në Jerusalem. Por pavarësisht vlerës së vet, ajo mbetej një shtëpi tokësore dhe fizike. Në kohën e Dhiatës së Re ajo ishte shkatërruar qysh kohë më parë. Shtëpia pasuese që u ndërtua nën Ezrën ishte çmontuar. Shtëpia aktuale atëherë, e ngritur prej Herodit, qe destinuar të shkatërrohej shumë shpejt (ashtu ndodhi në fakt në 70 pas Krishtit). Por biri i Davidit, Jezus Krishti, tashmë ishte duke e përmbushur detyrën e tij të dhënë nga Perëndia për t'i ndërtuar Atij një shtëpi të përjetshme dhe frymërore, të përbërë prej popullit të Perëndisë si familja e Perëndisë dhe si tempulli apo banesa e Perëndisë (Mat 16:18; Heb 3:1–6; 10:21; Ef 2:15–22).

Askush nuk duhet të mendojë atëherë që dëshira e Perëndisë për t'i ndërtuar një shtëpi në emrin e tij u kënaq plotësisht përmes tempullit fizik të Salomonit; dhe që pas kësaj ishte qëllimi i Perëndisë ta braktiste projektin e tij për një Tempull. Historia na ka treguar që shtëpia e ndërtuar prej Salomonit për Perëndinë ishte, në mendjen e Perëndisë, vetëm shtëpia e parë në vargun e shtëpive të planifikuara, e që e fundit do të ishte shtëpia e ndërtuar prej birit të Davidit, Jezus Krishtit. Duke autorizuar Salomonin të ndërtonte një shtëpi fizike, është e qartë se Perëndia kështu po krijonte një prototip të dukshëm të shtëpisë së përjetshme që do të ndërtohej prej Krishtit.

Shpallja e Perëndisë për një marrëdhënie të veçantë me birin e Davidit

Që të ndërtonte shtëpinë e tij përmes njërit prej bijve të Davidit, Perëndia duhet të garantonte se Davidi do të kishte pasardhës, të afërt dhe të largët. Dhe për të garantuar këtë në pikën e saj më kritike, Perëndia shpalli që ai do të adoptonte një marrëdhënie të veçantë Atë-bir me Salomonin.

Pika e parë e dobët e kësaj pasardhje u shfaq menjëherë pas vdekjes së Davidit, siç Perëndia i kishte parathënë Davidit (2 Sam 7:15). Sauli, paraardhësi i Davidit në fron, u zgjodh dhe u vajos prej Perëndisë (1 Sam 9:1–10:1); por për shkak të mosnënshtrimi të tij serioz dhe rebelimit të tij të hapur, atij iu tha që përfundimisht dinastia e tij nuk do të vazhdonte (1 Sam

13:13–14; 15:26–29). Kur vdiq, ai u zëvendësua në fron prej birit të tij, Ishboshethit; por pas disa vitesh Ishboshethi u vra (2 Sam 4) dhe dinastia e Saulit ra për të mos u ngritur më.

Një gjë e tillë nuk do t'i ndodhte ndonjëherë, tha Perëndia, dinastisë së Davidit. Nëse Salomoni – apo ndonjë mbret tjetër mes pasardhësve të tij – do të sillej keq, Perëndia do t'i ndëshkonte ata; por marrëdhënia e veçantë atë-bir që ai adoptoi me pasardhjen e Davidit (2 Sam 7:12–15; vini re termin shumëkuptimor, 'farë') do të siguronte që pasardhja mbretërore e Davidit, sado që të ndëshkohej rëndë, nuk do të anulohet asnjëherë plotësisht dhe përfundimisht.

Tani më në fund mbërritëm aty ku e filluam, te premtimi origjinal i Perëndisë në lidhje me Salomonin: "Unë do të jem një atë për të dhe ai do të jetë im bir"; sërish do të ngremë pyetjen tonë përfundimtare. Si mundej autori i letrës së Hebrenjve të justifikonte marrjen e kësaj marrëdhënie Atë-bir midis Perëndisë dhe Salomonit, dhe pjesës tjetër të pasardhësve të Davidit, dhe ta aplikonte në një marrëdhënie shumë herë më të lartë Atë – Bir, mes Perëndisë dhe Birit të Perëndisë?

Ka dy përgjigje të qarta për këtë:

1. Në atë nivel të thjeshtë në të cilin Salomoni, dhe gjithë pjesa tjetër e pasardhësve mbretërorë të Davidit, gëzonte një marrëdhënie atë-bir me Perëndinë, në po atë nivel edhe biri i Marisë, duke qenë një pasardhës mbretëror i Davidit, kishte të drejtë të pohonte të njëjtën gjë.
2. Por ashtu si shtëpia që i biri i Davidit, Salomoni, ndërtoi për Perëndinë, ishte një prototip që tregonte drejt shtëpisë shumë më superiore që biri i Davidit, Jezusi, do të ndërtonte për Perëndinë një ditë, po ashtu edhe marrëdhënia atë-bir që Perëndia adoptoi me Salomonin, ishte një tregues i caktuar në mënyrë hyjnore për marrëdhënien unike mes Atit dhe Birit, të cilën biri i Davidit, Jezus Krishti, Zoti ynë, mban gjallë përjetësisht. Është në fakt kjo marrëdhënie unike që ka siguruar dhe do të garantojë përjetësisht, premtimin e vazhdimësisë së përhershme të bërë Davidit përmes Nathanit.

Në perspektivë

Tani, Dhiata e Re pohon që ka shumë prototipe të tillë të caktuar në mënyrë hyjnore në Dhiatën e Vjetër; dhe do na duhet që në fund të bëjmë pyetjen se cili është qëllimi dhe arsyeja e ekzistencës së këtyre prototipeve. Por, megjithatë, ka edhe shumë mjete të tjera interpretative që Dhiata e Re përdor për të aplikuar thesaret e Dhiatës së Vjetër për përfitimin tonë shpirtëror. Prandaj, është koha që të përmbledhim përfundimet tona dhe të shqyrtojmë pyetjet e mëtejshme që kanë kapur vëmendjen tonë ndërsa largohemi prej studimeve hyrëse dhe fillojmë të shqyrtojmë këto mjete me hollësi.

...

Pyetjet e studimit për këtë kapitull mund t'i gjeni
në faqen 433.

5

Përfundime dhe çështjet e ngritura

Ashtu si e kemi menduar, dy gjëra tani janë të dukshme. Me autoritetin e vetë Dhiatës së Re:

1. *Dhiata e Vjetër është e vlefshme në vetvete.* Ajo u frymëzua fillimisht prej Perëndisë. Jo vetëm një pjesë e saj, por në tërësi. Dhe ende është e tillë. Nuk pushoi së qeni e tillë me ardhjen e Dhiatës së Re. Perëndia, që ua shprehu atë fillimisht etërve përmes profetëve, ende u flet përmes saj atyre që janë të gatshëm të dëgjojnë.
2. *Dhiata e Vjetër është e dobishme, jo vetëm në një pjesë të saj, por në të gjitha pjesët.* “Sepse të gjitha gjërat që u shkruan në të kaluarën” këmbëngul Dhiata e Re tek Rom 15:4 “u shkruan për mësimin tonë, që me anë të këmbënguljes dhe të ngushëllimit të Shkrimeve, të kemi shpresë.”

Historia i mbështet këto pohime

Pohimi i bërë për dobishmërinë e përhershme është i vërtetuar nga përvoja e popullit të Perëndisë. Gjatë gjithë shekujve, të krishterët kanë marrë nxitje të pafundme prej Dhiatës së Vjetër. Profecitë e hollësishme mesianike kanë konfirmuar besimin e tyre që Jezusi është Krishti, Shpëtimtari i botës. Sakrifikat levetikase kanë shërbyer si tipe për të ndihmuar të kuptojnë

vdekjen shlyese të Krishtit. Dhe pavarësisht dhimbjeve normale të jetës, dhe përballë përndjekjes, këmbëngulja e të krishterëve është forcuar fuqimisht prej përshkrimeve të Dhiatës së Vjetër të lavdive që do të jenë në “kohën e ripërtëritjes të të gjitha gjërave, për të cilën Perëndia ka folur nëpërmjet gojës së gjithë profetëve të tij të shenjtë.” (Veprat 3:21).

Të krishterët kanë ndjerë gjithashtu (ndoshta jo aq shpesh sa duhet) forcën e denoncimeve profetike kundër korrupsionit fetar, tregtar, shoqëror dhe politik. Për më tepër, në punët praktike të jetës së përditshme, ata janë drejtuar prej aforizmave të sakta të Fjalëve të urta, kanë mësuar për shenjtërinë dhe gëzimet e dashurisë martesore përmes Këngës së Këngëve dhe janë kthjelluar prej shtjellimit që i bën Predikuesi boshllëkut të jetës nën diell pa Perëndinë.

Kurse bëmat e heronjve të besimit të Dhiatës së Vjetër kanë nxitur kurajon e tyre. Dhe kur vuajtje, sëmundje apo vdekje të rënda, apo tragjedi të mëdha i kanë futur mendjet e tyre ndonjëherë në dyshime të errëta për dashurinë dhe drejtësinë e Perëndisë, tregimi i Jobit i ka ngushëlluar. Ata nuk qenqeshin të vetmit që u kanë kaluar nëpër mend mendime të errëta për Perëndinë: edhe Jobit i ndodhi kjo; dhe në fund Perëndia e shfaqësoi atë dhe jo perëndishmërinë false të miqve të tij të ashtuquajtur, dhe hoqi dyshimet e tij.

Vështirësitë mbeten

E thënë kjo, ngelet e pamohueshme që ka fusha të vështira në Dhiatën e Vjetër, madje edhe në rrëfimet e saj historike që në sipërfaqe duken të thjeshta. Kjo është sidomos e vërtetë në pasazhe për të cilat Dhiata e Re nuk bën ndonjë koment specifik. Le të marrim si shembull sjelljen e Davidit si mbret. Së pari, Samueli dokumenton refuzimin e Perëndisë të mbretit Saul sepse nuk iu bind dy herë urdhërave të Perëndisë. Pastaj aty deklarohet që Davidi ishte “një njeri sipas zemrës së Perëndisë” (1 Sam 13:14), flitet për mënyrën shembullore si e trajton Saulin dhe për refuzimin e tij për të marrë hak. Së dyti, Samueli përcjell pranimin e tij si mbret nga të 12 fiset, konsolidimin e tij në fuqi dhe besëlidhjen e përvetshme të Perëndisë me të dhe shtëpinë e

tij mbretërore (2 Sam 7).

Me këtë fillim të mbarë, së bashku me konfirmimin e Dhiatës së Re për mbretin David si “njeri sipas zemrës së Perëndisë” (Veprat 13:22), ne mund të prisnim që kronikat e mbretërimit të tij aktual të ishin të spërkatura me akte politike të frymëzuara nga një dituri e dhënë prej Perëndisë. Përkundrazi, edhe një lexim i përciptë sugjeron që gjatë gjithë sundimit të tij, Davidi që i varur jashtëzakonisht prej kryekomandantit të tij mizor të ushtrisë dhe i pafuqishëm qoftë për ta kontrolluar apo korrigjuar atë.¹ Si mund, atëherë, ta interpretojmë rrëfimin e 2 Samuelit për sundimin e Davidit?

Për më tepër, nuk janë vetëm rrëfimet e Dhiatës së Vjetër, për të cilat Dhiata e Re nuk bën asnjë koment, që ngrenë pengesa në kuptimin e tyre; disa herë ato dalin edhe në pasazhe që Dhiata e Re komenton. Sakrifika e Isakut nga Abrahami është një shembull i njohur (Zan 22).

Në fillim të saj ngrihet një problem moral: pse Perëndia e urdhëron Abrahamin të bëjë diçka që më vonë Perëndia vetë do ta ndalojë kategorikisht dhe e shpall si një gjë të neveritshme për të?² Kritikë dashakeqës duan që ta zmadhojnë këtë si problem. Çfarë përgjigje duhet t’u japim atyre pastaj? Dhiata e Re nuk bën asnjë koment për këtë.

Filozofi danez Søren Kierkegaard sugjeroi që, një bindje e përkushtuar ndaj Perëndisë kërkon që ne të lëmë mënjane ligjin moralin dhe etik “Nuk do të vrasësh”, përderisa ligdhënësi hyjnor vetë tejkalon parimet racionale edhe madje etike.³ Por sigurisht, ky sugjerim nuk mund të jetë i saktë: nëse adoptohet, do të çojë në një moçal subjektiv. Njerëzit shpesh kanë justifikuar krime të tmerrshme thjesht mbi baza se besuan që Perëndia u

1 Joabi vrau Abnerin; Davidi e dënoi këtë publikisht, por rrëfeu se ishte i pafuqishëm vetë të bënte ndonjë gjë për këtë (2 Sam 3:26–29). Joabi e nxiti të kthente pas Absalomin vëlla-vrasës dhe ta falte atë. Pasoja që shkatërrimtare (2 Sam 14 e në vazhdim.). Kundër udhëzimeve specifike të Davidit, Joabi e vrau Absalomin (2 Sam 18:5–17). Pas kësaj Davidi e shkarkoi Joabin dhe caktoi Amasan në vend të tij. Joabi e vrau Amasan dhe duke e sfiduar Davidin qëndroi si kryekomandant (2 Sam 19:11–13; 20:4–12). E vetmja herë e regjistruar që Davidi fitoi mbi Joabin ishte kur, edhe pse Joabi kundërshtoi, ai numëroi popullin – me pasoja shkatërrimtare (2 Sam 24:1–17).

2 Krhs. LiP 18:10; 2 Mbret 16:3; 2 Kron 28:3; Mik 6:7.

3 Frikë dhe Dridhje

tha atyre t’i bënin ato.

A është e duhur të themi se Perëndia kurrë nuk donte që Abrahami të sakrifikonte Isakun: vetëm sa bëri gjoja? Por nëse ai shtiret? Çfarë do të thotë kjo për karakterin e Perëndisë?

Komenti i Dhiatës së Re për këtë rast është që, duke ofruar birin e tij, Isakun, mbi altar, Abrahami u justifikua përmes veprave të tij, dhe prandaj u bë një shembull për të gjithë ne. Sepse Perëndia pret që të gjithë besimtarët të provojnë rrëfimin e tyre të besimit përmes veprave të tyre (Jak 2:20–22).

Nga ana tjetër, një traditë e vjetër e krishterë e quan ofrimin e Abrahamit të birit të tij ndaj Perëndisë mbi altar si një lloj hijeje e ofrimit të Perëndisë të Birit të tij për ne mbi kryq.⁴ Por, dikush mund të pyesë, si lidhet e gjitha kjo me shfajësimin përmes veprave?

E gjithë kjo ngre pyetje të rëndësishme që do të na sjellin tek Pjesa 2 e studimit tonë.

Tri pyetjet e ngritura

Si mund të interpretojmë rrëfimet e vështira si ajo e mbretërimit të Davidit?

A mjafton vetëm të përcaktojmë gjuhësisht sa më saktë që të jetë e mundur se çfarë po thotë teksti, dhe pastaj të lëmë çdo lexues të vendosë për veten e vet se çfarë do të thotë? Dhe kur të kemi vendosur se çfarë do të thoshte kjo ngjarje për bashkëkohësit e saj, dhe se çfarë do të thoshte për ata që e lexuan regjistrimin e parë të saj, a kemi të drejtë të presim një mesazh prej saj ne që e lexojmë atë tani? Apo duhet ta vlerësojmë thjesht si një fakt historik, një orendi artistike në muze si të thuash, dhe të quajmë çdo përpjekje për të marrë një kuptim për veten thjesht një shprehje e reagimit tonë subjektiv, i preferencave tona dhe mospëlqimeve tona, të përcaktuara nga seti ynë i vlerave morale?

4 Një mbrojtje e fortë, me nuanca dhe e argumentuar mirë, e kësaj pikëpamje është Wenham, *Genesis*, 2:117.

A mundet një rrëfim i vetëm të ketë një kuptim të vlefshëm në më shumë se një nivel?

Duke qenë se kemi një shumëllojshmëri interpretimesh për një pasazh si ai i sakrificës së Isakut nga Abrahami, a duhet të mendojmë që vetëm një nga interpretimet e preferuara tona është ai që Fryma e Shenjtë dëshironte të thoshte? Apo ne mund të mendojmë – pa rënë në relativizmin post-modern – që ndonjëherë një rrëfim i vetëm mund të ketë më shumë kuptime sesa në një nivel?

Cilat janë parimet hermeneutike të vlefshme që duhet të kontrollojnë interpretimet tona?

Duam që të jemi të sigurt se nuk krijojmë kuptimin tonë prej rrëfimeve të Dhiatës së Vjetër. Nga ana tjetër, ne duam të dimë gjithçka që vetë Dhiata e Vjetër do që ne të dimë. Çfarë parimesh duhet të na drejtojnë në këtë dilemë? Ku të gjejmë udhëzime?

Nxjerrja e udhëzimeve prej praktikës së Dhiatës së Re

Duhet të jemi të ndershëm për të pranuar që disa herë do të hasim vështirësi, si edhe momente të lumtura, kur interpretojmë seri të gjata rrëfimesh të Dhiatës së Vjetër për të cilat Dhiata e Re nuk bën ndonjë koment apo i komenton ato pjesërisht. Por nuk duhet të dorëzohemi. Dhiata e Re ende mund të na japë udhëzime të dobishme nëse studiojmë praktikën e saj të hollësishme për gjërat që komenton.

Prandaj në Pjesën e Parë, ne kemi inspektuar lidhjen e saj të përgjithshme me Dhiatën e Vjetër; dhe kjo ka qenë relativisht një gjë e thjeshtë. Gjë që mund të përmbledhet në sloganin e bukur të Agustinit: “E Reja është e fshehur tek e Vjetra, e Vjetra zbulohet tek e Reja.” Apo për ta thënë me fjalë të tjera të arsyeshme: Dhiata e Vjetër qe premtim, E Reja është përmbushje e tyre; E Vjetra është fusha e mbjellë, E Reja është fusha në lulëzim të plotë.

Por tjetër është lidhja e përgjithshme e Dhiatës së Re me të

Vjetrën dhe tjetër është shtjellimi i detajuar i Dhiatës së Vjetër; dhe këtë do të studiojmë në Pjesën e Dytë. Ne do të shohim që praktika e saj interpretative është tejet e shumëllojshme për t’u përmbledhur në një apo dy fraza të shkurtra. Urtësia e Perëndisë, thotë Pali, është e shumanëshme (Efes 3:10). Nuk duhet të na çudisë fakti që interpretimi i Dhiatës së Vjetër nga Dhiata e Re të jetë po ashtu i shumanshëm. Kjo nuk duhet të na dekurajojë. Sa më i shumanshëm të jetë, aq më shumë do të gëzohemi në pasurinë e Dhiatës së Vjetër që ajo gërmon.

Ne do të studiojmë kategoritë interpretative të Dhiatës së Re në radhë të parë për hatër të tyre, përderisa ato janë një pjesë përbërëse e Fjalës së Perëndisë. Por duke bërë kështu, do të gjejmë udhëzime që ne vetë mund t’i ndjekim më pas në interpretimin tonë të Dhiatës së Vjetër.

PJESA E DYTË

**Kategori konceptesh të Dhiatës së Re
për të interpretuar Dhiatën e Vjetër**

KATEGORIA E PARË

Perspektiva profetike

6

Interpretimi i profecisë së Dhiatës së Vjetër nga Krishti

Përgjatë shërbesës së tij tokësore Zoti ynë citoi shpesh Dhiatën e Vjetër, dhe disa prej këtyre citimeve të tij shkrimore do t'i kushtojmë vëmendje në kohën e duhur. Por për të filluar, ne zgjedhim të përqendrohemi te pohimi i tij që Dhiata e Vjetër parashikoi dy ardhje të Mesias dhe jo thjesht një. Ne e bëjmë këtë sepse ky interpretim është thelbësor për pohimin e tij se është Mesia i Dhiatës së Vjetër i premtuar nga Perëndia; dhe së dyti, sepse është thelbësore për besimin tonë në ungjillin e krishterë (shih 1 Kor 15:3–4, 20–23; Zbul 1:7) dhe për këtë arsye është po aq thelbësore për mënyrën e duhur të të kuptuarit të profecisë së Dhiatës së Vjetër dhe për dëshminë tonë në botë, qofshim hebrenj ose paganë.

Pohimi i vetë Krishtit

Dhiata e Vjetër tha që Mesia do të hynte në Jerusalem si Mbreti i Sionit, i përlurur dhe duke ngarë një gomar (Zak 9:9). Ajo gjithashtu parashikoi që Biri i Njeriut do të vijë me retë e qiellit (Dan 7:11–14). Tani, logjika e thjeshtë mund të diktonte se përshkrimi “i përlurur dhe i hipur mbi një gomar” dhe përshkrimi “mbi retë e qiellit”, nuk mund të bënin fjalë për të njëjtën ardhje. Por Dhiata e Vjetër nuk tha asgjëkundi shprehimisht se do të

kishte dy ardhje të Mesias. Ishte Krishti vetë që e interpretoi Dhiatën e Vjetër kështu. Gjatë vizitës së tij të fundit në publik në Jerusalem (Mat 21:1–11), ai qëllimisht siguroi një gomar dhe hyri në qytet duke e ngarë nën thirrjet e turmave si Mbreti i Sionit. Në këtë mënyrë ai interpretoi profecinë e Zakarias për mbretin që po vinte si diçka që i referohej ardhjes së tij të parë.

Një javë më vonë ai qëndroi i akuzuar para Sinedrit. Kryepriifti i kërkoi me betim që t'i tregonte trupit gjykues nëse ai ishte Krishti, Biri i Perëndisë (Mat 26:63–64). Duhet të ketë qenë e kuptueshme për të gjithë ata që ishin të pranishëm në gjyq, siç ishte edhe për të, se nëse thoshte se ai qe, do të dënohej me vdekje. Si përgjigje, ai aludoi duke cituar dy Shkrime të Dhiatës së Vjetër që parathoshin se çfarë do t'i ndodhë atij pasi ta vrisnin. Njëra, Ps. 110:1, parathoshte fronëzimin e tij në të djathtën e Perëndisë; tjetra, Dan 7:11–14, parathoshte ardhjen e tij të dytë.

Biri i kujt? Aludimi i Krishtit për Psalmin 110:1

Nuk ishte kjo hera e parë që Zoti ynë iu referua Psalmit 110:1. Një apo dy ditë para gjykimit të tij, ai kishte cituar të gjithë vargun në një diskutim publik me farisenjtë (Mat 22:41–46), dhe kishte theksuar që vargu nënkuptonte një Mesia më shumë sesa njerëzor. “Çu duket juve,” pyeti ai, “për Krishtin (pavarësisht se kush mendonin se ishte): Biri i kujt është?” Ata i thanë: “I Davidit”; dhe pjesërisht kjo ishte e vërtetë. Por nuk mund të ishte e gjithë e vërteta, kundërshtoi Krishti; sepse Davidi duke folur i frymëzuar prej Frymës, e quajti Mesian Zot. Pas kësaj Krishti citoi të gjithë vargun: “‘Zoti [Yahweh] i ka thënë Zotit tim [të Davidit]: Ulu në të djathtën time, deri sa unë të vë armiqtë e tu si stol të këmbëve të tua’”.

Nëse Davidi e quajti atë “Zot”, si mund të ishte thjesht biri i Davidit? Davidi kurrë, ndërsa ishte ende mbret, nuk do ta quante një nga djemtë e tij “Zoti im”. Prandaj nëse Mesia nuk ishte thjesht një bir i Davidit, Biri i kujt duhet të ishte, përveçse Bir i Perëndisë?¹

¹ Duhet të vëmë re këtu për hatër të një citimi të ardhshëm, që po të flasim ngushtë, Zoti ynë qe duke interpretuar jo vetëm çfarë po thoshte psalmi haptas por edhe domethënien e asaj që po pohonte.

Tërthorazi ai i kishte paraprirë kërkesës së kryepriut për t'i thënë trupit gjykues nëse ai ishte "Krishti, Biri i Perëndisë". E vetmja gjë që mund të ishte në dyshim në këtë moment ishte nëse ai do të shkonte edhe më tej me deklaratat e tij duke i bërë publike në gjyq në kurriz të vetë jetës së tij, që ai vetë ishte Krishti, Biri i Perëndisë. Përgjigja e tij e sqaroi këtë çështje përtej çdo dyshimi: "Po, është ashtu si thua ti" (Mat 26:64 *versioni anglisht NIV* e përkthen kështu)². Disa kanë menduar që kjo përgjigje është një "po" e zbehur dhe se duhet kuptuar si: "Ti shprehesh kështu, por unë do ta thosha ndryshe." Por pasazhi i njëjtë te Marku ka një po "Unë jam" të qartë (Marku 14:62). Vetë te Mateu në një kontekst të ngjashëm (Mat 26:25), Krishti përdor të njëjtën frazë në greqisht në përgjigje ndaj pyetjes së Judës: Rabi, mos jam unë ai? Versioni anglisht NIV e parafrazon saktësisht përgjigjen e Krishtit: "Po, ti je."

Përderisa dënimi me vdekje i gjyqit që një çështje e mbyllur, Krishti citoi më gjatë atë që Dhiata e Vjetër parashikonte se do të ndodhte me të pasi ta kishin vrarë, d.m.th. fronëzimin e tij në të djathtën e Perëndisë. Jo vetëm kaq, por ai e informoi Sinedrin se që nga ai çast ata "do të shihnin" (me shumë mundësi në kuptimin "do ishin të ndërgjegjshëm", "do të dallonin se që kështu", ndoshta një ditë "realisht do të shihnin") Birin e Njeriut të ulur në të djathtën e Perëndisë, dhe do të ishte e dukshme në mënyrë demonstrative që Krishti është Biri i Perëndisë.

Zotinyë po aludonte për Psalmin 110:1 dhe ftesën e Perëndisë për Krishtin, Birin e Perëndisë për t'u ulur në të djathtën e Perëndisë. Por meqë në një bisedë të hershme me farisenjtë ai e kishte interpretuar jo vetëm atë që psalmi e thoshte shkoqur, por edhe pasojën e asaj që nënkuptonte, ne mund të theksojmë një pasojë tjetër të tij. Vetë ftesa për të ardhur dhe për t'u ulur në të djathtën e Perëndisë nënkuptonte që do të kishte një kohë kur, ai që ishte Biri i Perëndisë, por gjithashtu edhe Bir i Davidit, nuk ka qenë i ulur aty. Me fjalë të tjera kjo nënkupton mishërimin, jetën dhe shërbesën mbi tokë, vdekjen, ringjalljen dhe më pas, ngjarjen e lavdishme që do të shënonte fundin e ardhjes së tij të parë, d.m.th. lartësimin dhe fronëzimin e tij. Për më tepër, Psalmi

2 Versioni greqisht përkthehet si në gjuhën shqipe: "Ti po [e]thua!"

110:1 paratha gjithashtu – dhe këtë herë haptazi – që do të vinte dita kur Perëndia do të vendoste poshtë këmbëve të Krishtit të gjithë armiqtë e tij. Kjo është pikërisht ngjarja që përshkruhet në vizionin profetik të Danielit për ardhjen e Birit të Njeriut me retë e qiellit, që po ashtu Krishti e aludoi në gjyqin e tij.

Cili Bir i Njeriut? Aludimi i Krishtit për Danielin 7:11–14

Le të citojmë pjesën e duhur të vetë vizionit *gjerësisht*:

Atëherë unë shikova për shkak të fjalëve të mëdha që briri thoshte; shikova deri sa u vra kafsha, dhe trupi i saj u shkatërrua dhe u hodh në zjarr për të djegur. Sa për kafshët e tjera, u hoq sundimi i tyre por iu lejua atyre një zgjatje e jetës për një periudhë të caktuar kohe. Unë shikoja disa vegime nate, dhe ja mbi retë e qiellit po vinte dikush që i ngjante një Biri njeriu; ai arriti deri te i Lashti i ditëve dhe iu afrua atij. Atij iu dha sundimi, lavdia dhe mbretëria, me qëllim që gjithë popujt, kombet dhe gjuhët t'i shërbenin; sundimi i tij është një sundim i përjetshëm që nuk do të kalojë, dhe mbretëria e tij është një mbretëri që nuk do shkatërrohet kurrë". (Dan 7:11–14)

Pastaj le të citojmë edhe interpretimin e vizionit:

Unë shikoja dhe po ky bri bënte luftë kundër shenjtorëve dhe i mundte, deri sa arriti i Lashti i ditëve dhe iu dha e drejta shenjtorëve të Shumë të Lartit, dhe erdhi koha në të cilën shenjtoret zotëruan mbretërinë. (Dan 8:21–22)

Atëherë është e dukshme që Krishti po interpretonte këtë vizion si një përshkrim profetik të ardhjes së tij personale të dytë. Disa studiues mohojnë, gjithsesi, që personazhi i Birit të Njeriut të përfaqësojë vetë Mesian. Ata mendojnë që në përshkrimin e vizionit (14–7:1) sundimi universal iu dha "dikuq që i ngjante një biri njeriu"; por në shpjegimin e vizionit, që i jepet më pas Danielit (7:16–28), nuk përmendet më ky bir i njeriut. Përkundrazi, sundimi universal dhe i përjetshëm thuhet në mënyrë të përsëritur u jepet "shenjtorëve të Shumë të Lartit" (7:18, 21, 22, 25, 27). Sipas këtyre studiuesve, ai "që është i

ngjashëm me një bir njeriu” në vizion është një simbol kolektiv i asaj që, sipas një shpjegimi të qartë në dritën e realitetit, nuk është gjë tjetër veçse thjeshtësisht një linjë e gjatë e martirëve njerëzorë. Prandaj ata argumentojnë që nuk mund të merret se përfaqëson personalisht Mesian dhe aq më pak ardhjen e tij të dytë.

Vëzhgimi i tekstit të Danielit 7 mbi të cilin mbështetet ky mendim është shumë i saktë; por konkluzioni i nxjerrë prej tij është shumë larg prej të qenit i saktë. Në vizion ne shohim në mënyrë të përsëritur që bisha i përndjek egërsisht shenjtoret (7:21–22, 25–27). Prandaj vetëm pasi bisha vritet, Perëndia u jep sundimin shenjtorëve. Zoti ynë u tha të njëjtën gjë dishepujve të tij: “Mos ki frikë, o tufë e vogël, sepse Atit tuaj i pëlqeu tju japë mbretërinë.” (Luka 12:32). Por ata nuk do ta gëzonin atë, të ndarë prej tij si edhe Zoti ynë e ka bërë të qartë në raste të tjera. “Në të vërtetë po ju them, në krijimin e ri, - tha ai - kur Biri i njeriut të ulet në fronin e lavdisë së vet, edhe ju që më keni ndjekur do të uleni mbi dymbëdhjetë frone për të gjykuar të dymbëdhjetë fiset e Izraelit.” (Mat 19:28). Dhe nëse pyesim se ç’periudhë apo kohë kishte parasysh ai kur po fliste për Birin e Njeriut që ulet mbi fronin e lavdisë së tij, sërish e qartësoi këtë çështje përtej çdo dyshimi: “Dhe kur të vijë Biri i njeriut në lavdinë e tij, bashkë me të gjithë engjëjt e shenjtë, atëherë do të ulet mbi fronin e lavdisë së vet. Dhe të gjithë kombet do të mbledhen para tij...” (Mat 25:31–32). Pa asnjë fije dyshimi, Krishti është duke folur për ardhjen e tij të dytë: Birin e Njeriut që do të vijë me retë e qiellit, si është përshkruar te Danieli 7.

Për më tepër, si edhe në vizionin e Danielit ku shenjtoret që kanë përjetuar përndjekje prej bishës iu është dhënë sundim universal në ardhjen e Birit të Njeriut, po ashtu te Mateu 25:3 dhe në një pasazh të ngjashëm te Luka 22:28–30, Krishti thekson faktin që ata që kanë vuajtur për hatër të tij, do të sundojnë me të në ardhjen e tij të dytë.³

Duhet të bëjmë një vërtetim të mëtejshëm këtu para se të ecim

3 Kjo është shprehur prej Palit në mënyrë klasike në përshkrimin që i bën ngjarjeve që do të ndodhin kur Krishti do të vijë prej qiellit me engjëjt e fuqisë së tij, për të ngushëlluar popullin e tij të përndjekur, për të qenë i lartësuar mes shenjtorëve të tij dhe të gjykojë përndjekësit e tyre (2 Selan. 1:4–10).

përpara drejt çështjeve më të rënda. Disa studiues protestojnë se te vizioni i Danielit Biri i Njeriut vjen tek i Lashti i Ditëve në qiell – dhe ky vëzhgim është i vërtetë. Pikërisht për shkak të kësaj ata argumentojnë që vizioni i Danielit nuk mund të mendohet se i referohet ardhjes së dytë të Krishtit në tokë në Parusinë e tij. Logjika e tyre është e mangët. Biri i Njeriut vjen tek i Lashti i ditëve për të marrë sundim universal mbi të gjitha kombet; por zotërimi i këtij sundimi universal nënkupton dhe përfshin ardhjen e Birit të Njeriut mbi dhe për ta ushtruar atë. Kështu te 2 Selanikasve 10–1:5 shohim që është Perëndia që u jep prehje prej përndjekësve shenjtorëve dhe dënon përndjekësit e tyre; dhe në kontekstin e tij, ai e bën këtë përmes ardhjes së Zotit Jezus prej qiellit në tokë. Po ashtu te 1 Timoteut 6:13–16 është Perëndia, Sundimtari i bekuar dhe i vetëm, që përgatit shfaqjen e Zotit tonë Jezus Krisht. Por kjo shfaqje nënkupton, duke u nisur nga vetë koncepti, se po vjen prej qiellit në tokë.⁴

Dy ardhjet e Krishtit dhe problemi i së keqes

Interpretimi i Krishtit, që Dhiata e Vjetër parashikon dy ardhjet e Krishtit dhe jo vetëm një, ka të bëjë me shumë sesa me interesin akademik. Ai ndikon drejtpërdrejt në një problem që ndjek çdo person të ndjeshëm, d.m.th problemi i së keqes.

Shumë vite më parë një shok shkollë që ishte hebre, dhe prindërit e të cilit ishin vrarë nën regjimin e Hitlerit, më kapi pas një ore mësimi dhe më tha: “David, Jezusi juaj nuk mund të jetë Mesia.”

“Pse jo?” – i thashë.

“Sepse Dhiata e Vjetër thotë që, kur të vijë Mesia, ai do të zhdukë të gjitha të këqijat kudo në botë. Dhe Jezusi juaj nuk e ka bërë këtë.” – u përgjigj ai. “Dhe mos më dredho duke më thënë që ai ka ngritur një mbretëri frymërore, e ndryshme nga ajo materiale. Dhiata e Vjetër nuk flet asgjë për këtë lloj mbretërie. Jezusi juaj nuk është Mesia.” – shtoi ai.

4 Krhs. D. A. Carson: ‘Vetëm po të mendosh për vendndodhjen e të Lashtit të Ditëve në një kuptim fizik dhe hapësinor, bëhet e vështirë të mendosh për afrimin e Krishtit për të marrë mbretërinë te Perëndia Atë si diçka që mund të kombinohet me kthimin e tij mbi tokë për të ngritur mbretërinë e plotë.’ (Matthew, EBC 8:506).

Nuk janë vetëm hebrenjtë që e ndjejnë këtë problem. Edhe johebrejtë e shprehin në mënyrën e tyre: "Nëse ka një Perëndi që bën drejtësi" – thonë ata – "dhe nëse Jezus Krishti është Biri i Tij, pse Jezusi nuk ndërhyr në botë dhe të zhdukë të keqen? Ai është ngjallur prej së vdekurish, apo jo, dhe është ulur në fronin e universit. Pse nuk është zhdukur e keqja prej kohësh?"

Tani nuk është vendi që të japim një përgjigje të plotë për problemin e së keqes. Do mjaftohemi duke shpjeguar lidhjen e doktrinës së dy ardhjeve në strategjinë e Perëndisë, të zbuluar në Dhiatën e Vjetër, me zhdukjen përfundimisht të së keqes.

Dhiata e Vjetër siguron profetizoi që kur Mesia do të vinte, ai do të ekzekutonte zemërimin e Perëndisë mbi një botë të keqe dhe të çlironte të perëndishmit në Izrael prej përndjekësve të tyre. Merrni si shembull parashkrimin e Isaia me metaforat e tij të gjalla:

Kush është ai që vjen nga Edomi, nga Botsrahu,
me rrobat e ngjyrosura me bojë të kuqe flakë?
Ky, i veshur shkëlqyeshëm, që ecën
në madhësinë e forcës së tij?
"Jam unë që flas me drejtësi dhe jam
i fuqishëm për të shpëtuar".

Pse veshja jote është e kuqe dhe rrobat e tua
si ata që shtrydhnin rrushin në gaviç?

"Gaviçin e shtypa vetëm dhe asnjë
nga popujt nuk ishte me mua.
I shtypa në zemërimin tim
dhe i shkela në tërbimin tim.
Gjaku i tyre spërkati rrobat e mia
dhe njollosoi tërë veshjet e mia.
Sepse dita e hakmarrjes ishte në zemrën time
dhe viti i çlirimit tim ka ardhur...
I shkela me këmbë popujt në zemërimin tim,
i deha në tërbimin tim
dhe bëra që të derdhet gjaku i tyre mbi tokë".
(Isa 63:1-6) 5

5 Krhs. Përkrahimin gjuhësor të ngjashëm të Krishtit në ardhjen e tij të dytë, Zbul. 19:11-21.

Problemi për shumë izraelitë të perëndishëm ishte se, përballë vuajtjeve të mëdha të Izraelit, Perëndia rrinte i heshtur për periudha të gjata historie dhe dukej se nuk bënte asgjë për të përmbushur profeci të tilla mesianike të çlirimit. Ja pse thërriste thirrjet e ankthit psalmisti:

O Perëndi i hakmarrjes, o Zot,
Perëndi i hakmarrjeve, shkëlqej.
Çohu, o gjykatës i tokës,
dhe jepu shpërblimin mendjemëdhenjve.
Deri kur të pabesët, o Zot,
deri kur të pabesët do të triumfojnë?
Ata vjellin fjalë dhe mbajnë fjalime të paturpshme;
të gjithë ata që kryejnë paudhësi flasin me arrogancë
Ata marrin nëpër këmbë popullin tënd,
o Zot, dhe shtypin trashëgiminë tënde.
Vrasin gruan e ve dhe të huajin,
dhe vrasin jetimët,
dhe thonë: "Zoti nuk shikon,
Perëndia i Jakobit nuk kupton".

(Ps 94:1-7)

Por dy psalme më vonë psalmisti ka gjetur fillimin e një përgjigjeje për këtë problem të tijin. Ajo është ardhja e Zotit për të gjykuar botën:

Le të gëzohen qiejtë dhe të gëzohet toka ... përpara Zotit,
sepse ai vjen, vjen për të gjykuar tokën. Ai do ta gjykojë
botën me drejtësi dhe popujt në besnikërinë e tij. (Ps
96:11, 13; e përsëritur te Ps 98:7-9)⁶

Por në ç'formë do të vijë Yahveh? Kur do të ndodhë kjo ardhje? Në fakt, pak më tej në librin e Psalmeve vjen një psalm që përmbante përgjigjet e këtyre pyetjeve; por kuptimi i tij nuk do të bëhej i qartë derisa Mesia të vinte dhe ta interpretonte me anë të mishërimit dhe shërbesës së tij. Ky psalm është Psalmi 110.

6 Kjo është pjesë e ungjillit që Pali u predikoi athinasve (Veprat 17:31).

Psalmisti parashikon një pushim mes ardhjes në fron të Krishtit dhe gjykimit të së keqes nga Perëndia

Kur Krishti u ngjall prej së vdekurish dhe iu shfaq trupërisht dishepujve të tij, mund të kishim pritur, siç bënë apostujt (Veprat 1:6–8), që ai menjëherë të shkatërronte të keqen dhe të përmbushte premtimet për çlirimin e Izraelit në Dhiatën e Vjetër. Por shumë shpejt zbuluan të kundërtën; dhe brenda një kohe të shkurtër shohim që Pjetri deklaroi publikisht se Krishtin: “qielli duhet ta mbajë deri në kohën e ripërtëritjes të të gjitha gjërave, për të cilën Perëndia ka folur nëpërmjet gojës së gjithë profetëve të tij të shenjtë...” (Veprat 3:21). Psalmi 110:1 ishte një nga këto profeci. Kjo parathoshte se midis kohës së lartësimit dhe ardhjes në fron të Krishtit, dhe kohës kur Perëndia do të nënshtrojë të gjithë armiqtë e tij nën këmbët e tij, do të kishte një periudhë të paspecifikuar në kohëzgjatje: “Ulu në të djathtën time *derisa* ti bëj armiqtë e tu stol të këmbëve të tua”

Kjo periudhë e quajtur *derisa* nuk është një ide e shpikur prej të krishterëve të hershëm për të mbuluar zhgënjimet e tyre që Krishti nuk shkatërroi menjëherë të keqen kudo që ndodhej në botë. Kjo ishte pjesë e strategjisë të qëllimshme dhe të thënë shumë kohë më parë nga ana e Perëndisë për të përballur problemin e së keqes. Vetë Krishti theksoi të njëjtën gjë në Shëmbëlltyrën e grurit dhe egjërës në të cilën ai shpalli planet e tij për të çrrënjësuar të keqen. Kur bujqit e pyetën zotërinë në shëmbëlltyrë nëse donte të shkulte egjërën, ai tha jo; sepse duke shkukur të keqen me gjykimin e tyre që nuk ishte i pagabueshëm, do të çrrënjësonte edhe grurin po ashtu. Le të rriten bashkë deri në të korra, u tha atyre. Dhe e korra, sipas vetë interpretimit të Krishtit të kësaj shëmbëlltyre, do të ndodhë në fund të epokës (Mat 13:30, 39–43).

Drejtësia do të bëhet në fund. E keqja do të mposhtet. Kjo është pjesë e ungjillit, qoftë e Dhiatës së Vjetër, qoftë e së Resë. Që do të ketë një gjykim përfundimtar është një lajm madhështor, i mirë. Në dritën e kësaj, psalmisti i bëri thirrje të gjithë krijesës të gëzohet (Ps 96 dhe 98). Dhe pse jo? Cili do të dëshironte që e keqja dhe padrejtësia të vazhdojë përjetë mbi dhé?

Pse atëherë kjo vonesë e gjatë? Nuk mund të jepet përgjigje

më e mirë se ajo e Pjetrit për kritikët e tij. Kur ata kundërshtuan: “Ku është premtimi i ardhjes së tij?”, Pjetri iu përgjigj, “Zoti nuk vonon plotësimin e premtimit të tij, siç disa besojnë që ai bën; por është i durueshëm ndaj nesh, sepse nuk do që ndokush të humbasë, por që të gjithë të vijnë në pendim. Dhe dita e Zotit do të vijë...” (2 Pjet 10–3:9).

Aktivitetet e shumta të profetizuara të Mesias dhe domosdoshmëria e dy ardhjeve të tij

Është e rëndësishme të kujtojmë që profetët e Dhiatës së Vjetër disa herë regjistruan të gjithë sferën e aktiviteteve të parashikuara të Mesias pa treguar se cilat do të kryente në ardhjen e tij të parë dhe cilat në të dytën. Një shembull i mirënjohur është përshtkrimi i detajuar i Isaias 61:1–4, që Zoti ynë citoi në predikimin e tij programor në Nazareth (Luka 4:16–e më tej). Kur iu dha pergamena e Isaias, ai e hapi tek 61:1 dhe lexoi prej saj gjërat e mrekullueshme që parashikoi se do të bënte Mesia deri në hollësi duke përfshirë “për të predikuar vitin e pranueshëm të Zotit” (v.2). Pastaj ai e mbylli pergamenën dhe shpalli “Sot ky Shkrim u përmbush në veshët tuaja”. Që atëherë komentues dhe predikues të shumtë kanë shpjeguar se sa mirë bëri Krishti që ndali aty ku e la. Sepse fraza tjetër ishte “ditën e hakmarrjes të Perëndisë tonë”. Ishte mëshira e Perëndisë, thonë ata, që ai nuk citoi edhe atë klauzolë dhe shtoi “Sot ky Shkrim u përmbush në veshët tuaja”.

Predikuesit kanë të drejtë, por është e dyshimtë nëse njerëzit e mbledhur në sinagogë do të kishin rënë dakort me ta. Sepse në të njëjtin kontekst të Isaias “dita e hakmarrjes” është lidhur me “vitin e çlirimit tim” (63:4) apo “viti i të shpenguarve të mi”. Dhe asambleja e sinagogës mund ta kishte menduar që do të thoshte se Perëndia do të çlironte apo shpengonte izraelitët, duke derdhur zemërimin e tij mbi armiqtë e Izraelit (siç bëri shumë kohë më parë në Egjipt), nga shtypja dhe përndjekja e armiqve të tyre. Në atë rast ata do të qenë të zhgënjyer se Krishti nuk propozoi aty dhe në atë çast të zbatonte zemërimin e Perëndisë mbi armiqtë e Izraelit dhe të çlironte Izraelin.

Si shumë prej ideve të tjera, edhe ideja e tyre për zgjidhjen e Perëndisë për problemin e së keqes ishte e pa zhvilluar mirë,

për të mos thënë shumë e thjeshtëzuar. Zgjidhja asnjëherë nuk mund të ishte thjesht të vendoseshin njerëzit e mirë në një grup, të këqijtë në një tjetër, të agjësohej grupi i të këqijve dhe të mbetej grupi i të mirëve; sepse të gjithë janë të mëkatshëm dhe fajtorë në shkallë të ndryshme, qofshin shtypësit qofshin të shtypurit.

Krishti nuk mohoi që Perëndia një ditë "...do të marrë hak për të zgjedhurit e tij që i këlthasin atij ditë e natë"; por kjo do të ndodhë, shpjegoi ai, në ardhjen e Birit të njeriut kur ai do të jetë ashtu si rrufeja "që vetëtin nga njëri skaj i qiellit te tjetri e ndriçon" (Luka 17:24; 18:7-8). Në atë ditë ai do të jetë i dukshëm njëherazi për të gjithë mbi tokë dhe i pakundërshtueshëm (Zbul 1:7). "Por më parë" – shtoi Krishti - "i duhet të vuajë shumë dhe të hidhet poshtë nga ky brez." (Luka 17:25).

Pse duhet? Sepse Shkrimet e thanë këtë, dhe faji i njeriut e kishte të domosdoshme. Në Dhomën e Sipërme, para vdekjes së tij, ai përsëriti këtë "duhet": "Sepse unë po ju them se çfarë është shkruar duhet të plotësohet ende në mua: "Dhe ai është radhitur ndër keqbërësit". Sepse ato gjëra që janë shkruar për mua do të kenë kryerjen e tyre." (Luka 22:37). Kjo ishte një referencë e qartë e Isaias 53:12, atij kapitulli të famshëm që parashikoi vdekjen shlyese dhe zëvendësuese të Shërbëtorit të Vuajtur të Perëndisë, përmes së cilës falja dhe shfajësimi janë bërë të mundshme për të gjithë që pendohen dhe besojnë.

Atëherë, Krishti interpretoi Dhiatën e Vjetër se ajo parashikonte dy role për të: sigurisht atë të Mbretit-Mesia fitimtar, por më parë atë të Shërbëtorit të Vuajtur të Perëndisë i cili nuk do të vinte që t'i shërbenin, por për të dhënë jetën e tij si shpengim për shumë (Mark 10:45), që të shpëtojë njerëzit prej gjykimit që po vjen. Ja, pra, pse duheshin dy ardhjet: të dyja këto role nuk mund të përmbusheshin në një ardhje.

...

Pyetjet e studimit të këtij kapitulli mund t'i gjeni
në faqen 434.

7 Koncepti i përmbushjes

Pohimi i zakonshëm është që Dhiata e Vjetër përmbushet në Dhiatën e Re; një pohim i tillë është plotësisht i vërtetë. Në fakt, është i vërtetë në një nivel më thellë sa na e pret mendja. Sepse kur Dhiata e Re thotë se një pjesë e caktuar e Dhiatës së Vjetër tashmë është plotësuar, shpesh, thjesht mund të thotë që një parashikim ose profeci tani u bë realitet. Por shumë shpesh ajo ka parasysh diçka tjetër, siç edhe do të shohim tani ndërsa hetojmë katër kuptimet e ndryshme në të cilën folja “përmbush” përdoret në Dhiatën e Re.

1. Përmbushja si përmbushje e parashikimeve
2. Përmbushja si shprehja më e lartë dhe finale e parimeve themeltare
3. Përmbushja e Ligjit nga Krishti
4. Përmbushja e Ligjit nga të krishterët

Përmbushja si përmbushje e parashikimeve

Në shumë raste Dhiata e Re vëzhgon që disa parashikime të Dhiatës së Vjetër janë përmbushur në jetën dhe veprën e Zotit Jezus, në përhapjen e ungjillit apo në formimin e kishës. Shembuj tipikë janë këta:

(a) Lindja e Zotit në Betlehem (Mat 2:4–6) që përmbushi

parashikimin e bërë nga profeti Mikea (5:2).

(b) Hyrja e tij në Jerusalem mbi një gomar (Gjoni 12:13–16) përmbushi parashikimin e bërë nga profeti Zakaria (9:9).

(c) Ardhja e Frymës së Shenjtë në Ditën e Rrëshajëve që përmbushte parashikimin e bërë nga profeti Joel (2:28–29).

Në raste të tjera ajo pohon, siç tashmë e kemi parë, që profeci të tjera të Dhiatës së Vjetër do të përmbushen në të ardhmen. Shembuj të spikatur të kësaj janë:

(a) Vizioni profetik i Danielit, për ardhjen e Birit të Njeriut mbi retë e qiellit, do të përmbushet në ardhjen e dytë të Zotit Jezus (Marku 14:62; Luka 21:27).

(b) Programi profetik i parathënë te Psalmi 110:1 ‘Ulu në të djathtën time deri sa ti bëj armiq të tu stol të këmbëve të tua’, do të kryhet plotësisht në kthimin e Zotit tonë (Heb 10:13).

Shembujt janë aq të shumtë, dhe parimi – parashikim > përmbushje – është kaq i qartë, sa që nuk kemi nevojë të ndalemi gjatë për ta shpjeguar.

Por ka një klasë tjetër përmbushjesh që pohohen prej Dhiatës së Re që, ndoshta për ne në kohët moderne, kërkon domosdoshmërisht një shpjegim.

Përmbushja si shprehja më e lartë dhe finale e parimeve themeltare

Në këtë klasë, ajo që nënkuptohet prej këtij koncepti është përmbushja, si shprehja përfundimtare në nivelin më të lartë të mundshëm, e parimeve themeltare që u shprehën në një nivel më të ulët përgjatë historisë së Dhiatës së Vjetër. Kjo lloj përmbushjeje na del në pah në mënyrë të qartë kur Dhiata e Re pohon se diçka në Dhiatën e Vjetër është përmbushur por, pas shqyrtimit, del se kjo gjë nuk ishte në fakt një parashikim, por thjesht një regjistrim i një ngjarjeje historike të shkuar për shembull, ose madje një institucion i Besëlidhjes së Vjetër. Shtrohet pyetja: si mundet që regjistrimi i një ngjarjeje të shkuar historike, që kurrë nuk u mendua si një parashikim, të mendohet me të drejtë se u përmbush nga një ngjarje apo situatë e Dhiatës së Re? Ja disa shembuj tipikë të kësaj çështjeje:

‘Derisa ajo të plotësohet’: Përmbushja e Pashkës

Sipas Lukës, pasi Krishti u ul me dishepujt e tij në Dhomën e Sipërme në vigjilje të kryqëzimit të tij, ai u tha atyre:

Kam pasur dëshirë të madhe ta ha këtë Pashkë bashkë me ju, para se të vuaj, sepse po ju them se nuk do të ha më të tillë derisa ajo të plotësohet në mbretërinë e Perëndisë (Luka 22:14–16)

Përkufizimi i problemit

Të përmbushet Pashka? A ishte atëherë Pashka një parashikim? Aspak. Të paktën jo në kuptimin e zakonshëm të kësaj fjale. Pashka e parë ishte një ngjarje historike në themel të krijimit të Izraelit si një komb i lirë dhe i pavaruar; dhe, më pas, kremtimi i përvitshëm i Festës së Pashkës ishte një mjet që synonte rikujtimin e ngjarjes së shkuar në mendjet dhe kujtesat e brezave të ardhshëm. Atëherë, që nga fillimi, qe një kthim i kokës pas, në fakt, dhe jo një parashikim për të ardhmen. Prandaj çfarë deshi të thoshte Zoti Jezus kur tha që Pashka do të përmbushej në mbretërinë e Perëndisë?

Zgjidhja e problemit

Për t’iu përgjigjur kësaj pyetjeje ne duhet të mbajmë parasysh jo vetëm atë që u realizua në Pashkën e parë, por edhe hollësitë si u realizua ajo, dhe, si rrjedhim, çfarë ishte ajo që përkujtonin aq gjallë të gjitha Pashkët pasuese. Pashka e parë realizoi çlirimin e Izraelit prej engjëllit shkatërrues të zemërimit të Perëndisë përmes gjakut të një qengji të therur (Eks 12:23). Ky zemërim i Perëndisë theu kokëfortësinë e faraonit që më në fund Izraeli u la i lirë, ndërsa fuqia e Perëndisë në Detin e Kuq u hapi një rrugë shpëtimi teksa largoheshin me nxitim nga kurthi i tij për t’i kthyer pas. Për Izraelin ishte përjetimi i parë i Perëndisë si shpengues dhe çlirimtar, shijimi i parë kombëtar i tyre i të mirave të shpengimit fizik dhe politik.

Pashka: një model shprese për të ardhmen e Izraelit

Nga vetë natyra e gjërave, ajo ishte vetëm një përvojë fillestare.

Të mirat e saj duheshin pranuar me mirënjohje dhe duheshin kujtuar detyrimisht çdo vit. Por kjo nuk vazhdoi gjatë. Në shekujt që vijuan, Izraeli iu nënshtrua sërish zgjedhës së johebrenjve dhe humbi pavarësinë dhe lirinë e tij politike. Por, kur kjo ndodhi, ne lexojmë te profetët e Dhiatës së Vjetër, si Isaia, që kremtimi i përvitshëm i Pashkës nga Izraeli filloi të mbartte një përmasë shtesë. Përkujtimi i Pashkës së parë filloi të ushqente shpresë në zemrat e tyre se atë që Perëndia e kishte bërë kohë më parë në të shkuarën, do ta bënte sërish në të ardhmen, madje, në një shkallë edhe më të madhe. Sërish ai do të thyente shtypjen e johebrenjve, sërish do të sillte një eksod dhe do të çlironte kombin politikisht dhe do ta kthente në vendin e tyre. (Nëse dëshironi të lexoni një përshkrim të shpresës së Izraelit me terma të gjuhës së Pashkës, lexo Isa 51:9–11; 63:11–19.) Kjo shpresë ende vazhdon: inkuizicioni, pogromet dhe holokausti nuk e kanë shuar atë dhe nuk do të mund ta bëjnë ndonjëherë.

Pashka: për të gjithë njerëzimin

Sidoqoftë, historia e njerëzimit ka treguar që ka një skllavëri më të madhe sesa nënshtrimi politik; dhe Satani është një tiran më i lig dhe më i fuqishëm sesa faraonët e lashtë apo hitlerët modernë. Gjithë raca njerëzore ka nevojë për çlirim prej fuqisë së tij, dhe mbrojtje prej zemërimit të Perëndisë përmes një mburoje më të efektshme sesa gjaku i një qengji të pafajshëm. Prandaj ajo që Krishti donte të thoshte kur foli për përmbushjen e Pashkës ishte kjo: përmes vdekjes së tij si Qengji i Perëndisë, shpengimi i Perëndisë (që fillimisht u tregua në një nivel relativisht më të ulët në çlirimin fizik dhe politik të Izraelit prej Egjiptit), tani do të realizohej mbi të njëjtin parim themeltar të shpengimit me anë të gjakut, veçse, në nivelin më të lartë të mundshëm dhe në shkallën më të gjerë të mundshme. (shih Gjoni 12:31; 16:11; Kol 1:13). Krishti, Pashka jonë, do të sakrifikohej për ne (krh. 1 Kor 5:7).

Pashka: një prototip i modeluar nga Perëndia

Tani, Perëndia kishte caktuar si qëllim të vetin që të shpengonte njerëzimin përmes vdekjes së Birit të tij shumë kohë para se

Izraeli i lashtë të shkonte në Egjipt (1 Pjet 1:19–20). Prandaj nuk ndodhi se, kur Krishti erdhi të vdiste, Perëndia papritur kuptoi se Pashka, që ai e kishte orkestruar më parë për të realizuar çlirimin e Izraelit nga Egjipti, papritur nga një kthesë e fatit, mund edhe të përdorej si një ilustrim për vdekjen shpenguese të Birit të Tij. Ishte tërësisht e kundërta. Kur Perëndia çliroi Izraelin e lashtë nga Egjipti, ai tashmë e kishte parasysh shpengimin final të racës njerëzore përmes vdekjes së Birit të tij. Prandaj e orkestroi Pashkën që të ishte jo thjesht mjeti sesi ai do ta çlironte vetëm Izraelin në atë kohë, por edhe si një lloj prototipi¹ i shpengimit përfundimtar.

Në këtë kuptim vdekja e Krishtit “përmbushi” më në fund Pashkën. Pa dyshim që interpretimi i Pashkës së parë të Dhiatës së Vjetër si prototip i vdekjes së Krishtit, nuk ia zbeh në asnjë mënyrë domethënien ose efektshmërinë Pashkës së parë si një ngjarje historike në vetvete.

‘Nga Egjipti’: Përmbushja e Oseas 11:1

Le të shohim një shembull tjetër të kësaj lloji përmbushjeje, këtë herë nxjerrë nga Profetët. Mateu regjistron sesi Jozefi u urdhërua në mënyrë hyjnore prej një engjëlli të Zotit të shpinte fëmijën, Jezusin, dhe nënën e tij në Egjipt, që t'u shpëtonin qëllimeve vrasëse të Herodit të Madh (Mat 23–19, 15–2:13). Jozefit iu tha, gjithashtu, se duhej të qëndronte në Egjipt derisa engjëlli ta udhëzonte të kthehej. Pastaj Mateu shton që e gjithë kjo (arratisja në Egjipt dhe veçanërisht qëndrimi atje derisa të udhëzohej prej engjëllit të Zotit të kthehej në tokën e Izraelit) që caktuar nga Perëndia, me qëllim që të përmbushej ajo që Zoti kishte folur përmes Oseas, profetit: ‘nga Egjipti thirra birin tim’ (Osea 11:1).

Gafa e supozuar e Mateut

Kritikët antipatikë ndaj Mateut e kanë drejtuar gishtin te kjo: këtu Mateu ka bërë një gabim flagrant sipas tyre. Ata vënë në dukje se Osea 11:1 nuk ka për qëllim të bëjë ndonjë parashikim. Atëherë, si mund të përmbushet në mënyrën që thotë Mateu?

¹ Për domethënien e ‘prototipit’ shih fq. 149

Përsa i përket kësaj, kritikët kanë të drejtë: Osea 11:1 nuk kishte për qëllim të bënte një parashikim: ai ishte thjesht një referencë ndaj një ngjarjeje të shkuar historike, domethënë eksodit, në kohën e foshnjërisë së Izraelit si komb. Kjo është plotësisht e qartë kur dikush lexon të gjithë vargun: “Kur Izraeli ishte fëmijë [*d.m.th.* në foshnjërinë e kombit], unë e desha dhe nga Egjipti thirra birin tim” Pra, meqë është kështu, si mund të thotë Mateu se kjo ngjarje e shkuar historike u përmbush shekuj më vonë prej Krishtit që shkoi dhe pastaj u kthye nga Egjipti në vendin e Izraelit? Është një gabim trashanik prej Mateut, thonë kritikët e tij antipatikë; dhe ata sugjerojnë një teori sesi ai arriti të bënte një gabim kaq trashanik.

Sipas atyre, Mateu, pa e vërtetuar këtë më parë (*ex hypothesi*), që i bindur se Jezusi, si Mesia, duhet të ketë përmbushur çdo profeci të Dhiatës së Vjetër në lidhje me Mesian. Kështu që Mateu kërkoi për profeci të tilla në Dhiatën e Vjetër. Kur gjente një, përzgjidhte ndonjë ngjarje nga jeta e Jezusit që kishte njëfarë ngjashmërie me atë profeci, dhe e shpallte si një përmbushje. Pastaj, kur nuk mund të gjente ndonjë ngjarje të vërtetë në jetën e Jezusit që i përshtatej një profecie të caktuar, zelli i tij e shtynte të shpikte një ngjarje të përfytyruar që përfaqësonte Jezusin duke përmbushur atë profeci, siç Mateu besonte se Jezusi duhet të kishte bërë.

Por tek Osea 11:1 ai gaboi. Ai e kujtonte vargun, por jo qartazi. Ai mendoi se ishte një parashikim, dhe prej tij shpiku ngjarjen e largimit për në Egjipt dhe kthimin prej andej, me qëllim që ta nxirrte Jezusin duke përmbushur këtë parashikim. Fatkeqësisht për të, nuk që një parashikim dhe prandaj nuk mund “të përmbushej” nga asnjë ngjarje në jetën e Krishtit. Mateu është zënë me presh në dorë. Ngjarja e arratisjes dhe kthimit nga Egjipti demaskohet si trillim nga ana e Mateut, mbështetur mbi një keqkuptim të këtij vargu nga Dhiata e Vjetër, sikur të ishte një parashikim.

Kuptimi i fjalës “përmbush” te Mateu 2:15

Mirëpo, nuk është Mateu, në fakt, që ka gabuar, por kritikët e tij. Kritika e tyre mbështetet mbi supozimin që sa herë Dhiata e Re përdor fjalën *përmbush* në lidhje me ndonjë pasazh të Dhiatës

së Vjetër, nënkupton përmbushjen e një parashikimi. Ata kanë lënë pas dore kuptimin tjetër të fjalës *përmbush*, që ne sapo e kemi treguar në lidhje me Pashkën: shprehja finale, në nivelin më të lartë të mundshëm, e parimeve apo strategjive themeltare që u shprehën fillimisht në një nivel të ulët përgjatë rrjedhës së historisë së Dhiatës së Vjetër.

Për të kuptuar se kjo është mënyra si fjala ‘përmbush’ u përdor te Mateu 2:15, ne duhet të bëjmë dy gjëra që një interpretim i shëndoshë do të na kërkonte t’i bënim gjithsesi. Së pari duhet të hetojmë të gjithë kontekstin e frazës “nga Egjipti thirra birin tim” tek Osea 11:1. Pasi ta kemi bërë këtë, ne duhet të shqyrtojmë të gjithë kontekstin në të cilin Mateu citon këtë frazë nga Osea.

Konteksti ‘nga Egjipti thirra birin tim’ tek Osea 11:1

Te Zanafilla 15 Perëndia premtoi se do t’i jepte vendin e Kanaanit farës së Abrahamit për trashëgimi, por jo menjëherë: vetëm pas një intervali prej 400 vjetësh në një tokë të huaj, të kaluar shumicën në skllavëri (Zan. 15:13, 16). Në përputhje me këtë, disa vite pas këtij premtimi, zia e bukës i detyroi pasardhësit e Abrahamit – që në atë kohë ishin një farefis prej jo më shumë se 70 veta – të largoheshin nga Kanaani në Egjipt. Por ata u larguan me premtimet e Perëndisë që jehonin ende në veshët e tyre: “Unë do të bëj që sigurisht të kthehesh” (Zan 46:4). Prandaj kur më në fund ata u bënë një komb i ri, Perëndia, duke u qëndruar besnik premtimeve të tij, i ktheu prej Egjiptit pas në vendin e Kanaanit. Duke kujtuar këtë lëvizje strategjike më vonë, Perëndia u thotë përmes Oseas:

Kur Izraeli ishte fëmijë, unë e desha dhe nga Egjipti thirra birin tim... Unë vetë i mësova Efraimit të ecë, duke e mbajtur nga krahët... Unë i tërhiqja me litarë të dashamirësisë njerëzore, me lidhje dashurie; isha për ta si ai që e ngre zgjedhën nga qafa e tyre, dhe përulesha për t’u dhënë të hanë. (Osea 11:1, 3, 4)

Por pas kësaj menjëherë Perëndia fillon të dënojë dhe të vajtojë braktisjen që Izraeli i bëri Atij (Ose 11:2) dhe i kërcënon me dëbim:

Izraeli nuk do të kthehet në vendin e Egjiptit; por Asiri do të jetë mbreti i tij, sepse nuk kanë pranuar të konvertohen. Shpata do të bjerë mbi qytetet e tij, do të shkatërrojë shufrat e tyre dhe do t’i hajë për shkak të planeve të tyre të këqija. (Osea 11:5–6)²

Por menjëherë pas kësaj, Perëndia pohon që ai nuk do të heqë dorë prej Efraimit (10 fiseve) përgjithmonë (Osea 11:8–9). Ai do të vrumbullojë si një luan dhe Izraeli do të kthehet:

“...bijtë e tij do të rendin drejt tij nga perëndimi duke u dridhur. Do të rendin duke u dridhur si zogjtë nga Egjipti dhe si pëllumbesha nga vendi i Asirisë; unë do t’i bëj të banojnë në shtëpitë e tyre”, thotë Zoti. (Osea 11:10–11)

Prandaj thirrja e parë e Perëndisë për birin e tij, Izraelin, që të dilte nga Egjipti për t’i dhënë zotërimin e tokës së Palestinës, nuk ishte diçka që do të ndodhte vetëm njëherë. Ndonëse u kthye mbrapsht përmes apostazisë së Izraelit, ajo do të përsëritej. Sërish Perëndia do ta thërriste prej Egjiptit birin e tij, Izraelin. Isaia tha të njëjtën gjë për kthimin e dy fiseve prej dëbimit të tyre në Babiloni (Isa 51:9–11 — ‘Rahabi’ është një emër tjetër për Egjiptin. Shih edhe 52:3–12 në lidhje me Egjiptin dhe Asirinë bashkë).

Konteksti i ‘nga Egjipti thirra birin tim’ te Mateu 2

Mateu e prezanton Zotin Jezus si birin e Davidit, birin e Abrahamit (Mat 1:1): për këtë arsye, edhe trashëgimtar i tokës që i takonte Abrahamit dhe pasardhësve të tij nga besëlidhja (Zan 15), si edhe trashëgimtar i fronit të Davidit dhe pasardhësve të tij sipas besëlidhjes (2 Sam 7). Në përputhje me këtë, sipas parashikimit të Mikeas 5:2, ai u lind në Bethlehem, vendlindja e Davidit (Mat 6–2:4). Por këtë herë kombi ishte nënshtruar sërisht nga një fuqi tjetër perandorake johebreje, domethënë Roma, që sundonte Judenë përmes një mbreti të huaj vasaal, Herodi i Madh, një edomit. Ndërtesat e tij qenë madhështore; disa prej

2 Më mirë do të ishte që i gjithë vargu 5 të lexohet si një pyetje dhe pjesa e parë të mos përkthehet si deklaratë — *Izraeli nuk do të kthehet*. . . Është e vërtetë që 10 fiset e Izraelit u dëbuan në Asiri dhe jo në Egjipt. Por shih Os 8:13 dhe 9:3. Asiria u bë metaforikisht Egjipti për Izraelin.

tyre janë ende sot në këmbë. Por ai vetë që një tiran gjakatar dhe psikopat, po aq mizor dhe vrastar sa çdo perandor asirian apo egjiptian më parë. Ai kishte dëgjuar për shpresën e Izraelit në ardhjen e Mesias. Por kur dëgjo për lindjen e Jezusit “Mbreti i Judenjve” (2:2–3), ai vendosi ta zhdukte këtë rival të fronit të tij para se të rritej dhe të fitonte simpatinë e popullit.

Sidoqoftë, në këtë pikë të ngjarjes, Mateu regjistron që nuk iu la iniciativës së Jozefit të vendoste nëse ose ku do ta çonte fëmijën në një vend të sigurt; as nuk iu la të vendoste kur që koha e duhur për t’u kthyer. Engjëlli që i tha të shpinte fëmijën në Egjipt, po aq qartë e udhëzoi atë të qëndronte atje derisa të merrte urdhra të mëtejshme (2:13). Me fjalë të tjera, Jozefi duhej të priste derisa Perëndia ta thërriste nga Egjipti edhe një herë birin e tij.

Largimi dhe kthimi nga Egjipti nuk qenë masa urgjente të marra papritmas nga Jozefi kur u përball me një vështirësi të paparashikuar. Kjo gjë bëhej nga Perëndia i cili adoptonte qëllimisht të njëjtat strategji që kishte përdorur më parë. Sepse pikërisht ashtu si Perëndia i kishte dhënë Abrahamit fillimet e farës së premtuar ndërsa ai që në Kanaan; dhe ashtu siç i kishte mbrojtur duke dërguar Jakobin dhe familjen e tij në Egjipt me një premtim të qartë se do t’i kthente mbrapa në Kanaan kur të bëheshin një komb (Zan 46:1–4); dhe ashtu siç thirri përfundimisht birin e tij Izrael nga Egjipti, në foshnjërinë e tij politike, dhe u kishte dhënë atyre tokën e premtuar dhe dinastinë mbretërore të Davidit, po ashtu Perëndia do të përdorte të njëjtat strategji dhe taktika sërish. Fara e premtuar e Abrahamit dhe Davidit u lind në atdhe, në qytetin e Davidit. Pastaj, për ta mbrojtur atë si foshnjë, Perëndia po e dërgonte në Egjipt që, kur të plotësohej koha, ta thërriste nga Egjipti dhe ta kthente në tokën e Izraelit për të filluar fushatën e madhe të ripushtimit të tokës së premtuar dhe rindërtimit të shtëpisë mbretërore të Davidit.

Pra është e njëjta strategji, por këtë herë në një nivel shumë më të lartë. Herën e parë ai thirri birin e tij nga Egjipti: këtë herë ai do të thërriste Birin e tij. Hera e parë që kombi: këtë herë do të ishte një individ, Krishti.

Kombi si biri i Perëndisë, siç Perëndia kishte vajtuar përmes

Oseas, kishte dështuar në mënyrë mjerane dhe dukej se kishte shkatërruar qëllimet e Perëndisë kur i nxori prej Egjiptit. Tani të gjitha shpresat e Izraelit, të gjitha qëllimet e Perëndisë për Izraelin dhe botën, u veshën në këtë individ, Krishtin, Izraelin e vërtetë, Birin e Perëndisë. Këtë herë kur Perëndia ta thërriste Birin e tij nga Egjipti, ai nuk do të pengohet nga ndonjë dështim i mëvonshëm. Fitorja përfundimtare që e sigurt.

Prandaj përmbushja e Oseas 11:1 ishte përmbushje jo e një parashikimi, por e një prototipi. Por para se të largohemi prej kësaj ngjarjeje, do të ishte mirë të shqyrtonim tri përmbushjet e tjera të dokumentuara në kontekstin e ngushtë të Mateut dhe të vëmë re karakteristikat e tyre të ndryshme.³

‘Rakela vajton bijtë e saj’: Përmbushja e Jeremias 31:15

Në momentin dramatik në tregimin e Mateut kur fëmija Jezus është dërguar në Egjipt, (2:14–15) dhe nuk është urdhëruar ende që të kthehet prej andej (2:19–20), Mateu përshkruan masakrën e Herodit të të gjithë fëmijëve meshkuj, nën dy vjeç, në qytetin e Davidit, Betlehem.⁴ Pastaj Mateu shton:

Atëherë u përmbush ajo që ishte thënë nëpërmjet profetit Jeremi që thotë: Në Ramë u dëgjua një klithmë, një vaje një qarje dhe gjëmë e madhe; Rakela vajton bijtë e saj dhe nuk pranon të ngushëllohet, sepse ata nuk janë më’ (Mat 2:17–18)

Pa dyshim që masakra e Herodit të fëmijëve në Betlehem provokoi gjëmë dhe vajtim mes nënave dhe etërve të tyre. Por pyetja jonë duhet të jetë: ‘Në ç’mënyrë përmbushi ky vajtim atë që u tha përmes profetit Jeremia?’ Sërish ne kthehemi te Jeremia 31:15 dhe konteksti nga ku ngrihet ky citim.

Së pari ne vëmë re që *Rakela*, realisht emri i gruas së preferuar të patriarkut Jakob, këtu simbolizon jo dhe aq shumë një grup të veçantë nënash, por është një personifikim i kombit, ‘nënës Izrael’, me një fjalë.

³ Në pjesën që vijon unë kam huazuar trajtimin e R. T. France, *Matthew*, 85–9.

⁴ Historianët dhe ekspertët e demografisë sugjerojnë që do të kenë qenë të vrarë rreth 20 fëmijë — një numër i vogël për listën e gjatë të mizorive të Herodit!

Konteksti i përgjithshëm i kësaj, si edhe i shumë profecive të Jeremias, është pushtimi i afërt prej perandorit Nebukadnetsar dhe ushtrive babilonase. Kjo profeci e veçantë është një parashikim i të qarave dhe vajtimeve të Nënës Izrael, sepse në pak kohë, fëmijët e saj, d.m.th qytetarët e saj, ose do të masakrohen në vendin e tyre ose do të dëbohen në mërgim. Prandaj është para së gjithash një profeci e asaj që do të ngjasë në të ardhmen e afërt.

Sidoqoftë, gjëja më e rëndësishme për këtë profeci të Jeremia është që nga të gjitha anët, para dhe pas saj, Nënës Izrael i bëhet shumë herë thirrje të thajë lotët, sepse fëmijët e saj do të kthehen një ditë:

Kështu thotë Zoti: “Mbaje zërin tënd nga e qara, sytë e tu nga të derdhurit lot, sepse vepra jote do të shpërblehet”, thotë Zoti; “ata do të kthehen nga vendi i armikut. Ka shpresa për pasardhësit e tu”, thotë Zoti; “bijtë e tu do të kthehen brenda kufijve të tyre. (Jer 31:16–17)

Mbani mend sërish se në këtë pikë në profecinë e Jeremias, Rakela është një personifikim i kombit, i parë si Nëna Izrael. Profecia nuk po thotë që çdo nënë që i kanë vrrarë bijtë apo janë dëbuar prej babilonasve, do të gjejnë fëmijët e tyre kur të kthehen prej mërgimit. Ajo po thotë që Nëna Izrael, qytetarët e së cilës janë asgjësuar dhe shpërngulur prej babilonasve, do të shohë brezat e ardhshëm të qytetarëve të saj të kthehen tek ajo dhe ta ripopullojnë vendin e saj.

Mërgimi zgjati 70 vite siç tha edhe Jeremia se do të ndodhte (29:10); dhe pastaj profecia e kthimit të fëmijëve të Rakelës u përmbush – por vetëm pjesërisht. Kthimi në atë rast nuk shteri premtimet e ndritshme të kthimit final që jo vetëm Jeremia, por edhe Isaia dhe Ezekieli po ashtu, i kishin shprehur në emrin e Perëndisë (shih p.sh. pasazhe si këto Isa 35; Jer 32:36–41; 33:25–26; Ezek 36:16–37:28).

Prandaj me këtë, ne kthehemi tek e qara e prindërve në Betlehem prej masakrës së Herodit të foshnave. Ishte një shembull më shumë i Rakelës, Nënës Izrael, që qante e pangushëlluar për qytetarët e saj të vdekur; dhe në këtë kuptim

të termit, kjo “përmbushi” profecinë e Jeremias 31:15.

Por siç edhe te Jeremia 31:15 vajtimi i Rakelës ndiqet menjëherë me premtimin e kthimit nga mërgimi, po kështu te rrëfimi i Mateut, vajtimi i Rakelës ndiqet menjëherë me kthimin e Krishtit, me urdhër të Perëndisë, nga Egjipti për në tokën e Izraelit (Mat 2:19–21). Ky kthim do të ishte baza dhe garancia e kthimit final. Në përputhje me këtë, në këtë pikë të rrëfimit, Mateu flet për dy fazat e hershme të “ripushtimit” të tokës nga Krishti, që vijnë kthimin e tij nga Egjipti. Të dyja ato përmbushen profecitë e Dhiatës së Vjetër.

‘Ai do të quhet Nazareas’: përmbushja e treguesve të përgjithshëm profetikë për një Mesi të përbuzur

Kur Jozefi dhe Maria u kthyen me fëmijën Jezus sërish në vendin e Izraelit, që ende e rrezikshme ta kthenin në qytetin e vjetër të Davidit, Betlehemi i Judesë. Arkelau, biri jashtëzakonisht mizor i Herodit, ishte në fron në Jude; prandaj për asye sigurie fëmija u dërgua në Nazaret (Mat 2:19-23).

Nazareti, ndonëse ishte i sigurt, që një vend shumë i përbuzur dhe i parëndësishëm. Prandaj edhe përshkrimi, “Jezusi i Nazaretit,” që e ndoqi gjithë jetën ishte një nofkë përbuzjeje (shih, p.sh Gjoni 1:45–46).

Por vetë ky fakt, thotë Mateu, nuk kundërshton pohimin e Krishtit për të qenë Mesia i Izraelit, por e përforcon atë. Sepse ai përmbush parashikimin e përgjithshëm të profetëve të Izraelit që Mesia do të jetë së pari plotësisht i përbuzur (krh. Isa 53:3) dhe në paraqitje i parëndësishëm, një degëz e vogël prej rrënjëve të cungut të Jeseut (Isa 11:1).

‘Galileja e paganëve’: Përmbushja e Isaia 9:1–7

Vite më vonë, kur erdhi koha që Krishti të linte sigurinë e Nazaretit dhe të fillonte fazën e parë të “ripushtimit” të vendit të Izraelit, ai qëllimisht vendosi të shkojë, jo në Jerusalem, kryeqyteti i mbretërve të Judës, por në Galile, atë pjesë të vendit ku errësira shpirtërore që edhe më e madhe. Kjo gjithashtu ishte një strategji që Dhiata e Vjetër e kishte paraparë dhe parathënë:

Pastaj la Nazaretin dhe shkoi të banojë në Kapernaum, qytet bregdetar, në kufijtë të Zabulonit dhe të Neftalit, që të përmbushej çishte thënë nëpërmjet profetit Isaia kur tha: Toka e Zabulonit, toka e Neftalit, mbi bregun e detit, krahina përtej Jordanit, Galileja e paganëve, populli që dergjej në errësirë ka parë një dritë të madhe, dhe përmbi ata që dergjeshin në krahinë dhe në hijen e vdekjes, doli drita. (Mat 4:13–16)

Ishte, siç edhe e kemi thënë, vetëm faza e parë e “ripushtimit”. Përsa i përket mënyrës sesi do të arrihej ripushtimi i plotë dhe përfundimtar, dhe se çfarë profecish do të përmbusheshin në këtë proces, ne duhet t’ia lëmë Mateut dhe pjesës tjetër të Dhiatës së Re të na e thonë në raste të tjera. Për tani, ne duhet të kthehemi te dy kuptimet që mbeten të përmbushjes për të cilat flet Dhiata e Re.

Përmbushja e Ligjit nga Krishti

Është shkruar shumë për theksin që Zoti ynë i vuri faktit se nuk erdhi të anulojë Ligjin, por, e kundërta, erdhi ta përmbushë atë (Mat 5:17). Një shpjegim i shpeshtë që jepet është që ai e përmbushi Ligjin duke theksuar se thjesht të mos e kryesh një krim nuk mjafton të përmbushet ligji kundër vrasjes. Zemërimi që ushqehet në zemër, për shembull, është po aq vrasës edhe kur nuk shprehet në vëllavrasje të vërtetë. Padyshim që Zoti ynë theksoi se Ligji është shpirtëror dhe nuk përmbushet vetëm së jashtmi.

Por ky shpjegim i zakonshëm ka nevojë për disa shtesa. Krishti nuk tha: “Mos mendoni se unë erdha për të shfuqizuar Ligjin.” Ai tha: “Mos mendoni se unë erdha për të shfuqizuar ligjin ose profetët; unë nuk erdha për t’i shfuqizuar, po për t’i plotësuar.” Kjo na thotë qartas se duke përmendur Ligjin, ai nuk po mendonte thjesht 10 Urdhërimet. “Ligji”, kur lidhet me “Profetët”, nënkupton 5 librat e Moisiut, Toran; dhe Ligji dhe Profetët së bashku iu drejtohen dy ndarjeve të para të kanunit hebre. Fraza përsëritet edhe diku gjetkë te Mateu në këtë kuptim (shih 7:12; 11:13; 22:40).

Kjo do të thotë atëherë që Ligji që Krishti erdhi të përmbushë

përfshinte nevojën për sakrificat e kafshëve në tempull, ligjet e pastrimit ceremonial dhe ligjet e ushqimit. Krishti nuk i hodhi poshtë ato si të kota. Ai përmbushi kërkesat e tyre, duke ofruar veten si sakrifica e madhe për mëkatën. Por duke bërë kështu, ai i nxori jashtë loje këto sakrifica kafshësh. Edhe pse kur është errësirë nevojitet drita e një qiriu, kur dielli ndriçon botën me rrezet e tij, nuk na duhet më ai. Dielli e plotëson qëllimin për të cilin qiriri u shpik. Ligjet e ushqimeve të Dhiatës së Vjetër kishin kufizuar kontaktet shoqërore të Izraelit me johebrenjtë duke i mbrojtur, në këtë mënyrë, prej papastërtive – fizike, morale dhe shpirtërore – të shoqërisë pagane. Por pagëzimi që i bën Krishti popullit të vet në Frymë ditën e Rrëshajëve, dhe pas asaj, nuk la vend më për ligjet e ushqimeve; dhe vetë Perëndia i shfuqizoi ato (Veprat 10). Sepse tani të krishterët kishin një fuqi shumë më të madhe për t’i mbajur të shenjtë ndërsa shoqëroheshin lirisht me paganët në shtëpitë e tyre, dhe hanin në tavolinat e tyre, me qëllim që t’u predikonin ungjillin atyre.

Dhjetë Urdhërimet vetë nuk u mohuan nga Krishti, por u përkrahën; dhe për këtë arsye ato gjenden në letrat e Dhiatës së Re.⁵ Krishti ra dakort me rabinët e kohës së tij, dhe ata me të, që dy nga urdhërimet më të mëdhaja janë, së pari: “Duaje Zotin, Perëndinë tënd me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd dhe me gjithë mendjen tënde”; dhe, së dyti: “Duaje të afërmin tënd porsì vetveten”. Nga këto dy urdhërime, tha Krishti, varet i tërë ligji dhe profetët (Mat 22:37–40).

Por edhe këtu ai shkoi përtej bashkëkohësve të tij. Ai i nxiti ndjekësit e tij të duan jo vetëm të afërmit e tyre, por edhe armiqtë e tyre po ashtu, dhe të luten për ata që i përndjekin. Duke vepruar kështu, ata tregojnë se janë jo vetëm fëmijë moralë, por edhe fëmijë plotësisht të rritur dhe të pjekur të Atit të tyre, përfaqësues të denjë të përsosmërisë së tij (Mat 5:43–48). Përmbushja e ligjit mundet, në disa rrethana, të jetë një çështje nivelesh. Nuk mund të tolerosh të njëjtën sjellje njësoj si te një fëmijë në kopsht, siç ishte për shekuj fëmijëria shpirtërore e Izraelit (shih Gal 4:1–4), edhe te një i rritur. Sjellja dhe mësimi i

5 Shabati nuk bëhet më i detyrueshëm për besimtarët paganë. Ai nuk është një urdhërim moral. Krishti tha për Shabatin që këtë ditë priftërinjtë në tempull e shkelin dhe nuk bëjnë faj (Mat 12:5). Por nuk mund të thuhet e njëjta gjë për nëntë urdhërimet e tjera.

Krishtit qenë kopje të sakta të natyrës së Perëndisë. Ai sigurisht e përmbushi Ligjin dhe Profetët – madje edhe më shumë se kaq.

Përmbushja jonë e Ligjit

“Dashuria”, thotë Pali, “është përmbushja e ligjit” (Rom 13:10); dhe në këtë kontekst “përmbush” do të thotë thjesht të bësh atë që Ligji urdhëron dhe jo atë që ai ndalon. Është përdorur këtu në kuptimin e vet të zakonshëm dhe të parë. Sidoqoftë fraza e Palit, “dashuria është përmbushja e ligjit”, disa herë është keqkuptuar se do të thotë që, për aq kohë sa duam të afërmit tanë dhe veprojmë në dashuri, ne nuk duhet të drejtohem, aq më pak të kontrollohem, prej 10 urdhërimeve apo prej ndonjë rregulli apo norme tjetër.

Por rrjedha e argumentit të Palit në këtë pasazh tregon që kjo pikëpamje është e gabuar. Pali rreshton veprat dhe qëndrimet që Ligji ndalon, të cilat do të lëndonin të afërmin tonë; dhe pastaj përmbledh këto ndalime në fjalët e urdhërësive pozitive të Ligjit: “Duaje të afërmin tënd porsì vetveten”. Me fjalë të tjera dashuria e vërtetë ndaj të afërmit tënd do të thotë që të mos i bësh keq atij; dhe, për rrjedhojë, do të thotë t’u bindesh ndalesave të detajuara të gjërave që Perëndia deklaroi se do ta lëndojnë atë.

Kështu, atëherë, përdorimi i fjalës “përmbush” ka rëndësi për jetën tonë të përditshme, dhe nuk është i kufizuar te kuptimi i tij formal apo parësor si përmbushje e parashikimeve. Po ashtu ai përfshin përmbushjen e Ligjit nga Krishti me të gjitha gjërat që kjo nënkupton. Siç edhe e kemi trajtuar tani, Dhiata e Re flet për përmbushjen si shprehje finale, në nivelin më të lartë të mundshëm, e parimeve themeltare që janë shprehur në një nivel më të ulët përgjatë rrjedhës së historisë së Dhiatës së Vjetër. Në lidhje me këtë kuptim përmbushjeje, duhet theksuar një pikë finale për hatër të qartësisë në kapitujt që vijojnë.

Kuptimi i fjalës “prototip”

Përgjatë këtij kapitulli unë kam filluar të përdor termin *prototip*. Para se ta përdor atë sërish, dua të shpjegoj se çfarë kam

parasysh me të, dhe pse e përdor. Pse nuk jam i kënaqur me fjalën që përdoret zakonisht në këto kontekste, dmth *tip*?

Arsyeja ime e parë është që fjala greke τύπος (prej së cilës vjen fjala *tip ose lloj*) është përdorur në disa kuptime në Dhiatën e Re. Më poshtë vijojnë rastet që lidhen me subjektin e studimit tonë:

1. *Një shembull*: ose i mirë, si ai i Palit që duhet të ndiqet (Filip 3:17), ose i sjelljes së keqe, si ajo e izraelitëve në shkretëtirë që duhet shmangur (1 Kor 10:6, 11).

2. *Një model apo mostër*: sipas të cilit duhej ndërtuar diçka në përmasa të mëdha siç u bë me tabernakullin kur u ndoqën planet që Perëndia i tregoi Moisiut në Sinai (Heb 8:5).

3. *Një tip* (në kuptimin e zakonshëm teologjik): një person, send apo institucion që në një farë mënyre shërben si një version i së ardhmes. Kështu për Adamin thuhet se është “figura e atij që duhej të vinte” (Rom 5:14).

Bie lehtë në sy që kuptimet 1 dhe 3 janë shumë të ndryshme. Sjellja e keqe e izraelitëve në shkretëtirë nuk serviret si një model për sjelljen tonë, por si një shembull që duhet të shmanget. Sjellja e tyre nuk duhet të modelojë tonën dhe sjellja jonë nuk duhet të pasqyrojë të tyren. Nuk duhet të ketë ngjashmëri midis stilit të tyre të jetës dhe tonit; ndonëse, nëse ka patur, shembulli i tyre na paralajmëron që ne mund të pësojmë të njëjtat ndëshkime si ato të tyre (krh. 1 Kor 32–11:27).

Adami nga ana tjetër, që për shkak se ishte kreu i racës, dëmtoi, përmes aktit të tij të rebelimit, të gjithë ata që rrodhën prej tij, është një tip në një kuptim tjetër: ai është një version i Krishtit i cili, për shkak se është kreu i racës së re të burrave dhe grave të shpenguar, shpëton përmes aktit të tij të bindjes të gjithë ata që janë të përfshirë në atë (Rom 5:19). Në këtë drejtim (ndonëse jo në të tjerat) ngjashmëria mes Adamit dhe Krishtit është e qartë dhe e dukshme. Të theksosh këtë gjë, si bën edhe Pali, do të thotë të tregosh se rrugët e Perëndisë janë të drejta: nëse ne u lindëm mëkatarë jo për fajin tonë, por për atë që dikush tjetër bëri (Adami), tani ne shpallemi të drejtë para Perëndisë jo prej përpjekjeve tona, por prej veprës së dikujt tjetër (Krishtit).

Atëherë fjala *tip* është përdorur në kuptime të ndryshme brenda vetë Shkrimeve. Por në shtesë të kësaj, duhet të dimë

që në ligjëratën e përditshme, fjala “tip” nuk ka në vetvete të gjitha këto përdorime të vetë Shkrimit. P.sh njerëzit shpesh thonë që tabernakulli i Moisiut, priftëria dhe ritualet e tij, ishin një tip i Krishtit, i sakrificës dhe shërbesës së tij. Në kuptimin që ata i veshin kjo është plotësisht e vërtetë. Po ashtu, ata thonë se Krishti, sakrifica dhe shërbesa e tij, janë ‘antitipe’ (Anglisht: antitypes), dmth, realitete për të cilat tabernakulli ishte vetëm një tip. Sërish, në kuptimin që ata i veshin termit, kjo është e vërtetë, por kjo nuk është mënyra se si Dhiata e Re i përdor këto terma në këto raste: në gjuhën e Dhiatës së Re, tabernakulli nuk është τύπος (tipos), por është vetë një ἀντίτυπος (antitipos). Te Hebrenjve 8:5 τύπος (ALB: shembull) është fjala e përdorur që i referohet planimetrisë së tabernakullit që Perëndia i tregoi Moisiut mbi Malin Sinai. Pastaj, teksti i referohet tabernakullit të ndërtuar sipas kësaj planimetrie, një ἀντίτυπος (ALB: shëmbëllesë) e tabernakullit të vërtetë qiellor (Heb 9:24).

Kështu, për momentin dhe për disa kapituj të tjerë në vijim, me qëllim që të shmangim konfuzionin, nuk do të përdor fjalën “tip”, ndonëse besoj fort në tipologjinë si një mënyrë e vlefshme për të shtjelluar Dhiatën e Vjetër. Kur do të përshkruaj një mënyrë të veçantë në të cilën Dhiata e Re trajton ngjarje dhe persona të caktuar në Dhiatën e Vjetër, do të përdor termin *prototip*, por jo në kuptimin e një origjinali të përsosur apo kryetipi prej të cilit të gjithë shembujt e tjerë rrjedhin. Unë do ta përdor atë në kuptimin që ne i japim kur themi që çdo aeroplan i hershëm qe një prototip i aeroplanëve tanë modernë të sofistikuar. Aeroplanët e hershëm qenë sajesa primitive dhe shpesh kishin defekte. Sigurisht që ndryshojnë në shumë aspekte me avionin modern reaktiv. Por pavarësisht primitivitetit të tyre, ata trupëzonin të njëjtat parime të aerodinamikës që ende ndiqen sot, ndonëse tani ato shprehen me sofistikim të madh, në një nivel më të lartë tek avionët reaktivë. Në të njëjtën mënyrë, kur ne lexojmë jetët e burrave të Dhiatës së Vjetër si Abrahami, Moisiu, Davidi, ne i shohim shumë qartë gabimet dhe dështimet e tyre të cilat Shkrimet i dokumentojnë me ndershmëri të madhe. Por ne gjithashtu mund të shohim që në jetët e tyre veprojnë parime që, më vonë, shihen se veprojnë më plotësisht, në një nivel më të lartë të ungjillit të zbuluar prej Krishtit, dhe, në të vërtetë në

nivelin më të lartë, në personin, jetën dhe punën e vetë Zotit. Prandaj ne do t'i quajmë ato ngjarje dhe persona historikë të mëparshëm jo *tipe*, por *prototipe*.

...

Pyetjet e studimit për këtë kapitull mund t'i gjeni
në faqen 434.

KATEGORIA E DYTË
Koncepte ligjore

8

Jurisprudenca: precedent dhe analogji ligjore*Shembuj të Romakëve 3–4*

Materiali i Dhiatës së Vjetër është shumë i larmishëm. Një pjesë e tij është poezi, një pjesë është prozë. Një pjesë histori, një pjesë profeci. Një pjesë përmban tregime, një pjesë fjalë të urta popullore. Një pjesë oshëtin nga psalmet e lavdisë, një pjesë vajton me kuje të hidhura. Një libër është në thelb histori dashurie. Por pasazhe të tjera, ndryshe nga këto, merren me ligje të hollësishme dhe praktika të shëndosha ligjore. Në këtë kapitull, dhe dy të tjerët që vijojnë, ne do të merremi me materialin e kësaj kategorie të fundit dhe interpretimin e saj në Dhiatën e Re.

Për disa njerëz sot mund të tingëllojë e çuditshme apo madje e papranueshme nëse thekson, siç do të bëjmë këtu, anën ligjore të shpëtimit tonë të krishterë. Ata e pranojnë lirisht që Dhiata e Vjetër është plot me ligje; por pikërisht këtu, thonë ata, qëndron dallimi mes Dhiatës së Vjetër dhe së Resë. Ligji dhe ligjshmëria sunduan në të Vjetrën¹; në kontrast me të,

¹ Ata duket se harrojnë pasazhet e Dhiatës së Vjetër që flasin për mëshirën dhe dashurinë e Perëndisë: p.sh. Eksod 34:6–7; Ps 103:8–18.

e Reja dallohet prej hirit që Perëndia u jep pa dallim të gjithë mëkatarëve. Le të marrim si shembull babanë të shëmbëlltyra e Birit Plangprishës. Kur plangprishësi u kthye në shtëpi, babai vrapoi ta takonte, e puthi, e veshi, i vendosi një unazë në gisht dhe këpucë në këmbë, dhe festoi kthimin e tij në shtëpi me një banket të kushtueshëm. Aty nuk flitet asgjë për ligjin dhe drejtësinë apo për ndëshkimin e merituar që duhet dhënë. Asgjë përveçse mëshirës së pamasë dhe faljes. Prandaj, të përdorësh gjuhën e gjykatave për të përshkruar marrëdhënien tonë me Krijuesin tonë, sugjerojnë ata, do të thotë të fusësh një disonancë të madhe të Dhiatës së Vjetër në muzikën e krishterë të hirit të pakushtëzuar të Perëndisë.

Gjithashtu, një letër e njohur e Dhiatës së Re flet me entuziazëm të dallueshëm për “hirin me tepri” të Perëndisë. I përshkruan besimtarët si “hyrës të hiri”, dhe “qëndrojnë në hir”, dhe “të shfajësuar nga hiri”, dhe se nuk janë nën ligj, por nën hir². Por është pikërisht e njëjta letër e Palit drejtuar Romakëve që këmbëngul për themelin ligjor të shpëtimit tonë të krishterë. Në të vërtetë ajo mëson se është pikërisht sfondi i këtij themeli ligjor që zmadhon hirin e Perëndisë.

Tani, kjo ndodh sepse Dhiata e Re beson me gjithë zemrën e saj që ligji i shpallur në Dhiatën e Vjetër u dha prej Perëndisë, dhe ishte shprehje e karakterit të tij të shenjtë. Prandaj në mënyrë të kuptueshme, ajo këmbëngul që shpëtimi ynë, duke dalë prej të njëjtit Perëndi, nuk mund të nëpërkëmbë apo shkelë ligjin: nuk mund ta hedhë poshtë atë. Për rrjedhojë, duke shpjeguar në detaje parimet mbi të cilat mbështetet doktrina e krishterë e shpëtimit, Dhiata e Re, përgjatë shtjellimit të saj, i drejtohet ende Dhiatës së Vjetër si autoritetit të saj ligjor.

Prandaj, qëllimi ynë kryesor në këta kapituj është të shqyrtojmë kategoritë ligjore nën të cilat Dhiata e Re përmend autoritetin e Dhiatës së Vjetër në përkrahje të parimeve të saj të shpëtimit. Me qëllim që të kuptojmë më saktësisht këto kategori ligjore, ne do të fillojmë duke i kujtuar vetes sesi Dhiata e Re shtjellon drejtësinë e ungjillit të saj. Ne do t'i japim vëmendje të veçantë rastit të Abrahamit kur Dhiata e Re e përmend si një

² Rom 3:24; 5:2, 20; 6:14. Letrat e tjera thonë të njëjtën gjë: p.sh. Efes 1:7; 2:7–8.

precedent ligjor për parimin e shfajësimit prej besimit.

Nevoja e Dhiatës së Re për të shtjelluar drejtësinë e ungjillit të saj

Merrni në shqyrtim atë që Pali ka shkruar te Letra e Romakëve:

Por ne e dimë se gjithçka që thotë ligji, e thotë për ata që janë nën ligj, me qëllim që çdo gojë të heshtë dhe gjithë bota të jetë nënshtruar gjykimit të Perëndisë, sepse asnjë mish nuk do të shfajësohet para tij për veprat e ligjit; me anë të ligjit në fakt arrihet njohja e mëkatit. Por tani, pavarësisht nga ligji, është manifestuar drejtësia e Perëndisë, për të cilën dëshmojnë ligji dhe profetët, madje drejtësia e Perëndisë nëpërmjet besimit në Jezu Krishtin për të gjithë e mbi të gjithë ata që besojnë, sepse nuk ka dallim; sepse të gjithë mëkatuan dhe u privuan nga lavdia e Perëndisë, por janë shfajësuar falas me anë të hirit të tij, nëpërmjet shpengimit që është në Krishtin Jezus. Atë ka paracaktuar Perëndia për të bërë shlyerjen nëpërmjet besimit në gjakun e tij, për të treguar kështu drejtësinë e tij për faljen e mëkateve, që janë kryer më parë gjatë kohës së durimit të Perëndisë, për të treguar drejtësinë e tij në kohën e tanishme, me qëllim që ai të jetë i drejtë dhe shfajësues i atij që ka besimin e Jezusit. (Rom 3:19–26)

Gjëja e parë që duhet të vëmë re në këtë pasazh është termi që përdoret për të përshkruar aktin e madh shpëtues të Perëndisë kundrejt mëkatarit: ai është “shfajësues i atij që ka besimin e Jezusit” (v. 26).

“Të shfajësosh” është një term ligjor, siç edhe e shohim prej udhëzimeve të dhëna gjykatësve në Dhiatën e Vjetër:

Në rast se fillon një grindje midis burrave dhe ata paraqiten në gjyq, gjykatësit do t'i gjykojnë *duke i dhënë pafajësinë* (duke shfajësuar) të pafajshmit dhe duke dënuar fajtorin. (LiP 25:1)

Isaia nga ana e tij denoncon gjykatësit që marrin rryshfet për të shtrembëruar drejtësinë. Ata “që e nxjerrin të pafajshëm

(shfajësojnë) njeriun e keq për një dhuratë dhe ia mohojnë të drejtën e tij!” (Isa 5:23).

Në pasazhe si këto, “të shfajësosh” nuk do të thotë “që të bësh dikë të drejtë”, por “të shpallësh dikë të pafajshëm”. Kur gjykatësit “shfajësojnë të drejtin”, nuk është çështje e të bërit të drejtë njeriun e drejtë. Ai njeri ishte i drejtë që në fillim; d.m.th ai është pala e pafajshme. Ai nuk qe fajtor. Puna e gjykatësve ishte thjesht ta shpallnin atë të pafajshëm. Po ashtu, nëse një gjykatës i korruptuar shfajësonte një njeri të lig, vendimi i gjykatësit nuk e shndërronte njeriun e lig praktikisht në njeri të drejtë dhe të ndershëm. Ai thjesht shpallte, kundër çdo prove dhe të vërtete, që njeriu i lig ishte “i pafajshëm”, “jo fajtor”, “në të drejtën e tij”.³

Duke qenë kështu, është e kuptueshme që kur njerëzit u përballën me ungjillin e krishterë për herë të parë, shumë prej tyre u skandalizuan. Ende skandalizohen! Sepse Dhiata e Re shpall që Perëndia “shfajëson të paudhin” (Rom 4:5)! Me fjalë të tjera, duket sikur Perëndia po bën pikërisht atë që ua ka ndaluar gjykatësve njerëzorë të bëjnë. Nuk është për t’u çuditur nëse bashkëkohësit hebrenj të Palit, dhe madje edhe disa prej atyre që besonin se Jezusi ishte Mesia (shih Veprat 15:1–5), u tërbuan. Ata kishin një ndjenjë se ungjilli i krishterë ishte një shtrembërim i drejtësisë dhe moralit, një përbuzje e ligjeve të Perëndisë, dhe që përmbyste çdo gjë që përfaqësonte Dhiata e Vjetër. Mbi çfarë bazash mundëj Perëndia të shfajësonte atë që besonte në Jezusin? Pali kishte nevojë të jepte ca shpjegime për këtë punë.

Çfarë nuk mund të jetë në themel të shfajësimit të Perëndisë

Shfajësimi nuk mund të mbështetet në përpjekjet më të mira të dikujt për të zbatuar sa më mirë ligjin e Perëndisë. Arsyeja për këtë vjen prej qëllimit themeltar për të cilin ligji u dha.

³ Një shembull tjetër, tërësisht i ndryshëm, i “shfajësimit” në kuptimin “të shpallësh dikë të ketë të drejtë” dhe jo “të bësh dikë të drejtë” shih Luka 7:29.

Qëllimi i ligjit

Të gjithë do të binin dakort që ligji ishte një udhëzues i shkëlqyer, i dhënë prej Perëndisë, për jetën. Sa më shumë ta zbaton atë, aq më mirë do të jetoje (Lev 18:5). Por megjithëse ishte kështu, ligji nuk u dha asnjëherë, thotë Dhiata e Re, me qëllimin që, duke e zbatuar atë, apo duke u përpjekur për ta zbatuar atë, ne mëkatarët të pranojmë nga Perëndia.

Ky dallim është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Le të përdorim një analogji. Është e vërtetë që sa më shumë të mësojë një fëmijë, aq më shumë nota të mira do të marrë në provimet e tij. Prandaj prindërit do t'i nxisin fëmijët që të mësojnë shumë. Por asnjë prind, të paktën ata të arsyeshmit, nuk do t'i nxisin fëmijët të mësojnë me kushtin që nëse nuk i nxjerr të gjitha provimet me dhjetë, ata do ta mohojnë si fëmijën e tyre në zemërimin e tyre.

Në kontrast me këtë, ligji i Perëndisë është një kërkesë e vazhdueshme për përsosmëri. Mos këmbëngul në të gjitha gjërat që ai poroset (LiP 27:26; Gal 3:10), shkel një nga urdhërimet e tij, dhe do ta kuptosh që ligji, jo më përsosmërisht i plotë, është thyer (Jak.2:10). Prandaj, realisht, Perëndia kurrë nuk e dha ligjin e tij që, duke e zbatuar atë, ne mëkatarët të pranojmë një ditë prej tij. E kundërta është e vërtetë: “Por ne e dimë se gjithçka që thotë ligji, e thotë për ata që janë nën ligj, me qëllim që çdo gojë të heshtë dhe gjithë bota t'i jetë nënshtruar gjykimit të Perëndisë.” (Rom 3:19), d.m.th. janë fajtorë dhe nën rrezikun e zemërimit të Perëndisë, pa patur ndonjë gjë për të thënë në mbrojtje të vetes. (Meqë ra fjala, kjo është ajo që Dhiata e Re ka parasysh kur flet për pendesën ndaj Perëndisë, Veprat 20:21). Dhe përderisa ky është qëllimi i ligjit, edhe efekti i tij i synuar vjen rrjedhimisht.

Efekti i ligjit

Vjen një moment kur ata, që e marrin ligjin seriozisht, kuptojnë se “asnjë mish nuk do të shfaqet para tij për veprat e ligjit”. Psalmisti i Dhiatës së Vjetër e kishte kuptuar që prej shumë kohësh këtë: “Mos hyr në gjyq me shërbëtorin tënd, sepse asnjë i gjallë nuk do të jetë i drejtë para teje.” (Ps 143:2). Ky

ndërgjegjësim vjen sepse, siç edhe Pali shpjegon (Rom 3:20), “me anë të ligjit në fakt arrihet njohja e mëkatit” – dhe ai e thotë këtë nisur nga përvoja e tij që e paraqet me hollësi te Romakëve 7:7-24. Mbetet fakt që sa më shumë ta marrim seriozisht mbajtjen e standartit të tij të përsosmërisë, aq më shumë ndërgjegjësohemi për natyrën tonë mëkatore. Ne mund të themi që ligji është si një termometër: na detyron të përballemi me faktin se kemi temperaturë të lartë dhe jemi sëmurë rëndë; por nuk mund të na shërojë. Nuk ishte ky qëllimi për të cilin u krijua. Përdorimi i tij i vërtetë është të na nxisë të shkojmë te një doktor i mirë që mund të na shërojë. Prandaj, sipas Dhiatës së Re (Gal 3:24), qëllimi i vërtetë i ligjit është të na ndërgjegjësojë për natyrën tonë mëkatore dhe të na shtyjë kështu te Krishti, që ai të na shpëtojë.

Cili është themeli i shfaqjesimit prej Perëndisë?

Tani le të shqyrtojmë bazat mbi të cilat Perëndia mund të mbetet i drejtë edhe pse shfaqeson mëkatarin. Sepse Pali parashtron disa të vërteta pozitive rreth drejtësisë së Perëndisë (Rom 3:21–26).

Shfaqësimi manifestohet “i ndarë nga ligji”

Ai nuk manifestohet pjesërisht mbi bazat e të zbatuarit të ligjit të Perëndisë dhe pjesërisht mbi bazat e sakrificës së Krishtit. As nuk manifestohet se Krishti na jep hir dhe forcë për të zbatuar ligjin mjaftueshëm për të na kualifikuar në të qenit i pranuar prej Perëndisë. Shfaqësimi ynë para Perëndisë duhet të jetë, dhe është, i ndarë nga ligji në tërësi.

Shfaqësimi është “një drejtësi e Perëndisë”

Kjo do të thotë që është një status i drejtë që na është dhënë prej Perëndisë; jo një drejtësi “e jona” që ne e kemi fituar përmes veprave tona (krh. Filip 3:9).

Ai merret përmes besimit në Jezus Krisht

Shfaqësimi është “drejtësia e Perëndisë nëpërmjet besimit në Jezu Krishtin për të gjithë e mbi të gjithë ata që besojnë” (Rom 3:22).

Shfajësimi u jepet pa dallime të gjithë atyre që besojnë

Të gjithë jemi njësoj në këtë që “të gjithë mëkatuan në të shkuarën dhe ende janë të privuar nga lavdia e Perëndisë” sado pak apo shumë; dhe të gjithë janë njësoj po ashtu në këtë: që ata munden, nëse dëshirojnë, të shfajësohen prej hirit të Perëndisë.

Ai jepet si një dhuratë falas

Ne jemi të shfajësuar falas (greqisht: δωρεάν), d.m.th. pa ndonjë shkak nga ana jonë, pa bërë ne vetë ndonjë gjë që ta meritojmë këtë. Krahasoni përdorimin nga ana e Krishtit e të njëjtit term te Gjoni 15:25. Duke komentuar për bashkëkohësit e tij, ai thotë: “Më kanë urreyer *pa shkak*” (greqisht: δωρεάν), d.m.th. pa bërë diçka që të meritojë urrejtje. Kështu shfajësimi ynë prej Perëndisë është plotësisht një akt i hirit të tij, pavarësisht meritave tona dhe me gjithë faktin e defektit tonë në thelb.

Ai është “nëpërmjet shpengimit që është në Krishtin Jezus”

Vetë Perëndia e ka ofruar Zotin Jezus si një sakrificë shlyese për mëkatet tona. Kjo nuk nënkupton që mëkati ynë nuk ka rëndësi, nuk nënkupton që ai anashkaloi ligjin ose uli standartet e tij, përkundrazi, Krishti, përmes sakrificës së tij, e ka *forcuar* ligjin, ka paguar ndëshkimin e plotë që ligji kërkonte për mëkatin tonë, plotësoi zemërimin e drejtë të Perëndisë kundër mëkatit, dhe ka përligjur kështu shenjtërinë e Perëndisë. Kështu, duke qenë se dikush tjetër ka paguar për ndëshkimin e ligjit, nuk mbetet më ndëshkim për t’u paguar; dhe kjo e bën të mundur për Perëndinë të nxjerrë të pafajshëm, të shfajësojë plotësisht, të gjithë ata që kanë besim të Jezusi, pa ulur standartet e drejtësisë së tij qoftë edhe një pikë.

Përgjatë shekujve, shumë kohë më para kryqit të Krishtit, besimtarët u mësuan të ofronin kafshë të pafajshme për mëkatet e tyre. Dukshëm, ato sakrifica nuk mund të paguanin ndëshkimin e vërtetë për mëkatin. Ato ishin vetëm simbole të pranuar të mëkatit, dhe shenja për pagesën e vërtetë. Si mundej Perëndia të justifikonte durimin e tij duke mos kërkuar ndëshkimin e vërtetë për mëkatin prej këtyre besimtarëve? Përgjigjja, sipas Dhiatës së Re, është se durimi i tij justifikohet prej sakrificës së

Krishtit, i cili ka paguar në të vërtetë ndëshkimin që sakrificat e kafshëve thjesht sa e simbolizonin (Rom 3:25).

Atëherë, Perëndia nuk është vetëm i dashur dhe i duruar, por edhe i drejtë. Jo vetëm që është i drejtë, por ai e ka shfaqur haptazi dhe publikisht drejtësinë e tij në shfajësimin e atyre që kanë besim te Jezusi. Përderisa Krishti ka paguar ndëshkimin për mëkatin e tyre, është plotësisht e drejtë që Perëndia t’i shpallë të pafajshëm. Në fakt do të ishte e padrejtë nga ana e Perëndisë, nëse ai, pasi hodhi mbi Krishtin paudhësitë e tyre, duke e ndëshkuar Krishtin për ato (Isa 10 ,53:6), t’i ndëshkonte edhe ata pastaj për të njëjtat mëkate!

Kështu, deri tani, Dhiata e Re ka argumentuar që sakrifica e Krishtit na tregon Perëndinë i cili është i drejtë kur shfajëson besimtarin. Tani ajo vazhdon të justifikojë pohimin e vet se besimtari e merr këtë “drejtësi të Perëndisë” përmes besimit dhe jo përmes veprave të ligjit (Rom 3:28).

Shfajësimi prej besimit është një parim shumë i shëndoshë

Ka tri arsye që shtjellohen te Romakëve 3:27–31 si përfitime të këtij parimi.

Përrjashton çdo lloj mburrjeje

Nëse mund të fitojmë shfajësimin para Perëndisë përmes veprave të ligjit, atëherë siguria jonë do të mbështetet mbi veprat tona, dhe ne mund të mburremi në arritjet tona. Nga ana tjetër, nëse drejtësia është përmes ligjit, atëherë Krishti ka vdekur më kot thotë Dhiata e Re: ne mund të ishim shfajësuar pa vdekjen e tij dhe hiri i Perëndisë jepet më kot (Gal 2:21). Duke qenë kështu, ne jemi shfajësuar prej besimit; dhe kjo përrjashton çdo mburrje, sepse në këtë rast besimi është e kundërta e veprave. Veprat janë ato që *ne bëjmë*; besimi është të besosh në Perëndinë dhe të mbështetesh plotësisht mbi atë që *Krishti ka bërë*.

Barazon të gjithë njerëzit qofshin hebrenj apo johebrej

Nga pikëpamja fetare, hebrenjtë ishin popull i privilegjuar, të zgjedhur prej Perëndisë për të dëshmuar për të vetmin Perëndi

të vërtetë në një botë që, në tërësi, i qe dorëzuar idhujtarisë (për një listë të privilegjeve të tyre shih Rom. 5-9:1). Por privilegjet e tyre nuk mund t'i shpëtonin ata, dhe as nuk mund të jepnin ndonjë lloj kontributi për shpëtimin e tyre. Po të ishte kështu, do të ishte një padrejtësi e madhe në kurriz të kombeve të tjera. Realisht, pavarësisht privilegjeve të tyre, hebrenjtë, si çdokush tjetër, mëkatuan dhe kishin nevojë për shpëtim; dhe kjo i bëri të barabartë me johebrejtë. Duke qenë se shfajësimi është prej besimit dhe jo prej veprave të ligjit, kjo e bën shpëtimin të mundur njësoj qoftë për johebrejtë, qoftë për hebrenjtë dhe mbi të njëjtat kushte.

Është i vetmi parim që përforcon ligjin

Ka një mendim të përhapur që supozon se e vetmja mënyrë për të ruajtur autoritetin e ligjit të Perëndisë është të këmbëngulësh se, në fund të fundit, shpëtimi varet jo vetëm nga sakrifica e Krishtit, por edhe në një masë të konsiderueshme nga veprat tona. Nëse, sipas këtij mendimi, në ditën e gjykimit veprat tona do të kenë qenë mjaft të mira, ne do të shpëtohem; nëse jo, ne do të dënohem.

Problemi me këtë teori është që askush nuk mund të thotë se çfarë nënkuptojmë me "mjaft të mira". Kjo teori në mënyrë të pashmangshme mbështetet mbi shpresën se, nëse kemi bërë më të mirën tonë, ciladoqoftë ajo, Perëndia do tregohet i mëshirshëm, do të bëjë lëshime për mospërputhjen e dukshme dhe serioze mes arritjeve tona dhe standarteve të ligjit të tij të shenjtë, dhe do të na pranojë në qiellin e tij.

Por kjo do të thotë që në fund, kërkesat e vetë ligjit të Perëndisë nuk plotësohen, por anashkalohen; që dëshimet tona mëkatore tolerohen dhe nuk trajtohen ashtu si duhet. Ky nuk është "forcim i ligjit", por, përkundrazi, është shkelje e tij. Vetëm shfajësimi përmes besimit në sakrificën shlyese të Krishtit mund të mbështesë ligjin sipas standarteve të drejtësisë së Perëndisë.

Kjo do hidhte poshtë deklaratën e Palit rreth parimeve mbi të cilat, sipas ungjillit të krishterë, shfajësimi u ofrohet gjithë njerëzimit. Por Pali e dinte prej predikimit në sinagogat hebraike dhe prej debateve të ngritura mes pjesëtarëve hebrenj të kishave

të hershme të krishterë, se sa e çuditshme dhe e vështirë ishte të pranohej teza e tij. Është e rrënjësuar në mendjen fetare të njeriut të thjeshtë që, disi dhe diku përgjatë procesit të shfajësimit dhe pranimi nga Perëndia, diçka, qoftë edhe pjesërisht, duhet të varet nga veprat tona. Tani, që të përballej me kundërshtimet e tyre, Pali i drejtohet Dhiatës së Vjetër dhe citon rastin e Abrahamit.

Rasti i Abrahamit – një precedent ligjor

Pali fillon citatin e tij (Rom 4:1-5) duke pyetur se cila ishte tamam përvoja e Abrahamit: a u shfajësua ai prej veprave apo prej besimit? Nëse prej veprave, argumenton Pali, ai mund të ishte mburrur për arritjet e tij para bashkëkohësve të vet dhe gjatë gjithë brezave në vijim, siç edhe bëri vetë Pali në ditët kur nuk ishte bërë ende besimtar (Fil 3:4-7). Por një lloj mburrjeje e tillë prej anës së Abrahamit është e pamundur. Pse? Sepse Pali thekson se Perëndia në fjalën e tij e ka bërë të njohur për botën mbi çfarë kushtesh e shfajësoi Abrahamin: "ai i besoi Zotit, që ia vuri (d.m.th. besimin e tij) në llogari të drejtësisë" (Zan 15:6).

Prandaj është jashtëzakonisht e rëndësishme të dallosh sesi Pali po e trajton Dhiatën e Vjetër këtu. Ai nuk po e spiritualizon një histori nga Dhiata e Vjetër, as nuk po e trajton atë si një lloj hijeje apo alegorie. Ai po citon rastin e një personi të vërtetë dhe historik, të quajtur Abraham, dhe po citon një deklaratë autoritare dhe të frymëzuar nga Shkrimet si bazë mbi të cilën Abrahami është shfajësuar. Pali argumenton që, nëse drejtësia para Perëndisë iu llogarit një njeriu, Abrahamit, mbi bazat e besimit dhe jo të veprave, atëherë kjo ka themeluar një precedent të përhershëm ligjor. Prandaj kushdo që dëshiron të shpallet i drejtë para Perëndisë, mund dhe duhet të shfajësohet sipas të njëjtit parim që u shfajësua edhe Abrahami.

Për më tepër, ngaqë rasti i Abrahamit përbën një precedent ligjor, Pali tregohet menjëherë i kujdesshëm për të ilustruar dallimin thelbësor në këtë kontekst mes veprave dhe besimit. Dhe jo më kot; sepse ende sot shumë njerëz mendojnë që besimi dhe veprat janë të lidhura ngushtë bashkë si binjakë siamezë. Nëse njëra përmendet, kuptohet që tjetra nënkuptohet. "Të

shfajësuar nga besimi” dhe “të shfajësuar nga veprat” ata mendojnë që janë një gjë e vetme dhe e njëjtë. Prandaj shprehen duke thënë që kanë besim të madh se veprat që bëjnë, do të jenë të mjaftueshme për të qenë të pranuar nga Perëndia në fund.

Por Pali thotë që jo; në kontekstin e shfajësimit të mëkatarit nga Perëndia, veprat dhe besimi janë të kundërta me njëra-tjetrën. Nëse ne duhet ta fitonim shfajësimin prej Perëndisë me anë të veprave tona, atëherë pasi t’i kemi bërë veprat, Perëndia do të jetë në borxh me ne dhe i detyruar të na shfajësojë. Nuk do të jetë më një çështje hiri nga ana e tij për të na shfajësuar, ashtu si nuk do të ishte një akt hiri dhënia e pagës nga ana e punëdhënësit punëtorëve që e kanë merituar përmes punës.

Në kontrast me këtë, shfajësimi nga besimi përfshin një qëndrim shumë të ndryshëm ndaj Perëndisë. Do të thotë të pranojmë verdiktitin e Perëndisë se nuk jemi të perëndishëm. Do të thotë që, për shkak të asaj që Krishti ka bërë, Perëndia mund të na shfajësojë ne ndonëse nuk jemi të perëndishëm. Pastaj do të thotë që të besojmë te Perëndia dhe të mbështetemi plotësisht tek ai, që të bëjë pikërisht këtë për ne përmes hirit të tij të pafund.

Një provë më shumë në favor të argumentit të Palit

Ka dy figura madhore që hedhin hijen e tyre mbi historinë e Izraelit: Abrahami, ati i kombit, dhe Davidi, themeluesi i një dinastie mbretërore të tij. Historia e Abrahamit ishte themeltare për kombin, dhe Pali sapo ka argumentuar se në rastin e tij ishte çështje e një drejtësie pozitive që iu njoh atij. Besimi i plotë dhe varësia nga Perëndia, si ajo që Abrahami tregoi, është mbi të gjitha qëndrimi i duhur që krijesa duhet të mbajë kundrejt Krijuesit të tij.

Por tani Pali përmend rastin e atij personazhi tjetër themeltar, Davidit (Rom 4:6–8); dhe këtë herë është një shembull i aspektit negativ të shfajësimit: fshirja e mëkateve të shkuara dhe shpallja e verdiktit: “Nuk dënohet, shfajësohet, falet”. Pali citon deklaratën e vetë Davidit për këtë situatë:

Lum ai të cilit i kanë falur shkeljen, ai të cilit i kanë mbuluar mëkatin! Lum ai njeri të cilin Zoti nuk e padit

për paudhësi dhe në frymën e të cilit nuk ka vend mashtrimi. (Ps 32:1–2)

Davidi nuk përmend asnjë punë të ligjit që iu desh të bënte për të fituar këtë falje. Gjithçka që bëri ishte vetëm të mos fshihte më mëkatin e tij, dhe haptazi të rrëfente fajin e tij:

Para teje pranova mëkatin tim, nuk e fsheha paudhësinë time. Thashë: “Do tia rrëfej shkeljet e mia Zotit”, dhe ti e ke falur paudhësinë e mëkatit tim. (Ps 32:5)

Prandaj Pali e përmend këtë rast, jo thjesht si një regjistrim të një përvojë interesante të dikujt, por si një precedent ligjor shtesë që themelon për të gjitha kohët bazën mbi të cilën Perëndia fal dhe shfajëson përmes besimit dhe jo veprave.

Renditja kronologjike e rrethprerjes së Abrahamit dhe shfajësimit i tij.

Deri tani, duke diskutuar rastin e Abrahamit, Pali ka cituar vetëm një varg: “Dhe ai i besoi Zotit, që ia vuri në llogari të drejtësisë.” (Zan 15:6). Prandaj kundërshtarët e tij mund të kenë menduar se ata kishin para vetes një çështje të lehtë për t’u përgjigjur. Qoftë Abrahami, qoftë Davidi iu nënshtroan ligjit të rrethprerjes. Prandaj, të argumentojë vetëm mbi bazën e Zan. 15:6 se drejtësia iu njoh Abrahamit vetëm mbi bazën e besimit, ishte e gabuar. Të dyja këto raste – ajo e Abrahamit dhe e Davidit – tregojnë, sipas tyre, që është ende e vërtetë se “Nëse nuk jeni rrethprerë sipas ritit të Moisiut, nuk mund të shpëtoheni” (Veprat 15:1).

Pali iu përgjigjet duke theksuar renditjen kronologjike të rrethprerjes së Abrahamit të regjistruar në Bibël (Rom 4:9–12). “Sepse ne themi se besimi iu numërua Abrahamit si drejtësi. Në çmënyrë, pra, iu numërua? Kur ai ishte i rrethprerë apo i parrethprerë? Jo ndërsa ishte i rrethprerë, por kur ishte i parrethprerë. (Rom 4:9–10). Sipas Zanafillës, sekuenca e ngjarjeve që e tillë:

1. Abrahami i besoi Perëndisë dhe iu numërua për drejtësi (Zan 15:6).

2. Ca kohë më vonë, kur Abrahmi ishte 86 vjeç, biri i tij Ismaeli u lind (16:16).
3. Kur ishte 99 vjeç, ai dhe Ismaeli bashkë u urdhëruan nga Perëndia të rrethpriteshin (17:23–24).

Prandaj mbetet fakt historik se Abrahamit iu numërua për drejtësi besimi i tij më shumë se 13 vjet para se të rrethpritej dhe realisht u deshën të kalonin 13 vite që të përmendej rrethprerja. Duke argumentuar si një jurist, dhe me të drejtë, Pali thekson rrjedhojat ligjore të kësaj renditjeje: nëse drejtësia iu numërua Abrahamit para se të rrethpritej, rrethprerja nuk mund të ketë qenë një parakusht i domosdoshëm për drejtësinë që i ishte njohur atij. Dhe nëse nuk qe e tillë për këtë rast, atëherë, nëse Perëndia nuk ka ndryshuar, nuk ka qenë e tillë as në rastin e Davidit dhe as do të jetë e tillë në rastin e dikujt tjetër. Rrethprerja që Abrahami mori si vulë 13 vjet më vonë, ishte një vulë drejtësie e besimit që ai e kishte patur ndërsa qe i parrethprerë sipas Palit – një simbol, vulë, por jo një parakusht. (Rom 4:11).

Për më tepër, rasti i Abrahamit hodhi bazat e një precedenti ligjor për të gjithë pasardhësit e Abrahamit. Ata i rrethpritnin meshkujt tetë ditë pas lindjes. Por kur u falën dhe u shfajësuan, si Davidi, kjo u bë jo mbi baza të rrethrerjes së tyre – rrethprerja nuk ka kontribuar ndonjëherë për shpëtimin e njerëzve – por mbi bazat që ata ecën në hapat e besimit të atit tonë Abraham, të cilin e kishte kur ishte “i parrethprerë” (Rom 4:12).

Premtimi i trashëgimisë së botës

Por ndoshta, edhe në këtë fazë në argumentimin tonë, mund të ketë mbetur në mendjet tona një hije dyshimi: a nuk po ngre Pali një argument të madh mbi një varg të vogël, Zanafilla 15:6, që është nxjerrë jashtë kontekstit?

Përgjigjja është: aspak. Sepse te Romakëve 4:13-16 ai vazhdon të theksojë që, në vetë kontekstin në të cilin thuhet se Abrahami i besoi Perëndisë dhe iu numërua për drejtësi, Perëndia i premtoi Abrahamit se do t'i jepte atij dhe farës së tij një trashëgimi të madhe, dhe e garantoi përmbushjen e këtij premtimi duke e ligjëruar përmes një besëlidhjeje. Ne do ta studiojmë atë besëlidhje te Kapitulli 10, prandaj gjithçka që

mund të themi për atë premtim dhe besëlidhje tani është ajo që Pali po thotë këtu te Romakëve 4:13: Perëndia e bëri atë besëlidhje me Abrahamin dhe farën e tij para se Abrahami të rrethpritej; dhe bekimet që ajo garantonte se do t'i jepeshin Abrahamit dhe farës së tij nuk qenë të kushtëzuara paraprakisht nga zbatimi apo jo i ligjit, por mbi bazën e besimit, dhe, mbi të gjitha, mbi bazën e hirit të pamerituar të Perëndisë. Vetëm mbi atë bazë mund të garantohej përmbushja e premtimit: “Prandaj trashëgimia është nëpërmjet besimit; në këtë mënyrë ajo është nëpërmjet hirit, me qëllim që premtimi të jetë i siguruar për të gjithë pasardhësit, jo vetëm për atë që është nga ligji, por edhe për atë që vjen nga besimi i Abrahamit ...” (Rom 4:16).

Natyra e besimit të Abrahamit

Sidoqoftë, Palit nuk i shpëton nga ana ligjore fakti që, nëse do të deduktojmë prej Zanafillës 15:6 se drejtësia iu numërua Abrahamit vetëm mbi bazën e besimit, do bënte mirë të përkufizonte se çfarë do të thotë të besosh në këtë kontekst. Ai e bën këtë, jo duke dhënë një përkufizim personal të besimit, por duke iu drejtuar vetë historisë në vijim te Zanafilla për të treguar se çfarë do të thoshte “të besojë në Perëndinë” për Abrahamin (Rom 22–4:17).

Tani premtimi i veçantë ndaj të cilit po reagonte Abrahami, kur ai i besoi Zotit dhe kjo iu numërua për drejtësi, ishte se Perëndia do t'i jepte atij një bir dhe trashëgimtar, dhe, përmes atij biri, pasardhës të shumë si yjet (Zan 15:2-6). Në atë kohë Abrahami ishte pa fëmijë për një arsye të thjeshtë se Sarah, gruaja e tij, qe shterpë; por ai ende mund të bënte fëmijë. Dhe ndodhi që Sarah dhe ai u bindën bashkarisht se t'i besojë fjalës dhe premtimit të Perëndisë, do të thoshte që të bënin të pamundurën dhe të përdornin burimet e tyre për të përmbushur premtimin e Perëndisë. Prandaj me sugjerimin e Sarës, Abrahami u bashkua me Agarin, skllaven e Sarës dhe u bë me një bir nga ajo, Ismaelin. Por Perëndia nuk do të binte dakort që ky ishte pikërisht kuptimi i premtimit të tij.

Trembëdhjetë vjet më vonë Perëndia ende nuk e kishte përmbushur premtimin e tij; dhe tani, jo vetëm që Sara ishte shterpë, por edhe trupi i Abrahamit ishte i plakur dhe nuk

mund të bënte fëmijë. Abrahami i sugjeroi Perëndisë që ndoshta tani ai do të pranonte ta quante Ismaelin si birin e premtuar. Por Perëndia ende refuzoi dhe thjesht përsëriti premtimin, duke i siguruar Abrahamin dhe Sarën që ai do të përmbushej shumë shpejt (Zan 17:15-19). Në këtë pikë të historisë do të ishte mirë të citonim plotësisht komentën e Palit; do të shohim se është plotësisht e qartë ajo që Pali nënkupton përmes “besimit”, kur ai thotë që Abrahami u shfajësua prej besimit.

. . . ati i të gjithë neve para Perëndisë që ai besoi, i cili i jep jetë të vdekurve dhe thërret gjërat që nuk janë sikur të ishin. Ai, duke shpresuar kundër çdo shprese, besoi për t'u bërë ati i shumë kombeve sipas asaj që i ishte thënë: Kështu do të jetë pasardhja jote. Dhe, duke mos qenë aspak i dobët në besim, nuk i kushtoi kujdes trupit të tij, i bërë tashmë si i vdekur (ishte pothuaj njëqind vjeç) as barkut të vdekur të Sarës. Madje as nuk dyshoi nga mosbesimi në lidhje me premtimin e Perëndisë, por u përforcua në besim duke i dhënë lavdi Perëndisë, plotësisht i bindur se atë që ai kishte premtuar ishte edhe i fuqishëm ta bënte. Prandaj edhe kjo iu numërua atij për drejtësi. (Rom 4:17–22)

Prandaj besimi i Abrahamit nuk qe një rrëfim kalimtar besimi, i bërë në nxitim, por diçka që dukej shumë i largët me kalimin e viteve. Ai qe një besim i gjallë, këmbëngulës, vazhdimisht në përtëritje dhe i ankoruar në karakterin e Perëndisë së gjallë. Besim do të thoshte t'i besojë një Perëndie i cili, kur të gjitha burimet dhe përpjekjet njerëzore dështonin dhe dorëzoheshin, mund ta bënte dhe do ta bënte atë që kishte premtuar që nga fillimi se do të bënte, të sillte jetë prej vdekjes.

Analogjia mes besimit të Abrahamit dhe tonit dhe rëndësia praktike e tij

Palit i mbetej edhe një hap më shumë për të hedhur nëse do të donte të nguliste argumentin e tij se shfajësimi i Abrahamit përmes besimit përbënte një precedent ligjor, edhe për ne që jemi shfajësuar njësoj përmes besimit (Rom 4:23–25). Abrahami u thirr të besonte që Perëndia do t'i jepte atij dhe Sarës një

bir (dhe pas kësaj turme pasardhësish) edhe ndonëse ai ishte i plakur dhe gruaja e tij shterpë. Por, sigurisht, neve vetë nuk na kërkohet të besojmë që Perëndia do të na japë në mënyrë mbinatyrore një fëmijë kur jemi të plakur apo shterpë apo kur i kemi të dyja këto kushte bashkë. Si mund të ketë ngjashmëri mes besimit të Abrahamit dhe tonit?

Përgjigjja e Palit është që ka një analogji të ngushtë mes besimit të Abrahamit dhe tonit. Abrahami duhej të besonte te një Perëndi që mund të nxirrte jetë prej vdekjes. Ne po ashtu, që të jemi të shfajësuar, duhet “të besojmë në atë që ka ringjallur prej të vdekurve Jezusin, Zotin tonë, i cili u dha për shkak të fyerjeve tona dhe u ringjall për justifikimin tonë.” (4:24–25).

Kjo analogji është shumë udhëzuese dhe e dobishme. Shumë njerëz nuk kanë paqe me Perëndinë, sepse keqkuptojnë se çfarë do të thotë “me anë të besimit” kur Shkrimet thonë: “Të shfajësuar, pra, me anë të besimit, kemi paqe me Perëndinë” (5:1). Ata kanë lexuar për besimin në lidhje me gjëra të tjera në Dhiatën e Re ku njerëzit qortohen për besimin e tyre të pakët; dhe fillojnë të arsyetojnë me veten e tyre që arsyeja pse nuk kanë paqe me Perëndinë është se besimi i tyre nuk është mjaftueshëm i fortë. Pastaj ata përfytyrojnë se besimi i tyre është një lloj veprë që duhet të arrijë një shkallë standarte para se të vlejë për shfajësimin dhe paqen; apo se është një lloj force e cila, po të prodhojë mjaftueshëm fuqi të matshme nga një manometër shpirtëror, do të sjellë shfajësimin, por në të kundërt nuk ndodh asgjë.

Por kjo nuk është ajo që do të thotë “besim” në kontekstin e shfajësimit, siç edhe e tregon shumë qartë analogjia mes besimit të Abrahamit dhe tonit. Abrahami u shfajësua kur ai i besoi Perëndisë që tha se mundej të sillte, dhe në fakt do të sillte, jetë prej vdekjes. Nuk qe besimi i Abrahamit që prodhoi mrekullinë: vite të tëra të kaluara në besim dhe shpresë bënë që trupi i tij t'i afrohej vdekjes më shumë. Ishte Perëndia ai që kreu mrekullinë. Po ashtu, ne jemi të shfajësuar kur besojmë në Perëndinë që ngjalli Zotin Jezus nga të vdekurit. Nuk ishte besimi ynë, i fortë apo i dobët qoftë, që ngjalli Zotin Jezus prej së vdekurish: ishte Perëndia që e bëri këtë.

Mendoni të pamundurën për një moment. Përfytyroni sikur

jemi duke qëndruar me apostujt përreth varrit të Krishtit para se trupi i tij të ngjallet prej së vdekuri. Vazhdoni të përfytyroni sikur e kuptojmë se trupi i Krishtit është në varr për shkak se ai vdiq për mëkatet tona; dhe vetëm po të ngjallet prej së vdekurish, do të ketë shfajësim për ne: përndryshe do të mbetemi ku jemi, të pafalur dhe nën zemërimin e Perëndisë (1 Kor 15:17). Duke kuptuar seriozitetin e situatës, ne i themi njëri-tjetrit: “Ja, le të kapemi për dore rreth e rrotull varrit dhe të besojmë sa më shumë që të mundemi. Sepse vetëm po të arrijmë të besojmë mjaftueshëm, besimi ynë do të bëjë që trupi i Zotit të ngjallet prej varrit, dhe ne mund të jemi kështu të sigurt që jemi të shfajësuar dhe në paqe me Perëndinë.”

A do ta nxirrte Jezusin prej varrit forca e besimit tonë? Natyrisht që jo. Vetë kjo ide është groteske. Ngjallja e Krishtit që diçka që shtrihej përtej çdo veprë që mund të realizojë fuqia njerëzore. Vetëm Perëndia mund ta bënte këtë. Nëse Perëndia nuk do ta kishte bërë, nuk do të kishte ndonjë ungjill që ne ta besonim (1 Kor 17–15:14). Prandaj, për ne, besim do të thotë të besosh se Perëndia ka bërë atë që ne nuk mund ta bëjmë ndonjëherë vetë, duke ngjallur Krishtin prej së vdekurish, dhe pastaj të mbështetemi plotësisht mbi këtë gjë dhe mbi domethënien e saj: për hatër të shkeljeve tona Perëndia ia dorëzoi sanksioneve të ligjit Birin e tij; prandaj Krishti vdiq dhe u varros. Por pastaj Perëndia e ngjalli atë prej së vdekurish për shfajësimin tonë duke shpallur kështu se Perëndia është i kënaqur me sakrificën e Birit të tij në favor tonë; dhe të gjithë ata që i besojnë atij janë të shfajësuar plotësisht dhe përgjithmonë (Veprat 13:38).

Një fjalë përmbyllëse

Ndërsa kemi shqyrtuar shkurtimisht mënyrën si Dhiata e Re shtjellon drejtësinë e ungjillit të saj, kemi vënë re që Pali ka theksuar shumë Zanafillën 15:6 – “Abrahami i besoi Zotit, që ia vuri në llogari të drejtësisë.” Pali e ka theksuar shumë faktin se ajo që iu numërua atij si drejtësi, nuk ishte ndonjë punë që ai kishte bërë, por besimi i tij në Zotin.

Por një frazë e ngjashme është përdorur te Psalmi 106:30–

31 për Fineasin, priftin: “Por Fineasi u ngrit dhe bëri drejtësi; dhe murtaja pushoi. Dhe kjo iu vu në llogari të drejtësisë, brez pas brezi, përjetë.” Këtu nuk bëhet fjalë për besimin e Fineasit te Perëndia, por për veprën e tij të zbatimit të zemërimit të Perëndisë dhe të largimit të epidemisë që iu numërua për drejtësi. Prandaj lind pyetja: si t’i lidhim këto dy deklarata në mendjet tona, kur njëra thotë se ishte besimi dhe jo veprat dhe tjetra thotë se ishte vepra që iu numërua për drejtësi?

Gjëja më e mirë për t’u bërë në këtë rast është të fillojmë me Fineasin dhe të pyesim se çfarë bëri ai, pse iu numërua për drejtësi, dhe si e shpërbleu Perëndia për këtë.

Situata që e tillë – izraelitët kishin kryer kurvëri dhe idhujtari me gratë moabite, dhe, për pasojë, Perëndia kishte dërguar një epidemi vdekjeprurëse në Izrael. Në mes të kësaj fatkeqësie një princ izraelit futi një grua midianite në fushimin e tyre, duke u kapardisur me kurvërinë e tij idhujtare në sy të të gjithë asamblesë, të Moisiut dhe të vetë Perëndisë. Prandaj prifti Fineas, mori një ushtë dhe i shpoi tej e tej edhe burrin, edhe gruan.

Padyshim që ishte një veprim i rëndë; por Perëndia e shpalli të ishte i drejtë dhe i duhur. Fineasi kishte shprehur në mënyrë të përsosur xhelozinë e Perëndisë dhe kishte bërë kështu shlyerjen për popullin, kishte larguar zemërimin e Perëndisë dhe kishte bërë të pushonte epidemia. Ai nuk ishte thjesht një prift vetëm me emër; përmes veprimeve të tij ai e kishte shfaqur veten si një prift të vërtetë mes Perëndisë dhe njerëzve të tij. Prandaj shpërblimi që mori prej Perëndisë për veprimin e tij, nuk ishte shfajësimi në kuptimin e të qenit i shpëtuar, por një priftëri e përhershme (shih Num 25:1–15).

Kësaj i referohet Psalmi 106:30–31 kur komenton: “kjo iu vu në llogari të drejtësisë, brez pas brezi, përjetë.” Me veprën e tij, ai vertetoi pretendimin e tij për të qenë një prift. Perëndia e aprovoi këtë veprim dhe e shpalli si të drejtë. Ishte një rast i shlyerjes me anë të veprave.

Mbetet e vërtetë që në rastin e Abrahamit, nuk ishte ndonjë veprë e tij, por vetë besimi i tij në Perëndinë që iu numërua për drejtësi; dhe ajo që ai mori si rezultat nuk ishte priftëria, por një marrëdhënie e drejtë me Perëndinë, shfajësimi në kuptimin e të

qenit i shpëtuar.

Po ashtu është e vërtetë që më vonë Abrahami u shfajësua përmes veprave të tij kur e ofroi birin e tij Isak mbi altar (shih Jak 2:21–24). Ne do të diskutojmë sakrificën e tij të Isakut gjërësisht në Pjesën e Tretë, kapitulli 23. Mjafton të themi këtu se ajo që kjo sakrificë demonstronte ishte se besimi i Abrahamit që plotësisht dhe thellësisht te Perëndia, dhe jo te dikush tjetër, jo te vetja, madje as tek Isaku. Me fjalë të tjera vepra e Abrahamit tregonte që besimi i tij te Perëndia ishte i vërtetë: Abrahami ishte një besimtar i vërtetë.

...

Pyetjet e studimit për këtë kapitull mund t'i gjeni
në faqen 435.

9

Rrjedhimi ligjor, paradigma ligjore, synimi i ligjit

Në këtë kapitull do të studiojmë tri mjete të tjera që Dhiata e Re përdor në interpretimin e saj të Dhiatës së Vjetër: rrjedhimi ligjor, paradigma ligjore, synimi i ligjit.

Rrjedhimi ligjore

Dhiata e Re argumenton disa herë se nëse një ligj zbatohet specifikisht për një gjë apo situatë të vogël, përmes një rrjedhoje logjike, ai duhet të gjejë akoma më shumë zbatim për gjëra apo situata më të mëdha, edhe pse nuk përmenden specifikisht prej atij ligji. Ky argument ngjason me formën *a minore ad maius* – (nga më e vogla tek e madhja). Kaq i zakonshëm dhe i natyrshëm është ky lloj përfundimi logjik, sa që rabinët hebrenj e quajtën formalisht *qal wahomer*, ‘e lehta dhe e rënda’; dhe ai po ashtu u pranua nga juristët klasikë grekë dhe romakë (me sa duket, prej të cilëve rabinët e morën këtë emërtim formal) si një metodë e pranueshme dhe realisht e domosdoshme për të interpretuar ligjin e tyre. Ja ku janë tre shembuj:

Në lidhje me ligjin e Shabatit dhe shërbimin (Mat. 12:1–8)

Zoti përdori këtë lloj argumentimi për të justifikuar dishepujt e

tij kur ata u qortuan se po korrnin dhe shkoqnin drith me duart e veta ditën e Shtunë:

Apo nuk keni lexuar në ligj që në tempull, të shtunave, priftërinjtë e shkelin të shtunën dhe megjithatë nuk mëkatojnë? Dhe unë po ju them se këtu është një më i madh se tempulli. (Mat 12:5–6)

Me fjalë të tjera, nëse Ligji autorizonte posaçërisht – në të vërtetë urdhëronte – priftërinjtë të punonin në tempull të Shtunave, ndonëse kjo e shkelte Shabatit, sepse ata po punonin në tempull dhe për tempullin, aq më tepër (*a fortiori*) duhet të jetë e drejtë për dishepujt të thyejnë Shabatit, përderisa ata po punonin për dikë që ishte më i madh se tempulli.

Në lidhje me ligjin e Shabatit dhe shërimin (Gjoni 7:23–24)

Në qoftë se një njeri merr rrethprerjen të shtunën, që të mos shkelet ligji i Moisiut, ju zemëroheni kundër meje sepse shërova tërësisht një njeri të shtunën? Mos gjykoni sipas pamjes së jashtme, por gjykoni sipas drejtësisë! (Gjoni 7:23–24)

Rabinët mësonin që kryerja e rrethprerjes e bënte dikë të plotë nga ana ceremoniale. Prandaj nuk përbënte shkelje të ligjit të Shabatit bërja e këtij operimi të vogël nga ana e njeriut. Aq më tepër, argumentoi Krishti, shërimi i plotë i dikujt në të shtunën, jo thjesht në sipërfaqe si *ceremoni* por në të vërtetë, duhet të vlerësohet si diçka që nuk e shkel ligjin e Shabatit.

Në lidhje me pohimin e Krishtit se ishte Biri i Perëndisë (Gjoni 10:34–36)

Jezusi u përgjigj atyre: A nuk është shkruar në ligjin tuaj: “Unë thashë: Ju jeni perëndi”? Nëse ai i quan perëndi ata, të cilëve u qe drejtuar fjala e Perëndisë (dhe Shkrimi nuk mund të bjerë poshtë), ju thoni se ai, që Ati e ka shenjtëruar dhe e ka dërguar në botë,

blasfemon, sepse ka thënë: “Unë jam Biri i Perëndisë”?
(Gjoni 10:34–36)

Citati është marrë nga Psalmi 82:6; dhe argumenti është: nëse sipas Shkrimeve disa qenie të thjeshta njerëzore, pa blasfemuar, mund të quhen me të drejtë në njëfarë mënyre, “perëndi”, aq më tepër nuk do të ishte blasfemi për dikë, që Ati e ka shenjtëruar dhe dërguar në botë, të pohonte se ishte Biri i Perëndisë në kuptimin e plotë të këtij termi.

Paradigma ligjore

Përveç përfundimeve logjike, Dhiata e Re, ashtu si rabinët hebrej, përdor edhe një parim ca më të ndryshëm në interpretimin e Dhiatës së Vjetër: ajo argumenton se një pjesë e ligjeve të Dh.V. ishin paradigma ligjore. Ideja është që Perëndia, Ligjdhënësi, nuk synoi të mbulonte çdo rast të mundshëm të një parimi të caktuar sjelljesh duke dhënë ligje veçanërisht për secilën prej tyre. Përkundrazi, Ligjdhënësi parashtronte një urdhërim specifik, që mbulonte një situatë të caktuar, duke patur si qëllim që parimi i përgjithshëm i mishëruar në këtë situatë të caktuar dhe ligji që e trajtonte atë, duhet të gjente zbatim me të njëjtin autoritet për të gjitha situatat e ngjashme apo korresponduese. Këtë lloj urdhërimi specifik ne e quajmë paradigmë, sepse ai parashtron një shembull që duhet të ndiqet në të gjitha situatat.

Nuk duhet të jetë e vështirë për të kuptuar urtësinë e Ligjdhënësit kur udhëzon popullie tij përmes këtyre paradigmeve. Para së gjithash, një kod ligjesh, që përpiquej të mbulonte çdo situatë të përfytyrueshme përmes ligjeve specifike të posaçme, do të ndërlikohej shumë dhe do të bëhej kaba. Së dyti, dhënia e një shembulli konkret, si shprehje praktike e një parimi të përgjithshëm, është shpesh një mënyrë më e mirë për të ndihmuar njerëzit të kapin parimin e përgjithshëm, dhe pastaj ta zbatojnë atë në raste të tjera. Një deklaratë e gjatë dhe tërësisht e ndërlikuar për një parim të përgjithshëm, e bashkuar me një terminologji ligjore abstrakte, do të ishte më e vështirë për t’u kuptuar dhe për t’u zbatuar.

Përdorimi i një ligji të Dhiatës së Vjetër si paradigmë ligjore nga ana e Palit

Te Ligji i Përtërirë 25:4 Perëndia na ka dhënë një urdhërim të qartë dhe të posaçëm: “Nuk do të vësh turizën kaut që shin grurin.” Duke cituar këtë urdhërim tek 1 Korintasve 9:8-10, Pali argumenton se Perëndia synoi që të zbatohet jo vetëm, apo kryesisht, për qetë dhe të zotët e tyre, por për apostujt, ungjilltarët, pastorët, mësuesit dhe besimtarët: “Apo e thotë këtë për ne?” (1 Kor. 9:10)

Arsyetimi pas pohimit të Palit është mjaft i qartë. Së pari, qetë pluguan, korrën dhe shinë drithin; punëtorët e krishterë pluguan, mbollën dhe sollën të korra; qetë materialisht, të tjerët metaforikisht; por, përveç kësaj, puna mbetet e njëjtë (1 Kor -3:6 8; krh Gjoni 38–4:35; Mat 30–13:3).

Së dyti, thelbi dhe qëllimi i urdhërimit fillestar dhe i zbatimit që Pali i bën, mbeten të njëjtë. Ligji - “Nuk do të vësh turizën kaut që shin grurin.” (LiP 25:4) nuk ishte për vetë qetë: ishte një detyrim për njerëzit që përfitonin nga puna e tyre. Ata nuk duhet të pengonin kaun të ulte kokën herë pas here për të ngrënë ca nga drithi që po shinte, duke shijuar edhe ai një pjesë nga përfitimi i punës që bënte. Po ashtu, kur Pali përmbledh dhe aplikon të njëjtin parim dhe qëllim themeltar të pranishëm në urdhërimin fillestar, ai e shpreh atë në këtë mënyrë: “kush lëron duhet të lërojë me shpresë, dhe kush shin, duhet të shijë me shpresë që të marrë atë që shpreson.”¹ Faza “duhet” në këtë deklaratë, si edhe ka vënë në dukje Bengeli, nuk e vë përgjegjësinë mbi lëruenin dhe shirësin, por mbi personin për të cilin ata punojnë.² Pali nuk po thotë që punëtori i krishterë duhet të shpresojë se detyrimisht do të shpërblehet për punën që bën. Ai po thotë se ata, për të cilët ai po punon, e kanë për detyrë të sigurojnë që ai të ketë mundësi për të patur fitime materiale prej rezultateve të punës së tij. Ata nuk duhet t’ia privojnë këtë shpërblim, aq sa nuk duhet të privohet kau prej drithit nga i zoti i tij.

1 Përkthimet që e përkthejnë me fjalën “bujku”, frazën “kush lëron”, dhe jo me fjalën “lërueni” errësojnë faktin që, sipas Palit, ky parim themeltar gjen zbatim të njëjtë si te rasti i kaut, ashtu edhe tek ai i punëtorit të krishterë.

2 Bengel, *Gnomon*, 3:261.

Të dyja këto raste përputhen plotësisht. Prandaj është tërësisht e arsyeshme për Palin të deklarojë që vetë Ligjdhënësi, që nga fillimi, ka patur si qëllim që parimi i deklaruar për rastin e kaut të zbatohet në të gjitha rastet e ngjashme, duke përfshirë veçanërisht atë të punëtorit të krishterë dhe kishave. Të paktën asnjë jurist grek apo romak nuk do ta konsideronte këtë interpretim si të paarsyeshëm apo fantastik³.

Kundërshtime ndaj këtij përdorimi nga ana e Palit

Disa studiues kanë një tendencë të vështirësojnë gjërat rreth këtij pasazhi. Së pari ata këmbëngulin se përgjigja ndaj pyetjes retorike të Palit: “A u merrka Perëndia me qetë, vallë?” (1 Kor 9:9) është një mohim i prerë: “Perëndia nuk merret fare me qetë!” Por deklarata të tjera të ngjashme gjetkë, mund të provohen se nuk nënkuptojnë mohime të prera. P.sh. Romakëve 14:17 (“sepse mbretëria e Perëndisë nuk është të ngrënët dhe të pirët, por drejtësia, paqja dhe gëzimi në Frymën e Shenjtë.”) nuk ka për qëllim të mohojë faktin që mbretëria e Perëndisë nuk merret me çështjet e grykësisë dhe dehjes, por vetëm me drejtësinë, gëzimin dhe paqen. Ajo që ka dashur të thotë është se, në mbretërinë e Perëndisë, çështjet e të ngrënët dhe të pirit nuk janë aq shumë parësore sa janë drejtësia, paqja dhe gëzimi në Frymën e Shenjtë.

Ata këmbëngulin ta përkthejnë frazën tjetër të Palit “apo e thotë këtë për ne?” si “a e thotë këtë tërësisht për ne?” Në të vërtetë fjala greke kyç *πάντως* nuk do të thotë domosdoshmërisht “tërësisht”, por mund të ketë kuptimin “sigurisht” (krh. Luka 4:23 *πάντως ἐρεῖται*: ‘me siguri ju do të më përmendni’). Të dyja frazat mund të përkthehen si “Pse vetëm me qetë merret Perëndia? Sigurisht ai e thotë këtë për ne, apo jo? Po, për ne...”.

Por pasi këmbëngulin që t’i interpretojnë fjalët e Palit sikur thotë se Perëndia nuk kujdeset fare për qetë, ata e akuzojnë atë se ka mohuar haptazi dhe qartazi kuptimin e synuar të urdhërimit fillestar, dhe i ka veshur atij një kuptim që kurrë nuk synohej t’i vishej.

3 Për një diskutim të dobishëm të qëndrimeve të juristëve romakë ndaj 12 pllakave në krahasim me qëndrimet e rabinëve ndaj ligjit të Moisiut, shih D. Daube, ‘Rabbinic Methods’, 239–64.

Duke pranuar këtë përkthim “të prerë”, studiues të tjerë janë përpjekur të shmangin rrjedhimet e papëlqyeshme duke sugjeruar se në LiP 25:4 urdhërimi u dha fillimisht në kuptim metaforik dhe jo të drejtpërdrejtë. Por kjo nuk pi ujë. E gjithë forca e ndalimit të lidhjes së gojës së një kau metaforik, do të varej nga një fakt tjetër që e paraprinte atë; se lidhja e gojës së një kau të vërtetë konsiderohej diçka mizore dhe e paligjshme; prandaj në këtë rast ligji natyrshëm do të kuptohej se së pari zbatohet në kuptim të fjalëpërfjalshëm dhe pastaj në atë metaforik.

Kanë qenë më pranë së vërtetës sugjerimet që urdhërimi fillestar kishte të bënte qysh nga fillimi me faktin se, kushdo që punëson punëtorë, qofshin kafshë apo njerëz, dhe përfiton prej mundit të tyre, duhet të njohë të drejtën që punëtori gëzon për pjesën që i takon nga prodhimi. Në rastin aktual Pali thjesht po u bën thirrje të krishterëve në Korint që të kenë të njëjtën ndjenjë detyre ndaj atyre që u shërbenin. Gjë e cila vjen shumë afër vlerësimit që i kemi bërë ne se urdhërimi fillestar është dhënë për të qenë një paradigmë ligjore.⁴

Synimi i ligjit

Përveç rrjedhjes logjike dhe paradigmës ligjore, Dhiata e Re ngre po ashtu këtë parim të tretë ligjor. Shqyrtoni rrjedhojat e fjalëve të Zotit tonë:

Pastaj u tha atyre: ‘E shtuna është bërë për njeriun dhe jo njeriu për të shtunën.’ (Marku 2:27)

Këtu Krishti ngriti çështjen se cili ishte qëllimi i caktuar i ligjit të Shabatit. Njeriu nuk u krijua për të qenë një lloj krijese racionale që t’i imponohej të respektohte Shabatit që tashmë ekzistonte. E kundërta që e vërtetë. Njeriu u krijua së pari dhe pastaj pushimi i Shabatit u caktua për të mirën e njeriut. Do të ishte në kundërshtim me qëllimin e Shabatit, nëse imponimi i tij do të lëndonte një qenie njerëzore. Kufizimi i shpejtësisë është i detyrueshëm në qytete që të parandalojë aksidentet dhe të shpëtojë jetë njerëzish. Por nëse ambulanca po sjell një

4 Shih këtë përmbledhje të dobishme nga Moo, ‘Sensus Plenior’, 189

pacient në gjendje kritike në spital me maksimum të shpejtësisë, do të ishte në kundërshtim me synimin e ligjit të kërkoje që ata të ngadalësonin shpejtësinë. Bëje këtë, dhe pacienti mund të humbasë jetën e tij para se të mbërrijë në spital.

Në një Shabat, një grua, të cilën Satani e kishte lidhur për 18 vjet, hyri në një sinagogë. Krishti e çliroi atë. Drejtuesi i sinagogës e kritikoi Jezusin se kishte thyer Shabatin. Por të mbaje ligjin e Shabatit, do të thoshte ta lejoje gruan në pushtetin e Satanit akoma edhe një ditë më shumë; gjë që do të ishte një shtrembërim i synimit të ligjit. Krishti e qortoi publikisht drejtuesin për këtë (Luka 13:10–17).

...
Pyetjet e studimit për këtë kapitull mund t'i gjeni
në faqen 435.

10

Interpretimi i besëlidhjeve ligjore

Te GALATASVE 3:29 Pali shpall atë që është e vërtetë për të gjithë besimtarët në Krishtin, qofshin hebrenj apo johebrej, skllevër apo të lirë, meshkuj apo femra: “në qoftë se jeni të Krishtit, jeni pra pasardhja e Abrahamit dhe trashëgimtarë sipas premtimit.” Çdokush që e beson këtë – dhe të gjithë të krishterët duhet ta besojnë – mund t’i bëjnë vetes pyetjet e mëposhtme:

1. Si mund të quhen nga fara e Abrahamit të krishterët johebrej? Në fund të fundit pse ka rëndësi nëse janë apo jo nga fara e Abrahamit?
2. Tek e fundit, çfarë do të thotë termi “farë”?
3. Çfarë na qenka kjo lloj trashëgimie që ata do të gëzojnë?
4. Thuhet se “janë trashëgimtarë sipas premtimit”. Cili është premtimi? Më e rëndësishmja, ç’lloj premtimi qenka ky? Premtimet bëhen në dy lloje: me kushte apo pa kushte. Për cilin nga këta bëhet fjalë këtu?

Përgjigjja për këtë pyetje të katërt është: premtimi i një trashëgime, që Perëndia i bëri Abrahamit, është garanci se do të përmbushet përmes një besëlidhjeje të pathyeshme. Detajet, qoftë të premtimit, qoftë të besëlidhjes, jepen te Zanafilla 15:1-21.¹

Prandaj detyra jonë është të shqyrtojmë sesi Dhiata e

¹ Këto detaje jepen në të njëjtin kapitull dhe në të njëjtin kontekst që shpallet parimi i justifikimit përmes besimit për të gjitha kohët.

Re e interpreton këtë besëlidhje. Sidoqoftë, për ta bërë këtë si duhet, e kemi për detyrë të kalojmë kohë në shqyrtimin e kësaj besëlidhjeje në sfondin e ngushtë të kontekstit të saj në Dhiatën e Vjetër. Pastaj na duhet të studiojmë natyrën e saktë dhe statusin ligjor të besëlidhjes. Pasi ta kemi bërë këtë, do të kemi një themel të shëndoshë për të shqyrtuar interpretimin që i bën Pali kuptimit të saktë të terminologjisë, të cilën besëlidhja e përdor për të specifikuar qoftë përfituesit nën besëlidhjen apo qoftë përfitimet që kanë ata prej saj. Ndërsa e bëjmë këtë, do ta kemi të domosdoshme të bëjmë pyetje që shtrohen në lidhje me besëlidhjen e bërë në Sinai. Atëherë ne mund të shqyrtojmë forcën dhe funksionin që kjo besëlidhje, sipas Palit, kishte për qëllim të ushtronte në lidhje me historinë e mëvonshme të pasardhësve të Abramit, dhe madje të të gjithë botës. Në fund fare do të nxjerrim konkluzione përsa i përket domethënies së këtyre pikave, ashtu siç janë shfaqur në besëlidhjen e re për të cilën Krishti është ndërmjetës dhe garantues.

Sfondi dhe konteksti i ngushtë i besëlidhjes në Dhiatën e Vjetër

Ja me çfarë fjalësh është shprehur thirrja dhe mandati i Abrahamit nga Perëndia:

Por Zoti i tha Abramit: “Largohu nga vendi yt, nga të afërmit e tu dhe nga shtëpia e babait tënd, dhe *shko në vendin që do të të tregoj*. Unë prej teje do të bëj një komb të madh, do të të bekoj dhe do ta bëj të madh emrin tënd, dhe ti do të jesh një bekim. Dhe unë do të bekoj të gjithë ata që do të të bekojnë dhe do të mallkoj ata që do të të mallkojnë, te ti do të jenë të bekuara tërë familjet e tokës.” (Zan 12:1-3)

Dua që ta përmend kalimthi se qëllimi afatgjatë i Perëndisë në zgjedhjen e Abramit për të qenë themeluesi i një kombi të ri, dhe me premtimin për t’i dhënë atij dhe pasardhësve të tij një vend të tyrin, kishte për qëllim final bekimin e të gjitha kombeve të tokës. Kjo shpesh është lënë në harresë; vetë Izraeli e harroi shpesh atë. Por Pali, në interpretimin e tij të besëlidhjes,

do t'i drejtohet kësaj lidhjeje të qëllimshme mes trashëgimisë së premtuar Izraelit dhe bekimit të të gjithë kombeve (Gal 3:8–14). Kur Abrahami shkeli për herë të parë në Kanaan (Zan 12:5), ne lexojmë se Zoti iu shfaq atij dhe i tha: “Unë do t'ia jap këtë vend pasardhësve të tu” (Zan 12:7)

Më vonë Perëndia e përsëriti edhe njëherë këtë premtim:

Dhe Zoti i tha Abramit, mbas ndarjes së Lotit prej tij: “Ço tani sytë e tu dhe shiko nga vendi ku je drejt veriut e jugut; drejt lindjes dhe perëndimit. *Tërë vendin që sheh, unë do të ta jap ty dhe pasardhësve të tu, për gjithnjë.* Dhe do ti bëj pasardhësit e tu si pluhurin e tokës; prandaj nëse dikush mund të llogarisë pluhurin e tokës, do të mund të llogarisë edhe pasardhësit e tu. Çohu në këmbë, bjeri rreth e qark vendit, sepse unë do të ta jap ty”. (Zan 13:14–17)

Nuk mund të mos e vëmë re theksin e përsëritur se ajo që Perëndia i premtoi Abramit dhe farës së tij, ishte toka e Kanaanit.

Megjithatë edhe pse kaluan vite, Abrahami ende nuk e kishte në zotërim të tij vendin. Më keq akoma, ai nuk kishte fëmijë. Nëse ai mbetej pa fëmijë derisa të vdiste, si mund të përmbushej premtimi i Perëndisë për t'ia kaluar tokën farës së tij? Nuk do të kishte farë që mund t'ia jepte! Natyrisht, Abrami e ngriti këtë pështjellim para Zotit:

Po Abrami i tha: “Zot, Perëndi, çfarë do të më japësh, sepse unë jam pa fëmijë dhe trashëgimtari i shtëpisë sime është Eliezeri i Damaskut?”. Pastaj Abrami shtoi këto fjalë: “Ti nuk më ke dhënë asnjë pasardhës; dhe ja, një i lindur në shtëpinë time² do të jetë trashëgimtari im”. (Zan 15:2–3)

Në përgjigje Perëndia jo vetëm e siguroi Abramin se ai do të kishte një bir të vetin që do të ishte trashëgimtari i tij (15:4–5), por përsëriti premtimin e tij në lidhje me tokën:

Unë jam Zoti që të nxori nga Uri i Kaldeasve, për të ta lënë si trashëgimi këtë vend. (15:7)

Por këtë herë Abrami nuk qe i kënaqur thjesht që t'i përsëritej premtimi: ai dëshironte një lloj garancie se premtimi do të përmbushej, që të ishte plotësisht i sigurt për përmbushjen e tij:

2 D.m.th. një nga shërbëtorët e familjes sime.

Zot, Perëndi, nga mund ta di unë që do ta kem si trashëgim? (15:8)

Atëherë, si përgjigje ndaj kërkesës së Abramit për të patur një garanci, Perëndia bëri besëlidhjen me Abramin të cilës Pali i drejtohet te Galatasve 3:15. Por nëse ishte garancia e përmbushjes ajo që donte Abrami, atëherë duhet të pyesim si dhe në çfarë shkalle, kjo besëlidhje do të siguronte këtë garanci; dhe kjo do të varej prej llojit të besëlidhjes që do të bëhej dhe prej termave dhe kushteve që do të parashtronte.

Natyra e besëlidhjes

Le të marrim rastin e një sipërmarrësi në ndërtim i cili do të ngrejë një shtëpi me specifika të caktuara për një klient. Ky klient bie dakort t'i paguajë ndërtuesit një shumë të caktuar me kushtin që shtëpia e përfunduar të plotësojë të gjitha specifikat e kërkuara. Në bazë të këtyre kushteve, ata bëjnë një kontratë dhe pastaj e firmosin të dyja palët, sepse të dyja palëve të kontratës, ndërtuesit dhe klientit të tij, u kërkohet prej kushteve të besëlidhjes të përmbushin disa premtime. Nëse njëri prej tyre tërhiqet, besëlidhja prishet dhe, për rrjedhojë, pala e tërhequr mund të paditet për të paguar dëmet e shkaktuara. Ne mund ta quajmë këtë lloj forme kontrate një besëlidhje dypalëshe, sepse secila nga të dyja palët ka kushte dhe premtime që duhet t'i zbatojë.

Nga ana tjetër, nëse në botën moderne dikush nuk mund t'i paguajë për një moment huadhënësit të tij paratë që i detyrohet, huadhënësi mund t'i kërkojë që të shkruajë një deklaratë zotimi, e cila specifikon shumën që i detyrohet dhe datën se kur do t'ia paguajë. Në këtë rast, vetëm huamarrësi e firmos deklaratën, sepse vetëm ai po e bën këtë premtim. Kjo deklaratë premtuese nuk e detyron huadhënësin të bëjë ndonjë gjë. Ne mund ta quajmë këtë lloj besëlidhjeje, besëlidhje njëpalëshe. Bota e lashtë biblike i njihte të dyja këto besëlidhje, ndonëse mënyra sesi firmoseshin ndryshon shumë prej praktikave tona moderne.

Në kohët e lashta besëlidhjet e ndryshme bëheshin solemne duke derdhur gjak sakrificash të kafshëve apo shpendëve; por praktikat e lidhura me ceremoni të tilla ndryshonin në mënyrë domethënëse në vartësi të natyrës së secilës besëlidhje të veçantë. Një formë sakrifice e besëlidhjes ishte si më poshtë:

kafshët dhe zogjtë vriteshin dhe kafshët ndaheshin në copa. Këto copa dhe zogjtë vendoseshin në dy rreshta paralele me hapësirë të mjaftueshme mes tyre, që njerëzit të ecnin në mënyrë ceremoniale mes atyre dy rreshtave. Por ai që kalonte mes rreshtave do të varej nga natyra e veçantë e besëlidhjes.

Qoftë besëlidhjet njëpalëshe, qoftë ato dypalëshe u solemnizuan në këtë mënyrë. Për të ilustruar dallimet mes tyre, le të marrim një shembull tjetër për besëlidhjet njëpalëshe para se të kthehemi pas te besëlidhja e dokumentuar te Zanafilla 15. Interesi ynë i veçantë do të jetë të vëmë re në secilin rast se kush kaloi mes copave.

Një besëlidhje e bërë nga judenjtë në lidhje me skllavërinë (Jer 34:8–22)

Në këtë besëlidhje, judenjtë premtojnë të linin të lirë skllavërit e tyre hebrenj pa pagesë. Sfondi që i tillë. Ligji, i dhënë prej Perëndisë Izraelit pas Eksodit, porosiste që në fund të çdo shtatë viteve izraelitët duhet të linin të lirë çdo skllav hebre që kishin blerë (Jer 34:13–14). Por në kohën e Jeremias, njerëzit në përgjithësi e kishin shkelur këtë ligj për shumë kohë. Por pastaj, në një moment të caktuar, ata rrëfyn se u penduan dhe bënë një besëlidhje para Perëndisë në tempull, e cila garantonte se do të lironin skllavërit e tyre hebrenj (Jer 34:8–10). Megjithatë, shumë shpejt pas kësaj, ata e mohuan këtë besëlidhje, i skllavëruan përsëri bashkatdhetarët e tyre hebrenj, dhe tërhoqën mbi vete gjykimin e Perëndisë.

Interesi ynë në këtë histori bie mbi formën që kjo lidhje e besës mes palëve ndodhi: “duke kaluar në mes pjesëve të viçit që e kishin ndarë më dysh” (34:18). Kushtojni rëndësi se kush kaloi mes pjesëve: qenë të gjithë princat dhe populli (34:10). Natyrisht që po; sepse qenë këta njerëz (34:18) që po bënë një besëlidhje dhe po zotoheshin solemnisht për të përmbushur premtimin e tyre para Perëndisë për t’i lënë të lirë skllavërit e tyre hebrenj. Perëndia as që përmendet fare, apo ndonjë simbol i pranishëm së tij që të ecte mes pjesëve. Natyrisht që jo. Perëndia nuk po bënte ndonjë premtim këtu: ai nuk kishte ndonjë detyrim për të përmbushur. Vetëm ai që kishte detyrim për të përmbushur ecte mes pjesëve. Që një besëlidhje e njëanshme.

Besëlidhja e bërë nga Perëndia me Abramën dhe farën e tij (Zan 15:8–21)

Besëlidhja që Pali shtjellon te Galatasve 3 u lidh duke ndjekur të njëjtat praktika si ajo që sapo shqyrtuam. U vranë kafshë dhe shpezë dhe ato u ndanë më dysh. Pastaj ato u vunë paralelisht njëra përballë tjetrës me hapësirë në mes tyre, të bëra gati, kështu që palët apo pala e besëlidhjes të ecte solemnisht mes pjesëve.³ Abrami e përgatiti të gjithë këtë dhe priti; priti aq gjatë në fakt sa që zogjtë grabitqarë filluan të vinin rrotull kërmave dhe Abramit iu desh që t’i trembte (Zan 15:11). Pse iu desh të priste? Pse nuk e mori iniciativën të ecte vetë mes pjesëve? Përgjigjja është sepse ai nuk e dinte se mbi ç’marrëveshje do të bëhej besëlidhja; atij nuk i qenë treguar kushtet e besëlidhjes (as nëse kishte të tilla) që duhej të mbante për të siguruar këtë trashëgimi të madhe që Perëndia po lidhte një besëlidhje për t’ia dhënë. Nëse i qenë dhënë kushte për t’u përmbushur, atij i duhej të ecte mes pjesëve, që të zotohej kështu për t’i përmbushur ato kushte. Për shkak të rrjedhimeve të thella ligjore të këtij veprimi (pra nëse Abrami do ecte mes pjesëve apo jo), ne do të shqyrtojmë tekstin duke i mbajtur sytë katër për të parë se çfarë ndodhi në të vërtetë. Atje do të zbulojmë dy fakte shumë domethënëse.

Abrami nuk kaloi mes pjesëve

Në këtë rast ai nuk mundi sepse e zuri një gjumë shpejt para se të fillonte ceremonia e besëlidhjes (Zan 15:12). Patjetër që Perëndia i foli atij kur ishte në gjumë dhe që Abrami e dëgjoi atë të fliste dhe e kuptoi atë që Perëndia po i thoshte. Por nuk përbën argument që, përderisa ai ishte në një ëndërr apo vizion, mund të supozojmë që Abrami u quajt sikur kishte ecur mes pjesëve, ndonëse nuk është specifikuar kjo gjë në tekst. Në ëndrrat dhe vizionet e Biblës, njerëzit e gjejnë veten duke bërë gjëra të ndryshme (shih p.sh. ëndërrën e Jozefit, Zan 37:5-7). Nëse në vizion Abrami kishte ecur mes pjesëve, ai do ta kishte

³ Fakti që Abrami siguroi dhe përgatiti këto kafshë dhe shpezë nuk merret si bazë që ai përfitonte nga të mirat e besëlidhjes. Një noter që i jep klientit të tij letër, penë dhe bojë për të shkruar me to vullnetin e tij, nuk mundet që të presë se do të bëhet pjesë e testamentit.

parë veten që do t'i ndodhte kjo gjë, dhe do të ishte thënë në tregim që ai e kishte bërë këtë.

Arsyeja që Abrami nuk eci mes pjesëve ishte që ai nuk kishte detyrime për të përmbushur. As në parathënien profetike (Zan 16-15:13) dhe as në kushtet aktuale të besëlidhjes (20-15:17), Abramit nuk iu vunë kushte apo nuk iu kërkua të bënte ndonjë premtim. Në fakt ai nuk thotë ndonjë gjë.

Perëndia eci mes pjesëve

Qe prania e Perëndisë, e simbolizuar nga një furrë që nxirrte tym dhe një pishtar që flakëronte, që thuhet shprehimisht se kaloi mes pjesëve (Zan 18-15:17). Kjo natyrisht që e vlefshme ligjërisht sepse, siç edhe do ta shohim, Perëndia vetë po i bënte të gjitha premtimet dhe, prandaj, Perëndia vetë po e lidhte veten me përmbushjen e këtyre premtimeve⁴. Kjo provohet prej deklaratës formale të kushteve të besëlidhjes:

Po atë ditë Zoti bëri një besëlidhje me Abramit duke i thënë: “Unë u jap pasardhësve të tu këtë vend, nga përroi i Egjiptit deri në lumin e madh, lumin e Eufratit: kenejtë, kenizejtë, kadmonejtë, hitejtë, perezejtë, refejtë, amorejtë, kanaanejtë, gergazejtë dhe jebuzejtë (Zan 15:18-20)

Abrami vetë nuk premtoi gjë. Kjo që një besëlidhje njëpalëshe. Po ashtu konfirmohet fakti se e kemi kuptuar drejt interpretimin që Pali i bën kësaj besëlidhjeje kur i kushtojmë vëmendje të veçantë kuptimit të termit *premtim*, të cilin Pali e përdor në mënyrë të përsëritur në lidhje me këtë gjë (shih Gal 3:14, 16, 17, 18, 21, 24; 4:28; Rom 4:13, 14, 16, 20, 21).

Interpretimi i Palit për “premtimin” në lidhje me trashëgiminë

Sepse, në qoftë se trashëgimi është nga ligji, nuk është më nga premtimi. Por Perëndia ia fali atë Abrahamit me anë të premtimit. (Gal 3:18)

⁴ Fenomenin që lidhet me praninë hyjnore në këtë rast, e krahasoni me fenomenin e Shkurrës që digjet, Eksodi 3:2-4.

Premtimet e kushtëzuara dhe ato të pakushtëzuara

Në gjuhën tonë të përditshme premtimet mund të jenë të dy llojeve: ose të kushtëzuara, ose të pakushtëzuara.

Një premtim i kushtëzuar mund të ilustruhet kështu – një baba i thotë djalit të tij adoleshent: “Nëse studion shumë dhe i merr të gjitha provimet 10-a, të jap fjalën që do të të blej një motoçikletë.” Sigurisht që ky është një premtim i vërtetë; por nëse djali e fiton motoçikletën apo jo, varet nga fakti nëse ai studion shumë dhe i merr të gjitha provimet e tij shkëlqyeshëm. Nëse ai nuk i përmbush kushtet e vëna nga babai i tij, babai nuk do ta mbajë fjalën e dhënë, dhe ai nuk do të ketë një motoçikletë.

Një premtim i pakushtëzuar mund të ilustruhet kështu – një baba që i thotë djalit të tij adoleshent: “Sepse të kam fëmijën tim dhe ngaqë të dua, të jap fjalën e burrit që, kur të mbushësh 21 vjeç, do të të blej një Benz të ri.” Në këtë premtim të veçantë babai nuk vendos ndonjë kusht që i biri duhet ta përmbushë, që të meritojë dhe të fitojë paratë e premtuara. Thjesht, prej dashurisë së madhe për të birin e tij, babai premtton t’i blejë një makinë si një dhuratë bujare dhe të pamerituar. Ky është një premtim i pakushtëzuar, dhe nëse babai do ta mbajë fjalën, do të realizohet.

Prandaj, kur Pali thotë që Perëndia ia ka dhënë trashëgiminë Abramit përmes premtimit (3:18), a është ai një lloj premtimi me kusht apo pa kusht? Përgjigja është e padiskutueshme: ai nënkupton “përmes një premtimi të pakushtëzuar”. Sepse ndiqni argumentin e tij: “nëse trashëgimia është nga ligji” thotë ai – d.m.th. nëse përmbushja e premtimit varet nga zbatimi që Abrami do i bënte ligjit – “atëherë nuk është më nga premtimi”; dhe ky lloj argumenti nuk ka asnjë vlerë, vetëm nëse Pali e shihte premtimin si të pakushtëzuar kur që bërë në fillim. Le të ndjekim rrjedhojat logjike të këtij argumenti.

Supozoni që premtimi fillestar kishte qenë i kushtëzuar, d.m.th. që në përmbajtjen e tij, qoftë haptazi apo me nënkuptim, ka patur një kusht që, për të zotëruar trashëgiminë e premtuar, Abrami duhet të zbatonte ligjin. Kjo nuk do të thoshte se Perëndia nuk i kishte bërë një premtim të vërtetë: vetëm se në këtë rast do të ketë qenë një premtim i kushtëzuar.

Por supozoni që premtimi fillestar për trashëgiminë ishte që nga fillimi një premtim i pakushtëzuar. Atëherë nëse ka qenë kështu, edhe sikur Perëndia apo dikush tjetër, t'i ketë shtuar kushtin se përmbushja e tij varej nga zbatimi që Abrami do t'i bënte ligjit, kjo klauzolë kushtëzuese do të kishte ndryshuar në thelb natyrën, qëllimin dhe statusin ligjor të premtimit fillestar. Sepse tani nuk do të qe më një premtim pa kushte, sepse një premtim nuk mund të jetë edhe i pakushtëzuar edhe i kushtëzuar njëherazi. Këto dy lloj besëlidhjesh janë në kundërshtim me njëra-tjetrën.

Për më tepër, po t'i shtosh këtë kusht të zbatimit të ligjit premtimit fillestar të pakushtëzuar, pasojat do të kenë qenë shkatërrimtare për Abramin dhe farën e tij. Për aq kohë sa zotërimi përfundimtar i trashëgimisë varej prej premtimit të pakushtëzuar të një Perëndie që nuk i thyen asnjëherë premtimet e tij, ata mund të ishin plotësisht të sigurt për përmbushjen e tij. Por nëse plotësimi i premtimit varej nga kushti që ata duhet të zbatonin ligjin, zotërimi i tyre përfundimtar i trashëgimisë nuk do të kishte qenë thjesht i pasigurt, por realisht i pamundur. Sepse, siç edhe Pali vëzhgon pak më poshtë në argumentin e tij, askush nuk mund të zbatojë të gjithë ligjin e Perëndisë si duhet, dhe për këtë arsye, të gjithë janë nën mallkimin e tij (3:10–12).

Atëherë pikërisht këtë nënkupton Pali prej kësaj deklarate (të cituar më sipër):

Sepse, në qoftë se trashëgimi është nga ligji, *nuk është më nga premtimi. Por Perëndia ia fali atë Abrahamit me anë të premtimit.* (3:18)

Ai e mbështet interpretimin e tij duke iu drejtuar një praktike tjetër ligjore të shëndoshë.

Praktikë e shëndoshë ligjore

Së pari, ai iu drejtua asaj që përgjithësisht vlerësohej në kohën e tij si një praktikë e shëndoshë ligjore në interpretimin e besëlidhjeve:

O vëllezër, po ju flas në mënyrën e njerëzve: në qoftë se një besëlidhje është aprovuar, edhe pse është besëlidhje

njeriu, askush nuk e zhvleftëson as nuk i shton gjë. [d.m.th. kushte shtesë që nuk janë vënë aty që nga fillimi i besëlidhjes]. (Gal 3:15)

Pastaj ai komenton se besëlidhja e pakushtëzuar e njëanshme që Perëndia bëri me Abramin dhe farën e tij, qe konfirmuar 430 vite *para* se të shpallej Ligji i Moisiut në Malin Sinai.⁵

Mbi këto baza Pali këmbëngul se kur Perëndia ia dha Izraelit ligjin në Malin Sinai, ai nuk mund të ketë patur për qëllim që t'ia shtonte këtë besëlidhjes së tij të parë me Abramin si kusht që duhej plotësuar para se të fitonte trashëgiminë e premtuar. Sepse nëse Perëndia do ta kishte patur këtë gjë në mend, argumenton Pali, atëherë do të qe duke zhvleftësuar premtimin e tij fillestar dhe do të kishte anuluar besëlidhjen e parë. Fjalët e Palit ishin:

Dhe unë them këtë: ligji, që erdhi katërqind e tridhjetë vjet më pas, nuk e zhvleftëson besëlidhjen e aprovuar më parë nga ana e Perëndisë në Krishtin, në mënyrë që të prishë premtimin. (Gal 3:17)

Pyetjet që shtrohen

Por këmbëngulja e Palit, që premtimi fillestar i pakushtëzuar prej Perëndisë ngelet i paprekur dhe i pandryshuar prej ligjit të dhënë në Sinai, ngre disa pyetje që mund të përmbledhen me vetë fjalët e Palit kështu: “Atëherë, pse u dha ligji?” (Gal 3:19). Sepse as që nuk mund të vihet në dyshim:

1. që Perëndia vetë ia dha ligjin Izraelit në Sinai para se ata të hynin në tokën e premtuar;
2. që besëlidhja mes Perëndisë dhe Izraelit ishte një besëlidhje dypalëshe dhe që përfitimet e premtuara nën atë besëlidhje qenë të kushtëzuara nga zbatimi i ligjit;

⁵ Ne mund të shtojmë që nuk kishin kaluar as 13 vjet para se Perëndia të caktonte besëlidhjen e rrethprerjes për Abramin dhe pasardhësit tij (shih Zan 17:10). Lindja e Isamelit erdhi ca kohë më vonë pas besëlidhjes së parë të Perëndisë (Zan 15), dhe është dokumentuar te Zan 16. Ndodhi 13 vjet më vonë që kjo besëlidhje e dytë u bë (shih Zan 17:25). Atëherë të dyja besëlidhjet nuk qenë të njëjtat. Shih argumentin e Palit te Rom 4:9–16; dhe vini re që ka vlerë qoftë për shfajësimin e Abramit, qoftë për trashëgiminë e premtuar.

3. që Moisiu e kushtëzoi haptazi hyrjen e Izraelit në tokën e premtuar me zbatimin që ata do u bënin kërkesave të ligjit;
4. dhe që Moisiu e paralajmëroi Izraelin se nëse ata thyenin kushtet e besëlidhjes dhe nuk zbatonin ligjet e tij, Perëndia do t'i dëbonte prej tokës së premtuar dhe do t'i dëbonte ata mes kombeve.

A nuk duket kjo sikur trashëgimia e Izraelit për tokën e premtuar ishte në fund të fundit e kushtëzuar, duke kundërshtuar atë që Pali kishte interpretuar? Por para se të marrim këtë vendim, duhet së paku të saktësojmë faktet në mënyrë më të detajuar dhe me më shumë saktësi.

Lidhja me besëlidhjen e bërë në Sinai

Kjo besëlidhje zakonisht quhet besëlidhja e Moisiut, sepse Moisiu shërbeu si ndërmjetës mes Perëndisë dhe Izraelit kur ajo u bë. Përndryshe, në Dhiatën e Re ajo është njohur si besëlidhja e vjetër për ta dalluar prej besëlidhjes së re (Heb 8:6–13). Ajo u dekretua në Horeb, një vargmal që kishte Sinain, malin e veçantë nga i cili u dha ligji. Ja se si ndodhi dekretimi:

Pastaj Perëndia i tha Moisiut: “... Moisiu do t'i afrohet Zotit... Atëherë Moisiu erdhi dhe i tregoi popullit tërë fjalët e Zotit dhe tërë ligjet. Dhe gjithë populli u përgjigj me një zë dhe tha: “Ne do të bëjmë tërë gjërat që Zoti ka thënë”.

Dhe Moisiu i shkroi tërë fjalët e Zotit; pastaj u ngrit herët në mëngjes dhe ngriti në këmbët e malit një altar dhe dymbëdhjetë shtylla për të dymbëdhjetë fiset e Izraelit. Pastaj dërgoi bij të rinj të Izraelit për të ofruar olokauste dhe për të flijuar dema të rinj si theror falënderimi ndaj Zotit.

Dhe Moisiu mori gjysmën e gjakut dhe e vuri në legenë; dhe gjysmën tjetër të gjakut e shpërndau mbi altar. Pastaj mori librin e besëlidhjes dhe ia lexoi popullit, i cili tha:

“Ne do të bëjmë tërë ato që ka thënë Zoti, dhe do t'i bindemi”. Pastaj Moisiu mori gjakun, spërkati popullin me të dhe tha: “Ja gjaku i besëlidhjes që Zoti ka lidhur me ju sipas tërë këtyre fjalëve”. (Eksodi 24:1–8)

Dallimet

Dallimet ligjore të rëndësishme mes kësaj besëlidhjeje të Moisiut dhe besëlidhjes që Perëndia bëri me Abramit dhe farën e tij janë njëherazi të dukshme dhe shumë goditëse.

Së pari, në besëlidhjen me Abramit, Perëndia foli me Abramit drejtpërdrejt; në këtë besëlidhje të Moisiut, një ndërmjetës u caktua mes dy palëve, mes Perëndisë nga një anë dhe popullit nga ana tjetër (shih komentin e Palit te Gal 3:19-20).

Së dyti, në besëlidhjen e Moisiut, ndërmjetësit iu dhanë kërkesat e Perëndisë dhe ai i transmetoi ato te populli. Si fillim ai i recitoi ato gojarisht dhe njerëzit u përgjigjën: “Ne do të bëjmë tërë gjërat që Zoti ka thënë” (Eksodi 24:3). Pastaj ndërmjetësi shkroi të gjitha kërkesat e Perëndisë në një libër, dhe i lexoi ato prej librit në veshët e popullit (Eksodi 24:4, 7). Nuk kishte dyshime në mendjet e njerëzve për atë që po zotoheshin dhe po premtonin se do të bënin, dhe për kushtet me të cilat po e lidhnin veten. Sërish njerëzit u përgjigjën: “Ne do të bëjmë tërë ato që ka thënë Zoti, dhe do t'i bindemi” (Eksodi 24:7). Perëndia e kishte thënë tashmë se çfarë do të bënte nga ana e tij nëse ata do të mbanin besëlidhjen e tij:

Prandaj, në qoftë se do ta dëgjoni me vëmendje zërin tim dhe zbatoni besëlidhjen time, do të jeni thesari im i veçantë ndërmjet tërë popujve, sepse gjithë toka është imja. Dhe do të jeni për mua një mbretëri priftërinjsh dhe një komb i shenjtë. Këto janë fjalët që do t'u thuash bijve të Izraelit. (Eksodi 19:5–6)

Tani, pas dekretimit të besëlidhjes, njerëzve iu bënë të ditura kushtet që ata, nga ana e tyre, duhej të përmbushnin. Pa më të voglin dyshim që një besëlidhje dypalëshe.

Së fundi, për të treguar që ata ishin një palë aktive në lidhjen e besëlidhjes, populli, si edhe altari i Perëndisë, u spërkatën me gjakun e sakrificave të besëlidhjes në mënyrë ceremoniale. Me

fjalë të tjera, kjo besëlidhje e Moisiut nuk ishte një premtim pa kushte, njëpalëshe nga ana e Perëndisë, siç ishte besëlidhja e tij me Abramin. Ajo që një kontratë dypalëshe sipas të cilës përfitimet, që do të rridhnin prej saj, vareshin qartazi nga zbatimi që Izraeli do t'u bënte kushteve për të cilat ata u zotuan solemnisht së pari gojarisht në publik, dhe pastaj kur u spërkatën me gjakun e sakrificave të besëlidhjes.

Kushte dhe pasoja të përhershme

Dyzet vjet më vonë kur, nën Jozueun, izraelitët ishin në kufi të tokës së premtuar gati për të hyrë për herë të parë, Moisiu u kujtoi atyre haptazi që hyrja e tyre varej nga zbatimi i urdhërimeve të besëlidhjes së Horeb-Sinait:

Kini kujdes të zbatoni në praktikë të gjitha urdhërimet që po ju jap sot, me qëllim që të jetoni, të shumëzoheni dhe të pushtoni vendin që Zoti u betua t'u japë etërve tuaj. (LiP 8:1)

Po ashtu, ai i paralajmëroi ata që, pasi hynin në tokën e premtuar, zotërimi dhe shijimi i përhershëm i saj do të varej nga bindja e plotë dhe besnike ndaj ligjeve të Perëndisë. Mosbindja e vazhdueshme do t'i skualifikonte nga zotërimi i vendit.

Por në rast se nuk i bindesh zërit të Zotit, Perëndisë tënd, për të respektuar me kujdes të gjitha urdhërimet dhe të gjitha statutet e tij që sot të urdhëroj, do të ndodhë që të gjitha këto mallkime do të bien mbi ty dhe do të të gjejnë. . . do t'ju rrëmbejnë nga vendi ku po hyni për ta pushtuar. Zoti do të të shpërndajë midis tërë popujve, nga njeri skaj i tokës në tjetrin . . . Këto janë fjalët e besëlidhjes që Zoti i urdhëroi Moisiut të përfundonte me bijtë e Izraelit në vendin e Moabit, përveç besëlidhjes që kishte bërë me ta në malin Horeb. (LiP 28:15, 63–64; 29:1)

Sigurisht që nën besëlidhjen e Sinai-Horeb-Moabit, zotërimi i tokës së premtuar nga Izraeli varej nga zbatimi dhe përmbushja e disa kushteve; dhe historia e mëvonshme e Izraelit ka treguar që këto nuk qenë kushte të kota.

Një përmbushje e paplotë

Por tani le të përballemi me një gjë shumë domethënëse për hyrjen e Izraelit në tokën e premtuar nën kushtet e besëlidhjes së Sinait: as Perëndia dhe as Moisiu nuk supozuan, pritën apo deklaruan që ajo do të ishte përmbushja e plotë dhe finale e premtimit të pakushtëzuar të bërë nga Perëndia në besëlidhjen e tij me Abramin. Larg qoftë! Dëgjoni se çfarë tha Moisiu kur iu drejtua izraelitëve para se të hynin në vend:

Kur ... të keni banuar për një kohë të gjatë në atë vend, në rast se shthureni dhe sajoni shëmbëlltyra të gdhendura në trajtën e çfarëdo gjëje, dhe bëni të keqen në sytë e Zotit, Perëndisë tuaj, për ta ngacmuar, unë thërres sot për të dëshmuar kundër jush qiellin dhe tokën, se ju do të zhdukeni shpejt plotësisht nga vendi ku shkoni për t'u bërë zotër të tij, duke kaluar Jordanin. Ju atje nuk do t'i zgjatni ditët tuaja, por do të shkatërroheni plotësisht. Dhe Zoti do t'ju shpërndajë midis popujve, dhe nuk do të mbetet nga ju veçse një numër i vogël njerëzish midis kombeve ku do t'ju çojë Zoti. (LiP 4:25–27)

Nuk kishte dyshim që Izraeli do të prishte besëlidhjen dhe do të humbte të drejtën për të zotëruar vendin:

Dhe Zoti i tha Moisiut: “Ja, ti do të shkosh të flesh bashkë me etërit e tu; dhe ky popull do të çohet dhe do të kurvërohet duke shkuar pas perëdivë të huaja të vendit ...dhe do të shkelë besëlidhjen që kam lidhur me të. Atë ditë zemërimi im do të ndizet kundër tyre; ...”. (LiP 31:16–17)

Dhe Moisiu shtoi:

Sepse unë e di që, mbas vdekjes sime, do të korruptoheni plotësisht dhe do të largoheni nga rruga që ju kam urdhëruar, dhe ditët e fundit do të goditeni nga fatkeqësia... (LiP 31:29)

Librat historikë të Dhiatës së Vjetër na tregojnë sesi këto profeci u përmbushën fjalë për fjalë dhe në mënyrë dramatike. Pavarësisht nga paralajmërimi i profetëve të tyre, dhjetë fiset e

Izraelit këmbëngulën në idhujtari dhe ligësi; dhe Perëndia lejoi, në të vërtetë dërgoi, asirianët t'i shpërngulnin nga vendi.

Më vonë, për të njëjtat arsye, Perëndia lejoi Nebukadnetsarin të shpërngulte për në Babiloni dy fiset që kishin mbetur. Ja pra si përfundoi zotërimi i Izraelit i tokës së premtuar nën kushtet dhe afatet e besëlidhjes së Sinait.

Por ndoshta jemi duke anashkaluar një tipar tjetër të rëndësishëm të përvojës së Izraelit nën besëlidhjen e vjetër të ligjit. Moisiu, *bashkë* me profecitë e tij të tradhtisë së tyre në të ardhmen dhe dëbimin nga vendi që vinte pas saj, dëshmoi njëherazi që nëse ata do të pendoheshin, Perëndia do t'i mëkëmbte në tokën e premtuar.

Kështu, kur të të kenë rënë në kurriz tërë këto gjëra, bekimi dhe mallkimi që unë të kam vënë përpara, dhe ti do t'ua kujtosh të gjitha kombeve në mes të të cilëve Zoti, Perëndia yt, do të të ketë dëbuar, dhe kur të kthehesh te Zoti, Perëndia yt, dhe ti bindesh zërit të tij, ti dhe bijtë e tu, me gjithë zemër e me gjithë shpirt, duke respektuar tërë ato që po të urdhëroj sot, Zoti, Perëndia yt, do të të kthejë nga skllavëria, do të të ketë mëshirë për ty dhe do të të mbledhë përsëri nga radhët e të gjithë popujve, ndër të cilët Zoti, Perëndia yt, të kishte shpërndarë. Edhe sikur të kesh qenë përzënë në skajin e qiellit, Zoti, Perëndia yt, do të të mbledhë dhe do të marrë që andej. Zoti, Perëndia yt, do të të rikthejë në vendin që etërit e tu kanë zotëruar dhe ti do ta zotërosh atë . . . (LiP 30:1-5)

Një mëkëmbje e tillë, sado e vogël, ndodhi kur disa hebrenj, të nxitur prej profetëve si Jeremia dhe Danieli, si edhe bashkë me lejen e perandorit Kir, u kthyen nga mërgimi në Babiloni dhe ndërtuan tempullin dhe muret e Jerusalemit. Nuk kemi pse të nënvlerësojmë arritjet e tyre shpirtërore gjatë shekujve në vijim; por qëndron ende si fakt që ata qenë ende nën kushtet e besëlidhjes së vjetër dhe zotërimi i vendit në kthim nuk ishte as i plotë dhe as i përhershëm. Në vazhdim, kombi e hodhi zyrtarisht poshtë Mesian e tyre dhe, për rrjedhojë, Perëndia lejoi që të shkonin robër edhe njëherë mes kombeve, dhe Jerusalemin “do ta shkelin paganët, derisa të plotësohen kohët e paganëve” (shih Luka 21:24).

Pas afërsisht 2000 vjetësh, një pakicë nga diaspora hebraike, e shpërndarë nëpër botë, është kthyer dhe tani zotëron një pjesë të tokës së premtuar. Jerusalemi ende është kryeqyteti i tyre; por zotërimi i tij nga ana e tyre është vazhdimisht i rrezikuar. (shih Zak. 14:1-2).

Përfundimi që nxjerrim

Në të gjithë shekujt, që nga Abrami e deri tani, vetëm një pakicë izraelitësh kanë zotëruar realisht tokën e premtuar; dhe zotërimi i tyre sigurisht, edhe pse ka qenë i tillë, nuk ka qenë ndonjëherë i përhershëm. Prandaj mund të shtrojmë pyetjen se cilat janë gjasat që premtimi fillestar do të përmbushet qoftë ndonjë herë, qoftë plotësisht? Mund të përfytyrojmë që Pali do të përgjigjej: Asnjë... përderisa Izraeli të jetojë nën ligjin e Sinait dhe, akoma më të pakta, nëse ata jetojnë duke e përbuzur atë.

Por le të kthehemi te Pali për të parë se mbi çfarë bazash ai na siguron që premtimi fillestar dhe pa kushte i Perëndisë për Abramin dhe farën e tij ende vazhdon, dhe do të plotësohet një ditë përfundimisht dhe plotësisht.

Interpretimi që Pali i bën fjalës “farë” në besëlidhjen e Perëndisë me Abramin

Kuptimet e mundshme të fjalës “farë”

Fjala hebraike për *farë*, si fjalët shqip *pinjoll* dhe *skotë* (farefis), kur përdoret për të treguar pasardhësit e dikujt, mund të funksionojë në disa mënyra.

Ajo tregon për një individ të caktuar. Pra, Isaku ishte fara e Abramit. Një djalë i vetëm mund të përshkruhet si pasardhës i prindërve të tij. Prandaj secili prej pasardhësve të Abramit në çdo epokë të historisë mund të quhet fara e Abramit.

Ajo shërben si emër i përgjithshëm. Kështu Perëndia tha që fara e Abramit do të jetë e shumtë si yjet (Zan 15:5).

Ajo flet për një nëngrup. Ky mund të jetë çfarëdo lloj nëngrupi brenda shumës totale të farës së Abramit, qoftë e madhe apo e vogël, në çdo kohë të historisë.

Ajo mund të përdoret me ngjyime morale dhe frymërore. Në këtë rast “fara e Abramit” nuk do të thotë domosdoshmërisht të gjithë ata që rrjedhin fizikisht nga Abrami, por ata që shfaqin të njëjtin qëndrim besimi në Perëndinë, siç edhe bëri Abrami. Për këtë arsye Isaia përshkruan disa nga pasardhësit fizikë të Abramit si “pasardhës të shkelësit të kurorës dhe të prostitutës” dhe “pasardhës të gënjeshtres” (Isa 4–57:3). Po ashtu Krishti u tha disa prej bashkëkohësve të tij hebrenj që, edhe pse e dinte se fizikisht ata ishin pasardhës të Abramit, nuk po bënë veprat e Abramit për të treguar që ishin realisht fëmijë të Abramit. Sidoqoftë, ata, me veprat e tyre, provonin që ishin fëmijë të djallit (Gjoni 8:37–44).

Një kuptim parësor i veçantë

Interpretimi që i bën Pali fjalës *farë* është që ajo i referohet vetë Krishtit:

Dhe premtimet iu bënë Abrahamit dhe pasardhjes së tij.
Shkrimi nuk thotë: Edhe pasardhësve`si të ishin shumë,
por të një të vetme: Dhe pasardhjes sate, pra Krishti. (Gal 3:16)

Kështu që Pali këmbëngul se para së gjithash kjo fjalë duhet të interpretohet duke patur si referim një person të veçantë historik, d.m.th. Krishtin. Kuptohet që Pali nuk kishte në dispozicion atëherë një terminologji gramatikore dhe gjuhësore moderne, të saktë, si e kemi ne sot. Ai e shpreh veten në mënyra që për ne tingëllojnë të çuditshme:

Ai [Perëndia] nuk thotë: Edhe pasardhësve`si të ishin shumë, por “pasardhësit” sikur të qe një i vetëm (3:16, përkthim i fjalëpërfjalshëm)

Tani, faktikisht, fjala hebraike për *farë* nuk përdoret normalisht në shumës (farat) në asnjë rast. Sidoqoftë, ajo që Pali po thotë, kur shprehet “jo Edhe pasardhësve`si të ishin shumë”, është që fjala “farë” në këtë pikë nuk synon të shprehë kuptimin e një emri të përgjithshëm që nënkupton një shumicë individësh. Ajo përdoret në numrin njëjës duke iu referuar një individi të

caktuar, d.m.th., personit historik të Krishtit. Këtë gjë Pali e qartëson më tej kur komenton: “... ligji...u shtua për shkak të shkeljeve, deri sa të vinte pasardhja së cilës i qe bërë premtimi” (3.19), d.m.th. derisa njeriu Krishti Jezus të vinte në botën tonë me ardhjen e tij të parë. Kështu që premtimi i Perëndisë për t’i dhënë tokën farës së Abramit do të thoshte që ai do t’ia jepte një ditë Krishtit. Në këtë mënyrë nuk ka asnjë rrezik që premtimi të anulohet apo të mos përmbushej.

Një kuptim dytësor i veçantë

Interpretimi i fjalës *farë* i bërë nga Pali i referohet në vend të dytë një grupi të përbërë nga Krishti dhe ata që e besojnë atë:

Sepse të gjithë ju që jeni pagëzuar në Krishtin, Krishtin keni veshur. Nuk ka as jude, as grek, nuk ka as skllav as të lirë, nuk ka as mashkull as femër, sepse të gjithë jeni një në Jezu Krishtin. Dhe, në qoftë se jeni të Krishtit, jeni pra pasardhja e Abrahamit dhe trashëgimtarë sipas premtimit. (Gal 3:27–29)

Me fjalë të tjera, të gjithë ata që kanë besuar në Krishtin shihen prej Perëndisë si “në Krishtin”. Kjo është pozita e tyre ligjore. Ata janë bërë pjesë e Krishtit. Për të përdorur një shprehje të figurshme, ata “kanë veshur Krishtin”, siç bën dikush kur vesh një rrobë që e mbulon atë plotësisht dhe i fsheh çdo dallim tjetër, si raca, pozita sociale apo gjinia. Atëherë, përderisa Krishti është fara e Abramit, siç edhe përshkruhet te besëlidhja e Perëndisë me Abramin, të gjithë që janë “në Krishtin” janë në këtë mënyrë fara e Abramit dhe trashëgimtarë bashkë me Krishtin të premtimit të besëlidhjes.

Për ta shprehur ndryshe: besëlidhja e Perëndisë me Abramin ishte një prej “besëlidhjeve të premtimit” që Perëndia bëri me pasardhësit e Abramit. Në kohët e Dhiatës së Vjetër johebrenjtë qenë “të huaj për besëlidhjen e premtimit”. Por tani johebrenjtë që besojnë në Krishtin nuk janë më të huaj, por “bashkëpjesëtarë të premtimit të tij në Krishtin nëpërmjet ungjillit” (Efes 2:11–12; 3:6).

Jo një kuptim arbitrar

Pohimi i Palit, që fara është Krishti, nuk është as i fryrë dhe as arbitrar. Nuk mund të mohohet që njeriu, Krishti Jezus, që personalisht fara e Abramit. Thjesht duke qenë një njeri dhe hebre, ai ishte “trashëgimtar i premtimit” po aq sa Isaku dhe Jakobi (Heb 11:9) apo çdo hebre tjetër.

Por Krishti ishte më shumë se thjesht një njeri dhe një hebre. Ai qe Biri i Perëndisë, Biri i Njeriut, fara e gruas (Zan 3:15), biri i Abrahamit, fara e Davidit. Në një shëmbëlltysë, që ua tregoi pushtetarëve fetarë të cilët donin ta vrisnin me çdo kusht, ai e krahasoi Izraelin me një vresht. Perëndia ishte mbjellësi dhe pronari i tij. Vetë Krishti ishte Biri i dashur i pronarit dhe prandaj qe edhe trashëgimtar i trashëgimisë së vreshtit (Luka 20:13–15). “Birin... e bëri trashëgimtar të të gjitha gjërave”, thotë Heb 1:2. Prandaj nëse dikujt do t’i jepej ndonjëherë tapia e trashëgimisë së premtuar Abramit dhe farës së tij, ky do të qe vetë ai.

Por kur erdhi në tokë, atij nuk iu dha zotërimi i tokës së premtuar. “Biri i njeriut nuk ka as ku të mbështetë kokën.” (Mat 8:20) “Ai (fjala) ishte në botë, dhe bota u krijua me anë të tij, por bota nuk e njohu. Ai erdhi në shtëpinë e vet dhe të vetët nuk e pranuan” (Gjoni 1:10-11); dhe si një djalosh 33 vjeçar, ai u dëbua prej tokës përmes kryqëzimit, vdekjes dhe varrimit.

Por Perëndia e ngjalli prej së vdekurish dhe tani ai është i ulur në të djathtën e Perëndisë. Një ditë Perëndia, Ati, do ta ftojë atë:

Më kërko dhe unë do të jap kombet si trashëgimi për ty dhe mbarë dheun si zotërim tëndin. Ti do t’i copëtosh me një shufër hekuri, do t’i bësh copë-copë si një enë prej argjile. (Ps 2:8–9; krh. cituar edhe te Vep 4:25–27; Zbul 19:15)

Kur do të jetë kjo? Sipas Dhiatës së Re, në kthimin e dytë të Krishtit, Ai do të kthehet me fuqi dhe lavdi të madhe për të zbatuar gjykimet e Perëndisë, jo thjesht mbi një shoqëri amorite të prishur (si bëri Jozueu kur fara e Abramit u kthye nga Egjipti për në Kanaan; shih më sipër, Zan 15:16 dhe librin e Jozueut), por mbi të gjithë botën (shih Luka 21:25-28; 2 Sel 1:6-12). Ai do

të zotërojë të gjithë planetin; jo thjesht tokën e Kanaanit vetë pa pjesën tjetër të tokës; as edhe të gjithë tokën, sigurisht, pa vendin e Kanaanit.

Për më tepër, na thuhet që në ardhjen e dytë të Krishtit ata që janë të Krishtit – dhe për këtë arsye farë e Abramit – do të ngjallen prej së vdekurish dhe ata që ende janë të gjallë fizikisht do të transformohen (1 Kor 15:23, 51-52). Bashkë me Krishtin ata do të gëzojnë trashëgiminë e premtuar. (krh. Rom.8:17).

Atëherë, deklaratat e pastra të Dhiatës së Re për identitetin e Krishtit, ardhjen e tij të parë dhe çfarë do të bëjë në ardhjen e tij të dytë, tregojnë që Krishti do të trashëgojë atë që Perëndia do t’i japë Abramit dhe farës së tij. Krishti është ajo farë.

Një kuptim me një domethënie të madhe

Interpretimi se fara është Krishti është i vetmi interpretim që u jep ndonjë shpresë Abramit, Isakut, Jakobit dhe Jozefit (dhe mijëra pasardhësve të tyre besimtarë) për të patur realisht në zotërim trashëgiminë që Perëndia u premtoi atyre. Zanafilla, 15:7-18 thotë haptazi që Perëndia i premtoi t’u jepte vendin Abramit dhe farës së tij. Sapo u lidh besëlidhja, ata zotëronin (në mënyrë të figurshme) hipotekën e tokës. Ata ishin “trashëgimtarë të premtimit”, siç edhe shprehet Dhiata e Re (Heb 11:9). Vendi u takonte atyre ligjërisht; por ata kurrë nuk e zotëruan atë plotësisht. Abrami banoi “në tokën e premtuar, si në një dhe të huaj, dhe ndenji në çadra bashkë me Isakun dhe Jakobin” (11:9).

Por kjo nuk duhet të na çudisë. Në parathënien e besëlidhjes, përmes së cilës Perëndia garantonte se do t’ua jepte vendin Abramit dhe farës së tij, thuhej që asnjë prej pasardhësve të Abramit nuk do ta zotëronte atë për 400 vjetët e ardhshëm (Zan 15:13). Burra dhe gra, besimtarë me famë, si Jozefi dhe nëna e Moisiut, dhe madje edhe vetë Moisiu, vdiqën para se Jozueu nisi zotërimin e pjesshëm, dhe shpesh të ndërprerë, të vendit nga ana e Izraelit. Nëse Krishti nuk qe fara për të cilën flet besëlidhja, nëse nuk ka ringjallje dhe asnjë fije shprese për të trashëguar vendin bashkë me të, atëherë ata kurrë nuk do të shohin përmbushjen e premtimit të besëlidhjes, kurrë nuk do të zotërojnë vendin për të cilin besëlidhja u dha hipotekën. Nëse

do të ishte kështu – falë Zotit nuk është – për aq sa lidhet me ata vetë, premtimi i besëlidhjes nuk do të qe më i mirë se Marksizmi, që bindi miliona njerëz të luftonin, vuanin dhe vdisnin me shpresën e një utopie që iu premtua se do të vinte patjetër, por që ata vetë realisht nuk do të rronin ta shihnin të realizuar. E vetmja mënyrë që vetë Abrami do të përjetojë përmbushjen e premtimit është nëse fara është, ashtu si thotë Dhiata e Re, Krishti. Sidoqoftë, duke qenë se është Krishti, premtimi është i sigurt për të dhe për të gjithë pjesën tjetër të farës (Rom 4:16).

Qëllimi historik dhe funksioni i ligjit në lidhje me trashëgiminë e premtuar

Interpretimi i Palit për besëlidhjen pa kushte, të njëanshme të Perëndisë me Abramit dhe farën e tij, si diçka e ndryshme dhe e pandikuar nga ligji i Sinait, ngre në mënyrë të pashmangshme dy pyetje. Të dyja ato, ai i shtron në Letrën e tij drejtuar Galatasve dhe iu përgjigjet vetë atje.

‘A është ligji atëherë kundër premtimeve të Perëndisë?’

Dikush që lexon në mënyrë të pavëmendshme interpretimin që bën Pali, mund të supozojë që ai e përbuzte ligjin, dhe nënkuptonte se dhënia e ligjit prej Perëndisë për Izraelin për shumë shekuj të gjatë qe një episod i gjerë në historinë e Izraelit, gjatë të cilit Perëndia po vepronte jo në përputhje me premtimet që i kishte bërë më parë Abramit. Por Pali nuk thotë asgjë të tillë. Larg qoftë! Ai këmbëngul që ligji kishte një qëllim pozitiv strategjik në historinë e Izraelit. Ishte e vetmja mënyrë që Perëndia dinte për ta sjellë Izraelin – dhe botën – në atë lloj gjendje shpirtërore, në të cilën ata do të qenë të përgatitur për të pranuar trashëgiminë e premtuar me ato kushte që ai do t’u parashtronte atyre.

E drejta për trashëgiminë dhe, për pasojë, edhe shijimi i përmbushjes të premtimeve, ishte në mendjen e Perëndisë gjithmonë diçka që do të varej nga besimi i njerëzve në Krishtin. Prandaj Pali e përshkruan premtimin si “premtimin e bërë nga besimi në Krishtin Jezus” (Gal 3:22). Prandaj e drejta dhe shijimi

mund t’u jepej “vetëm atyre që besojnë” (3:22).

Por ç’do të thotë “besim në Krishtin Jezus” dhe “të besosh” në këtë kontekst? Për Palin ato do të thonë që të braktisësh besimin te vetja dhe te arritjet e meritura njerëzore dhe të besosh vetëm te Krishti. Por të arrish t’i sjellësh njerëzit te kjo pozitë është, çuditërisht, jo dhe aq e lehtë sa mund të tingëllojë në fillim. Prandaj, kur Perëndia ia imponoi ligjin Izraelit përgjatë shumë shekujve, e bëri për t’i përgatitur ata të përshtatnin qëndrimin e duhur ndaj farës së premtuar kur ai të vinte. Ligji u dha për të sjellë disa efekte të dëshiruara. Së pari, sipas Galatasve 3:19, i ndërgjegjësoi njerëzit edhe më shumë se çfarë ishte e drejtë dhe çfarë ishte e gabuar duke shpallur qartazi standardet e Perëndisë. Askush nuk mund të shkelë një ligj që nuk është dhënë. Dikush edhe mund të ngasë me shpejtësi të lartë në një zonë të banuar, por nëse autoritetet nuk kanë nxjerrë një ligj që kufizon shpejtësinë, ai njeri nuk mund të akuzohet se ka thyer ligjin. Ekzistenca e ligjit, nga ana tjetër, e ndërgjegjëson atë se ajo, që për të ishte shpejtësi e pranueshme, është në fakt e rrezikshme dhe e jashtëligjshme.

Për më tepër, ligji i Perëndisë i ndërgjegjësoi njerëzit për seriozitetin e mëkatit përmes ndëshkimeve që jepte. U mësoi atyre që mëkati do të shkatërronte gëzimin e trashëgimisë; dhe në këtë mënyrë ligji kufizoi shkeljet.

Por edhe më seriozisht, ai vuri në dukje faktin që disa izraelitë – disa herë ata qenë të shumtë – nuk qenë si Abrami, besimtarë të vërtetë në Perëndinë, por rebelë dhe tradhëtarë, që kryen dhe nxitën padrejtësi të mëdha shoqërore, braktisën adhurimin e Perëndisë së vërtetë dhe u shërbyen idhujve (shihni librat historikë dhe profetikë të Dhiatës së Vjetër).

Nga ana tjetër, kishte disa gjëra që Ligji nuk mund t’i bënte. Sipas Galatasve 3:20-21, ligji nuk ishte dhe nuk është kundër premtimeve të Perëndisë. Qëllimi i tij nuk ka qenë kurrë të shfuqizojë premtimet e bëra nga Perëndia për njerëzit e tij besnikë, që ndoqën hapat e besimit të Abramit (shih Rom 4:12). Por kjo i bëri ata vazhdimisht të ndërgjegjshëm që, sado që u përpoqën me sinqeritet dhe fuqishëm të zbatonin ligjin e Perëndisë, ata dështuan në mënyrë të pashmangshme dhe merituan ndëshkimet e tij. Për të përdorur frazeologjinë e

gjallë të Palit, ai “i burgosi nën mëkat” që ata të kuptonin se shpresa e tyre e vetme për të qenë të shfajësuar nuk qe përmes përpjekjeve të tyre për të zbatuar ligjin, por përmes besimit në Krishtin, si Shpengues dhe Shpëtimtar. Derisa Krishti të vinte dhe të shpallej plotësisht ungjilli i shfajësimit përmes besimit, mbi bazën e sakrificës së tij shlyese, ligji veptoi si skllavi në një familje romake, i cili ishte përgjegjës për sjelljen e bijve dhe i qortonte dhe ndëshkonte nëse ata nuk silleshin si duhej.⁶

Për më tepër, sipas Galatasve 3:21 dhe 4:1–7, ligji nuk u dha për të sjellë jetë. Pali ka treguar kujdes të theksojë që ai nuk po përbuz ligjin; ai thjesht po tregon që është në thelb i paafte: nuk mund të japë jetë. “Nëse,” thotë ai, “do të mund të jepej një ligj që dhuron jetë, atëherë drejtësia do të ishte vërtetë përmes ligjit” (Gal 3:21). Por “dhurata e jetës” është diçka që ligji nuk mund ta bëjë, dhe kurrë nuk pati si qëllim ta bëjë. Ai na tregon si mund të jetojmë; ai nuk mund të na komunikojë jetë shpirtërore që zotëron natyrën dhe fuqinë për të jetuar si duhet. Vetëm dhurata e Frymës së Perëndisë përmes besimit në Krishtin mund ta bëjë këtë.

‘Për çfarë duhej pra ligji?’

Pali thotë që ligji luajti një rol shumë pozitiv dhe të rëndësishëm, ndonëse të përkohshëm, përgjatë kohës kur Izraeli ishte fëmijë dhe adoleshent frymërisht: “Ai u shtua për shkak të shkeljeve, deri sa të vinte pasardhja së cilës i qe bërë premtimi” (Gal 3:19), domethënë, derisa të mishërohej Biri i Perëndisë.

Pali nuk po i nënvlerësonte izraelitët: ai qe vetë i tillë (Rom 11:1). As nuk po thotë që asnjë izraelit nuk u fal apo u shfajësua ndonjëherë para se Jezusi të lindte, apo që asnjë hebre nuk u frymëzua si profet prej Perëndisë derisa të shkruhej Dhiata e Re. Kjo do të ishte marrëzi. Por ai po thotë që derisa Krishti të vinte, të vdiste si Qengj i Perëndisë – flijimi i vetëm i përsosur për mëkatet – të ngjallej, të ngjitej, të merrte premtimin e Atit dhe të pagëzonte popullin e tij në Frymën e Shenjtë, Izraeli nuk mund të

⁶ Sipas greqishtes së Palit, fjala për këtë skllav është παιδαγωγός (paidagōgos); por ajo nuk do të thotë të njëjtën gjë si fjala jonë e sotme “pedagog” – mësues, por thjesht edukator fëmijësh.

bëhej një bir i rritur i Perëndisë. Ata qenë ende frymërisht fëmijë dhe adoleshentë. Për këtë arsye Perëndia i mbajti përkohësisht nën ligj si forma më e përshtatshme e arsimimit frymëror deri atëherë.

Për të ilustruar se çfarë Pali do të thotë me këtë, ai përdor një analogji (Gal 4:1-7). Në kohën e tij, fëmija e një familjeje të madhe patrice romake, si bir i babait të tij, do të ishte trashëgimtar i pronës së babait të tij. Por derisa të rritej ai, nuk do t’i lejohej të prekte, dhe aq më pak të administronte, pasurinë e familjes. I ati do ta vendoste nën gardianë dhe tutorë, që do ta trajtonin jo shumë ndryshe nga një skllav – të gjithë këta po e përgatisnin për kohën kur do të rritej sa duhej për të qenë administrator i pasurisë së bashku me babain e tij. Në këtë mënyrë edhe izraelitët që besuan, argumenton Pali, u vendosën prej Perëndisë nën ligj, përgjatë shekujve të fëmijërisë së tyre frymërore, derisa të vinte koha në histori kur Perëndia do të dërgonte Birin e tij, të lindur prej gruaje dhe të lindur nën vetë ligjin, i cili, si përfaqësues i tyre, mund të shpengonte ata që ishin nën ligj dhe të paguante për shkeljet e atij ligji. Kështu, u hap rruga që Perëndia të vendoste në zemrat e tyre vetë Frymën e Birit të tij dhe t’u jepte jetë dhe statusin e bijve të rritur të Perëndisë, të paracaktuar të kenë pjesë bashkë me Birin e Perëndisë në trashëgiminë, të cilën Perëndia e premtoi me besëlidhje për t’ia dhënë Abramit dhe farës së tij, dhe pafundësisht shumë e më shumë përveç kësaj.

Krishti, ndërmjetësi dhe garanti i besëlidhjes së re

Nuk mund ta përfundojmë këtë studim të interpretimit të Dhiatës së Re për besëlidhjet e Dhiatës së Vjetër pa marrë në shqyrtim besëlidhjen e re për të cilën vetë Krishti është ndërmjetësi (Heb 12:24 ;9:15 ;8:6) dhe garanti (Heb 7:22).

Ekzekutimi i besëlidhjes së re

Idea se Perëndia do të bënte një ditë një besëlidhje të re me shtëpinë e Izraelit dhe me shtëpinë e Judës, nuk ishte një shpikje e të krishterëve të hershëm. Diku rreth shekullit të gjashtë apo të shtatë para Krishtit, Perëndia kishte shpallur tashmë përmes Jeremias që ai do të themelonte një ditë një besëlidhje të tillë, dhe

kishte përshkruar se cilat do të qenë kushtet (Jer 31:31–34). Qe pikërisht themelimi i kësaj besëlidhjeje të re që Zoti ynë shpalli kur në Dhomën e Sipërme ai mori një kupë me verë dhe, pasi ua dha dishepujve të tij, tha: “Kjo kupë është besëlidhja e re në gjakun tim, që është derdhur për ju.” (Luke 22:20).

Besëlidhjet që ne kemi studiuar deri tani në Dhiatën e Vjetër – besëlidhja me Abramit dhe farën e tij (Zan 15), besëlidhja me Izraelin në Sinai (Exod 24), dhe besëlidhja e bërë nga princat dhe populli (Jer 34) – të gjitha ishin, si të thuash, të firmosura, vulosura dhe të merituar dhe, si rrjedhim, të vendosura me ligj kur flijimet e besëlidhjes u bënë dhe ceremonitë përkatëse u zbatuan. Po kështu edhe besëlidhja e re: ajo u themelua kur Krishti ofroi veten si flijimi i besëlidhjes mbi kryq.

Besëlidhja e re “është bazuar” (Heb 8:6, shkruar rreth vitit 64 pas Krishtit), domethënë që është tashmë themeluar ligjërisht. Kur “i gjithë Izraeli”, d.m.th. Izraeli si i tërë, do të kthehet te Zoti dhe të jetë shpëtuar (Rom 11:25–27), atëherë Izraeli dhe Juda do të përfitojnë prej besëlidhjes së re. Por vetë besëlidhja e re është në fuqi prej shumë kohësh tani: ajo u ekzekutua në Kalvar. Besimtarët hebrenj, të cilëve iu drejtua ajo letër, u siguruan mbi bazën e besëlidhjes së re që mëkatet e tyre qenë fshirë prej regjistratit të Perëndisë dhe nuk do të përdreshin më kundër tyre si akuza (Heb 10:14–18). Për shkak se besëlidhja e re që themeluar, besëlidhja e vjetër, me tabernakullin, priftërinë dhe flijimet e saj, që vjetëruar dhe kishte mbaruar (Heb 8:13). Besimtarët johebrenj nuk ishin ndonjëherë nën besëlidhjen e vjetër, dhe, para se të ktheheshin te Krishti, qenë “të huaj për besëlidhjen e premtimit” – përfshirë këtu edhe besëlidhjen e re. Por tani në Krishtin, atyre iu tha (Efes 2:12–22) se nuk ishin më të huaj dhe bujtës. Që nga fillimet e epokës së krishterë qofshin besimtarët hebrenj, qofshin johebrenj mësuan se sa herë që pinin prej kupës së Darkës së Zotit, duhej të kujtonin se ishte besëlidhja e re në gjakun e Krishtit (1 Kor 11:25).

Epërsia e besëlidhjes së re

Dobësia themelore e besëlidhjes së vjetër ishte se që një besëlidhje e dyanshme, siç edhe e kemi parë më lart. Perëndia parashtrioi

ligjet e tij para popullit dhe ata premtuan nga ana e tyre se do t’i zbatonin ato të gjitha. Por nuk e mbajtën fjalën: “ata e shkelën besëlidhjen time”, thotë Perëndia (Heb 8:9 - ata nuk qëndruan besnikë”, Jer 31:32). Problemi i tyre që “dobësia e mishit”, siç shprehet edhe Pali (Rom 8:3); ata nuk i përmbushën premtimet e tyre, sepse nuk kishin fuqi morale dhe frymërore për ta bërë.

Besëlidhja e re “bazohet mbi premtime më të mira” (Heb 8:6). Kjo është e vërtetë për dy arsye. Së pari kushtet e besëlidhjes së re, pa përjashtim, lidhen me atë që Perëndia premton se do të bëjë. Nuk thuhet gjë për atë që njerëzit duhet të bëjnë apo premtojnë të bëjnë. Nga fillimi në fund, kushtet e besëlidhjes së re specifikojnë atë që vetë Perëndia ka marrë përsipër të bëjë (Jer 34–31:33; Heb 12–8:10).

Perëndia premton të fusë ligjet e tij në mendje dhe t’i shkruajë ato në zemra. Vetë Dhiata e Re gjetkë shpjegon që Perëndia e bën këtë duke dhënë Frymën e tij jetë-dhënëse, përtëritëse, që shkruan ligjet e Perëndisë, jo mbi pllaka guri, siç bëri në Sinai, por në pllaka të zemrave njerëzore (2 Kor 3:3), duke e bërë të mundur për besimtarët të bëjnë atë që ligji me të drejtë e kërkon (Rom 8:3–4).

Përfundimi do të jetë jo vetëm një ndërgjegjësim i përgjithshëm se ka një Perëndi, por një marrëdhënie e thellë me Perëndinë dhe një njohje personale e drejtpërdrejtë e Perëndisë:

...do të jem Perëndia e tyre dhe ata do të jenë populli im.
Dhe askush nuk do të mësojë më të afërmin e tij, askush
vëllanë e vet, duke thënë: “Njih Perëndinë!”. Sepse të
gjithë do të më njohin, nga më i vogli e deri tek më i
madhi prej tyre. (Heb 8:10–11)

Po për fajet dhe mëkatet e tyre? Premtimi i Perëndisë është:

...unë do të jem i mëshirshëm për paudhësitë e tyre dhe
nuk do të kujtoj më mëkatet e tyre dhe keqbërjet e tyre
(Heb 8:12)

Jo vetëm kaq. Fakti që besëlidhja e re është ekzekutuar mbi premtime më të mira sesa ato që Izraeli bëri në Sinai, është i vërtetë për një arsye tjetër gjithashtu: Zoti Jezus është ndërmjetësi dhe garanti i besëlidhjes së re.

Krishti dhe besëlidhja e re

Ai është ndërmjetësi (Heb 8:6; 9:15; 12:24) dhe është denjësisht i kualifikuar për të vepruar si i tillë. Si Perëndi dhe njeri njëkohësisht, ai mund të përfaqësojë Perëndinë para nesh, qenieve njerëzore, dhe ne qeniet njerëzore para Perëndisë. Ai e bëri këtë në mënyrë supreme në Kalvar kur e ofroi veten si flijim besëlidhjeje, duke bërë të mundur që Perëndia të përmbushë me drejtësi kushtin e tretë të besëlidhjes: “unë do të jem i mëshirshëm për paudhësitë e tyre dhe nuk do të kujtoj më mëkatet e tyre dhe keqbërjet e tyre”.

Gjithashtu ai na “ka bërë të njohim emrin e Atit” dhe na ka premtuar të bëjë kështu akoma më shumë (Gjoni 17:6, 26) që ne të njohim Atin dhe të shohim dritën e njohurisë së Perëndisë në fytyrën e Jezus Krishtit. Kjo bën të mundur, qoftë për Perëndinë dhe qoftë për ne, një marrëdhënie personale të një realiteti të thellë të premtuar në kushtin e dytë të besëlidhjes së re: “do të jem Perëndia e tyre dhe ata do të jenë populli im.”

Por Krishti nuk është vetëm ndërmjetësi i besëlidhjes së re: ai është garanti. Nuk varet nga ne dhe as nga përpjekjet tona të dobëta për të përmbushur kushtet e besëlidhjes. Krishti është zotuar vetë ta bëjë këtë në emrin tonë, si garant që do të përmbushë të gjitha kushtet e besëlidhjes. Sepse ai është garanti. Letra e Hebrenjve nxjerr përfundimin: “prandaj edhe mund të shpëtojë plotësisht ata që me anë të tij i afrohen Perëndisë” (Heb 7:22, 25).

Dhiata e Re këmbëngul që besëlidhja e vjetër, e dhënë në Sinai, dhe e shkruar mbi pllaka guri, ishte jashtëzakonisht e lavdishme. Por ajo shton: “Sepse, në qoftë se ajo që duhet të anulohet u rrethua me lavdi, ajo që mbetet do të jetë shumë më e lavdishme.” (2 Kor 3:7–11).

...

Pyetjet e studimit për këtë kapitull mund t’i gjeni
në faqen 436.

KATEGORIA E TRETË

Figura letrare

11 Citate dhe referime

Në këtë kapitull, dhe ata të katërt që vijojnë, ne do të shqyrtojmë shtatë figura letrare kyç që shkrimtarët e Dhiatës së Re i kanë përdorur për të përvetësuar mësimet e Dhiatës së Vjetër. Mjeti i parë dhe më i thjeshtë i atyre është citati ose referimi i ndonjë ligji, parimi, këshille, premtimi, personazhi apo ngjarjeje. Do të mjaftojë për qëllimet tona të përmendim vetëm disa shembuj, sepse kjo çështje është e thjeshtë dhe nuk kërkon shumë komente shtesë.

Ligje

1. ‘Do të nderosh atin dhe nënën tënde’, thotë LiP. 5:16. ‘Do të nderosh atin dhe nënën tënde’, thotë Efesianëve 6:2, dhe vëren që ky është urdhërimi i parë në Dekalog që shoqërohet me një premtim të cilin e citon në vijim: ‘që ti të jesh mirë dhe të jetosh gjatë mbi dhé’

2. ‘Nuk do të tundoni Zotin’, thotë Dhiata e Vjetër (LiP 6:16). ‘Mos e tundo Zotin, Perëndinë tënd’, tha Krishti, ndërsa e zbatoi për veten këtë ligj përballë tundimit të djallit (Mat 4:7).

Parime

1. Habakuku 2:4 parashtron parimin ‘i drejti do të rrojë për shkak të besimit të tij’; dhe ky parim është cituar në Dhiatën e Re si diçka themeltare për shpëtimin (p.sh Rom 1:17; Gal 3:11).

2. ‘Abrahami, ati ynë, a nuk u shfajësua me anë të veprave, kur e ofroi birin e vet, Isakun, mbi altar?... Gjithashtu a nuk u shfajësua edhe Rahabi, lavirja, nga veprat, kur i priti të dërguarit dhe i përcolli nga një udhë tjetër?’ Kështu argumenton Jakobi në Dhiatën e Re (2:21–25) ndërsa zbaton të njëjtin parim për lexuesit e tij dhe kërkon që ata që janë shfajësuar prej besimit, siç ishte Abrahami (2:23), të demonstrojnë realitetin e besimit të tyre përmes veprave të tyre.

Këshilla

1. ‘Biri im, mos e përçmo ndëshkimin e Zotit dhe mos urre qortimin e tij, sepse Zoti qorton atë që do, si një baba djalin që atij i pëlqen.’ Kështu thoshte një fjalë e urtë e lashtë (Prov 3:11–12); dhe shkruesi i Hebrenjve i qorton butësisht bashkëbesimtarët e krishterë, sepse dukej që e kishin harruar këtë këshillë të Dh.V. (Heb 12:5–6).

2. Ilaçi i psalmistit për një jetë të gjatë dhe të mirë (Ps 34:12–16) përsëritet tekstualisht nga apostulli Pjetër:

Sepse “kush don ta dojë jetën dhe të shohë ditë të mira, le ta ruajë gojën e tij nga e keqja dhe buzët e tij nga të folurit me mashtrim; të largohet nga e keqja dhe të bëjë të mirën, të kërkojë paqen dhe të ndjekë atë, sepse sytë e Zotit janë mbi të drejtët dhe veshët e tij janë në lutjen e tyre; por fytyra e Zotit është kundër atyre që bëjnë të keqen”. (1 Pjet 3:10–12)

Premtime

1. ‘Nuk do të të lë, as nuk do të të braktis.’, i tha Perëndia Jozueut kur Izraeli po bëhej gati për të hyrë në tokën e premtuar (Joz 1:5). Hebrenjve 13:5 përsërit premtimin; dhe miliona besimtarë në të gjitha epokat kanë përfituar prej tij, ashtu si edhe Jozueu, nxitjen dhe forcën e domosdoshme për vepra të guximshme.

2. ‘Sepse ja, unë krijoj qiej të rinj dhe një tokë të re’ (Isa 65:17). Këtë premtoi Perëndia në Dhiatën e Vjetër; dhe Pjetri duke u mbështetur mbi atë thotë: ‘Por ne, sipas premtimit të tij,

presim qiej të rinj dhe tokë të re' (2 Pjet 3:13).

Personazhe

1. 'Ju keni dëgjuar për durimin e Jobit, dhe e keni parë fatin përfundimtar që Zoti i rezervoi, sepse Zoti është plot mëshirë e dhembshuri.', thotë Jakobi (5:11), ndërsa komenton jo vetëm rreth librit të Jobit, por edhe më specifikisht për përfundimin e tij.

2. 'Kujtoni gruan e Lotit', paralajmëroi Krishti, dhe priste që dëgjuesit e tij të dinin sesi historia e saj lidhej me situatën e ardhshme që ai po parashikonte (Luka 17:32).

3. 'Dhe çtë them më? Sepse nuk do të më mjaftonte koha, po të doja të tregoja për Gedeonin, Barakun, Sansonin, Jeftin, Davidin, Samuelin. . .' (Heb 11:32). Të gjithë ata, sipas shkruesit të Hebrenjve, kryen vepra të mëdha besimi – ndonëse ai na e lë neve të plotësojmë detajet e hollësishme nga njohja jonë e Dhiatës së Vjetër.

Ngjarje

1. Krishti vëreu se 'Asnjë profet nuk mirëpritet në atdheun e vet. Në të vërtetë po ju them se në kohën e Elias, kur qielli u mbyll për tre vjet e gjashtë muaj dhe u bë një uri e madhe në gjithë vendin, ishin shumë të veja në Izrael; e megjithatë tek asnjëra nga ato nuk u dërgua Elia, përveç se te një grua e ve në Sareptë të Sidonit. Dhe në kohën e profetit Elize kishte shumë lebrozë në Izrael; megjithatë asnjë prej tyre nuk u pastrua, përveç Naamanit Sirian' (Luka 4:24–27).

2. Dy raste historike që Krishti përmend janë veçanërisht solemne dhe edukative: "Banorët e Ninivesë do të ringjallen në gjyq bashkë me këtë brez dhe do ta dënojnë, sepse ata u penduan me predikimin e Jonas; dhe ja, këtu është një më i madh se Jona. Mbretëresha e jugut do të ringjallet në gjyq bashkë me këtë brez dhe do ta dënojë, sepse ajo erdhi nga skaji më i largët i tokës për të dëgjuar diturinë e Salomonit; dhe ja, këtu është një më i madh se Salomoni." (Mat 12:41–42)

Krishti po përshkruan se çfarë do të ndodhë në gjykimin e fundit (në të cilin, natyrisht, ai do të jetë vetë gjykatësi: shih Gjoni

5:22-23), kur të vijë radha e bashkëkohësve të tij. Thelbi i çështjes është nëse kishte prova të mjaftueshme për bashkëkohësit e tij për t'i bindur ata përtej çdo dyshimi se Jezusi ishte Krishti, Biri i Perëndisë dhe Shpëtimtari i botës, dhe t'i shtynte të pendoheshin dhe të besonin tek ai. Për të provuar se ishin mëse të mjaftueshme provat që dispononin ata – vetëm u duhej t'i shqyrtonin ato seriozisht – "prokuroria" thërret dy dëshmitarë.

Së pari, popullin e Ninivesë. Prova e vetme që ata kishin, se Perëndia po u bënte thirrje të pendoheshin, ishte shenja dhe predikimi i Jonës; dhe ata u penduan. Në dallim me ata, bashkëkohësit e Krishtit dëgjuan predikimin – dhe do t'u flitej edhe për ringjalljen – e një më të madhi se Jona. Por kaq të vendosur ishin të mos e besonin atë, saqë kur nuk mund të mohonin fuqinë mbinatyrore të mrekullive të tij, ata ia atribuonin ato Satanit, duke e quajtur të zezë atë që, në rrethana të tjera, do ta quanin të bardhë. (Mat 12:22–37).

Dëshmitari *i dytë* që do të thërriste "prokuroria" ishte mbretëresha e Jugut. E vetmja provë që ajo kishte në vendin e saj ishte raporti se në një vend të largët ishte një mbret i pajisur me urtësi të veçantë, të dhënë prej Perëndisë. Por kaq e vendosur ishte ajo për të patur urtësi të vërtetë, saqë udhëtoi prej shumë larg për të dëgjuar urtësinë e Salomonit. Në të kundërt me të, bashkëkohësit e Krishtit, duke e patur në mes tyre urtësinë e Perëndisë të mishëruar, pohuan se qe i marrë, dhe as nuk morën mundimin të dilnin nga dera e shtëpisë për ta dëgjuar çfarë thoshte ai.

Atëherë në gjykimin e madh, dëshmia e popullit të Ninivesë dhe ajo e Mbretëreshës së Shebës do të zhbëjë të vetmin shfajësim të vlefshëm që mund të kishin bashkëkohësit e Krishtit për të mos besuar, d.m.th. që nuk kishin patur mjaft prova (shih Gjoni 25–15:22).¹

¹ Nuk ka pse të përmendim që Krishti i konsideronte të dyja ato ngjarje si historike. Kështu që libri i Jonës nuk është një novelë fetare. Personazhet e trilluara të nove-lave nuk mund të dalin dëshmitarë në bankën e gjyimit si dëshmitarë të thirrur prej prokurorisë kur të bëhet gjyqi përfundimtar!

Një shembull tipik

Kjo listë e shkurtër e citateve dhe referimeve të pjesëve nga Dhiata e Vjetër mund të vazhdojë shumë gjatë. Por është thënë mjaftueshëm për të ilustruar këtë mjet të thjeshtë gjuhësor që lejon përvetësimin e mësimave nga Dhiata e Vjetër. Ne tani duhet t'u kthehemi mjeteve të tjera gjuhësore.

...
Pyetjet e studimit për këtë kapitull mund t'i gjeni
në faqen 437.

12

Krahasime formale, Krahasime të thjeshta dhe Metafora

Le të fillojmë edhe njëherë me më të qartat.

Krahasime formale

Dhiata e Re shpesh krahason apo ballafaqon formalisht situata, ngjarje dhe njerëz me situata, ngjarje dhe njerëz të përshkruar në Dhiatën e Vjetër. Shqyrtoni shembujt e mëposhtëm:

i cili (Jezusi) është besnik ndaj atij që e bëri, *ashtu si* që edhe Moisiu në tërë shtëpinë e tij.. (Heb 3:2, që riprodhon lavdërimin e Perëndisë posaçërisht për besnikërinë e Moisiut nga Num 12:7)

Dhe, ashtu siç ndodhi në kohën e Noes, *ashtu* do të ndodhë edhe në ditët e Birit të njeriut. (Luka 17:26)

Ta duam njeri-tjetrin, *jo sikundër* Kaini, i cili ishte nga i ligu dhe vrau vëllanë e vet. (1 Gjoni 3:11–12)

Krahasime të tilla janë kaq të dukshme dhe të shumta, sa që ne nuk duhet ta zgjatim më shumë këtë çështje, përveçse të vëmë re që detajet e krahasimit, veçanërisht nga ana e Dhiatës së Vjetër, nuk bëhen të qarta gjithmonë. Supozohet që lexuesi (apo dëgjuesi) do ta njohë mjaft mirë historinë e Dhiatës së Vjetër, sa

të kuptojë krahasimet e hollësishme për vete.

Në bisedë me Nikodemin

Kjo është e vërtetë veçanërisht me krahasimin e famshëm mes Zotit, që e ngritën mbi kryq, dhe Moisiut që ngre lart gjarprin në shkretëtirë:

Dhe ashtu si Moisiu e ngriti lart gjarprin në shkretëtirë, kështu duhet të ngrihet lart Biri i njeriut, që kushdo që beson në të të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme. (Gjoni 3:14–15)

Natyrisht, po të duam që të jemi skolastikë, mund të këmbëngulim se e vetmja pikë e krahasimit që qartazi po bëhet, qëndron mes faktit të thjeshtë që Moisiu ngriti një gjarpër dhe faktit që Biri i Njeriut duhet të ngrihet lart. Ne mund të argumentojmë që përderisa as qëllimi për të cilin Moisiu ngriti lart gjarprin, dhe as rezultati i ngritjes së tij lart nuk përmendet në tekstin e Gjoni, nuk na lejohet të kërkojmë për detaje në tregimin e Moisiut të Dhiatës së Vjetër për të gjetur këto pika të tjera krahasimi.

Kjo mënyrë argumentimi nuk është thjesht pedantizëm, por edhe e paarsyeshme. Do ta thjeshtonte krahasimin vetëm në një simetri të thjeshtë formale (2 ngritje), e cila nuk do të ndihmonte as Nikodemin dhe as ne për të kuptuar se pse ishte e domosdoshme që Biri i Njeriut të ngrihej lart në mënyrë që besimtari të ketë jetë të përjetshme në të. Me fjalë të tjera, krahasimi do të ishte pa ndonjë vlerë nga ana interpretative; dhe një hermeneutikë që na shtyn në këtë drejtim do të ishte tejet e thjeshtëzuar.

Nëse, nga ana tjetër, na lejohet të krahasojmë detajet e papërmendura (në tekstin e Gjoni) të tregimit të gjarprit me detajet e bisedës së Zotit tonë me Nikodemin, do të dalin ngjashmëritë që përmenden në Tabelën 2.

Pak arsyetim do të tregojë që pikat e ilustruara nga ky krahasim ishin pikat për të cilat Nikodemi, në bisedën e tij me Krishtin, donte shpjegim dhe miratim.

Një tablo e goditur

Nikodemi filloi duke u habitur prej këmbënguljes së Zotit tonë që njerëzit duhet të linden prej së larti, të linden nga uji dhe Fryma, për të hyrë në mbretërinë e Perëndisë. Ai nuk duhej të çuditej aq shumë; si mësuesi kryesor në Izrael (Gjoni 3:10), ai duhej të mbante mend që rilindja e Izraelit, e premtuar përmes Ezekielit, do të ndodhte përmes ujit (Ezek 36:25) dhe Frymës (37:14). Kur ai, menjëherë pas kësaj, vazhdoi të pyeste Si mund të ndodhin këto gjëra?, përgjigjja mund të kishte qenë “përmes besimit në Birin e Njeriut të kryqëzuar”. Sidoqoftë, këto fjalë të forta dhe të drejtpërdrejta, mund ta kishin hutuar atë dhe nxitur skepticizmin e tij: ç’ide të çuditshme qenkan këto? Kush është ky Biri i Njeriut? Pse duhet të kryqëzohet? Si u lidhka kryqëzimi i tij me dhuratën e jetës së përjetshme nëse dikush vetëm beson në të?

	Numrat 21:4–9	Gjoni 3:14–16
1.	Për shkak se mëkatuan kundër Perëndisë, izraelitët u kafshuan nga gjarpërinjtë dhe po vdisnin.	Burra dhe gra duhet të shpëtohen prej humbjes.
2.	Për të shpëtuar njerëzit nga humbja Mosiu, i urdhëruar nga Perëndia, ngriti mbi një hu një gjarpër bronzi.	Që të shpëtohen njerëzit nga humbja, Biri i Njeriut duhet të ngrihet lart.
3.	Njerëzve që donin të shpëtoheshin iu tha që të shihnin drejt gjarpërit.	Njerëzve që duan të shpëtohen u thuhet të besojnë në Birin e Njeriut.
4.	Ata që e bënë këtë “jetuan”.	Ata që besojnë marrin jetë të përjetshme.

Tabela 2. Një krahasim mes Numrave 21 dhe Gjoni 3 rreth historisë së gjarpërit

Krishti, i shtyrë nga mëshira e tij, u parapriu vështirësive të Nikodemit duke iu referuar me mençuri një pasazhi nga Dhiata e Vjetër (dhe për të ky pasazh qe i frymëzuar dhe i besueshëm) që përshkruante ngritjen e gjarpërit në shkretëtirë dhe, për të thjeshtuar krahasimin, Krishti qëllimisht iu referua vdekjes së tij të afërt jo si kryqëzim, por si ngritje lart. Sepse ndonëse

Moisiu nuk e kryqëzoi gjarpërin, ai e ngriti lart atë; po ashtu do të ngrihej Biri i Njeriut. Ndoshta Nikodemi kishte filluar tashmë të kuptonte se nuk do të ishte edhe aq e çuditshme në fund të fundit që t’u jepej jetë e përjetshme atyre që besuan në Birin e Njeriut të ngritur lart; sepse, sipas tregimit të Numrave 21:4–9, qëllimi i ngritjes së gjarpërit të bronzit nga Moisiu mbi një hu ishte se kushdo që u kafshua nga një gjarpër, dhe ishte në rrezik të vdiste, ai mund të jetonte, shërohej, dhe të fitonte jetë të re duke parë drejt gjarpërit të bronzit në hu.

Kjo mund të ketë hapur oreksin e Nikodemit për pyetje të tjera: pse para së gjithash po humbisnin njerëzit në kohën e Moisiut? Si një studiues i Dhiatës së Vjetër ai do ta ketë ditur historinë përmendësh dhe thjesht duhej ta kujtonte atë. Izraelitët u kafshuan nga gjarpërinjtë, dhe po vdisnin si një ndëshkim i dërguar nga Perëndia për mëkatet e tyre (Num 21:6). Por vetë fakti që Krishti ia përmendi këtë rast Nikodemit, nënkuptonte që Nikodemi, pavarësisht shkollimit të tij biblik dhe teologjik apo statusit të tij si rabin i vjetër (Gjoni 3:10), ishte po aq mëkatar sa paraardhësit e tij, nën zemërimin e Perëndisë, dhe duhej të shpëtohej prej Birit të Njeriut nga humbja e përjetshme.

Në regjistrimin që Gjoni i bën kësaj bisede, një nënkuptim i tillë mbetet i pashprehur; dhe në këtë shohim hirin, urtësinë dhe taktin e Krishtit. Nikodemi, si teolog, duhej ta pranonte lirisht se ai, së bashku me të gjithë njerëzit e tjerë, ishte mëkatar. Por t’i thoje një rabini shumë të shquar troç në fytyrë që ai ishte një mëkatar i pashpresë, që rrezikonte të humbte nëse nuk besonte në një Shpëtimtar të kryqëzuar, nuk do të ishte mënyra më e mirë për t’ia shtënë në zemër këtë fakt të vërtetë, por tronditës. Do të ishte më e sjellshme dhe efektive që ta përçoje një nënkuptim të tillë gradualisht, ndërsa ai vetë do ta mendonte mirë me veten e tij, pasi të largohej, kuptimin e këtij tregimi të Dhiatës së Vjetër.

Nëse ai do ta bënte këtë, tregimi do të ilustronte një pikë tjetër të rëndësishme. ‘Kështu duhet të ngrihet lart Biri i njeriut’, tha Krishti, ‘që kushdo që beson në të të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme’ (Gjoni 3:15). Ç’do të thoshte që të besojë? Pse ishte e domosdoshme të besojë në këtë Bir të Njeriut?

Kur Zoti ynë foli për domosdoshmërinë e të lindurit prej Frymës, Nikodemi e pranoi që nuk po e kuptonte. Si mund të

ndodhin këto gjëra?” pyeti ai (3:9). Por fakti që nuk po e kuptonte dot, nuk qe problemi i tij i vetëm. Ajo që ishte më thelbësore ishte dështimi i tij dhe i bashkëkohësve të tij për të besuar. “Në qoftë se ju fola për gjërat tokësore dhe ju nuk besoni”, tha Krishti, “si do të më besoni nëse ju flas për gjërat qiellore?” (3:12). Dhe të besojë në të dhe dëshminë e tij, në këtë kontekst, qe plotësisht e domosdoshme, ashtu si vazhdoi të shpjegonte Krishti, dhe kjo për arsyen që vijon: vetëm ai kishte njohuri që nuk i kishte askush tjetër për gjërat qiellore. Asnjë njeri nuk ishte ngjitur në qiell, dhe ishte kthyer më pas për t’i treguar racës njerëzore për ato realitete qiellore. Në dallim nga ata, Krishti, Biri i Njeriut, që ishte dhe, asnjëherë nuk pushoi së qeni, në miqësi të ngushtë me Atin, kishte zbritur në tokë për këtë qëllim. Nëse Nikodemi do t’i dinte ndonjë herë këtë gjëra, ai duhet t’i mësonte përmes besimit në dëshminë e Krishtit. Nëse nuk do ta besonte atë, ai kurrë nuk do t’i mësonte ato.

Prandaj çfarë do të thoshte të besojë? Dhe çfarë duhet të besojë? Si mund të fitojë besim të mjaftueshëm? Në tregimin e gjarprit mbi hu, e barabarta e *besimit* është *shikimi*: “ndodhte që, kur një gjarpër kafshonte dikë, në rast se ky shikonte gjarprin prej bronzi, ai vazhdonte të jetonte.” (Num 21:9). Analogjia është shumë ndihmëse qoftë nga ana psikologjike, qoftë nga ana frymërore. Nuk qe i rastësishëm, i kotë apo thjesht nga kureshtja shikimi që hodhën mbi gjarprin ata burra dhe gra që po vdisnin në shkretëtirë. Me urdhërin e Perëndisë ata panë nga gjarpri i bronzit që Perëndia kishte ngritur lart; dhe me këtë siguri, që nëse shihnin, do të jetonin (21:8), ata panë drejt tij duke lënë mënjane çdo gjë tjetër, si shpresa e tyre e vetme e shpëtimit. Kështu, përmes kësaj analogjie, Nikodemi do të dallonte se çfarë do të thoshte “kushdo që beson në Birin e Njeriut që duhet të ngrihet lart”: do të thoshte të dalloje që Biri i Njeriut i ngritur lart ishte mënyra e Perëndisë për ta shpëtuar atë; dhe pastaj të hiqje dorë nga të gjitha rrugët e tjera të shpëtimit, dhe të besojë për jetë të përjetshme vetëm në Birin e Njeriut. (krhs. shpjegimet e mëvonshme 1 Kor 1:23–25; Gal 6:14).

Megjithatë, kur mbaroi biseda atë natë, Nikodemi mund të ketë menduar çfarë kuptimi do të kishte saktësisht kjo “kështu duhet të ngrihet lart Biri i njeriut” dhe pse qe e domosdoshme

për shpëtimin e tij. Sigurisht që edhe afër fundit të shërbesës publike të Zotit, popullsinë e Jerusalemit e ngatërronte shumë kjo frazë. “Ne kemi dëgjuar nga ligji”, thanë ata, “se Krishti mbetet përjetë; tani si mund të thuash ti se Biri i njeriut duhet të ngrihet lart? Kush është ky Bir i njeriut?” (Gjoni 12:34). Por Nikodemi qe dëshmitar i kryqëzimit dhe me guxim mbajti anën e Krishtit dhe doli kundër Sinedrit duke dhënë ndihmën e tij në varrosjen e Krishtit. Pa dyshim që si të gjithë dishepujt e tjerë, ai e kuptoi rëndësinë e kryqit: “Sepse ai bëri të jetë mëkat për ne ai që nuk njihte mëkat, që ne të bëhemi drejtësia e Perëndisë në të.” (2 Kor 5:21). Dhe padyshim ai kuptoi që Krishti i ngritur lart është, në një kuptim tjetër, ringjallja dhe lartësimi i tij në të djathtën e Perëndisë.

Kuptimi pas detajeve

Mund të duket se kemi bërë diçka të mbrapshtë, dhe sigurisht të mërzitshme, pas gjithë kësaj kohe dhe mundimi për të provuar atë që miliona të krishterë ndër shekuj e kanë parë si diçka krejt të qartë. Por ne po argumentojmë për parimin që kur Dhiata e Re i referohet një ngjarjeje të Dhiatës së Vjetër, psalmi apo profecie të saj, për të kuptuar plotësisht çështjen dhe qëllimin e kësaj reference, mund të na kërkohet ndonjëherë që të sjellim ndër mend më shumë detaje nga pasazhi i Dhiatës së Vjetër nga ç’përmend në të vërtetë pasazhi i Dhiatës së Re. Kur e shohim si vepron ky parim në këtë rast të thjeshtë dhe të mirënjohur, do të na ndihmojë më vonë ta shohim atë në veprim në kontekste më të ndërlikuara.

Krahاسime të thjeshta

Ndryshe nga krahاسimet formale, krahاسimet e thjeshta nuk kanë pse të përdorin strukturën e plotë “*si x-i po ashtu edhe y-i*”; ato thjesht mund të prezantohen vetëm me fjalët “*si*” apo “*posi*”.

Një krahاسim i tillë është përdorur nga Pjetri: “duke ditur se jo me anë gjërash që prishen, *si* argjendi ose ari, jeni shpenguar ..., por nga gjaku i çmuar i Krishtit” (1 Pjet 1:18–19). Dhe aty ai mund ta kishte mbyllur deklaratën e tij. Mënyra si është shprehur ka shumë kuptim dhe thekson mjaftueshëm koston

e shpengimit tonë duke vënë në kontrast *gjakun* e Krishtit me *argjendin* dhe *arin*, dhe *gjakun e çmuar* të Krishtit, me *argjendin* dhe *floririn që prishet*. Por ai nuk e përfundon deklaratën e tij atje: ai shton një krahاسim, “nga gjaku i çmuar i Krishtit, *si të Qengjit të patëmetë dhe të panjollë*” (1:19).

Pse ky krahاسim? Ai nuk thekson thjesht karakterin e Krishtit – ai ishte i pafajshëm, jo i shtirë dhe zemërmirë si një qengj – ndonëse kjo është plotësisht e vërtetë, dhe kjo është pika që Isa 53:7 dhe 1 Pjet 2:21-23 theksojnë. Ai flet për shpengimin përmes gjakut si ai i një qengji; që do të thotë sigurisht se kjo është një referencë për ndonjë pjesë të sistemit të sakrificave të Dhiatës së Vjetër. Të gjithë qengjat që bëheshin kurban nën atë sistem duhej të ishin të patëmetë, çfarëdo lloj sakrifice që të qe. Por nëse ishte një çështje e shpengimit, atëherë, në atë drejtim, sakrifica e përsosur ishte Qengji i Pashkës, përmes gjakut të të cilit izraelitët u shpenguan prej gjyqimit të Perëndisë dhe u çliruan nga skllavëria e Egjiptit (Eksodi 12).

Që ky ishte një aluzion i qëllimshëm nga ana e Pjetrit, kjo provohet edhe më tepër prej gjërave që kujton në lidhje me tregimin e Pashkës, të cilat i prezanton në këtë kapitull të parë të letrës së tij.

Trashëgimia e premtuar

Ne e kujtojmë se arsyeja që Perëndia e shpengoi Izraelin nga Egjipti ishte që t’i shpinte përfundimisht në një trashëgimi ku rridhte qumësht dhe mjaltë, për të cilën iu ishte betuar etërve të tyre t’ua jepte si zotërim (LiP 1:8). “Perëndia”, thotë Pjetri, “na rilindi [të krishterët] për një shpresë të gjallë ...për një trashëgim të paprishshëm, të panjollë dhe të pafishkur, që është ruajtur në qiejt për ju” (1 Pjet 1:3–4).

Besëlidhja e Sinait

I çliruar nga Egjipti, Izraeli, rrugës për në trashëgiminë e tij, mbërriti në Sinai. Aty Perëndia bëri me ata një besëlidhje dhe ata premtuan solemnisht se do t’i bindeshin kushteve të saj:

Pastaj mori librin e besëlidhjes dhe ia lexoi popullit, i cili tha: “Ne do të bëjmë tërë ato që ka thënë Zoti, dhe do t’i

bindemi”. Pastaj Moisiu mori gjakun, spërkati popullin me të dhe tha: “Ja gjaku i besëlidhjes që Zoti ka lidhur me ju sipas tërë këtyre fjalëve”. (Ekodi 24:7–8)

Duke kujtuar pikërisht këtë skenë dhe duke përdorur termat e saj simbolikë, Pjetri u drejtohet bashkë të krishterëve:

Pjetri... të zgjedhurve ... sipas paranjohjes së Perëndisë, Atit, me anë të shenjtërimit të Frymës, për t’u bindur dhe për t’u spërkatur me gjakun e Jezut Krishtit. . . . (1 Pjet 1:1–2)

Atëherë ne arrijmë në përfundimin se Pjetri në këtë kapitull po kujton qëllimisht shpengimin e Izraelit përmes gjakut, trashëgiminë që ishte qëllimi i udhëtimit të tyre në shkretëtirë, dhe bindjen për të cilën u betuan vetë rrugës për atje. Pse? Kuptohet, jo që të mburret me njohurinë e tij të detajuar të Dhiatës së Vjetër, por sepse ai beson që e gjithë historia e shpengimit të Izraelit ishte një histori e orkestruar nga Hyjnia për shpengimin tonë përmes Krishtit. Ai e përdor këtë histori si një ilustrim të gjallë, të dhënë nga Perëndia për të na ndihmuar të kuptojmë me përfytyrimin tonë doktrinën e shpengimit dhe pasojat e saj, të cilat Dhiata e Re i prezanton para intelektit tonë. Ne jemi të shpenguar nga gjaku i Krishtit; ne po udhëtojmë drejt trashëgimisë tonë të përjetshme; dhe ne jemi çliruar, jo që të kënaqim veten, por të jetojmë një jetë bindjeje ndaj Shpenguesit tonë, përmes gjakut të të cilit jemi shpenguar.

Por ai bën më shumë se kaq; sepse te 1 Pjetrit 1:13 përdor një detaj tjetër nga historia e Pashkës, për të ngulur në mendjen e lexuesve të tij nevojën për të menduar seriozisht pasojat logjike të shpresës së tyre të krishterë.

Por këtë herë, ai përvetëson detajet e Pashkës jo me anë të një krahاسimi, por të një metafore. Prandaj le të mbajmë mend dallimin mes krahاسimeve dhe metaforave.

Metaforat

Krahاسimi është kur një gjë, përvojë apo aktivitet krahاسohet në mënyrë të hapur me një tjetër: “frika e lidhte atë *si* një zinxhir”. Metafora është kur një gjë, përvojë apo aktivitet, në vend që të

krahasehet me një gjë tjetër, përshkruhet me fjalë që përdoren për atë: “qeveria e ka zënë për fyti opozitën”. Shprehja “zë për fyti” është marrë nga sporti i mundjes, në të cilin një lojtar mund të kapë trupin e kundërshtarit në një mënyrë që kundërshtari nuk mund të lëvizë pa këputur qafën. Duke qenë e përdorshme për të përshkruar një garë mundjeje, ky term nënkupton një ndeshje fizike, kur krahët e vërtetë kanë mbërthyer qafën reale. Por kur themi “qeveria e ka zënë për fyti opozitën”, nuk po flasim më për një garë force në të cilën duart e vërteta kanë kapur trupa të vërtetë. Po flasim për një garë të një lloji tjetër, ku nuk ka kontakt fizik fare. Por ja që mund të përshkruhet me fjalë të marra nga mundja fizike, sepse kjo garë është në mënyrën e vet një lloj mundjeje. Për shkak se taktikat qeveritare e kanë vënë opozitën në një pozitë që nuk mund të lëvizë pa e dëmtuar veten, kjo po ashtu mund të përshkruhet si një lloj kapjeje prej fyti.

Prandaj metafora është një mënyrë e gjallë për të sjellë në mendje një tablo. Ajo përdor një proces në një fushë që njihet nga lexuesi, për ta ndihmuar atë të kuptojë një proces të ngjashëm që po ndodh në një fushë tjetër. Metafora nuk është e kufizuar vetëm për fushën letrare apo akademike. Për të mos thënë që edhe njerëz me përvojë dhe fjalor të kufizuar janë të prirur të përdorin metafora më të shpeshta dhe të gjalla sesa të tjerët. Kur dikush është shumë i zemëruar nga një tjetër, ai thotë: “do ta ndaj më dysh!”, ndoshta pa e ditur ai po përdor një metaforë; por ai merr vesh nga punët e kasapit. Prandaj e vetmja mënyrë që ai mund të mendojë për atë të keqe që do t’i bëjë armikut të tij, është të flasë për të sikur do të therte një bagëti.¹

Metafora e Pjetrit dhe origjina e saj

Prandaj, *ngjeshni ijët e mendjes suaj*, rrini zgjuar dhe mbani shpresë të plotë në hirin që do vijë mbi ju në zbulesën e Jezu Krishtit. (1 Pjet 1:13)

¹ Ata nga ne që nuk kanë therur ndonjëherë gjë të gjallë, nuk mund të kuptojnë se “të ndash më dysh” vjen nga përvoja e kasapit dhe që kjo shprehje është metaforike. Nëse ajo do të përdoret për sendet ajo e humbet kuptimin e saj të figurshëm dhe tregon diçka që aktualisht ndahet më dysh.

Mendjet nuk kanë ijë! Prandaj “Ngjeshni ijët e mendjes suaj” është dukshëm një metaforë, por burimi i saj mund të mos jetë aq i dukshëm për ne sot siç ishte për Pjetrin. Ajo e ka zanafillën prej një nevojë praktike. Ka qenë e zakonshme në botën e lashtë, siç është edhe aktualisht sot, që burrat të vënë një brez të fortë në ijë, për të ndihmuar mesin që të përballojë punën apo barrën e rëndë që po ngre. Në Lindjen e Mesme burrat vishnin zakonisht një rrobë të gjatë nga jashtë. Por kur punonin gjatë apo u duhej të bënë një copë udhë, ata do të ngrinin fundin e rrobave të tyre të gjata në mes dhe do ta lidhnin me rrip që të mos i pengonte në marshimin e tyre (për shembull, shih 1 Mbr 18:46). “Ngjeshni ijët e mendjes suaj”, do të thotë atëherë se “duhet të përgatitesh për punë apo udhëtim të gjatë”.

Burimi i veçantë i kësaj metafore ishte një ngjarje specifike kur lindi kjo domosdoshmëri praktike. Natën e Eksodit anëtarët e çdo familjeje izraelite duhej të piquin një qengj Pashke dhe ta hanin atë. Por nuk u lejohej ta hanin kur ata donin, sepse pjekja e qengjit të Pashkës ishte një pjesë e domosdoshme e përvojës së tyre të shpengimit. Porosia e dhënë ishte:

Do ta hani në këtë mënyrë: ijengjeshur, sandalembathur dhe me bastunin tuaj në dorë; do të hani me nxitim: se është Pashka e Zotit. (Eksodi 12:11)

Ijët e ngjeshura, këpucët dhe shkopi tregonin se qenë gati për t’u nisur menjëherë jashtë Egjiptit dhe të vazhdonin të udhëtonin derisa të mbërrinin në tokën e premtuar. Dhe kjo porosi këmbëngulte se nuk mund të haje prej qengjit të Pashkës nëse nuk ishte i gatshëm dhe i përgatitur për të udhëtuar. Një izraelit që mendonte se mund të mbrohej nga shkatërrimi i engjëllit përmes gjakut shpengues të qengjit, por do të qëndronte pastaj në Egjipt dhe nuk do të merrte mundimin për të udhëtuar drejt tokës së premtuar, do ta kishte keqkuptuar seriozisht natyrën e planit shpengues të Perëndisë. Kishte tri pjesë logjike të dallueshme në këtë plan: çlirimi nga Egjipti, udhëtimi në shkretëtirë dhe hyrja në tokën e premtuar. Por asnjë nga këto pjesë nuk qe me dëshirë. Të trja këto pjesë formonin një të plotë të pandashme. Ose i pranoje të treja me dëshirë dhe qëllimisht, ose asnjërin nga ato.

Zbatimi i metaforës nga Pjetri

“Ngjeshni ijët e mendjes suaj”, thotë ai; me fjalë të tjera përgatituni të bëni shumë punë. Çfarë lloji? Të mendoni për shpresën tuaj si të krishterë dhe rrjedhimet e hollësishme për qëndrimet dhe sjelljen tuaj aktuale. “Prandaj, ngjeshni ijët e mendjes suaj, rrini zgjuar dhe mbani shpresë të plotë në hirin që do vijë mbi ju në zbulesën e Jezu Krishtit.” (1 Pjetri 1:13)

Shpresa e vërtetë e krishterë nuk është një gjë e mjegullt, e cekët dhe e lojtur: ajo mbart rrjedhoja praktike me ndikim të gjerë; dhe ne duhet të mendojmë shumë dhe gjatë për të zbuluar se çfarë janë këto rrjedhoja dhe pastaj t’i zbatojmë ato saktësisht në sjelljen tonë.

Nëse jemi shpenguar nga gjaku i çmuar i Krishtit, kjo ka ndodhur që Perëndia të na sjellë në fund fare në trashëgiminë tonë qiellore, që nuk prisetet, nuk njolloset dhe nuk vyshket. Ndërkaq, jeta bëhet një udhëtim shtegtues moral dhe shpirtëror, gjatë të cilit besimi ynë sprovohet dhe rafinohet si ari, që “të dalë për lëvdim, nder e lavdi në zbulesën e Jezu Krishtit” (1 Pjet 7-1:5).

Sipas Dhiatës së Vjetër (Num 11:4-35), izraelitët nuk kishin shkuar edhe aq larg në udhëtimin e tyre drejt tokës së premtuar, kur e lejuan epshin t’i shmangte nga qëllimi i tyre fillestar dhe t’i kthente zemrat e tyre pas në Egjipt. Historia e tyre sjell më shumë forcë në nxitjen e Pjetrit:

... mbani shpresë të plotë... si bij të bindur, mos iu përshtatni lakmive të mëparshme kur ishit në padijen tuaj, por ashtu si është i shenjtë ai që ju thirri, të jini edhe ju të shenjtë në gjithë sjelljen tuaj. (1 Pjet 1:13-15)

Apostulli Gjon thotë të njëjtën gjë. Te 1 Gjonit 3:2-3 ai u kujton bashkëbesimtarëve të tij që ata janë tashmë fëmijë të Perëndisë dhe i siguron që, në ardhjen e dytë të Krishtit, ata do të jenë të ngjashëm me të. Por pastaj ai deklaron si një fakt kategorik: “kushdo që e ka këtë shpresë në të [Krishtin], le ta pastrojë veten, siç është i pastër ai.” Kushdo që nuk përpiqet të pastrojë veten, dhe nuk ka synim të veprojë kështu, nuk e ka shpresën të jetë i ngjashëm me Krishtin më pas.

Mendoni pak. Sikur të kishit një makinë kohe dhe të ktheheshit pas në histori, dhe të mbërrinit në Egjiptin e lashtë 10 vjet pas largimit të Moisiut dhe të izraelitëve për në tokën e premtuar. Sikur të takoheshit me një izraelit që ende jetonte në Egjipt. Kur e pyet, ai të tregon se ishte shpenguar prej gjakut të qengjit të Pashkës, dhe thotë se një ditë shpreson të shkojë në tokën e premtuar në një mënyrë apo në një tjetër. Por tani për tani ai nuk ka ndërmend të ngjeshë ijët e tij dhe të udhëtojë në shkretëtirë. Ai do që të qëndrojë në Egjipt. Dhe mendoni sikur ta pyesnit edhe më: “Po si do t’ia dalësh të mbërrish një ditë në tokën e premtuar?” dhe ai të përgjigjej: “Nuk e di. Nuk mendoj për gjëra të tilla.” Çfarë do t’i thoshit?

Pyetjet e studimit për këtë kapitull mund t’i gjeni në faqen 437.

13

Aluzione të drejtëpërdrejta

Një mjet tjetër, të cilin Dhiata e Re e përdor për të përfituar nga thesaret e Dhiatës së Vjetër që të ilustrojë mesazhin e saj, është përdorimi i aluzioneve të drejtëpërdrejta. Me efektet që krijojnë këto aluzione u ngjajnë krahasimeve formale dhe të thjeshta: ato na ftojnë të përjasim ndonjë person, apo ndonjë situatë në Dhiatën e Re me një person apo situatë të ngjashme në Dhiatën e Vjetër. Por forma e tyre letrare është e ndryshme. Një krahasim formal ndjek skemën: ‘*si* x-i *po ashtu* edhe y-i’. Një krahasim i thjeshtë përdor një ‘*si*’ apo ‘*posi*’ - ‘ai noto *si* një peshk’; ‘fluturon *posi* shigjetë.’ Një aluzion nuk përdor këta indikatorë formalë dhe flet më shumë drejtëpërdrejt.

Kështu, p.sh., në një letër drejtuar kishës në Tiatira, Zoti i gjallë qorton:

Por kam disa gjëra kundër teje, sepse ti e lejon gruan Jezebel, që e quan veten profeteshë, të mësojë dhe të mashtrojë shërbëtorët e mi të kurvërojnë dhe të hanë gjëra të flijuara idhujve. (Zbul 2:20)

Aluzionet e këtij lloji kuptohen lehtësisht, sepse ne përdorim të njëjtën mënyrë shprehjeje në shumë gjuhë moderne. Nëse ne themi për një njeri “Ai është një Hitler i kohëve tona!”, nënkuptojmë se ai është një tiran i llahtarshëm siç ishte Hitleri. Nëse themi për dikë tjetër që “Ai është një kuisling!”, nënkuptojmë që ai sillet si norvegjezi Vidkun Kuisling, që bashkëpunoi me gjermanët, dhe u shpërblye nga ata duke u

caktuar si kryeministri kukull i Norvegjisë. Kështu, kur Zoti ynë i referohet ndonjë mësuesi në kishën në Tiatira si “ajo grua Jezebel”, ai po e qorton atë mësues/e se po prish bashkëbesimtarët e tij/saj në të njëjtën mënyrë që Jezebeli, gruaja e Ahabit, mbretit të Izraelit, prishi burrin e saj dhe izraelitët në përgjithësi. Ajo i nxiti të braktisin Perëndinë e vetëm të vërtetë, dhe të adhuronin idhullin Baal (1 Mbr 18:13—19:2; 21:25–26).

Tani, aluzionet e drejtëpërdrejta që Dhiata e Re i bën Dhiatës së Vjetër janë lehtësisht të dallueshme për arsyen e thjeshtë që ato u referohen qartazi ndonjë personi apo situatë; edhe në qoftë se ai person apo situatë është një nga personat apo situatat më pak të njohur në Dhiatën e Vjetër, një konkordancë e mirë mund ta gjejë se ku është.

Nga ana tjetër, kur e kemi gjetur se ku përmendet ai person apo situatë, ne mund të zbulojmë se ende kemi shumë punë për të bërë që të sigurohemi se po fokusohemi pikërisht në atë veçori që Dhiata e Re po aludon. Që të ilustrojmë këtë mjet gjuhësor dhe kujdesin që duhet të tregojmë kur interpretojmë raste të veçanta të tij, le të shqyrtojmë aluzionin e trefishtë të Judës në vargun 11 të letrës së tij.

Mjerë ata, sepse kanë marrë rrugën e Kainit dhe u dhanë pas çoroditjes së Balaamit për fitim dhe mbaruan në rebelimin e Koreut. (Juda 11)

Faza e parë e interpretimit

Hapi i parë

Ne duhet t’i kushtojmë vëmendje çfarë lloj njerëzish po përmend ai këtu dhe kë karakterizon përmes këtyre aluzioneve të Dhiatës së Vjetër. Këta njerëz, thotë Juda, “depërtuan/hynë fshehtas” mes besimtarëve (v.4). Atëherë ata pretendojnë të jenë besimtarë të vërtetë, por në fakt janë të krishterë të rremë; sepse asnjë besimtar i vërtetë nuk “hyn fshehtas” mes besimtarëve të tjerë, nuk maskohet, po të shprehemi ndryshe, si dikush që nuk është.

Aq më tepër që ata mbrojnë si përmes sjelljes së tyre, ashtu edhe deklaratave të fuqishme që bëjnë, një shtrembërim të plotë

të ungjillit të krishterë: “të pabesë që e kthejnë hirin e Perëndisë tonë në imoralitet” (v.4).

Më e keqja, ndërsa pohojnë se janë të krishterë, ata “mohojnë të vetmin Zotëri Perëndi, dhe Zotin tonë Jezu Krisht” (v.4). Nuk është për t’u çuditur atëherë që edhe pse pretendojnë të jenë barinj të popullit të Zotit, ata nuk janë të ndershëm dhe kërkojnë vetëm kënaqësinë dhe fitimin e tyre personal (v. 12–13).

Për ta përmbledhur, ata pohojnë se janë fetarë dhe akoma më shumë të krishterë; por feja e tyre është tërësisht e kotë.

Hapi i dytë

Hapi ynë i dytë do të jetë të vëmë re sa i goditur është aluzioni i Judës në kontekstin e përgjithshëm. Kaini, Balaami dhe Koreu ishin të tre njerëz fetarë të rremë. Ne njihemi me Kainin (Zanafilla 4) në kontekstin e një sakrifice që i bën Perëndisë. Ne përballemi me Balaamin (Num 22–24) gjatë një serie sakrificash që ai po bënte; dhe lexojmë për Koreun dhe mbështetësit e tij sesi humbasin duke djegur temjan para Perëndisë (Num 16).

Hapi i tretë

Tani duhet të vëzhgojmë tiparet që i dallojnë ata të tre nga njëri-tjetri; sepse ndonëse ishin të gjithë fetarë, dhe ishin të gjithë të rremë, nuk ishin saktësisht të gjithë njësoj.

Ata ishin të ligj në shkallë të ndryshme

Kaini qe shumë i keq. Edhe pse i ofroi një sakrificë Perëndisë, ai vrau vëllanë e tij. Edhe pse kjo ishte një shtrembërim i neveritshëm i fesë në vetvete, duhet të themi që ndryshe nga dy të tjerët, Kaini qe jo klerik.

Balaami ishte më keq akoma, sepse qe profet me profesion. Edhe pse e njihnte të vërtetën e Perëndisë, ishte i gatshëm të kundërshtonte vullnetin e Perëndisë dhe të përdhoste pozitën e tij si profet për hatër të fitimit financiar dhe karrierës.

Koreu ishte edhe më shumë i keq: sepse për Balaamin s’ke çfarë të thuash, ishte vetëm një profet pagan. Koreu ishte një Levit - një lloj prifti i rangut të ulët - në shërbim të shtëpisë së

Perëndisë të Izraelit që është i vetmi i vërtetë.

Përshkrimi që Juda u bën mëkateve të secilit prej tyre është i ndryshëm

Për Kainin, Juda komenton në mënyrë të veçantë dhe me saktësi për rrugën që zgjodhi. Ai nuk i akuzon mësuesit e rremë në kishë se kanë vrarë vëllezërit e tyre si Kaini vrau Abelin. Faji i tyre është: “kanë marrë rrugën e Kainit” – dhe cila ishte ajo rrugë, Zanafilla 4 na e tregon menjëherë.

Me Balaamin, është vendosmëria e tij e shpërpjesëtuar dhe e mbrapshtë për të bërë para përmes fesë, gjë që Juda në veçanti e dënon.

Me Koreun ishte një çështje rebelimi shpirtëror kundër apostullit dhe kryepiftit të Perëndisë.

Faza e dytë e interpretimit

Pasi kemi përfunduar hetimin tonë paraprak, ne duhet të ecim përpara në fazën e dytë të interpretimit. Në Dhiatën e Vjetër tregimet e Kainit, Balaamit dhe Koreut janë që të treja shumë të hollësishme; dhe kështu, nëse nuk jemi të kujdesshëm, ne mund të kënaqemi duke grumbulluar vetëm disa përshtypje prej secilit. Natyrisht që s’ka asnjë të keqe me këtë; por në kontekstin tonë të tanishëm, detyra jonë është të bëjmë kujdes të përqendrohemi, sa mundet, mbi pikën që Juda na tërheq vëmendjen. Le të fillojmë me Kainin.

Aluzioni i Judës për Kainin

Kaini është përmendur tri herë në Dhiatën e Re, njëherë nga Gjoni (1 Gjonit 3:12), njëherë te Hebrenjve (11:4), dhe njëherë nga Juda (v. 11). Secili nga këta shkrimtarë thekson aspekte të ndryshme; dhe nëse shqyrtojmë së pari pikat e bëra nga 1 Gjonit dhe Hebrenjve, do të jemi më të aftë të shohim dallimet mes tyre dhe asaj që po thekson Juda aty.

Gjoni thekson gjendjen e rëndë të Kainit

Së pari, Gjoni na tregon që Kaini “ishte nga i ligu” (1 Gjoni 3:12). Ai hiqej sikur ishte fetar duke i bërë sakrifica Perëndisë. Por nuk ishte i rilindur, nuk ishte fëmijë i Perëndisë. Ai “ishte nga i ligu”; dhe si provë të kësaj, në vend që të donte një fëmijë tjetër të Perëndisë, ai e vrau atë.

Së dyti, Gjoni na tregon arsyen për këtë vrasje: “sepse veprat e tij ishin të liga dhe ato të të vëllait ishin të drejta.” (1 Gjoni 3:12). Dallimi mes stilit të jetës së Abelit dhe të Kainit qe shumë i dukshëm. Ai i Abelit tregonte sa fals ishte petku fetar me të cilin Kaini mbulonte stilin e tij rebel të jetës; dhe kështu kjo solli zemërimin e tij vrastar.

Autori i Hebrenjve thekson arsyet e pëlqimit të Abelit

Së pari, autori vëzhgon si dhe mbi çfarë bazash Abeli i ofroi Perëndisë një sakrificë më të mirë sesa ajo që ofroi Kaini:

Me anë të besimit Abeli i ofroi Perëndisë fljijm më të mirë nga ai i Kainit; me anë të tij ai mori dëshminë se ishte i drejtë, sepse Perëndia dha dëshminë se i pranoi ofertat e tij; dhe me anë të tij, ndonëse vdiq, ai po flet ende. (Heb 11:4)

Atëherë, vetëm përmes besimit Abeli mundi të ofronte një sakrificë më të mirë sesa ajo e Kainit. Sipas Shkrimeve, *besimi* nuk lidhet me sigurinë që ka njeriu në vetvete se po bën gjënë e duhur. *Besimi* është gjithmonë një reagim ndaj Perëndisë dhe fjalës së tij (shih Rom 10:17). Kaini, sipas atyre që dimë, mund të jetë ndjerë shumë i sigurt se duke i ofruar Perëndisë një sakrificë, mund ta mbulonte jetën e tij të keqe dhe të papenduar me një vello pastërtie. Por vetëbesimi i tij qe i kotë. Perëndia e refuzoi sakrificën e tij për shkak të hipokrizisë që shfaqti. Ndryshe nga ai, Abeli e ofroi përmes besimit. Ai po i përgjigjej fjalës së Perëndisë me pendesë të vërtetë, duke pranuar nevojën e tij për një sakrificë mbi bazën e së cilës mund t'i afrohej Perëndisë: në këtë mënyrë ai po ofronte atë sakrificë si Perëndia u kishte mësuar prindërve të tij ta bënin, kur i fali ata për herë të parë dhe i veshi me lëkurën e një kafshe të pafajshme. (Zan 3:21).

Së dyti, autori na tregon se mbi çfarë bazash Perëndia e deklaroi Abelin të ishte i drejtë. Perëndia, thotë autori i Hebrenjve (11:4), dëshmoi që Abeli ishte i drejtë. Ai nuk qe përsosmërisht i pamëkat, patjetër. Por Perëndia e shpalli atë “të drejtë para Perëndisë” dhe “se i pranoi ofertat e tij” duke pranuar sakrificën e tij. Me fjalë të tjera, Perëndia e shpalli atë të drejtë jo për shkak se veprat e tij ishin më të mira se të Kainit, por ngaqë sakrifica e tij ishte më e mirë se e Kainit: “me anë të besimit i ofroi një fljijm më të mirë nga ai i Kainit”, e ofroi me pendesë dhe besim të singertë, dhe mbi këtë bazë ai u shpall i drejtë.

Juda thekson rrugën e Kainit

Mjerë ata, sepse kanë marrë rrugën e Kainit. (Juda 11)

Duke na tërhequr vëmendjen për rrugën e Kainit (d.m.th. shtegun, apo udhën që ai mori), Juda nuk po ritregon thjesht historinë e Zanafillës me fjalët e tij. Ai po i referohet një deklarate aktuale në tekstin e Zanafillës: “Atëherë Kaini u largua nga prania e Zotit dhe banoi në vendin e quajtur Nod...” (Zan 4:16).

Kjo pra ishte rruga e Kainit dhe për të parë domethënien e saj ne duhet të shqyrtojmë një nga temat kryesore të Zanafilla 2, 3 dhe 4, d.m.th., lidhjen e njeriut me tokën.

Toka para njeriut:

... nuk ekzistonte njeriu për të punuar tokën... (2:5)

Materia bazë e njeriut:

Atëherë Zoti Perëndi formoi njeriun nga pluhuri i tokës... (2:7)

Qëllimi i ekzistencës së njeriut:

Zoti Perëndi e mori, pra, njeriun dhe e futi në kopshtin e Edenit me qëllim që ta punonte dhe ta ruante (2:15)... Prandaj Zoti Perëndi e dëboi njeriun nga kopshti i Edenit, me qëllim, që të punonte tokën nga e cila kishte dalë... (3:23)

Reagimi i Perëndisë ndaj mëkatit të Adamit:

... *toka* do të jetë e mallkuar për shkakun tënd, ti do të hash frytin e saj me mund tërë ditët e jetës sate. Ajo do të prodhojë gjemba dhe bimë gjembore, dhe ti do të hash barin e fushave; do të hash bukën me djersën e ballit, deri sa të rikthehesh në dhe sepse nga ai ke dalë; sepse ti je pluhur dhe në pluhur do të rikthehesh. (3:17-19)

Përgjigjja e Perëndisë ndaj mëkatit të Kainit:

Dhe ti tani je më i mallkuar se *toka*... Kur të punosh *tokën*, ajo nuk do të të japë më prodhimet e saj, dhe ti do të jesh një endacak dhe një ikanak *mbi tokë*. Atëherë Kaini i tha Zotit; "... Ja, ti po më dëbon sot nga *faqja e këtij dheu* dhe do të fshihem nga fytyra jote; dhe do të bëhem endacak dhe ikanak nëpër botë ". (4:11-14)

Është menjëherë e dukshme që ndëshkimi i dhënë Kainit ishte shumë më i ashpër se ai që iu dha Adamit. Sipas Zanafillës 2, një nga qëllimet për të cilin njeriu u krijua ishte të punonte tokën, të kujdesej dhe të mbronte kopshtin e Edenit. Brenda atij kopshti duhej të kishte qenë padyshim shumë e kënaqshme të punoje tokën. Kur Adami nuk iu bind Perëndisë, ai u dëbua nga kopshti, humbi pavdekësinë fizike dhe u ndëshkua rëndë. Por atij nuk iu hoq detyra për të cilën u krijua që nga fillimi: ai ende duhet të punonte tokën, ndonëse do të ishte një punë e vështirë dhe shpesh dëshpëruese (3:17-19). Veç kësaj, ai e dinte që ai dhe Eva u falën prej një akti të hirshëm të Perëndisë që vrau një kafshë të pafajshme dhe e përdori lëkurën e tij për të mbuluar turpin e tyre (3:21). Jo vetëm kaq! Perëndia i premtoi Evës që fara e gruas do të shtypte kokën e gjarprit. Kjo ishte provë e qartë që raca njerëzore nuk qe prishur pa asnjë shpresë për rimëkëmbje. Larg qoftë! Kishte një të ardhme të ndritur për racën njerëzore. Adami arriti te ky përfundim; dhe duke vepruar me besim, ai e quajti gruan me emrin Eva – sepse ajo do të bëhej nëna e të gjithë të gjallëve (Zan 3:20), dhe jo nëna e të mallkuarve.

Në dallim me këtë, Kaini jo vetëm që nuk iu bind Perëndisë, por e sfidoi atë. Kur Perëndia nuk e pranoi sakrificën e tij hipokrite, ai u zemërua. Kur Perëndia e këshilloi me butësi dhe i bëri thirrje të zgjidhte rrugën që do ta bënte të pëlqyeshëm para Perëndisë, Kaini kategorikisht e refuzoi rrugën e Perëndisë

(Zan 4:6-7). Ai jo vetëm nuk do të paraqitej me atë që Perëndia vetë kërkonte, por gjithashtu vrau atë që veptoi kështu. Sipas Kainit, nëse Perëndia nuk do të pranonte atë që Kaini ofronte, Perëndia as nuk mund të kishte edhe ofertat e Abelit. Perëndia do të ngelej me gisht në gojë.

Përgjigjja e Perëndisë ndaj kësaj sfide ishte të dëbonte Kainin nga faqja e dheut. Me të nuk do të ishte siç ishte me Adamin, që kur punonte tokën, do të prodhonte gjemba dhe ferra dhe puna e tij do të bëhej e rëndë. Me Kainin këtë herë, kur ai të punonte tokën, nuk do të prodhonte gjë fare përmes mundit që ai do të bënte. Prandaj nëse qëllimi i krijimit të njeriut ishte të punonte tokën, Kaini e humbi qëllimin për të cilin Perëndia e krijoi atë. Përveç kësaj, ai u dëbua prej pranisë së Perëndisë. Ai duhej të largohej. Çfarëdo lloj pune që do të bënte nga ajo herë e tutje, nuk do të gjente kënaqësinë që të jep mendimi se po bëj atë që Perëndia më ka thirrur të bëj, dhe po e bëj në miqësi me Perëndinë. Ai do të humbiste çdo ndjenjë të qëllimit final dhe do të bëhej një i arratisur dhe endacak mbi dhë.

Na thuhet që Kaini kuptoi menjëherë sa i tmerrshëm do të ishte ndëshkimi i tij (4:13). Ai kishte frikë se kur ta gjenin, do ta vrisnin. Prandaj Perëndia e shënjoj për ta mbrojtur prej vdekjes nga dora e njeriut. Por ka diçka më të keqe se vdekja; ajo është të jetosh dhe të punosh i fshehur nga fytyra e Perëndisë dhe të mos kesh për pasojë asnjë qëllim dhe rëndësi të përvetshme. Prandaj, "Kaini u largua nga prania e Zotit." (Zan 4:16).

Kjo ishte, pra, rruga e Kainit. Ai jo vetëm bëri një jetë të mëkatshme dhe u përpoq të fshihte mëkatën e tij me hipokrizi përmes një kurbanit fetar; por kur Perëndia i tregoi rrugën e shpengimit dhe kthimit te Perëndia, ai e refuzoi atë dhe Perëndinë po ashtu kategorikisht.

Rruga e marrë prej tij në vijim është e papërshtatshme me fjalë: "Kaini u largua nga prania e Zotit." (Zan 4:16).

Sipas Judës, mësuesit e rremë në kishë kishin marrë të njëjtën udhë si Kaini. Ata pretendonin që ishin fetarë dhe pjesëtarë të kishës. Ata e paraqisnin veten si drejtues dhe mësues. Pavarësisht nga kjo, ata bënë jetë mëkatore. Ata abuzonin me hirin e Perëndisë dhe nxinin imoralitet. Por më keq akoma: mohonin Zotin dhe Mësuesin tonë të vetëm, Jezus Krishtin,

dhe hidhnin poshtë rrugën e tij të shpëtimit. Rruga që ata po shkelnin qe rruga e Kainit. Do t'i shpinte atje ku kishte çuar atë.

Aluzioni i Judës për Balaamin

Ata...u dhanë pas çoroditjes së Balaamit për fitim. (Juda 11)

Aluzioni i Judës për Balaamin thekson tri gjëra për Balaamin, dhe prandaj le të nënvizojmë tri tiparet e dukshme që kishin mësuesit e rremë në kohën e Judës.

Gabimi i tij

Gabimi i Balaamit (greqisht: *πλάνη*) ishte se u largua nga e vërteta. Ndonëse qe një profet pagan, ai dinte shumë prej së vërtetës, dhe disa herë u detyrua prej Perëndisë për ta thënë atë (Num 22:35; 23:5, 16, 20, 26; 24:4, 13). Por edhe pse e dinte të vërtetën e Perëndisë dhe qëllimet e Perëndisë për popullin e tij, Balaami u shmang prej tyre, realisht i braktisi ato në mënyrë kriminale. Ishte ai vetë që, i shtrënguar më parë për të shpallur vendosmërinë e Perëndisë për të bekuar Izraelin, i këshilloi moabitët më pas si të thyenin besnikërinë e Izraelit ndaj Perëndisë, duke i futur ata në kurthin e imoralitetit seksual dhe idhujtarisë (Num 25:1–2; 31:15–16).

Motivimi i tij

Ajo që e frymëzonte atë qe fitimi material, paraja, statusi shoqëror, influenza në qarqet mbretërore (–24:10 ;37 ,18–15 ,22:7 13).

Vendosmëria e tij

Ai ishte i vendosur, nëse do të ishte e mundur, të thyente çdo kufizim hyjnor. Kur Balaamit i erdhi fillimisht ftesa vezulluese prej mbretit të Moabit për të shkuar tek ai dhe të mallkonte Izraelin, Balaami u konsultua me Perëndinë dhe Perëndia e ndaloi ta pranonte (22:8–12). Balakut, mbretit, iu desh që të rriste për shkak të kësaj shpërblimin e premtuar (22:15–17). Balaami,

duke qenë shumë i ndërgjegjshëm që Perëndia e pati ndaluar të shkante dhe të mallkonte Izraelin, strehoi përfaqësuesit e Balakut që të kalonin një natë me të me qëllim që të këshillohej me Zotin edhe një herë më shumë (22:18–19). Pse duhej që të lutej sërish? Ai tashmë e dinte fjalën e Perëndisë. Po, por fjala e Perëndisë ia priste udhën Balaamit që të fitonte shpërblimin e majmë të Balakut; dhe ai shpresoi ose të bindte Perëndinë të kthente fjalën, ose të gjente një mënyrë tjetër për të shkuar.

Këtë herë, duke parë vendosmërinë e tij për të shkuar, Perëndia e lejoi të nisej, por me një kusht të rreptë që ai nuk duhej të fliste dhe nuk duhej të bënte asgjë përveç asaj që Perëndia i tha (22:20). Pastaj Perëndia e kufizoi atë edhe në një mënyrë tjetër: i vuri në udhën e tij një engjëll me një shpatë të zhveshur në dorë (22:23–35). Fillimisht Balaami nuk e pa engjëllin, ndonëse gomari i tij e shihte. Sa herë që gomari shmangej që të mos përplasej me engjëllin, Balaami, në këmbënguljen e tij të verbër dhe kokëforte, e nxiste të shkante përpara. Në fund ai përfundoi në një shteg të ngushtë ku gomari nuk mund të hapte rrugë dhe sytë e Balaamit u hapën për të parë engjëllin me shpatën e tij të zhveshur, që e kërcënonte Balaamin me vrasje të menjëhershme nëse ai këmbëngulte në mënyrë të mbrapshtë që të përfitonte shpërblimet e Balakut duke mallkuar Izraelin (22:35).

Pavarësisht nga kjo, ai u ngjit dy herë me Balakun në vendet e larta, dhe bashkë me të ndërtoi altarë, ofroi nga një dem në secilin altar, dhe ushtroi magjinë e zezë që të bindte Perëndinë të ndryshonte fjalën e tij dhe të mallkonte Izraelin (23:1–3). Ndonëse ishte profet, Balaami ishte tërësisht ashtu si Balaku - një i pafe. Ai mendoi që nëse do t'i ofronte Perëndisë një sakrificë më të majme sesa ato të Izraelit, ai mund t'i bënte kështu një ryshfet Perëndisë që do ta largonte nga besnikëria e tij ndaj Izraelit dhe ta lejonte t'i mallkonte ata; kështu Balaami do të fitonte shpërblimin e tij nga Balaku.

Natyrisht që ai dështoi dhe u detyrua t'i raportonte Balakut vendosmërinë e pathyeshme dhe të pandryshueshme të Perëndisë për të bekuar Izraelin. Pas kësaj, dikush edhe mund të mendojë se Balaami hoqi dorë dhe iu nënshtrua fjalës së Perëndisë. Por jo! Balaami ende shikonte nga shpërblimi material. Perëndia nuk do të tregohej jobesnik ndaj Izraelit;

por Balaami veproi në mënyrë të atillë që ta shtynte Izraelin të tregohej i pabesë ndaj Perëndisë dhe fjalës së tij. Për këtë ai këshilloi moabitët si të vepronin, duke i tunduar izraelitët së pari me shthurje seksuale, dhe pastaj t'i ftonin në idhujtarinë e Moabit (25:1–9; 31:15–16).

Kaq mjafton të themi për këmbënguljen e vazhdueshme të Balaamit për të fituar shpërblim tokësor, edhe pse për të, si profet, do të thoshte të shtrëmbëroje fjalën e Perëndisë dhe të çorodisje popullin e Perëndisë.

Një aluzion i përshtatshëm

Në dritën e sjelljes së Balaamit, siç e përshkroi këtu Dhiata e Vjetër, përshkrimi i Judës për mësuesit e rremë të kohëve të tij është shumë i goditur: “Ata u dhanë pas çoroditjes së Balaamit për fitim” (Juda 11).

Folja që ai përdor, ἐξελύθησαν (e përkthyer këtu ‘u dhanë pas çoroditjes’), është një fjalë shumëgjyreshe, e vështirë për ta përkthyer. Në kuptimin e fjalëpërfjalshëm është përdorur për lëngjet që derdhen apo janë duke u derdhur jashtë prej një ene. Duke dalë nga enët, lëngu do të derdhet duke u përhapur gjithandej; nëse do të ngresh ndonjë pengesë do të vërshojë rreth saj. Në kuptim të figurshëm, ajo përdoret për njerëzit që “jepen pas” apo “braktisin veten pas” ndonjë aktiviteti apo pasioni. Ajo është shumë e goditur kur përdoret për profetin Balaam, dëshira e madhe e të cilit për fitime materiale e shtyu të anashkalonte fjalën e Perëndisë.

Është përdorur në mënyrë të goditur nga Juda për të kategorizuar mësuesit e rremë të kohës së tij, dhe tonës, të cilët, edhe pse thonë se janë të krishterë, janë në garë me njëri-tjetrin për të mohuar fjalën e Perëndisë, autoritetin e Mësuesit dhe Zotit tonë Jezus Krisht, dhe në emrin e hirit të Perëndisë mbrojnë shthurjen seksuale dhe kompromentohen me idhujtarinë. Si Balaami, ata marrin shpërblimin që kërkojnë – por me të njëjtën kosto të lartë (Num 31:8; Zbu 2:14–16).

Aluzioni i Judës për Koreun

Ata ... mbaruan në rebelim e Koreut. (Juda 11)

Aluzioni i Judës për Koreun saktëson mëkatin e tij si rebelim (greqisht: ἀντιλογία, ‘foli kundër’, në kuptimin e armiqësisë së hapur apo rebelimit). Kështu Juda po i akuzon njësoj për rebelim mësuesit e rremë. Prandaj ajo që ne kemi nevojë të dimë është natyra e rebelimit të Koreut: kundër çfarë dhe kundër kujt po rebelohej ai.

Historia e tij është treguar në librin e Numrave (kap 16-17). Por po të hetosh gjysmën e dytë të Numrave, nga kap. 11 deri në fund të librit, atje përshkruhen jo më pak se katër rebelime që ngjanë (plus një ngjarje që për sytë e Moisiut ishte një rebelim, por nuk qe realisht) përgjatë viteve të Izraelit në shkretëtirë. (Shih (1) kapt. 2) ;14–13 ,11) kapt. 4) ;29–23 ,13–20:1 (3) ;17–16) kapt 5) ;25) kapt 32.) Duket që rebelimi në ato kohë ishte një gjë e shpeshtë dhe me shumë ngjyra. Prandaj ne kemi nevojë të dallojmë gjërat e veçanta që rrezikohen në këto rebelime të ndryshme.

Rebelimi i parë i dokumentuar te Numrat

Dhiata e Re na ndihmon këtu, sepse ajo citon tri nga këto rebelime (nr. 1, 2 dhe 4) dhe i komenton e i aplikon dy prej tyre me hollësi. I pari nga ata trajtohet te Hebrenjve 3-4, dhe aplikohet si një paralajmërim, jo thjesht kundër mungesës së një përkushtimi të plotë nga ana e besimtarëve, por kundër rrezikut të braktisjes haptazi të besimit nga ana e njerëzve, që, edhe pse së jashtmi janë të krishterë, nuk e kanë besuar kurrë ungjillin. (Shih Heb Heb 3:19; 4:2; dhe diskutimin tonë të këtij pasazhi në Kapitullin 18) Tek Heb 3.18 këta njerëz janë përshkruar si rebelë dhe, sigurisht, besimtarët e vërtetë ka raste që të jenë rebelë. Por folja greke e përdorur për “rebel” këtu është ἀπειθέω. Kjo folje dhe emri e mbiemri i prejardhur nga ajo përdoren 29 herë në Dhiatën e Re. Ato kurrë nuk përdoren për të përshkruar rebelimin e një besimtari të vërtetë. Ato përshkruajnë ata që refuzojnë Perëndinë, ligjin e tij, ungjillin e tij dhe refuzojnë të besojnë si Zotin, ashtu edhe ungjillin e tij. Krahasoni verdiktin

e Perëndisë të dhënë te Numrat 14:11, 22.23 dhe te Psalmi 106.¹

Rebelimi i katërt i dokumentuar te Numrat

Rebelimi i katërt është përmendur te 1 Korintasve 10:8 kur Pali përmend imoralitetin në të cilin u përfshi Izraeli kur u bë pjesë e adhurimit të Baalit (Num 25:1, 6–8), dhe dënimin që merituan për pasojë të tij. Te Numrat, Perëndia shpjegon që dënimi erdhi si pasojë e xhelozisë së tij sepse Izraeli, si një grua e pabesë, “u bashkua” me Baal–Peorin; dhe, për më tepër, ai e lavdëron Fineasin që “largoj zemërimin tim nga bijtë e Izraelit, sepse ai ishte i frymëzuar nga po ajo xhelozia ime; kështu në xhelozinë time nuk i kam shfarosur bijtë e Izraelit.” (Num 25:11). Po ashtu Pali, te pasazhi i Korintasve, i paralajmëron bashkëbesimtarët e krishterë për të keqen e kompromisit me idhujtarinë pagane dhe adhurimin e demonëve. Ai u kujton se një kompromis i tillë nga ana e tyre do të nxisë xhelozinë e Perëndisë sërish: “Ju nuk mund të pini kupën e Zotit dhe kupën e demonëve; ju nuk mund të merrni pjesë në tryezën e Zotit dhe në tryezën e demonëve. A duam ne të provokojmë Zotin deri në xhelozinë? A jemi ne më të fortë se ai?” (1 Kor 10:21–22; cf 11:30–32; 2 Kor 11:2–3). Natyrisht, xhelozia në këtë kontekst është një gjë e mirë. Një burrë që nuk është xheloz nëse dikush tjetër trazon besnikërinë e gruas së tij, nuk mund të jetë duke e dashur gruan e tij realisht.

Rebelimi i Koreut (Num 16–17)

Por kur i vjen radha rebelimit të Koreut, Dhiata e Re e aludon atë, por nuk tregon se cilat qenë karakteristikat e tij të veçanta. Prandaj duhet të vendosim vetë prej leximit të kësaj historie në Dhiatën e Vjetër. Nuk qe një rast tjetër kompromentimi me një fe pagane. As nuk bëhet fjalë për rastin kur po refuzonin të hynin në tokën e premtuar. Koreu natyrisht i qe bashkuar atij refuzimi së bashku me shumicën e atyre që morën pjesë në rebelimin e parë; por tani ai po organizonte një tjetër, diçka të ndryshme, një rebelim të vetin. Rebelimi i tij ishte mbi të gjitha një sulm kundër Moisiut dhe Aaronit (Num 16:3). Jo kundër

atyre si individë, por kundër pohimeve të tyre të veçanta dhe absurde, sipas mendimit të Koreut, që ata kishin deklaruar për detyrat që Perëndia u kishte ngarkuar atyre.

Tani Moisiu ishte në fakt – sipas vetë asaj që Perëndia deklaronte – unik për kohën e tij, si gojëdhënësi i vetëzbulesës së Perëndisë për Izraelin:

Pastaj Zoti tha: “Dëgjoni tani fjalët e mia! Në se ka një profet midis jush, unë, Zoti i bëhem i njohur atij në vegim, flas me të në ëndërr. Por nuk veproj kështu me shërbëtorin tim Moisi, që është besnik në tërë shtëpinë time. Me të unë flas sy për sy, duke bërë që ai të më shohë, dhe jo me shprehje të errëta; dhe ai sodit dukjen e Zotit. Pse nuk keni pasur frikë të flisni kundër shërbëtorit tim, kundër Moisiut?” (Num 12:6–8)

Moisiu ishte apostulli i besimit të Izraelit, sjellësi i fjalës së frymëzuar në mënyrë të drejtpërdrejtë prej Perëndisë së Izraelit, të zbulesës së tij unike dhe autoritare.

Koreu sulmonte dhe mohonte pikërisht këtë. Jo se ai donte të braktiste besimin e Izraelit (në versionin e tij personal). Ai ishte një Levit, një klerik i ulët në sistemin priftëror të Izraelit; dhe nuk kishte për qëllim të hiqte dorë nga privilegjet materiale të saj dhe as nga shpërblimet që sillte. Jo, pohimi i tij ishte: “Mjaft më me ju, sepse tërë asambleja është e shenjtë, secili nga anëtarët e saj, dhe Zoti është në mes tyre; pse, pra, ngriheni mbi asambelën e Zotit?” (16:3). Me fjalë të tjera, ai mohonte detyrën e veçantë të Moisiut dhe autoritetin e tij mbi pjesën tjetër të Izraelit. Në njëfarë kuptimi, ishte e vërtetë që e gjithë asambleja qe e shenjtë; por rrjedhoja logjike që ai nxori prej saj ishte e gabuar. Për Koreun nuk kishte nevojë apo hapësirë për autoritetin e veçantë dhe urgjent të Moisiut si apostulli i frymëzuar nga Perëndia. Nuk kishte nevojë në Izrael që të pranoje dhe t’i nënshtroheshe asaj që Moisiu thoshte për shkak se ai qe zëdhënësi i veçantë i Perëndisë. Secili kishte të drejtë të kishte mendimin e tij aq sa edhe Moisiu. Pohimet autoritare që Moisiu bëri për mësimin e tij ishin, sipas disa prej ndjekësve të Koreut, një lloj forme tiranie intelektuale e prapambetur që madje u nxirrte sytë njerëzve (16:14).

¹ Për një diskutim të plotë shihni librin e Gooding, *An Unshakeable Kingdom*, 109–24.

Koreu dhe shokët e tij refuzuan gjithashtu pohimet e veçanta që u bënë për Aaronin. Aaroni ishte kryepriifti i besimit të Izraelit. Sipas vetë deklaratave të Perëndisë, vetëm Aaroni kishte të drejtën në Ditën e Shlyerjes të hynte në Shenjtoren e Shenjtoreve si përfaqësuesi dhe ndërmjetësi i kombit para Perëndisë (Lev 16:17). Koreu nuk mund ta pranonte këtë: të gjithë njerëzit qenë të shenjtë, të gjithë ata qenë të përshtatshëm për të hyrë në praninë e Perëndisë pa ndonjë ndërmjetës apo kryepriift.

Shokët e Koreut pretendonin gjithashtu që drejtimi në të cilin Moisiu dhe Aaroni po shpinin popullin që i gabuar. Egjipti ishte në fakt vendi ku rridhte mjaltë dhe qumësht (Num 16:13)! Të gjitha premtimet për një vend ku rridhte qumësht dhe mjaltë, tek i cili do të mbërrinin dikur në të ardhmen, ishte një mashtrim qëllimisht i kurdisur mirë për t'i nxjerrë ata nga Egjipti në shkretëtirë, ku Moisiu mund të ushtronte tiraninë e tij fetare mbi ta. Egjipti ishte toka e premtuar: nuk kishte asnjë tjetër të tillë.

Nuk duhet të shtojmë gjëra të tjera për rebelimin e Koreut, edhe pse detajet mund të jenë interesante, për të dalluar çfarë lloj mësuesish të rremë kishte Juda në mendje kur ai u vuri nofkën korenj. Sepse ka ende shumë të tillë në krishtërimin e ditëve tona: klerikë që jo vetëm mohojnë frymëzimin dhe autoritetin hyjnor të mësimeve të Moisiut, por edhe nuk hezitojnë të mohojnë hyjninë e Zotit tonë dhe autoritetin e tij unik si zbulues i Perëndisë për njerëzit. Ata do të pohojnë lirisht se në çështje të ndryshme Krishti e kishte gabim dhe nuk duhet të pranojmë domosdoshmërisht çdo gjë që ai tha, aq më pak të pranojmë frymëzimin dhe autoritetin e shkrimeve të apostujve të tij. Për më tepër, ata po ashtu do të mohojnë vdekjen e Krishtit si një sakrificë shlyese për mëkat; ata në fakt do të refuzojnë se ishte e domosdoshme që kjo sakrificë të bëhej. Perëndia i fal të gjithë, është teoria e tyre, pa qenë nevoja për një sakrificë shlyese, apo për ndërmjetësimin e Zotit tonë si kryepriift.

Për të parë sa serioz është ky mësim i rremë, që e ka infektuar kaq shumë krishtërimin në disa qarqe, ne duhet të kthehemi pas te një fazë e ndërmjetme në rrugën mes Koreut të Dhiatës së Vjetër dhe modernistëve tanë besëthyes. Ne duhet të kthehemi

pas te kryqi i Zotit tonë Jezus Krisht. Duke përshkruar atë që ndodhi atje, shkruesi i letrës së Hebrenjve përdori të njëjtën fjalë, "rebelim" (greqisht: ἀντιλογία) që Juda e përdor në lidhje me Koreun:

duke i drejtuar sytë te Jezusi, kreu dhe plotësonjësi i besimit, i cili, për gëzimin që ishte përpara tij, duroi kryqin duke e përçmuar fyerjen dhe u ul në të djathtën e fronit të Perëndisë. Kujtoni, pra, atë që duroi një kundërshtim [ἀντιλογία] të tillë nga ana e mëkatarëve kundër tij... (Heb 12:2-3)

Me fjalë të tjera, atë që Koreu dhe shokët e tij i bënë Moisiut dhe Aaronit, Judaizmi zyrtar ia bëri Krishtit në kohën e tij. Ata e refuzuan pohimin e tij se ishte profeti i ngjashëm me Moisiun (Veprat 3:22), se ishte "më i madh se tempulli" (Mat 12:6), dhe prandaj ishte edhe më i madh se Aaroni. Ata mohuan, "apostullin dhe kryepriiftin" e zbulesës përfundimtare të Perëndisë për njeriun (shih Heb 1:1-2; 3:1; 7:11-28). Kjo është shumë e trishtueshme. Por është shumë herë më e trishtueshme kur teologët, që pohojnë se janë të krishterë, bashkohen me këtë revoltë, së bashku me mësuesit e rremë të kohës së Judës që mohuan Zotin dhe Mësuesin tonë të vetëm, Jezus Krisht.

Kur Koreu dhe bashkërevoltuesit e tij humbën, të konsumuar në zjarrin e gjykimit të Perëndisë, Perëndia e urdhëroi Moisiun që të përdornin temjanicat e tyre prej bakri pasi t'i kishin petëzuar për të veshur altarin (Num 16:36-40). Pas kësaj, asnjë izraelit që ishte i mirëinformuar nuk do të guxonte t'i afrohej dhe të lakmonte altarin pa u kujtuar për rebelimin e Koreut.

Dhe ende sot, sa herë që mendojmë për kryqin e Krishtit, ne gjithashtu mund të kujtojmë atë që mendjet dhe zemrat e parilindura i bënë Krishtit në Kalvar, dhe ende janë duke ia bërë atij.

Libri i Numrave regjistron si Perëndia e përligji pohimin e Aaronit se është kryepriifti. Perëndia urdhëroi secilin prej udhëheqësve të dymbëdhjetë fiseve të vendoste në çadrën e mbledhjes, për një natë, shufrën që mbante për detyrën që kryente. Në mëngjes ata panë që 11 prej atyre shufrave ishin të pandryshuara; por shufra e Aaronit kishte çelur lule dhe sythe

dhe kishte bërë bajame (Num 17:1–11).

Nuk na duhet të qëndrojmë shumë mbi këto detaje. Mjafton të kujtojmë që Perëndia e ka përligjur pohimin e Krishtit për të qenë kryepriфт dhe ka treguar se është shumë më i lartë se Aaroni duke e ngjallur prej së vdekurish dhe duke e vënë të ulet në të djathtën e tij, ku tani jeton prej fuqisë së jetës së pashtershme (Heb 7:16).

Përfundim

Kaq, pra, rreth përdorimit të mjetit gjuhësor nga Dhiata e Re të aluzioneve të drejtëpërdrejta. Puna e domosdoshme për t’u siguruar se po fokusohemi në karakteristikat e duhura të tregimit të Dhiatës së Vjetër, të cilin Dhiata e Re aludon, mund të jetë sfilitëse. Megjithatë është edhe një punë që të kënaq. Po të njëjtën gjë do të gjejmë me mjetin tjetër që do të shqyrtojmë në vijim.

...

Pyetjet e studimit për këtë kapitull mund t’i gjeni
në faqen 438.

14

Aluzione të tërthorta

Në kapitullin tonë të fundit shqyrtuam disa shembuj të përdorur nga Dhiata e Re për të aluduar haptazi për personazhe, situata apo ngjarje në Dhiatën e Vjetër. Këto aluzione të drejtëpërdrejta, ne vumë re, dallohen lehtësisht për arsyen e thjeshtë që ato janë të drejtëpërdrejta.

Por disa pasazhe të Dhiatës së Re aludojnë për personazhe, situata apo ngjarje në Dhiatën e Vjetër pa treguar në mënyrë të drejtëpërdrejtë që po veprojnë kështu. Këto i quajmë aluzione ‘të tërthorta’. Pasi të identifikohen se çfarë janë, këto aluzione të tërthorta do të hedhin shumë dritë mbi pasazhin e Dhiatës së Re ku gjenden. Nga ana tjetër, vetëm kur njohim mirë Dhiatën e Vjetër, dhe jemi të ndjeshëm ndaj shfaqjeve të mundshme të aluzioneve të tërthorta për të në Dhiatën e Re, do të mund t’i kapim ato. Në të kundërt, edhe pse pasazhi i Dhiatës së Re do të ngelet i kuptueshëm dhe i dobishëm, lexuesi do të humbasë ndriçimin që aluzioni i tërthortë, nëse do të kuptohej, do të hidhte mbi pasazhin. Le të marrim në shqyrtim një shembull relativisht të thjeshtë si fillim, dhe pastaj të shqyrtojmë Ungjillin e Gjonit si një rast studimor të një përdorimi më kompleks të këtij mjeti gjuhësor.

Parajsa e Perëndisë

Te Zbulesa 2:7 Zoti i ngjallur i thotë kishës në Efes: “... Kujt fiton do t’i jap të hajë nga pema e jetës, që është në mes të parajsës së Perëndisë.” Tani kjo deklaratë është e kuptueshme plotësisht ashtu siç është; dhe në dritën e rasteve të tjera kur përmendet pema e jetës më vonë te ky libër (Zbul 22:2,14), është dukshëm një premtim për jetë të përjetshme dhe bekim.

Por për shkak se është saktësisht e kuptueshme si qëndron, një lexues që nuk njeh përmbajtjen e Zanafillës 2 dhe 3, mund të mos e vërë re këtë aluzion të tërthortë. *Parajsa* ishte një fjalë persiane fillimisht, e përdorur për të treguar një park të rrethuar që mbretërit persë e mbillnin dhe ngrinin për kënaqësinë personale. Grekët e lashtë e përvetësuan atë prej persishtes dhe e përkthyen si *παράδεισος*. Prandaj, kur hebrenjtë e Aleksandrisë e përkthyen Biblën hebraike në greqisht rreth 280 para Krishtit, ata përdorën këtë fjalë *παράδεισος* për kopshtin që Zoti Perëndi mbolli në Eden (Zan 9-2:8). Në këtë parajsë ndodhi që të mbillej pema e jetës; dhe prej kësaj parajse u dëbuan prindërit tanë të parë fajtorë, kur ata mëkatuan, që të mos hanin më prej pemës së jetës dhe të jetonin përgjithmonë. (Zan 3:22-24)

Patjetër që kur Zoti ynë iu drejtua kriminelit që po vdiste i penduar me fjalët: Në të vërtetë po të them: sot do të jesh me mua në parajsë (Luka 23:43), ai nuk kishte në mend kopshtin tokësor të Edenit, por qiellin e përjetshëm të Perëndisë. Dhe, po kështu, kur thotë: “kujt fiton do t’i jap të hajë nga pema e jetës, që është në mes të parajsës së Perëndisë.” Por aluzioni për tregimin e Zanafillës që përmban ky premtim, na kujton mbi të gjitha rënien e njeriut në mëkat, dëbimin e tij prej kopshtit, ndalimin e tij për të ngrënë nga pema e jetës dhe kthimin e tij përfundimisht në pluhur prej edhe nga kishte ardhur. Kështu, kjo thekson paralajmërimin për kishën: “Kujtohu, pra, se nga ke rënë, pendohu...; në mos ... do ta luaj shandanin tënd nga vendi i vet.” (Zbul 2:5). Por në të njëjtën kohë ajo shpall triumfalisht se, popullit të tij të shpenguar, Krishti do t’u kthejë – dhe më shumë se kthejë – jetën dhe bekimin e humbur racës njerëzore për shkak të mëkatit të Adamit.

Eksodi		Ungjilli i Gjonit
1.	Princi i Egjiptit, Faraoni tiran	Princi i kësaj bote, djalli, i Ligu (12:31; 14:30; 16:11; 17:15)
2.	Egjipti, shtëpia e skllavërisë së Izraelit (20:2)	‘Bota’ në kuptimin e keq të saj (15:18–19; 16:8–11; 17:14–16)
3.	Moisiu u dërgua prej Perëndisë në Egjipt (3:10, 13–15; 4:13)	Krishti u dërgua nga Ati në botë (3:17; 5:38; 8:16, 18; 9:4; 10:36)
4.	Moisiu do t’u zbulonte izraelitëve emrin e Perëndisë (3:13–14)	Krishti: ‘unë i kam bërë të njohin emrin tënd dhe do të bëj ta njohin akoma’ (17:6, 26)
5.	“UNË JAM AI QË JAM” (3:14)	Krishti: UNË JAM (8:24, 28)
6.	Moisiut iu dha të bëjë mrekulli, që Izraeli të besonte se Perëndia iu shfaq atij (4:1–9, 28–31)	‘veprat që Ati më ka dhënë të kryej, ato vepra që bëj unë, dëshmojnë për mua’ (5:36) ‘Jezusi bëri edhe shumë shenja të tjera në prezencën e dishepujve të tij, të cilat nuk janë shkruar në këtë libër. Por këto gjëra janë shkruar që ju të besoni se Jezusi është Krishti, Biri i Perëndisë. . .’ (20:30–31)
7.	Qengjat e Pashkës (ch. 12)	Qengji i Perëndisë (1:29)
8.	Porosia e Pashkës: ‘nuk do të thyeni asnjë kockë të tij.’ (12:46)	‘por, kur erdhën te Jezusi nuk ia thyen kërcinjtë. . . Këto gjëra në fakt ndodhën që të përmbushet Shkrimi: Nuk do të thyhet asnjë eshtër’ (19:33, 36)
9.	Mana (kap. 16)	Mana e krahasuar me Bukën e Jetës që vjen nga qielli (6:31–33, 48–51, 58)
10.	Moisiu dhe Ligji (kap. 19–24; 31:18–34:28)	‘Ligji u dha nëpërmjet Moisiut, por hiri dhe e vërteta erdhën nëpërmjet Jezu Krishtit.’ (1:17)
11.	‘Le të më bëjnë një shenjtërore, që unë të banoj në mes tyre.’ (25:8)	‘Nëse ndokush më do...edhe Ati im do ta dojë dhe ne do të vijmë tek ai dhe do të bëjmë banesën tek ai.’ (14:23)

Tabela 3. Aluzionet për Eksodin tek Ungjilli i Gjonit

Libri i Eksodit si një maket mendimi për të kuptuar Ungjillin e Gjonit

Gjatë gjithë Ungjillit të Gjonit ka një radhë të gjatë aluzionesh për librin e Eksodit; disa janë të hapura; disa janë të tërthorta, por shumica prej tyre janë të tërthorta. Merrni në shqyrtim listën e [Tabelës 3](#).

Në këtë listë pikat 8, 9 dhe 10 janë aluzione të hapura. Tetë të tjerat Gjoni ua lë në dorë lexuesve t’i përcaktojnë vetë; ato janë aluzione të tërthorta.

Natyrisht, një johebre që e lexon këtë ungjill për herë të parë nuk mund t’i kapë këto aluzione – dhe as nuk ka nevojë. Mesazhi themeltar i ungjillit është i qartë dhe i drejtpërdrejtë; ka kuptim ashtu si lexohet. Miliona njerëz e kanë lexuar pa ditur më parë se çfarë thotë Dhiata e Vjetër, e kanë kuptuar argumentin e tij kryesor dhe kanë besuar në Krishtin e kanë fituar personalisht jetë të përjetshme.

Por Gjoni e dinte se ata që do e lexonin njëherë librin e tij nuk do ta linin me kaq. Ai e priste që besimtarët do ta lexonin herë pas here atë. Kështu ata do të mësonin të përcaktonin në fund fare zbulesën finale të Perëndisë që ai përmbante në sfondin e të gjitha zbulesave të pjesshme të Perëndisë për vetveten në besëlidhjen e vjetër.

Studentë seriozë të letërsisë botërore harxhojnë kohë dhe energji pafund të gjejnë çdo aluzion të mundshëm në veprat e autorëve të tyre të preferuar të letërsisë së hershme. Si mund të kuptojë dikush plotësisht një autor si Virgjili pa gjetur ngjashmëritë mes *Eneidës* së tij dhe *Iliadës* dhe *Odisesë* së Homerit? Do të ishte një fenomen i çuditshëm nëse të krishterët nuk do të kërkonin thellësi në Ungjillin e Gjonit, nëse nuk do të ishin po aq entuziastë për të gjurmuar paralelet mes atij ungjilli dhe Dhiatës së Vjetër në përgjithësi dhe librit të Eksodit në veçanti.

Për më tepër, kjo gjë nuk do të ishte thjesht një ushtrim gjuhësor dhe akademik. Ngjashmëritë mes Eksodit dhe ungjillit do ta kthenin tregimin e hollësishëm të Eksodit në një maket mendimi, përmes të cilit mund të analizojmë një pjesë të koncepteve më të vështira në këtë ungjill.

Kjo botë dhe princi i saj

Një shikim kalimtar mbi listën e ngjashmërive mes Eksodit dhe Ungjillit të Gjonit do të mjaftonte të provojë se Egjipti dhe Faraoni i tij tek Eksodi, janë të njëvlershëm me “botën” dhe “princin e kësaj bote” në ungjill. Kjo sugjeron aty për aty që Egjipti dhe Faraoni do të sigurojnë një ilustrim të gjallë se çfarë do të thotë ky ungjill përmes fjalëve “botë” dhe “princi i kësaj bote”.

Nëse është kështu, kjo do të jetë shumë ndihmëse; sepse kur flasim për termin “botë”, mund të thuhet dy gjëra njëherazi. E para është që ky term përdoret shpesh në shkrimet e apostullit Gjon, disa herë në një kuptim të mirë (p.sh “bota” që Perëndia ka krijuar) dhe shpesh në një kuptim të keq (p.sh “bota” mbi të cilën Satani sundon si princ). E dyta është se kur ky term përdoret në një kuptim të keq, ka qenë shumë e vështirë për ta përkufizuar saktësisht.

Vështirësitë për të kuptuar termin “botë”

Atëherë, çfarë ka parasysh Bibla me termin *botë* në kuptimin e saj të keq? Si mund ta përkufizojmë këtë term? Dhe ajo që e bën edhe më të vështirë, si mund t’ia shpjegojmë atë dikujt që nuk e ka hasur këtë përdorim të termit më parë? Është mjaft e lehtë (dhe patjetër plotësisht e drejtë), thjesht të përsërisësh urdhërimin biblik “Mos e doni botën, as gjërat që janë në botë”; por mosshpjegimi i kuptimit të fjalës “botë” shpesh ka çuar ndër shekuj në qëndrim të gabuar.

Nga një anë, interpretimet fetare të “botës” i kanë bërë njerëzit të mendojnë që, përveç leximit të Biblës, lutjes dhe ushtrimeve shpirtërore, çdo gjë përtej asaj që është domosdoshmërisht e nevojshme për të nxjerrë jetesën – muzika, arti, letërsia, hulumtimi shkencor në vetvete, lojrat dhe zbavitja – janë në vetvete të gabuara dhe duhet t’u qëndrosh larg. Në raste ekstreme ky lloj interpretimi i ka shtyrë njerëzit, si amishët, të refuzojnë të gjitha shpikjet moderne, si: makinat, dritën elektrike dhe rrobat moderne.

Nga ana tjetër ka njerëz që e kuptojnë “botën” vetëm thjesht si gjëra, qëndrime dhe aktivitete që janë të mëkatshme në vetvete. Përballë listës së Gjonit për gjërat që janë në botë,

d.m.th, dëshirës së mishit, dëshirës së syve dhe krenarisë së jetës (1 Gjoni 2:16), ata mendojnë se këto gjëra u referohen thjesht imoralitetit seksual, lakmisë dhe krenarisë. N.q.s, heqin dorë nga këto qëndrime dhe aktivitete të mëkatshme, ata mendojnë se janë të sigurt, edhe nëse gjërat e bukura, interesante dhe në vetvete të dobishme të jetës pushtojnë kaq shumë mendimet, zemrat, ambiciet, kohën dhe energjitë e tyre, sa që ata kanë pak apo aspak kohë për Perëndinë, dhe, si rezultat, “dashuria e Atit”, siç edhe Gjoni e shpreh atë, “nuk është në ta.”

Drejt një përkufizimi të termit “botë”

Prandaj, ne kemi nevojë për të patur një kuptim biblik të asaj se çfarë është *bota* dhe çfarë përfaqëson ajo. Për ta bërë këtë, le të shqyrtojmë tri aspektet e ndryshme të botës që Gjoni prezanton në letrën e tij të pare. Kështu do të jemi në një pozitë më të mirë për të parë më qartë atë anë tjetër të *botës* të cilën ai e përshkruan dhe e ilustron në ungjillin e tij.

“Bota” dhe joshja e saj (1 Gjoni 2:15–17)

Nuk ka asgjë të gabuar, apo madje të çuditshme, në faktin që bota është tërheqëse. Ka dalë nga mendja dhe dora e Krijuesit që “na jep gjithçka bujarisht për të na gëzuar,” (1 Tim 6:17). Por ka rrezik që Satani do të na bëjë neve atë që i bëri edhe Evës: do të marrë gjërat e mira dhe të bukura të jetës dhe, në vend që të na shtyjnë drejt mirënjohjes, dashurisë dhe bindjes ndaj Perëndisë, do t’i përdorë për të shtyrë zemrën tonë larg tij.

Satani i tregoi Evës që pema e njohjes të së mirës dhe së keqes në kopshtin e Edenit ishte “e mirë për të ngrënë” (d.m.th. – të jepte kënaqësi fizike), “e këndshme për sytë” (d.m.th. – të jepte kënaqësi estetike) dhe “e dëshirueshme për ta bërë të zgjuar dikë” (d.m.th. – të jepte kënaqësi intelektuale). Natyrisht që i kishte të gjitha këto sepse vetë Perëndia e kishte krijuar dhe mbjellë atë në kopsht. Por Satani i sugjeroi Evës që Perëndia ia kishte ndaluar deri tani asaj dhe Adamit të shijonin frytin e pemës nga xhelozia dhe përbuzja sepse, po ta hanin, ata do të ishin “në gjendje si Perëndia të njihni të mirën dhe të keqen” (Zan 3:5). Prandaj Satani e siguroi Evën që ata mund të shijonin këto gjëra të bukura dhe joshëse veçmas prej Perëndisë dhe duke shpërfillur plotësisht fjalën e tij.

Eva dhe Adami iu dorëzuan ngasjeve të Satanit; por ata zbuluan se përpjekjet për të shijuar gjërat e bukura të jetës veçmas Perëndisë, pa patur shoqëri me të dhe në mospërfillje ndaj fjalës së tij, nuk sjellin fisnikërimin e jetës, por shpien në pluhurin e vdekjes.

Apostulli Gjon thotë të njëjtën gjë. Nëse lejojmë gjërat e bukura të jetës të na tërheqin zemrat tona larg prej Atit, në vend që të na shtyjnë drejt tij, atëherë vetë gjërat e bukura të jetës do të bëhen gjëra të zvetënuara. Ato do të bëhen idhuj, qëllime në vetvete, që duhen ndjekur për hatrin e tyre. Dëshira e shëndetshme për gjërat e mira në vetvete shndërrohet në lakmi; dhe mirënjohja për dhuratat që vijnë nga Perëndia zëvendësohet prej “krenarisë së jetës”, një komplet i rremë vlerash dhe qëllimesh që varet nga të paturit e më shumë gjërave dhe nga të paturit e gjërave më të mira, dhe veçanërisht më shumë se njerëzit e tjerë. Gjon thotë që “bota”, duke mos qenë “prej Atit”, nuk ka një vlerë të përjetshme: “ajo kalon”. (1 Gjonit 2:16–17)

“Bota” dhe armiqësia e saj (1 Gjonit 3:13–15)

Bota nuk është gjithmonë tërheqëse: mund të jetë shumë armiqësore ndaj një besimtarit të vërtetë. Qe e tillë ndaj Krishtit në fund; dhe ai i paralajmëroi dishepujt e tij që të mos habiteshin nëse ajo do të ishte e tillë edhe ndaj tyre (Gjoni 15:18-25).

Krishti e shpjegoi kështu shkakun themeltar të kësaj armiqësie: “Po të ishit nga bota, bota do të donte të vetët; por sepse nuk jeni nga bota, por unë ju kam zgjedhur nga bota, prandaj bota ju urren.” (Gjoni 15:19; krhs. 17:14).

Nuk ka arsye pse besimtarët të zhvillojnë një mani përndjekjeje; as nuk po mohon Zoti ynë mirësinë themeltare njerëzore që kanë njerëzit e zakonshëm. Por bota e njerëzve të parilindur është në armiqësi me Perëndinë; dhe padija e tyre për Perëndinë, e bashkuar me ndërgjegjet e tyre të përlyera, i bën ata të ndjejnë instiktivisht që Perëndia është kundër tyre. Besimtarët e vërtetë, për pasojë, mund t’u duken se janë “tradhëtarë” që “kanë ndërruar krah”.

Nuk është vetëm bota ateiste që urren besimtarët e vërtetë. Bota fetare po ashtu kërkon të përndjekë besimtarët e vërtetë - ndonjëherë në mënyrë më të hidhur sesa bota ateiste. Kaini,

na kujton Gjoni (1 Gjoni 3:12), sapo kishte mbaruar së bëri sakrificën e tij të neveritshme fetare kur vrau vëllanë e tij Abel që bëri një sakrificë të pëlqyeshme ndaj Perëndisë. Po kështu ishte edhe në kohën e Krishtit: ishin kryepriiftërinjtë dhe drejtuesit fetarë të Judaizmit që qenë kryesisht përgjegjës për kryqëzimin e Krishtit. Feja që përndjek njerëzit është sigurisht “nga bota”.

“Bota” si një pengesë që duhet kuptuar (1 Gjonit 5:3–4)

Dashuria e vërtetë për Perëndinë, thotë Gjoni (1 Gjonit 5:3), do të thotë të mbash urdhërimet e tij. Por mbetet fakt që bota e bën shpesh të vështirë për një besimtar të zbatojë urdhërimet e Perëndisë. Ndodh kështu jo sepse bota është domosdoshmërisht në armiqësi me besimtarët. Por më shumë për shkak të mënyrës që bota është organizuar dhe parimeve mbi të cilat qeveris punët e saj. Drejtori i një fabrike, që të mos takojë huadhënësit e tij, mund ta udhëzojë sekretaren që t’u thotë telefonuesve se ka shkuar jashtë shtetit – kur realisht ai është në zyrat e ndërmarrjes. Nëse sekretarja është një besimtare, dhe për hatër të ndërgjegjes do të refuzojë të thotë gënjeshtër, ajo mund të humbasë vendin e punës.

Një miku im, në një vend që nuk po ia përmendim emrin, u ankua te zyra rajonale e tatimeve për shkallën e lartë të taksave që qeveria po kërkonte prej tij. Inspektori i tha se shumica e njerëzve që ai njihte mashtronin duke mos deklaruar shumën të mëdha të të ardhurave të tyre. Prandaj qeveria përpigjej të kompensonte për këtë humbje të taksave duke ngritur shkallën e taksimit për sasinë që njerëzit deklarorin. Inspektori iu shpreh kështu mikut tim: “Nëse për hatër të parimeve të tua të krishtera do refuzosh të mashtrosh, dhe do të deklarosh ndershmërisht të ardhurat e tua, nuk të ndihmojmë dot: do të taksohesh në shumën të mëdha.”

Pa dyshim që mund të përmendim shumë situata të tjera të ngjashme, në të cilat mënyra sesi bota vepron e bën të vështirë për një besimtar të zbatojë urdhërimet e Perëndisë. Por pastaj, thotë Gjoni (1 Gjonit 5:3-4), për një besimtar urdhërimet e Perëndisë nuk janë të rënda, “sepse çdo gjë që ka lindur nga Perëndia e mund botën.”

<i>A. Çlirimi i Izraelit nga Egjipti dhe princi i tij</i> Pjesët përbërëse të strategjisë së Perëndisë për çlirimin e Izraelit: 1. <i>Perëndia ia zbulon veten Moisiut në ferrishten që digjej</i> (Eksodi 3:1–10) si: (a) Perëndia i së shkuarës së Izraelit (3:6). (b) Perëndia i së ardhmes së Izraelit (3:8). (c) Perëndia i së tashmes së Izraelit: erdhi në botë për t'i çliruar ata (3:8). 2. <i>'Dërgimi' i Moisiut tek Izraeli dhe Faraoni për t'u transmetuar këtë zbulesë atyre dhe për ta çliruar kështu Izraelin nga Egjipti</i> (3:10, 14). 3. <i>Prova përmes së cilës Moisiu do të bindte izraelitët që Perëndia e kishte dërguar atë dhe t'i bënte të besonin tek ai dhe, për pasojë, edhe te Perëndia</i> (3:13–4:9). (a) shpallja e emrit të Perëndisë: <i>UNË JAM AI QË JAM</i>. (b) <i>mrekullitë që Moisiu do të bënte</i> (4:1–8, 27–31). 4. <i>Pashka ishte njëherazi:</i> (a) <i>Gjykimi i Perëndisë mbi princin e Egjiptit dhe thyerja e pushtetit të tij mbi Izraelin</i>. Nëntë shenjat e para ishin një provë e padiskutueshme për Faraonin që Zoti ishte Perëndia në mes të vendit (8:22; krhs. 8:19; 9:11, 27). Por kur ai refuzoi me kokëfortësi kërkesën e Perëndisë, gjykimi i Perëndisë erdhi mbi të dhe theu fuqinë e tij. (b) <i>Çlirimi i Izraelit prej engjëllit shkatërrimtar të gjykit të Perëndisë</i> (12:23) dhe nga fuqia e Faraonit (12:29–36). 5. <i>Mana</i> (Eksodi 16) u sigurua përditë për të mbajtur gjallë Izraelin ndërsa udhëtonte prej Egjiptit për në trashëgiminë e premtuar. 6. <i>Tabernakulli</i> (26–31; 35–40) u ndërtua në mënyrë të atillë që Perëndia të mund të banonte mes popullit të tij ndërsa udhëtonin, dhe që prej andej e tutje jeta dhe punët e tyre të përditshme të përqëndroheshin dhe të lidheshin me adhurimin dhe shërbimin ndaj Perëndisë.	<i>B. Çlirimi i burrave dhe grave prej botës dhe princit të saj</i> 1. <i>Krishti është zbulesa e plotë dhe përfundimtare e Perëndisë për vetveten</i> (a) Ai ishte nga fillimi, ai ishte me Perëndinë dhe ai ishte Perëndi (Gjoni 1:1–2). (b) Ai zbriti nga qielli në tokë për të na zbuluar Perëndinë (1:14; 6:38). Ai na e ka bërë të njohur Perëndinë (1:18). (c) Ai është Perëndia i së ardhmes (14:3; 17:24). 2. <i>Krishti që "i dërguari i Perëndisë" që u dërgua në botë që bota të mund të shpëtohej përmes tij</i> (,28 ,7:18 ;57 ,6:39 ;37–5:36 ;4:34 ;3:17 10:36 ;26 ,18 ,8:16 ;29). 3. (a) <i>Krishti shpalli, ende shpall, emrin e Atit që dishepujt e tij ta besojnë atë dhe vetë Perëndinë</i> (17:6–8), dhe të provojnë dashurinë e Atit (17:26). Krishti vetë është UNË JAM (8:24; and 6:48; 8:12; 11:25; 14:6; 15:1). (b) <i>Krishti dha shenja d.m.th. bëri mrekulli që ne të besojmë se ai është i dërguari, Krishti, Biri i Perëndisë</i> (;38–37 ,10:32 ;5:36 31–20:30). 4. <i>Krishti ishte Qengji i Pashkës prej Perëndisë</i> (1:29; 19:31–36). (a) me anë të vdekjes së Krishtit, dhe ringjalljes që pasoi, princi i botës është gjykuar (16:11) dhe do të dëbohet, dhe pushteti i tij mbi njerëzimin do të thyhet (12:31–32). (b) me anë të gjakut të Krishtit ne jemi të shpëtuar nga zemërimi i Perëndisë kundër mëkatit tonë (1:29). 5. <i>Krishti është mana, buka e gjallë prej qiellit për të mbajtur gjallë besimarët në udhëtimin e tyre prej tokës për në qiell</i> (Gjoni 58–6:48). 6. <i>Krishti dhe Ati i tij do ta bëjnë shtëpinë e tyre në zemrat e besimtarëve</i> (Gjoni 14:23).
--	---

Tabela 4. Çlirimi i Izraelit dhe i botës

Egjipti i Faraonit si një tablo e “botës”

Faraonët e bënë Egjiptin një “shtëpi skllavërie” (Eksodi 20:2) dhe një burg për Izraelin

Nuk ishte vetëm se e bënë punën e rëndë të izraelitëve jashtëzakonisht të vështirë, ndonëse e bënë edhe këtë, patjetër, si pjesë e politikës së tyre të qëllimshme për t'i nënshtruar ata (Eksod 1:8–14).

Nuk ishte vetëm se provuan një formë të kontrollit të popullsisë që ishte gati-gati genocide, ndonëse ata e provuan edhe këtë (Eksod 1:15–22).

Më tepër ishte se kur Moisiu, në emrin e Perëndisë, i bëri thirrje Faraonit të lejonte izraelitët të shkonin në një udhëtim tregëtar në shkretëtirë për të patur një festë fetare për Perëndinë, Faraoni ua refuzoi lejen haptazi. Realisht, ai e bëri punën e tyre dhjetë herë më të rëndë që ata të mos kishin as kohë dhe as energji të tepërta për të menduar që të kishin një festë të tillë fetare. Jeta për izraelitët nuk do të ishte tjetër përveçse punë, ushqim dhe gjumë; për ta nuk do të kishte një përmasë shpirtërore në jetë (Eksod 5:1–19).

Akoma edhe më e keqe ishte arsyeja që Faraoni dha si refuzim: “Kush është Zoti që unë duhet t'i bindem zërit të tij dhe ta lë Izraelin të shkojë? Unë nuk e njoh Zotin dhe nuk kam për ta lënë Izraelin të shkojë”. (Eksod 5:2).

Vetë Faraoni, natyrisht, njihte dhe adhuronte shumë perëndi; por ato qenë forca të natyrës të hyjnizuara. Perëndinë e vetëm të vërtetë, ai as nuk e njihte dhe as nuk u tregua i gatshëm ta pranonte.

Çfarë domethënie pati mohimi i Perëndisë nga Faraoni për botëkuptimin e Izraelit

Shumë kohë para se Izraeli të kishte shkuar në Egjipt, Perëndia iu shfaq patriarkut të tyre të lashtë, Abrahamit, dhe i pati treguar qëllimin dhe planin e tij për kombin (Zan 15). Qëndrimi i tyre në Egjipt, ndërsa familja e gjerë u zhvillua në 12 fise dhe pastaj në një komb, do të ishte i gjatë – por jo i përhershëm (Zan 15:13–16). Do të kishte një “më pas”, një të ardhme, kur Izraeli

do të linte Egjiptin dhe do të hynte në trashëgiminë e tyre të premtuar nga Perëndia.

Duke mos njohur Zotin, Faraoni po mohonte automatikisht që të kishte patur ndonjëherë një qëllim apo plan hyjnor të mëparshëm pas ardhjes së Izraelit në Egjipt; dhe njëherazi ai po mohonte që të kishte një të ardhme të planifikuar në mënyrë hyjnore për ta përtej dhe jashtë Egjiptit. Egjipti, për ta, do të ishte gjithçka, dhe do të bëhej gjithçka: asgjë përveçse të ndërtonin qytete rezervash shtetërore për faraonët (Eksod 1:11).

Egjipti i Faraonit në një shkallë më të lartë: materializmi ateist

Materializmi ateist nuk ka të bëjë vetëm me mohimin e ndërhyrjes së Perëndisë në historinë e shkuar për kombin e vogël të Izraelit. Materializmi ateist mbron që ka patur ndonjëherë një qëllim, qoftë hyjnor ose jo, pas shfaqjes së racës njerëzore mbi tokë, për të mos thënë pas lindjes së ndonjë individi.

Ai po ashtu mbron që ka ndonjë të ardhme për individin përtej jetës së tij ose të saj mbi këtë planet, apo ndonjë të ardhme të planifikuar në mënyrë hyjnore për vetë planetin.

Së treti, ai mbron që të ketë patur ndonjëherë një përmasë të vërtetë jo materiale, por frymërore për racën njerëzore përgjatë kohës së shkurtër që çdo individ jeton mbi këtë planet.

Duke mbrojtur këto pikëpamje, materializmi ateist e shndërron planetin tonë në një burg; dhe sa më intelektual të jetë një njeri, aq më mizor do të duket ky burg intelektualisht. Sepse materializmi këmbëngul që racionaliteti njerëzor është i paplanifikuar, i paqëllimtë, dhe produkt i forcave të verbëra që në fund fare do të asgjësojnë sistematikisht çdo inteligjencë, dashuri, shpresë dhe ekzistencë të individit. Në fund këto forca të verbëra do të shkatërrojnë planetin Tokë dhe çdo gjurmë të inteligjencës mbi të, dhe – shakaja e hidhur – kur ta kenë bërë këtë, nuk do të dinë që e kanë bërë. Prandaj inteligjenca njerëzore është përfundimisht e burgosur në mënyrë të pashpresë nga një materie pa mendje.

Fakti që ky materializëm filozofik na transmetohet neve dhe u mësohet fëmijëve tanë si kulmi i mendimit intelektual, na tregon se cili është burimi i vetëm dhe anti-intelektual i tij.

Ai vjen prej “princit të kësaj bote” për të cilin Krishti thotë në Ungjillin e Gjonit: “Ju jeni nga djalli, që është ati juaj, dhe doni të bëni dëshirat e atit tuaj; ai ishte vrasës që nga fillimi dhe nuk qëndroi në të vërtetën, sepse në të nuk ka të vërtetë. Kur thotë të rrema, flet nga vetvetja, sepse është gënjeshtar dhe ati i rrenës.” (Gjoni 8:44).

Strategjitë për emancipim

Së pari le të mendojmë për strategjitë e Perëndisë për të çliruar Izraelin nga zgjedha e princit të Egjiptit, si na përshkruhen tek Eksodi; dhe pastaj, së dyti, për strategjitë e Perëndisë për të çliruar burrat dhe gratë nga pushteti intelektual, moral dhe frymëror i princit të kësaj bote, siç na tregohet kjo tek Ungjilli i Gjonit.

Pikat e përbashkëta

Të përbashkëtat janë të dukshme; lidhjet e tyre mes çlirimit të njeriut nga bota dhe nga princi i saj meritojnë një vëmendje të gjatë dhe të detajuar. Ndoshta mjaftohemi për tani të theksojmë katër të vërteta që dalin nga ky krahasim. Ndërsa i mendojmë ato, do të bëjmë mirë të mbajmë mend që nëse nuk marrim parasysh shfaqjet e aluzioneve të tërthorta nga Dhiata e Vjetër, nuk do të dimë të çmojmë gjithçka që Dhiata e Re po thotë.

Perëndia i përgjigjet gënjeshtres

Mishërimi i Birit të Perëndisë, vdekja, ringjallja dhe lartësimi i tij janë përgjigjja e Perëndisë ndaj përpjekjeve të Satanit për të dëbuar Perëndinë nga bota dhe për të bindur njerëzimin që nuk ka tjetër veç kësaj bote. Krishti u tha përmbledhtas për misionin e tij dishepujve të vet kështu: “Unë dola nga Ati dhe erdha në botë; përsëri po e lë botën dhe kthehem tek Ati” (Gjoni 16:28). Atëherë, ka një botë tjetër; kjo botë nuk është e vetmja.

Krishti refuzon shpifjet

Shpallja e emrit dhe karakterit të Atit nga Krishti është përgjigjja që Satani merr për shpifjet në emër të Perëndisë, fillimisht të bëra

në kopshtin e Edenit dhe shumë herë të përsëritura që atëherë. Kur zbulojmë sesi është Ati në të vërtetë, kjo thyen zgjedhën e botës dhe princit të saj mbi ne.

Krishti thyen prangat

Vdekja e Krishtit, si Qengji i Pashkës nga Perëndia, thyen prangat e fajit dhe heq frikën e vdekjes dhe të zemërimit të Perëndisë përmes të cilave Satani mban njerëzit në armiqësi me Perëndinë.

Krishti jep një kontekst të ri

Kështu Krishti çliron njerëzit nga burgu i jetës së përkohshme dhe u jep atyre këtu dhe tani një përmasë tjetër të jetës: njohurinë e Perëndisë dhe marrëdhënie personale me Perëndinë që është jetë e përjetshme, për ta shijuar këtu në këtë jetë dhe përgjithmonë më pas (Gjoni 3:16; 17:1–3). Në këtë mënyrë kjo gjë e vendos jetën tonë në këtë botë në kontekstin e saj të vërtetë: qëllimet e përjetshme të Perëndisë para se ajo të fillonte (;4–1:1 17:5), miqësi me Perëndinë në të tashmen (14:23), dhe qëllimet e përjetshme të Perëndisë në të ardhmen (17:24 ;3–14:1).

...
Pyetjet e studimit për këtë kapitull mund t’i gjeni
në faqen 438.

15

Interpretimi alegorik, apo jo?

Te Galatasve 4:21-31 Pali të lë përshtypjen se ka bërë një gabim ekzegjetik të pafalshëm sipas disa studiuesve: në pamje të parë ai po interpreton një pasazh të Dhiatës së Vjetër në mënyrë alegorike dhe, më e keqja, në pamje të parë e pranon këtë haptazi. Them ‘në pamje të parë’, sepse ka dyshim nga ana gjuhësore përse i përket kuptimit që ai synon me frazën kyç në greqisht te 4:24: *ἀτινά ἐστιν ἀλληγορούμενα*.

Emri grek *ἀλληγορία* do të thotë “përshkrimi i një gjëje nën petkun e një tjetre”. Prandaj ajo mund të përdoret, dhe është përdorur shpesh, për “alegorinë” në kuptimin e saj të ngushtë letrar, dhe gjithashtu për interpretimet alegorike të legjendave mitike. Por mund të përdoret në një kuptim disi të ndryshëm për të përshkruar gjuhën metaforike dhe të figurshme të përdorur nga një orator (krhs. përdorimin e Ciceronit të këtij termi tek *Orator* 27.94). Atë që Pali ka dashur të thoshte me *ἐστιν ἀλληγορούμενα* (koha e kryer, forma joveprorë e foljes *ἀλληγορέω*), mund ta kuptojmë plotësisht pasi të kemi shqyrtuar me hollësi interpretimin e tij të historisë së Zanafillës që ai po citon te Galatasve 4:21-31. Por përkohësisht le të mos e zvogëlojmë forcën e akuzës: Pali akuzohet se ka përdorur interpretim alegorik.

Akuza kryesore kundër interpretimit alegorik

Pa dyshim që edhe kritikët më të ashpër të Palit nuk do të ishin kundër që dikush të shkruante qëllimisht një vepër alegorike. Alegoria është një metodë komunikimi tërësisht e respektueshme e së vërtetës. Ajo për të cilën kritikët ngrenë zërin – dhe me të drejtë – është që kur dikush trajton një vepër, e cila nga vetë autori i saj është synuar të jetë historike apo thjesht tregimtare, dhe e interpreton atë sikur autori ka synuar të jetë alegori, ndërkohë që autori origjinal nuk kishte fare synim të tillë.

Metoda

Një interpretim i tillë alegorik ka një histori të gjatë dhe jo shumë të mirë. Disa shprehje dhe tregime në epikat e Homerit, p.sh., qenë jashtëzakonisht ngjethëse për shijet e rafinuara të studiuesve të mëvonshëm aleksandrianë. Prandaj ata e hoqën këtë pengesë në lidhje me papranueshmërinë e tyre duke argumentuar se Homeri nuk nënkuptonte kurrë që këto shprehje të kishin kuptim të drejtpërdrejtë, por vetëm alegorik; kështu e interpretuan tekstin në mënyrë alegorike. Natyrisht që ata e kishin gabim dhe bënë interpretime absurde. Të gjithë sot kuptojnë që Homeri i kishte shkruar ato në kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës.

Më vonë filozofi aleksandrian hebre, Filo, interpretoi të gjithë Pentatukun alegorikisht.¹ Ai nuk e hodhi poshtë plotësisht kuptimin e pastër dhe të drejtpërdrejtë gramatik dhe historik të tekstit origjinal. Por ai pohoi që shumë hollësi brenda tekstit ishin ose naive, ose krejtësisht false nëse merreshin në kuptimin e plotë të fjalës; dhe kjo tregon, argumentoi ai, që kuptimi i vërtetë i të gjithë Pentatukut nuk qe kuptimi i tij i drejtpërdrejtë, por kuptimi “më i lartë” i fshehur që zbërthimi i tij alegorik ka zbuluar në të. Sistemi doktrinor që ai ngriti prej kësaj metode mund të ketë qenë arritje intelektuale e realizueshme vetëm nga

1 Filo lindi rreth vitit 20 para Krishtit. Ai ishte bashkëkohës i Gjon Pagëzorit dhe Krishtit, dhe për disa vjet edhe i Palit, ndonëse duket që ai nuk ka ditur ndonjë gjë për ta. Për një shembull të interpretimit të tij alegorik shih *Shënimin* në fund të këtij kapitulli.

një gjeni. Por një metodë që e ktheu Moisiun hebre në një mësues të filozofisë platonike, aristoteliane dhe stoike shumë kohë para se këto filozofi të krijoheshin, dhe pastaj të pohonte që Moisiu ishte krijuesi i këtyre filozofive, është një sistem shpjegues që nuk qëndron në vetvete.

Më vonë, gjatë epokës së krishterë, Origeni dhe ndjekësit e tij e përdorën interpretimin alegorik të Dhiatës së Vjetër dhe të Re për të gjitha arsyet (mes tyre ishte edhe dëshira për të hequr qafe ide si mijëvjeçari fizik që për ta ishte i papranueshëm). Interpretimi alegorik i Shën Agustinit i shëmbëlltyrës së Samaritanit të mirë (Luka 10:30–37) mbahet si rasti famëkeq i kësaj shkolle.²

Akuza

Ankesa themeltare që studiuesit modernë kanë për këtë lloj zbërthimi alegorik është që i vesh tekstit një kuptim që autori fillestar nuk e pati kurrë në mend. Prandaj është i pajustificueshëm. Po ashtu është arbitrar; sepse nëse metoda që e lejueshme, do ta lejonte interpretuesin ta bënte tekstin të thoshte çdo gjë që ai donte që teksti të thoshte; dhe lexuesi nuk do të kishte asnjë mjet për të gjykuar nëse interpretimi ishte apo jo i vërtetë.

Përveç kësaj, zbërthimi alegorik bie ndesh me metodën gramatiko-historike që studiuesit modernë (së bashku me shumë të lashtë) mendojnë se është themeli i patundur i zbërthimit të vërtetë. P.sh., ata këmbëngulin që nëse te Zanafilla Moisiu po fliste për Agarin, ai kishte parasysh Agarin, jo besëlidhjen e Sinait, që Pali thotë se ajo e përfaqëson (Gal. 4:24). Nëse Moisiu do të kishte parasysh besëlidhjen e Sinait, ai do të kishte thënë besëlidhja e Sinait. Nëse do të dëshironte të thoshte që Agari e përfaqësonte disi besëlidhjen e Sinait, ai do të na e kishte thënë këtë. Nëse nuk e tha këtë, nuk e ka patur në mend. Ky është i vetmi themel i sigurt për një interpretim të përgjegjshëm; dhe nëse themeli hiqet, çfarë do të bëjnë të drejtët? Prandaj ata e refuzojnë menjëherë interpretimin “alegorik” që Pali i bën

² Ai sugjeroi që Samaritani i mirë përfaqësonte Krishtin, hani ishte Kisha dhe paratë ishin sakramentet.

Zanafillës te Galatasve si të rremë dhe jo të duhur.

Nga ana tjetër studiuesit konservatorë, që besojnë se letrat e Palit janë fjala e frymëzuar e Perëndisë, natyrshëm e marrin në mbrojtje. Por disa herë mbrojtja që ata japin për të del më e keqe sesa akuza fillestare. Ata thonë që rabinët e kishin për zakon të përdornin këtë metodë alegorike të tepruar; prandaj Pali po i lufton me vetë armët e tyre. Ata nxitojnë të shtojnë se ishte vetëm një argument formal, disi i papërshtatshëm për ne që ta përdorim me bashkëkohësit tanë. Edhe vetë Pali, sugjerojnë ata, nëse do të ishte i gjallë sot, nuk do të përpiquej ta përdorte atë me njerëzit e brezit tonë.

Por pse jo? Ata thonë që brezi ynë do të kuptonte menjëherë që argumenti nuk është i vlefshëm. Por pse është kështu? Ngaqë pasazhi nga Zanafilla nuk ka të njëjtin kuptim me atë që i vesh Pali? Atëherë nuk ka patur ndonjëherë atë kuptim! Kështu që shtjellimi i tij që i gabuar nga fillimi. Por nëse pranojmë që rabinët bashkëkohorë mund të binden ende nga ky argument, kjo nuk i përmirëson gjërat. Perëndia i së vërtetës nuk do të përdorte kurrë një argument të rremë, vetëm sepse kështu mund t’ua hidhte kundërshtarëve ngaqë ata nuk do ta konsideronin të gabuar. Nëse Pali do të përdorte një argument të tillë, ai nuk do të ishte i frymëzuar nga Perëndia. Nëse Perëndia frymëzoi Palin, ai nuk do të përdorte një argument të tillë.

Thelbi i çështjes

Një gjë mund të thuhet këtu në mbrojtje të Palit. Ai e përdor interpretimin e tij, të ashtuquajtur alegorik, të historisë së Agarit për të ilustruar dhe përforcuar argumentin që tashmë e ka ngritur në këtë letër deri tani. Ky argument është mbështetur jo në ndonjë gjë sado pak alegorike, por mbi një seri citatesh të pastra dhe të drejtpërdrejta nga kontekste doktrinale dhe ligjore të Dhiatës së Vjetër (Gal 17–16, 13, 12, 11, 10, 8, 3:6). Pavarësisht këtij fakti, kjo nuk do ta shpëtojë emrin e tij, nëse do të vepronte pa ndonjë bazë për të alegorizuar atë që te Zanafilla është thënë me një gjuhë të qartë historike. Pyetja shtrohet se çfarë ka bërë ai? A e ka alegorizuar në fakt tregimin në kuptimin teknik të fjalës?

Tregimi i Agarit, Ismaelit, Sarës dhe Isakut te Zanafilla

Çfarë ka patur në mendje Pali kur tha që disa elemente të historisë Agar-Sara mbartin një kuptim “alegorik”? E vetmja mënyrë e besueshme për ta gjetur këtë është të shohim dhe kuptojmë çfarë ka bërë me hollësitë që nxori nga Zanafilla; dhe të mos shqyrtojmë vetëm disa vargje në shkrimet e tij të cilat ai përdor këta elementë “alegorikë”, por të gjithë gamën e argumentit të tij gjerë. Po ashtu, të shqyrtojmë jo vetëm pasazhet dhe vargjet që citon në të vërtetë nga Zanafilla, por gjithashtu edhe funksionin që këto pasazhe dhe vargje kryejnë në rrjedhën e tregimit të kontekstit më të gjerë nga vetë Zanafilla.

Referenca e fundit që Pali jep nga tregimi Agar-Ismael është si më poshtë:

Po çfarë thotë shkrimi? Dëboje skllaven dhe djalin e saj, sepse i biri i skllaves nuk mund të jetë trashëgimtar bashkë me djalin e së lirës. (Gal 4:30)

Këto janë fjalët e Sarës të marra nga Zanafilla 21:10, me një dallim të vogël: ajo që Sara tha në të vërtetë që “...nuk duhet të jetë trashëgimtar me birin tim, me Isakun”.

“Urdhëro,” thotë dikush, “Pali po ndryshon fjalët e tregimit të Zanafillës për ta përshtatur me interpretimin e tij alegorik.”

Në rregull, patjetër që Pali po i përshtat fjalët për të mbështetur pikën që ka ngritur gjatë gjithë diskutimit të tij, d.m.th., që biri i Sarës ishte biri i një gruaje të lirë, ndërsa ai i Agarit ishte biri i një skllave. Por a ka ndryshuar realitetin historik Pali kur ka vepruar kështu? A nuk ishte Isaku, biri i Sarës, biri i gruas së lirë?

Prandaj le të lëmë jashtë hollësitë e vogla dhe të merremi me gjërat e rëndësishme të komentit të Sarës. Ato lidhen me pyetjen: kush do të jetë trashëgimtari i Abrahamit? Ismaeli? Apo Ismaeli dhe Isaku së bashku? Apo thjesht Isaku? Sara po kërkon që të jetë vetëm Isaku; dhe kjo na sjell te kulmi i temës kryesore me të cilën është marrë kjo histori që nga fillimi i saj te Zanafilla 15.

Rrjedha e tregimit historik të Zanafillës 15

Nga një vëzhgim i thjeshtë mund të kuptohet që tema kryesore gjatë këtyre kapitujve është: kush do të jetë trashëgimtari i Abrahamit? (madje edhe Filo bie dakort me këtë). Tema zhvillohet gjatë 7 episodeve kryesore:

1. Te Zan 15:2, Abrahami i ankohet Perëndisë se nuk ka ndonjë bir të vetin për të qenë trashëgimtari i tij: nëse ai vdes, administratori i tij, Eliezeri, do të trashëgojë gjithë pasurinë e tij. Perëndia e siguron Abrahamin se do të ketë një djalë të vetin që do të jetë trashëgimtari i tij. Abrahami e beson Perëndinë (15:6). Përmes një besëlidhjeje solemne, Perëndia i garanton zotërimin përfundimtar të trashëgimisë farës së ardhshme të Abrahamit.

2. Zanafilla 16 ngre pyetjen: si do të lindë fara e premtuar? Sara, duke qenë shterpë, po vdes që të ketë fëmijë. Sipas këshillës së saj Abrahami merr Agarin; dhe ajo, tani shtatëzënë, arratiset nga shtëpia; por Perëndia e kthen pas në familjen e Abrahamit. Ismaeli lind.

3. Te Zanafilla 17 Ismaeli rrethprietet së bashku me vetë Abrahamin dhe gjithë shërbëtorët e shtëpisë së tij (17:23). Por kur Abrahami i përgjërohet Perëndisë për të njohur Ismaelin si farën dhe trashëgimtarin e premtuar, Perëndia refuzon. Trashëgimtari duhet të jetë dhe do të jetë, një bir i Abrahamit prej Sarës; emrin do ta ketë Isak, dhe pikërisht me të dhe me farën e tij pas tij, do të bëhet besëlidhja e Perëndisë (17:18–21).

4. Te Zanafilla 18:1-5 Perëndia viziton Abrahamin, dhe pavarësisht dyshimeve të Sarës, shpall që brenda 9 muajve të ardhshëm Sara do të lindë një djalë.

5. Ndërkohë Zanafilla 18:16–19:38, në kontrast me këtë, tregon historinë e dhimbshme sesi fara e Lotit vazhdon pas shkatërrimit të Sodomës dhe Gomorës.

6. Zanafilla 20 tregon, si pasojë e mossinqeritetit të Abrahamit, si një mbret filisteas merr Sarën dhe si atësia e fëmijës së ardhshme të Sarës do të ishte e dyshimtë nëse Perëndia nuk do të ndërhynte.

7. Zanafilla 21 pastaj sjell kulmin e temës: Isaku lind, dhe me këmbënguljen e Sarës skllavja dhe biri i saj dëbohen, për të qenë

të sigurt se Isaku do të jetë trashëgimtari i vetëm i Abrahamit (21:12).

Kaq, pra, për kronologjinë e këtij tregimi të Zanafilla.

Mënyra si e përdor Pali këtë tregim në tërësi dhe qëndrimi i Palit ndaj tij

Te Galatasve 4:30, si edhe e kemi parë, Pali citon fjalët e Sarës nga kulmi i tregimit. Por tani duhet të bëjmë pyetjen: në cilën pikë të argumentit të tij ai e përmend atë? Dhe sa prej kronologjisë së Zanafillës ai citon?

Përgjigjja është që sa për temën “Kush do të jetë trashëgimtari i Abrahamit?”, ai e citon të gjithën nga premtimi i besëlidhjes së Zanafillës 15 (Gal 3:15-29), që nga lindja e Ismaelit prej skllaves Agar te Zanafilla 16 (Gal 4:22) dhe premtimin e veçantë për Sarën që ajo do të lindë farën e premtuar te Zanafilla 17:15-21 (Gal 4:23), talljen e Ismaelit ndaj Isakut dhe deklaratën kulmore të Sarës te Zanafilla 21 (Gal 4:29-31). Pali jo vetëm i referohet të gjithë asaj, por ai citon detajet e saj në të njëjtin rend; ai e citon për të njëjtin qëllim, d.m.th. të provojë se kush është fara dhe trashëgimtari i Abrahamit; dhe përdor deklaratën kulmore të Sarës si kulm të vetë argumentit të tij.

Atëherë të lëmë mënjanë këtë “alegorizim” të supozuar të disa detajeve. Si e trajton ai tregimin në tërësi? A e alegorizon atë nga fillimi në fund? Apo pjesërisht e tregon si histori dhe pjesërisht si alegori? Apo si?

Përtej çdo dyshimi, ai e trajton atë tërësisht si një histori. Pali e thekson këtë gjë vetë. E gjithë forca e argumentit të tij ligjor (Gal 3:17), mbështetur mbi besëlidhjen e Perëndisë me Abrahamin dhe farën e tij, varet nga ana historike e tij dhe datimi. Ligji, argumenton ai (siç edhe e pamë te Kapitulli 10), u dha 430 vjet pas besëlidhjes së Perëndisë me Abrahamin dhe prandaj nuk mund të përdoret për ta anuluar apo zhvleftësuar atë. As nuk mund t'i shtoheshin kushtet dhe rregullat e ligjit të mëvonshëm kushteve të besëlidhjes së hershme, pa e shtrëmbëruar natyrën e premtimeve të saj të pakushtëzuara (Gal 3:15-18). Ky të paktën nuk është zbërthim alegorik: është duke folur me gjuhën e saktë të një historiani dhe juristi.

Por ai vazhdon të pohojë se fara, për të cilën trashëgimia u caktua, ishte Krishti (Gal 3:16). A nuk është ky një lloj alegorizmi jo historik? Patjetër që jo. Për Palin, Krishti nuk qe një pasardhës alegorik i Abrahamit (sido që ta kuptojmë këtë), as thjesht një pasardhës frymëror i tij; ai ishte realisht dhe fizikisht pasardhës i tij. Ai qe fara fizike e Abrahamit po aq sa ishte Isaku. Që të qëndronte argumenti, edhe deklarata e Perëndisë për Abrahamin, “nga Isaku do të dalin pasardhës që do të mbajnë emrin tënd”, (Zanafilla 21:12), duhej në radhë të parë të nënkuptonte për Palin, ashtu siç bën edhe te pjesa e Zanafillës, që Isaku ishte pasardhës real dhe fizik i Abrahamit.

Është e vërtetë që në komentet e mëvonshme të Palit, ai pohon se në lindjen e Isakut kishte më shumë në lojë sesa proceset e natyrshme të riprodhimit njerëzor: Ismaeli u lind sipas mishit, Isaku u lind “përmes premtimit” dhe “sipas Frymës” (Gal 4:23, 29). Por Pali as nuk ka për qëllim të thotë se lindja e Isakut “sipas Frymës” ishte vetëm një lindje alegorike dhe jo fizike. Lindja qe një mrekulli e hirit dhe fuqisë së Perëndisë e bërë në përputhje me premtimin fillestar të Perëndisë; por, megjithatë, në mendjen e Palit kjo nuk ishte një ngjarje më pak reale, historike dhe fizike. Vetëm shqyrtoni këtë vëzhgim të Romakëve 4:19 që Abrahami nuk e konsideronte trupin e tij, tashmë të thyer, dhe shterpësinë e barkut të Sarës, një pengesë për besimin e tij. Ky ishte sfondi historik dhe fizik për një mrekulli historike dhe fizike.

Nga kjo rrjedh që Pali e quante lindjen e Ismaelit si një ngjarje reale, fizike dhe historike po ashtu. Agari ishte një grua reale. Madje edhe kur trajton rastin kur Ismaeli e talli Isakun, te pjesa në të cilën Pali mendohet se tingëllon më shumë “alegorik” (Gal 4:24-31), ai rastësisht tregon që e quan këtë tregim si histori. “Po, sikurse atëherë ai që lindi sipas mishit përndiqte atë që kishte lindur sipas Frymës, kështu është edhe tani.” Jo “si në tregim ashtu edhe realisht” (aq më pak “si në alegori”); por “sikurse atëherë historikisht, kështu edhe tani.”

Domethënia e lindjes së Ismaelit “sipas mishit”

Çfarë do të thotë Pali me shprehjen se lindja e Ismaelit ishte “sipas mishit”, ndërsa ajo e Isakut ishte “përmes premtimit”?

Nëse këto dy lindje ishin të vërteta dhe fizike, çfarë dallimi kanë mes tyre?

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje në një mënyrë që është në përputhje me zhvillimin historik të mendimit të Palit, duhet të fillojmë me zbulesën e ungjillit që Pali mori prej Zotit të ngjallur (Gal 12-1:11; Veprat 26:12-18). Para kthimit të tij në besim, Pali (apo Sauli, siç quhej atëherë) ishte përpjekur me gjithë sinqeritetin dhe zellin për të fituar jetën e përjetshme dhe për t'u pranuar nga Perëndia mbi bazën e mbajtjes së ligjit të dhënë në Sinai (shih përshkrimin e tij për jetën fetare të vetën para kthimit në besim te Filip 3:5-6). Kthimi te Krishti ndryshoi në mënyrë radikale qëndrimin e tij (Filip 3:7-12). Tani ai e kuptoi me një qartësi të pakundërshtueshme se shfajësimi dhe jeta e përjetshme nuk mund të fitoheshin përmes përpjekjeve të tij të mëdha për të mbajtur ligjin, por ishin vetëm një dhuratë e hirit të Perëndisë përmes vdekjes fajëshlyese të Krishtit dhe ringjalljes së tij.

Për më tepër, kur përshkroi dallimin mes këtij parimi themeltar dhe motivimit të jetës së tij para dhe pas kthimit në besim, fraza që përdori për të përshkruar qëndrimin e tij të mëparshëm ishte “unë kam përse të besoj edhe në mishin” (Filip 3:3-7). Me këtë ai do të thoshte besim në përpjekjet dhe disiplinën e vet fetare për të zhvilluar një karakter që në fund do t'i jepte pranim para Perëndisë. Në kthimin e tij në besim, kjo siguri në mish dhe në vetë drejtësinë e tij ishin të dyja plotësisht dhe përgjithmonë të braktisura. Në vendin e tyre erdhi besimi te Perëndia dhe te fuqia e Frymës së Perëndisë, dhe te një drejtësi që Perëndia ia komunikoi atij si një dhuratë të pamërituar, thjesht përmes besimit në Krishtin (Filip 3:3-9).

Prandaj kur thotë që Abrahami pati dy bij, një nga skllavja dhe një nga e lira, por biri i skllaves u lind sipas mishit ..., ai po përdor fjalën “mish” në kuptimin që ai e përdori për të përshkruar qëndrimin e tij në ditët para se të bëhej i krishterë. Ai nuk po qorton Agarin që i lindi fizikisht një fëmijë. Ai po kritikon Abrahamin që u mbështet në burimet, fuqitë dhe përpjekjet e veta për të arritur përmbushjen e premtimit të Perëndisë; me fjalë të tjera, që pati siguri në mish.

Natyra e gabimit të Abrahamit

Sipas Zanafillës 15 Perëndia i bëri Abrahamit një premtim të pakushtëzuar se do t'i jepte një bir dhe trashëgimtar; dhe Abrahami i besoi Perëndisë me gjithë zemër dhe kjo iu numërua atij për drejtësi (15:6). Pyetja e vetme ishte: si dhe në çfarë mënyre do të përmbushej premtimi i Perëndisë?

Në atë kohë Sara qe shterpë (Zan 16). Po t'i lije gjërat të rridhnin natyrshëm, ngjizja do të ishte e pamundur. Ajo nuk duhej të shqetësohej: Perëndia e dinte se ajo ishte shterpë kur bëri premtimin e tij, prandaj synonte të bënte një mrekulli jetëdhënëse në trupin e Sarës që ajo të mund të mbetej me barrë. Asaj dhe Abrahamit iu kërkua thjesht të besonin se Perëndia e kishte seriozisht premtimin e tij dhe të vendosnin besimin e tyre vetëm te Perëndia, besnikëria e tij dhe te fuqia e tij përtëritëse.

Në vend të kësaj, Sara mendoi që premtimi i Perëndisë nuk ishte në të vërtetë një premtim absolut i pakushtëzuar, por një nxitje apo shtytje më tepër për t'u mbështetur mbi veten dhe mjetet e tyre që, përmes burimeve të tyre, të përmbushnin premtimin. Kështu duke qenë vetë shterpë, ajo bindi Abrahamin të bashkohej me skllaven e tyre Agar, dhe të bëheshin me fëmijë përmes saj.

Këtë kishte në mendje Pali kur thotë që biri i Abrahamit prej gruas skllave ishte lindur “sipas mishit”. Natyrisht, ai nuk po fajëson Agarin: ai po kritikon Abrahamin dhe Sarën; por i kritikon ata me mësimin e fituar nga vetë përvoja e tij. Qëndrimi i tyre ndaj premtimit të Perëndisë ishte njësoj si qëndrimi i tij para kthimit në besim ndaj premtimeve të Perëndisë për shfajësimin dhe jetën e përjetshme. Ai kishte menduar gabimisht se këto bekime, të premtuara racës njerëzore prej Perëndisë, duhej të fitoheshin dhe të meritoeshin “sipas mishit”; përmes përpjekjeve dhe veprave të tij.

Prandaj Pali nuk po e interpreton përvojën e Abrahamit dhe Sarës si një alegori. Për të, ata ishin dhe mbeten personazhe historikë të cilët, në një pikë të karrierës së tyre, përdorën të njëjtin qëndrim si përdori ai për një kohë në karrierën e tij. Natyrisht, Perëndia në fund i mësoi Palit të njëjtin mësim si ia kishte mësuar më parë Abrahamit dhe Sarës.

Lindja e Isakut përmes premtimit

Kur Perëndia i bëri për herë të parë premtimin Abrahamit, Sara ishte shterpë; por Abrahami ende ishte potent dhe në gjendje të ndiqte sugjerimin e Sarës që të bënte një fëmijë me Agarit. Me kalimin e viteve e deshi shumë të birin e Agarit dhe iu përgjërua Perëndisë që ta pranonte Ismaelin si përmbushje të premtimit fillestar. Perëndia nuk e pranoi këtë (Zan 17:15-22) dhe priti që trupi i Abrahamit të bëhej i vdekur, për sa i përket të paturit e një fëmije, derisa të pranonte faktin se ai nuk mund dhe nuk duhej të përmbushte premtimin e Perëndisë përmes përpjekjeve dhe burimeve të tij. Jeta e re, që ai kërkonte, duhej t'i bëhej dhuratë atij dhe Sarës prej një akti të fuqisë krijuese të Perëndisë sipas qëllimit fillestar të premtimit të pakushtëzuar.

Prandaj duhet të theksojmë sërish se kur te Romakëve 4:18-25 Pali e citon besimin e Abrahamit në premtimin e Perëndisë dhe e përdor atë, përmes një analogjie, për të shpjeguar se çfarë do të thotë “besim” edhe në rastin tonë po ashtu, kur na thuhet se jemi të shfajësuar prej besimit, ai nuk po e interpreton tregimin e Abrahamit si një alegori. Ai po citon një rast historik të asaj se çfarë do të thotë për një qenie njerëzore të besojë në fjalën e Perëndisë, dhe pastaj e zbaton atë në kohën tonë për ne që duhet të mësojmë se çfarë Perëndia do të thotë me shprehjen “prej besimit” kur ai thotë se shfajësimi është prej besimit.

Çfarë ka parasysh Pali me fjalën “alegori” te Galatasve 4:24

Tani do të merremi me vargjet që përmbajnë frazën greke që është në thelb të hetimit tonë: ‘ἀτινά ἐστιν ἀλληγορούμενα’.

Detyra jonë e parë është të vendosim si kjo frazë duhet të përkthehet. Ka dy mundësi:

1. ‘... gjëra të cilat janë interpretuar alegorikisht’;
ose
2. ‘... gjëra që janë shprehur si një alegori’.

Përkthimi i parë do ta bëjë Palin të thotë që, në kohën e tij, tregimi i Agarit dhe Sarës është interpretuar përgjithësisht

prej studiuesve të ndryshëm si një alegori. Kjo natyrisht që do të ishte e vërtetë. Zbërthimi që Filo i bën kësaj historie është një shembull i njohur në botën e lashtë i metodës alegorike. Por interpretimi i Filos është shumë i ndryshëm nga ai i Palit (për të parë sa i ndryshëm, konsultohuni me pëmbledhjen e interpretimit që Filo i bën Agarit dhe Sarës të dhënë në shënimet në fund të kapitullit); dhe sigurisht çdo alegorizim bashkëkohës rabinik i historisë do të ketë qenë i ndryshëm nga interpretimi i Palit. Prandaj, është e pamundur që Pali të jetë duke iu apeluar interpretimeve alegorike bashkëkohore sikur ato të justifikonin alegorizimin e tij të tregimit.

Ka shumë të ngjarë që përkthimi i dytë prej atyre të dhënë më sipër të jetë i duhuri: “tani të gjitha këto gjëra janë thënë [prej autorëve të Dh.V] si një “alegori”. Me fjalë të tjera, çfarëdo gjë që Pali do të thotë këtu me “alegori”, ai po pohon se kjo alegori është pjesë e kuptimit të synuar nga vetë Dhiata e Vjetër.

Kjo konfirmohet përmes mënyrës që Pali i prezanton këto vargje (Gal 4:21-22): “Po më thoni, ju që doni të jeni nën ligj, a nuk e dëgjoni ligjin? Sepse është shkruar se Abrahami pati dy bij...”. “Është shkruar” paraqet fjalën greke γέγραπται, pësoren e shkruar të foljes “shkruaj” (γράφω). Është formula e përdorur në Dh.R kur citohet një pasazh i Dh.V si fjala autoritare, e pandryshueshme dhe e padiskutueshme e Perëndisë (shih, p.sh., Mat 4:4, 7, 10).

Nëse është kështu, ajo ngre edhe më ngutas pyetjen: çfarë ka në mendje Pali kur përdor fjalën “alegori”? Por tani menjëherë mund të pohojmë të sigurt se çfarëdo gjëje të ketë patur në mendje, ai nuk ka dashur të thotë që historia e Abrahamit, Sarës, Agarit dhe bijve të tyre që menduar nga autori i saj si një alegori johistorike. Po, është e vërtetë që kritikët paganë letrarë grekë do ta kenë menduar ashtu këtë fjalë, por nuk ka të ngjarë që Pali ta ketë përdorur këtë fjalë në kuptimin e tyre. Në dritën e asaj që kemi parë deri tani për qëndrimin e Palit rreth kësaj historie, është plotësisht e dukshme që ai e vlerëson atë si historike. Ajo që ka dashur të thotë është se, përveçse një kronikë për njerëz historikë, dhe qëndrimet dhe veprimet e tyre, kjo histori gjithashtu mbart një domethënie shtesë. Si shumë tregime të tjerë të Dhiatës së Vjetër, ajo është siç edhe do ta

shohim së shpejti, një prototip. Por së pari duhet të shqyrtojmë atë që Pali po argumenton në lidhje me ligjin dhe skllavërinë.

Le të japim hollësitë:

Këto gjëra kanë një kuptim alegorik, sepse këto dy gra janë [d.m.th. përfaqësojnë] dy besëlidhje: një [besëlidhje, që u dha] nga mali Sinai, që ngjiz për skllavëri, dhe *e tillë* [greqisht: ἡτις, jo përemri i thjeshtë lidhor, ἡ] është [d.m.th. korespondon me] Agari. (Gal 4:24)

Le të ndalojmë këtu të thithim atë që Pali po thotë. Thelbi i analogjisë mes Agarit dhe besëlidhjes së Sinait është fakti i vërtetë, sipas Palit, që besëlidhja e Sinait prodhon bij të skllavëruar. Përderisa kjo qëndron, besëlidhja e Sinait përputhet shumë mirë me Agarin: sepse ajo që një skllave vetë dhe kur Abrahami lindi një djalë me të, ai djalë ishte dhe do të mbetej gjithmonë me statusin e një skllavi.

Natyrisht që deklarata e Palit se besëlidhja e Sinait “ngjiz për skllavëri” është përpiluar në një gjuhë shumë metaforike, që ishte e zakonshme për gjuhët semite. Djali i Agarit që një fëmijë real; “bijtë” e besëlidhjes së Sinait qenë fëmijë metaforikë, d.m.th., njerëz që u janë formuar qëndrimet, karakteri dhe cilësia e jetës prej përpjekjeve të tyre për të jetuar sipas parimeve të asaj besëlidhje. Por ajo që Pali do të thotë për besëlidhjen e Sinait nuk është më pak reale dhe historike ngaqë është shprehur në gjuhë metaforike.³ Madje edhe besimtarët e vërtetë hebrenj, thotë Pali, që jetuan gjatë gjithë shekujve derisa erdhi Biri i Perëndisë nën kushtet dhe rregullat e besëlidhjes së Sinait, ishin si fëmijët e një familjeje të pasur: trashëgimtarë të babait të tyre, por gjatë fëmijërisë nuk dalloheshin nga skllavërit. “Kështu edhe ne, sa ishim të mitur, ishim të robëruar”, thotë ai, “nën elementet e botës.” (Gal 4:1–7).

Për më tepër, shumë, të mos themi të gjithë nga bashkëkohësit hebrenj të Palit, jetuan në një lloj skllavërie fetare (siç janë ende shumica e paganëve dhe hebrenjve sot) për shkak

3 Shumë gjuhë moderne përdorin pothuajse të njëjtën metaforë që Pali përdor. P.sh., ne mund të themi që sistemi arsimor francez prodhon nxënës me një botëkuptim dhe cilësi të caktuar, ndërsa *produkti* i sistemit arsimor amerikan ka një cilësi dhe botëkuptim disi tjetër. Askush nuk do të mendojë se kemi të bëjmë me një shprehje alegorike.

të qëndrimit të gabuar që mbajnë ndaj ligjit. Ashtu siç Abrahami keqpërdori Agarin duke u përpjekur të përmbushë premtimin e Perëndisë për një jetë të re, ashtu bashkëkohësit e Palit ishin duke keqpërdorur ligjin. Ata menduan që Perëndia u dha atyre ligjin e Sinait që, përmes përpjekjeve të tyre për ta respektuar atë, të mund të fitonin shfajësimin dhe jetë të përjetshme. Por ky nuk që qëllimi i besëlidhjes së Sinait – dhe nuk mund të ketë qenë kurrë. Le të lejojmë Palin ta shpjegojë arsyen.

Parimi themeltar i ligjit, thekson ai (3:12), ishte “Do të respektoni statutet dhe dekretet e mia, me anën e të cilave, kushdo që i zbaton në praktikë, ka për të jetuar.” (Lev 18:5). Tani është plotësisht e vërtetë se, në çështjet e jetës së përditshme, të respektuarit e ligjit të Perëndisë sa më mirë që të mundemi sjell shëndet dhe jetë. Por jo jetë të përjetshme dhe pranim final para Perëndisë! Në atë nivel, ligji i Sinait mund të na bindë të gjithëve vetëm për mëkatën dhe të shpallë deklaratën e mallkimit dhe vdekjes mbi ne sa herë kemi dështuar ta zbatojmë ligjin plotësisht (Gal 3:9–10). Pikërisht për këtë gjë Krishti duhej të vdiste dhe të bëhej mallkim për ne, që të mund të na çlirojë prej mallkimit të ligjit të thyer (3:13), dhe në këtë mënyrë të na çlirojë për të marrë dhe shijuar “bekimin e Abrahamit me anë të Jezu Krishtit, që ne të marrim premtimin e Frymës me anë të besimit.” (3:14).

Nuk kishte asgjë të gabuar me ligjin, natyrisht; dhe duke i dhënë Izraelit ligjin, Perëndia nuk po anulonte premtimet që i dha fillimisht farës së Abrahamit (3:21). Me të vërtetë, thotë Pali, “Sepse po të ishte dhënë një ligj që mund të jepte jetë, drejtësia do të ishte me të vërtetë prej ligjit.” (3:21). Por, pikërisht këtë, ligji nuk mund ta bënte në vetvete. Ligjet e higjienës janë të mirë; por ato nuk mund të krijojnë jetë të re, nuk mund të rilindin një trup të vdekur. Pyesni Abrahamin! Kështu është edhe me ligjin. Jeta e përjetshme duhet të pranohet jo përmes zbatimit të ligjit, por si një dhuratë falas përmes besimit në Krishtin (3:11).

Por pikërisht këtë Jerusalemi dhe shumica e fëmijëve të tij – d.m.th., qytetarët e tij – nuk do ta pranonin. Në të vërtetë ata u munduan shumë ta zbatonin ligjin me shpresën e kotë se do të fitonin jetë të përjetshme duke vepruar ashtu, ndërkohë që nuk kishte asnjë mundësi për ta fituar në këtë mënyrë, prandaj mosarritja e zbatimit të ligjit do të thoshte vdekje e përjetshme.

Kjo ishte skllavëri e vërtetë (shih Rom 9:30-10:4).

Por ka ardhur koha që ne të kthehemi te pjesa që mbetet nga zbërthimi që Pali i bën prototipit të Dhiatës së Vjetër.

Mali Sinai dhe Jerusalemi si metafora të mamasë

Dhe Agari është mali Sinai në Arabi⁴ dhe i përgjigjet [greqisht: *συστοιχεί*] Jerusalemit të kohës së sotme; dhe ajo është skllave me bijtë e saj. (Gal 4:25)

Le të fillojmë me të thjeshtën. Fakti që Pali po i referohet Jerusalemit të tanishëm dhe “fëmijëve” të tij nuk tregon se ai po flet alegorikisht. Ai po flet për qytetin e vërtetë të asaj kohe të Jerusalemit, kryeqytetin fetar të të gjithë hebrenjve kudo në botë. Kur i referohet asaj si një nënë dhe qytetarëve të tij si fëmijë të saj, ai po përdor një metafor shumë të njohur në botën e lashtë dhe ende të përdorshme në shumë gjuhë edhe sot.

Edhe Krishti iu drejtua qytetit të Jerusalemit si një nënë, dhe fëmijëve të saj si fëmijë të tij (Luka 13:34). Edhe rusët e përshkruajnë vendin e tyre si Nëna Rusi dhe përdorin termin *metropol* për të folur për shtetin amë. Po ashtu shumë studentë të vendeve të ndryshme do të flasin për universitetin e tyre si *alma mater* – *shkolla mëmë*. Asnjë nga këto shembuj nuk do të merrej si alegorike.

Për shkak se shprehje si këto janë thjesht metafora, një profet i lashtë, si Isaia, mund të përziejë lehtësisht metaforat e tij. Në një pjesë ai flet për Sionin si një nënë dhe për qytetarët e Sionit si fëmijët e saj (Isa 49:14–21); por në një pjesë tjetër ai flet për bijtë e Sionit që martohen me të (62:5)!

Prandaj këtu, në zbërthimin e prototipit të Dhiatës së Vjetër nga Pali, ai mund të thotë së pari se, për shkak se besëlidhja e dhënë nga Mali Sinai polli fëmijë të skllavëruar, ajo korrespondon me gruan skllave Agarin, që i lindi një bir Abrahamit në skllavëri. Pastaj ai mund të shtojë se Mali Sinai është në përputhje me qytetin e atëhershëm të Jerusalemit, sepse edhe ajo gjithashtu është në skllavëri bashkë me fëmijët e saj.

⁴ Ky përkthim mbështetet nga dorëshkrimet më të mira dhe ka shumë të ngjarë që të ketë qenë kuptimi fillestar i vargut.

Edhe njëherë tjetër, Pali nuk po arrin në përfundimin se Jerusalemi aktual është në skllavëri bashkë me fëmijët e saj prej të dhënave të tregimit të Abrahamit dhe Agarit në Dhiatën e Vjetër. Ai po e deklaron këtë si një fakt të historisë bashkëkohore që e njihje shumë mirë – ai vetë kishte jetuar një pjesë të jetës së tij në atë vetëskllavëri fetare të njëjtë, që ishte kryesisht një ide e gabuar për qëllimin e ligjit nga Mali Sinai.

Kjo ishte e trishtueshme jo vetëm për shkak të skllavërisë së pashmangshme që pasoi, por për një arsye tjetër historike dhe gjeografike. Kur Perëndia bëri besëlidhjen fillestare me Abrahamin dhe farën e tij, Abrahami ishte tashmë në Kanaan. Prandaj, që në hyrje të besëlidhjes, Perëndia i tha Abrahamit: “Pastaj Zoti i tha: “Unë jam Zoti që të nxori nga Uri i Kaldeasve, për të ta lënë këtë vend si trashëgimi.” (Zan. 15:7). Kur Abrahami pyeti si mund të ishte i sigurt që ai do ta trashëgonte atë, Perëndia iu përgjigj duke bërë një besëlidhje pa kushte që garantonte t’ia jepte atë Abrahamit dhe farës së tij (Zan. 15:8-21).

Por Mali Sinai, Pali thekson, ishte në Arabi. Tani Arabia ishte ai vend që biri i Agarit, Ismaeli, dhe pasardhësit e tij e bënë atdheun e tyre (shih Zan 21:21; Ps. 83.6). Por çka është më e rëndësishme, në nivelin e kuptimit të tij si prototip, Mali Sinai nuk ishte në Kanaan dhe Arabia nuk ishte pjesë e trashëgimisë së premtuar. Kur Izraeli mori besëlidhjen e Malit Sinai, ata nuk ishin në tokën e premtuar, por po shkonin drejt asaj. Ajo besëlidhje u tregoi atyre sjelljen që Perëndia priste prej tyre, qoftë kur qëndruan në shkretëtirë, qoftë pasi të hynin në Kanaan. Por në themel të prerogatives së Izraelit për trashëgiminë e tyre ishte besëlidhja pa kushte që Perëndia bëri me Abrahamin dhe farën e tij, jo ligji nga Sinai. Dhe si Pali ka theksuar më herët (Gal. 3:16), fara e përmendur në besëlidhjen me Abrahamin që kryesisht Krishti (shihni diskutimin tonë të mëparshëm, kapitulli 10). Të gjithë ata që vendosin besimin e tyre tek ai, dhe jo te përpjekjet e tyre për të mbajtur ligjin e Sinait, do të fitojnë sigurisht trashëgiminë e premtuar për Abrahamin dhe farën e tij (3:29).

Fatkeqësisht Jerusalemi i kohës së Palit, kryeqyteti fetar dhe qyteti amë i gjithë judenjve kudo në botë, e refuzoi Krishtin si çelësin për zotërimin e vazhdueshëm të trashëgimisë së

premtuar dhe në vend të kësaj e mbështeti shpresën e tij të trashëgimisë në përpjekjet e veta për të mbajtur ligjin prej Sinait. Judaizmi zyrtar – dhe pjesa më e madhe e botës së krishterë – ende vepron kështu.

Jerusalemi prej së larti

Ndërsa Jerusalemi nga lart është i lirë dhe është nëna e ne të gjithëve. (Gal 4:26)

Në vargun 24 Pali na ka thënë që këto gra (d.m.th. Agari dhe Sara) përfaqësonin 2 besëlidhje. Ai pastaj shpjegoi që Agari përfaqësonte besëlidhjen nga Sinai, por nuk na ka thënë se cilën besëlidhje përfaqësonte Sara. Por tani ky detaj qartësohet: Sara përfaqëson besëlidhjen pa kushte që Perëndia bëri me Abrahamin (Zan 15). Është në përputhje me premtimin e dhënë nga Perëndia të asaj besëlidhjeje që ajo, gruaja e lirë, lindi birin e lirë – Isakun.

Por nëse Agari = besëlidhja e Sinait = Jerusalemi i tanishëm; atëherë, Sara = besëlidhja e Abrahamit = Jerusalemi që është nga lart. Ky Jerusalemi përbëhet nga një komunitet i gjerë hebrenjsh dhe johebrejsh që janë fëmijët shpirtëror të Abrahamit dhe Sarës sepse, ashtu si ata (dhe si Pali), ata e kanë mbështetur shpresën e tyre për jetë të përjetshme jo në përpjekjet e tyre për të mbajtur ligjin e Moisiut, por vetëm mbi premtimet pa kushte të Perëndisë që u jepen atyre që e vendosin besimin e tyre te Krishti.

Përdorimi i historisë Agar – Sara nga Isaia si një prototip

Ngazëllo, o shterpë, që nuk lindje; shpërthe në britma të larta gëzimi, ti që nuk provojë dhembjet e lindjes! Sepse fëmijët e së shkretës do të jenë më të shumtë se fëmijët e gruas së martuar, thotë Zoti. (Isa 54:1)

Pali nuk ishte i vetmi që pa se tregimi i Zanafillës 15-21 ishte edhe historik edhe një prototip. Isaia e kuptoi kështu shekuj më parë. Tek Isaia 51:1-2 ai i bën thirrje kombit të tij “Shikoni

Abrahamin, atin tuaj, dhe Sarën që ju ka lindur, sepse e thirra kur ishte vetëm. E bekova dhe e shumova.” Sidoqoftë, qysh atëherë, si pasojë e besimit të kombit në vetvete dhe në idhujt e tij dhe jo në Perëndinë e gjallë që ishte krijuesi dhe bashkëshorti i tyre, Jerusalemi kishte provuar armiqësi me Perëndinë, shkatërrimin e qytetit dhe dëbimin e fëmijëve të tij në mërgim dhe robëri.

Por tani Isaia, në emrin e Perëndisë, i premtonte Jerusalemit mëkëmbjen e fëmijëve të tij dhe përmend përvojën e Sarës si një prototip. Sara fillimisht ishte shterpë. Kur humbi besimin në premtimin e Perëndisë, ajo sugjeroi, për të keqen e vet më pas, që Abrahami të bashkohej me Agarin. Ndërkaq kur ajo ishte shterpë, Agari u bë me burrë, lindi një fëmijë, përbuzi Sarën dhe kapardisej me djalin e saj në sytë e Sarës duke e tallur për shterpësinë e saj (Zan 16). Përveç kësaj, Abrahami e deshi shumë djalin e Agarit, të mos themi vetë Agarin, dhe do të kishte qenë i lumtur që Sara të qëndronte shterpë, vetëm e vetëm që të mund ta bënte Ismaelin trashëgimtarin e tij (Zan 17). Nuk kishte dëshpërim më të madh për Sarën sesa ky.

Por në kohën e mirë të Perëndisë situatat u përmbysën. Sara, gruaja dikur shterpë, lindi një fëmijë. Ndonëse Perëndia bekoj Agarin dhe birin e saj dhe u premtoi pasardhës të shumtë (Zan 16:10; 21:18), Perëndia i premtoi Abrahamit shumë më tepër fëmijë, qofshin fizikë dhe frymërorë, përmes Sarës (Zan 17:16, Rom 4:16-18).

Që prej Rrëshajëve, profecia vezulluese e Isaiaes është përmbushur, në njëfarë shkalle, përtej ndoshta asaj që Sara dhe Abrahami mund të kishin përfytyruar. Dhe përmbushje edhe më të mëdha janë përpara (Rom 27-11:12). Sepse ashtu si mund të themi që Koperniku është ati i shkencës moderne, përderisa ai, përmes shembullit të tij, u tregoi rrugën që duhet të ndiqnin të gjithë shkencëtarëve që do të pasonin, po ashtu Abrahami dhe Sara, përmes përvojës së tyre, u kanë treguar miliona njerëzve që nga ajo kohë se çfarë do të thotë të besosh te Perëndia dhe të jesh i shfajësuar prej besimit. Në këtë kuptim këto miliona janë fëmijët e tyre frymërorë.

Fatkeqësisht, një detaj tjetër i prototipit është përmbushur vazhdimisht. “Po, sikurse atëherë ai që lindi sipas mishit [d.m.th. Ismaeli] përndiqte atë që kishte lindur sipas Frymës

[d.m.th. Isakun: shih Zan 21:9], kështu është edhe tani,” thotë Pali (Gal 4:29). Përndjekja e atyre që u lindën prej Frymës nga ata që u lindën sipas mishit ka vazhduar gjatë gjithë shekujve. Kjo nuk bën gjë tjetër veçse tregon sesa e nevojshme është të kuptojmë se çfarë do të thotë realisht shfajësimi nga besimi dhe pastaj të qëndrojmë të patundur për të. Në lidhje me këtë, do të jetë e rëndësishme të kuptojmë sa më saktë interpretimin që Dhiata e Re i bën Dhiatës së Vjetër.

Shënim

Një përmbledhje e interpretimit të Filos për Sarën dhe Agarin mbështetur mbi një numër traktatesh të tij dhe e hartuar nga J. B. Lightfoot.⁵

Abrahami – shpirti njerëzor që përparon drejt njohjes së Perëndisë – bashkohet së pari me Sarën dhe pastaj me Agarin. Këto dy aleanca kundërshtojnë në mënyrë të plotë njëra-tjetrën. Sara – princesha – sepse ky është kuptimi i emrit – është dituria hyjnore. Abrahamit i bëhet thirrje të dëgjojë gjithçka që ajo i thotë. Nga ana tjetër Agari, që i përkthyer ky emër do të thotë “shtegtim” (παροίχησις) dhe tregon për diçka kalimtare dhe që nuk të kënaq, është një edukim përgatitor dhe i ndërmjetëm – edukimi i shkollave – arsimim laik, siç mund edhe ta shprehim me fraza të kohës moderne. Për këtë arsye ajo është përshkruar siç edhe e meriton: si një egjiptiane, si shërbëtore e Sarës. Fillimisht aleanca e Abrahamit me Sarën është e parakohshme. Ai nuk është mjaftueshëm i përparuar në zhvillimin e tij moral dhe shpirtëror për të përfituar prej saj. Ai ende nuk mund të lindë një djalë me të. Prandaj ajo e drejton atë të shkojë te shërbëtorja e saj, të ushtrohet në edukimin që jep shkollimi. Kjo aleancë më e ulët është e frytshme menjëherë. Më vonë, pas këtij edukimi paraprak, ai e bashkon sërish veten me Sarën; dhe këtë herë bashkim i tij me diturinë hyjnore është pjellor. Jo vetëm që Sara i jep një djalë, por ajo shpallet si nëna e një pasardhjeje të panumërt. Në këtë

mënyrë përmbushet paradoksi i çuditshëm që “gruaja shterpë do të jetë me e frytshme se pjellorja”. Kështu në përparimin e shpirtit njerëzor vërtetohen fjalët e profetit, të thënë alegorikisht, që “fëmijët e së shkretës do të jenë të shumtë.”

Por alegoria nuk mbaron këtu. Kontrasti mes nënave riprodhohet në kontrastin mes bijve. Isaku përfaqëson diturinë e të urtëve, Ismaeli, sofizmat e sofistëve. Sofizmat duhet që t’i lënë vendin diturisë. Djali i skllaves duhet dëbuar dhe të largohet para djalit të princeshës.

...

Pyetjet e studimit për këtë kapitull mund t’i gjeni në faqen 439.

⁵ Galatasit, 198–9.

KATEGORIA E KATËRT

Tipare të nënkuptuara

16

Kuptime të shumëfishta

Ne po i afrohem tani një kategorie të katërt mendimi në interpretimin e Dhiatës së Vjetër nga Dhiata e Re. Në këtë kapitull, dhe në dy kapitujt që vijnë, do të shqyrtojmë disa rrjedhime të mënyrës në të cilën Dhiata e Vjetër është shkruar. Kjo për arsye se Dhiata e Re dëshmon rëndësinë e këtyre rrjedhimeve, dhe i përdor këto tipare ndërsa zbërthen Dhiatën e Vjetër për lexuesit e saj.

I pari, nga tiparet e nënkuptuara që ne do të shqyrtojmë, na shpie te pyetja e ngritur në Kapitullin 5: nëse është e mundur dhe si është e mundur që një pjesë apo koncept i vetëm në Dhiatën e Vjetër të ketë kuptime në më shumë se një nivel. Le të shqyrtojmë sërish një shembull të thjeshtë para se të lëvizim te një që është më i zgjeruar dhe i detajuar.

Rasti i Adamit dhe Evës

Interpretimi i Dhiatës së Re për Adamin dhe Evën tregon se ajo e vlerëson historinë e tyre si një gjë që ka kuptim në më shumë se një nivel.

Natyrisht që nuk ka nevojë të përmendim se Dhiata e Re beson në anën historike të tregimit të krijimit dhe rënies në mëkat të Adamit dhe Evës. Të shumta janë vendet ku ajo i referohet qëllimit të krijimit të tyre dhe marrëdhënies së tyre me Krijuesin, administrimin e tyre të tokës dhe privilegjeve të tyre ngaqë

mbartin imazhin dhe shëmbëlltyrën e Perëndisë. Gjithashtu më shumë se një herë Adami, njeriu i parë, është krahasuar dhe ballafaquar me Krishtin, njeriun e dytë dhe Adamin e fundit (krhs. Rom 5:12–19; 1 Kor 15:45–49; Heb 2:5–18).

Por ne do t'i kushtojmë vëmendje të veçantë këtu mënyrës sesi Dhiata e Re trajton një nga detajet e tregimit të krijimit dhe e interpreton atë, njëherë në nivelin e drejtpërdrejtë dhe historik, dhe njëherë tjetër në nivelin prototipik dhe frymëror. Detajet e veçanta janë marrë nga krijimi i Evës si bashkëshortja dhe ndihmësja e Adamit:

Pastaj Zoti Perëndi me brinjën që i kishte hequr njeriut formoi një grua dhe e çoi te njeriu. Dhe njeriu tha: “Kjo së fundi është kocka e kockave të mia dhe mishi i mishit tim. Ajo do të quhet grua sepse është nxjerrë nga burri”. Për këtë arsye njeriu do të braktisë babanë dhe nënën e tij dhe do të bashkohet me gruan e tij, dhe do të jenë një mish i vetëm. (Zan 2:22–24)

Te Mateu 19:4–6, Krishti citon këtë pasazh nga Zanafilla dhe e interpreton atë në nivelin e drejtpërdrejtë dhe historik. Duke korrigjuar disa nga idetë liberale të bashkëkohësve të tij rreth temës së divorcit, ai i kthen pas te standardi ideal i Perëndisë, i paraqitur në krijimin e gruas:

Dhe ai, duke u përgjigjur u tha atyre: A nuk keni lexuar ju, se ai që i krijoi që në fillim, i krijoi mashkull dhe femër? Dhe tha: “Për këtë arsye njeriu do ta lërë babanë dhe nënën e vet dhe do të bashkohet me gruan e vet; dhe të dy do të jenë një mish i vetëm”. Dhe kështu ata nuk janë më dy, por një mish i vetëm; prandaj atë që Perëndia ka bashkuar, njeriu të mos e ndajë.

Te 1 Korintasve 6:16 apostulli Pal përmend po ashtu këtë detaj nga historia e krijimit, dhe e aplikon atë në të njëjtin nivel drejtpërdrejt për marrëdhëniet seksuale njerëzore. Por ai e përmend përsëri të njëjtin pasazh dhe këtë herë e interpreton atë në nivelin prototipik dhe frymëror:

...sikurse edhe Zoti bën me kishën, sepse ne jemi gjymtyrë të trupit të tij, të mishit të tij dhe të kockave të tij. Prandaj njeriu do të lërë babanë e vet dhe nënën e vet dhe do të

bashkohet me gruan e vet, dhe të dy do të bëhen një mish i vetëm. Ky mister është i madh; tani unë e them në lidhje me Krishtin dhe me kishën. (Efes 5:29–32)

Është e dukshme që Pali nuk e vlerëson të vërtetën e zbuluar të Perëndisë si një gjë që ka vetëm një përmasë. As nuk do të binte dakort që interpretimi i asaj të vërtete në nivelin prototipik dhe frymëror do ta shkatërronte domethënien e tij në nivelin e drejtpërdrejtë dhe historik. Por, le të kthehemi te një shembull më i hollësishëm i domethënies së shumëfishtë.

Riti i rrethprerjes

Interpretimi që Dhiata e Re i bën ritit të rrethprerjes në Dhiatën e Vjetër është shumë edukativ, sepse tregon se, që nga fillimet e themelimit të tij, rrethprerja mbartte më shumë se një domethënie. Pastaj më vonë, gjatë rrjedhës së historisë së saj, ajo mori edhe domethënie të tjera, disa të mira dhe disa të këqija. Prandaj nuk është për t'u çuditur që, kur arrijmë te letrat e Dhiatës së Re, zbulojmë se ato komentojnë njëherë për një domethënie të rrethprerjes, njëherë tjetër për një domethënie tjetër; dhe kështu tregojnë se një interpretim i plotë i rrethprerjes së Dhiatës së Vjetër duhet të lejojë që ky rit të mbartë domethënie në më shumë se një nivel.

Rrethprerja personale e Abrahamit (Zan. 17)

Në rastin e Abrahamit, thotë Pali, rrethprerja që para së gjithash një shenjë dhe vulë e drejtësisë që ai kishte prej besimit ndërsa ishte ende i parrethprerë. Me fjalë të tjera, Abrahami u shfajësua së pari dhe pastaj, dhe vetëm pastaj, u rrethpre (Rom 4:11). Rrethprerja nuk ndikoi në shfajësimin e tij. As nuk e shoqëroi shfajësimin e tij: kaluan më shumë se 13 vjet pasi ishte shfajësuar që u rrethpre (Zan. 17:24-26). Rrethprerja ishte shenjë e jashtme e cila tregonte drejt faktit se ai ishte shfajësuar, dhe një vulë e vënë në mënyrë hyjnore e cila vërtetonte dhe pohonte drejtësinë që tashmë e kishte fituar prej besimit.¹

1 Disa njerëz janë tunduar të barazojnë rrethprerjen e Dhiatës së Vjetër me pagëzimin

Për më tepër, do të ishte e gabuar të thoje që besëlidhja e rrethprerjes (Zan 17) që një pjesë përbërëse e besëlidhjes që Perëndia bëri me Abrahamin dhe farën e tij te Zanafilla 15. Besëlidhja e Zanafillës 15 ishte “firmosur, vulosur dhe palosur” 13 vjet para se të përmendet ndonjëherë besëlidhja e rrethprerjes; dhe sipas parimeve të një praktike ligjore të shëndoshë e shpalosur në vetë Shkrimet (Gal 3:15–18), pasi të konfirmohej një besëlidhje, asaj nuk mund t'i shtohej asnjë kusht i mëtejshëm prej ndonjë besëlidhje tjetër.

Sidoqoftë, së dyti, rrethprerja personale e Abrahamit ishte një zotim nga ana e tij që, tani që u shfajësua nga besimi, “do të ecte para Perëndisë dhe do të ishte i patëmetë”, d.m.th. do të bënte një jetë të perëndishme në vazhdimësi (Zan 17:1).

Rrethprerja e fisit të Abrahamit (Zan 17:9–14)

Përveçse të rrethpritej vetë, Abrahamit iu kërkua po ashtu të rrethpresë të gjithë meshkujt në familjen dhe fisin e tij: jo vetëm fëmijët e tij, por edhe shërbëtorët e familjes, qofshin të lindur aty apo të blerë me para (Zan 17:9–14). Çfarë simbolizonte, atëherë, rrethprerja për të gjithë këta njerëz? Ajo ishte një shenjë që ata ishin pjesëtarë fizikë të fisit të Abrahamit. Çdo pasardhës jo i rrethprerë i tij “do të hidhet jashtë popullit të tij” (Zan 17:14).

Rrethprerja patjetër që nuk i bënte ata bij shpirtërorë të Abrahamit, dhe aq më pak të Perëndisë. Nëse ndonjë nga ata besonte te Perëndia në të njëjtën mënyrë si Abrahami kishte bërë më parë, ai rrethpritej dhe pastaj bëhej fëmijë shpirtëror i Abrahamit (Rom 4:12); dhe në këtë rast rrethprerja e tij do të quhej patjetër si një vulë e drejtësisë së tij prej besimit. Por nëse jo, atëherë nuk që.

Në të vërtetë, rrethprerja nuk provonte në çdo rast që Perëndia e njihje personin në fjalë si dikush prej kombit të veçantë, të cilit Perëndia i kishte caktuar një rol të veçantë në histori. Ismaeli ishte fizikisht fëmijë i Abrahamit dhe i rrethprerë gjithashtu (Zan 17:25), por ai nuk ishte trashëgimtar

e krishterë. Një barazim i tillë ngjall shumë dyshime; por ata që mendojnë kështu duhet të shohin domethënien e asaj; ashtu si rrethprerja, pagëzimi nuk sjell shfajësim. Kjo qëndron edhe nëse pagëzimi është e barasvlefshmja e rrethprerjes apo jo.

sipas besëlidhjes së Zanafillës 15; ai as nuk u lejua të vazhdonte si pjesëtar i fisit fizik të Abrahamit (Zan. 21:9–14). Rastin e tij Pali e sjell si shembull dhe e zgjeron edhe për shumë të tjerë në Izrael: “Por kjo nuk do të thotë se fjala e Perëndisë ra poshtë, sepse jo të gjithë që janë nga Izraeli janë Izrael. As sepse janë pasardhës të Abrahamit janë të gjithë bij; por: ‘Në Isakun do të quhet pasardhja jote.’” (Rom 9:6–7).

Rrethprerja si një shenjë

Si me vetë Abrahamin, ashtu edhe me pasardhësit e tij, rrethprerja ishte gjithashtu një shenjë e gatishmërisë për t’iu bindur Zotit dhe ligjit të tij. Natyrisht, ishte shumë e lehtë ta kishe shenjën, por të mos e shfaqje realitetin për të cilin ajo shenjë qëndronte. Vetë profetët e Izraelit ankohen për këtë:

Kujt do ti flas dhe cilin do të qortoj që të më dëgjojë? Ja, veshi i tyre është i parrethprerë dhe ata nuk janë të zotë të tregojnë kujdes; ja, fjala e Zotit është bërë për ta objekt përçmimi dhe ata nuk gjejnë tek ajo asnjë kënaqësi. (Jer 6:10)

Pali vë të njëjtin theks:

Sepse rrethprerja është e dobishme në qoftë se ti respekton ligjin, por në qoftë se je shkelës i ligjit, rrethprerja jote bëhet mosrrethprerje. Prandaj në qoftë se një i parrethprerë respekton statutet e ligjit, a nuk do të çmohet parrethprerja e tij si rrethprerje? Dhe, në qoftë se ai që prej natyrës është i parrethprerë e plotëson ligjin, a nuk do të të gjykojë ai ty që me shkronjën dhe me rrethprerjen je shkelës i ligjit? (Rom 2:25–27)

Me fjalë të tjera, shenjat nuk kanë vlerë praktike pa realitetin për të cilin ato janë dhënë që të tregojnë. Jo vetëm hebrenjtë e lashtë, por edhe të krishterët kanë nevojë ta kujtojnë këtë. Çfarë vlere ka të jesh pjesëtar në simbolet e bukës dhe verës gjatë Darkës së Zotit nëse nuk shijon faljen për të cilën Zoti ynë vdiq për ta fituar? Thjesht marrja e bukës dhe verës nuk do ta përçojë faljen. Dhe për më tepër, është edhe më e rrezikshme që të hash nga buka dhe vera nëse nuk je i përgatitur për të

zbatuar kushtet e besëlidhjes për të cilën kupa është simbol. Sipas asaj besëlidhjeje Zoti premtonte të shkruajë ligjet e tij në zemrat tona. Kur një besimtar pi nga kupa, por nuk ka qëllim të bashkëpunojë me Zotin që t’i shkruajë edhe më thellë ato ligje në zemrën e tij dhe t’i përmbushë ato, kjo do të thotë se ai do të bjerë nën disiplinën e rëndë të Zotit (1 Kor 11:27–32).

Edhe në rastin e pagëzimit, çfarë vlere do të ketë nëse personi i pagëzuar vazhdon të bëjë një jetë në mëkat dhe nuk synon të jetojë ndryshe? Nuk ka asgjë magjike me pagëzimin. Një grua mund të ketë një unazë martesë në gisht dhe ta mbajë çdo ditë të jetës së saj; nëse nuk martohet asnjëherë me ndonjë burrë, mbajtja e unazës nuk do të ndryshojë gjendjen e saj civile. Nëse nuk kemi përjetuar një bashkim përmes besimit me Krishtin, nëse nuk zotërojmë dhe jetojmë jetën e re që ajo simbolizon (Rom 6:1–4), të qenit i pagëzuar është një simbol bosh, po aq i kotë sa edhe unaza e martesës së një gruaje beqare.

Një shtrembërim i ritit të rrethprerjes (Gal 5:2–4)

Me kalimin e shekujve rrethprerja, si edhe vetë ligji, u shtrembërua në mendjet e njerëzve deri në atë pikë sa, për ata, ajo nuk ishte më thjesht një shenjë fizike e prejardhjes nga Abrahami dhe i anëtarisë në kombin e Izraelit; as nuk ishte më thjesht një simbol i gatishmërisë së tyre për të zbatuar ligjin e Perëndisë; dhe aq më pak një shenjë e drejtësisë që është prej besimit. E kundërta ndodhi: ata e vlerësuan atë, së bashku me zbatimin e ligjit, si mjet për të fituar shpëtimin përmes zbatimit të kësaj dhe të të gjitha rriteve dhe ligjeve të tjera, dhe në këtë mënyrë të meritonin shfajësimin. Kur ndodhi kështu, kjo e shndërroi rrethprerjen nga një simbol, vulë apo shenjë e plotë, e dobishme, e dhënë nga Perëndia, në një rit të shtrembëruar dhe të rrezikshëm.

Pikërisht kundër këtij keqpërdorimi të rrethprerjes Pali po proteston:

Edhe i dëshmoj përsëri çdo njeriu që rrethpritet, se ai është i detyruar të zbatojë mbarë ligjin. Ju që kërkonit të shfajësoheni me anë të ligjit, jeni ndarë nga Krishti; ratë poshtë nga hiri. Ne në fakt në Frymë, nëpërmjet besimit presim shpëtimin e drejtësisë,

sepse në Jezu Krishtin, as rrethprerja, as parrethprerja skanë ndonjë vlerë, por besimi që vepron me anë dashurie. Ju vraponi bukur; kush ju ka penguar që të mos i bindeni së vërtetës? (Gal 5:2–4, 6)

Nuk ka dyshim që simbolet e krishterë të pagëzimit dhe Darkës së Zotit mund të shtrembërohen në të njëjtën mënyrë. Sikur vetëm njëherë të konsiderohen si akte të fuqishme merite të cilat fitojnë, arrijnë, kryejnë, prodhojnë pranimin para Perëndisë, atëherë veprat, ndonëse fetare, kanë zëvendësuar besimin dhe ligji hirin, rruga e shpëtimit shkatërrohet dhe Krishti mbetet pa vlerë.

“Rrethprerja” e vërtetë (Fil 3:2–9)

Jo vetëm që keqpërdorimi i lartpërmendur i rrethprerjes është i gabuar në vetvete, por është edhe një kontradiktë e drejtpërdrejtë, siç edhe tregon Dhiata e Re, me kuptimin e brendshëm metaforik të rrethprerjes. Heqja e jashtme e një cope mishi njerëzor do të thoshte braktisjen e plotë të të gjithë sigurisë “në mish” në kuptimin moral. Në Dhiatën e Vjetër fjala *mish* është përdorur për të folur për njeriun në gjendjen e tij të pavarur prej Perëndisë dhe në rebelim ndaj tij. Kjo pavarësi shihet më lehtësisht në rastet e mëkatarëve të mëdhenj; por po aq shpesh dhe, ndoshta akoma më shumë, ajo maskohet nën petkun e mirësjelljes dhe fesë. Njeriu i pavarur do të mbajë pavarësinë dhe meritat e tij edhe në marrëdhëniet e tij me Perëndinë. Atij nuk i pëlqen të pranojë që është i dështuar frymërisht. Ai do ta përbuzte ofertën e dyqanxhiut që dëshiron t’ia japë ushqimet javore si një dhuratë bamirësie: ai e përballon vetë koston. Dhe e përbuz idenë se duhet të pranojë shpëtimin e tij si një dhuratë, edhe pse prej Perëndisë: ai duhet, ai mundet dhe ai do të paguajë vetë për to, duhet t’i meritojë ato. (Të paktën kështu mendon.) Ai mendon se i ka mundësitë për ta bërë këtë. Por kjo do të thotë, në fakt, të besosh te mishi.

Pali që vetë një shembull i kësaj gjëje; dhe për të, kthimi në besim do të thoshte që të braktisje përdorimin e shtrembëruar të rrethprerjes, ta kuptojë kuptimin e saj të brendshëm shpirtëror, dhe të konformoheshe me të. Dëgjoni rastin e tij me fjalët që ka thënë vetë:

Ruhuni nga qentë, ruhuni nga punëtorët e këqij, ruhuni nga të prerët. Sepse rrethprerja e vërtetë jemi ne, që i shërbejmë Perëndisë në Frymë dhe që mburremi në Krishtin Jezus pa besuar në mish, megjithëse unë kam përse të besoj edhe në mishin; nëse ndonjë mendon se ka përse të besojë, unë kam akoma më shumë: u rrethpreva të tetën ditë, jam nga kombi i Izraelit, ... sa për zellin, përndjekës i kishës; për sa i përket drejtësisë, që është në ligj, i paqortueshëm. Por gjërat që më ishin fitim, i konsiderova, për shkak të Krishtit, humbje. ... që unë të fitoj Krishtin, dhe që të gjendem në të, duke pasur jo drejtësinë time që është nga ligji, por atë që është nga besimi në Krishtin: drejtësia që është nga Perëndia, me anë të besimit. (Fil 3:2–9)

Rrethprerja, pra, në këtë nivel, tregon atë pendesë rrënjësore dhe ndryshim sjelljeje kur dikush braktis të gjithë besimin të përpjekjet e tij ose të saj, te zbatimi i ligjit, i rriteve dhe i gjithçkaje tjetër, dhe në vend të kësaj mbështetet te Krishti duke pranuar si dhuratë drejtësinë që Perëndia, dhe vetëm Perëndia, mund ta japë.

Rrethprerja frymërore

Ka një rëndësi tjetër edhe më të thellë që i jepet rrethprerjes në Dhiatën e Re. Për ta kuptuar atë, ne do të kthehemi pas te Dhiata e Vjetër dhe te një nga metaforat e saj për këtë term. Përshkrimi i mëkëmbjes së Izraelit te Ligji i Përtërirë 30 përfshin këtë premtim: “Zoti, Perëndia yt, do ta rrethpresë zemrën tënde dhe zemrën e pasardhësve të tu, që ti ta duash Zotin, Perëndinë tënd, me gjithë zemër e me gjithë shpirt, dhe kështu ti të jetosh.” (LiP 30:6).

Kërkesa që ne të duam Zotin, Perëndinë tonë, me gjithë zemrën, mendjen, shpirtin dhe forcën tonë është urdhërimi i parë dhe më i madh nga të gjithë. Por historia e gjatë e Izraelit ka treguar që njeriu i parilindur, “njeriu në mish”, nuk mund të përmbushë kërkesat e ligjit. Kjo është po aq e vërtetë për ne johebrejtë, sa është edhe për hebrejtë; dhe, për shkak të mëshirës së Perëndisë, historia e mosbindjes, pabesisë, rebelimit, tradhëtisë, mërgimit dhe ndëshkimit të Izraelit nën qortimin e

Perëndisë meriton të jetë një shfaqje e gjallë dhe e dobishme, e synuar të bindë të gjithë botën për faktin që ligji nuk mund të na shpëtojë: vetëm mund të na dënojë (Rom 3:19).

Të parilindurit as nuk mund të ndryshojnë zemrat e tyre dhe as ta bëjnë veten që ta dojë Perëndinë. Nëse do ta duan Perëndinë si duhet, ata duhet të çlirohen prej rrënjëve të tyre në mish dhe të shpërngulen në Frymë (Rom 8:4–9). Ky është një veprim që vetëm Perëndia mund ta bëjë. Asnjë thikë rituale, ceremoniale nuk mund të prekë rrënjët e problemit, asnjë dorë njerëzore nuk mund të operojë suksesshëm me bisturi që të prekë problemin. Por atë që ne nuk mund ta bëjmë, Perëndia mund ta bëjë. Këtu te LiP 30:6 ai dokumenton premtimin e tij që do ta bëjë atë; dhe te Kolosianëve na tregon si do ta bëjë këtë; përmes bashkimit tonë me Krishtin në vdekjen, varrimin dhe ringjalljen e tij.

në të cilin ju edhe u rrethpretë me një rrethprerje që nuk u bë me dorë, por me rrethprerjen e Krishtit, me anë të zhveshjes së trupit nga mëkatet e mishit: të varrosur bashkë në të në pagëzim, ju edhe u ringjallët bashkë në të, me anë të besimit në fuqinë e Perëndisë që e ka ringjallur prej së vdekurish. Dhe bashkë me të Perëndia ju dha jetë juve, që kishit vdekur në mëkate dhe në parrethprerjen e mishit. . . . (Kol 2:11–13)

Atëherë qoftë në Dhiatën e Vjetër apo në Dhiatën e Re, rrethprerja mbart një domethënie jo vetëm në një nivel, por në shumë; ndonëse, zakonisht, një pasazh përqendrohet vetëm në një nivel të caktuar. Do të ishte e gabuar të mendoje se sa herë që riti përmendet në Shkrimet, po aq herë do të dalloje (lexoje) të gjitha kuptimet e mundshme të tij. Por, do të ishte po aq e gabuar të mendoje se një interpretim i vërtetë i ritit të rrethprerjes në Dhiatën e Vjetër duhet të këmbëngulë se në të gjitha rastet ka vetëm një kuptim të pandryshueshëm.

...
Pyetjet e studimit për këtë kapitull mund t'i gjeni
në faqen 440.

17

Rrjedha logjike e mendimit dhe heshtja e qëllimshme

Për qëllimin e këtij studimi ne do t'i kthehemi sërish Letrës së Hebrenjve. Së pari do të studiojmë një shembull të mënyrës në të cilën autori i saj mbështet argumentin e tij duke iu referuar renditjes së saktë të fjalëve të një pjese nga Dhiata e Vjetër. Pastaj do të vazhdojmë duke vëzhguar mënyrën sesi ai i jep domethënie, jo vetëm asaj që një pjesë nga Dhiata e Vjetër dokumenton, por edhe asaj që ajo nuk dokumenton.

Rendi interpretues

Shembulli ynë vjen nga Hebrenjve 10. Pika kryesore e argumentit të tij të përgjithshëm është të provojë që sakrificat e Krishtit jo vetëm është më e lartë në krahasim me sakrificat e kafshëve të urdhëruara nga ligji, por i ka tejkaluar ato dhe i ka nxjerrë jashtë funksionit. Deri në këtë kapitull autori argumenton kështu: ligji nuk mundet kurrë, përmes sakrificave, të bëjë të përsosur ata që i ofrojnë ato sepse, nëse do të qe e mundur, adhuresit, pasi të pastroheshin plotësisht përgjithmonë, nuk do të kishin nevojë të ofronin sakrificat më, dhe ofrimi i tyre për pasojë do të ndalonte. Sidoqoftë, siç dihet, në atë sistem të sakrifikimit të kafshëve,

mëkatet e njerëzve gjykoreshin çdo vit (Ditën e Shlyerjes) dhe ofrimi i sakrificave të tjera bëhej i domosdoshëm. Arsyeja për gjithë këtë ofrim të përsëritur ishte se gjaku i kafshëve nuk ishte i aftë dhe nuk mund të hiqte fajin e mëkateve të njeriut (Heb 10:1-4). Autori ynë më pas sugjeron se është pikërisht kjo dobësi e sistemit të sakrificave që fshihet pas fjalëve profetike të Mesias të dokumentuara te Psalmi 40. Këto fjalë, thotë autori (Heb 10:5), shpjegojnë qëllimin e ardhjes së Mesias në botë, dhe ai fillimisht i citon ato të plotë:

Ti nuk deshe as flijim as blatë, po bëre gati për mua një trup; ti nuk pëlqeve as olokauste as flijime. Atëherë unë thashë: "Ja, unë po vij; në rrotullin e librit është shkruar për mua; 'për të bërë, o Perëndi, vullnetin tënd'." (Ps 40:6-8 [në përkthimin e Septuagintit]; Heb 10:5-7)

Por autori ynë nuk kënaqet vetëm duke cituar plotësisht pjesën dhe pastaj ta lërë në dorë të lexuesve të tij për të dalluar, aq sa munden, sesi ky pasazh mbështet pikën që ai po argumenton. Në të vërtetë ai e citon sërish pasazhin (Heb 10:8-9), këtë herë duke e komentuar vetë dhe duke synuar të tregojë:

1. që pjesa ka jo një, por dy deklaratatë të dallueshme nga njëra-tjetra prej Mesias;
2. që deklarata e dytë e Mesias është thënë jo në vijim *pas* së parës, por *si përgjigje* e domethënies së deklaratës së parë;
3. që fakti se ka dy deklarata, dhe që e dyta është përgjigje ndaj së parës, nuk është një analizë arbitrare e imponuar mbi psalmin nga autori: ajo është qartësisht pjesë e vetë psalmit.

Fjalët e tij janë:

Mbasi tha [d.m.th. në fillim të citatit Mesia e fillon deklaratën e tij të parë duke thënë]: Ti nuk deshe as flijim, as mblatë, as olokauste, as flijime për mëkat, [ky është komenti shpjegues i autorit tonë:] që të blatohej sipas ligjit, ai shtoi: Ja, unë vij për të bërë, o Perëndi, vullnetin tënd. Ai heq të parën, që të vërë të dytën. (Heb 10:8-9)

Pastaj ai tha (dhe kjo është deklarata e dytë e Mesias, "ai

shtoi”, Ps 40:7): Ja, unë vij për të bërë, o Perëndi, vullnetin tënd. Vini re menjëherë frazën “ai shtoi”. Ky nuk është një koment nga autori ynë, që këmbëngul arbitrarisht se ligjëratat e Mesias mundet dhe duhet të ndahet në dy deklarata. Autori ynë po thekson që në vetë tekstin e psalmit Mesia vetë fillon deklaratën e tij të dytë me fjalët “*ai shtoi*: Ja, unë vij për të bërë, o Perëndi, vullnetin tënd. Kështu Mesia po tregon që deklarata e tij e dytë është bërë si një përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj pakënaqësisë së Perëndisë me sakrificat e kafshëve, gjë që është shprehur në deklaratën e parë. Në vend të sakrificave të kafshëve që kurrë nuk mund të kënaqin Perëndinë, Mesia tregon që ai ka ardhur për të bërë vullnetin e Perëndisë duke i ofruar Perëndisë vetë trupin e tij si një sakrificë për mëkat, për të kënaqur plotësisht dhe përjetësisht Perëndinë.

Argumenti i autorit, atëherë, është se vetë rendi i deklaratave të Psalmit shpreh qëllimin e Mesias për të lënë mënjane të parën, në mënyrë që të themelojë të dytën (Heb 10:9), që do të thotë heqja e sakrificave të kafshëve të Dhiatës së Vjetër dhe zëvendësimi i tyre me sakrifikimin e vetes së tij.

Interpretimi i heshtjes së tregimit biblik

Sepse ky Melkisedeku, mbret i Salemit dhe prift i Shumë të Lartit Perëndi, i doli përpara Abrahamit, kur po kthehej nga disfata e mbretërve dhe e bekoi; dhe Abrahami i dha atij edhe të dhjetën e të gjithave. (emri i tij do të thotë më së pari “mbreti i drejtësisë”, dhe pastaj edhe “mbreti i Salemit”, domethënë “mbreti i paqes”; pa atë, pa nënë, pa gjenealogji, pa pasur as fillim ditësh as fund jete, por i përngjashëm me Birin e Perëndisë), ai mbetet prift në amshim. (Heb 7:1–3)

Tregimi historik në lidhje me Melkisedekun gjendet te Zan 14:18–20; por para se të shqyrtojmë interpretimin e autorit për këtë pasazh, ne duhet të gjejmë rrugën përmes së cilës ai zgjodhi të mendojë për këtë pasazh që në fillim. Si gjithë të krishterët e hershëm ai filloi të besonte se Jezusi ishte Biri i Perëndisë dhe pranoi faktet historike të vdekjes, ringjalljes dhe lartësimit të tij

në qiell. Krishti po ashtu i kishte mësuar dishepujt e tij (shih Mat 22:41–46) që Psalmi 110:1 (“Zoti i thotë Zotërisë tim: “Ulu në të djathtën time deri sa ti bëj armiq të tu stol të këmbëve të tua”.”) fliste për të dhe dëshmonte për hyjninë e tij, lartësimin e tij, ngjitjen e tij në të djathtën e Perëndisë dhe kohën që duhet të kalojë mes lartësimit dhe ardhjes së tij të dytë, dhe fitores përfundimtare mbi të gjithë armiq të tij. Kështu, ky varg do të ketë qenë thelbësor në perceptimin e ungjillit të Krishtit nga autori ynë, siç qe edhe për shkruesit e tjerë të Dhiatës së Re; dhe ai e citon pjesërisht apo të plotë këtë te Hebrenjve 1:3, 13; 8:1; 10:12–13; 12:2. Prandaj ishte e natyrshme për të, të kalonte nga Psalmi 110:1 te vargu 4 i të njëjtit psalm, që deklaronte: “Zoti është betuar dhe nuk do të pendohet: “Ti je prift përjetë sipas rendit të Melkisedekut”.” Për autorin tonë nuk kishte dyshim që kjo lidhet me Zotin Jezus; dhe ai vuri re që atje ka dy deklarata për të. Së pari, që Perëndia e kishte caktuar Krishtin të ishte prift përjetë, dhe e kishte bërë këtë duke e shoqëruar me një betim solem (shih komentin e tij te Heb 21–7:20); dhe së dyti, që priftëria e Krishtit duhej të ishte “sipas rendit të Melkisedekut”. Prandaj natyrshëm, autori përdori historinë biblike të priftit të lashtë Melkisedek (Zan 14:18–20) për të parë si detajet e saj mund të ilustronin, dhe të na ndihmonin të kuptojmë më shumë, priftërinë e Zotit tonë.

Ai vuri re gjërat e para që historia thotë qartazi për Melkisedekun:

1. *Ai ishte prift i Perëndisë Shumë të Lartë*, d.m.th. ai nuk qe një prift pagan i ndonjë idhulli: ai qe prift i Perëndisë së vetëm dhe të vërtetë.

2. *Ai u takua me Abrahamin kur Abrahami u kthye nga lufta me mbretërit dhe ai (Melkisedeku) e bekoj atë (Abrahamin)*. Prej kësaj autori ka nxjerrë përfundimin se Melkisedeku ishte një personazh më i rëndësishëm se Abrahami: sepse as nuk vihet në dyshim që më i vogli bekohet nga më i madhi.

3. *Abrahami i dha Melkisedekut 1/10 e të gjitha plaçkave që ai kishte fituar*. Tani, në këtë kohë, Abrahamit i ishte premtuar nga Perëndia se do të ishte babai i një kombi të madh. Prandaj kur i jep të dhjetat priftit Melkisedek, ai po vepronte si themeluesi dhe patriarku i Izraelit, dhe si paraardhësi i priftërisë levetike që

do të dilte prej tij. Nga kjo, autori argumenton që Melkisedeku ka patur një status më të lartë, jo vetëm nga ai i vetë Abrahamit, por gjithashtu edhe më të lartë se vetë priftëria e mëvonshme levitike (Heb 7:4–10).

4. Teksti thotë që emri i këtij mbreti-prift është *Melkisedek* dhe emri i qytetit të tij mbretëror është *Salem*. Kuptohet që për autorin tonë këta emra kanë një kuptim të veçantë, sepse ai u shpjegon lexuesve të tij grekë që në hebraisht “Melkisedek” do të thotë “mbreti i drejtësisë” dhe “Salem” do të thotë “paqe”. Autori nuk e shpjegon domethënien e tyre. Ndoshta ngaqë mendoi se nuk kishte nevojë (të paktën për lexuesit e krishterë) për shpjegim. Paqja e vërtetë në çdo qytet varet nga drejtësia e qeverisë së saj, por tek ai që shërbeu si hije e Krishtit dhe ungjillit të tij, ky kombinim i termave “drejtësi” dhe “paqe” është shumë i goditur. Krahasojeni këtë me deklaratën e Palit të asaj që provojmë përmes Krishtit, kryepriftit tonë të lartë: “Të shfajësuar, pra, me anë të besimit, kemi paqe me Perëndinë nëpërmjet Jezu Krishtit, Zotit tonë,” (Rom 5:1)

Kaq për komentet e autorit tonë rreth asaj që tregimi i Dhiatës së Vjetër thotë në të vërtetë. Por tani ai shton një përshkrim të mëtejshëm rreth Melkisedekut:

Pa atë, pa nënë, pa gjenealogji, pa pasur as fillim ditësh as fund jete, por i përngjashëm me Birin e Perëndisë, ai mbetet prift në amshim. (Heb 7:3)

Këtu duhet të tregojmë kujdes për të kuptuar se çfarë po thotë autori. Ai nuk po thotë se personi historik me emrin Melkisedek nuk u lind nga prindër njerëzorë, se ekzistoi përjetësisht dhe se kurrë nuk vdiq. As nuk po thotë që Melkisedeku qe një “kristofani”, d.m.th. një shfaqje e Birit të Perëndisë para mishërimit të tij (si te Zan 32:24–30, dhe Gjyq 13:3–22). Ai po thekson që në historinë biblike të Melkisedekut nuk thuhet gjë për prindërit e tij, për gjenealogjinë e tij apo vitin e lindjes dhe nuk është regjistruar asgjë për vdekjen e tij apo se kur përfundoi priftëria e tij. Ai thjesht shfaqet në faqet e Zanafillës pa ndonjë aludim për historinë e tij të mëparshme, shpallet si prift dhe pas tre vargjeve nuk përmendet sërish (derisa vjen Ps.110:4). Përsa i përket historisë së Zanafillës, kohëzgjatja e priftërimit të tij është

e pacaktuar. Në mendjen e autorit tonë, mungesa e të gjitha këtyre hollësive prej historisë biblike nuk është rastësi. Perëndia që frymëzoi kompozitorin e Psalmi 110:4 për të shkruar rreth Mesias: “Ti je një prift përjetë sipas rendit të Melkisedekut” e kishte frymëzuar tashmë autorin e Zanafillës në përshkrimin e tij të Melkisedekut, qoftë në atë që thotë haptazi rreth tij, dhe në atë që lë pa thënë. Qëllimi i këtij frymëzimi ishte që kur ndokush të lexonte më vonë te Psalm 110:4, që Mesia do të ishte një prift përjetë sipas rendit të Melkisedekut, dhe ta kthente kokën pas te Zanafilla 14 për të parë se çfarë do të thoshte “sipas rendit të Melkisedekut”, ai mund të nxirrte prej andej një parahije të priftërisë së përjetshme të Mesias, një parahije që *brenda kanunit biblik* është “e ngjashme me Birin e Perëndisë” qoftë prej informacionit që jepte haptazi, qoftë prej informacionit që nuk jepte.

Bindja në frymëzimin hyjnor dhe autoritetin e Shkrimit, atëherë, ishte ajo që e shtyu autorin tonë t’u japë rëndësi edhe deklaratave, edhe heshtjes së dëshmisë biblike.

...

Pyetjet e studimit për këtë kapitull mund t’i gjenden në faqen 440.

18

Koherenca e brendshme si bazë për predikimin shtjellues

Një rast studimor për këtë tipar të tretë të nënkuptuar, që Dhiata e Re përdor, mund të gjendet te Hebrenjve 3:7–4:16. Ndonëse është pjesë e argumentit të vazhdueshëm të librit, ky pasazh përmban atë që është realisht një predikim i shkruar nga autori i kësaj letrë për lexuesit e tij. Predikimi mbështetet tërësisht mbi faktet historike të asaj që ndodhi kur Moisiu udhëhoqi Izraelin në kufijtë e tokës së premtuar, dhe shumica e popullit nuk pranoi të hynte (shih Num 13–14). Dhe jo vetëm mbi këto fakte të thata; sepse në atë rast vetë Perëndia e interpretoi domethënien shpirtërore të refuzimit të popullit, dhe autori i Hebrenjve do t'i referohet këtij interpretimi herë pas here.

Por autori i Hebrenjve nuk e mbështet predikimin e tij drejtpërsëdrejti mbi tregimin historik të Numrave 14–13. Ai e mbështet atë mbi një predikim të bërë nga poeti që shkroi Psalmin 95 disa shekuj pas refuzimit të Izraelit, por gjithashtu disa shekuj para se Letra e Hebrenjve të shkruhej. Atëherë shqetësimi ynë, në veçanti, është të vëzhgojmë metodat që autori i Hebrenjve përdor për të përvetësuar mesazhin e shpallur prej këtij psalmi dhe për ta zbatuar atë për lexuesit e tij.

Hapi i parë

Së pari, ai u kujton lexuesve të tij autoritetin që mbartin vargjet e psalmi që do të citojë:

Prandaj, sikurse thotë Fryma e Shenjtë: Sot, në qoftë se e dëgjoni zërin e tij... (Heb 3:7)

Me fjalë të tjera, nxitja që do të vijojë – “Sot, në qoftë se e dëgjoni zërin e tij, mos i ngurtësoni zemrat tuaja ...” nuk është, sipas vlerësimit të autorit, thjesht një këshillë e urtë prej një poeti shumë fetar: është zëri frymëzues i Frymës së Perëndisë që u flet drejtpërsëdrejti lexuesve të autorit tonë; dhe ata duhet ta pranojnë atë si të tillë.

Jo vetëm kaq, sepse, nëse në vargjet 8-1 të psalmi poeti i referohet Perëndisë në vetën e tretë “...në prani të *tij* ... ta kremtojmë ... në duart e *tij* ... i *tij* është deti... *ai* është Perëndia ynë...”, etj., nga vargu 9 deri në fund psalmi paraqet në mënyrë mbresëlënëse Perëndinë që flet drejtpërsëdrejti përmes zërit të tij, dhe i referohet vetes në vetën e parë: “etërit tuaj ...i kishin parë veprat e *mia*...e pata neveri ... thashë... nuk i njohin rrugët e *mia*... u betova në zemërimin *tim* ... nuk do të hyjnë në prehjen *time*”.

Autori i Hebrenjve nuk po i drejtohet thjesht autoritetit të vet si shkruar që ka marrë frymëzim për të shkruar një letër të Dhiatës së Re (ndonëse e kishte këtë të drejtë për të vepruar kështu): ai do t'u predikojë lexuesve të tij një mësim të mbështetur mbi një pjesë nga Dhiata e Vjetër dhe, kështu, fillon së pari duke u kujtuar atyre autoritetin hyjnor të kësaj pjese.

Hapi i dytë

Hapi i tij i dytë është të citojë plotësisht këtë pjesë. Qëllimi i tij nuk është të përzgjedhë arbitrarisht një frazë apo dy nga ky psalm dhe, pastaj, pavarësisht nga konteksti i tyre origjinal, të ndërtojë përreth tyre një ligjëratë të përbërë kryesisht nga ide që kanë pak apo aspak të bëjnë me kontekstin e tyre fillestar. Ligjëratat e tij do të marrë formën e një predikimi ekspozues. Ai do të ndjekë vetë zhvillimin ideor të pjesës nga fillimi deri në fund, duke theksuar me radhë, madje duke i përsëritur, frazat dhe fjalët kyç, duke ndriçuar referencat e tyre të ngjarjeve historike te Numrat, duke shpjeguar konceptet e saj madhore dhe duke justifikuar gjithë kohën zbatimin që i bën paralajmërimit nga ky psalm i Dhiatës së Vjetër për lexuesit e kohës së tij.

Prandaj le të ndjekim shembullin e autorit dhe të citojmë të gjithë pjesën nga Psalmet:

Prandaj, sikurse thotë Fryma e Shenjtë: Sot, në qoftë se e dëgjoni zërin e tij, mos i ngurtësoni zemrat tuaja si në provokim, në ditën e tundimit në shkretëtirë, ku etërit tuaj më tunduan duke më vënë në sprovë, ndonëse i kishin parë veprat e mia dyzet vjet. Prandaj u indinjova me atë brez dhe thashë: Gabojnë gjithnjë me zemër dhe nuk i njohën udhët e mia; kështu u betova në mërinë time: Nuk do të hyjnë në prehjen time. (Heb 3:7–11)

Hapi i tretë

Tani ai fillon të shtjellojë vetë tekstin e Psalmi 95 duke bërë një përmbledhje me fjalët e veta të mësimi kryesor të tij. Në këtë mënyrë, që nga fillimi, mësimi kryesor do të ngulitet në mendjet e lexuesve dhe pastaj do të përforcohet, dhe nuk do të fshihet prej komenteve të detajuara në vijim: “Kini kujdes, vëllezër, se mos ndonjë nga ju ka zemër të ligë, mosbesimi, që të largohet nga Perëndia i gjallë.” (Heb 3:12).

Sa të drejtë ka ai për këtë përmbledhje që i bën psalmi? Vetë psalmi i qorton izraelitët se “po gabojnë me zemrat e tyre”; por nuk përdor termin “zemër të ligë, mosbesimi”, as nuk flet për “[largimin] nga Perëndia i gjallë”. A po fut autori në predikimin e tij ide të vetat, pa arsye, duke zmadhuar paralajmërin e dhënë nga vetë psalmi?

Përgjigjja është: jo. Ai ka konsultuar shënimet historike të rebelimit në shkretëtirë të Izraelit të cilit i referohet ky psalm (Num 14:1–11, 22–23). Atje ka parë që Perëndia po komenton për sjelljen e Izraelit me këto fjalë: “Deri kur do të më përçmojë ky popull? Dhe deri kur do të refuzojnë të besojnë ...?” (Num 14:11).

Atëherë, mbi këtë bazë, autori jep paralajmërimin kundër “një zemre të keqe mosbesimi”. Sa për “largimin prej Perëndisë së gjallë”, historia tregon se Izraeli e bëri në të vërtetë këtë. Perëndia i shpengoi nga Egjipti, i drejtoi nëpër shkretëtirë, i solli në kufijtë e Kanaanit, dhe e gjithë kjo me qëllimin për

t’ua dhënë Kanaanin si trashëgiminë e tyre. Por, si përfundim, ata u zemëruan shumë që i kishte çliruar nga Egjipti dhe propozuan të zgjedhin vetë një drejtues, dhe të kthehen në Egjipt duke refuzuar, kështu, trashëgiminë e premtuar nga Perëndia dhe duke zhbërë shpengimin e tij. Nuk mund ta bësh këtë pa u larguar nga vetë Perëndia i gjallë (Num 10–14:1). “Një zemër e keqe mosbesimi” dhe “largimi nga Perëndia i gjallë”, atëherë, janë saktësisht ato të cilave ky psalm u referohet kur paralajmëron lexuesit e tij të mos ngurtësojnë zemrat e tyre, siç bëri Izraeli.

Hapi i katërt

Autori ynë tani kthehet te fjalët hyrëse të pasazhit:

Sot, në qoftë se e dëgjoni zërin e tij, mos jini zemërgur... (Heb 3:13)

Ai vë re që këto fjalë hyrëse janë një nxitje kumbuese. Për këtë shkak, si predikues, po i nxit vetë lexuesit e tij jo vetëm të pranojnë nxitjen e Frymës së Shenjtë, por akoma më shumë, edhe të nxisin njëri-tjetrin unanimisht me nxitjen e Frymës së Shenjtë (Heb 3:13). Për më tepër, ai vë re se, në psalm, Fryma e Shenjtë e fillon nxitjen e tij me fjalën *sot*; dhe, si një zbërthyes i kujdesshëm, e trajton këtë frazë kohore si domethënëse. “Sot”, siç e kupton ai, i referohet jo një dite të veçantë njëzetekatërorëshe, por një periudhe (krhs. një interpretim të ngjashëm te 2 Kor 6:2). Për aq sa kjo “periudhë e sotme” zgjat, ka një mundësi të dëgjosh fjalën e Perëndisë dhe ta besosh atë. Nga ana tjetër, vetë përdorimi i fjalës *sot*, nënkupton që *nesër* mund të mos ketë më shanse. Ky, pra, është rreziku i ngurtësimit të zemrave të tyre përgjatë “periudhës së sotme”.

Pasi e kuptoi domethënien e tekstit në këtë mënyrë, autori e zbaton atë tani: “por nxitni njëri-tjetrin çdo ditë, derisa thuhet: “Sot”, që të mos ngurtësohet ndonjë nga ju prej mashtrimit të mëkatit.” (Heb 3:13).

Mëkati, thekson ai, është mashtrues; dhe që të kuptosh sa mashtrues mund të jetë, mjafton të lexosh vetëm tregimet historike të eksodit. Kur kombi doli në fillim prej Egjiptit dhe

qëndroi në anën tjetër të Detit të Kuq ata, bashkë me Moisiun dhe Miriamin, i kënduan lavde Perëndisë për çlirimin e tyre (Eks 15). Po t'i shihte dikush në ato çaste, do të mendonte se ata ishin besimtarë të vërtetë. Por e vërteta qëndron se ata nuk ishin dhe nuk kishin qenë ndonjëherë (Eks 12:38; Num 14:11, 22); dhe ankesat, kërcënimet, rebelimi (Eksod 17:2-4) i tyre i vazhdueshëm dhe pabesia e hapur në Malin Sinai (Eks 32), duhet t'ua kishin hapur sytë atyre ndaj asaj të vërtete. Por mëkati është mashtrues: u fshihte fakte, u mpinte ndërgjegjet dhe u ngurtësonte zemrat derisa mosbesimi në thellësinë e zemrës së tyre, më në fund, shpërtheu në një refuzim të drejtpërdrejtë, lakuriq, si të Perëndisë, ashtu edhe të shpengimit të tij.

Hapi i pestë

Tani ngrihet një pyetje; dhe ne mund të ilustrojmë se çfarë është kjo pyetje duke kujtuar, shkurtimisht, rastin e Dhiatës së Vjetër që diskutuam te Kapitulli 13, d.m.th., rebelimin e Koreut kundër Mosiut dhe Aaronit. Nëse ndonjë predikues do ta merrte atë tregim rebelimi dhe ta zbatonte me paralajmërime solemne për besimtarët e vërtetë të kohëve të sotme të cilët janë plotësisht besnikë ndaj Zotit Jezus, por që, sidoqoftë, kanë mosmarrëveshje me drejtuesit e kishës së tyre për ndonjë çështje të vogël, do të ishte një keqzbatim serioz i tregimit të Dhiatës së Vjetër (shihni karakterizmin tonë të rebelimit të Koreut te Kapitulli 13).

Por tani autori ynë po përdor një histori tjetër të Dhiatës së Vjetër, d.m.th. atë të refuzimit rebel të Izraelit për të hyrë në Kanaan me gjithë pasojat e saj solemne, dhe po sugjeron që, të paktën, disa prej të krishterëve të kohës së tij rrezikonin të kryenin një rebelim të ngjashëm. Nëse kjo qëndronte, do të ishte diçka shumë serioze. Prandaj, ai e kupton se i duhet ta provojë analogjinë e nënkuptuar që po bën mes sjelljes së tyre dhe asaj të Izraelit; përndryshe, zbatimi që i bën paralajmërimit të psalmit do të duket si arbitrar, do të humbasë forcën e tij bindëse dhe do të jetë fyes.

Prandaj tani përpiqet ta provojë këtë analogji duke identifikuar së pari se cila është situata e tanishme shpirtërore e lexuesve të tij. Vini re që situata nuk është diçka që ai e dedukton

nga tregimi i Dhiatës së Vjetër. Është situata e shpallur nga ungjilli i krishterë, pothuajse e pavarur prej faktit nëse analogjia e nxjerrë prej Dhiatës së Vjetër ka lidhje me të apo jo.¹ Dhe situata është kjo: “Sepse ne jemi bërë pjestarë të Krishtit, në qoftë se do ta ruajmë të palëkundur deri në fund fillimin e besimit,” (Heb 3:14).

Ungjilli i krishterë shpall se nuk ka kuptim të kesh bërë një rrëfim besimi të krishterë dikur në të shkuarën, nëse nuk e mban atë fort deri në fund. Në të vërtetë, prova, se rrëfimi fillestar është i vërtetë, është pikërisht fakti që mbahet deri në fund. Shkele rrëfimin, dhe kjo gjë do të hedhë hije dyshimi mbi faktin se nëse ky rrëfim ka qenë ndonjëherë i vërtetë apo jo, apo nëse ishte rrënjësor, dhe nëse ai që e bëri ka qenë ndonjëherë pjesëtar i Krishtit që nga fillimi (krhs. interpretimin e Krishtit të shëmbëlltyrës së Mbjelesit, Luka 8:13-15).²

Kjo është, pra, pozita e krishterë. Por tani autori vazhdon përpara dhe bën një analogji mes sjelljes së Izraelit në shkretëtirë dhe asaj të bashkëkohësve të tij. Për më tepër, ai thekson që është Fryma e Shenjtë që bën krahasimin duke thënë – dhe këtu autori kthehet te fillimi i pjesës së psalmit dhe e citon sërish -

Sot, në qoftë se e dëgjoni zërin e tij, mos jini zemërgurë si në ditën e kryengritjes. (Heb 3:15)

Me fjalë të tjera, ja ku është Fryma e Shenjtë që rikujton rebelimin në shkretëtirë dhe e citon haptazi atë si një rast të ngjashëm, duke vënë në pah të njëjtin rrezik që i kërcënon bashkëkohësit e autorit.

Hapi i gjashtë

Por autori ynë nuk e shikon krahasimin që Fryma e Shenjtë bën vetëm si një analogji të gjerë dhe të përgjithshme: ai këmbëngul për shqyrtimin e detajeve të tregimit të Numrave dhe në zbatimin e këtyre detajeve për lexuesit e tij. Dhe me të drejtë: sepse Psalmi 95 po ashtu përfshin në analogji një numër

1 Patjetër që është e vlefshme: autori ynë flet nën frymëzimin hyjnor.

2 Për një shtjellim të plotë të këtij vargu shihni Gooding, *Një mbretëri e patundur*, 110.

hollësish që janë të përfshira në rebelim. Ato janë:

1. Fakti që pati një rebelim
2. Zemërimi i Perëndisë me rebelët për 40 vjet
3. Betimi i Perëndisë që nuk do të hyjnë në prehjen e tij

Prandaj, autori i shqyrton këto hollësira me radhë dhe komenton rreth tyre në mënyrë të tillë që të nxjerrë në dritë rëndësinë e tyre për lexuesit e tij dhe paralajmërimin që po u jep me shumë ngulm.

Komente rreth Hollësisë 1

Kush janë ata që, mbasi e dëgjuan, e provokuan? A thua jo të gjithë ata që dolën nga Egjipti me anë të Moisiut? (Heb 3:16)

Pyetja është retorike dhe përgjigjja e nënkuptuar është: po, të gjithë: të gjithë, d.m.th., përveç disa individëve si Kalebi dhe Jozueu. Atëherë, rebelimi nuk ishte një dështim i rrallë dhe i pazakontë i nxitur nga pak njerëz plotësisht të pazakonshëm gjë që, po të ishte kështu, do ta bënte groteske të mendoje se ndonjë prej lexuesve të autorit tonë mund të fajësohej për të njëjtat gjëra. Nëse pothuajse i gjithë kombi rebeloi në kohën e Moisiut, nuk është e paimagjinueshme të mendosh që të paktën disa nga dëgjuarit e autorit tonë mund të rrezikonin të binin në të njëjtin mëkat.

Komente rreth Hollësisë 2

Dhe kush qenë ata me të cilët u zemërua për dyzet vjet? A s'qenë vallë ata që mëkatuan, kufomat e të cilëve ranë nëpër shkretëtirë? (Heb 3:17)

Me fjalë të tjera, rebelimi nuk ishte një vetëtimë në qiell të pastër që papritmas shkrepëtiu dhe po aq shpejt u zhduk pa ndonjë pasojë serioze apo të përhershme. Përkundrazi, serioziteti i rebelimit ishte kaq i madh dhe pasojat e tij kaq të pariparueshme, sa që Perëndia duroi aq shumë derisa i gjithë brezi rebel u fshi

fare para se të lejonte brezin tjetër të hynte në tokën e premtuar. (shih Num 14:32–35; LiP. 2:14–15).

Komente rreth Hollësisë 3

Dhe për cilët bëri be se nuk do të hynin në prehjen e tij, veç se për ata që qenë të pabindur? (Heb 3:18)

Këtu, shqetësimi i autorit është të përcaktojë me hollësi se cili ishte mëkati që e nxiti këtë rebelim. Nuk ishte, si të thuash, një shpërthim i papritur zemërimi nga një acarim nervash. Ishte një rast mosbesimi thelbësor, i vazhdueshëm. Dhe autori ynë mbërrin në përfundimin: “Ne shohim se ata nuk mundën të hyjnë për shkak të mosbesimit.” (Heb 3:19).³

Hapi i shtatë

Në këtë pikë shtjellimi i këtij psalmi nga autori bën një kthesë më pozitive. Deri më tani ai është fokusuar në ata që, për shkak të mosbesimit të tyre të qëllimshëm dhe të vazhdueshëm, u dënuan nga Perëndia me betim që të mos hynin kurrë në tokën e premtuar të Kanaanit apo me fjalët e Psalmi 95:11, të mos hynin “kurrë në prehjen time [d.m.th. të Perëndisë]”. Por tani autori pohon që gjuha e betimit të Perëndisë, e marrë në kontekstin e gjerë të psalmi, tregon që ky koment rreth rebelëve nuk ka anuluar premtimin në lidhje me të tjerët. Larg qoftë! Ata që, ndryshe nga rebelët, besojnë fjalën e Perëndisë dhe nuk e ngurtësojnë zemrën e tyre, ende e kanë të hapur para tyre mundësinë, madje premtimin, për të hyrë në prehjen e Perëndisë. Autori ynë thotë:

Prandaj, përderisa mbetet akoma një premtim për të hyrë në prehjen e tij, le të kemi frikë se mos ndonjë nga ju të mbetet jashtë. (Heb 4:1).

³ Togëfjalëshi greqisht i përkthyer si “i pabindur” (Heb 3:18), ‘mosbindje’ (4:6, 11), përdoret vazhdimisht kudo në Dhiatën e Re për të përshkruar qëndrimin e atyre që qëllimisht refuzojnë ungjillin dhe me dëshirë nuk e besojnë atë. Ky grup fjalësh nuk përdoret asnjëherë për besimtarët e vërtetë që mund të jenë të dobët në besim apo që përkohësisht shfaqin sjellje rebele (shih Gooding, *Një mbretëri e patundur*, 113).

Menjëherë na lindin disa pyetje, dhe e para është kjo: ku thuhet në psalm haptazi që ky premtim ende qëndron, dhe qëndron jo vetëm për lexuesit e parë të psalmistit, por edhe për bashkëkohësit e autorit tonë – madje edhe për ne?

Përgjigjja është që nuk thuhet haptazi në asnjë vend në psalm; por autori ynë argumenton që përmbajtja e përgjithshme e tij e nënkupton atë qartazi.

Çfarë bazash, atëherë, mund të parashtrijmë për këtë argument? Së pari, ne mund të marrim si dëshmi tregimin fillestar historik.

Konteksti i betimit të Perëndisë te Numrat 14

Kur Perëndia u betua kundër rebelevë, ai premtoi njëherazi jo vetëm një gjë, por dy:

1. Rebelët nuk do të hynin kurrë në tokën e premtuar.
2. Por Kalebi, bashkëkohësi i tyre, do të hynte, si edhe fëmijët e rebelëve të cilët, duke qenë ende të vegjël, nuk do të ngarkoheshin me faj për vendimin e prindërve të tyre.

Atëherë Zoti tha: "... tërë këta njerëz që kanë parë lavdinë time dhe mrekullitë që kam bërë në Egjipt e në shkretëtirë, dhe më kanë tunduar dhjetë herë dhe nuk e kanë dëgjuar zërin tim, me siguri nuk kanë për ta parë vendin që u betova t'u jap etërve të tyre. Askush nga ata që më kanë përçmuar nuk ka për ta parë; por shërbëtorin tim Kaleb, duke qenë se veproi i shtyrë nga një frymë tjetër e më ka ndjekur plotësisht, unë do ta fus në vendin ku ka shkuar; dhe pasardhësit e tij do ta zotërojnë. ... Ashtu siç është e vërtetë që unë jetoj, thotë Zoti, unë do t'ju bëj atë që kam dëgjuar prej jush. Kufomat tuaja do të bien në këtë shkretëtirë; ju të gjithë që jeni regjistruar, nga mosha njëzet vjeç e lart, dhe që keni murmuritur kundër meje, nuk do të hyni me siguri në vendin ku u betova se do të banoni, me përjashtim të Kalebit... dhe të Jozueut... . Të vegjlit tuaj përkundrazi, që ju thatë se do të ishin viktimat e armiqve, do t'i fus; dhe ata do të njohin vendin që ju keni përçmuar. (Num 14:20–24, 28–31)

Perëndia u premtoi fillimisht stërgjyshëve të kombit, Abrahamit, Isakut dhe Jakobit, që ai do t'i kthente pasardhësit e tyre në Kanaan (Num 14:24, 31). Fakti që Perëndia u betua më pas se rebelët nuk do të hynin kurrë në të, patjetër nuk do të anulonte premtimin fillestar për këdo tjetër. Kjo e bënte të vlefshëm ende premtimin për Kalebin dhe Jozueun, bashkëkohës të rebelëve, që ishin besimtarë të vërtetë, si edhe për pasardhësit e tjerë qoftë të tyre apo edhe të rebelëve.

Konteksti i përgjithshëm i betimit të Perëndisë te Psalmi 95

Me këtë kthehem pas te Psalmi 95 ku Fryma e Shenjtë i tregon brezit "të sotëm" që ata mund të dëgjojnë zërin e Perëndisë që po u flet atyre, njësoj si bënë stërgjyshërit e tyre. Prandaj ai i nxit të mos i ngurtësojnë zemrat, si bënë rebelët në shkretëtirë; dhe e përforcon këtë nxitje duke i kujtuar brezit "të sotëm" se çfarë u ndodhi stërgjyshërve të tyre kur i ngurtësuan zemrat: Perëndia u betua që ata kurrë nuk do të hynin në prehjen e tij. Por fare mirë mund të pyesim: çfarë kuptimi do të kishte t'u kujtonim njerëzve "të sotëm" pasojën solemne të refuzimit të rebelëve për të besuar, nëse për brezin e sotëm (po që se ata nuk do të ngurtësonin zemrat, por do të besonin fjalën e Zotit) nuk mbetej asnjë premtim ose mundësi për hyrje në prehjen e Zotit (apo ndonjë ekuivalent tjetër)? Vetë nxitja e betimit të Perëndisë se *jobesimtarët* nuk do të hyjnë në prehjen e tij, sigurisht nënkupton se *besimtarët* do të hyjnë.

Prandaj autori ynë është ende mbi baza të shëndosha kur argumenton që Psalmi 95 e lë premtimin e hyrjes në prehjen e Perëndisë në fuqi për njerëzit "e sotshëm". Por ai ka një arsye më shumë për të deklaruar se ky premtim ende qëndron në fuqi, ashtu si edhe do të argumentojmë në vijim.

Hapi i tetë

Autori tani na tërheq vëmendjen tek analogjia mes premtimit të dhënë besimtarëve prej ungjillit të krishterë dhe premtimit të dhënë izraelitëve kur u shpenguan nga Egjipti. Ai e ka përdorur

këtë analogji tashmë më herët në predikimin e tij; dhe vëmë re atje që nuk është se ai qartësoi në fillim pozitën e Izraelit dhe pastaj të arsyetonte pozitën e krishterë prej kësaj. Ai si fillim prezantoi pozitën e krishterë dhe pastaj theksoi ngjashmërinë mes saj dhe përvojës së mëparshme të Izraelit në shkretëtirë. Ai ndjek të njëjtin rend këtu duke cituar një hollësi tjetër në të njëjtën analogji:

Pozita e tanishme e krishterë: “në fakt neve na është shpallur lajmi i mirë [d.m.th. ungjilli]”.

Pozita e izraelitëve të lashtë: “si edhe atyre” [d.m.th. edhe atyre u ishte shpallur lajmi i mirë]. Ngjashmëria është e dukshme; por le të kujtojmë se çfarë përmban ky lajm i mirë i krishterë.⁴ Ai i thotë besimtarit jo vetëm që është nxjerrë “nga pushteti i errësirës... dhe ka ... faljen e mëkateve” (Kol 1:13–14), por edhe që ka para vetes, si pjesë përbërëse të shpëtimit të tij, “një trashëgim të paprishshëm, të panjollë dhe të pafishkur, që është ruajtur në qiejt” për të (1 Pjet 1:3–4). Përveç kësaj, ai ka tani kaparin e Frymës së Shenjtë që është “garancia e trashëgimisë tonë derisa ta kemi në zotërim.” (Efes 1:13–14). Asnjë pjesë e këtij ungjilli të dyfishtë, “e këtij shpëtimi kaq të madh” (Heb 2:3), nuk është lënë në dëshirën e ndokujt. Këto dy pjesë janë të pandashme. Prano pjesën e parë dhe do t’i kesh pranuar të dyja. Mos beso dhe mos prano pjesën e dytë, dhe do të kesh refuzuar pjesën e parë po ashtu.

Ja, pra, edhe rreziku që i kanoste lexuesit e autorit tonë. Ata kishin rrëfyer se besonin që Jezusi ishte Mesia; por tani dukej që disa prej tyre po hezitonin të “synonin përkryerjen” (6:1), madje të hynin në atë pjesë të trashëgimisë së madhe të krishterë që mund të shijohet prej besimtarëve tani – siç janë përfitimet e krypriftërisë së Zotit tonë (Heb 7), bekimi që jep besëlidhja e re (Heb 8–9), dhe privilegji i hyrjes së tanishme frymërore në Vendin Shumë të Shenjtë (Heb 10) – pa përmendur këtu hyrjen në trashëgiminë qiellore që do të vijë (10:35–39; 11:13–16; 12:22–29; 13:14).

Prandaj, ky hezitim nga ana e lexuesve të autorit ishte

⁴ Fjala greke εὐαγγελίζομαι (euangelizomai) = ‘t’u predikosh lajmin e mirë të tjerëve’, është pjesë e atij grupi fjalësh që Dhiata e Re e përdor vazhdimisht për fjalën “ungjill”.

ogurzi; dhe për këtë arsye ai u tërheq vëmendjen për hezitimin e paraardhësve të tyre, realisht për refuzimin e tyre, për të hyrë në trashëgiminë e tyre fizike dhe tokësore. Ngjashmëria mes sjelljes së paraardhësve të tyre dhe sjelljes së tyre është kaq e madhe, saqë, ndërsa tani heton thellësisht zemrat e paraardhësve të tyre për të vënë në dukje shkakun dhe pasojat e refuzimit të tyre, ai është duke i ftuar njëherazi lexuesit e tij t’i hetojnë thellësisht zemrat për të konfrontuar shkakun e mundshëm të hezitimit të tyre.

Pse ungjilli nuk pati dobi për paraardhësit e tyre

Së pari, le të kujtojmë vetë se çfarë ishte “lajmi i mirë” apo “ungjilli” që morën paraardhësit e tyre. Ai sigurisht që përfshinte lajmin e mirë që dy spiunët, Kalebi dhe Jozueu, sollën me vete pasi kishin vëzhguar vendin dhe banorët e tij gjigantë:

“Vendi që kemi përshkuar për ta vëzhguar është një vend i mirë, shumë i mirë. Në rast se Zoti kënaqet me ne, do të na çojë në këtë vend dhe do të na japë neve, “një vend ku rrjedh qumësht dhe mjaltë”. Vetëm mos ngrini krye kundër Zotit dhe mos kini frikë nga populli i vendit, sepse ai do të jetë ushqimi ynë; mbrojtja e tyre është larguar nga ata dhe Zoti është me ne; mos kini frikë nga ata”. (Num 14:7–9)

Por kjo pjesë e veçantë e lajmit të mirë që Kalebi dhe Jozueu u treguan njerëzve, nuk ishte një ungjill tjetër apo shtesë: që një pjesë përbërëse e të vetmit ungjill që Perëndia i kishte predikuar fillimisht Izraelit që nga fillimi kur ishin ende në Egjipt:

Kështu zbrita për ta çliruar nga dora e egjiptasve dhe për ta çuar nga ky vend në një vend të mirë dhe të hapur, në një vend ku rrjedh qumështi dhe mjalti. (Eksodi 3:8)

Nuk ka patur ndonjëherë dy ungjij, një që u premtonte atyre çlirim nga Egjipti dhe pastaj një ungjill të dytë që u premtonte vendin e Kanaanit si një alternativë shtesë për këdo që do të donte të shkonte atje. Ka patur dy pjesë të ungjillit, por vetëm një ungjill.

Atëherë, pse ky ungjill i madh nuk solli dobi tek ata? Sepse, thotë autori ynë, “fjala e predikimit nuk u dha dobi fare, sepse nuk qe e bashkuar me besimin tek ata që e dëgjuan.” (Heb 4:2).

Ata që të gjithë e kishin dëgjuar lajmin e mirë që nga fillimi. Kalebi dhe Jozueu e kishin besuar atë që nga fillimi. Por shumica e bashkëkohësve të tyre thjesht e kishin dëgjuar dhe asnjëherë nuk e kishin përvetësuar personalisht apo ta kishin përfshirë në vetvete përmes besimit; dhe kur erdhi dita e provës, doli që ata nuk e kishin besuar realisht.⁵ Ata ishin si anije të ankoruara në mol, por pa qenë të lidhura me kavo; dhe kur erdhi stuhia, rrëshqitën dhe u përplasën me shkëmbinjtë (shih Heb 2:1, dhe si kontrast 6:18–20).

Një kontrast pozitiv

Përmes kësaj analize të hollësishme të mosbesimit themeltar të parardhësve të tyre, autori ka hetuar zemrat e lexuesve të tij shumë thellë. Qëllimi i kësaj është t’i drejtojë të sigurohen se janë vërtet besimtarë, pavarësisht mospërputhjeve në dukje mes rrëfimit të tyre fillestar të besimit dhe praktikës së tyre të tanishme, dhe me qëllim që të korrigjonin këto mospërputhje me ndihmën e Zotit. Besimi fillestar mund të jetë i dobët, por ne nuk jemi të shpëtuar përmes forcës së besimit tonë, por përmes Shpëtimtarit në të cilin e kemi vendsour besimin. Ka shumë të ngjarë që përndjekjet, që kishin hequr së fundi (35–10:32), të kishin dobësuar besimin e tyre; dhe autori nuk kishte për qëllim të dobësonte më shumë atë pak besim që u kishte mbetur, por, më tepër, donte t’i bindte se besimi i vërtetë në Krishtin, sado i dobët, mjafton për të siguruar shpëtimin dhe trashëgiminë e premtuar. Prandaj edhe njëherë tjetër ai tani shpall qartë dhe thjesht se çfarë kërkohet për të hyrë në prehjen e Perëndisë. Ai thotë: “*ne që besuam* hyjmë në prehje” (4:3).

Duhet të vëmë re se pjesorja në greqisht, e përkthyer këtu “*besuam*”, është një kohë që tregon pas në kohë te momenti kur

⁵ Disa dorëshkrime greke kanë një lexim tjetër, që mund të përkthehet ashtu si është përkthyer në Biblën shqip, versioni ABS – 91/94: “nuk qe e bashkuar me besimin tek ata që e dëgjuan”. Kjo do të thotë që, duke qenë jobesimtarë, ata nuk qenë të bashkuar me besimtarët e vërtetë si Kalebi dhe Jozueu.

besuam në fillim, kur vendosëm personalisht besimin tonë në Krishtin. Është e vërtetë që besimi fillestar, nëse është i vërtetë, do të durojë dhe do të dëshmojë me vepra për veten – Krishti, ndërmjetësi ynë, vetë do ta bëjë të mundur këtë (Luka –22:31 32; Heb 25–7:23), por besimi fillestar na sjell menjëherë në atë prehje që Krishti ua ofron të gjithëve që duan të vijnë tek ai (Mat 11:28); në atë prehje që ne provojmë kur besojmë lajmin e mirë se pranimi ynë nga Perëndia nuk varet nga veprat e denja që bëjmë ne, por nga vepra që Krishti ka bërë për ne (Rom 28- 3:21; Ef 10-2:7). Një besim i tillë fillestar, duhet të kujtojmë se mjaftoi për hajdutin që po jepte shpirt në kryq kur besoi, për t’i dhënë hyrje të menjëhershme në prehjen e parajsës së përjetshme të Perëndisë (Luka 43–23:42); dhe kështu do të jetë për të gjithë që besojnë në Krishtin.

Hapi i nëntë

Por tani ngrihet një pyetje për formulimin e psalmit që autori ynë po shtjellon; dhe më mirë ta sqarojmë këtë çështje tani, para se të vazhdojmë me zbërthimin e autorit. Pyeja është kjo. Te Numrat, betimi i Perëndisë kundër rebelëve është “me siguri nuk kanë për ta parë vendin” (Num 14:23), ose “nuk do të hyni me siguri në vendin” (14:30). Por kur te Psalmi 95 Fryma e Shenjtë i referohet këtij betimi, ai e perifrazon atë si “nuk do të hyjnë në prehjen time”. Pse?

Sepse në radhë të parë, Psalmi 95:11 i drejtohet “brezit të sotëm” të Izraelit kur kombi kishte qenë në tokën e premtuar për shekuj me radhë. Prandaj nuk do të kishte kuptim t’i paralajmëroje që, nëse do të refuzonin ungjillin e Perëndisë, si bënë paraardhësit e tyre, ata nuk do të shihnin apo nuk do të hynin kurrë në tokën e premtuar. Ajo që rrezikonin të humbisnin nuk qe hyrja në tokën e premtuar, por diçka më e rëndësishme, d.m.th., hyrja në prehjen e Perëndisë.

Kjo ngre një pyetje tjetër. Nëse “hyrja në prehjen e Perëndisë” nuk është e njëjtë si “hyrja në tokën e premtuar”, pse Fryma e Shenjtë të jep përshtypjen te Psalmi 95:11 se “kurrë nuk do të hyjnë në prehjen time” ishte fraza e përdorur nga Perëndia kur u betua kundër rebelëve në shkretëtirë?

Dy gjëra merren në shqyrtim këtu. Së pari, kur izraelitët besimtarë hynë në tokën e premtuar, ata provuan, në një nivel, prehjen e dhënë nga Perëndia: “Dhe kështu vendi pati një pushim nga lufta,” thotë Jozueu 11:23; dhe 22:4 shton: “tani që Zoti, Perëndia juaj, i ka lënë të pushojnë vëllezërit tuaj”. Për më tepër, shekuj më vonë, Perëndia, duke përdorur vetë fjalët e tij: “nuk kam banuar në një shtëpi nga dita që kam nxjerrë bijtë e Izraelit nga Egjipti e deri më sot, por kam bredhur nën një çadër dhe në një tabernakull.” (2 Sam 7:6), e lejoi Salomonin t’i ndërtonte një shtëpi të qëndrueshme prej guri dhe hyri në prehjen e tij (2 Kron 6:41). Për atë kohë, Perëndia e kishte përmbushur qëllimin e tij për të nxjerrë Izraelin nga Egjipti dhe për ta sjellë në tokën e premtuar. Perëndia tani nuk kishte nevojë të ‘endej’ më dhe hyri në vendin e prehjes së tij.

Prandaj ka një lloj ngjashmërie mes qëllimit të shpengimit të Izraelit të lashtë, d.m.th. një prehje e dhënë nga Perëndia që në njëfarë kuptimi edhe vetë Perëndia e provoi, dhe prehjes që Perëndia paraqet te Psalmi 95 për “brezin e sotëm”. Kjo justifikon përdorimin e të njëjtës fjalë “prehje” për t’i përshkruar të dyja. Nga ana tjetër, ato nuk janë të njëjta. Prehja përfundimtare në të cilën Izraeli hyri ishte jo e përhershme dhe shpesh e paqëndrueshme; prehja që Perëndia ofron te Psalmi 95 është e përjetshme. Prehja e dhënë nga Perëndia për Izraelin në Kanaan ishte prototip i një prehjeje shumë më të madhe që Perëndia i ofron “brezit të sotëm”; por nuk ishte saktësisht e njëjta gjë.

Kështu, rebelët në shkretëtirë sigurisht humbën prehjen e dhënë nga Perëndia në Kanaan. Por ata humbën më shumë se kaq. Sepse prehja e Perëndisë, për të cilën flet Fryma e Shenjtë te Psalmi 95, ka qenë e arritshme që nga krijimi i botës për të gjithë ata që vendosin besimin e tyre te Perëndia dhe fjala e tij (Heb 4:3). Por rebelët në shkretëtirë refuzuan fjalën e Perëndisë, refuzuan ungjillin e Perëndisë dhe në fund i kthyen shpinën Perëndisë. Duke vepruar kështu, ata u dënuan që të mos hynin kurrë jo vetëm në Kanaan, por edhe në prehjen e përjetshme të Perëndisë. Dhe se çfarë është kjo prehje, ne duhet ta lejojmë vetë autorin ta shpjegojë ndërsa hedh hapin tjetër në predikimin e tij.

Hapi i dhjetë

...siç tha ai: Kështu u përбетова në mërinë time: nuk do të hyjnë në prehjen time, ndonëse veprat e tij u mbaruan që kur se u krijua bota. Sepse diku ai ka thënë kështu për të shtatën ditë: Dhe Perëndia u preh të shtatën ditë nga të gjitha veprat e tij; dhe po aty: Nuk do të hyjnë në prehjen time. (Heb 4:3–5)

Atëherë argumenti i autorit është që, kur në psalm Perëndia përdor frazën “prehja ime”, po i referohet prehjes që ai vetë filloi kur puna e krijimit u përfundua, dhe “atë ditë Perëndia u çlodh nga gjithë vepra që kishte krijuar dhe kryer.” (Zan. 2:3). Universi i krijuar i qiellit dhe tokës, dhe vetë jeta brenda tyre, i mbartte në vetvete si potencialin për zhvillim, ashtu dhe mundësinë e shpengimit dhe përtëritjes kur njeriu, administratori i tij kryesor, përmes pabesisë dhe mosbindjes së tij, do të kërcënonte suksesin e qëllimit fillestar të Perëndisë në krijim. Por fakti që Perëndia e kishte bërë me duart e tij universin dhe i shkoi deri në fund veprës së krijimit, që një garanci që qëllimi i tij në krijim do të përmbushej. Krijesa nuk u la përgjysmë dhe as nuk do të lejohet të kthehet pas në hiçin nga i cili doli. Arritja e qëllimit të saj përfundimtar ishte e përfshirë tashmë në faktin që Perëndia e nisi dhe pastaj e përfundoi veprën e krijimit; në atë siguri hyjnore prehej Perëndia.

Hyrja e kombit të Izraelit në tokën e premtuar ishte një nga qëllimet që Perëndia kishte në mendje kur ai krijoi botën; dhe fakti që ishte kështu, ishte garanci që kjo do të përmbushej. Përmes besimit Kalebi dhe Jozueu pranuan sigurinë e padiskutueshme të asaj përmbushjeje, dhe hynë, kështu, në prehjen e zemrës së vetë Perëndisë në lidhje me pasojat edhe para se të gjitha betejat e domosdoshme të fitoheshin dhe ata të mbaronin luftën (Num 14:6–9). Bashkëkohësit e tyre nuk e patën këtë besim në sigurinë e përmbushjes së qëllimit të Perëndisë dhe, për pasojë, ata nuk shijuan paqen e zemrës së Perëndisë ndërsa u përballën me betejat që kishin para. Kështu ata refuzuan të hynin në tokën e premtuar dhe nuk shijuan kurrë prehjen e mëvonshme pas lufte.

Hapi i njëmbëdhjetë

Por tani autori përfytyron një kundërshtim të mundshëm nga lexuesit e tij: të gjitha premtimet e Perëndisë për t'i dhënë Izraelit prehje u plotësuan tërësisht kur Jozueu mposhti përfundimisht të gjithë mbretërit e Kanaanit, dhe kur izraelitët nuk bënë më luftë. Prandaj, asnjë prehje e ngjashme apo e mëpasme nuk vihet para nesh; dhe nuk kemi nevojë të shqetësohemi nëse kemi hyrë, apo do të hyjmë ndonjëherë, në atë prehje.

Si përgjigje, autori ynë thjesht tregon që Psalmi 95, me ofertën e tij për “brezin e sotëm” për të hyrë në prehjen e Perëndisë, u shkrua shekuj pas prehjes që Jozueu fitoi për Izraelin në Kanaan. Prehja e Jozueut kuptohet se nuk ishte përmbushja e prehjes që përshkruhet në psalm. Ai del në përfundimin se “Mbetet, pra, një pushim i së shtunës për popullin e Perëndisë.” (Heb 4:9). Ai është “pushim i së shtunës” (greqisht: σαββατισμός, Heb 4:9); është e njëjtë si prehja që Perëndia shijoi kur pushoi prej veprës së tij të krijimit: “Sepse kush ka hyrë në prehjen e tij [të Perëndisë], ka bërë pushim edhe ai nga veprat e veta, ashtu si Perëndia nga të tijat.” (Heb 4:10). Natyrshëm ne pyesim: kur prehemi ne nga veprat tona dhe hyjmë në prehjen e tij? Përgjigjja është e dyfishtë:

Prehja fillestare

Kjo mund të provohet këtu dhe tani kur i përgjigjemi ftesës personale të Krishtit:

Ejani tek unë, o ju të gjithë të munduar dhe të rënduar, dhe unë do tju jap çlodhje. Merrni mbi vete zgjedhën time dhe mësoni nga unë, sepse unë jam zemërbutë dhe i përlulur nga zemra; dhe ju do të gjeni prehje për shpirtrat tuaj. (Mat 11:28–29)

Nga ai mësojmë që, për shfajësim dhe paqe me Perëndinë, ne duhet të braktisim të gjithë besimin në veprat tona dhe të prehemi tërësisht në veprën shlyese që Krishti ka bërë dhe përfunduar për ne (Rom 3:19–31). Dhe ndonëse ka shumë beteja përpara, ne mundemi, si Jozueu dhe Kalebi, të shijojmë prehjen e Perëndisë në zemrat tona duke ditur që shpëtimi ynë final

është i sigurt (Rom 5:1–11; 8:31–39).

Prehja finale

Këtë ne do ta dimë kur të vdesim, kur të largohemi nga trupi ynë dhe të jemi në praninë e Zotit (2 Kor 5:1–8; Rev 14:13); ose, nëse ne do të jemi gjallë në ardhjen e dytë, kur Zoti Jezus të kthehet, do të na ndryshojë dhe të na marrë me bashkëbesimtarët e ringjallur për të qenë gjithmonë me Zotin (1 Thes 4:13–18; 2 Thes 1:7–12).

Hapi i dymbëdhjetë

Dhe tani predikimit zbërthyes të autorit tonë po i afrohet fundi; por si pastor besnik, ai nuk do ta përfundojë pa një nxitje solemne dhe pastaj një fjalë të fortë inkurajimi. Fjala e gjallë dhe e fuqishme e Perëndisë, mbi të cilën ky predikim është mbështetur, ka hetuar dhe do të vazhdojë të hetojë vetë thellësitë e zemrave të tyre. Ata nuk duhet t'i shmangen tehut të mprehtë të saj, por të sigurohen më shumë se nuk do të humbasin prehjen e Perëndisë prej rebelimit kundër ungjillit të Perëndisë (Heb 4:11–13).

Është e vërtetë që, kohët e fundit, mund të kenë qenë të paqëndrueshëm në rrëfimin e besimit të tyre. Por nuk kanë pse të braktisin rrëfimin e besimit, sepse në Krishtin kanë një kryepriest besnik, të mëshirshëm, të dhembshur dhe të urtë. Prandaj ata duhet t'i afrohen “me guxim fronit të hirit, që të marrin mëshirë e të gjejnë hir, për të pasur ndihmë në kohë nevojë.” (Heb 4:14–16).

...

Pyetjet e studimit për këtë kapitull mund t'i gjeni në faqen 440.

KATEGORIA E PESTË

Hije tipologjike

19

Tabernakulli si hije e gjërave qiellore

Duhet të pranojmë se mes teologëve akademikë përgjatë 100 viteve të fundit, interpretimi tipologjik i Dhiatës së Vjetër nuk ka patur gjithmonë përkrahje të madhe. Kjo ndodh pjesërisht për shkak se është menduar që një interpretim i tillë nuk kombinohet mirë me këndvështrimin racional gramatiko-historik ndaj tekstit, i cili është vlerësuar nga të gjitha anët si themelor për një kuptim të duhur të Dhiatës së Vjetër. Ndodh, gjithashtu, edhe për shkak të kuptimeve arbitrare të imponuara ndonjëherë mbi tekstin prej disa praktikantëve të tipologjisë. Mendohet se interpretimi tipologjik mbështetet shumë më tepër në imagjinatën krijuese, sesa në zbërthimin dhe shtjellimin racional. Për më tepër, sugjerohet se kjo mbivendosje e një kuptimi tipik të tekstit priret të zhvlerësojë kuptimin e tij të parë dhe fillestar.

Sidoqoftë, në 30 vitet e fundit ka patur një lëvizje në drejtim të interpretimit tipologjik, më shumë për shkak të botimit të një libri në anglisht nga akademiku liberal, Leonhard Goppelt¹. Në të ai ka demonstruar që interpretimi tipologjik i Dhiatës së Vjetër është jo vetëm i ligjshëm, por në Dhiatën e Re ka një rëndësi të madhe. Vepra e tij ka patur ndikim të gjerë së bashku me veprën më të fundit të G. K. Beale që ka mbrojtur në mënyrë bindëse pranueshmërinë e tipologjisë².

1 *Typos*, botuar në gjermanisht në 1939; përkthimi anglisht 1982.

2 Shihni koleksionin e Beale-it të artikujve prej akademikëve të ndryshëm, që e

Në këtë pjesë të dytë të librit tonë, e kemi lënë qëllimisht për në fund diskutimin e tipologjisë. Jo se duam të nënvlerësojmë interpretimin tipologjik. Ajo që duam të bëjmë është të theksojmë faktin që tipologjia (në kuptimin e ngushtë e quajtur kështu) është vetëm një nga mjetet që vetë autorët e Dhiatës së Re e kanë përligjur për të gërmuar pasurinë e Dhiatës së Vjetër. Disa shtjellues dhe predikues, të bindur që vetë autorët e Dhiatës së Re e përligjën përdorimin e interpretimit tipologjik, kundërshtojnë, sidoqoftë, trajtimin tonë të ndonjë tipari tjetër të Dhiatës së Vjetër si tip, përveç atyre që autorët e Dhiatës së Re, nën frymëzim hyjnor, kanë deklaruar me autoritet se janë tipe. Kujdesi që kanë këta komentues dhe predikues është i tepërt, siç edhe e thekson Beale. Por nuk është se ata janë të detyruar të zgjedhin vetëm midis dy opsioneve: ose kuptimit të qartë dhe të drejtpërdrejtë dhe të fjalëpërfjalëshëm (së bashku me rrjedhimet morale apo frymërore që mund të ketë patur për lexuesit e tij fillestar dhe ndoshta edhe për ne), ose një interpretimi tipologjik. Vetë trajtimi që Dhiata e Re i bën Dhiatës së Vjetër demonstroi, siç edhe jemi përpjekur të tregojmë, që kategoritë e tjera interpretative janë të mundshme: krahasim, krahasimet formale, metaforat, paradigma ligjore, analogjia dhe përmbushja jo vetëm e parashikimeve, por edhe e prototipeve.³ Prandaj, nga nxitja që kemi marrë prej studimeve tona të deritanishme dhe pa u treguar të pandjeshëm ndaj miqve tanë, tani duhet të kërkojmë të zbulojmë sesi të kuptojmë tabernakullin si një tip.

Fjala *tip* ka shumë ngjyime në gjuhën angleze siç edhe mund të dallohet duke përdorur fjalorët e kësaj gjuhe. Fjala greke τύπος, nga e cila e ka prejardhjen fjala angleze, ka po

kundërshtojnë ose përkrahin tipologjinë, që ai e ka botuar në librin e tij *Right Doctrine from Wrong Texts?* Kushtojni veçanërisht vëmendje mbrojtjes së tij të zjarrtë (fq. 404) për të drejtën që kemi në imitimin e shembullit të autorëve të Dhiatës së Re dhe të merremi vetë, duke treguar kujdes, me zbërthimin e Dhiatës së Vjetër në mënyrë tipologjike. Shihni edhe volumnin masiv, që përfshin të gjithë Dhiatën e Re, të botuar bashkë me Carson, *Commentary on the NT Use of OT*.

3 Shumë akademikë punojnë me një përkufizim të gjerë të tipologjisë që përfshin, të paktën, disa prej këtyre kategorive, veçanërisht prototipet. Ne nuk do të debatojmë për klasifikimin që u bëjnë atyre, sepse është thjesht një çështje e semantikës leksikore. Ne vetë thjesht na pëlqen të përdorim termin “tip” për gjërat që Perëndia i krijoi për të funksionuar vetëm si tipe dhe jo për diçka tjetër.

ashtu disa ngjyrimë; dhe siç e kemi vënë re në Kapitullin 7, kur përdoret në greqishten e Dhiatës së Re, ajo mbart kuptime të ndryshme në kontekste të ndryshme.

Sidoqoftë, në anglishten biblike, *tipi* është përdorur për çdo person, institucion, ceremoni apo ngjarje të Dhiatës së Vjetër që, në ndonjë mënyrë, qoftë në një skallë të vogël apo të madhe, shihet si një hije e një gjëje të barasvlershme në Dhiatën e Re. Kështu p.sh., Jozefi, në disa nga përvojat e tij, thuhet me të drejtë se është një tip (në kuptimin popullor) i Krishtit; dhe Samsoni, sigurisht në disa raste por jo në të gjitha, thuhet se është një tip i Krishtit, por me mangësi.

Prandaj mund të duhet pak punë nga ana jonë për të kuptuar në çfarë kuptimi fjala greke τύπος dhe e ndërsjellta e saj ἀντίτυπος, (*antitip*) janë përdorur në Shkrime në lidhje me tabernakullin. Sa për fillim, kjo fjalë do të përfshijë dallimin e dy funksioneve të ngjashme, por shumë të ndryshme, që Perëndia synonte që t'i përmbushte tabernakulli. Në këtë kapitull do të shqyrtojmë funksionin e tij si një hije të gjërave qiellore dhe në kapitullin 20, funksionin e tij si një hije të gjërave të mira që do të vijjnë. Kapitulli 21 do të përmbyllë këtë pjesë të studimit tonë duke parë simbolizmin e tabernakullit në skenat qiellore të dokumentuara te Zbulesa.

Banesa e përkohshme e Perëndisë mes popullit të tij

Perëndia i tha Moisiut: “Le të më bëjnë një shenjtërore, që unë të banoj në mes tyre.” (Eksod 25:8). Por Perëndia nuk e la në dorë të Moisiut – aq më pak në atë të izraelitëve – të ndërtonin atë që ata mendonin se mund të ishte një shenjtërore në të cilën Perëndia mund të banonte. Ai jo vetëm që i dha Moisiut detaje, urdhëra verbale për strukturën dhe mobilimin e saj: ai gjithashtu i dha atij një skicë pamore – atë që hebraishtja e quan një תבנית (*tabnīth*) — si për vetë tabernakullin, ashtu edhe për mobilimin e tij (25:9). Pastaj ai e urdhëroi Moisiun: “Dhe shiko të bësh çdo gjë simbas modelit (*tabnīth*) që tui tregua [fjalëpërfjalë – të doli para syve] në mal” (25:40).

Kështu, çfarë do të thotë saktësisht fjala hebraike, *tabnīth*?

Ka mendime të ndryshme. Është një emër i formuar nga folja בָּנָה, *bānāh*, “ndërtoj”, “ngre”. Kjo e shtyu F. F. Bruce të mendonte se *tabnīth* duhet të ketë qenë “një lloj maketi i shenjtërores që do të ndërtohej”.⁴ B. K. Waltke pëlqen ta quajë “plan” apo “projekt”.⁵ Tek Eksodi 25:40 Septuaginti e përkthen *tabnīth* jo prej fjalës greke παράδειγμα si në vargun 25:9, por me τύπος për të cilin shumica e përkthimeve anglisht jep fjalën “model”. Por cilido qoftë kuptimi i saktë i *tabnīth*, rrjedhoja logjike te Hebrenjve 8:1–5 tregon që Dhiata e Re e quan atë si një lloj paraqitjeje grafike të dukshme të shenjtërores qiellore. Sepse ky paragraf pohon që tabernakulli i Mosiut, i ndërtuar rreptësisht sipas këtij τύπος (= *tabnīth*), ishte, për pasojë, një “shembull dhe hije e gjërave qiellore” (Heb 8:5). Nuk ishte – dukshëm jo – “tabernakulli i vërtetë, d.m.th., “gjëja e vërtetë”, “shenjtërorja qiellore e Perëndisë”; sepse nuk qe ajo që Moisiu ndërtoi: atë e ndërtoi Perëndia (8:2). Tabernakulli i Moisiut, si edhe përsëritet te Hebrenjve 9:23 edhe njëherë tjetër, ishte vetëm një kopje e “gjërave në qiejt”. Por në të njëjtën kohë ishte një kopje reale, e projektuar nga Perëndia e atyre gjërave qiellore. Vendet e shenjta të saj, siç e thekson Hebrenjve 9:24, ishin të ndryshme nga shenjtërorja qiellore, në kuptimin që ato ishin bërë nga duart e njerëzve; por sidoqoftë ato ishin, për të përmendur KJV-në, “një shëmbëllesë e së vërtetës”. Këtë herë fjala greke është ἀντίτυπος. Tabernakulli i Moisiut u përputh plotësisht me τύπος që Perëndia i shfaqti atij mbi mal. Prandaj, ajo qe, në kuptimin e fjalës greke, vetë një τύπος i qiellit; dhe (së bashku me tempujt që e zëvendësuan atë, deri në kohën e tempullit të Herodit) shërbyen si të tillë për shekuj të tërë.

Prandaj, ne nuk duhet të nënvlerësojmë domethënien e tabernakullit historik (dhe ata që e pasuan atë). Ka patur vetëm një syresh të tillë çdo herë.⁶ Për rrjedhojë kishte shumë sinagoga hebraike qoftë në Palestinë apo qoftë në vendet ku

4 Hebrews, 165, n. 27. Ky është kuptimi i mundshëm, sepse Septuaginti në këtë pikë (Heb 25:9) përdor fjalën παράδειγμα paradeigma që mund të thotë ‘skicë e një arkitekti’.

5 5 TWOT, 1:118.

6 Ndryshe nga qindra tempujt e Zeusit (Jupiterit) apo Artemisë (Dianës) që ishin ndërtuar kudo në Lindjen e Mesme.

jetuan hebrenjtë e shpërngulur. Por ato nuk ishin versione të përsëritura të tabernakullit. Vetëm në tabernakull Perëndia i padukshëm erdhi personalisht mbi kerubinin e arkës. Vetëm në tabernakull (tempull) mund të ofroheshin kurbanet për mëkatin dhe të ishin të pëlqyeshme. Tabernakulli ishte unik.⁷

Për më tepër, edhe pse objektet dhe ritet e tij ishin vetëm simbolike, hije, “tipe” të realiteteve të mëdha të përjetshme, ato ende shërbenin për shekuj si mjete të vetë-zbulesës së Perëndisë për popullin e tij. Ato komunikan të vërteta të përjetshme përmes simboleve që mund të kuptoheshin nga njerëzit e asaj kohe. Ashtu si të vërtetat abstrakte të aritmetikës u mësohen disa herë fëmijëve të vegjël duke përdorur blloqe druri me ngjyra, po ashtu Perëndia përdori ato “kopje dhe hije” materiale për të ngulitur në popullin e tij disa parime të caktuara thelbësore të jetës, shlyerjes, faljes dhe shenjtërisë nga të cilat varej bashkësia me Perëndinë e qiellit, që tani kishte zbritur për të banuar mes tyre. (shih Kap. 3).

Le të marrim si shembull tri pjesët e shenjta që qëndruan në ndarjen e parë të tabernakullit, të quajtur Vendi i Shenjtë: Shandani, Tryeza e Bukës së Paraqitjes dhe Altari i Artë. Të tria këto pjesë qenë orendi të paraqitjes. Funkzioni praktik i Shandanit ishte kryesisht të mbante bashkë shtatë llambat që të mund të ndriçonin para Zotit vazhdimisht (Lev 24:1–4), si edhe të bënin dritë për priftërinjtë. Po ashtu Tryeza paraqiti vazhdimisht dymbëdhjetë çyrekë buke para Zotit (Lev 24:5–9). Dhe mbi Altarin e Artë kryepriifti duhej të digjte rregullisht temjan para Zotit (Eksodi 30:6-8). Por edhe në ato kohë të shkuara, të tria kishin një domethënie të madhe përtej funksionit praktik të tyre.

Shandani (Eksodi 25:31–40)

Pavarësisht se funksioni praktik i tij ishte i rëndësishëm, stili që u projektua Shandani nuk ishte i kursyer dhe as vetëm funksional.

⁷ Si një analogji ne mund të citojmë faktin që kur Fjala u bë mish dhe “banoi mes nesh”, si Perëndia i mishëruar, kishte vetëm një si ai: ai që unik. Ai nuk ishte, si disa mendojnë, thjesht një rast më i spikatur i asaj se si Perëndia kishte banuar në çdo burrë dhe grua që ka jetuar ndonjëherë.

Ai u prodhuan në mënyrë të madhërishme, shumë tërheqës dhe simbolikisht elegant. Sepse u prodhuan t’i ngjasojë, me detaje, një peme bajameje të gjallë. Ai kishte një bazë, apo “një këmbë” siç edhe është shprehja në hebraisht, që përfaqësonte pjesën e poshtme të një peme të cilës i duken rrënjët që dalin nga dheu. Pastaj kishte një bosht, që përfaqëson trungun e një peme. Nga trungu dilnin gjashtë degë, tre nga secila anë. Artizanët u porositën rreptësisht: degët nuk duhet të bashkohen me trungun mekanikisht. Ato duhet “të jenë një pjesë e vetme me trungun”, të farkuar nga e njëjta masë primare e arit si trungu, që të japin përshtypjen e një dege natyrore që ka dalë nga trungu dhe që ka pjesë në jetën e tij (Ekod 25:32, 35–36). Përveç kësaj, të modeluara me finesë në arin qoftë të degëve, qoftë të trungut, qenë pjesët të cilat një pemë e vërtetë bajameje prodhon çdo vit ndërsa kalon në procesin e prodhimit të fryteve. Natyrisht, në natyrë këto tipare ndjekin njëra-tjetrën; në pemën prej ari që formonte Shandanin të tria këto përfaqësoheshin njëherazi.

Tani, kuptohet se nuk është e lehtë nga ana gjuhësore të saktësosh kuptimet në hebraishten e lashtë të këtyre termave botanike, të cilat përdoren për të përshkruar këto tipare. Kjo edhe mund të shihet thjesht duke krahasuar disa përkthime anglisht me njëra-tjetrën⁸; sidoqoftë ne do t’i rezervojmë një diskutim të hollësishëm kësaj vështirësie te Shtojca në fund të këtij libri. Pavarësisht nga kjo pasiguri për kuptimin e saktë të termave, është e qartë se ajo që teksti hebraik përshkruan dhe ajo që Shandani përfaqësonte ishin tipare të ngjashme me ato të një peme të vërtetë bajameje ndërsa kalon në ciklet vjetore të prodhimit të fryteve.

Prandaj funksioni praktik i Shandanit ishte të mbartte dhe të përfaqësonte dritën; por – dhe kjo është gjëja më e rëndësishme – ishte simbolikisht vetë një “pemë e jetës”. Ai përfaqësonte

⁸ Eksod 25:33 thotë te KJV ‘Three bowls made like unto almonds, with a knop and a flower’ (‘tre kupat do të bëhen si bajame, me një bufkë dhe një lule’); te RV ‘Three cups made like almond-blossoms... a knop and a flower’ (‘tre kupa të bëra si lulet e bajames ... një bufkë dhe një lule’); te Bibla e Studimit NIV ‘Three cups shaped like almond flowers with buds and blossoms’ (‘tre kupa në formën e luleve të bajames me gongxe dhe lule’), dhe në një shënim ‘tre kupat e shandanit i ngjajnë ose sepalit (pjesës së jashtme të lules) ose frutit të bajames.’.

vetë jetën fillimisht në bukurinë e pastër të lulëzimit: në Izrael pema e bajames qe e para që lulëzonte pas shterpësisë së dimrit, dhe mbartte shpresë për një jetë të re, dhe aludonte për jetën e ringjallur. Pastaj pema shfaqte jetën e saj gjithashtu në forma të ndryshme, të krijuara nga artizanët në trungun dhe degët e saj, të përfutuara gjatë proceseve të saj frytdhënëse.⁹

Atëherë, çfarë kuptimi kishte kjo pemë e jetës për një prift hebre që shërbente në grupin e parë të tabernakullit, atje ku ishte vendosur Shandani? Nëse e njihte librin e Zanafillës, padyshim Shandani do ta kishte kujtuar për rënien në mëkat dhe sesi Adami dhe Eva u dëbuan nga kopshti i Edenit që të mos “shtrijnë dorën e tyre për të marrë edhe nga pema e jetës kështu që të jetojnë për gjithnjë”; dhe sesi Perëndia caktoi pastaj kerubinët në lindje të kopshtit dhe një shpatë të zjarrtë që flakëronte në çdo drejtim, për të ruajtur rrugën për te pema e jetës (Zan 24–3:22).

Por ja që prifti tani ishte në Vendin e Shenjtë. Para tij ishte Veli mbi të cilin ishin qëndisur kudo simbole të kerubinëve. Po ashtu edhe mbulesa mbi kokën e tij dhe muret në secilën anë¹⁰. Kështu, kishte kerubinë mbi të dhe kerubinë përreth tij. Por, megjithatë, ai qëndronte në praninë e kësaj peme të jetës aq afër saj, sa që po të donte, mund të zgjaste dorën dhe ta prekte; në fakt nëse ai qe kryepriifti, duhet ta prekte atë për të rregulluar fitilat përditë (Eksodi 30:7).

Ne e dimë (dhe me shumë gjasa edhe priftërinjtë e dinin po ashtu), që ishte vetëm një simbol i pemës së jetës, thjesht një hije, një antitip i realitetit qiellor.¹¹ Sepse nuk ishte përmbushur akoma koha kur Shpëtimtari ynë, Jezus Krishti, do të shfuqizonte vdekjen dhe do të nxirrte në dritë jetën dhe pavdekësinë përmes

9 Në kapitullin tjetër ne do të shqyrtojmë këtë ‘Pemë-e-jetës-që-mbartte-Dritën’ në funksionin e saj të dytë, si ‘një hije e gjërave të mira që do të vijnë’ (Heb 10:1). Ne pastaj do të identifikojmë stilin elokuent që u përdor për Fjalën e përrjetshme nga Gjoni kur deklaroi në ungjillin e tij (1:3–4): ‘Të gjitha gjërat u bënë me anë të tij. . . Në atë ishte jeta, dhe jeta ishte drita e njerëzve.’ Por për momentin ne ende po studiojmë Shandanin në funksionin e tij të parë si një kopje e gjërave në qiell për izraelitët para Krishtit.

10 Muret dhe tavani qenë të bëra nga të njëjtat perde që formonin tabernakullin (ato realisht ashtu quheshin, krh. Eksod 26); dhe kerubinët mbi mure do të dukeshin nga hapësirat në skeletin e drurit që formonte pjesën e qëndrueshme ku mbaheshin perdet.

11 Shiko Zbu 2:7.

ungjillit (2 Tim 1:10). Por Perëndia nuk kishte për qëllim të torturonte priftërinjtë e tij besnikë, në ato ditë të shkuara, vetëm me gjëra që për ta mbeteshin thjesht simbole. Më saktë, Perëndia po tregonte përmes këtij simboli se tashmë kishte filluar të hapej një rrugë për t’u kthyer te pema e jetës, për të përmbysur dëbimin fillestar të njeriut nga parajsja e Edenit (krhs. Zbul 2:7).

Veç kësaj, ndonëse ishte vetëm një hije e gjërave qiellore, ky simbol u kujtonte brezave të priftërinjve izraelitë se Perëndia i vetëm, i vërtetë dhe i gjallë, që ia kishte zbuluar veten Izraelit dhe që banonte tani mes tyre në tabernakull, ishte i vetmi burim, Krijuesi dhe Mbështetësi i jetës fizike dhe frymërore, me të gjitha potencialet e saj të përkohshme dhe të përjetshme. Kjo ishte një kujtesë e dobishme dhe e domosdoshme për priftërinjtë që duhet të mbronin bashkëkombasit e tyre hebrej nga idhujtaria (shpesh joshëse) e kombeve që i rrethonin. Këto kombe prej kohësh kishin mbytur njohjen e Perëndisë së vetëm të vërtetë (Rom 1:18–23), dhe kishin bërë për vete perëndi të tjera duke hyjnizuar forcat e natyrës, siç edhe bëjnë sot evolucionistët tanë modernë.

Mbreti David i këndoi Perëndisë: “Sepse pranë teje është burimi i jetës, dhe me anë të dritës sate ne shohim dritën.” (Ps 36:9). Nuk ka prova që Davidi po mendonte për Shandanin kur kompozoi këtë psalm. Por poezia e tij shprehte shumë mirë se çfarë tipizonte Pema-e-jetës-që-mbartte-Dritën.

Tryeza e Bukës së Pranisë (Eksodi 25:23–30)

Funksioni i Tryezës

Ashtu si Shandani që sapo kemi studiuar, Tryeza, e cila ishte përballë tij në krahun tjetër të Vendit të Shenjtë, ishte një orendi për paraqitje. Funksioni i saj ishte të mbante dhe paraqiste dymbëdhjetë çyrekë buke dhe një sasi temjani vazhdimisht para pranisë së Zotit (Eks 25:30; 40:23; Lev 24:6–8). Çdo të Shtunë priftërinjtë, duke vepruar në emër të njerëzve, duhet të vendosnin çyrekë të rinj mbi tryezë; një besëlidhje e përrjetshme i detyronte të vepronin kështu (Lev 24:9). Edhe kur kampi qe në lëvizje, çyrekët duhet të ishin ende mbi tryezë (Num 4:7). Çdo

të Shtunë, kur çyrekët e rinj paraqiteshin mbi tryezë, priftërinjtë lejoheshin të hanin të vjettrat. Por duhet t'i hanin ato në një vend të shenjtë. Nuk ishte një vakt i zakonshëm (Lev 24:9).

Domethënia e dymbëdhjetë çyrekëve

Shumë komentues këmbëngulin me të madhe që çyrekët mbi Tryezë përfaqësojnë furnizimin e hirshëm të Perëndisë për popullin e tij: dhe jo furnizimin e tyre për Perëndinë. Motivi pas kësaj këmbënguljeje është i shëndoshë: sepse ajo synon të mbrojë institucionin e Bukës së Paraqitjes nga sugjerimi modern që thotë se ky rit ishte një mbetje nga një fazë më e hershme e evolucionit të fesë, në të cilën Izraeli, si kombet e tjera, mendonte se duhej të ushqente perënditë e tij, dhe që këto perëndi antropomorfe hanin fizikisht sakrificat që u bëheshin atyre. Prandaj Profesor J. I. Durham shkruan:

Çfarëdo lloj ideje e sigurimit të ushqimit për Yahveh . . . është aq larg nga ky sigurim ushqimi, sa ç'është edhe nga ofrimi i sakrificave; pavarësisht asaj që mendonin njerëzit primitivë për perënditë e tyre, populli i Izraelit nuk mund të vendosej në të njëjtën kategori si ata, sado shumë ta zgjerojmë përfytyrimin tonë socio-teologjik.¹²

Këtyre fjalëve i shtojmë edhe mendimin tonë se “sigurisht ata nuk mund të grupohen bashkë”.

Nga ana tjetër ne, që shpesh përdorim edhe vetë metafora, sigurisht duhet ta lejojmë Perëndinë të përdorë metafora vetë nëse vendos ta bëjë këtë. Kur Dhiata e Vjetër thotë për kurbanët se qenë “flijim që është bërë me zjarr me erë të këndshme për Zotin.” (Lev 1:9, 13, 17), nuk do të thotë që Perëndia ka një hundë në sensin fizik, siç edhe nuk mund të kuptohet kështu kur Dhiata e Re komenton se Krishti e dha veten për ne si sakrificë për Perëndinë, një parfum erëmirë (Efes 5:2). Në mes të kundërmimit moral dhe frymëror që nxiti kryqëzimin e Krishtit dhe rrethoi kryqin e tij, fakti që Krishti po e ofronte me dëshirë veten për ne mëkatarët si sakrificë për Perëndinë u ngjiti te Perëndia si aromë e mirë. Disa herë metaforat e Perëndisë

¹² Exodus, 362.

shprehin fuqimisht interesin e tij personal në sakrificat e Izraelit: “Do të kujdeseni të më paraqisni në kohën e caktuar ofertën time, me ushqimin e flijimeve të mia të përgatitura me zjarr, me erë të këndshme për mua.” (Num 28:2).¹³

Gjithsesi, dymbëdhjetë çyrekët nuk ishin të vetmet gjëra që u paraqitën mbi Tryezën para Zotit. Dymbëdhjetë çyrekët vetë u paraqitën në dy rreshta (apo në dy dëngje: përkthimi është i pasigurt); por përveç çyrekëve duhej shtuar edhe temjan i pastër mes dy rreshtave (apo, mbi dy rreshtat). Dhe qëndronte atje, si çyrekët, para Zotit derisa, në fund të çdo jave, ofrohej mbi altarin e madh në oborr “një kujtim mbi bukën, si një flijim i bërë me zjarr për Zotin.” (Lev 24:7).¹⁴

Bukët dhe temjani së bashku, qenë bërë nga një lloj i veçantë drithi për ofertë – gjë që shpjegon ngjashmëritë e tij me rregullat për ofertat e drithit te Levetiku 2. Nëse oferta e drithit që me majë mielli, vaj dhe temjan, atëherë një pjesë e saj, d.m.th. një grusht mielli dhe vaji dhe temjani, duhej të ofrohej së pari mbi altar si “një përkujtimore” e saj, si një ofertë e bërë me zjarr duke patur një aromë të këndshme për Zotin; dhe pastaj pjesa tjetër e ofertës iu jepej Aaronit dhe bijve të tij: një gjë shumë e shenjtë nga ofertat e bëra me zjarr për Zotin (Lev 2:1–3). Po ashtu udhëzimet për Bukën e Paraqitjes të dhëna te Levetiku 24:5-9, e bëjnë të qartë, siç edhe e kemi parë, që temjani ishte një ofertë e bërë me zjarr për Zotin (24:7). Pastaj ato theksojnë faktin që është e njëjta gjë edhe për çyrekët: Aaroni dhe bijtë e tij duhet t'i hanin ata “në një vend të shenjtë, sepse do të jenë një gjë shumë e shenjtë për atë midis flijimeve të bëra me zjarr para Zotit.” (24:9).

Atëherë, ne arrijmë në përfundimin se dymbëdhjetë çyrekët përfaqësojnë dymbëdhjetë fise dhe se ato qenë të paraqitura para Zotit vazhdimisht, kryesisht për kënaqësinë e tij.¹⁵ Kjo

¹³ Krh. ESV, dhe përkthimin e dhënë nga Aleni, EBC, 2:948.

¹⁴ RV = ‘që të mund të jetë për bukën një kujtim, një ofertë e bërë me zjarr për Zotin’. Shihni diskutimin e termit ‘pjesë përkujtimore (Hebrew אֲזְכָּרָה [‘azkārāh]) nga Wenham, *Leviticus*, 68, n. 3.

¹⁵ Nuk mund të thuhet që ato përfaqësonin furnizimin e Perëndisë për dymbëdhjetë fiset; sepse dymbëdhjetë fiset nuk do t'i hanin ato ndonjëherë. Vetëm priftërinjtë u lejuan t'i hanin.

nuk ishte një bestytini primitive pagane. Dymbëdhjetë çyrekët ishin vetëm një simbol; dhe çdo izraelit do të mësonte shumë shpejt atë që priftërinjtë shihnin me sytë e tyre, se Perëndia kurrë nuk i konsumonte bukët dhe as nuk i hiqte në mënyrë të mbinatyrshme.¹⁶ Dymbëdhjetë çyrekët, të prezantuar para Zotit, vazhdimisht përfaqësonin përmbushjen e qëllimit të Perëndisë në shpengimin e Izraelit: “Ju e patë atë që u bëra egjiptasve, dhe si ju solla mbi krahë shqiponje pranë meje... do të jeni thesari im i veçantë...” (Eks 19:4–5). Dhe sërish, “pjesa e Zotit është populli i tij” (LiP 32:9).

Përveç kësaj, fakti që përbërësit e çyrekëve u morën nga dymbëdhjetë fiset (krh. Lev 24:8) si një ofertë e bërë me zjarr për Zotin, nuk do të thotë që ata mendonin se përmes këtij kurbanit përfitonin shlyerje dhe falje. Nuk ishte ofertë mëkati, por një ofertë drithi. Të prekur nga mëshira e Perëndisë në shpengimin e tyre prej Egjiptit dhe në përfitim të një trashëgimie të madhe, fiset po prezantonin simbolikisht veten si një sakrificë e gjallë për Perëndinë (krhs. Rom 12:1). Së bashku me temjanin, qe një aromë e këndshme, një kurban i pranueshëm, i pëlqyeshëm para Perëndisë (krhs. Fil 4:18).

Madhështia e Tryezës

Kështu që dymbëdhjetë çyrekët përfaqësonin dymbëdhjetë fiset e Izraelit; por Tryeza që i mbante ata dhe i prezantonte para Zotit nuk përfaqësonte fiset e Izraelit. Vetëm vini re madhësinë e saj.

Ajo qe bërë nga druri i akacies dhe veshur me ar. Por jo me ar të një karati të zakonshëm: duhej të ishte safi, d.m.th. me pastërtinë më të lartë të mundshme.¹⁷ Përreth pjesës së lartme të tryezës kishte një kurorë ari. Me sa duket kjo ishte vetëm ar i plotë, d.m.th. jo thjesht dru i veshur me ar. Përqark tryezës (nëse qe vertikalisht apo horizontalisht nuk dihet) kishte një buzë një pëllëmbë të gjerë e cila gjithashtu rrethohej me një kurorë prej ari të plotë. Kur tabernakulli ishte në lëvizje, Tryeza duhej mbartur

¹⁶ Kur Krishti i ngjallur thotë që nëse dikush do të hapë derën, ai do të hyjë dhe do të hajë me të (Zbu 3:20), nuk ka parasysh që t’ia shtrojnë me të ngrëna bashkë.

¹⁷ Po të shprehemi me gjuhën e sotme duhej të ishte 24 karatsh.

mbi shpatulla. Për këtë qëllim, me të qenë lidhur katër unaza, secila në anën e katër këmbëve që dy shtiza të mund të futeshin tejprtej gjatësisë së Tryezës. Edhe këto unaza duhej të ishin prej ari, dhe shtizat e drunjtë duhej të ishin veshur me ar. Pastaj Tryeza duhej pajisur me enë të ndryshme që do të përdoreshin për shërbimin e Tryezës. U prodhuan pjata dhe enë, kana dhe poçe: dhe të gjitha këto duhej të ishin prej ari të pastër, dhe prej asgjëje tjetër. Nuk duhet të na çudisë fakti që Tryeza është quajtur ndryshe “tryeza e pastër” (Lev 24:6), si edhe Shandani është quajtur “Shandani i pastër” (Lev 24:4).

Pra, kjo nuk qe një tryezë e zakonshme e projektuar vetëm që të ishte funksionale. Ishte jashtëzakonisht madhështore në çdo detaj. Ajo ishte vetë furnizimi i Perëndisë për të mbajtur dhe paraqitur popullin e tij para pranisë së tij për kënaqësinë dhe ëndjen e tij. Fakti që çyrekët e bërë prej mielli të zakonshëm (edhe pse i imët) vendoseshin mbi një tavolinë aq madhështore, është mjaft i habitshëm në kontrastin që përcjell. Por fakti që këta çyrekë të cilët, sipas vendimit të Zotit, përfaqësonin simbolikisht dymbëdhjetë fiset e tij (që edhe pse ishin të shpenguar shpesh gabonin) tregon për gjerësinë e hirit të tij hyjnor që është i pamasë.

Por kësaj i ishte shtuar edhe një hir tjetër: priftërinjtë e Perëndisë u lejuan në fund të çdo jave të afroheshin pranë tryezës, për të ngrënë dymbëdhjetë çyrekët dhe, në një vend të shenjtë, të ishin pjesëmarrës në kënaqësinë që kishte Perëndia me popullin e tij.¹⁸

Altari i Artë i temjanit (Eksodi 30:1–10; 40:26–27)

Si Shandani, edhe Tryeza, siç e kemi parë, ishin orendi të paraqitjes. E tillë, në një farë kuptimi, qe edhe pjesa e tretë e orendisë që ishte në Vendin e Shenjtë; sepse mbi të Aaroni duhej të digjte temjan para Zotit dy herë në ditë: në mëngjes kur ai

¹⁸ Përdorimi i gjerë i arit në tabernakull nuk është një legjendë e fryrë. Shih Kitchen, *Reliability of the Old Testament*, 280; dhe për tempullin e Salomonit, shih Millard, *Treasures*, 70–3.

rregullonte llambat dhe në mbrëmje kur i ndizte ato (Eks 30:7–8). Ndryshe nga dy të tjerët, kjo orendi qe një altar me katër brirë, nga një në çdo cep, si Altari i madh i Bronztë në oborr (Eks 10,30:2 ;2–27:1).

Aq më tepër, ai kishte një marrëdhënie domethënëse rituale me Altarin e Bronztë. Thëngjijtë e zjarrit që digjin temjanin dhe lëshonin aromën e tij merreshin nga Altari i Bronztë ku ofertat e djegura dhe kurbanet thereshin (krhs. Lev 16:12; Num 16:35). Dhe gjaku i flijimeve të shlyerjes, i derdhur në Altarin e Bronztë, ngjyhej te brirët e Altarit të Artë. Kjo ndodhte një herë në vit në Ditën e Shlyerjes (Eksod 30:10), dhe gjithashtu në ato raste ku një flijim ofrohej për një prift apo për të gjithë asamblenë (Lev 4:7, 18; Heb 5:1–3). Temjani nënkuptonte shlyerjen fillestare.

Nga ana tjetër, Altari i Artë dallohej nga Altari i Bronztë në atë që asnjë kurban, ofertë mëkati, blatim drithërash apo libacion pijesh nuk ofrohej ndonjëherë mbi të: vetëm një lloj i veçantë temjani, i caktuar vetëm për kënaqësinë e Zotit. Përdorimi i tij për kënaqësinë e ndonjë njeriu qe rreptësisht i ndaluar (Eksod 30:9, 38).

Sidoqoftë, temjani mund të digjej edhe në vende të tjera përveçse mbi Altarin e Artë. Dy rastet e shquara të kësaj janë në fakt të dokumentuara në detaje te Pentatuku, dhe studimi i këtyre dy rasteve do të na ndihmojë të dallojmë rëndësinë e djegies së temjanit dy herë në ditë mbi Altarin e Artë. Sepse të tria do të përfshinin takim të drejtpërdrejtë me Perëndinë e gjallë.

Rasti i parë

Rasti i parë ndodhi kur u shfaq një rebelim i drejtpërdrejtë dhe i vazhdueshëm kundër Perëndisë në çështjet fetare. Koreu kishte vënë në diskutim autoritetin e apostullit të dërguar nga Perëndia, Moisiut, dhe kryepriiftit të Perëndisë, Aaronit¹⁹. Pavarësisht nga gjykimi publik i Perëndisë mbi Koreun, populli, si një i tërë, vazhdoi në kundërshtimin e tij ndaj Moisiut dhe Aaronit. Pas kësaj, reja mbuloi çadrën e takimit dhe lavdia e

19 Për një diskutim të plotë, shih Kap.13

Zotit u shfaq. Duke kuptuar që ky ishte reagimi i Perëndisë ndaj rebelimit të popullit dhe se çfarë pasojash do të sillte kjo përballje me Perëndinë, Moisiu i tha Aaronit:

“Merr temjanicën, vër brenda saj zjarr të marrë nga altari, vendos mbi të temjan dhe çoje shpejt në mes të asamblesë, dhe bëj shlyerjen e fajit për ta, sepse ka shpërthyer zemërimi i Zotit, dhe plaga ka filluar”. Atëherë Aaroni... vrapoi në mes të asamblesë; ...ai vuri temjanin në temjanicën dhe bëri shlyerjen për popullin. Dhe u ndal midis të gjallëve dhe të vdekurve, dhe fatkeqësia u ndal. (Num 16:46–49)

Populli, siç bën gjithmonë, qe përfshirë në rebelimin e demagogëve të tyre fetarë gojëtarë dhe, tani, mbante mëri ndaj gjykimit të Perëndisë mbi ata demagogë si të ishte diçka e tepërt. Ata duhej të mësonin se sa e rëndë ishte kritika rebeluese ndaj Perëndisë. Prandaj filloi edhe murtaja. Por i njëjti Perëndi që në gjykim tregohet i mëshirshëm, drejtoi Aaronin, vetë kryepriiftin që ata kishin kritikuar, për të djegur temjan para tij në emër të tyre dhe të bënte shlyerjen për ta. Dhe murtaja pushoi.

Rasti i dytë

Rasti i dytë qe pjesë e një ceremonie vjetore e caktuar “të bëjë shlyerjen për shenjtëroren, për shkak të papastërtive të bijve të Izraelit, të shkeljeve të tyre dhe të të gjitha mëkateve të tyre. [Aaroni] Do të veprojë në të njëjtën mënyrë për çadrën e mbledhjes, që mbetet midis tyre, në mes të papastërtive të tyre.” (Lev 16:16).

Izraeli nuk ishte më i keq se ne të gjithë; por Perëndia e dinte qysh më parë se, kur vendosi të banonte mes tyre, prania e Izraelit rreth vendbanimit të tij do ta përdhoste atë. Kjo ishte arsyeja që Perëndia u dha atyre flijimet e Ditës së Shlyerjes. Gjaku i këtyre sakrificave do të pastronte çadrën dhe orenditë e saj të shenjta (krhs. Heb 9:22).

Por kishte një problem. Gjaku i flijimeve të shlyerjes duhej të çohej në Vendin Shumë të Shenjtë dhe të spërkatej mbi pajtuesin në krahun lindor; dhe, si përfaqësues i njerëzve, Aaroni, kryepriifti i tyre, duhej ta çonte atje dhe ta spërkaste. Por

ai qe vetë një mëkatar! Vetë prania e tij ndoste çadrën, siç bënte edhe ajo e popullit! Si mund të hapte Velin, të hynte në Vendin Shumë të Shenjtë dhe të dilte para pajtuesit, që ishte pikërisht vendi që Perëndia i kishte premtuar Moisiut se “aty unë do të të takoj, nga lart, mbi pajtuesin, midis dy kerubinëve që janë mbi arkën e dëshmisë.” (Eks 25:22)?

Së pari, Aaroni duhej të ofronte një fljijim shlyerjeje për veten dhe ta shpinte gjakun e tij brenda, dhe ta spërkaste mbi pajtuesin. Megjithatë, sapo hapte Velin dhe hynte në Shenjtërore për të patur këtë takim të drejtpërdrejtë me Perëndinë, madje para se të kishte kohë të spërkaste gjakun mbi pajtuesin, ai duhet të digjte temjan mbi zjarrin e temjanicës së tij para Zotit, “me qëllim që reja e temjanit të mbulojë pajtuesin që është mbi dëshminë; kështu ai nuk do të vdesë.” (Lev 16:13).

Komentuesit thonë që reja duhej të mbulonte pajtuesin ku vetë Perëndia bëhej i pranishëm, për të penguar Aaronin që të shikonte Perëndinë, sepse “asnjë njeri nuk mund të më shikojë dhe të jetojë.” (Eks 33:20). Kjo ka shumë mundësi të ndodhte. Por temjani do të përhapte aromën e tij, që ishte caktuar vetëm për të kënaqur Perëndinë (Ekodi 30:37–38), mbi pajtuesin. Dhe në sytë e Perëndisë kjo aromë do të mbulonte edhe vetë Aaronin; dhe prania e tij do të ishte e mirëpritur.

Djegia e temjanit dy herë në ditë (Eksodi 30:7–8)

Kjo bëhej në çadrën e parë mbi Altarin e Artë të Temjanit, dhe domosdoshmërisht jashtë Velit, sepse në ditët e zakonshme Aaroni nuk lejohej të hynte në ndarjen e dytë. Por pozicionimi i Altarit të temjanit qe jashtëzakonisht domethënës. “Do ta vendosësh altarin përpara velit që ndodhet përpara arkës së dëshmisë, përballë pajtuesit që ndodhet mbi dëshminë, ku unë do të të takoj.” (Eksodi 30:6). Pra, ndonëse Aaroni duhej të qëndronte jashtë Velit, kur të vinte koha të digjte temjan në këtë altar, atij i duhej të afrohej sa më shumë që të ishte e mundur – duke patur vetëm Velin si ndarje – te vendi i caktuar ku Perëndia ishte zotuar të takohej me njeriun. Ai qe një takim i drejtpërdrejtë me Perëndinë.

E njëjta çështje theksohet në udhëzimet për bërjen e temjanit

të veçantë që Aaroni duhej të digjte përditë: “do ta kthesh një pjesë të tij në pluhur shumë të hollë dhe do të vendosësh pak nga ai përpara dëshmisë në çadrën e mbledhjes, ku unë do të të takoj.” Aaronit nuk duhet t’i mungonte asnjëherë ajo sasi e mjaftueshme temjani për këto takime me Perëndinë në emër të popullit.

Arsyeja për djegien e përditshme të temjanit

Aaroni duhej të digjte temjan dy herë në ditë: në mëngjes kur ai rregullonte llambat, dhe sërish në mbrëmje kur i ndizte. Tani vaji për llambat merrej nga ullinjët e shtypur. Pastaj vaji duhej rafinuar për të hequr copëza të tulit dhe të lëkurës së ullirit që mund të kishin rënë në vaj (Lev 24:2). Edhe pas kësaj, rregullimi i fitilave kur ishin konsumuar dhe bërë me yndyrë do të ishte një punë jo fort e këndshme; dhe një fitil i ri, kur ndizet, mundet së pari të nxjerrë më shumë tym se dritë. Kjo ishte natyrisht një dobësi natyrore nga vetë lloji i llambave të vajit që përdorej në shërbimin ceremonial të Perëndisë. Prandaj disa kanë sugjeruar që djegia dy here në ditë e temjanit qe fillimisht e menduar të mbulonte erën e pakëndshme të llambave që përndryshe do të ishte e papëlqyeshme në praninë e Perëndisë dhe ndoshta e neveritshme për të.

Të tjerët mund ta kundërshtojnë këtë shpjegim mbi bazat se do ta ulte Perëndinë e Izraelit në nivel të perëndive pagane, të cilat përfytyroheshin sikur kënaqeshin nga aromat e mira dhe nuk pëlqenin të këqijat. Dogmatizmi për këtë çështje është jo i domosdoshëm dhe i pajustificuar. Shkrimi nuk shpjegon pse djegia e temjanit duhej të përputhej me ndreqjen dhe ndezjen e llambave të vajit.

Por ajo për të cilën mund të jemi të sigurt është kjo: Perëndia qe i kënaqur me aromën e temjanit; sepse ishte ai që përcaktoi përbërësit e saj dhe urdhëroi të bëhej për kënaqësinë e tij dhe të askujt tjetër (Eks 38–30:34). Nuk është e pamundur që në vitet e fëmijërisë shpirtërore të Izraelit (krhs. Gal 4:1–3), aroma e temjanit mund të mbarnte një kuptim metaforik, për të mos thënë simbolik. Ne e dimë, nga deklaratat e veçanta të Perëndisë në vende të tjera, që Perëndia nuk e pëlqen aromën e keqe

qoftë morale, qoftë ceremoniale; dhe ai nuk ka frikë të shprehë neverinë e tij në gjuhë metaforike: ai e paralajmëron Izraelin që nëse flijimet e shoqëruara nga aroma të mira u bashkëngjiten jetëve të shthurura dhe apostasive fetare, “Do tì katandis qytetet tuaja në shkretëtira, do të shkretoj vendet tuaja të shenjta dhe nuk do të thith më erën e këndshme të parfumeve tuaja.” (Lev 26:31).

Sërish, kur Izraeli përvetësoi rituale pagane me recetat e tyre boshe për shenjtëri, neveria e Perëndisë qe bërë publike: “Këto gjëra janë për mua një tym në hundë, një zjarr që digjet tërë ditën.” (Isa 65:5).

Kjo është e vërtetë edhe për ne sot. Jo të gjitha format e adhurimit janë të pranueshme nga Perëndia. Nga ana tjetër, dhënia sakrifikuere për kauzën e Krishtit është “një parfum erëmirë, një fli i pranueshëm, i pëlqyeshëm nga Perëndia.” (Filip 4:18). Perëndia ende i pëlqen aromat e mira!

Dhurata e hirshme e Perëndisë e një kryepriifti

Duke patur parasysh shthurjen e Izraelit, papastërtinë dhe adhurimin e tyre të dobët e të papërsosur, Perëndia u tregua i mëshirshëm që u dha një kryepriift dhe përfaqësues i cili mund të ndërhynte mes tyre dhe Perëndisë dhe të ofronte temjan në emrin e tyre para Perëndisë. Pllaka e hollë prej ari që Aaroni duhej të mbante në ballin e tij mbartte fjalët: “Shenjtëri Zotit”. Domethënia e tyre qe kjo:

Aaroni do të mbajë fajin të shoqëruar me gjërat e shenjta të paraqitura nga bijtë e Izraelit, në çdo lloj ofertash të shenjta; ajo do të rrijë vazhdimisht mbi ballin e tij, në mënyrë që ato të jenë të mirëpritura nga Zoti. (Eksodi 28:36–38)

Këto nuk qenë fjalë të kota. Që nga fillimi i shërbesës së Aaronit, dy nga bijtë e tij...

...morën secili temjanicën e vet, i vunë brenda zjarr, vendosën mbi të temjanin dhe ofruan para Zotit një zjarr të palejueshëm, që ai nuk ua kishte urdhëruar. Atëherë një zjarr doli nga prania e Zotit dhe i përpiu ata; dhe ata

vdiqën përpara Zotit. Prandaj Moisiu i tha Aaronit: “Kjo është ajo për të cilën foli Zoti, duke thënë: “Unë do të jem shenjtëruar nga ata që më afrohen mua dhe do të jem përlavdëruar përpara tërë popullit”. (Lev 10:1–3)

Për veshët modernë kjo mund të tingëllojë barbare; por ndodh kështu sepse bota jonë moderne perëndimore e ka humbur vetëdijen për lavdinë dhe shenjtërinë e pamasë të Perëndisë. Nëse një person tjetër do të guxonte të përmirësonte një tablo të Rembrantit thjesht duke hedhur bojë mbi të, bota artdashëse do të tërbohej. Perëndia i gjallë është “një zjarr që djeg”; dhe ne duhet të mësojmë t’i shërbejmë atij me respekt dhe nder (Heb 12:28–29). Humbja e kësaj ndjenje respekti është e rrezikshme për ne.

Aaroni vetë dështoi në fund. Në Sinai ai ishte shumë tolerant me njerëzit (Eksodi 32:1–5, 21). Më vonë ai e keqpërfaqësoi Perëndinë dhe e pagoi për këtë (Num 20:12–13, 23–29). Kjo nuk bëri gjë tjetër veçse theksoi nevojën për ngritjen e një priift tjetër, jo sipas rendit të Aaronit, por sipas rendit të Melkisedekut.

...
Pyetjet e studimit për këtë kapitull mund t’i gjeni
në faqen 441.

20

Tabernakulli si hije e gjërave që do të vinin në të ardhmen

Deri tani kemi studiuar tre shembuj të funksionit të parë të tabernakullit si hije apo τύπος (apo ἀντίτυπος) të gjërave qiellore. Tani ne do të ecim përpara për të shqyrtuar funksionin e tij të dytë si “një hije e gjërave të mira që duhet të vinin”. Këto gjëra të mira qenë përfitimet e lavdishme që do të na jepeshin prej Zotit tonë Jezus Krisht. Por Dhiata e Re tregon se këto gjëra të mira nuk do të na jepeshin të gjitha njëherazi dhe në të njëjtën kohë. Prandaj duhet të presim që të zbulojmë se hijet e këtyre gjërave të mira që do të vinin u përmbushën:

1. disa prej tyre prej mishërimit dhe shërbesës së tij tokësore;
2. të tjera prej vdekjes dhe flijimit të tij në emrin tonë;
3. të tjera prej ringjalljes, lartësimit dhe shërbesës së tij të tanishme;
4. të tjera në kthimin e tij të dytë; dhe
5. edhe disa të tjera përmes bashkimit të hirshëm të vetë atij me popullin e tij si trupi i tij.

Banesa e Perëndisë: *mishkân-i*

Kuptimi i drejtpërdrejtë i fjalës “tabernakull”

Perëndia i tha Moisiut: “Le të më bëjnë [izraelitët] një shenjtërore, që unë të banoj në mes tyre” (Eks 25:8); dhe folja që Perëndia përdori për “banoj” qe fjala hebraike מִשְׁכָּן (*shākan*). Vendbanimi

përfundimtar i Perëndisë quhet në hebraisht מִשְׁכָּן (*mishkân*), një emër i prejardhur nga folja *shākan* (Eksod 25:9). Në Septuagint fjala e këtij pasazhi, *mishkân*, përkthehet nga folja greke σκηνή që do të thotë “një çadër” apo “tabernakull”; dhe mund të bjerë kollaj në sy sa të ngjashme janë foljet hebraike dhe greke: hebraikja me tre bashkëtingëlloret e saj, *sh-k-n*, dhe greqishtja me tre bashkëtingëlloret e saj, *s-k-n*.¹

Kur Moisiu ngriti për herë të parë këtë banesë për Perëndinë, na thuhet që “reja e mbuloi çadrën e mbledhjes dhe lavdia e Zotit e mbushi tabernakullin.” Kjo ishte vërtet spektakolare, shumë e fuqishme, sa që Moisiu nuk mund të hynte në çadrën e mbledhjes, sepse reja e kishte mbuluar nga sipër dhe lavdia e Zotit mbushte tabernakullin (Eksod 40:34–35).

Prania e Perëndisë ishte e vërtetë; por tabernakulli ishte vetëm një hije, jo lëndore, e përkohshme, kalimtare, e krahasuar me realitetin e madh të qëndrueshëm drejt të cilit ai tregonte. Apostulli Gjon e pa personalisht këtë realitet të madh dhe ai e përshkroi kështu: “Fjala u bë mish dhe banoi ndër ne; plot hir e të vërtetë”; dhe fjala që ai përdor për “banoi” është fjala greke ἐσκήνωσεν që ka tre bashkëtingëlloret në rrënjën e saj – s, k, n – që do të thotë “çadër” apo “tabernakull”. Disa e kanë përkthyer fjalinë “Fjala u bë mish dhe ‘ngriti çadrën’ mes nesh.”

Pastaj Gjoni shton: “ne soditëm lavdinë e tij, si lavdia e të vetëmlindurit prej Atit, plot hir e të vërtetë” (Gjoni 1:14). Fjala, që ekzistonte që nga fillimi, që ishte me Perëndinë dhe ishte Perëndi, tani pa ndalur së qeni Perëndi, u bë realisht njeri, me një trup të vërtetë njerëzor. Ai trup u kryqëzua dhe u varros. Por ditën e tretë u ngjall nga të vdekurit dhe, gjatë 40 ditëve para se të ngjitej në qiell, u dha dishepujve të tij prova të pakundërshtueshme që ai ende kishte një trup të vërtetë njerëzor me mish e kocka, ndonëse të përlevduar. Atë trup ai do ta ketë për gjithë përjetësinë; dhe një ditë ne gjithashtu do ta shohim atë dhe do të sodisim lavdinë e tij. “Tek ai banon trupërisht gjithë plotësia e Hyjnisë” (Kol 2:9).

¹ Nuk kemi nevojë të diskutojmë historinë gjuhësore pas kësaj ngjashmërie.

Kuptimi i ngushtë i termit “tabernakull”

Termi *tabernakull* (*mishkān*) është përdorur në Shkrime, si edhe në të folurën e zakonshme, për t’iu referuar të gjithë ngrehinës që ndërtoi Moisiu.² Por në kuptimin e ngushtë termi *tabernakull* përdoret jo për të gjithë ngrehinën, aq më pak për orenditë e saj, por për dhjetë pëlhurat e linjta që përshkruhen tek Eksodi 26:1–6. Këto dhjetë pëlhura, në kuptimin e ngushtë të fjalës, ishin tabernakulli, *mishkān*, vendbanimi i Perëndisë. Dhe në këtë kontekst ky kuptim i ngushtë përdoret vazhdimisht.

Për shembull, kur ngrehina u ndërtua, këto pëlhura u hodhën përsipër skeletit prej ari para dhe mbrapa. Ai skelet qe me “dërrasa prej druri për tabernakullin” (Eks 26:15). Këto mbanin dhjetë pëlhura, *mishkān*, dhe mundësonin kështu që ato të funksionin si vendbanimi i Perëndisë. Por dërrasat nuk ishin tabernakulli: pëlhurat ishin.

Pastaj shpjegohet me hollësi sesi këto pëlhura, ndonëse të shumta dhe të ndara, bashkërisht formonin një *mishkān*. Fillimisht ato u ndanë në dy grupe. Pesë pëlhura u vendosën pranë njëra-tjetrës dhe u qepën bashkë; dhe pastaj po ashtu u veprua ndaras me pesë të tjerat. Pastaj, secili grup u pajis me 50 sythe ngjyrë blu në skajet e tyre.³ Pastaj pesëdhjetë kapëse ari do të bashkoheshin me pesëdhjetë sythet në një skaj dhe 50 kapëse të tjera në skajin tjetër, duke ngjitur dy grupet bashkë “në mënyrë që tabernakulli të formojë një të tërë” (Eksodi 26:6).⁴

Vendbanimi i lashtë i Perëndisë, *mishkān*, qe një shumësi në unitet; dhe ka të ngjarë që ky sistem i hollësishëm u ngrit kështu për një arsye praktike – si lehtësim i paketimit dhe magazinimit

2 Krh. Eks 40:34–35.

3 ‘Fund i një pëlhure të thurur mbarohej në këtë mënyrë që të mos shthurej filli. Po ashtu, qepej një copë rrobë që nuk ishte thurur në të njëjtën mënyrë si pëlhura, për të prerë apo mbuluar tegelin kur shkohej në fund të pëlhurës.’ (Oxford English Dictionary, 2nd ed., 1989, s.v. ‘skajet e pëlhurave’).

4 Ky kuptim i ngushtë u mbajt kur vargjet e mëposhtme na sqarojnë se 11 copë pëlhura dhie do të funksiononin si një “çadër” (Heb. אוהל, ‘ōhel) mbi “tabernakullin” (*mishkān*). Si 10 pëlhurat e tabernakullit, 11 pëlhurat e dhisë u qepën në dy grupe, njëri me 5 dhe tjetri me 6. Pastaj të dyja këto grupe u pajisën me 50 sythe secila dhe u lidhën bashkë me 50 kapëse bronzi: duke e bashkuar kështu çadrën në mënyrë që të formojnë një të tërë. (Eksod 26:11).

gjatë udhëtimit – dhe që nuk kishte ndonjë domethënie shtesë si një hije e gjërave të mira të së ardhmes.

Por nuk na bën dëm në këtë pikë të kujtojmë faktin e vërtetë se vendbanimi i tanishëm i Perëndisë është po ashtu një shumësi në unitet. Sepse në ditën e Pentakostit ai, që përgjatë jetës së tij tokësore banoi mes nesh, pagëzoi popullin e tij në Frymë të Shenjtë dhe i bashkoi ata në një trup:

Sepse ashtu si trupi [njerëzor] është një, por ka shumë gjymtyrë, dhe të gjitha gjymtyrët e të njëtit trup, megjithëse janë shumë, formojnë një trup të vetëm, kështu është edhe Krishti. Sepse të gjithë ne jemi pagëzuar në një Frymë të vetëm në të njëjtin trup, qofshin hebrenjtë apo grekët, qofshin skllevërit a të liruarit.. (1 Kor 12:12–13)

Dhe më vonë Pali shton që nga të dy, hebre dhe johebre, Krishti ka bërë një njeri të ri, dhe po e ngre këtë unitet të tanishëm si një vendbanim për Perëndinë në Frymë.⁵

Veli: *pārōketh*

Te Hebrenjve 9:3 פָּרוּכֶת (*pārōketh*) quhet ‘veli i dytë’, për ta dalluar nga ndarësja (Heb.: מָסָךְ, *māsāk*) që varej në hyrje të ndërtesës së tabernakullit. *Pārōketh*-i për dallim, varej pas 2/3 të largësisë në brendësi të ndërtesës. *Māsāk*-i ndante Vendin e Shenjtë, me Tavolinën, Shandanin dhe Altarin e Artë të tij, nga sytë e publikut të gjerë. Por ajo që *pārōketh*-i fshihte ishte vetë Arka dhe Pajturesi, prania dhe froni simbolik i Perëndisë; dhe ai i fshihte ato, madje edhe nga sytë e vetë priftërinjve.⁶

Priftërinjtë hynin brenda *māsāk*-it çdo ditë të javës; brenda *pārōketh*-it nuk futej askush përveç kryepriftit dhe ai mund ta bënte këtë vetëm në ditën e Shlyerjes. Ishte kundërpjesa e *pārōketh*-it në tempullin e Herodit që, kur vdiq Krishti, u shqye mëdysh nga maja në fund (Mat 27:51).

5 Ef 2:15–16, 21–22. Në këtë pasazh metafora ka ndryshuar nga një çadër në lëvizje tek ajo e një tempulli të përhershëm të ngritur mbi një themel. Por kuptimi bazë mbetet i njëjtë.

6 Funksioni i *pārōketh* si një perde e bën përkthimin e vjetër, ‘Veli’, më të pëlqeshëm se ai modern, ‘Perdja’.

Efekti i Velit

Nga ana arkitekturore, efekti i Velit ishte të ndante pjesën e brendshme të tabernakullit në dy pjesë të veçura, të quajtura zakonisht “Vendi i Shenjtë” dhe “Vendi Shumë i Shenjtë”.⁷ Por te Hebrenjve 9:2, 3, 8 ndarja e parë quhet “tabernakulli i parë”, dhe ndarja e dytë “tabernakulli i dytë”.

Prandaj është e rëndësishme të kuptojmë domethënien e këtyre termave teknikë. Kur Hebrenjve flet për “tabernakullin e parë”, nuk ka parasysh tabernakullin që Moisiu ndërtoi si të ndryshëm nga kopjet e mëvonshme. Të gjitha kopjet e mëvonshme, përfshirë këtu edhe tempullin e Herodit, kishin një Vel që e ndante ngrehinën në dy pjesë dhe i jepte tabernakullit të parë, Vendit të Shenjtë, një status të veçantë prej “tabernakullit të dytë”, Vendit Shumë të Shenjtë. Përmes emërimit të tij si “tabernakulli i parë”, Hebrenjve po i referohet ndarjes së parë brenda tabernakullit të Moisiut dhe brenda të gjitha kopjeve të tij të mëvonshme.

Kështu duke përdorur këto terma, Hebrenjve qartëson se, për aq kohë sa tabernakulli i parë kishte një status të veçantë, rruga për në Shenjtërore nuk ishte e hapur për të gjithë.⁸ Kjo ishte e dukshme! Sepse ai që i jepte tabernakullit të parë statusin e tij të veçantë, të ndryshëm prej tabernakullit të dytë, ishte pikërisht Veli. Për aq kohë sa ai që i varur atje, ishte e dukshme që rruga për në Shenjtërore nuk që e hapur. Hiq Velin, dhe tabernakulli i parë nuk do të kishte më një status të ndarë. E gjithë pjesa e brendshme e ngrehinës do të ishte një e tërë e pandashme. Rruga për në Vendin Shumë të Shenjtë do të ishte tërësisht e hapur.

Domethënia e Velit

Ne mund të ngremë pyetjen: pse Fryma e Shenjtë vendosi që të kishte këtë Vel në tabernakull për të penguar për shekuj të

⁷ Në kontekste ku është e qartë se për cilin Vend të Shenjtë flitet, Shkrimet shpesh flasin për Vendin Shumë të Shenjtë thjesht si Vendi i Shenjtë, p.sh. Lev 16:2; Heb 9:8; 10:19.

⁸ Vini re kohën e shkruar. Tempulli i Herodit ende qëndronte në këmbë kur u shkrua Letra e Hebrenjve; dhe ende kishte një vel.

tërë rrugën për në Vendin Shumë të Shenjtë? Përgjigjja është që sakrificat e Izraelit qenë të papërsosura: asnjë prej tyre nuk mund të përsoste ndërgjegjen e adhuruesit (Heb 9:9). Kur një izraelit, me pendesë dhe besim të vërtetë, ofronte një sakrificë të caktuar, mëkati apo mëkatet e tij të caktuara i faleshin (Lev 4:20). Por kur mëkatonte sërish, ai duhej të sillte një sakrificë tjetër. Nuk kishte fund kjo punë. Ndërgjegjja e besimtarit nuk mund të gjente siguri se faji i të gjitha mëkateve të tij ishte shlyer njëherë e përgjithmonë. Prandaj nuk mund të hynte në Shenjtërore. Madje edhe Mbreti David, që shprehu lumturinë e të qenit i falur (Ps 32), nuk do të guxonte të hynte në Vendin Shumë të Shenjtë.

Duke u nisur nga Letra e Hebrenjve, duket se një pjesë e lexuesve, të cilëve ajo u drejtohej, ende ishin të prirur për t’u dhënë pas tempullit të Jerusalemit, priftërisë dhe ceremonive të tij. Prandaj autori u kujton që vetë tempulli, pas të cilit ata ishin dhënë, ende kishte një Vel që pengonte rrugën në Shenjtërore dhe, kështu, dëshmonte se sakrificat e tyre ishin të pamjaftueshme (Heb 9:9); ndërsa flijimi i vetëm i Krishtit për mëkatet i bënte të përshtatshëm që të hynin në Vendin Shumë të Shenjtë, dhe jo vetëm në atë të tempullit tokësor, por edhe në vetë qiellin (Heb 10:12–22).

Një problem me Velin

Vargu që përshkruante rrugën në Shenjtërore, të cilën Krishti e inaguroi për ne, konsiderohet si një problem për disa komentatorë. Te versioni RV (anglisht) thuhet:

...boldness to enter into the holy place by the blood of Jesus, by the way that he dedicated for us, a new and living way, through the veil, that is to say his flesh...” (Heb 10:19–20 RV)

...guxim për të hyrë në shenjtërore me anë të gjakut të Jezusit, me anë të një udhe të re dhe të gjallë që ai përuroi për ne, përmes velit, domethënë mishit të tij . . . (Heb 10:19–20 përkthimi i RV-së)

Ky varg duket se po thotë që Veli, po ashtu, ishte hije e

një gjëje të mirë të së ardhmes, d.m.th. mishi i Krishtit, me një fjalë natyra dhe trupi i tij njerëzor. Por peshkopi dhe studiuesi i famshëm, B. F. Westcott, nuk mund të binte dakort që Shkrimi ta quante mishin e Krishtit si “një vel, një pengesë, për vizionin e Perëndisë në një vend ku theksohet natyra e tij njerëzore”.⁹ Prandaj ai i interpretoi këto vargje duke identifikuar mishin e Zotit tonë jo me Velin, por me rrugën e re dhe të gjallë përmes Velit. Edhe përkthimi anglisht NEB bën të njëjtën gjë: “... rrugën e re dhe të gjallë që ai e ka hapur për ne përtej perdes, rruga e mishit të tij.”

Por duket se kjo çështje nuk e vë re faktin se Veli ishte një mjet i hirit. Patjetër që pengonte hyrjen në praninë e menjëhershme të Perëndisë; por u jepte mundësi priftërinjve që të hynin së paku në Vendin e Shenjtë, te Shandani, Tryeza, Altari i Artë i temjanit dhe te të gjitha ato që këto gjëra përfaqësonin. Nëse nuk do të kishte patur Vel, nuk do të hynin edhe në Vendin e Shenjtë; sepse pa Velin, Vendi i Shenjtë gjithashtu do të ishte pjesë e pranisë direkte të Perëndisë. Ndërsa me Velin aty, ata nuk mund të futeshin vetëm te Vendi Shumë i Shenjtë, por mund të afroreshin deri te Veli, të shihnin ngjyrat, figurat dhe simbolizmin e tij dhe të mësonin diçka rreth madhësisë së Perëndisë.

Prandaj, Veli ishte një hije e mrekullueshme e Krishtit në mishërimin, jetën dhe shërbesën e tij mbi dhë. Turmat mund t'i afroreshin, mëkatarët mund ta preknin atë, fëmijët e vegjël mund të gjenin fole në krahët e tij. Ndërkohë e gjithë plotësia e hyjnisë banonte tek ai trupërisht. Në të vërtetë, ai e përfaqësonte Atin në mënyrë të tillë sa që mund të thoshte: “Kush më ka parë mua, ka parë Atin” (Gjoni 12:45; 14:9).

Kjo është kaq e mrekullueshme për ta shprehur, por edhe më i mrekullueshëm është fakti që ai nuk ka më funksionin e një Veli. I njëjti Jezus, ende realisht njerëzor dhe me një trup të vërtetë njerëzor, të shpuar nga gozhdët dhe shtiza, ka hyrë në vetë qiellin, në praninë e vetë Perëndisë si pararendësi ynë, si edhe përfaqësuesi dhe kryeprihti ynë. Duke e bërë këtë, ai ka përruar një rrugë të re dhe të gjallë për ne që të hyjmë në

praninë e menjëhershme të Perëndisë; dhe që tani ne mund të hyjmë aty frymërisht po me aq guxim, si edhe atë ditë kur të hyjmë me trupat tanë të rimodeluar dhe të ngjashëm me trupin e tij të lavdishëm.

Altari dhe Legeni në Oborr

Dy orendi qëndronin në oborrin e tabernakullit: e para, Altari i Madh i Bronztë, e dyta, Legeni. Të dyja përdoreshin për pastrim: Altari përmes gjakut, Legeni përmes ujit.¹⁰ Si hije të gjërave të mira që do të vinin, ato na nxisin të pyesim nëse edhe ungjilli i krishterë ofron pastrim qoftë përmes gjakut, qoftë përmes ujit. Përgjigjja është: po. 1 Gjonit 1:7 shpall që gjaku i Jezusit, Birit të tij, na pastron nga çdo mëkat; dhe Efesianëve 5:25–26 thotë që “sikurse edhe Krishti ka dashur kishën dhe e ka dhënë veten e vet për të, që ta shenjtërojë, pasi e pastroi me larjen e ujit me anë të fjalës”.

Kjo ngre një pyetje të dytë: pse na duhen dy pastrime? Pse pastrimi ynë përmes gjakut të Krishtit nuk mjafton në vetvete? Përgjigjja ndaj kësaj pyetjeje gjendet duke shqyrtuar së pari se çfarë pastron gjaku, pastaj se çfarë pastron uji, dhe pastaj të dimë dallimin mes këtyre të dyjave.

Pastrimi përmes gjakut

Gjaku pastron ndërgjegjen. Kështu thotë Hebrenjve 9:13–14:

Sepse, në qoftë se gjaku i demave dhe i cjepeve dhe hiri i një mëshqerre i spërkatur mbi të ndoturit, i shenjtëron, duke i pastruar në mish, aq më shumë gjaku i Krishtit, i cili me anë të Frymës së Shenjtë e dha veten e tij të papërlyer nga asnjë faj ndaj Perëndisë, do ta pastrojë ndërgjegjen tuaj nga veprat e vdekura për ti shërbyer Perëndisë së gjallë!

Veprat e vdekura, të cilat janë vepra që shpien në vdekje dhe e armiqësojnë njeriun me Perëndinë, rëndojnë dhe ndotin ndërgjegjen, dhe e bëjnë kështu një person të papërshtatshëm

⁹ Hebrews, 32.

¹⁰ Eksodi 27:1–8; 30:17–21; 38:8; 40:6–12.

për miqësi me Perëndinë plotësisht të shenjtë. Askush nuk mund të provojë hyrje, aq më pak paqe, në praninë e Perëndisë derisa ndërgjegjja të pastrohet prej ndjenjës së fajit. Gjaku i Krishtit pastron ndërgjegjen, jo sikur të ishte ndonjë pluhur larës, por sepse ai dëshmon për vdekjen e tij që pagoi ndëshkimin e shpallur prej zemërimit të Perëndisë kundër mëkateve tona. Rezultati është që ndërgjegjja e besimtarëve pastrohet nga faji, ai ka paqe me Perëndinë dhe liri për në praninë e tij: pikërisht atë që flijimet dhe ceremonitë e tabernakullit nuk mund të krijonin (Heb 9:9).

Por nëse gjaku i Krishtit është kaq i efektshëm, pse duhet të pastrohem edhe me ujë gjithashtu?

Pastrimi me ujë

Gjuha metaforike e Efesianëve 5:25–27 na ndihmon për këtë. Ajo është e mbështetur te dashuria dhe përkujdesja e bashkëshortit për gruan e tij. Nëse për shkak të shpejtësisë së lartë dhe pakujdesisë gruaja prish makinën e re të bashkëshortit të saj, ajo padyshim që do të kërkojë ndjesë dhe lyp për faljen e tij, që ai me dëshirë – herët ose vonë – do t’ia japë. Por nëse gruas së tij do t’i dilnin plagë apo puçrra në fytyrë, ai nuk do të thoshte “Unë të fal për këto!”: falja do të ishte e pavend dhe e panevojshme. Përkundrazi, për shkak të dashurisë së tij për të, bashkëshorti do të kërkonte trajtimin më të mirë mjekësor për të hequr këto të meta.

Prandaj kur Krishti, në dashurinë e tij për kishën, e pastron atë që të mund ta paraqesë para vetes “pa njolla a rrudha a ndonjë gjë të tillë”, çfarë përfaqësojnë këto njolla dhe rrudha në kuptimin e drejtpërdrejtë? Jo mëkatin që duhet falur, por të metat e karakterit që duhen hequr: egoizmin, lakminë, xhelozinë, krenarinë, përbuzjen dhe gjëra si këto. Nëse të metat e karakterit do të na shtynin të bënim akte të mëkatshme, atëherë, natyrshëm këto akte do të duhej të faleshin përmes gjakut të Krishtit. Por të metat vetë nuk pastrohen prej gjakut të Krishtit. Por si i bëhet atëherë?

Larja e ripërtëritjes

Këshilla e Palit për Titin hedh dritë mbi këtë pyetje. Ai i kujton Titit që kretasit e asaj kohe, sipas vetë pohimeve të tyre, ishin “gënjeshtarë, egërsira të këqija, barkpërtacë” (Tit 1:12). Por Pali nuk harron që “edhe ne dikur ishim të pamendë, rebelë, endacakë, robër të lakmive të ndryshme dhe të qejfeve, duke jetuar në ligësi dhe në smirë, të urryer dhe duke e urryer njëritjetrin.” (3:3). Karakteri i lig të shpie në një stil jete dhe sjelljeje të keqe.

Por kur Pali vazhdon të përshkruajë sesi ata u shpëtuan, është e dukshme se në këtë kontekst ai nuk përmend gjakun shlyes të Krishtit, por përqëndrohet mbi elementin tjetër të shpëtimit. Perëndia, thotë ai, në mirësinë dhe mëshirën e tij na shpëtoi “me anë të larjes së rilindjes dhe të ripërtëritjes së Frymës së Shenjtë, të cilën e derdhi me mbushëlli mbi ne, me anë të Jezu Krishtit, Shpëtimtarit tonë” (3:5–6). Atëherë, lindja e re dhe përtëritja e mendjes (Rom 12:2), të dyja kryhen prej Frymës së Shenjtë.¹¹

Kështu gjaku i Krishtit na pastron nga faji ynë dhe na jep paqe me Perëndinë. Por lufta kundër të metave të karakterit tonë nuk ngelet në forcat tona. Perëndia nuk është faraon. Ai nuk pret që të bëjmë tulla pa kashtë. Ai na jep jo vetëm faljen, por, së bashku me të, jetë të re të shoqëruar nga natyra dhe fuqi të reja.

Larja që bëhej një herë dhe larja që përsëritej.

Legeni i tabernakullit siguronte ujë që priftërinjtë të lahashin dhe qëndronte në një pozitë të favorshme mes dy pikave rreth të cilave përqendroheshin detyrat e tyre, d.m.th. Altari i Bronztë dhe Çadra e Mbledhjes (Eks 30:19–21).

Kur emëroheshin në detyrë, priftërinjtë paraqiteshin te dera (te *māsāk*) e çadrës së mbledhjes dhe u bëhej një banjo e plotë. Kjo ishte një larje ceremoniale e cila bëhej njëherë të vetme dhe i bënte priftërinjtë të përshtatshëm për shërbesën e tyre (Eks 29:4). Pas kësaj ata vetëm duhet të lanin vazhdimisht duart

¹¹ Metaforat e ujit: ‘larje’ dhe ‘derdhje’.

dhe këmbët e tyre sa herë që hynin në çadrën e mbledhjes apo shërbenin tek Altari i Bronztë (Eksodi 30:19–21).

Atëherë, nëse këto pastrime me ujë qenë gjithashtu “hije të gjërave të mira që do të vinin”, ne mund të pyesim me të drejtë nëse ungjilli i krishterë jep mundësi, po ashtu, për dy lartje me ujë: një që është përfundimtare dhe tjetra që bëhet vazhdimisht. Përgjigja është: po; dhe vetë Zoti ynë në dhomën e sipërme përdori pikërisht elementin e ujit për të ilustruar pastrimin shpirtëror që këto ceremoni të tabernakullit dikur paraprinin si hije. (Gjoni 13:1–11).¹²

Pjetri, në një moment zelli të tepruar, sugjeroi që Zoti t’i pastronte jo vetëm këmbët, por edhe kokën e tij po ashtu. Krishti iu përgjigj: “Ai që është i larë, ska nevojë veçse të lajë këmbët dhe është krejt i pastër...” (10–13:8).

Metafora e Krishtit mbështetej mbi zakonet e kohës së tij, siç edhe kanë komentuar shumë studiues prej një kohe të gjatë. Kur e ftonin në një festë dikë, ai do të lahej më parë në shtëpi dhe pastaj do të ecte më këmbë te vendi i festës. Kur të mbërrinte atje, nuk kishte pse të lahej i tëri sërish, por thjesht kishte nevojë të hiqte pluhurin e rrugës nga këmbët e veta.

Zakonisht i zoti i shtëpisë do të urdhëronte një nga shërbëtorët ta bënë këtë për mysafirin. Por nëse kjo është në themel të metaforës, çfarë do të thotë kjo në nivelin shpirtëror?

Larja e plotë

Sigurisht kjo është ajo që Zoti ynë kishte në mendje kur tha: “kush nuk ka lindur nga uji dhe nga Fryma...” (3:5). Ky është kushti fillestar që dikush të hyjë në mbretëri. Pa këtë lindje të re askush nuk mund të hyjë. Por kur të përjetohet njëherë, nuk ka pse të përsëritet. Është një ngjarje që ndodh vetëm një herë. Askush nuk mund të rilindet vazhdimisht shpirtërisht, dhe as nuk ka nevojë, sikurse nuk mund të ndodhë kjo gjë në botën natyrore.

¹² Po ashtu Krishti përdori pastrimin e këmbëve të dishepujve të tij si një shembull të gjallë për ta që t’i shërbenin përfundimisht njëri-tjetrit.

Larja e përsëritur

Sidoqoftë, pasi të rilindemi nga Fryma e Perëndisë, kemi nevojë vazhdimisht “ta pastrojmë veten nga çdo ndotje e mishit dhe e frymës dhe ta përfundojmë shenjtërimin tonë në druajtjen e Perëndisë.” (2 Kor 7:1) Ne kemi nevojë që “me anë të Frymës t’i bëjmë të vdesin veprat e trupit” (Rom 8:13).

Përgatitja e domosdoshme për hyrjen në Shenjtërore

Për ta përmbledhur, ne vëmë re atë që, sipas Letrës së Hebrenjve, është pastrim i dyfishtë (10:22), me anë të gjakut dhe ujit, që na përgatit për të hyrë në Shenjtërore. Ne duhet të afrohem me guxim:

1. ‘me një zemër të vërtetë në besim të patundur’,
2. ‘me zemra që janë spërkatur [me gjak] për t’u pastruar nga një ndërgjegje e keqe’ (shih Heb 9:14),
3. ‘dhe trupi ynë është i pastruar me ujë të pastër’.¹³

Shandani, Tryeza dhe Altari i temjanit

Në kapitullin e mëparshëm ne studiuam këto tri enë si “hije të gjërave qiellore”. Tani duhet të mendojmë për atë që ato tregonin si hije e gjërave të mira që do të vinin.

Shandani dhe llambat e tij

Nëse Shandani ishte një hije e gjërave të mira që do të vinin, nuk ka dyshim se kë simbolizonte ai. Sepse, siç e kemi thënë edhe më parë, Shandani ishte simbolikisht një pemë jete dhe njëherazi mbartte dritën. Ai tregonte në mënyrë shprehëse drejt atij për të cilin Gjoni thotë: “Në atë ishte jeta, dhe jeta ishte drita e njerëzve.” (Gjoni 1:4).

Kur thotë që “në atë ishte jeta”, Gjoni nuk po thotë thjesht atë që kuptohet lehtësisht, që Zoti ynë, Fjala e përjetshme, që

¹³ E gjithë shëmbëlltyra e skenuar nga Zoti ynë te Gjoni 13 është e mbështetur mbi pastrimin me ujë. Çuditërisht, disa komentues që zakonisht janë të kujdesshëm këtu sugjerojnë se larja e plotë në shëmbëlltyrë përfaqëson pastrimin tonë fillestar prej gjakut të Krishtit.

ishte me Perëndinë dhe ishte Perëndi, ishte vetë i gjallë. Gjoni po thotë që Fjala ishte burimi i të gjithë jetës së krijuar: “Të gjitha gjërat u bënë me anë të tij, dhe pa atë nuk u bë asnjë nga ato që u bënë.” Nëse do të pyesim se nga e mori këtë jetë për të krijuar një numër pothuajse të pafund gjërash të gjalla në univers, përgjigjja është, ai nuk e mori prej askund. Ai vetë është burimi i saj.

Kur Gjoni shton: “ajo dritë ishte drita e njerëzve”, po ta kapim ngushtë, ai ende po i referohet jetës së krijuar. Nëse do të ishte në një rrugë të errët natën dhe papritur një rreze drite do të shkëlqente përmes gardhit në rrugën tënde, natyrshëm do të pyesje veten se nga erdhi kjo dritë. Nuk do të mendoje se vinte nga hiçi: “thjesht ishte” aty. Drita duhet të ketë një burim. Po ashtu me jetën. Nëse do të zbulojmë ndonjëherë domethënien e saj, qoftë për veten dhe për botën në përgjithësi, ne duhet të shkojmë te burimi i saj: Fjala e përjetshme, personale, vetëekzistuese, në të cilin, përmes të cilit, dhe për të cilin u bë universi; dhe që i jep të gjithë jetës së krijuar kuptimin dhe qëllimin e saj përfundimtar.

Ai nuk pushoi së qeni burimi i jetës kur u bë mish dhe banoi mes nesh. Bashkëkohësve të tij ai u sqaroi: “Sepse, sikurse Ati ka jetë në vetvete, kështu ia ka dhënë dhe Birit të ketë jetë në vetvete” (Gjoni 5:26). Për rrjedhojë, ai mund t’i jepte jetë të përjetshme menjëherë çdokujt që besonte në të (5:24–25). Duke e ditur se “do të vinte dita që do të largohej”, ai i siguroi dishepujt e tij se do të vazhdonte të ishte burimi dhe ushqyesi i jetës së tyre shpirtërore: “sepse unë jetoj, edhe ju do të jetoni” (14:19). Madje edhe kur ishte ende mbi dhë, ai pohoi se ishte ringjallja dhe jeta (11:25); dhe ai e nxori L Lazarin jashtë varrit për ta provuar këtë (11:43). Do të vinte ora, tha ai, kur “të gjithë ata që janë në varre do ta dëgjojnë zërin e tij dhe do të dalin prej tyre” (5:28–29).

Jo më kot Shandani u prodhua që të ngjante me një pemë bajameje, pema e parë në Izrael që lulëzon pas shterpësisë së dimrit. Jo më kot ai mbante dritën e shtatë llambave. Qëllimisht u modelua për të qenë një shenjë që tregonte drejt atij që tha:

“Unë jam drita e botës; kush më ndjek nuk do të ecë në errësirë, por do të ketë dritën e jetës. ...Në të vërtetë, në

të vërtetë po ju them se ai që zbaton fjalën time, nuk do ta shohë kurrë vdekjen, përjetë.” (Gjoni 8:12, 51)

Tryeza e Bukës së Paraqitjes

Tani do të sjellim në mendje atë që kemi trajtuar më parë: që 12 çyrekët e bukës mbi këtë tryezë përfaqësonin 12 fiset e Izraelit; që ato vendoseshin aty para së gjithash për kënaqësinë e Perëndisë; që, pavarësisht nga kjo, në fund të çdo jave, priftërinjtë lejoheshin të hanin nga kjo bukë në një vend të shenjtë. Kështu, shumë shekuj para Krishtit, tashmë kjo tryezë paraqiste një miqësi të mrekullueshme: një tryezë në të cilën mund të kënaqeshin njësoj, Perëndia dhe njeriu bashkë.

Ndërsa e kthejmë vëmendjen tonë te kjo tryezë dhe 12 çyrekët e saj si një hije e gjërave të mira që do të vinin, koncepti i Isaia për Mesian, si një lloj Izraeli i vërtetë, mund të na ndihmojë këtu. Duke filluar që nga kapitulli 40 e në vazhdim në profecinë e Isaia, Perëndia i drejtohet të gjithë kombit të Izraelit, si “ti, Izrael, shërbëtori im,” (Isa 41:8). Por kur Perëndia na thërret të mendojmë për shërbëtorin e tij (52:13), është e dukshme që nuk po flet për të gjithë kombin në tërësi, por për një individ. Kombi ka shkelur dhe merituar ndëshkimin e Perëndisë. Por ky Shërbëtor “ishte goditur për shkak të shkeljeve të popullit tim” (53:8); vdekja e tij do të ishte një ofertë për mëkatin (53:10). “Me anë të ditorisë së tij, i drejti, shërbëtori im, do të bëjë të drejtë shumë veta, sepse do të marrë përsipër paudhësitë e tyre.” (53:11). Deklarata të tilla mund të gjejnë vlerë vetëm te një individ, d.m.th. Krishti.

Ne përfundojmë se Krishti ishte shërbëtori i përsosur i Perëndisë. Ai ishte gjithçka që Izraeli duhet të ishte dhe ca më tepër. Ai ishte Izraeli i përsosur në të cilin Perëndia që i kënaqur, në pagëzimin e të cilit një zë nga qielli shpalli: “Ky është Biri im i dashur, në të cilin jam kënaqur” (Mat 3:17).

Atëherë si hije e gjërave të mira që do të vinin, 12 çyrekët e bukës mbi Tryezën e Bukëve të Paraqitjes tregonin së pari drejt Krishtit. Por ashtu si priftërinjtë, në fund të çdo jave, lejoheshin të hanin bukët që ishin vendosur mbi tryezë kryesisht për kënaqësinë e Perëndisë, po ashtu besimtarët sot janë të thirrur

të gjejnë të njëjtën kënaqësi të madhe në Krishtin së bashku me Perëndinë. Le të shpjegohet Apostulli Gjon.

Ai shkruan si fillim për “jetën e përjetshme që ishte *pranë* Atit (πρὸς τὸν πατέρα - me Atin)” (1 Gjonit 1:2). Rasa që Gjoni përdor për emrin “Atë” pas parafjalës *me* në gramatikën e greqishtes, përdoret zakonisht për të treguar marrëdhënie mes dy personave. Është pikërisht kjo gjë që Gjoni përdor në pasazhe të ngjashme tek Ungjilli i tij: “Fjala ishte *me* Perëndinë” (Gjoni 1:1). Kështu fraza “jetën e përjetshme që ishte *pranë* Atit” përshkruan një miqësi personale të një lloji të pafund dhe përjetësisht të pëlqyeshme mes Atit dhe Birit.

“Dhe”, vazhdon Gjoni, “jeta u shfaq.” Ai po i referohet mishërimit dhe jetës tokësore të Zotit tonë; dhe ai shton: “Atë që pamë dhe dëguam, ne po jua shpallim, që edhe ju të keni bashkësi me ne; dhe bashkësia jonë është me Atin dhe me Birin e tij, Jezu Krishtin.” (1 Gjonit 1:2–3).

Tani, në terminologjinë biblike, “të kesh bashkësi me dikë” do të thotë që ke diçka të përbashkët me atë person. Atëherë cila është ftesa që Gjoni na bën për t’u bashkuar me të, me apostujt e tjerë, dhe në të vërtetë me Atin dhe me Birin e tij? Nuk është asgjë tjetër më pak sesa jeta e përjetshme që ishte me Atin. (1:3).

Kushti për ta shijuar këtë bashkësi

Është një fakt i thjeshtë historik që në Vendin e Shenjtë të tabernakullit Shandani ishte pikërisht përballë Tryezës. Prandaj, kur një prift shkante te Tryeza për të ngrënë nga buka e Perëndisë, të shtatë llambat mbi Shandan do të ndriçonin mbi të. Me fjalë të tjera, për të patur miqësi me Perëndinë, ai duhet të “ecte në dritë”.

Siç qe atëherë, është edhe tani. Le të shpjegohet Gjoni edhe njëherë më shumë:

“Perëndia është dritë dhe në Të nuk ka kurrfarë errësire. Po të themi se kemi bashkësi me Të, dhe ecim në errësirë, ne gënjejmë dhe nuk e vëmë në praktikë të vërtetën; por, po të ecim në dritë, sikurse ai është në dritë, kemi bashkësi njeri me tjetrin.” (1 Gjonit 1:5–7)

Doemos, nëse ecim në atë dritë, ajo do të shfaqë dështimet

dhe mëkatet tona. Por Perëndia ka siguruar për gjendjen tonë të mjerë: “gjaku i Jezu Krishtit, Birit të tij, na pastron nga çdo mëkat.” (1:7). Nuk kemi pse të fshehim mëkatet tona; përkundrazi, neve na thuhet se duhet t’i rrëfejmë ato. Dhe kur e bëjmë këtë, “ai është besnik dhe i drejtë që të na falë mëkatet dhe të na pastrojë nga çdo paudhësi.” (1:9).

Për më tepër, Gjoni thotë: “në qoftë se ndokush mëkatoi, kemi një avokat tek Ati, Jezu Krishtin të drejtin. Ai është shlyesi për mëkatet tona.” (2:1–2). Por mendimi për mbrojtjen e Krishtit për ne, do të na sjellë tek orendia e tretë e shenjtë që ishte në Vendin e Shenjtë.

Altari i Artë i temjanit

Përgjatë rrjedhës së historisë, djegia e temjanit mbi Altarin e artë lidhej me lutjen. Disa sugjerojnë që kjo ndodhte sepse djegia e temjanit brenda tempullit përkonte me ofertën e תמידין (*tāmîd*), sakrifica ditore e përhershme në mëngjes dhe mbrëmje jashtë tempullit, gjatë së cilës populli do të mblidhej jashtë dhe do të lutej.

Tashmë Davidi lutet: “Le të arrijë lutja ime para teje si temjani, ngritja e duarve të mia si flijimi i mbrëmjes.” (Ps 141:2).

Më vonë, gjatë kohës së Dhiatës së Re, një prifti të quajtur Zakaria – i ati i Gjon Pagëzorit – “i ra shorti të hyjë në tempullin e Zotit për të djegur temjanin” sërish duke e lidhur këtë me lutjet e njerëzve:

Ndërkaq mbarë turma e popullit rrinte jashtë e lutej, në orën e temjanit. Atëherë një engjëll i Zotit iu shfaq duke qëndruar në këmbë në të djathtën e altarit të temjanit... engjëlli i tha: Mos u tremb, Zakaria, sepse lutja jote u plotësua (Luka 1:10–13)

Prandaj nuk është vështirë të përfytyrojmë që Altari i artë me temjanin e tij dhe lutjet priftërore, ishin hije e ndërmjetësimeve të kryepriftit tonë (Heb 7:25–28) dhe shërbesës së tij si avokati ynë me Atin (1 Gjonit 2:1). Për më tepër, në Ditën e Shlyerjes, brirët e Altarit të artë që ishte para Zotit lyheshin me gjakun e flijimit shlyes të kryer mbi Altarin e Bronztë në oborrin e

tabernakullit. (Lev 16:18; shih gjithashtu 4:7, 18). Po ashtu, na thuhet që avokati ynë me Atin “është shlyesi për mëkatet tona” (1 Gjoni 2:2). Me fjalë të tjera, fuqia dhe efekti i avokatisë së Krishtit në emrin tonë, buron nga mjaftueshmëria e flijimit të tij shlyes për mëkatet tona në Kalvar.

Temjani si një hije e gjërave të mira që do të vinin

Te Zbulesa 8 Gjoni përdor simbolizmin e Altarit të artë të tabernakullit për të na paraqitur shkëmbimet shpirtërore që pa se bëheshin në qiell:

“Pastaj erdhi një engjëll tjetër që kishte një temianicë ari dhe ndaloi pranë altarit; dhe iu dha shumë erë e këndshme që tua shtonte lutjeve të të gjithë shenjtorëve mbi altarin prej ari që ishte përpara fronit. Dhe tymi i erëve të këndshme, të ofruara me lutjet e shenjtorëve, u ngrit përpara Perëndisë nga dora e engjëllit.” (Zbul 8:3–5)

Prej asaj që vijon në tekst është e qartë që me shtimin e temjanit lutjet e shenjtorëve bëhen efektive.

Kjo ishte po ashtu një hije e gjërave të mira që do të vinin. Sot nuk kemi nevojë për temjan aromatik fizik për t’i bërë lutjet tona të efektshme para Perëndisë. Ne lutemi në emrin e Zotit Jezus; dhe ai emër është një aromë e fuqishme dhe e përhershme para Atit (krhs. Gjoni 14:13–14; 16:23–24).

Një nivel tjetër domethënieje

Ne e pamë në kapitullin pararendës se qoftë Tryeza, qoftë Shandani qenë orendi të paraqitjes: Tryeza paraqiste 12 çyrekë buke para Zotit për kënaqësinë e tij të përhershme; kurse Shandani mbante shtatë llamba që shkëlqenin para Zotit, po ashtu vazhdimisht. Në funksionet e tyre të zakonshme të dyja këto orendi ishin një hije e Krishtit. Tek Efesianëve ne lexojmë: “Perëndia ngjalli Krishtin prej së vdekurish dhe e vuri të ulet në të djathtën e tij. Por jo vetëm atë. Sepse i pëlqeu Perëndisë “që të jemi të shenjtë dhe të papërlyer në dashuri *përpara tij*” (Efes 1:4). Dhe këtë, Perëndia e ka bërë tashmë – dhe në të ardhmen do ta realizojë edhe më plotësisht. “Ai na ringjalli me të, dhe me

të na vuri të rrimë në vendet qiellore në Krishtin Jezus,” (Efes 2:6). Krishti na mban dhe na paraqet para Atit për kënaqësinë e përvetshme të Atit.

Shandani ishte modeluar si një trung qendror me 6 degë. Ai ishte një hije e Krishtit në të cilin ishte jeta dhe ajo jetë që drita e njerëzve. Por Krishti ka shkëlqyer mbi ne, kështu që ne jemi “dritë në Zotin” (Efes 5:8). Jo vetëm kaq. Krishti na ka dhënë neve jetën e tij. Ne jemi “në të”; dhe përmes Frymës së tij, na mbështet dhe fuqizon në shërbesat që na ka besuar: ne shkëlqejmë si drita për Perëndinë në këtë botë të shthurur (Filip 2:15). Ne jemi gjithashtu një mjet ndriçimi për sundimtarët dhe autoritetet në vendet qiellore, ndërsa në këtë epokë Perëndia u zbulon atyre, përmes kishës, diturinë e tij të shumëanëshme (Efes 3:9-10). Mbi të gjitha, Krishti na fuqizon të përmbushim funksionin parësor për të cilin u krijuam dhe jemi shpenguar dhe jemi pajisur me dhunti, d.m.th., të shkëlqejmë para Zotit vazhdimisht për kënaqësinë e tij, tani në kishë dhe më pas në qiell.¹⁴ Pikërisht drejt kësaj sfere do ta kthejmë tani vëmendjen tonë. Prej këtyre dobive të lavdishme, që ishin si hije në tabernakull dhe që sillen te ne prej Zotit tonë Jezus Krisht, ne vazhdojmë përpara për një rast të veçantë, përfundimtar në përdorimin e Dhiatës së Re të simbolizmit të tabernakullit.

...

Pyetjet e studimit për këtë kapitull mund t’i gjeni në faqen 442.

14 Për një studim të Arkës dhe Pajturesit në faqet e mëparshme.

21

Tabernakulli si çelës për interpretimin e Zbulesës

Katër pjesët kryesore të librit të Zbulesës dokumentojnë vizionet e Gjonit të skenave të njëpasnjëshme në qiell. Në secilin rast, një përshkrim i ndonjë tipari të tabernakullit vë tonin e skenës dhe përkufizon domethënien e ngjarjeve që vijonë.

Pjesa 1- Një derë hapet në qiell (Zbulesa 4:1–7:17). Gjonit i kërkojnë të hyjë dhe të shohë fronin e Perëndisë i cili është i barasvlefshëm me Arkën në tabernakull. Pas kësaj vijon një përshkrim i hollësishëm i fronit që përfshin katër “qeniet e gjalla” të tij, të njohura ndryshe si *kerubinë* (shih Ezek 10:20), të ngjashëm me dy kerubinët mbi pajtuesin e Arkës, ku Perëndia “ishte fronëzuar” (1 Kr 13:6). Krahasoni gjithashtu fronin dhe atë që ulet në të mbi kerubinët në vizionin e Ezekielit (Ezek 1:26).

Pjesa 2 – Vula e shtatë hapet (Zbulesa 8:1–11:18). U bë heshtje në qiell për gjysmë ore. Pastaj futet një engjëll me një temjanicë në dorë. Atij i jepet shumë temjan për ta ofruar bashkë me lutjet e të gjithë shenjtorëve mbi altarin e artë para fronit. Pastaj temjanica mbushet me zjarr nga altari dhe boshatiset mbi dhë.

Pjesa 3 – Tempulli i Perëndisë në qiell hapet (Zbulesa 11:19–15:4). Arka e besëlidhjes së tij shihet brenda tempullit. Ka vetëtima, bubullima, gjëmime, tërmet dhe një breshër të fortë.

Pjesa 4 – U hap në qiell tempulli i tabernakullit të dëshmisë (Zbulesa 15:5–19:10). Dhe prej tempullit dalin shtatë engjëjt, që kishin të shtatë plagët... Një nga të katër qeniet e gjalla u dha të shtatë engjëjve shtatë kupa ari, plot me zemërimin e Perëndisë...

dhe tempulli u mbush me tym nga lavdia e Perëndisë dhe nga fuqia e tij; dhe askush nuk mund të hynte në tempull, derisa të mbaroheshin të shtatë plagët e të shtatë engjëjve.

Tani ky përdorim i simbolizmit të tabernakullit të Zbulesa na kthen pas te funksioni i parë i tabernakullit, që të ishte “figura e gjërave qiellore”. Dhe ishin pikërisht “gjërat qiellore” që iu dhanë Gjonit për t’i parë dhe për t’i hedhur në shkrim. Ai nuk përpiqet të shpjegojë simbolizmin apo ta interpretojë atë si “hijen e gjërave të mira që do të vinin”. Ai përshkruan atë që për të ishte një realitet i pranishëm. Duke përshkruar qiellin, shumica e përshkrimit duhet të vazhdojë domosdoshmërisht të jetë me terma metaforikë dhe simbolikë, edhe në këtë epokë të krishterë.

Çdo pjesë fillon me diçka që hapet në qiell. Kjo është e qartë. Ajo që ndoshta nuk është edhe aq e qartë është se një aspekt i veçantë i tabernakullit, që përmendet në fillim të çdo pjese, përcakton se cila do të jetë skena për gjykimin hyjnor që do të bjerë mbi dhë përgjatë asaj pjese. Dhe jo vetëm që përcakton skenën, por shpjegon pse ky numër gjykimesh duhet të bjerë mbi dheun dhe banorët e tij.

Pjesa 1 (Zbulesa 4:1-7:17)

Prandaj në pjesën 1, ne shohim fronin. Është froni i Krijuesit dhe të drejtat e tij krijuese qartësohen haptazi:

“Ti je i denjë, o Zot, të marrësh lavdinë, nderimin dhe fuqinë, sepse ti i krijove të gjitha gjërat, dhe nëpërmjet vullnetit tënd ekzistojnë dhe u krijuan” (Zbulesa 4:11)

Universi nuk ka asnjë arsye tjetër për të ekzistuar përveçse t’i bindet vullnetit të Krijuesit. Por raca njerëzore ka rebeluar kundër tij dhe këmbënguli që të bëhet zot i vetes. Pasoja: kaos frymëror, moral dhe, shpesh, edhe fizik. Por Krijuesi nuk ka për të lejuar që gjërat të shkojnë kështu përgjithmonë. Ai ka qëllimet e tij për ripërtëritjen e tokës që do të thotë, për rrjedhojë, një qiell dhe tokë të re, në të cilën vullneti i Krijuesit do të bëhet mbi dhë ashtu si në qiell. Ja pse gjykimet e Perëndisë janë të pashmangshme; sepse lidhen me përgatitjen për ripërtëritje.

Shpengimi u jepet të penduarve përmes flijimit të Qengjit (Zbul 5); por patjetër që kokëfortët do të gjykohen. Të drejtat e fronit të Krijuesit e sigurojnë këtë.

Në fund të pjesës, kur kanë kaluar gjykimet, na del para syve një turmë e madhe të shpëtuarish, që i kanë të lara rrobat e tyre në gjakun e Qengjit. Bekimet që i shoqërojnë ata përshkruhen vazhdimisht me temën kryesore në këtë pjesë, fronin e Krijuesit:

Prandaj edhe janë përpara fronit të Perëndisë dhe i shërbenin atij ditë e natë në tempullin e tij; dhe ai që rri ulur mbi fron do të banojë në mes tyre. Ata nuk do të kenë më uri, as nuk do të kenë etje, as nuk do të godasë më dielli, as kurrfarë vape, sepse Qengji, që është në mes të fronit, do të kullojë dhe do të çojë te burimet e gjalla të ujërave; dhe Perëndia do të thajë çdo lot nga sytë e tyre. (Zbulesa 7:15–17)

Froni i Krijuesit do të garantojë që krijesa e tij nuk do të lëndojë më ndonjë nga të shpenguarit e tij.

Pjesa 2 – (Zbulesa 8:1–11:18)

Te Pjesa 2 ajo orendi e tabernakullit që cakton skenën e asaj që vijon është Altari i Artë i temjanit. Tani, te tabernakulli i Moisiut, Altari i Artë ishte i lidhur funksionalisht me Arkën “e Zotit, që rri mbi kerubinët, ku përmendet emri i tij” (1 Kro 13:6). Ndonëse Veli i ndante nga njëri-tjetri, Altari i Artë ishte vendosur qëllimisht ballë për ballë Arkës (Eks 30:6). Prandaj, kur prifti rrinte më këmbë tek Altari i Artë para Zotit dhe lutej, ai po i drejtohej menjëherë Perëndisë që ishte i fronëzuar nga ana tjetër e Velit. Me të vërtetë, po ta besojë këtë, si të mos luteshe dhe të prisje përgjigje për lutjet e tua?

Por në mendjet e atyre që hetojnë, kjo ngre problemin e vjetër të pranisë së të keqes. Ateistët do të thonë: nëse ka një fron në qiell ku ulet një Perëndi që shqetësohet për drejtësinë dhe që dëgjon lutjet e të përndjekurve, pse i lejon ai mizoritë e bëra kundër njerëzve të pafajshëm? Pse nuk ndërhyjnë dhe t'i ndalojë të gjitha këto? Pse hesht ai përballë së keqes? Nuk janë vetëm ateistët që i ngrenë këto pyetje. Ky problem ka shqetësuar

shumë besimtarë gjatë shekujve. Te Psalmi 94 kemi të shprehur topitjen e ankthit të tyre shumë shekuj më herët:

O Zot, Perëndi i hakmarrjeve... shkëlqej. Çohu, o gjykatës i tokës, dhe jepu shpërblimin mëndjemëdhenjve. O Zot, deri kur të pabesët do të triumfojnë? ... Ata marrin nëpër këmbë popullin tënd, ... ata vrasin gruan e ve dhe ... vrasin jetimët, dhe thonë: “Zoti nuk shikon...”. (Ps 94:1-7)¹

Vetë Krishti e preku këtë problem në shëmbëlltyrën e Vejushës dhe Gjykatësit të Padrejtë (Luka 18:1–8). Ai e tregoi atë shëmbëlltyrë për të na nxitur të mos dorëzohemi asnjëherë nga lutjet tona drejtuar Perëndisë që të bëjë drejtësi për popullin e tij. Vetë shëmbëlltyra flet për një vejushë që i kërkonte një gjykatësi t'i jepte të drejtën përballë kundërshtarit të saj. Për njëfarë kohe gjykatësi refuzoi, por vejusha këmbënguli me kërkesën e saj. Prandaj gjykatësi, edhe pse i padrejtë, u dorëzua më në fund dhe bëri drejtësi. Krishti tha: “Vallë Perëndia nuk do të marrë hak për të zgjedhurit e tij që i këlthasin atij ditë e natë? A do të vonojë, vallë, të ndërhyjë në favor të tyre?” (18:7)²

Kjo vonesë e dukshme nga ana e Perëndisë për të bërë drejtësi për popullin e tij, prezantohet në mënyrë goditëse te drama e madhe që i jepet mundësia Gjonit të dëshmojë. Gjoni pa Qengjin që hap katër vulat e para (Zbul 6:1–8), dhe menjëherë pas hapjes së tyre mbi dhë ra një gjykim hyjnor. Kur u hap vula e pestë, shpirtrat e atyre të martirizuar për besimin e tyre thirrën (njësoj si autori i Psalmi 94): “Deri kur, o Zot, që je i Shenjtë dhe i Vërtetë, nuk gjykon dhe nuk merr hak për gjakun tonë nga ata që banojnë mbi dhë?” (Zbul 6:10).

Atyre iu tha që duhet të presin edhe ca më gjatë. Pastaj kur u hap vula e gjashtë, mbi dhë ranë gjykime katastrofike dhe e sollën këtë seri në kulmin e saj (6:12–17).

Por nuk ka mbaruar ende gjithçka. Vula e shtatë nuk është hapur ende; dhe kur ajo të hapet, një seri tjetër gjykimesh do të ndodhë. Kështu hapet vula e shtatë dhe pastaj... nuk ndodh

¹ “Hakmarrja” në këto pasazhe nuk do të thotë “shpagim”. Ajo nënkupton aktin apo procesin që siguron se është bërë drejtësi.

² Për një diskutim të kësaj fraze të fundit shihni Marshall, Luke, 674–5.

gjë, absolutisht asgjë! Përkundrazi, ka një heshtje në qiell për gjysmë ore. Nëse përmes syve të Gjonit edhe ne e shohim këtë dramë të shpaloset, do të pyesnim: Kur do të thyhet kjo heshtje, dhe çfarë do ta thyejë atë?

Sa për fillim, të shtatë engjëjve që rrinë para Perëndisë u jepet secilit nga një bori (8:2). Por nuk dëgjohet asnjë tingull. Pastaj një engjëlli tjetër i jepet shumë temjan për t'ua shtuar lutjeve të shenjtorëve mbi Altarin e Florinj të që është para fronit; dhe ndërsa tymi i temjanit ngrihet para Perëndisë, lutjet e tyre bëhen të efektshme. Engjëlli merr temjanicën, e mbush me zjarr nga altari dhe e hedh mbi dhë: pas kësaj dëgjohen vetëtima, zëra dhe bubullima dhe një tërmet (8:3–5). Më në fund thyhet heshtja. Në përgjigje të lutjeve të shenjtorëve, të grumbulluara përgjatë shumë shekujve, Perëndia çohet të bëjë drejtësi për të vetët.

Ndërsa Pjesa 2 vazhdon, koha e ndërhyrjes së Perëndisë mbetet një temë kryesore në të. Te kapitulli 10 një engjëll i fuqishëm zbret nga qielli dhe betohet që nuk do të ketë më vonesa, por që në ditët e borisë së engjëllit të shtatë, misteri i Perëndisë do të përmbushet si është shpallur prej shërbëtorëve të tij, profetëve (10:1–7).

E njëjta temë mbizotëron kulmin e kësaj pjese, sepse 24 pleqtë e adhurojnë me falënderime Perëndinë, sepse ka ardhur koha:

...koha që të gjykohen të vdekurit dhe t'u jepet paga shërbëtorëve të tu, profetëve, dhe shenjtorëve, dhe atyre që druajnë emrin tënd, ... dhe të shkatërrosh ata që shkatërrojnë dheun. (Zbul 11:18)

Pjesa 3 (Zbulesa 11:19—15:4)

Ashtu si referencat për simbolizmin e tabernakullit në fillim të Pjesës 1 dhe 2 janë të lidhura funksionalisht, po ashtu janë edhe referencat për tabernakullin në fillimet e Pjesës 3 dhe 4. Kjo është lehtësisht e dukshme prej ngjashmërisë në gjuhën e tyre.

Pjesa 3 thotë: 'Atëherë u hap tempulli i Perëndisë në qiell dhe u duk arka e besëlidhjes së tij' (11:19).

Pjesa 4 do të thotë: 'Dhe pas këtyre gjërave unë pashë dhe ja, u hap në qiell tempulli i tabernakullit të dëshmisë.' (15:5).

Deri këtu gjuha e tyre është pothuajse e njëjtë. Por ka dallime të dukshme në atë që vijon; dhe janë këto dallime që zbulojnë në secilin rast domethënien e simbolikës së asaj pjese të veçantë të zgjedhur të tabernakullit për ngjarjet që përshkruhen në vijim.

Kur hapet tempulli në Pjesën 3, shihet Arka e Perëndisë. Sidoqoftë, këtë herë nuk shihet si froni i Perëndisë, siç qe në Pjesën 1. Në të vërtetë ajo përmendet si "arka e besëlidhjes së tij". Kjo thekson faktin që arka kishte dy rasa guri mbi të cilat ishin gdhendur Dhjetë Urdhërimet; ato ishin themeli i besëlidhjes që Perëndia bëri me Izraelin (Eksodi 24:1–8). Dy urdhërimet e para të besëlidhjes ishin:

Nuk do të kesh perëndi të tjerë para meje. (Eksodi 20:3)

Dhe

Nuk do të bësh skulpturë ose shëmbëlltyrë të asnjë gjëje që ndodhet aty në qiejt ose këtu poshtë në tokë ose në ujërat nën tokë. Nuk do të përkulesh para tyre dhe as do t'i shërbesh, sepse unë, Zoti, Perëndia yt, jam një Perëndi xheloz. (Eksodi 20:4–5)

Është kollaj të konstatosh sesi shfaqja e Arkës së Besëlidhjes e përgatit skenën për gjykimet që do të vinin; sepse do të lexojmë në këtë pjesë për një kohë kur klauzolat bazë të saj do të përdhosen me blasfemi prej perandorisë së madhe të asaj kohe.

Dhe adhuruan dragoin që i dha autoritet bishës dhe adhuruan bishën duke thënë: Kush i ngjan bishës? Kush mund të luftojë kundër saj? ...ajo hapi gojën e vet për të blasfemuar kundër Perëndisë, për të blasfemuar emrin e tij, tabernakullin e tij...

[Pastaj pashë një bishë tjetër që ngjitej] ... dhe bënte që dheu dhe banorët e tij të adhurojnë bishën e parë... duke u thënë banorëve të dheut t'i bëjnë një figurë bishës, që kishte plagën e shpatës dhe u kthye në jetë... edhe ... ata të ... adhuronin figurën e bishës. (Zbul 13:4, 6, 11–12, 14–15)

Refuzimi do të thotë ekzekutim; ata që nuk e pranojnë shenjën e bishës mbi dorë apo ballë nuk do të mund të blejnë apo shesin.

Pavarësisht kësaj, Perëndia do të mbetet besnik ndaj vetes dhe besëlidhjes së tij për dhjetëra mijëra burra dhe gra. Të gjithë këta do të kenë emrin e Qengjit dhe të Atit të tij të shkruar mbi ballin e tyre. Vargjet e mëposhtme tregojnë si i kanë qëndruar besnik Atij: Qengji “i blen” ata jo me para apo mallra, por me gjakun e jetës së tij (14:1–5). Në përfundim të saj kjo pjesë tregon për këngën triumfuese të atyre që dolën fitimtarë prej bishës dhe imazhit të tij, dhe prej numrit të emrit të tij; dhe parashikon kohën kur të gjitha kombet do të vijnë dhe do të adhurojnë Perëndinë (15:2–4).

Pjesa 4 (Zbulesa 15:5—19:10)

Njësoj si tre pjesët që e paraprijnë, Pjesa 4 fillon me diçka që hapet në qiell. Por këtë herë Gjoni nuk sheh ndonjë pjesë tabernakulli: jo fronin, as Altarin e Artë të temjanit, as Arkën e Besëlidhjes. Në vend të tyre, Gjoni sheh shtatë engjëjt që dalin prej tempullit me shtatë kupa të arta plot me zemërimin e Perëndisë (15:7). Është e vërtetë se tempulli, prej të cilit ata dalin, quhet “tabernakulli i dëshmisë”, dhe “dëshmia” janë Dhjetë Urdhërimet që formojnë bazën e besëlidhjes së Perëndisë me Izraelin të përmendur te Pjesa 3. Por te Pjesa 4 nuk përmendet asnjëherë Arka që mbante Dhjetë Urdhërimet. Për më tepër ne jemi përballur me vetë lavdinë e Perëndisë të cilën këto urdhërime e dëshmonin personalisht. “Perëndia tha këto fjalë” (Eks 20:1). Ato ishin shprehje e karakterit dhe vullnetit të Perëndisë së gjallë.

Kur ai zbriti mbi Sinai për t’ia shpallur ato Izraelit, maja e malit “ishte tërë tym sepse Zoti kishte zbritur mbi të në zjarr; tymi i tij ngrihej si tymi i një furre.” (Eks 19:18). Por neveria e hapur që do të përshkruhet në Pjesën 4 jo vetëm që nuk u është bindur urdhërimeve të shkruara mbi rasa guri, por ajo ka sfiduar vetë Perëndinë. Prandaj zemërimi që mbush kupat e shtatë engjëjve është:

zemërimi i Perëndisë, që rron në shekuj të shekujve. Dhe tempulli u mbush me tym nga lavdia e Perëndisë dhe nga

fuqia e tij; dhe askush nuk mund të hynte në tempull, derisa të mbaroheshin të shtatë plagët e të shtatë engjëjve. (Zbul. 15:7–8)

Objektet e veçanta të atij zemërimi janë dy gra simbolike, të dyja të quajtura Babiloni. Njëra (Zbul 17) simbolizon zvetënimin e fesë – në Dhiatën e Vjetër Babilonia ishte e famshme për idhujtarinë e saj. Tjetra (Zbul 18) simbolizon zvetënimin e tregtisë. Ajo është përshkruar me terma të ngjashëm si Tiro tek Ezekieli 26 & 27; perandoria e Tiros që ngritur mbi tregtinë.

Gjuha e figurshme në të cilën prezantohet akuza kundër këtyre dy grave është nxjerrë prej Dhiatës së Vjetër. Atje marrëdhënia fillestare e Judës me Perëndinë përshkruhet si ajo e një virgjëreshe me të dashurin e saj, e një bashkëshorteje me bashkëshortin e saj³. Por Juda gaboi rëndë përmes kompromiseve fetare dhe politike. Ajo është e dënuar tek Ezekieli 16 dhe 23 në një gjuhë që përdor imazhe të gjalla lindore kur përshkruhet si një prostitutë më e harbuar sesa Samaria dhe Sodoma. Mosbesnikëria e saj jo vetëm që ka thyer urdhërimet: ajo ka plagosur dhe zemëruar zemrën e Perëndisë.

Gruaja e parë (Zbulesa 17)

Gruaja e parë, te Zbulesa 17, e ka përdhosur bukurinë e saj të dhënë prej Perëndisë në një aleancë të ndyrë me perandorinë botërore në fuqi të asaj kohe. Ajo perandori është përshkruar si një bishë “plot me emra blasfemie” (17:3). Por ja që kjo grua po kalëron bishën, duke i dhënë hua ndikimin e saj fetar në përpjekje për ta patur vetë fuqinë dhe të kontrollojë bishën politike dhe aleatët e saj. Për atë qëllim ajo është marrë vesh fshehtas me bishën për të ekzekutuar shenjtorët dhe ata që janë dëshmitarë besnikë të Jezusit, d.m.th. martirët (17:6).

Përmes mosbesnikërisë së saj jo vetëm që e ka plagosur zemrën e Perëndisë, por ajo i ka shpallur luftë atij. Jakobi thotë:

O shkelës dhe shkelëse të kurorës, a nuk e dini se miqësia

3 Krhs. Jer 2:2 ku Perëndia thotë: Unë të kujtoj ty, kujdesin e dhembshur të rinisë sate, dashurinë në kohën e fejesës sate, kur më ndiqje në shkretëtirë’. krhs. gjithashtu 2 Kor 11:2–3 ku përdoret për kishën një gjuhë e figurshme që ngjan me atë.

me botën është armiqësi me Perëndinë? Ai, pra, që don të jetë mik i botës bëhet armik i Perëndisë. (Jakobi 4:4)

Gjoni është ftuar të dëshmojë sesi Perëndia do të gjykojë këtë kurvë të madhe. Vetë mosbesnikëria e saj e mëkatshme është shkak i këtij shkatërrimi: Bisha dhe aleatët e saj politikë të lodhur me ndërhyrjet e saj do ta shkatërrojnë atë (Zbulesa ,17:1 17–16).

Gruaja e dytë (Zbulesa 18)

Gruaja e dytë është shumë e ndryshme nga e para. Ajo nuk është as shumë fetare, as politike, por tregëtare. Ja ku është lista e mallrave të saj të luksit që ua shet tregëtarëve për t'i pasuruar ata:

...mallra prej ari dhe argjendi, gurë të çmuar dhe margaritarë, pëlhura liri dhe purpuri, mendafshi e të kuqeje, dhe gjithfarë drurësh erëmirë, e gjithfarë sendesh fildishi dhe druri shumë të çmuar, bronzi, hekuri dhe mermeri, dhe kanellë, dhe parfume, vajra erëmirë, temian, verë, vaj, majë mielli, grurë, gjë e gjallë, dhen, kuaj, qerre... (Zbulesa 18:12–13)

Të gjitha këto mallra janë të mira në vetvete. Realisht ato janë dhurata të dashurisë së Krijuesit për racën njerëzore që na jep bujarisht nga çdo gjë për t'u kënaqur (1 Tim 6:17). Por grumbullimi i kësaj pasurie të madhe e ka nxitur këtë grua, jo drejt një vartësie mirënjohëse dhe dashuri për Perëndinë, por drejt një vetësigurie idhujtare dhe pavarësie arrogante ndaj Perëndisë. Qëndrimi i zemrës së saj është “Unë rri posi mbretëreshë, e ve nuk jam dhe brengë nuk do të shoh” (Zbul 18:7). Ajo nuk ka nevojë të bëjë ndere për pushtetin politik të botës. Ajo ka të mira materiale më shumë se shumica prej tyre. Janë ata që shkojnë tek ajo për të kërkuar nderet e saj dhe, si kurvë që është, ajo ua shet atyre dhe gjithë tregëtarëve të botës.

Për më tepër, e dhënë pas pasurimit të tepërt, ajo ka humbur vlerën reale që kanë njerëzit e bërë në imazhin e Perëndisë. Ajo i trajton ata thjesht si mallra dhe i ka shitur si skllevër për të nxjerrë fitime (18:13). Profetët dhe shenjtorët që kanë protestuar

kundër paudhësive të saj ajo i ka vrarë fshehtazi (18:24). Përmes yshtjeve të magjisë së konsumizmit vezullues të saj, të gjitha kombet e tokës janë mashtruar në standartin e vlerave të vërteta të jetës (18:23).

Ajo është një shembull i fuqishëm i asaj që Gjoni ka parasysh kur thotë:

Mos e doni botën, as gjërat që janë në botë. Ne qoftë se ndokush do botën, dashuria e Atit nuk është në të, sepse gjithçka që është në botë, lakmia e mishit, lakmia e syve dhe krenaria e jetës, nuk vjen nga Ati, por nga bota. Dhe bota kalon me lakminë e saj... (1 Gjoni 2:15–17)⁴

Gjëja më mbresëlënëse për gjykimin e Perëndisë mbi këtë grua dhe sistemin që ajo përfaqësonte ishte befasia me të cilën e gjitha kjo u prish: “Sepse në një moment u shkatërrua një pasuri kaq e madhe!” (Zbul 18:17).

Një grua e tretë (Zbulesa 19:1–8)

Nëse pabesia e dy grave të para e provokoi shumë zemërimin e Perëndisë, saqë askush nuk mund të hynte në tempull derisa të gjitha gjykimet të ishin dhënë, besnikëria e gruas së tretë bëhet shkak për shpërthimet e lavdërimeve triumfuese në qiell:

Le të gëzohemi dhe të ngazëllohemi dhe le të japim atij lavdi, sepse erdhi dasma e Qengjit dhe nusja e tij është përgatitur! Dhe i është dhënë të vishet me li të hollë, të pastër dhe të shkëlqyeshëm, sepse liri i hollë janë veprat e drejta të shenjtorëve (Zbul 19:7-8)

Interpretimi që Dhiata e Re i bën tabernakullit si një hije

A do të ishte e gabuar që, duke u nisur prej vëzhgimit të këtyre skenave qiellore të Zbulesa, të nxirrnim përfundimin se tema e tabernakullit që kemi qenë duke studiuar në këta tre kapituj të fundit ka një rëndësi të përgjithshme? Sigurisht që mund të themi PO, me siguri dhe bindje. Por le të sigurohemi për këtë përgjigje

4 Shihni kapitullin 14 për një diskutim më të plotë për termin “botë”.

duke cituar edhe një referencë të fundit për tabernakullin te Zbulesa:

Dhe unë, Gjoni, pashë qytetin e shenjtë, Jerusalemin e ri, që zbriste nga qielli, nga Perëndia, që ishte bërë gati si nuse e stolisur për burrin e vet. Dhe dëgjova një zë të madh nga qielli që thoshte: Ja tabernakulli i Perëndisë me njerëzit! Dhe ai do të banojë me ta; edhe ata do të jenë populli i tij dhe vetë Perëndia do të jetë bashkë me ta, Perëndi e tyre. (Zbulesa 21:2–3)

...
Pyetjet e studimit për këtë kapitull mund t'i gjeni
në faqen 442.

PJESA E TRETË

**Udhëzime për interpretimin tonë
të rrëfenjave të Dhiatës së Vjetër**

22

Nevoja për udhëzime

Qëllimi i pjesës së tretë

Në pjesën e parë kemi studiuar lidhjet e përgjithshme që ka Dhiata e Re me Dhiatën e Vjetër. Në pjesën e dytë kemi hetuar shumë përbërës të ndryshëm të pesë kategorive konceptuale të interpretimit që Dhiata e Re përdor për të nxjerrë të vërtetat e çmuara të Dhiatës së Vjetër, dhe për t'i zbatuar ato në të mirën tonë. Tani, në pjesën e tretë, do të përpiqemi të formulojmë disa udhëzime për interpretimin tonë të rrëfenjave të Dhiatës së Vjetër për të cilat Dhiata e Re ose nuk komenton aspak, ose e bën këtë vetëm pjesërisht.

Nevoja për udhëzime të tilla u diskutua te Kapitulli 5. Aty ne kemi përmendur dy shembuj specifikë: sjelljen e Davidit si mbret në gjysmën e dytë të 2 Samuelit dhe sakrifikimin e birit të Abrahamit te Zanafilla 22. Mund të përmenden edhe më shumë shembuj të tjerë. Prandaj ne kemi nevojë për udhëzime qoftë për të na drejtuar në arsyetimin tonë, qoftë për të qenë një provë kontrolli për vlefshmërinë e interpretimeve tona po ashtu. Kjo është arsyeja pse në pjesën e dytë vendosëm të zbulojmë se çfarë ndihme na ofrohet prej shembullit të vetë Dhiatës së Re në shtjellimin dhe zbatimin e saj të hollësishëm të Dhiatës së Vjetër.

Do të ishte e lodhshme të bënim sërish një listë të të gjitha

mësimeve që kemi nxjerrë prej pjesës së dytë; por disa parime themeltare duhen theksuar në këtë pikë për të freskuar kujtesën tonë.

Ideja e cekët se interpretimi ynë duhet të jetë ose i fjalëpërfjalshëm, ose tipologjik është e gabuar për disa arsye:

1. Mes këtyre ekstremeve (i fjalëpërfjalshëm apo tipologjik) Dhiata e Re përdor shumë kategori të tjera interpretative, siç janë krahasimi, metafora, prototipi dhe analogjia; kjo na lejon të ndjekim shembullin e Dhiatës së Re në këtë pikë.
2. Që tipologjia të jetë e vlefshme, së pari duhet të marrë në konsideratë kuptimin e saktë të fjalëpërfjalshëm dhe historik të gjësë, personit, ritit apo ngjarjes në fjalë. Në rast të kundërt është e pavlefshme.
3. Për më tepër, shumicën e rasteve nuk do të kemi të bëjmë *ose* vetëm me interpretim dhe zbatim të fjalëpërfjalshëm, *ose* vetëm me interpretim dhe zbatim tipologjik, por do të kemi të bëjmë *si* me atë të fjalëpërfjalshëm, ashtu *edhe* me atë tipologjik. Vini re trajtimin që Dhiata e Re i bën rrëfenjës së Adamit dhe Evës (shih Kapitullin 16).

Duhet marrë në konsideratë natyra e analogjisë

Të gjitha llojet e gjuhës së figurshme varen nga ndonjë lloj analogjie mes vetes dhe ndonjë gjëje konkrete mbi të cilën mbështeten¹. Por disa herë Dhiata e Re bën një analogji mes dy gjërave nga të cilat asnjëra nuk është e figurshme, por të dyja janë njësoj të fjalëpërfjalëshme. Kur Abrahami i besoi Perëndisë

¹ P.sh – krahasim: Ajo vrapoi si era; metaforë: Donte të binte në sy; prototip: Krishti, Pashka jonë, u flijua për ne.

dhe kjo iu numërua si drejtësi (Zan 15:6), ajo për të cilën ai i besoi Perëndisë ishte premtimi që Perëndia i kishte dhënë për të patur një bir. Kur ne i besojmë Perëndisë dhe kjo na numërohet si drejtësi, nuk na kërkohet të besojmë që Perëndia do të na japë fëmijë. Gjithsesi Pali te Romakëve 4:16–25 pohon se ka një analogji të ngushtë mes besimit tonë dhe atij të Abrahamit. Besimi i Abrahamit ishte te një Perëndi që u jep jetë të vdekurve (4:17), yni është në një Perëndi “që ka ringjallur prej të vdekurve Jezusin, Zotin tonë, i cili u dha për shkak të fyerjeve tona dhe u ringjall për justifikimin tonë.” Nuk është puna se besimi i Abrahamit ishte një “tip” i besimit tonë; as nuk është besimi ynë një krahasim apo një metaforë e mbështetur mbi besimin e tij real, dhe as nuk është një përmbushje e besimit të tij si një prototip. Besimi ynë dhe ai i Abrahamit janë thjesht raste të së njëjtës gjë, të njerëzve realë që vendosin besim real të të njëjtit lloj, te i njëjti Perëndi që u jep jetë të vdekurve, prandaj analogjia është mes dy gjërave të vërteta të të njëjtës cilësi (shih diskutimin te Kapitulli 8).

Efekti etik i doktrinës së Krishtit të dy ardhjeve të Mesias nuk duhet të anashkalohet

Po e përmendim këtë doktrinë sërish këtu (e kemi diskutuar tashmë atë te Kapitulli 6), për shkak të efektit të drejtpërdrejtë që ajo synonte të kishte te mësimet praktike për vetë sjelljen tonë, që ne, si të krishterë, duhet të nxjerrim prej rrëfenjave të Dhiatës së Vjetër.

Jozueu, për shembull, u porosit prej Perëndisë për të ekzekutuar zemërimin e Perëndisë mbi një kulturë të shthurur të kanaanejve dhe ta bënte këtë përmes forcës së armëve. Krishti nuk e vuri në dyshim këtë fakt. Por gjatë gjithë shërbesës së tij tokësore, ai këmbënguli për të dalluar mes qëllimit të ardhjes së tij të parë dhe asaj të dytë. Në ardhjen e tij të parë ai theksoi se nuk ishte dërguar për të gjykuar botën apo për të ekzekutuar zemërimin e Perëndisë mbi mëkatarët. Këtë detyrë solemne ai do ta plotësonte në ardhjen e tij të dytë. Qëllimi i vetëm i ardhjes së tij të parë ishte të kërkonte dhe shpëtonte ata që kishin humbur me çmimin e vetë vuajtjeve dhe vdekjes së tij (Gjoni

3:17; Luka 19:10).

Aq më tepër, ai i ndaloi rreptësisht dishepujt e tij të përdornin shpatën apo çfarëdo lloj dhune as për ta përhapur, as për ta mbrojtur mbretërinë e tij (Mat 26:51–52; Gjoni 18:36–37). Kur të krishterët kanë imituar Jozueun duke përdorur armët për të mbrojtur apo përhapur mbretërinë e Krishtit, ajo ka qenë një keqpërfaqësim i trishtueshëm i Krishtit dhe mosbindje e pastër ndaj porosisë së tij.

Tani, me këto vërejtje paraprake, ne duhet të nisim detyrën tonë të formuluarit të udhëzimeve për vetë interpretimet tona. Por le t'i thjeshtojmë gjërat për veten tonë aq sa mundemi, duke studiuar me hollësi së pari një rrëfenjë mbi të cilën Dhiata e Re ka komentuar gjerësisht edhe pse jo plotësisht; kjo është sakrifikimi i Isakut prej Abrahamit. Pas kësaj ne mund të merremi me rrëfenjat për të cilat Dhiata e Re nuk bën asnjë koment.

...

Pyetjet e studimit për këtë kapitull mund t'i gjeni në faqen 443.

23

Sakrifikimi i Isakut prej Abrahamit

Nga mënyra sesi Dhiata e Re e interpreton këtë rast të mirënjohur dhe çështjet që ai ngre, mund të formulohen të paktën shtatë udhëzime për interpretimin e rrëfenjave të Dhiatës së Vjetër.

UDHËZIMI 1:

Nëse Dhiata e Re interpreton ndonjë rrëfenjë të Dhiatës së Vjetër, ne duhet ta vlerësojmë interpretimin e saj si të autoritetshëm dhe ta ndjekim atë.

Tani, sipas Jakobit, sakrifikimi i Isakut prej Abrahamit na mëson domosdoshmërinë e shfajësimit prej veprave: “Abrahami, ati ynë, a nuk u shfajësua me anë të veprave, kur e ofroi birin e vet, Isakun, mbi altar?” (Jakobi 2:21). Nuk ka dyshime për këtë gjë: sipas Dhiatës së Re ky është kuptimi parësor i rrëfenjës.

UDHËZIMI 2:

Asnjë shpjegim i interpretimit që Dhiata e Re i bën një rrëfenje të Dhiatës së Vjetër nuk mund të jetë i saktë nëse ai shpjegim lë mënjanë apo bie ndesh me rrëfenjën e Dhiatës së Vjetër, mbi të cilën ai interpretim është mbështetur.

Në dukje të krijohet përshtypja se ka një mospërputhje mes

doktrinës së shfajësimit prej besimit që Pali mëson (Zan 15:6 dhe Rom 4:1-5) dhe doktrinës së shfajësimit prej veprave që Jakobi mëson (Zan 22). Një mënyrë si mund të zgjidhet kjo mospërputhje në dukje është ky shpjegim: ne jemi të shfajësuar prej besimit para Perëndisë; por para njerëzve ne jemi të shfajësuar prej veprave. Por ky shpjegim bie në kundërshti me Zanafillën 22. Kur Abrahami u ngjit në Malin Moriah, nuk pati njeri tjetër me vete përveç atij dhe Isakut; dhe Isaku nuk e dinte që do të bëhej fli derisa u shtri mbi altar (Zan 22:7-8). Madje vetë shërbëtorëve të Abrahamit iu tha që të prisnin te këmbët e malit; dhe më pas Abrahami dhe Isaku do të vazhdonin vetë më tutje mbi majën e malit për të adhuruar, dhe të dy do të ktheheshin (22:5). Me sa duket as Sara nuk dinte ndonjë gjë për flijimin e djalit të saj; as ka ndonjë gjurmë se filistejtë e atij vendi qenë në djeni për të. Prandaj nuk kishte ndonjë njeri para të cilit Abrahami mund të shfajësohej përmes veprave të tij duke ofruar Isakun.

Përkundrazi, na thuhet qartësisht se kur Abrahami e vuri Isakun mbi altar dhe kishte ngritur thikën për ta vlarë atë, Engjëlli i Zotit e thirri nga qielli dhe i tha: “Tani [unë] e di mirë që ti i trembesh Perëndisë, se nuk më ke refuzuar birin tënd, të vetmin bir që ke” (22:12). Zëri i Engjëllit të Zotit ishte zëri i vetë Zotit (krhs. Eks. 3:2–8). Abrahami u shfajësua para Perëndisë përmes veprave të tij.

Nuk ka kuptim të themi se Perëndia nuk kishte nevojë për sakrifikimin e të birit, që Abrahami do të bënte, për të ditur nëse besimi i Abrahamit ishte i vërtetë përderisa Perëndia e dinte këtë që nga fillimi. Nëse Perëndia flet nga qielli dhe i thotë Abrahamit: “Tani [pasi kjo kishte ndodhur] e di mirë që ti i trembesh Perëndisë, se nuk më ke refuzuar birin tënd”, duhet të pranojmë atë që Perëndia thotë. Është vetë Perëndia që pret nga ne të shfajësojmë besimin tonë para tij përmes veprave tona.¹

¹ Po të kishim nge, mund të konsideronim llojet e ndryshme të dijes njerëzore. P.sh, unë e di që është shumë ftohtë në Polin e Jugut. E di këtë mendërisht [a priori]. Jam i bindur që është kështu duke marrë në konsideratë pozicionin e tij, etj. Por nuk e di me përvojë [a posteriori]: nuk kam qenë kurrë atje. Perëndia, që nga përjetësia, e dinte se një ditë unë do të lindesha dhe do të jetoja gjithë ditët e mia mbi dhë. Jam i lumtur që ai nuk u mjaftua vetëm me atë lloj njohurie, por bëri që unë të lindesha me të vërtetë, duke e bërë të mundur për mua që, në jetën time trupore mbi dhë, ta njoh atë dhe ai të më

UDHËZIMI 3:

Dhiata e Re të lë të kuptosh se një rrëfenjë e Dhiatës së Vjetër nuk bie ndesh me tjetrën.

Me fjalë të tjera, Zanafilla nuk është një antologji tregimesh të veçuara, të cilat një autor i mbledhi bashkë pa vrarë mendjen nëse bien ndesh me njëra-tjetrën për shkak se i gjeti në vepra të ndryshme. Kështu Jakobi e di se nuk mund ta interpretojë Zanafillën 22 në një mënyrë që bie ndesh me deklaratën e Zanafillës 15:6. Ai duhet të shpjegojë sesi Zanafilla 15:6 është e lidhur me Zanafillën 22. Në fakt ai jep dy shpjegime: njëri për marrëdhënien mes dy Shkrimeve, dhe tjetri për dy fazat e besimit të Abrahamit.

Dy Shkrimet

Shkrimi te Zanafilla 15:6 që "Abrahami i besoi Zotit, që ia vuri në llogari të drejtësisë" *u përmbush* prej asaj që ndodhi në Malin Moriah (Jakobi 2:23). Përdorimi i foljes "u përmbush" nuk do të thotë që Zanafilla 15:6 ishte thjesht një parashikim apo premtim: Abrahami i besoi Perëndisë dhe, shumë më vonë, kur kishte flijuar Isakun, besimi i tij fillestar u mor parasysh dhe atëherë, por vetëm atëherë, ndodhi që u përmbush premtimi se i ishte llogaritur atij si drejtësi. Jo! Zanafilla 15:6 dokumenton një fakt: Abrahami i besoi Perëndisë dhe pikërisht në atë kohë dhe në atë vend kjo iu llogarit atij për drejtësi. Në atë çast ai u shfajësua prej besimit. Kur Jakobi thotë se Zanafilla 15:6 u përmbush te Zanafilla 22, ai po e përdor fjalën "përmbush" në të njëjtin kuptim që Krishti e përdori atë kur tha se nuk kishte ardhur për ta shfuqizuar ligjin, por për ta përmbushur atë (shihni diskutimin te Kapitulli 7).

njohë mua përmes përvojës. Ne mund të imagjinojmë akoma më shumë (nëse duam të imagjinojmë të pamundurën) se çfarë Perëndia mund të kishte thënë nëse, kur e vinte në provë Abrahamin, Abrahami t'i përgjigjej: "Zot, ti tashmë e di që unë të dua dhe të kam frikë, dhe ti tashmë e di të ardhmen dhe se çfarë do të bëj unë; kështu, pse vallë, duhet që ta flijoj Isakun për të ta provuar ty këtë."

Dy fazat e besimit të Abrahamit

"...Besimi vepronte bashkë me veprat e tij, dhe se, nëpërmjet veprave, besimi u përsos." (Jak 2:22)². Besimi i tij ishte tashmë real kur ai i besoi Perëndisë te Zanafilla 15:6. Por besimi i vërtetë do të shprehë veten me vepra. Dhe besimi i vërtetë do të rritet dhe piket.

Në Malin Moriah që besimi i Abrahamit që punoi me veprat e tij, domthenë mbështeti dhe ndihmoi veprat e tij. Pa atë besim, vepra e vendosjes së Isakut mbi altar nuk do të që përmbushur asnjëherë. Njëkohësisht, përmes veprës së ofrimit të Isakut, besimi i tij gjeti shprehje të plotë.

Duhet ta pranojmë – këtë na e thotë edhe vetë Zanafilla – se pasi Abrahami i besoi fillimisht premtimit të Perëndisë se do të bëhej me një djalë, Abrahami veproi në mospërputhje me besimin e tij, dhe lindi përmes Agarit Ismaelin. Por në Malin Moriah besimi i Abrahamit triumfoi.

Atëherë, Zanafilla 22 nuk bie në kundërshtim me Zanafillën 15:6. Nga ana tjetër ajo nuk përsërit thjesht Zanafillën 15:6. Rrëfenja e Zanafillës është një dokumentim i përparimit të besimit të Abrahamit drejt fitores së tij.

UDHËZIMI 4:

Nëse Dhiata e Re komenton për të njëjtën rrëfenjë të Dhiatës së Vjetër në më shumë se një rast, interpretimi ynë, për të qenë i plotë, duhet të marrë në konsideratë të gjitha këto raste.

Ndodh që autori i Hebrenjve përmend gjithashtu Zanafillën 22. Kontributi i tij është që analizon me hollësi natyrën dhe domethënien e veprave për të cilat Abrahami u thirr të bënte, që të mund të shfajësohej prej veprave të tij. Ja se çfarë thotë ai:

Me anë të besimit Abrahami, pasi u vu në provë, ofroi Isakun dhe ai që kishte pritur premtimet ofroi birin e tij të vetëm, ndonëse Perëndia i pati thënë: "Te Isaku do të quhet pasardhja jote (që do të mbajë emrin tënd)", sepse Abrahami mendonte se Perëndia ishte i fuqishëm sa ta ringjallte edhe prej së vdekurish; prej të cilëve edhe e

2 Shih Arndt and Gingrich, 'τελειόω', 809–810.

mori atë përsëri si një lloj figure. (Heb 11:17-19)

Nga kjo është e qartë se Abrahami nuk ishte thirrur thjesht për të bërë një vepër të mirë, si: të jepje para për bamirësi apo të ushqejë të varfërit. Qe një vepër, e përcaktuar nga Perëndia, për të provuar besimin e tij. Më përpara Abrahami ishte ankuar që Perëndia nuk i kishte dhënë ndonjë djalë për ta lënë pas si trashëgimtar; dhe kështu, kur të vdiste, për rrjedhojë, një nga shërbëtorët e tij do të trashëgonte gjithçka (Zan 15:1-4). Atëherë Perëndia i premtoi Abrahamit se do t'i jepte një djalë dhe trashëgimtar dhe përmes atij djali do të sillte në jetë turma trashëgimtarësh. Abrahami i besoi Perëndisë për këtë dhe kjo iu numërua për drejtësi.

Por përmbushja e premtimeve donte shumë kohë të bëhej realitet. Kur më në fund u afrua koha, Sara ishte ende shterpë njësoj si më parë; dhe përveç kësaj ajo ishte e shkuar në moshë. Sa i përket aftësisë për të ngjizur fëmijë, Abrahami mezi qëndronte në këmbë. Kështu, lindja e Isakut ishte një mrekulli. Pastaj kur djali po rritej, Sara shprehu atë që për të, por edhe për Abrahamin gjithashtu, ishte çështja më e rëndësishme të cilën Abrahami e kishte biseduar më parë me Perëndinë: cili do të ishte trashëgimtari i Abrahamit kur ai të vdiste? Për këtë Ismaeli dhe e ëma e tij u dëbuan: “sepse i biri i kësaj shërbyeseje” – tha Sara – “nuk duhet të jetë trashëgimtar me birin tim, me Isakun”. (Zan 21:10).

Pastaj, para se Isaku të mbushte moshën për martesë, dhe të kishte edhe ai një djalë për të filluar linjën e gjatë të pasardhësve të premtuar, Perëndia iu afrua Abrahamit me kërkesën që ta flijonte Isakun si një kurban. Kjo ishte një sfidë e fortë për besimin e Abrahamit. Të gjitha shpresat e tij për të ardhmen qenë mbështetur tek Isaku. Nëse Isaku do të flijohej tani, Abrahami nuk do të kishte më pasardhës sipas premtimit të Perëndisë (krhs. Zan 17:18-21). Në moshën që kishte, ai nuk mund të shpresonte se do të bëhej baba sërish.³

Pyetja që sprova e Perëndisë ngriti për Abrahamin ishte: në

3 Fakti që Zanafilla 25 përmend se Abrahami mori gra të tjera dhe lindi disa fëmijë nuk do të thotë se ai e bëri këtë menjëherë pasi Sara i vdiq. ‘Ka shumë të ngjarë që ai u martua me Keturahun më herët ndoshta pasi ndau Aagarin.’ (Wenham, *New Bible Commentary*, 77).

dritën e shpresës për të ardhmen, a ishte besimi i tij te Isaku apo te Perëndia? Kjo ngjarje provoi përtej çdo dyshimi se besimi i tij ishte vetëm dhe plotësisht te Perëndia. Letra e Hebrenjve e përmbledh me saktësi atë që po luhej:

... ai që kishte pritur premtimet ofroi birin e tij të vetëm, ndonëse Perëndia i pati thënë: “Te Isaku do të quhet pasardhja jote që do të mbajë emrin tënd”, sepse Abrahami mendonte se Perëndia ishte i fuqishëm sa ta ringjallte edhe prej së vdekurish; (Heb 11:17-19)

Vepra përmes të cilës Abrahami u shfajësua ishte një vepër që tregonte se besimi i tij ishte vetëm te Perëndia. Që nga fillimi Perëndia kishte bërë premtime dhe këto premtime, me këmbënguljen e Perëndisë, ishin për Isakun dhe jo për Ismaelin. Nëse Perëndia tani do të kërkonte që ai të sakrifikonte Isakun, Abrahami do ta sakrifikonte atë. Por Perëndia nuk mund të gënjente apo të thyente premtimet e tij. Perëndisë do t'i duhej, dhe ai do ta bënte, që ta ngjallte Isakun; kjo i vinte kapakun gjithçkaje.

Tani Abrahami ishte një nomad i pasur, një sheik. Nëse Perëndia do t'i kërkonte që t'ua dhuronte bagëtinë e tij të varfërve dhe Abrahami do ta kishte bërë këtë, kjo sigurisht që do të kishte qenë një vepër e mirë. Kjo do të kishte kënaqur gjithashtu kërkesën e Jakobit që besimi të mos mjaftohet vetëm me fjalë, por të tregojë veten përmes veprave (Jakobi 2:14-17). Sidoqoftë, kjo nuk do të kishte treguar se besimi i tij qe vetëm te Perëndia në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtën masë siç e tregoi flijimi i tij i Isakut.

UDHËZIMI 5:

Kur Dhiata e Re përmend disa pjesë të një rrëfenje të Dhiatës së Vjetër dhe pastaj e zbaton mësimin e saj për ne, është mirë ta studiosh rrëfenjën në kontekstin e saj të ngushtë për të dalluar se sa i përshtatshëm do të ishte ky zbatim.

Autori i Hebrenjve citon po ashtu nga Zanafilla 22 bekimin e madh që Perëndia shpalli mbi Abrahamin. Pastaj ai nxjerr dy mësim nga ky citat: një në lidhje me vetë Abrahamin dhe një tjetër në lidhje me trashëgimtarët e premtimit duke na përfshirë

edhe ne. Citati është si më poshtë:

Sepse kur Perëndia i dha premtimin Abrahamit, duke qenë se skishte ndonjë më të madh që të përbetohej, bëri be me veten e tij duke thënë: “Sigurisht do të të bekoj dhe do të të shumoj fort”. (Heb 6:13–14)

Autori supozon se lexuesit e tij do të mbajnë mend hyrjen e këtij bekimi te rrëfenja e Zanafillës: “Engjëlli i Zotit e thirri për të dytën herë Abrahamin nga qielli dhe tha: “Unë betohem për veten time, thotë Zoti, se ti e bërë këtë dhe nuk kurseve tët bir, të vetmin bir që ke” (Zan 22:15–16). Në dritën e kësaj, autori bën dy vëzhgime.

Vëzhgimi i parë

Ky premtim prej Perëndisë ka të bëjë me kohën në jetën e tij dhe rrethanat në të cilat Abrahami e mori atë.

Fjalët e autorit janë: “Dhe kështu Abrahami, duke pritur me durim, fitoi premtimin.” (Heb 6:15). Dhe me këtë nuk përsërit thjesht premtimin që Abrahami mori fillimisht te Zanafilla 15, por fillimet e para të përmbushjes së tij në “ringjalljen” prej së vdekurish të Isakut.

Për lexuesit e parë të autorit është urgjentisht e nevojshme të ndjekin shembullin e durimit të Abrahamit. Ca kohë më parë ata kishin bërë një rrëfim besimi në Krishtin; por kohët e fundit sjellja e tyre të jepte përshtypjen se e kishin braktisur atë rrëfim, për shkak të flakës së përndjekjes (Heb 12–6:1). Ata duhej ta mësonin dhe pastaj ta ndiqnin shembullin e stërgjyshit të tyre Abraham, të cilit i duhej të priste me durim dhe të kalonte në shumë sprova para se të merrte këtë bekim të fuqishëm prej Perëndisë (krhs. Heb 6:11–12; 10:35–36).

Vëzhgimi i dytë

Betimi që bëri Perëndia ishte për të mirën e të gjithë trashëgimtarëve të premtimit duke na përfshirë edhe ne aty. U garantonte atyre një siguri të ngjashme me ankorimin e një anijeje (6:17–20).

Tani, nëse do të bëjmë sipas asaj që Udhëzimi 5 ka sugjeruar,

do të zbulojmë se kjo çështje e sigurisë nuk është një temë që autori i Hebrenjve e ka nxjerrë përmes një deduksioni logjik, nga ato pak vargje që flasin për betimin e Perëndisë. Kjo është në fakt hera e tretë që çështja e sigurisë del në sipërfaqe në kontekstin e ngushtë të Zanafillës.

Te Zanafilla 21:8–12 Sara, duke patur instiktin e një nëne që dëshiron të sigurojë trashëgiminë e birit të saj të vërtetë përballë çdo rivali të mundshëm siç janë Ismaeli dhe pasardhësit e tij, deklaroi: “i biri i kësaj shërbyese nuk duhet të jetë trashëgimtar me birin tim, me Isakun”. Ajo nguli këmbë që Abrahami të dëbonte Agarin dhe djalin e saj; pastaj Perëndia i tha Abrahamit të bënte atë që kishte kërkuar Sara. Perëndia i shpjegoi arsyen Abrahamit: Perëndia ishte i vendosur të garantonte që pasardhësit e Abrahamit të vinin përmes Isakut, djali që Perëndia i kishte premtuar Abrahamit, dhe vetëm përmes tij. Perëndia do të ngrinte një komb edhe nga Ismaeli, gjithashtu, për shkak se ai ishte djali i Abrahamit. Por nuk ishte djali që Perëndia i kishte premtuar Abrahamit. Vetëm përmes Isakut do të ishte i sigurt qëllimi i Perëndisë për bekimin dhe shpëtimin e botës.

Te Zanafilla 21:22–34 mbreti filiste Abimelek, duke patur shqetësimin e një babai për të birin, kështu edhe për dinastinë e tij, i kërkoi Abrahamit të bënte një traktat me atë. Abimeleku kishte frikë se mos, pas vdekjes së tij, Abrahami do të thyente traktatin e pashkruar të miqësisë së dyanshme që kishin mes tyre dhe të sulmonte djalin dhe pasardhësit e tij.

Abrahami pranoi me dëshirë për të bërë një traktat me Abimelekun që do të garantonte sigurinë e djalit të tij. Bashkarisht Abrahami dhe Abimeleku u betuan për të konfirmuar traktatin; pas kësaj Abimeleku dhe shpura e tij u kthyen në shtëpi. Por Abrahami mbolli një pemë në atë vend dhe e quajti Beer-sheba. E përkthyer do të thotë “Pusi i betimit” për shkak të betimit që të dy (ai dhe Abimeleku) kishin bërë për të garantuar sigurinë e birit të Abimelekut. Atje Abrahami i bëri thirrje emrit të Zotit, Perëndisë së përjetshëm.

Siguri për djalin e Sarës. Siguri për djalin e Abimelekut. Por çfarë të themi për sigurinë e djalit të Abrahamit dhe pasardhësve të tij? Ku do ta gjente ai këtë?

Ai e gjeti atë më në fund në betimin e Perëndisë; dhe në kujtesën e paharrueshme të atij betimi, ai zbriti nga mali dhe banoi në një vend të quajtur Beer-sheba (22:19).⁴ Që do të thotë sërish “Pusi i betimit”, por këtë herë, i betimit të Perëndisë.

Por fokusi i Zanafillës 22 është *procesi* përmes të cilit Abrahami zbuloi sigurinë. Përmes udhëheqjes së Perëndisë, Abrahami, tashmë burrë plak, qëndronte mbi majën e malit bashkë me të birin në të cilin të gjitha premtimet dhe shpresat e tij ishin mbështetur, duke e lidhur mbi altar dhe me thikën e ngritur në dorën e vet gati, që me urdhërin e Perëndisë, të vriste birin e tij dhe të ngelej, për aq sa e dinte, pa gjë, pa shpresë për të ardhmen, pa asgjë përveç Perëndisë dhe premtimeve të Perëndisë dhe besimit të tij në këto premtime. Por në këtë botë të paqëndrueshme nuk ka siguri më të madhe se, kur je pa ndonjë shpresë në diçka tjetër, të kesh shpresë vetëm te Perëndia dhe besim tek ai dhe premtimet e tij. Kjo është siguria e përfundimtare.

UDHËZIMI 6:

Tërësia e një rrëfenje të Dhiatës së Vjetër është frymëzuar prej Perëndisë dhe jo vetëm pjesët që citon Dhiata e Re. Prandaj ne duhet ta trajtojmë të gjithë ndodhinë seriozisht, sikur të ishte një rrëfenjë e plotë në vetvete.

Kjo do të thotë që duhet t’i kushtojmë kujdes strukturës së saj dramatike dhe ndikimit që kjo strukturë ka mbi zhvillimin e idesë gjatë gjithë ndodhisë. Ne duhet të vëzhgojmë kulmet e saj, qofshin ato të mëdha apo të vogla. Duhet të përpiqemi të kuptojmë kuptimin e saktë të termave të saj teknikë dhe duhet të ndiejmë ngarkesën emocionale të frazave të saj. Mbi të gjitha, ne duhet të lejojmë personazhet e ndryshme në ndodhi të na zbulojnë domethënien e ngjarjeve, ashtu si ata i përjetuan ato.

Katër pjesët kryesore të rrëfenjës

E para është thirrja e Perëndisë për Abrahamin që t’ia flijojë Isakun si kurban Perëndisë; pastaj reagimi i Abrahamit deri në

⁴ Nëse bëhet fjalë gjeografikisht për të njëjtin vend ose jo që përmendet te Zanafilla 21, kjo nuk ngre shumë pyetje.

pikën dramatike ku ai ngre thikën për të vrrarë të birin (Zan 22:1-10).

Pastaj Engjëlli i Zotit thërret prej qiellit duke i thënë Abrahamit të mos e flijojë birin e tij, sepse “tani e di mirë që ti i trembesh Perëndisë, se nuk më ke refuzuar birin tënd, të vetmin bir që ke” (22:11-12).

E treta, Abrahami duke parë vërdallë, pikas një dash me brirë të ngecur në shkurre dhe e flijon atë si një kurban në vend të të birit. Ai e quan këtë vend “Jehovah Jireh. Prandaj edhe sot e kësaj dite thuhet: Do të furnizohet mali i Zotit.” (22:13-14).

Së fundi, Engjëlli i Zotit flet prej qiellit një herë të dytë duke deklaruar qëndrimin që do mbajë Perëndia për veprimin e Abrahamit që nuk ia kurseu birin e vet Perëndisë. Qëndrimi ishte premtimi i bekimit të Perëndisë të garantuar prej betimit të Perëndisë (19-22:15).

Ne mund të pyesim pse Engjëlli duhet të fliste prej qiellit dy herë. Pse nuk i tha të gjitha që duhet të thoshte që herën e parë?

Përgjigjja e parë e thjeshtë është që ai duhet të fliste në momentin e duhur siç bëri sepse, përndryshe, pesë sekonda më vonë, Isaku do të kishte vdekur. Përgjigjja e dytë e thjeshtë është se ajo që Abrahami bëri mes herës së parë dhe së dytë duhet të ketë qenë kaq e rëndësishme dhe e domosdoshme, saqë, pa atë, thirrja e dytë nuk do të bëhej. Përgjigjja më e kujdesshme do të ishte që çështjet në fjalë, të përmbledhura prej thirrjes së parë të Engjëllit, qenë të ndryshme prej çështjeve të përmbledhura në thirrjen e dytë.

Çështjet në fjalë në thirrjen e parë

Fakti i shpallur prej Engjëllit ishte ky: pasi kishte urdhëruar Abrahamin të flijonte të birin si kurban, Perëndia ishte i kënaqur të pranonte qëndrimin e zemrës së Abrahamit, vendimin e tij të palëkundur për t’ia flijuar birin e tij Perëndisë, të demonstruar përmes hapave të vështira praktike që ai vërtet hodhi për ta bërë kurbanin. Por Perëndia nuk e lejoi atë ta vriste të birin.

Këtu gjejmë përgjigje për disa nga pyetjet e ngritura te Kapitulli 5. Pse Perëndia e vuri në provë Abrahamin për të bërë atë që është e ndaluar diku tjetër në Dhiatën e Vjetër, d.m.th. bërjen fli të kurbaneve njerëzore? Përgjigjja e parë e thjeshtë

është që Perëndia nuk e lejoi Abrahamin të flijonte të birin. Ai e ndaloi atë së bëri këtë gjë.

A do të thotë kjo që Perëndia vetëm bënte gjoja sikur dëshironte që Abrahami ta flijonte birin e tij? Jo, nuk do ishte e vërtetë po të shpreheshim kështu.

Së pari, çdo gjë e mirë që kemi vjen prej Perëndisë. Perëndia ka të drejtën të na kërkojë neve t'ia kthejmë atij ato. Kjo është e barabartë me atë që Krishti urdhëron: "Nëse ndokush vjen tek unë dhe nuk urren babanë e vet dhe nënën e vet, gruan dhe fëmijët, vëllezërit dhe motrat, madje edhe jetën e vet, nuk mund të jetë dishepulli im." (Luka 14:26).⁵

Së dyti, për të mirën e Abrahamit, Perëndia duhet t'i mësonte atij, siç edhe e kemi parë, të vendoste të gjithë besimin dhe shpresat e tij për të ardhmen te Perëndia dhe jo tek Isaku.

Tani, Perëndia mund t'i kishte thënë edhe kështu Abrahamit: "Po të ta kërkoja, a do të ma jepje mua birin tënd?". Dhe me shumë gjasa Abrahami mund t'i kishte thënë: "Po, pa asnjë mëdyshje!" Por sa realiste do të kishte qenë kjo përgjigje? Vërtetësia e qëndrimit të zemrës së Abrahamit mund të demonstrohej vetëm kur të përballej me një situatë reale në jetë, dhe të ishte i gatshëm të hidhte hapat e nevojshëm praktikë.

Megjithatë, sipas deklaratës së parë të Engjëllit, demonstrimi praktik i zemrës që Abrahami bëri, mjaftonte për Perëndinë pa e bërë vërtet flimin e birit të tij.

Çështjet në fjalë herën e dytë

Pasi hoqi dorë prej flimit të djalit sipas thirrjes së Engjëllit, Abrahami pa përreth dhe vuri re një dash. Ai e mori dhe e ofroi si një flim për Perëndinë. Por në këtë pikë ne duhet të vëmë re termat tona teknike. Abrahami nuk ia ofroi dashin si një flim *falënderimi* Perëndisë ngaqë ai e kishte shpëtuar nga agonja e të bërit kurban të të birit. Ai e ofroi këtë si një *olokaust* në vend të Isakut.

Kjo është shumë domethënëse. Kërkesa fillestare e Perëndisë

⁵ 'Urrej' këtu duhet të kuptohet jo në mënyrën e saj moderne, por në kuptimin e saj të lashtë semit: 't'i japësh vendin e dytë dhe jo të parë'. Krhs. Zan 29:31. Ne duhet të vëmë Krishtin para të gjitha marrëdhënieve të tjera.

ishte që ai të ofronte Isakun si kurban. Kjo kërkesë nuk qe sa për sy e faqe. Sakrifika nuk mund të mos bëhej. Duhej të bëhej plotësisht dhe, në fakt, u çua deri në fund kur Abrahami ofroi dashin në vend të të birit si zëvendësim për Isakun (Zan 22:13). Dhe Abrahami e kuptoi se ky zëvendësim për Isakun qe siguruar prej Perëndisë, një zëvendësim nga vetë Perëndia që fillimisht e vuri në provë (22:1). Pikërisht këtij fakti i kushtoi vëmendje kur e emërtoi vendin, në mënyrë që brezat e ardhshëm të mund të dinin domethënien e asaj që ndodhi atje. Sepse ai nuk e quajti atë "vendi i triumfit të besimit tim" apo ndonjë gjë të tillë që do të përkujtonte arritjen e tij shpirtërore. Ai e quajti "Jahveh Jireh", "Zoti do të sigurojë", një premtim i mbështetur mbi përvojën e furnizimit të Perëndisë të një zëvendësuesi për birin e tij, Isakun. Le të kapen fort pas këtij premtimi të gjithë ata që vihen në provë prej Perëndisë në të ardhmen (krhs. 1 Kor 10:13).

UDHËZIMI 7:

Pasi kemi studiuar kontekstin e saj të ngushtë, ne duhet të marrim në konsideratë domethënien e mundshme prototipike të rrëfenjës.

Sigurimi i një kafshe, që mund të flijohet si zëvendësim për një qenie njerëzore, shton edhe një nivel më shumë kuptimi për rrëfenjën. Por në skemën madhore, asnjë kafshë nuk mund të ishte një zëvendësim i mjaftueshëm për një qenie njerëzore. Sakrifika të tilla zëvendësuese të Dhiatës së Vjetër ishin vetëm hije që tregonin në mënyrë prototipike drejt sakrificës së Krishtit që po vinte. Instikti i krishterë nuk gabon aspak kur shprehet se ngjarja e sakrifikimit të të birit nga Abrahami, në njëfarë mënyre ose tjetër ishte një hije për Krishtin, zëvendësuesin tonë të madh; por ne duhet ta lejojmë ngjarjen si një e tërë të përcaktojë se në çfarë kuptimi kjo është e vërtetë. Sipas Dhiatës së Re, domethënia parësore e ngjarjes është shfajësimi i Abrahamit prej veprave; ne nuk duhet të lëmë mënjanë interpretimin që Dhiata e Re i bën asaj për të vërtetuar interpretimin tonë vetjak tipologjik. Prandaj, si lidhet flimi i Krishtit me shfajësimin tonë përmes veprave?

Si përgjigje, ne duhet së pari të hetojmë se çfarë standardesh kërkon Perëndia që ne të përmbushim nëse do të shfajësohemi përmes veprave tona. Kush mund t'i përgjigjet kësaj? A do të mjaftojë 75% apo bën punë edhe më pak? A do të kënaqet Perëndia me vepra të një cilësie më të ulët? Aspak! P.sh., Krishti thotë: “Dhe unë po ju them: Kushdo që do të rrëfejë për mua përpara njerëzve, edhe Biri i njeriut do ta rrëfejë përpara engjëjve të Perëndisë. Por ai që do të më mohojë përpara njerëzve, do të mohohet përpara engjëjve të Perëndisë.” (Luka 9–12:8). A do të mendojmë vallë se nëse e mohojmë atë herë pas here nuk ka edhe aq shumë rëndësi?

Normalisht besimtarët dëshirojnë që, përmes veprave dhe devocionit të tyre ndaj Krishtit, t'i provojnë se janë dishepuj të vërtetë. Shumica kanë sukses me këtë. Por ndonjëherë ata sillen si të njëmbëdhjetët. Apostujt në përgjithësi, dhe Pjetri në veçanti, këmbëngulën se do ta ndiqnin Krishtin kudo që të shkonte, madje edhe në burg, edhe në vdekje – dhe ata e kishin seriozisht. Por kur erdhën në Gjetsemani, dhe iu kërkuar të rrinin zgjuar me Krishtin, u treguan të dobët dhe i zuri gjumi.

A kishte rëndësi ky dështim në përkushtimin e tyre? Patjetër që kishte rëndësi; Krishti i qortoi ata për këtë dhe u bëri thirrje: “Rrini zgjuar dhe lutuni, që të mos bini në tundim; sepse fryma është gati, por mishi është i dobët” (Mat 26:41). Por ata i zuri gjumi sërish; dhe për pasojë, Pjetri, i papërgatitur i gjithi, hyri në oborrin e kryepriut, u vu në provë, dështoi në mënyrë mjerane dhe e mohoi Zotin.

Krishti, sipas Lukës, e kishte parathënë këtë dhe u lut për Pjetrin që, pavarësisht kësaj, besimi i tij të mos thyhej; kështu Pjetri në fund u mëkëmb (Luka 22:31–34, 54–62). Por ky dështim në përkushtimin e tij qe një mëkat i rëndë para Perëndisë dhe duhej të shlyhej. U shlye një ditë. Me të vërtetë, në atë moment në Gjetsemani kur përkushtimi i Pjetrit dhe i të tjerëve dështoi, Krishti, në përkushtim të përsosur ndaj Perëndisë, u lut: “Jo vullneti im por yti, u bëftë!” Kështu, i përgatitur prej lutjes, ai ia ofroi veten Perëndisë mbi kryq si zëvendësuesi i tyre për të mbuluar jo vetëm mëkatet e tyre para kthimit, por edhe

dështimet në sjelljen e tyre pas kthimit. Ai e bën këtë për çdo besimtar të vërtetë.

...

Pyetjet e studimit për këtë kapitull mund t'i gjeni në faqen 443.

24

Ndodhia e Davidit dhe Goliathit

Tani, më në fund, do të studiojmë një rrëfenjë nga Dhiata e Vjetër për të cilën Dhiata e Re nuk bën asnjë koment të hollësishëm. Këtu, si të thuash, jemi vetëm. Si do ta shtjellojmë atë? Si të nxjerrim prej andej mësimin që është për ne? Pastaj, kur të kemi bërë interpretimin tonë, si mund të jemi të sigurt se është i vlefshëm?

Mësime që edhe mund të vihen re

Reagimi i disa njerëzve ndaj këtyre pyetjeve mund të jetë se po tregohemi tepër të kujdesshëm dhe se këto pyetje janë të panevojshme. Ata thonë se ndodhia e ka qartësisht në vetvete mësimin e saj madhor: guximi i pashembullt i Davidit që ishte mbështetur në besimin e tij te Perëndia.

Kjo është e vërtetë deri në njëfarë pike. Dhiata e Re bie dakort me këtë. Ajo nuk përmend specifikisht përleshjen e Davidit me Goliathin, por e vë emrin e Davidit në listën “e asaj reje të madhe dëshmitarësh” që dëshmojnë se ne gjithashtu jemi thirrur të kemi të njëjtin lloj besimi, guximi dhe këmbënguljeje si e kishin ata (Heb 11:32; 12:1). Si mund të ketë ndonjë problem me shtjellimin e ndodhisë dhe zbatimin e saj për ne sot?

Aq më shumë se ndodhia mbart haptas edhe një mësim

tjetër praktik në vetvete. Këtë e bën përmes shpjegimit që Davidi i jep Saulit sesi ndodhi që ai pati besimin e jashtëzakonshëm që të dilte vullnetar për t’u përleshur me Goliathin deri në vdekje në fushëbetejë (1 Sam 17:33–37). Nuk ishte shfaqja e papritur e Goliathit ajo që ndezi te Davidi një flakë të pazakonshme besimi dhe guximi. Nëse do të ishte kështu, siç e tha edhe vëllai i madh i Davidit, nuk do të ishte gjë tjetër veçse budallallëk i adoleshencës (1 Sam 17:28). E kundërta që e vërtetë. Guximi dhe besimi i Davidit ishin zhvilluar gjatë disa viteve në gjërat praktike të jetës së përditshme duke u kujdesur për delet e familjes. Kur bishat e sulmonin tufën, ai i besonte Perëndisë se do t’i jepte forcë për t’i sulmuar dhe vrarë ato. Ai kuptoi kështu se besimi te Perëndia funksionoi; dhe ky ishte bërë, për pasojë, një qëndrim i patundur zemre. Besimi te Perëndia do të funksiononte përsëri nëse Sauli do ta lejonte atë të përballej me Goliathin në betejë.

Nuk duhet ndonjë analizë e madhe prej eksperti për të dalluar se çfarë mësimi na jep ajo.

Mësime prej interpretimit analogjik

Në fund të Kapitullit 8 pamë se analogjia jo vetëm vlen si një mjet që *ne* mund të përdorim sot për të zbatuar një mësim nga Dhiata e Vjetër për vetveten, por është një mjet që *vetë Dhiata e Re* e përdor. Prandaj ne nuk mund të kemi domosdoshmërisht asnjë kundërshtim në përdorimin e analogjisë kur aplikojmë për veten shembullin e përleshjes së Davidit me Goliathin.

Davidi luftoi kundër gjigantit filiste: ne duhet të luftojmë me “principatat, fuqitë, sunduesit botërorë të kësaj errësire dhe forcave frymërore të ligësisë në vendet qiellore”.

Lloji i luftës që bëri Davidi ishte i ndryshëm nga kjo e jona. Ai luftoi me armë materiale: ne me frymërore. Por lufta jonë është po aq e vërtetë sa e tij; po ashtu, metaforat, që përdoren për të përshkruar armatimin tonë për luftë, janë marrë prej armatimit real që çdo ushtar në botën e lashtë do të kishte përdorur (Efes 6:10–20).

Mësimet prej interpretimit tipologjik

Disa vazhdojnë edhe më shumë. Ata sugjerojnë se fitorja e Davidit mbi Goliathin paraprin triumfin e Krishtit mbi djallin. Ata e mbështetën sugjerimin e tyre mbi ngjashmërinë mes mënyrës që Davidi mposhti gjigantin dhe mënyrës që thuhet se Krishti e ka shkatërruar djallin (Heb 15–2:14). Pasi mundi Goliathin, Davidi përdori shpatën e Goliathit për të prerë kokën e Goliathit (1 Sam 17:51): kështu te Hebrenjve 2:14–15 djalli përshkruhet si ai që ka fuqinë e vdekjes dhe Krishti e shkatërron atë përmes vdekjes.

Pyetje rreth këtyre mësimëve

Qoftë interpretimi analogjik, qoftë ai tipologjik e mendojnë Goliathin si përfaqësues, apo një hije, të vetë djallit apo fuqive të tij demonike. Por ne mund të pyesim në mënyrë të arsyeshme nëse këto interpretime rrjedhin natyrshëm prej kësaj forme të veçantë të strategjisë së lashtë ushtarake, e cila përshkruhet me hollësi në këtë rrëfenjë. Ndoshta është kështu, ndoshta jo. Por përfundimet tona do të ishin më të sigurta nëse kthehemi sërish te fillimi, dhe e nisim shtjellimin tonë duke studiuar elementet e vërtetë historikë të ngjarjes.

Pastaj, gjatë rrugës, ne mund të pyesim se çfarë domethënie pati dueli mes Davidit dhe Goliathit për autorin e frymëzuar të 1 Samuelit. A ishte për të një rast i vetëm, i veçantë, që nuk lidhet me çfarë e ka paraprirë? Apo ishte kulmi i një zhvillimi ideor të filluar në kapitujt e mëparshëm?

UDHËZIMI 8:

Filloni me kuptimin historik, të drejtpërdrejtë të rrëfenjës së Dhiatës së Vjetër.

Një formë e veçantë e strategjisë luftarake të lashtë

Përleshja mes Davidit dhe Goliathit që një formë e veçantë luftimi e njohur si dyluftimi mes heronjsh. Ai është i vetmi rast i dokumentuar në Dhiatën e Vjetër, por shembuj të tjerë mund të gjenden në letërsinë e kombeve të tjera nga kohë dhe vende

të ndryshme. Poeti grek, Homeri, dokumenton gjerësisht duelin mes heroit trojan, Paridit, dhe heroit grek, Menelaut, si edhe një duel të ngjashëm mes Hektorit, trojanit, dhe Ajaksit, grekut (*Iliada*, përkatësisht, Libri 3 dhe Libri 7). Epika e mëvonshme irlandeze, *Tain*, po ashtu përshkruan shumë duele të ngjashme mes Kukulinit, heroit nga Ulsteri, dhe heronjve të njëpasnjëshëm të dërguar kundër tij prej armiqve nga provincat e tjera të Irlandës dhe, përfundimisht, duelin e famshëm që zgjati disa ditë mes Kukulinit dhe Ferdias. Të gjithë këto dule, tek *Iliada* dhe *Taini*, janë shembuj të dyluftimit mes heronjve.

Tiparet e veçanta të dyluftimit mes heronjve

1. Kur dy ushtri luftonin me njëra-tjetrën, ishte e lejueshme që të ndalonin betejën, të paraqitnin një nga luftëtarët e tyre, më trimin, dhe të sfidonin palën tjetër që edhe ajo, po ashtu, të paraqiste një nga luftëtarët e saj që ata të mund të dyluftonin duke përfaqësuar secili palën e vet.

2. Pasi bëhej sfida, të dyja ushtritë duhej të mos ndesheshin më dhe të ulnin armët. Pastaj shpallej një armëpushim. Gjatë armëpushimit askush prej palës tjetër nuk lejohej të godiste palën kundërshtare dhe aq më pak heroin e prezantuar, sepse kështu do të thyente armëpushimin e shenjtë.

3. Disa herë luftëtari i përzgjedhur prej palës që bënte sfidën ishte aq i fuqishëm, sa që pala tjetër do të kishte vështirësi të mëdha në përzgjedhjen e një luftëtari nga vetë rangjet e tyre, aq të fuqishëm dhe të guximshëm sa duhej për t'u përballur dhe luftuar me heroin e armikut.

4. Ndërkohë luftëtari i palës sfiduese mund të afrohej deri te pararoja e armikut dhe t'i tallte ata, pa patur frikë që do ta qëllonin përderisa armëpushimi ende ishte në fuqi.

5. Nëse ushtria tjetër pranonte sfidën, do të shpalleshin kushtet e duelit dhe do të pranoheshin në lidhje me atë që duhet bënte ose pësonte ushtria humbëse.

6. Pastaj të dy luftëtarët dilnin secili nga kampi i vet në një fushëbetejë neutrale dhe i afroheshin njëri-tjetrit derisa të mund të dëgjonin se çfarë do t'i thoshnin njëri-tjetrit. Pastaj ata prisnin ndërsa secili hero dënonte kundërshtarin e tij dhe

e paralajmëronte për humbjen e dhimbshme që do të pësonte.

7. Pasi kjo qe bërë, ata i afroreshin njëri-tjetrit dhe luftonin me armë të ndryshme që përgjithësisht përshkruhen me hollësi, përderisa zgjedhja e armatimit dhe pajimeve dhe aftësia me të cilat armët përdorëshin ndikonin shumë në rezultatin përfundimtar.

8. Lufta vazhdonte derisa një nga heronjtë vritej (apo, me raste, kur një nga heronjtë dhe ushtria që ai përfaqësonte do të pranonte mposhtjen).

Krëfenja e Davidit dhe Goliathit ka në vetvete të gjitha këto elemente

1. Ushtria filisteje dhe ajo izraelite ishin gati për betejë kur filistejtë nxorën në shesh një luftëtar kampion, Goliathin, i cili i sfidoi izraelitët që edhe ata të zgjidhnin një luftëtar të tyre për t'u përleshur me të në një dyluftim trimash (1 Sam 17:1–10, 21, krhs. elementi 1 më sipër).

2. Paraqitja fizike, takëmet dhe armët e Goliathit përshkruhen me hollësi (1 Sam 17:4–7, krhs. elementi 7 më sipër).

3. Kushtet sipas të cilave do të kryhet dueli janë bërë të njohura: nëse hero i izraelit mund heroin filiste, të gjithë filistejtë do të bëhen shërbëtorë të izraelitëve. Nëse Goliathi mund heroin izraelit, të gjithë izraelitët do të bëhen shërbëtorë të filistejve (1 Sam 10–17:8, krhs. elementi 5 më sipër).

4. Kur dëgjojnë sfidën e Goliathit, izraelitët i zë paniku. Asnjë prej tyre, as edhe vetë Sauli apo Jonathani, nuk bëhet gati për ta pranuar sfidën (1 Sam 17:11, 24, krhs. elementi 3 më sipër).

5. Pasi është bërë e njohur sfida dhe është shpallur armëpushimi, hero i filiste është i lirë të afrohet deri te pararoja e izraelitëve pa patur frikë se do ta sulmojnë (1 Sam 17:23, krhs. elementi 4 më sipër).

6. Kur Davidi del vullnetar të luftojë me Goliathin, theksohet shumë zgjedhja e pajimeve dhe armëve nga Davidi (1 Sam 17:38–40, 43, krhs. elementi 7 më sipër), dhe si i përdori ato armë në dyluftim (50–17:48).

7. Davidi dhe Goliathi dalin përkatësisht nga kampet e tyre

dhe përparojnë drejt njëri-tjetrit derisa të mund të dëgjojnë zërat e tyre (1 Sam 17:40–41). Pastaj ata ndalen dhe Goliathi denoncon dhe mallkon Davidin (17:42–44), dhe Davidi, nga ana tjetër, shpall vdekjen e afërt të Goliathit (17:45–47) (shih elementin 6 më sipër).

8. Dy heronjtë fillojnë luftën dhe shumë shpejt Davidi e vret Goliathin (1 Sam 17:48–51).

Tipari i veçantë i duelit mes Davidit dhe Goliathit

Ne jemi tani në një pozitë ku mund të kuptojmë formën e lashtë të luftës të njohur si dyluftim heronjsh. Mund të kuptojmë që rrëfenja e Davidit me Goliathin përputhet me këtë formë të lashtë lufte – përveç në një tipar të veçantë: dy ndërluftuesit nuk janë të barabartë mes vetes. Nga njëri krah, gjiganti filiste, me përmasa shumë të mëdha, i rrahur në beteja dhe, përveç këtyre, i pajisur me armë jashtëzakonisht shumë të mëdha dhe një ndihmës që mban mburojën e tij në fushëbetejë. Nga krah tjetër një çunak, pothuajse pa përvojë ushtarake dhe i armatosur vetëm me një shkop dhe një hobe.

Kur filisteu pa Davidin, ai u ofendua. Nuk mund të mbante veten nga provokimi i Izraelit në dërgimin e një kundërshtari kaq të përbuzshëm, pothuajse të paarmatosur dhe me ca armë qesharake. Por Davidi i tha atij se për çfarë bëhej fjalë në të vërtetë në atë përleshje: “Ti po më vjen me shpatë, me shtizë dhe me ushtë; kurse unë po të dal në emër të Zotit të ushtrive, Perëndisë të ushtrisë së Izraelit që ti ke fyer.” (1 Sam 17:45). Nuk qe në lojë se kush ishte burri më i fortë, luftëtar më me përvojë, më shumë i armatosur apo më i shkathët në taktikë. “Përfundimi i betejës varet nga Zoti” (1 Sam 17:47).

Një gjë mund të thuhet menjëherë: dyluftimi mes heronje nxori në pah se për çfarë bëhej fjalë shumë më qartë sesa mund ta bënte një betejë në fushë të hapur.

UDHËZIMI 9:

Hetoni për shenjat që shprehin qëllimin e autorit në rrjedhën e mendimit brenda kontekstit të të gjithë rrëfenjës.

Dueli mes Davidit dhe Goliathit është kulmi i historisë që fillon me 1 Samuelin 8. Në atë kapitull pleqtë e vendit shkojnë te Samueli dhe i kërkojnë që të caktojë dikë të jetë mbret mbi ta. Qëllimet e tyre nuk ishin të pastra. Samueli kishte qenë gjyqtar shumë i ndershëm dhe besnik. Por bijtë e tij, që e zëvendësuan atë si gjyqtarë, ishin të korruptuar. Prandaj ishte e kuptueshme që pleqtë të mos i pranonin ata. Por ata nuk u kënaqën vetëm me zëvendësimin e këtyre personave të korruptuar me gjyqtarë më të ndershëm. Ata propozuan që ta zhbënin ofiqin e gjyqtarit plotësisht dhe ta zëvendësonin me një monarki. Samueli, që si gjyqtar u kishte shërbyer atyre për shumë vite, e kuptoi propozimin e tyre si një sulm personal kundër tij dhe ofiqit të tij, dhe prandaj u ofendua shumë nga kjo (1 Sam 8:6).

Por pleqtë kishin qëllime të tjera po ashtu, siç edhe ua nxori Samueli në shesh (1 Sam 12:6–13). Deri në atë ditë gjendja ishte e tillë: kur Izraeli që i shtypur në Egjipt, ata i thërritën Zotit dhe ai u dërgoi Moisiun dhe Aaronin për t'i çliruar nga Egjipti. Kur u futën në tokën e premtuar dhe harronin herë pas here Zotin dhe kompromentoheshin me idhujtarinë, Perëndia i lejonte armiqtë e tyre t'i mposhtnin dhe t'i sundonin ata. Pastaj e thërrisnin sërish Zotin dhe ai dëgjonte thirrjet e tyre dhe ngrinte një sërë çlirimtarësh.

Por më në fund ata u lodhën prej këtij procesi. Fakti që u duhej të thërrisnin Zotin sa herë që kishin përballë një ushtri armike e cila kërcënonte me skllavërim, dhe që u duhej të mbështeteshin te Perëndia për të ngritur një çlirimtar, me sa duket u shkaktonte shumë ankth. Kështu kur mbreti amonit, Nahashi, filloi t'i kërcënonte, ata i kërkuan Samuelit të krijonte një monarki të trashëgueshme. Në këtë mënyrë, kur një armik do t'i sulmonte, ata do të kishin një mbret të përzgjedhur dhe të gatshëm t'i mbronte, dhe nuk do të kishin pasigurinë që përfshihej kur duhej të thirrshin Zotin dhe të prisnin që ai të ngrinte një çlirimtar.

Perëndia e interpretoi këtë kërkesë si një refuzim të vetes (1 Sam 9–8:7). Jo se ai nuk e miratonte idenë e një monarkie të trashëgueshme në vetvete. Kapitulli 16 i të njëjtit libër na tregon sesi Perëndia dërgon Samuelin të vajosë Davidin si mbret, dhe 2 Samuelit 7 tregon për besëlidhjen e Perëndisë që garanton

të ardhmen e dinastisë mbretërore të Davidit. Ishte pikërisht *motivi* pas kërkesës së pleqve që nuk i pëlqente Perëndisë. Çdo organizatë apo institucion që ngrihet për të fshirë nevojën që kemi për t'u mbështetur te Perëndia ka një mangësi fatale.

Sidoqoftë, për çudinë e Samuelit, Perëndia e udhëzoi Samuelin ta pranonte kërkesën e pleqve. Ai do të vajoste Saulin dhe do t'ia paraqiste popullit si mbret. Perëndia do t'i mësonte popullit një mësim që ta mbante mend. Nga ana tjetër, ai nuk i shtrëngoi të pranonin përzgjedhjen e tij kundër vullnetit apo gjykimit të tyre. Kur populli e pa Saulin ata u kënaqën me përzgjedhjen e Perëndisë: sepse Sauli ishte një burrë shtatlartë. Ai ishte më i gjati nga të gjithë: “ishte më i lartë se gjithë njerëzit nga supi e lart.” (1 Sam 10:23). Me thënë të vërtetën, ditët e para pasi u zgjodh, Sauli pati disa suksese ushtarake të dukshme kundër armiqve të popullit të tij (11:1–15), siç ndodh rëndom me burrat e mëdhenj.

Por, të besosh te një burrë i madh në vend që të besosh te Perëndia, ka një dobësi fatale: një burrë i madh do t'ia dalë mbanë derisa një burrë akoma më i madh i del përpara. Kështu, një ditë, nga kampi armik doli një burrë gjigant, Goliathi (17:4–7); dhe ai e sfidoi Izraelin në një dyluftim trimash. Sapo e panë atë, burri i madh, Sauli, së bashku me pjesën tjetër të izraelitëve, u hyri frika në palcë (17:11).

Pastaj Davidi hyri në skenë dhe doli vullnetar për të luftuar kundër Goliathit. Sauli e kundërshtoi sugjerimin e tij si jashtëzakonisht të paqenë: Davidi ishte thjesht një kadet, Goliathi ishte kampioni më i madh i filistejve me shumë vite përvojë. Por Davidi këmbënguli. Ai shpjegoi se e gjitha kjo që një çështje besimi te Perëndia. Ai kishte mjaft përvojë besimi te Perëndia, i cili e kishte çliruar nga luanët dhe arinjë ndërsa ruante tufën e tij. Në të njëjtën mënyrë Perëndia do ta çlironte atë prej filisteut (17:33–37). Atëherë Sauli ra më në fund dakort ta lejonte Davidin të luftonte me Goliathin. Por tani objekt diskutimi u bë përzgjedhja e pajimeve dhe armëve. Sauli iu lut Davidit të përdorte armaturën dhe shpatën e tij. Por ky ishte një budallallëk: ushta e Goliathit ishte aq e gjatë dhe e rëndë saqë, nëse Davidi do të kërkonte të përdorte shpatën e Saulit, Goliathi do ta kishte shpuar atë para se Davidi t'i afrohej. Davidi e refuzoi

armaturën e Saulit dhe armët e tij, dhe, në vend të tyre, mori me vete thjesht shkopin dhe hobenë e tij.

Kur Goliathit i zuri syri Davidin, sedra e tij profesionale u lëndua. Sepse qe një fyerje që Izraeli të dërgonte një çunak për një dyluftim me heroin më të madh filiste. Pastaj kur pa edhe armatimin e Davidit, ai shpërtheu nga zemërimi: “Mos jam vallë një qen që po del kundër meje me shkop në dorë?” – thërriti ai. “Armët” e Davidit qenë shumë të dobëta, armatura e tij nuk dukej gjëkund. Goliathi e mallkoi Davidin në emrin e perëndive të tij (17:40–44).

Por kur i erdhi radha Davidit të fliste, ai i shpjegoi Goliathit se për çfarë bëhej në të vërtetë dueli i tyre, dhe arsyen se pse ai kishte zgjedhur qëllimisht armë kaq të dobëta në dukje:

Ti po më vjen me shpatë, me shtizë dhe me ushtë; kurse unë po të dal në emër të Zotit të ushtërive, Perëndisë të ushtrisë së Izraelit që ti ke fyer. Pikërisht sot Zoti do të të dorëzojë në duart e mia...me qëllim që gjithë dheu të mësojë se ka një Perëndi në Izrael. Atëherë gjithë kjo turmë do të mësojë që Zoti nuk të shpëton me anë të shpatës as me anë të shtizës; sepse përfundimi i betejës varet nga Zoti, dhe ai do tju dorëzojë në duart tona. (1 Sam 17:45–47)

Atëherë Davidi gjuajti me hobenë e tij dhe guri e shëmbi Goliathin përtokë. Pas kësaj Davidi vrapoi dhe mori shpatën e Goliathit – sepse Davidi nuk kishte një të tillë me vete – dhe i preu kokën.

Në këtë drejtim, ndodhia e Davidit me Goliathin nxjerr në pah marrëzinë e izraelitëve kur pushuan së besuari plotësisht te Perëndia dhe në vend të kësaj besuan te “njeriu i madh”, Sauli. Në të njëjtë kohë, ajo paraqet urtësinë dhe fuqinë e taktikave të Perëndisë që përdori armët e dobëta dhe në dukje të kota të Davidit, për të shembur përdhe gjigantin Goliath, duke e çliruar kështu popullin e tij prej shtypësve të tyre dhe duke e kthyer besimin e tyre sërish te Perëndia.

UDHËZIMI 10:

Ne duhet të peshojmë mirë rëndësinë relative të mësimit që

mendojmë të nxjerrim prej rrëfenjës së Dhiatës së Vjetër.

Le të përmbledhim studimin tonë deri në pikën ku kemi mbërritur. Për të vendosur se çfarë mësimesh ka për qëllim të na mësojë ngjarja e Davidit dhe Goliathit, ne kemi hedhur dy hapa:

1. Jemi përpjekur të marrim seriozisht të gjitha hollësitë e rrëfenjës dhe t'i kuptojmë ato në kontekstin e tyre historik.

2. Ne e kemi studiuar ndodhinë në kontekstin e saj të gjerë rrëfimtari dhe jemi përpjekur të kuptojmë sesi ajo lidhet me të paktën një nga temat që vetë autori i 1 Samuelit ka kërkuar të theksojë.

Por ka edhe dy pyetje të tjera që duhet të shtrojmë:

3. A është mësimi që ne mendojmë se kemi dalluar në këtë ndodhi aq i rëndësishëm, saqë ka zënë kaq shumë vend brenda Shkrimeve të frymëzuara? Apo është aq i vogël dhe i zakonshëm, saqë mund të nxirrej prej pothuajse çdo pasazhi në Dhiatën e Vjetër?

4. A ka ndonjë pasazh në Dhiatën e Re që mëson të njëjtin mësim me hollësi si temën e tij kryesore dhe të qëllimshme?

Përgjigjja ndaj kësaj pyetjeje të katërt është: Po. Kapitulli i parë te 1 Korintasve (dhe të tre kapitujve të tjerë në vijim) paraqet protestën e Frymës së Shenjtë përmes Palit që të krishterët e Korintit po bënë një gabim të trashë që po mbështeteshin te “disa burra të mëdhenj”, disa predikues të famshëm si Pali, Kefa dhe Apollo në vend që të mbështeteshin te Perëndia. Tani Pali, Kefa dhe Apollo ishin që të tre shërbëtorë fisnikë të Krishtit. Aq më tepër që Pali dhe Kefa ishin apostuj; dhe korintasve, si edhe ne sot, iu kërkua të pranonin dhe besonin çdo fjalë dhe shkrim të apostujve të Zotit. Por korintasit e kishin tejkaluar këtë. Secili prej tyre kishte përzgjedhur ndonjë nga ata si kampionin personal, duke u mburrur me të dhe duke i besuar atij vetëm dhe duke hedhur poshtë kampionët me të cilët të tjerët mburreshin (1 Kor 1:11–13; 3:1–9; 4:6).

Por të mburresh me njeriun sikur shpëtimi të varet nga njeriu dhe jo nga Perëndia, është në thelb e rreme dhe shkatërruese. “Mos Pali u kryqëzua për ju?” pyet me zemërim Pali (1:13). Sikur edhe proteston Dhiata e Vjetër:

Kështu thotë Zoti: “I dituri të mos lavdërohet me diturinë e tij, njeriu i fortë të mos lavdërohet me forcën e tij, i pasuri të mos lavdërohet me pasurinë e tij. Por kush lavdërohet të lavdërohet me këtë: të ketë gjykim dhe të më njohë mua...” (Jer 9:23–24)

Mburria me njeriun, argumenton Pali, është një akt i pastër në kundërshtim me strategjinë e kryqit që kishte Perëndia. Për të shpëtuar njerëzit, Perëndia duhet të thyente këtë siguri të rreme te njeriu dhe ta bënte atë të vendoste sigurinë e tij vetëm te Perëndia. Prandaj, shpjegon Pali, Perëndia qëllimisht zgjodhi ato që për botën duken strategji, taktika dhe armatime jashtëzakonisht të dobëta dhe shumë të marra:

Sepse mesazhi i kryqit është marrëzi për ata që humbin, por për ne që shpëtohem është fuqia e Perëndisë.... Sepse, duke qenë se nëpërmjet ditorisë së Perëndisë bota nuk e njohu Perëndinë me urtinë e vet, Perëndisë i pëlqeu të shpëtojë ata që besojnë nëpërmjet marrëzisë së predikimit... sepse marrëzia e Perëndisë është më e ditur se njerëzit dhe dobësia e Perëndisë më e fortë se njerëzit... por Perëndia ka zgjedhur gjërat e marra të botës për të turpëruar të urtët; ... Perëndia ka zgjedhur gjërat jo fisnike të botës dhe gjërat e përçmuara, edhe gjërat që nuk janë, për të asgjësuar ato që janë, që asnjë mish të mos mburret përpara tij... sikurse është shkruar: “Ai që mburret, le të mburret në Zotin”... që besimi juaj të mos qëndrojë mbi diturinë e njerëzve, po mbi fuqinë e Perëndisë... Prandaj asnjë të mos mburret në njerëzit. (1 Kor 1:18–31; 2:5; 3:21)

Përfundim

Prandaj ne nxjerrim përfundimin se Dhiata e Re përforcon mësimin që kemi sugjeruar se është mësuar nga 1 Samuelit 17: besimi i Izraelit te Sauli, edhe pse ishte burrë i madh, që i gabuar. Sauli nuk mund t’i shpëtonte ata. Vetëm Perëndia mund ta bënte këtë. Që t’ia komunikonte këtë pikë qartësisht Izraelit, Perëndia qëllimisht përzgjedhi jo burrin e madh, Saulin, por bariun çunak dhe pa armaturë, Davidin, dhe armët e tij shumë

të dobëta dhe të marra, për të mposhtur njeriun gjigant Goliath dhe të kthente përsëri besimin e Izraelit te Perëndia.

Prandaj, sërish, instikti i krishterë, se ky pasazh i veçantë në rrëfenjën e Dhiatës së Vjetër në një mënyrë tregon drejt Krishtit, ka dalë i vërtetë. Por studimi ynë na ka ndihmuar të kuptojmë më saktësisht në cilin kuptim është i vërtetë; dhe pastaj të shohim se çfarë mësimi praktik duhet të na mësojë.

...
Pyetjet e studimit për këtë kapitull mund t’i gjeni
në faqen 444.

25

Rasti i gabaonitëve

Në këtë kapitull do të studiojmë një rrëfenjë tjetër të Dhiatës së Vjetër rreth së cilës Dhiata e Re nuk bën asnjë koment dhe për të cilën mosmarrëveshjet janë të një niveli më të lartë. Për shumë njerëz – realisht për shumicën e studiuesve – ndodhia e gabaonitëve mbart një mësim të qartë dhe të pamohueshëm. Ajo flet për një moment kyç në historinë e izraelitëve kur ata nuk kërkuar këshillë prej Zotit. Për rrjedhojë, ata u mashtruan duke mos iu bindur një prej urdhërimeve më të rrepta të Zotit dhe, për këtë arsye, hoqën pasoja të këqija dhe të pakthyeshme për shumë shekuj në vijim¹. Mësimi për ne është i dukshëm: kurrë nuk duhet të jemi kaq të sigurt në mençurinë tonë, sa që të mos kërkojmë drejtim prej Zotit. Të paktën ky është mendimi i shumicës.

Prandaj le të fillojmë duke analizuar faktet themelore të ndodhisë.

Faktet themelore dhe mendimi i shumicës

Para se Izraeli të hynte në Kanaan, Moisiu i kishte udhëzuar për mënyrën sesi do të trajtonin qytete të ndryshme që do të hasnin në vend. Ata duhet të shkatërronin plotësisht popullsinë

¹ Joz 9:1–10:27 dhe veçanërisht 9:14.

në të gjitha qytetet që do të kishin afër vendbanimeve të Izraelit. Kurse, ndaj qyteteve që ishin larg do të tregoheshin më të mëshirshëm (LiP 20:10–18).

Tani qytetarët e Gabaonit dëgjuan tërthorazi për porositë e Moisiut dhe i zuri frika, sepse ata do të ishin fqinj me Izraelin sapo Izraeli të ngulej aty. Ata vendosën se shpresa e tyre e vetme për të shmangur shkatërrimin e plotë, do të ishte të dërgonin një delegacion tek izraelitët para se ata të zbulonin vendndodhjen e vërtetë të qytetit të tyre; të përpiqeshin t'i bindnin që qyteti nga po vinin ishte shumë larg. Për këtë qëllim sajuan një mashtrim të stërholluar, për ta bërë të lehtë që Izraeli ta besonte gënjeshtren e tyre.

Për këtë mashtrim, natyrisht, gabaonitët janë qortuar prej komentuesve. Por rrëfenja na tregon se, gjatë negociatave, Jozueu dhe krerët e Izraelit në asnjë moment nuk “u konsultuan me Zotin” (Joz 9:14); dhe për këtë komentuesit i qortojnë izraelitët edhe më shumë se gabaonitët. Nëse izraelitët do të kishin kërkuar këshillë prej Zotit, me siguri ai do t’ua kishte zbuluar mashtrimin e gabaonitëve. Pastaj, ashtu siç supozojnë kritikët e Izraelit, Zoti do t’u kishte thënë atyre t’i bindeshin urdhërimit të Moisiut dhe të shkatërronin të gjithë banorët e Gabaonit dhe të qytezave pranë tyre (9:17). Por për shkak se nuk kishin kërkuar këshillën e Zotit, izraelitët u mashtruan për të bërë atë që Shkrimet e ndalonin haptazi, d.m.th. të bënë një besëlidhje me banorët e një qyteti aty pranë dhe t’i lejonin të rronin.

Prandaj, shumë mendojnë se çështja kundër Izraelit është e padiskutueshme. Për më tepër, nëse do të donim, mund ta bënim akoma më të rëndë akuzën kundra tyre. Ata jo vetëm që bënë një marrëveshje me gabaonitët, por, pa kërkuar drejtimin apo lejen e Zotit, “u ishin betuar atyre në emër të Zotit, Perëndisë së Izraelit”, “në bazë të së cilës ata mbeteshin gjallë” (9:15, 18, 19, 20). Kjo i shton edhe arrogancën akuzës së rebelimit të pakujdesshëm.

Sidoqoftë, tri ditë më vonë, dëgjuan se gabaonitët ishin fqinjët e tyre të afërt dhe, duke marrë gjithë ushtrinë me vete, Jozueu dhe krerët shkuan të vizitojnë gabaonitët në trojet e tyre (9:17). Ushtria po humbiste durimin. Ata donin që Jozueu dhe

krerët të mohonin besëlidhjen dhe të shkatërronin gabaonitët menjëherë (9:18). Ligjërisht, Jozueu mund ta bënte këtë mbi bazën se gabaonitët e kishin mashtruar për të bërë besëlidhjen. Për këtë arsye ajo ishte e pavlefshme, prandaj nuk ishte detyruese për Izraelin. Por Jozueu dhe krerët argumentuan që pasi ishin betuar në emrin e Perëndisë nuk do ta shkelnin atë, sepse nëse bënë kështu, ata kishin frikë se zemërimi i Perëndisë do të binte mbi ata (9:18–20).

Padyshim që ishte një situatë e vështirë. Nëse do të marrim të mirëqena akuzat ndaj Izraelit, Jozueu dhe krerët e kishin zemëruar tashmë Perëndinë, sepse nuk i ishin bindur urdhërit të tij të dhënë përmes Moisiut për të shkatërruar gabaonitët. Tani ata kishin frikë se do ta zemëronin atë nëse ndryshonin sjelljen e tyre dhe i bindeshin urdhërit të tij të dhënë përmes Moisiut. Përballë pasojave të rënda të dështimit të tyre për t'u konsultuar me Zotin në fillim, pse nuk po konsultoheshin me Zotin tani të paktën? Sigurisht që ai do ta kishte zgjidhur dilemën e tyre.

Edhe një herë tjetër Jozueu dhe krerët nuk u konsultuan me Zotin – të paktën nuk kemi asgjë të shkruar për këtë. Ata vendosën ta zgjidhnin dilemën vetë. Në kundërshtim me atë që ushtria dëshironte, këmbëngulën se duhet të respektonin betimin dhe të mos i shkatërronin gabaonitët, edhe pse kjo do të thoshte që të mos i bindeshe urdhërit të Moisiut. Nga ana tjetër, për të qetësuar ndërjegjet e tyre, ata ndryshuan kushtet fillestare të besëlidhjes dhe futën një mallkim mbi gabaonitët që do të garantonte se do të ishin shërbëtorë të izraelitëve përgjithmonë (27–9:18). Ky ishte kompromisi më i mirë që Jozueu dhe krerët mund të mendonin në rrethanat ku qenë.

Prandaj deri në këtë pikë është ngritur akt-akuza ndaj Izraelit, dhe mbi këtë bazë shumë komentare pastorale nxjerrin një mësim paralajmërues për ne të gjithë. Ata vënë në dukje faktin se izraelitët tashmë kishin siguruar dy fitore të mëdha: të parën në Jeriko dhe, pas shumë lutjesh, rrëfim mëkati dhe pritjeje në Perëndinë, të dytën në Ai (Jozueu 8-6). Sidoqoftë, të ngrefosur nga ky sukses, atyre u hyri vetja në qejf. Kur mbërritën gabaonitët, ata, në mënyrë të gabuar, nuk e ndjenë të nevojshme të pritnin në lutje Perëndinë. Ata menduan se mund të merreshin vetë me këtë çështje: faktet e situatës ishin shumë

të qarta dhe kursi i duhur ishte i dukshëm. Kështu, u mashtruan rëndë në mosbindje ndaj fjalës së Perëndisë. Prandaj e vetmja mënyrë që mund t'ia hidhnin ishte të bënë kompromise, e cila i la në një situatë jo aq të mirë dhe turpëruese edhe në shekujt që do të vinin.

Nga mësimi që marrim prej këtij shembulli fatkeq, ne paralajmërohem për të mos e lejuar suksesin e shkuar të na largojë nevojën e vazhdueshme që kemi për lutje, varësi nga Perëndia, për njohuri nga fjala e tij dhe bindje të skrupullt ndaj saj.

Ta themi që nga fillimi se, në vetvete, kjo këshillë është sigurisht e mirë, e shëndetshme dhe e domosdoshme. Asgjë në pjesën tjetër të këtij kapitulli nuk do ta vërë në diskutim apo ta nënvlerësojë atë. Por vështirë të besosh se ky është mësimi që ndodhia e gabaonitëve ka për qëllim të na mësojë. Sa për fillim, merrni në konsideratë rrjedhojat teologjike të këtij interpretimi nëse do të ishte i vërtetë.

UDHËZIMI 11:

Merrni në shqyrtim rrjedhojat teologjike të çfarëdo interpretimi të sugjeruar.

Kur mbreti i Jerusalemit mori vesh që gabaonitët kishin bërë paqe me Izraelin dhe qenë bashkuar me ta, u alarmua. Gabaoni ishte një qytet i madh, si një nga qytetet mbretërore (10:2), një qytet nënë për një numër të madh qytezash të tij. Prandaj ai bashkoi në një konfederatë të gjithë mbretërit e jugut dhe dërgoi ushtritë e tyre jo kundër izraelitëve, por kundër Gabaonit. Qëllimi i tij ishte t'i shkatërronte me bar e me gjethe gabaonitët që i kishin braktisuar ata për Izraelin; dhe me këtë në mendje ata rrethuan qytetin.

Tani, nëse Zoti do të donte, ai mund ta lejonte 'Konfederatën e Jugut' të këtyre mbretërve të bënte atë që priste që izraelitët ta kishin bërë (sipas mendimit të shumicës), domethënë të shkatërronte gabaonitët. Përkundrazi, ai ndërhyri në mënyrë mbresëlënëse për t'i shpëtuar ata.

Së pari, gabaonitët mundën t'i dërgonin fjalë përmes vijës së armikut Jozueut në Gilgal duke iu lutur që të vinte dhe

t'i ndihmonte; Jozueu vendosi të shkonte. Në këtë moment Perëndia ndërhyri dhe e nxiti Jozueun: "Mos ki frikë nga ata, sepse i kam lënë në duart e tua; asnjë prej tyre nuk do të jetë në gjendje të të rezistojë".

Prandaj Jozueu e udhëhoqi ushtrinë e tij drejt një marshimi të detyruar gjatë gjithë natës dhe bëri një sulm të papritur mbi forcat rrethuese herët në ditën tjetër (10:6–9). Dhe pastaj

... Kështu Zoti i theu para Izraelit... ndërsa iknin ...Zoti hodhi kundër tyre nga qielli gurë të mëdhenj ... ata që vdiqën nga breshëri i gurëve ishin më shumë se ata që bijtë e Izraelit vranë me shpatë. (Joz 10:10–11)

Në fund, ne lexojmë për Jozueun që i flet Zotit:

Jozueu i foli Zotit dhe në prani të Izraelit tha: "O Diell, ndalu mbi Gabaonin, dhe ti, hënë, në luginën e Ajalonit!". Kështu dielli u ndal dhe hëna qëndroi në vend deri sa mbaroi hakmarria e popullit kundër armiqve të tij. ... Dhe nuk pati kurrë, as më parë dhe as më vonë, një ditë si ajo kur Zoti plotësoi dëshirën e zërit të një njeriu, pse Zoti luftoi për Izraelin. (Joz 10:12–14)

Sigurisht që kjo e lehtësoi rrethimin e Gabaonit dhe i shpëtoi ata nga shkatërrimi i sigurt, por si duhet ta interpretojmë historinë në tërësinë e saj? A duhet të mendojmë se, po të ishte për Perëndinë, ai kurrë nuk do t'i kishte shpëtuar gabaonitët? Përkundrazi, ai donte që Izraeli t'i shkatërronte sipas urdhërit të Moisiut (LiP 20:15–18); dhe sikur Izraeli të ishte konsultuar me të kur erdhën gabaonitët herën e parë, ai do t'u kishte thënë izraelitëve t'i shkatërronin ata. Por Izraeli nuk u këshillua me të. Akoma më keq, pa lejen e tij dhe kundër vullnetit të tij, ata me vetë iniciativën e tyre u betuan në emrin e tij të mos i shkatërronin gabaonitët, por t'i linin të jetonin (Jozueu 9:15). Prandaj, a duhet të arrijmë në përfundimin se përmes marrëzisë së izraelitëve dhe mosbindjes së tyre të plotë, Perëndia u detyrua të shpëtonte gabaonitët kur në të vërtetë nuk dëshironte ta bënte këtë?

Teologjikisht, ky është një interpretim jo bindës. Do të ishte më e lehtë të mendoje se Perëndia disi e kishte si qëllim gjatë gjithë kohës të ishte i mëshirshëm me gabaonitët sesa të

mendoje se shpëtimi i gabaonitëve iu imponua Zotit për shkak se izraelitët u betuan në emrin e tij, pa lejen e tij dhe kundër vullnetit dhe qëllimit të tij.

Një shpjegim i pakënaqshëm

Do të ishte e mundur të argumentojë – dhe shumë do të bënin kështu – që, edhe pse Perëndisë nuk i pëlqeu dështimi i Izraelit kur nuk zbatoi zemërimin e tij ndaj gabaonitëve, prapëseprapë, në mëshirën e tij, ai e kapërceu atë mosbindje për të mirë: të paktën ajo i dha një mundësi Izraelit për të mposhtur ushtritë e Konfederatës Jugore. Por një shpjegim i tillë duket se përplaslet keqas me theksin madhor të tre kapitujve që paraprijnë ndodhinë e gabaonitëve (Jozueu 6–8).

Caktimi për shfarosje i shpallur prej Moisiut mbi qytetet e afërta (LiP 20:16–18), duke përfshirë edhe Gabaonin, ishte i ngjashëm me atë të shpallur mbi Jerikon (Joz 6:17–21, 24). Ai ishte një gjë që duhej marrë shumë seriozisht pa ndryshuar asgjë. Në rastin e Jerikos, izraelitët u paralajmëruan që shkelja më e papërfillshme nga çdokush, do të sillte mallkimin mbi të gjithë Izraelin.

Ndodhi që njëfarë Akani nuk e respektoi shfarosjen; edhe pse për njëfarë kohe kjo ishte e fshehur prej Izraelit, Perëndia nuk mund ta anashkalonte. Kështu, kur Jozueu dërgoi një batalion kundër qytetit tjetër, Ait, Perëndia lejoi që trupat të dëboheshin duke humbur edhe 30 veta. Vetëm kur Izraeli të distancohej nga mëkati i Akanit duke e ekzekutuar atë, Perëndia mund ta lejonte Izraelin të vazhdonte me pushtimin e Ait dhe pjesës tjetër të Kanaanit.

Tani nuk është se Akanin e gënjyen kur shkeli shfarosjen: atë që bëri, e bëri me vetë dëshirën e tij – askush nuk e detyroi. Në dallim me këtë, gabaonitët e mashturuan Izraelin duke e bërë të besojë se vinin nga një qytet i largët; prandaj ka të ngjarë që Izraeli mendoi se po bënte gjënë e duhur kur u betua në emrin e Perëndisë për t'i lënë të gjallë. Por sipas mendimit të shumicës ata e kishin fajin vetë që u mashturuan. Vetëm sikur të kishin pyetur Zotin – sërish sipas mendimit të shumicës – ai do t'ua kishte zbuluar dredhinë e gabaonitëve dhe do t'i kishte

urdhëruar izraelitët t'i shkatërronin ata. Por, siç shkuan gjërat, moszbatimi i shfarosjes në rastin e Gabaonit ishte pasojë e një papërgjegjshmërie të dënueshme nga ana e Jozueut dhe krerëve që nuk iu lutën Zotit këtë herë.

Prandaj, nëse, për shkak të moszbatimit nga ana e Akanit të shfarosjes së Jerikos, Perëndia pezulloi çdo pushtim të mëtejshëm derisa Izraeli të pendohej dhe të vriste Akanin, si mundet vallë që Perëndia të ishte i drejtë duke anashkaluar moszbatimin e shfarosjes së Gabaonit nga Izraeli? Por jo vetëm që e anashkaloi atë, por menjëherë dhe pa e qortuar Izraelin, e fuqizoi me mrekulli mahnitëse që të shpëtonte gabaonitët?

Një shpjegim tjetër i mundshëm

Teologjikisht, pikëpamja e shumicës përballet me shumë vështirësi'. A mundet vallë që ata ta kenë gabim? Duhet të konstatojmë se ajo mbështetet mbi një supozim të pashprehur. Kur te Jozueu 9:14 thuhet që "njerëzit e Izraelit morën disa nga nozullimet e tyre, por pa u konsultuar me Zotin", pikëpamja e shumicës me të drejtë supozon se vetëm sikur të ishin konsultuar me Perëndinë, ai do t'ua kishte zbuluar gënjeshtren e gabaonitëve se po vinin nga një qytet i largët. Por pikëpamja e shumicës vazhdon të supozojë që, po ashtu, Perëndia do të kishte pritur, për të mos thënë do t'i kishte urdhëruar ata, të zbatonin shfarosjen e tij mbi të gjitha qytetet e afërta dhe të shkatërronin gabaonitët. Por në dritën e asaj që vijon, ky supozim mund të jetë i gabuar.

Supozoni – dhe në këtë fazë vetëm mund të supozohet – që Perëndia e kishte interpretuar atë që gabaonitët bënë si një shprehje të pendesës; një pranim të faktit që ata ishin nën gjykimin e drejtë të Perëndisë, por gjithashtu si një përgjërimit të sinqertë që mëshira, të cilën do ta tregonte ndaj qyteteve të largëta, t'u tregojë edhe atyre gjithashtu.

Dikush mund të kundërshtojë: por ata gënjen! Jo vetëm që gënjen por edhe simuluan një maskaradë që ta bënte Izraelin të kapërdinte gënjeshtren e tyre!

Po, ata vepruan ashtu. Por nuk ishin të vetmit kanaanitë që gënjen. Një grua, në një qytet tjetër, i cili ishte akoma më

afër gënjeu gjithashtu. Jo vetëm që ajo shpëtoi, por veprimi i saj duke mbrojtur spiunët izraelitë – që ishte edhe shkak për ajo tha gënjeshtër (Joz 2:2–7) – është përmendur në Dhiatën e Re si një rast i shfajësimit përmes besimit (Heb 11:31) dhe veprave (Jak 2:25).

Sidoqoftë, ndoshta diskutimi ynë në këtë fazë rrezikon të ngecë në detaje të hollësishme. Prandaj le të shtyjmë vendimin edhe për ca kohë dhe t'ia fillojmë nga e para, duke ndjekur një udhëzim tjetër.

UDHËZIMI 12:

Shqyrtoni librin në tërësi për të parë nëse ka një temë apo tema kryesore ose të përsëritura.

Duke u nisur prej ngjashmërisë së frazeologjisë, pasazhet që vijojnë duket se përbëjnë një temë mbizotëruese të Jozueu:

Joz 2:12–13 — Rahabi. 'Prandaj betohuni në emër të Zotit ... që do t'i lini të gjallë atin tim, nënën time, vëllezërit dhe motrat e mia dhe të gjitha gjërat që u përkasin atyre, dhe që do të shpëtoni jetën tonë nga vdekja.'

6:17 — 'Vetëm prostituta Rahab do të shpëtojë, ajo dhe gjithë ata që janë bashkë me të në shtëpi, sepse ajo fshehu vëzhguesit...'

6:25 — 'Por Jozueu e la të gjallë prostitutën Rahab, familjen e atit të saj dhe gjithçka që i përkiste; kështu që ajo banoi në mes të Izraelit deri sot.'

9:15 — 'Jozueu lidhi paqe me ta [gabaonitët] dhe nënshkroi një besëlidhje në bazë të së cilës ata mbeteshin të gjallë'

9:20 — 'Këtë do t'u bëjmë atyre: do t'i lëmë të gjallë.'

9:21 — 'Krerët u thanë atyre: "Le të jetojnë"'

14:10 — Kalebi (ndryshe nga gjithë ai brez i bashkëkohësve të tij që vdiqën në shkretëtirë nën gjykimin e Perëndisë). 'Dhe ja, tani Zoti më ka ruajtur të gjallë, siç e kishte thënë, këto dyzet e pesë vjet . . .'

20:9 — Qytetet e strehimit. 'Këto ishin qytetet që iu caktuan ... në mënyrë që kushdo që kishte vrarë dikë pa dashje të mund të strehohej dhe të mos vritej nga hakmarrësi i gjakut, para se të dilte përpara asamblesë.'

Libri i Jozueut sigurisht që regjistron gjykimet e ashpra të Perëndisë mbi shoqërinë e prishur kanaanite, madje edhe mbi izraelitin Akan. Por në ashpërsi nuk mungon lehtësimi. Frazologjia e përsëritur e këtyre shprehjeve të mëshirës së Perëndisë formon një kontrast të pëlqyeshëm.

Për më tepër, do të ishte e dobishme të shqyrtonim rastin e Rahabit me më shumë hollësi, sepse mund të hedhë dritë mbi trajtimin e Perëndisë mbi gabaonitët. Të dyja qytetet, si Jeriko ashtu edhe Gabaoni, ishin caktuar njësoj për shfarosje nga Perëndia. Megjithatë, në Jeriko u bë një përjashtim vetëm për rastin e Rahabit dhe të gjithë familjes së saj, dhe në Gabaon i gjithë qyteti dhe banorët e tij u çliruan nga gjykimi që ra mbi të gjithë qytetet e tjera të afërta. Atëherë, pse dhe për çfarë arsye Izraeli e kurseu Rahabin? Përgjigjja ndaj kësaj pyetjeje mund të ndihmojë të shpjegojë pse Perëndia kurseu gabaonitët.

Hollësitë e rastit të Rahabit

Situata ishte e tillë. Para se Jozueu të urdhëronte ushtrinë dhe popullin e tij të kalonin Jordanin, ai dërgoi spiunë, jo për të vëzhguar tokën e Kanaanit natyrisht (atë ai dhe Kalebi e kishin bërë dyzet vjet të shkuara), por për të zbuluar se në ç'shikallë qe morali në Jeriko. A e kishte mobilizuar mbreti ushtrinë e tij për të dalë dhe sulmuar izraelitët ndërsa ata do të kalonin Jordanin? Apo, a po e përgatiste mbreti qytetin për t'i bërë ballë një rrethimi? Do të ishte shumë e rrezikshme për Izraelin nëse mbreti do të synonte ta sulmonte Izraelin kur ata ishin duke dalë zvarrë prej lumit. Ajo që spiunët zbuluan ishte se mbreti nuk kishte në plan asnjë sulm, por ishte duke u përgatitur të përballej me një rrethim (Joz 6:1).

Sidoqoftë, kur spiunët hynë në qytet, u drejtuan për nga shtëpia e një prostitute të quajtur Rahab. Nuk ishte ndonjë gjë e pazakontë apo e dyshimtë që njerëz të huaj hynë në shtëpinë e saj. Megjithatë, dikush informoi mbretin që dërgoi policinë të hetonte. Por Rahabi i kishte fshehur spiunët. Ajo e pranoi që dy burra të huaj kishin hyrë në shtëpinë e saj – nuk e dinte se nga ishin! – por në të ngrysur, para se të mbylleshin portat e qytetit, burrat ishin zhdukur prej andej! Se ku do të shkonin, as atë nuk

e dinte! Por e këshilloi policinë të nxitonte dhe t'i kapte.

Kur kaloi rreziku, ajo i nxori burrat nga ku ishin fshehur dhe iu përgjërua atyre që t'i betoheshin në emrin e Jahve-s që, kur izraelitët do të shkatërronin Jerikon dhe të masakronin qytetarët e tij – siç ajo e besonte se do të ndodhte – ata të kursenin atë dhe familjen e saj (13–2:12). Dy spiunët reaguan duke iu betuar për këtë gjë.

Kjo është e jashtëzakonshme. Së pari, nuk ka dyshim që kjo, më e pakta, binte ndesh me fjalët e porosisë së Moisiut për të mos u treguar mëshirë banorëve të qyteteve të afërta, dhe gjithashtu përbuzte shfarosjen që Perëndia kishte shpallur mbi Jerikon. Së dyti, betimi i tyre do të thoshte që Jozueu dhe izraelitët ishin të detyruar të respektonin betimin. Por ja që ata as nuk u lidhën me bazën për t'u konsultuar me Jozueun dhe krerët izraelitë (kjo qe e pamundur për rrethanat ku ndodheshin). Ata u treguan të gatshëm me iniciativën e tyre të bënë një betim që Izraeli do ta shpëtonte atë dhe familjen e saj, pa kërkuar madje as këshillën e Zotit!

Pse vepruan kështu?

Ata e bënë këtë, para së gjithash, sepse Rahabi kishte shpëtuar jetët e tyre. Lutja e Rahabit qe e pamohueshme:

. . . Prandaj, ju lutem, betohuni në emër të Zotit që, ashtu si kam treguar dhembshuri ndaj jush, edhe ju do të tregoni po atë dhembshuri ndaj shtëpisë së atit tim... që do t'i lini të gjallë atin tim, nënën time, vëllezërit dhe motrat e mia dhe të gjitha gjërat që u përkasin atyre, dhe që do të shpëtoni jetën tonë nga vdekja. (Joz 2:12–13)

Do të kishte qenë shumë e vështirë për spiunët të thoshnin: “Po, vërtet tregove dhembshuri ndaj nesh kur erdhi policia sot, dhe na shpëtove duke vënë kokën në rrezik. Të jemi mirënjohës që na dhe një litar për të zbritur nga dritarja mbi mur. Por na vjen keq. Kur të kthehemi, do të të vrasim. Feja jonë na porosit të bëjmë kështu. Nuk mund të tregojmë dhembshuri ndaj jush.”

Por spiunët patën një arsye tjetër edhe më të fortë për t'u betuar në emrin e Perëndisë që do të shpëtonin atë dhe familjen e saj: ata kuptuan se Rahabi ishte një grua e kthyer në besim! Për

të huazuar një frazë nga Dhiata e Re, ajo “u kthye nga idhujt te Perëndia, për t'i shërbyer Perëndisë së gjallë e të vërtetë” (1 Thes 1:9). Dëgjoni si u drejtohet spiunëve ajo:

Unë e di që Zoti ju ka dhënë vendin, që tmerri juaj na ka zënë, dhe që të gjithë banorët e vendit dridhen nga frika para jush. Sepse ne kemi dëgjuar si i thau ujërat e Detit të Kuq Zoti përpara jush kur dolët nga Egjipti, dhe atë që ju u bëtë dy mbretërve të Amorejve, matanë Jordanit, Sihonit dhe Ogut, që vendosët ti shfarosni. Duke dëgjuar këto gjëra zemra jonë u mpak, për shkakun tuaj askujt nuk i mbeti asnjë fije trimërie, sepse Zoti, Perëndia juaj, është Perëndi atje lart në qiejt dhe këtu poshtë në tokë. (Joz 11-2:9)

Çfarë mund të themi për rrëfimin e saj të besimit te Perëndia: a ishte i vërtetë? Këtu nuk kemi ç'të themi tjetër përveçse të përulemi para gjykimit të Dhiatës së Re: “Me anë të besimit Rahabi, një prostitutë, nuk humbi bashkë me ata që nuk besuan, sepse kishte pritur paqësisht zbuluesit.” (Heb 11:31).

Dhe Jakobi shton që jo vetëm kthimi i saj në besim te Perëndia që i vërtetë, por ajo e përligji besimin e saj përmes veprave që bëri (edhe pse për të mbrojtur spiunët gënjeu policinë e Jerikos). Por kur ndihmoi spiunët të shpëtonin përmes dritares së saj, ajo i këshilloi edhe për rrugën që duhet të ndiqnin që të mos binin në dorë të policisë që i kishte drejtuar t'i kërkonte ata (Joz 2:16): “Gjithashtu a nuk u shfajësua edhe Rahabi, lavirja, nga veprat, kur i pritit të dërguarit dhe i përcolli nga një udhë tjetër?” (Jak 2:25).

Prandaj, sjellja e Rahabit na tregon që spiunët kishin të drejtë të bënin një përjashtim në rastin e saj duke mos e përfshirë në shfarosjen e Jerikos, dhe të bënin një betim në emër të Perëndisë që ta linin atë dhe familjen e saj të gjallë.

Pas pak, do na duhet të pyesim nëse një argument të ngjashëm mund ta sjellim në favor të mënyrës sesi Perëndia i trajtoi gabaonitët. Por për momentin na duhet të vëzhgojmë një tipar tjetër të ndodhisë së Rahabit, i cili ilustron gjithashtu sugjerimin tonë të udhëzimit të mëposhtëm.

UDHËZIMI 13:

Merrni në konsideratë simetrinë e rrëfenjës.

Libri i Jozueut i kushton dy kapituj Jerikos. Kapitulli 2 tregon rastet që ne sapo i kemi përmendur me Rahabin dhe spiunët. Në versionet anglisht ka 24 vargje në këtë kapitull dhe të gjitha ato flasin për Rahabin; si ajo u soll me oficerët izraelitë dhe betimin që ata bënë në emrin e Perëndisë për të shpëtuar atë dhe familjen e saj kur qyteti të shkatërrohej.

Pastaj vjen kapitulli 6 që tregon në të vërtetë shkatërrimin e Jerikos. Ai përmban 27 vargje në tërësi. Por gjysma e vargut 17 dhe i gjithë vargu 22, 23 dhe 25 i kushtohen shpëtimit të Rahabit dhe familjes së saj, që në total bëjnë 3½ vargje duke lënë kështu 23½ vargje për vetë shkatërrimin.

Kështu, raportet mes asaj që është shkruar për gjykimin e Perëndisë dhe asaj që është shkruar për mëshirën e tij në këtë rast, mund të paraqitet si më poshtë:

Gjykimi i Perëndisë: 23½ vargje

Mëshira e Perëndisë: 24+3½= 27½ vargje

Tani, nëse shthurja morale e Jerikos ishte në atë shkallë saqë, sipas gjykimit të Perëndisë, i gjithë qyteti duhej të shkatërrohej për të mos u ndërtuar më, është habi që Perëndia të shpëtonte ndonjë prej banorëve të tij. Por fakti që Perëndia shpëtoi Rahabin dhe të gjithë familjen e saj, dhe i kushtoi më shumë vend në rrëfenjë duke na treguar për mëshirën e tij ndaj Rahabit sesa për shkatërrimin e qytetit, na tregon se në cilin krah qëndron pëlqimi i Zotit: “mëshira triumfon mbi gjykimin” (Jak 2:3).

Në dritën e kësaj, nuk duhet të çuditemi nëse Perëndia vendosi të shpëtonte gabaonitët.²

Provë për shpjegimin tjetër të mundshëm

Le të marrim në shqyrtim se çfarë provash ka që sugjerojnë se pendesa dhe besimi i gabaonitëve ishin të vërteta, dhe se

² Ne duhet të kujtojmë që refuzimi fillestar i Jonas për të predikuar gjykimin e ard-hshëm mbi Ninivenë ishte që Perëndia që kaq i mëshirshëm, saqë Jona kishte frikë se Perëndia mund të shpëtonte madje edhe niniveasit nëse ata do pendoheshin.

kjo ishte arsyeja që Perëndia i shpëtoi. Së pari, kur gabaonitët u siguruan që Jozueu do ta mbante betimin e tij dhe nuk do t'i shkatërronte, atëherë u ndjenë të sigurt të tregonin se pse gënjen dhe mashtruan Izraelin (Joz 9:15, 18–27). Ata kishin dëgjuar "...që Perëndia yt, Zoti, kishte urdhëruar shërbëtorin e tij Moisiun tju jepte tërë vendin dhe të shfaroste para jush tërë banorët e tij. Prandaj ne na hyri një frikë e madhe për jetën tonë nga shkaku juaj, dhe kemi vepruar në këtë mënyrë." (9:24).

Por dikush mund të kundërshtojë se ata vetë, në rrëfimin e tyre, pohojnë se vepruan ashtu të shtyrë nga frika për jetët e tyre dhe jo prej pendesës së vërtetë. Edhe mundet. Por për shkak të frikës nga gjykimi final mijëra "kanë vrapuar për të gjetur strehë" te Krishti për shpëtim. A nuk ka qenë pendesa e tyre e vërtetë?

Së dyti, gabaonitët mund të kishin dëgjuar gjithashtu për paqen që u ofrohej qyteteve të largëta, sepse kjo qe arsyeja që ata sajuan hilenë e tyre të ndëlikuar për ta shtyrë Izraelin të mendojë që vinin prej një qyteti shumë të largët. Kjo të lë të kuptosh se mund edhe të kenë dëgjuar për kushtet që ofrohej paqja: ata ishin të detyruar t'i nënshtroheshin punës angari dhe të ishin shërbëtorë të Izraelit (LiP 20:10–11). Prova pohon se ata ishin tërësisht të gatshëm të nënshtroheshin ndaj këtyre kushteve.

Kur erdhën në fillim dhe i kërkuan Izraelit të bënte një besëlidhje me ta, por Izraeli ngurroi sepse kishte frikë se mund të vinin nga ndonjë qytet aty pranë, gabaonitët i thanë Jozueut: "Ne jemi shërbëtorë të tu!" (9:8); pastaj ata pohuan se ishte dëshira unanime e gjithë qytetarëve dhe krerëve të qytetit të tyre që ata të bënin këtë deklaratë: 'Ne jemi shërbëtorët tuaj!' (Joz 9:11).

Kuptohet se kjo u tha para se të bëhej betimi që të garantohej siguria e tyre. Por edhe pasi u bë besëlidhja dhe ata u siguruan që Izraeli kurrë nuk do ta shkelte atë, ata kurrë nuk u përpoqën të mohonin gatishmërinë e tyre për të respektuar kushtet e saj. Prandaj, kur Jozueu u shpjegoi se nga ajo kohë e tutje do të ishin druvarë dhe bartës uji për të gjithë asamblenë (9:21), shtëpinë e Perëndisë (9:23) dhe për altarën e Zotit (9:27), ata ranë dakort me shumë gatishmëri: "ja, tani jemi në dorën tënde; bëna atë që të

duket e mirë dhe e drejtë" (9:25).

Së treti, duhet të marrim në konsideratë sesi fqinjët e gabaonitëve vlerësuan sjelljen e tyre. Kur ata dëgjuan "që banorët e Gabaonit kishin bërë paqe me Izraelin dhe ishin mes tyre" (10:1), u shqetësuan shumë. Ata organizuan një konfederatë të mbretërve jugorë dhe sulmuan Gabaonin pikërisht për shkak se kishin bërë paqe me Izraelin (10:4). Po ashtu, Perëndia nga ana e tij e mori shumë seriozisht që ata bënë paqe me Izraelin. Në vlerësimin e tij gabaonitët nuk ishin hipokritë. Nëse ishin sulmuar se kishin bërë paqe të vërtetë me Izraelin, atëherë Perëndia do t'i mbronte ata.

Së katërti, për sa kohë vazhdoi që gabaonitët i shërbyen Perëndisë dhe Izraelit? Autori i librit të Jozueut komenton se gabaonitët u shërbyen ashtu atyre "deri në ditën e sotme."³

Për më tepër, kur mbretin Saul e mbërtheu një ndjenjë shovinizmi shekuj më vonë dhe vrau disa prej gabaonitëve, Perëndia u ofendua shumë që Izraeli kishte shkelur një betim solemn ndaj gabaonitëve. Ai dërgoi një zi buke në Izrael që mbaroi vetëm kur gabaonitët u lejuan të zgjidhnin, dhe pastaj të ekzekutonin, ndëshkimin për këtë mëkat të rëndë (2 Sam 21).

Së pesti dhe së fundi, arsyeja pse Perëndia nga fillimi urdhëroi shkatërrimin e banorëve të qyteteve afër, ishte të ndalonte Izraelin të ndikohej, për shkak të afërsisë me ta, nga praktikatat e tyre fetare të neveritshme si idhujtaria, prostitucioni në kult dhe flijimi i fëmijëve. (shih LiP 20:17–18.)

Nuk kemi asnjë bazë të dyshojmë drejtësinë e gjykimit të Perëndisë në këtë rast. Perëndia kishte pritur katërqind vjet para se të zbatonte zemërimin e tij ndaj praktikave të tyre të neveritshme (Zan 15:16). Por kishte ardhur koha kur e vetmja gjë që mund të bëhej, ishte të shkulte me rrënjë këtë hithër. Pas durimit, vjen edhe koha për ndëshkim.

As nuk mund të mendojmë se kujdesi i Perëndisë për mbrojtjen e popullit të tij prej këtij infeksioni moral dhe frymëror ishte i tepërt. Libri i Gjykatësve flet për pasojat e këqija të cilat erdhën prej lëshimeve që Izraeli i bëri fesë pagane.

Por gabaonitët ishin rast tjetër. Perëndia, që njeh zemrën,

3 Krhs. E njëjta frazë përdoret në lidhje me Rahabin (Joz 6:25).

pa se pendesa dhe besimi i tyre ishte i vërtetë. Ai e respektoi betimin dhe besëlidhjen e Izraelit me ta, duke i mbrojtur ata vetë dhe duke i bërë shërbëtorë të altarit të tij. Më pas nuk ka asnjë provë në Dhiatën e Vjetër që ata të kishin sjellë me vete zakone të këqija në Izrael.

Kuptohet që është për të ardhur keq që Jozueu dhe pleqtë nuk u këshilluan me Zotin kur erdhën fillimisht gabaonitët. Sikur ta kishin bërë, Perëndia do t'i kishte ndihmuar të mos mashtroheshin nga maskarada e tyre e jashtme, por të shikonin pendimin dhe besimin e tyre të vërtetë siç i shikonte Zoti. Kështu ata mund të ishin betuar të qetë në emrin e Perëndisë për t'i lënë të gjallë duke ditur se po bënë vullnetin e Perëndisë kur treguan mëshirë, jo vetëm ndaj Rahabit, por edhe ndaj gabaonitëve.

Përfundimi

Ja ku është lista e udhëzimeve të sugjeruara për lehtësi në punën tuaj në Pjesën 3:

UDHËZIMI 1:

Nëse Dhiata e Re interpreton ndonjë rrëfenjë të Dhiatës së Vjetër, ne duhet ta vlerësojmë interpretimin e saj si të autoritetshëm dhe ta ndjekim atë.

UDHËZIMI 2:

Asnjë shpjegim i interpretimit që Dhiata e Re i bën një rrëfenje të Dhiatës së Vjetër nuk mund të jetë i saktë nëse ai shpjegim lë mënjanë apo bie ndesh me rrëfenjën e Dhiatës së Vjetër, mbi të cilën ai interpretim është mbështetur.

UDHËZIMI 3:

Dhiata e Re të lë të kuptosh se një rrëfenjë e Dhiatës së Vjetër nuk bie ndesh me tjetrën.

UDHËZIMI 4:

Nëse Dhiata e Re komenton për të njëjtën rrëfenjë të Dhiatës së Vjetër në më shumë se një rast, interpretimi ynë, për të qenë i plotë, duhet të marrë në konsideratë të gjitha këto raste.

UDHËZIMI 5:

Kur Dhiata e Re përmend disa pjesë të një rrëfenje të Dhiatës së Vjetër dhe pastaj e zbaton mësimin e saj për ne, është mirë të studiosh rrëfenjën në kontekstin e saj të ngushtë për të dalluar se sa i përshtatshëm do të ishte ky zbatim.

UDHËZIMI 6:

Tërësia e një rrëfenje e Dhiatës së Vjetër është frymëzuar prej Perëndisë dhe jo vetëm pjesët që citon Dhiata e Re. Prandaj ne duhet ta trajtojmë të gjithë ndodhinë seriozisht, sikur të ishte një rrëfenjë e plotë në vetvete.

UDHËZIMI 7:

Pasi kemi studiuar kontekstin e saj të ngushtë, ne duhet të marrim në konsideratë domethënien e mundshme prototipike të rrëfenjës.

UDHËZIMI 8:

Filloni me kuptimin historik, të drejtpërdrejtë të rrëfenjës së Dhiatës së Vjetër

UDHËZIMI 9:

Hetoni për shenjat që shprehin qëllimin e autorit në rrjedhën e mendimit brenda kontekstit të të gjithë rrëfenjës.

UDHËZIMI 10:

Ne duhet të peshojmë mirë rëndësinë relative të mësimet që mendojmë të nxjerrim prej rrëfenjës së Dhiatës së Vjetër.

UDHËZIMI 11:

Merrni në shqyrtim rrjedhojat teologjike të çfarëdo interpretimi të sugjeruar.

UDHËZIMI 12:

Shqyrtoni librin në tërësi për të parë nëse ka një temë apo tema kryesore ose të përsëritura.

UDHËZIMI 13:

Merrni në konsideratë përpjesëtimet e rrëfenjës.

Përveç këtyre, nuk duhet të harrojmë mjetet e ndryshme që Dhiata e Re përdor në interpretimin e saj të Dhiatës së Vjetër dhe që ne i kemi studiuar në Pjesën e Dytë: citimet e drejtpërdrejta, krahasime, krahasim të zgjeruar, metafora, koncepti i përmbushjes, precedenti ligjor, analogjia, paradigma ligjore, aluzioni, prototipi dhe tipi. Të gjitha këto janë shembuj që ne t'i ndjekim në studimin tonë të rrëfenjave të Dhiatës së Vjetër.

Ia vlen të përsëris që udhëzimet e mësipërme janë veçse sugjerime prej një studenti për cilindo student tjetër që mund t'i hyjnë në punë. Ato nuk jepen si rregulla të pagabueshme që, nëse do të ndiqen me saktësi, do të garantojnë rezultate të sakta.

Mbi të gjitha, siç edhe vetë Krishti na ka mësuar, ne duhet të kërkojmë në të gjitha Shkrimet e Dhiatës së Vjetër për “gjërat që i takojnë atij” dhe kudo ku jemi duhet të kujtojmë që Dhiata e Vjetër është fjala e Perëndisë së gjallë që, prej Frymës së tij, është gati ta shprehë fjalën e tij sërish po aq të gjallë për mendjen dhe zemrën e atyre që e kërkojnë me zell atë.

...

Pyetjet e studimit për këtë kapitull mund t'i gjeni
në faqen 444.

Fjala përmbyllëse

Dëshmia personale e Frymës së Shenjtë

Në fillim të studimit u përgatitëm për detyrën që kishim përpara duke kujtuar qëndrimin personal të Zotit tonë ndaj Dhiatës së Vjetër. Pastaj, duke u lutur në zemrat tona që të mund të tregojmë të njëjtin përkushtim ndaj Shkrimeve, si edhe ai e tregoi, ne nisëm shqyrtimin tonë të Dhiatës së Vjetër.

Analizimi ynë më pas për mënyrat e ndryshme me anë të të cilave Dhiata e Re e përdor të Vjetrën, na ka shtyrë të përdorim mendjet tona për një studim të gjatë, të përqendruar dhe objektiv të tekstit, pa u marrë shumë me të gjitha pasojat subjektive të tij në zemrat tona. Tani ky studim objektiv ka mbaruar për momentin. Por para se të largohemi nga kjo temë, është me vend që të hapim zemrat tona ndaj dëshmisë personale të Frymës së Shenjtë përmes Dhiatës së Vjetër në nivelin subjektiv.

Në fillim të këtij libri (Kapitulli 4, fq____) mësuam si dhe përmes çfarë mekanizmesh, profecitë, të shprehura nga profetët të cilët ishin thjesht qenie njerëzore, janë sidoqoftë Fjala e Perëndisë: këto qenie njerëzore qenë “të shtyrë nga Fryma e Shenjtë” (2 Pjetri 1:21). Dhiata e Re thotë edhe më shumë. Ajo na jep arsye për të menduar se, edhe në momentin që Fryma e Shenjtë po fliste përmes këtyre profetëve shekuj më parë, ai na kishte ne në mendje dhe po shprehej kryesisht për dobinë tonë.

Duke vepruar në këtë mënyrë, ai kishte kryesisht dy qëllime (në mes shumë të tjerave) në mendje. I pari ishte të vërtetonte

dhe forconte besimin tonë se Jezusi është me të vërtetë Krishti, Biri i Perëndisë, pavarësisht prej shumë mundimeve që ne si të krishterë do të kemi.

I dyti ishte të garantonte që ne do të hyjmë plotësisht dhe tërësisht në të gjitha përfitimet dhe bekimet e besëlidhjes së re të themeluar prej Zotit Jezus. Është ai, Fryma e Shenjtë, që profetizoi se një ditë Perëndia do të bëjë një besëlidhje të re (Jer 31:31). Krishti e inaguroi këtë (Luka 22:20). Por është Fryma e Shenjtë që zbaton kushtet e saj, prej fuqisë së tij, në përvojën tonë të brendshme. (2 Kor 3:3, 6, 17–18).

Qëllimi i parë

Për këtë shpëtim kërkuan dhe hetuan profetët që profetizuan nga hiri për ju, duke kërkuar të njohin kohën dhe rrethanat që tregonte Fryma e Krishtit që ishte në ta, dhe që dëshmonte që më parë për vuajtjet që do të vinin mbi Krishtin dhe për lavditë që do të pasonin. Dhe atyre iu zbulua se ata i administronin jo për vete, po për ne, ato gjëra që po ju rrëfehen tani nga ata që ju kanë predikuar ungjillin, me anë të Frymës së Shenjtë të dërguar nga qielli; gjëra të cilat engjëjt dëshirojnë ti vëzhgojnë. (1 Pjet 1:10–12)

Në këtë fragment Pjetri po u shkruan njerëzve që ishin, siç edhe shprehet ai vetë, “të trishtuar nga prova të ndryshme” (1 Pjet 1:6). Vuajtjet e tyre ishin sidomos sprovues ngaqë nuk kishin shumë kohë që e kishin vendosur besimin e tyre te Zoti Jezus; dhe ata mund të kenë pritur që, nëse Jezusi ishte në fakt Krishti, Biri i Perëndisë, atëherë pranimi i tij do t’i sillte atyre bekimin e Perëndisë dhe *liri* prej vuajtjeve. Por siç qenë punët, ata tani po vuanin jo vetëm pasi kishin besuar në Krishtin, por pikërisht për shkak se i kishin besuar atij (1 Pjet 2:20; 3:17; 4:12–16). A mos kishin gabuar vallë? A mos nuk ishte Jezusi fare Krishti, Biri i Perëndisë? Do të ishte plotësisht e kuptueshme nëse dyshime si këto do të kishin kaluar nëpër mendjet e tyre.

Për të bërë të qëndrueshëm dhe të fortë besimin e tyre, për t’i bindur ata se nuk kishin bërë një gabim, Pjetri po u vë në dukje se Fryma e Shenjtë e kishte paraparë prej kohësh se

sa shumë turbulluese mund ishte për besimin e tyre, kur, sado e çuditshme t'u dukej atyre, do thirreshin për të vuajtur. Prandaj duke menduar për nevojat e tyre, shekuj më parë, ai kishte dëshmuar përmes profetëve se cili do të ishte programi i shpëtimit dhe me çfarë rendi do të zbatoheshin fazat e tij të ndryshme. Mesia do të përmbushte sigurisht të gjitha gjërat e lavdishme për të cilat premtohet në Dhiatën e Vjetër se ai do t'i bënte. Por kjo nuk do të ishte faza e parë. Faza e parë do të ishte vuajtjet e Krishtit; dhe vetëm pas atyre do të vinin lavditë.

Tani kur Fryma e Krishtit te profetët dëshmon për këtë program që përpara, vetë profetët, sigurisht, i kuptonin se çfarë do të thoshnin ato fjalë. Ajo që ata nuk kuptuan atypari ishte se për cilin person dhe në çfarë kohe e rrethanash këto profeci do të gjenin zbatim. Për këtë arsye ata bënë hetim të detajuar. Për rrjedhojë, Fryma e Shenjtë u zbuloi atyre që, duke përdorur frazën e Pjetrit, "ata i administronin jo për vete, po për ne" (1:12). Me fjalë të tjera, Fryma e Shenjtë po dëshmonte përmes këtyre profetëve jo kryesisht për të mirën e vetë profetëve dhe bashkëkohësve të tyre, por për të mirën e të krishterëve të shekullit të parë. Vuajtja dhe vdekja e Krishtit, kur do të ndodhte, do të ishin një tronditje e madhe për shumë prej tyre. Por besimi i tyre do të rimëkëmbej kur të kuptonin që vuajtjet e Krishtit nuk ishin diçka e çuditshme apo e papritur: Fryma e Shenjtë kishte paralajmëruar për to shekuj më parë. Aq më tepër që edhe pas gjithë kësaj kohe, ai i mbante sytë mbi këta besimtarë të shekullit të parë, dhe kishte përpiluar Shkrim pas Shkrimi që mund të mbronte dhe forconte besimin e tyre kur do të vinin vuajtjet, jo vetëm mbi Krishtin, por gjithashtu edhe mbi ata vetë. Natyrisht, dëshmia e Frymës së Shenjtë përmes këtyre Shkrimeve të Dhiatës së Vjetër shërben për të njëjtën arsye praktike për ne kur vuajmë, siç bëri për të krishterët e shekullit të parë.

Jo vetëm kaq, por Fryma e Shenjtë, i dërguar prej qiellit në ditën e Rrëshajëve, sipas Pjetrit (1:12), ishte fuqia dhe autoriteti pas predikuesve të hershëm të ungjillit (dhe natyrisht, pas të gjithë predikuesve të vërtetë të ungjillit që atëherë) që tregonte se Perëndia "e ringjalli prej së vdekurish dhe i dha lavdi" (1:21), duke përmbushur kështu pjesën e dytë të profecive të Dhiatës

së Vjetër që parashikonin "për lavditë që do të pasonin" (1:11). Pastaj si shtesë, vetë Fryma e Shenjtë është kapari në zemrat e besimtarëve, për lavditë e përjetshme që i presin ata përtej vuajtjeve të përkohshme të kësaj jete (2 Kor 4:16–5:5).

Qëllimi i dytë

Prandaj, duke hyrë në botë, ai thotë: "Ti nuk deshe as flijim as mblatë, po bëre gati për mua një trup; ti nuk pëlqeve as olokauste as flijimet për mëkat. Atëherë unë thashë: "Ja, unë po vij; në rotullin e librit është shkruar për mua; për të bërë, o Perëndi, vullnetin tënd"". Mbasi tha: "Ti nuk deshe as flijim as mblatë, as olokauste as flijime për mëkat, që të blatohej sipas ligjit, ai shtoi: "Ja, unë vij për të bërë, o Perëndi, vullnetin tënd". Ai heq të parën, që të vërë të dytën. Prej këtij vullneti, ne jemi shenjtëruar me anë të kushtimit të trupit të Jezu Krishtit, që u bë një herë për të gjithë. Dhe ndërsa çdo prift rri për diti në këmbë duke shërbyer dhe duke mblatuar shpesh herë të njëjtat flijime, që nuk mund të heqin kurrë mëkatet, ai, përkundrazi, pasi dha për gjithnjë një flijim të vetëm për mëkatet, u vu të rrijë në të djathtë të Perëndisë, duke pritur paskëta vetëm që armiq të tij t'i vihen si ndenjës për këmbët e tij. Sepse, me një ofertë të vetme, ai i bëri të përsosur për gjithnjë ata që shenjtërohen. Por edhe Fryma e Shenjtë na e dëshmon; sepse, mbasi pat thënë më parë: "Kjo është Besëlidhja që unë do të bëj me ata pas atyre ditëve, thotë Perëndia, unë do t'i shtie ligjet e mia në zemrat e tyre dhe do t'i shkruaj në mendjet e tyre", shton: "Dhe nuk do t'i kujtoj më mëkatet e tyre dhe paudhësitë e tyre". Edhe atje ku ka ndjesë të këtyre gjërave, nuk ka më ofertë për mëkat. (Heb 10:5–18)

Pjesa e parë e këtij fragmenti (v. 5–14) përmban deklartën e vetë Krishtit¹. Në të ai shpall qëllimin e mishërimit të tij dhe të ardhjes në botë. Duke cituar fjalët e Psalmi 40:6–8, ai flet për qëllimin që kishte të shfuqizonte sakrificat që përsëriteshin vazhdimisht, të cilat porositeshin nga Dhiata e Vjetër dhe, në vend të tyre, të

1 Për një diskutim të mëtejshëm shihni Kapitullin 17.

ofronte sakrificën e vetë trupit të tij. Kjo sakrificë, duke qenë e përsosur, do të mjaftonte për të gjitha kohët për të përsosur shenjtërimin e të gjithë atyre që vendosin besimin e tyre tek ai. Pasi ta ofronte atë, do të ulej në të djathtën e Perëndisë dhe nuk duhej ta bënte sërish këtë ofertë.

Prandaj, deri këtu, ky pasazh përsërit deklaratën e Birit të Perëndisë dhe na jep fakte objektive në lidhje me sakrificën e Krishtit. Faktet objektive janë një gjë; por, që njerëzit t'i kuptojnë subjektivisht dhe të gjejnë kënaqësinë në përvetësimin e tyre për paqen e mendjes dhe të zemrës së tyre, është një çështje krejt tjetër.

Prandaj në këtë pikë Fryma e Shenjtë bashkëngjit dëshminë e tij personale (Heb 10:15–18). Ai vetë frymëzoi profetin Jeremia për të shkruar kushtet e besëlidhjes së re (Jer 31:31). Tani ai i përmend këto kushte sërish dhe thekson veçanërisht klauzolën e fundit: “Dhe nuk do t'i kujtoj më mëkatet e tyre dhe paudhësitë e tyre” (Heb 10:17). Prandaj, ja ku e kemi sigurinë e Frymës së Shenjtë, që u është dhënë të gjithë atyre që vendosin besimin e tyre në Krishtin, për një falje të plotë dhe të përfundimshme.

Rrjedhimisht dalim në këtë përfundim: atje ku një person ka, dhe shijon, një falje kaq të plotë si kjo, ai apo ajo nuk i duhet të ofrojë më asgjë tjetër që të përfitojë faljen e mëkateve (Heb 10:18). Sigurisht që ka shumë sakrifica të llojeve të ndryshme që na bëhet thirrje për t'i bërë vazhdimisht. Të tilla janë sakrificat e lavdërimit të Perëndisë, sakrifica e të bërit mirë dhe të të ndarit të asaj që kemi me njerëzit e tjerë (Heb 16–13:15). Aq më tepër që sakrifica të tilla mund të jenë të kushtueshme në kohë, energji dhe para; edhe ato duhet të përsëriten për aq kohë sa kemi jetë dhe burime. Por procesi i të bërit kurban për mëkatet ka mbaruar me kohë e me vakt. Sakrifica e Krishtit në emrin tonë është e mjaftueshme. Pasi e bëri atë, ai u ul. Ne nuk kemi nevojë, ne nuk mundemi t'i shtojmë ndonjë gjë asaj: dhe as nuk është e domosdoshme që ajo të përsëritet. Ne mund të kemi paqe me Perëndinë. Mbi këtë themel Fryma e Shenjtë ka derdhur dashurinë e Perëndisë në zemrat tona për ne (Rom 5:5), dhe vepron kështu, me një logjikë të pagabueshme, për të zbatuar domethënien e vdekjes së Krishtit në vendin tonë:

Sepse, ndërsa ishin akoma pa forcë, Krishti vdiq në kohën e tij për të paudhët. Vështirë në fakt se vdes dikush për një të drejtë; mbase ndonjë do të guxonte të vdiste për një njeri të mirë. Por Perëndia e tregon dashurinë e tij ndaj nesh në atë që, kur ende ishim mëkatarë, Krishti vdiq për ne. Shumë më tepër, pra, duke qenë tani të shfajësuar në gjakun e tij, do të shpëtojmë nga zemërimi me anë të tij. Në fakt, ndërsa ishim armiq, u pajtuam me Perëndinë nëpërmjet vdekjes së Birit të tij, akoma më shumë tani, që jemi pajtuar, do të shpëtohem nëpërmjet jetës së tij. E jo vetëm kaq, por edhe mburremi në Perëndinë, nëpërmjet Zotit tonë Jezu Krisht, me anë të të cilit tani kemi marrë pajtimin. (Rom 5:6–11)

Faleminderit Perëndisë për dëshminë personale të Frymës së Shenjtë!

Tani ai që pati mëshirë për gabaonitët dhe i lejoi ata të bëheshin shërbëtorë të altarit të tij, na shtyftë më shumë përmes mëshirës së tij të madhe, për ta dashur atë me gjithë mendjen tonë dhe t'i paraqisim trupat tanë si fli të gjallë, të shenjtëruar, të pëlqyer te Perëndia, që është shërbesa jonë e mençur.

...

Pyetjet e studimit për këtë kapitull mund t'i gjeni në faqen 445.

Shtojca

*Vështirësia e dyfishtë në
caktimin e kuptimit korrekt
të detajeve dekorative të
Shandanit*

Në radhë të parë po trajtojmë fjalë hebraike të lashta të botanikës, kuptimin e saktë të të cilave mund të mos e gjejmë dot. Aq më shumë që disa prej këtyre fjalëve kanë kuptime të ndryshme në varësi të kontekstit ku përdoren. Le të marrim për shembull emrin hebraik פָּרַח (*perach*). Ai e ka prejardhjen prej foljes פָּרַח (*pārach*), që do të thotë “të çelë”. Ai mund të përkthehet ose “një gonxhe” apo “një lulëzim”; dhe ne duhet të vendosim se cili kuptim është i duhuri në varësi të kontekstit.

Së dyti, këto fjalë të lashta të botanikës, në kontekstin tonë, janë përdorur jo për të përshkruar një pemë reale bajameje, por një vepër arti të një lloji tërësisht të veçantë: një shandan ari me gjashtë krahë në të cilin funksioni praktik i vetë shandanit dhe llambave të tij duhet të kontrollojë, për të mos thënë ndryshojë, interpretimin tonë të termave të tij.

Prandaj për ndihmesë, le të sjellim një shembull më të thjeshtë. Shkopi i Aaronit (Num 17:8 [v. 23 në tekstin hebraik]) nuk qe edhe aq i ndërlikuar sa shandani, por një shkopi i zakonshëm, me sa duket prej dru bajameje. Fjalët hebraike që përshkruajnë pasojat e mrekullisë që ndodhi me të jepen në

Tabelën 5.

1.	‘kishte lulëzuar’:	Hebraisht פָּרַח <i>pārach</i> ;
2.	kishte nxjerrë ‘sytha’ apo ‘lastarë’:	Hebraisht פָּרַח <i>perach</i>
3.	kishte çelur ‘lule’:	Hebraisht וַיִּצֵץ צִיץ, <i>wayyātsēts tsīts</i> ;
4.	kishte prodhuar bajame:	Hebraisht וַיִּגְמֹל שְׁקָדִים, <i>wayyigmōl shēqēdīm</i>

Tabela 5. Fjalët hebraike të përdorura në përshkrimin e thuprës së Aaronit

Ne duhet të vëmë re që *perach* (termi 2) nuk do të thotë këtu “lulëzoj”, sepse këtë e nënkupton termi 3. Po ashtu *shēqēdīm* (termi 4) nuk do të thotë “lule bajameje” (kjo përmendet tashmë te termi 3), por vetë fruti i pemës. Ndoshta të katërta fazat ndodhën njëherazi, por rendi në të cilin ato përmenden është rendi natyror i zhvillimit. Për më tepër, “fruti i pemës” këtu ka të ngjarë që nënkupton të gjithë frutin dhe jo vetëm lëvozhgën apo thelpinjtë brenda saj që ne i hamë. Fruti i bajames është i veshur me tul, një frut i mbushur (si pjeshka, ulliri apo kumbulla). Daan Smit e përshkruan kështu:

Pasi lulet e saj pjalmohen, ato formojnë shumë vezore që bëhen bajame. Frutat e rrumbullakta janë rreth 4 cm të gjatë dhe rrethohen nga një tul i trashë dhe i ngjeshur. Ai është mbuluar së jashtmi nga një push i butë, i ngjashëm me bërthamën e një pjeshke. Në tetor kur piqet fruti, mbështjella prej tuli çahet më dysh dhe lëvozhgat dallohen. Ato janë gati për t’u vjelë në nëntor dhe pasi janë tharë, thelbi i butë mund të nxirret prej lëvozhgës duke përdorur një çekan. Kjo është bajamja që ne hamë.¹

Tre termat kryesore dekorative të Shandanit

Kur vjen puna për përshkrimin e Shandanit dhe motivet e tij dekorative, ne sërish gjejmë tre elemente kryesorë në trungun

¹ *Plants of the Bible*, 136–7.

kryesor (apo boshtin) dhe gjashtë degët e tij. Ato janë:

1. Hebraisht גִּבְעִים (*gēbîm*) = kupa, apo tasa të cekët
2. Hebraisht כַּפְתֹּרִים (*kaphtôrîm*) = kapiteli (në majë të shtyllave)
3. Hebraisht פְּרָחִים (*pěrachîm*) = lulet.

Vihet re lehtë që vetëm një nga këto fjalë (elementi 3) është i njëjtë me atë që përdoret në rastin e shklopit të Aaronit; dhe që do të thotë aty “sytha”, ndërsa këtu nënkupton “lule”. Për më tepër, teksti thotë se kupat (*gēbîm*) duhet të modelohen “në formë të bajames”; dhe akoma debatohet nëse kjo do të thotë “si lulet e bajames” ose thjesht “si bajame”. Dhe fjala hebraike *kaphtôrîm* (elementi 2), kur përmendet tek Amosi 9:1, përkthehet zakonisht në versionet moderne “kapitele”. Por këtu, në lidhje me Shandanin, shumica e versioneve moderne e përkthejnë “kupa” apo “tasa/mollë”.

Nuk është për t’u çuditur që mendimi akademik është ndërdyshas; dhe dogmatizmi s’ka vend. Prandaj, ajo që do të bëjmë së pari është të paraqesim mendimin e shumicës dhe pastaj të përmendim një apo dy hollësi që akademikët e tjerë i shohin me dyshim.

Pikëpamja e shumicës

Ka shumë gjëra që mund të thuhet rreth saj. Me një shikim të parë përkthimi anglez RV i Eksodit 25:33 “three cups made like almond-blossoms... a knop and a flower”, mund të tingëllojë përsëritës duke përdorur “blossoms” dhe pastaj “flower” që realisht mund të jenë e njëjta gjë.² Por pikëpamja e shumicës është që këto tre fjalë “blossoms, knop and flower” janë një treshe që mund të kuptohet si “lule bajameje, d.m.th., kupa dhe lulja bashkë.”

[Përkthimet e Biblës në gjuhën shqipe kanë përdorur fjalë të ndryshme për këto terma. Tabela e mëposhtme pasqyron disa prej këtyre versioneve:

² Veç në rast se i referohet qendrës së lules e përbërë jo nga petalet, por nga pistili dhe thekët.

		Kristoforidhi 1884	Diodati i ri '91-'94	ECM 1993
1	גִּבְעִים (<i>gēbîm</i>)	“lekanë”	“kupa”	“kupa”
2	כַּפְתֹּרִים (<i>kaphtôrîm</i>)	“sumbullë”	“mollë”	“sytha”
3	פְּרָחִים (<i>pěrachîm</i>)	“lule”	“lule”	“petla”

Tabela 6: Krahësimi i përkthimeve shqip i fjalëve hebraike të përdorura në përshkrimin e Shandanit. Shën. përk]

Së dyti, me “kupa” (hebraisht *gēbîm*) nuk po flitet për “kupa të pijes”, si ajo nga e cila pinte Jozefi (Zan 44:2–5) që është përkthyer në greqisht si κόνδυ, por më saktë “tasat e cekët” të cilët greqishtja e Eksodit 25:31 i përkthen si κροατήρες — “tasa të përzierjes”. Ky kuptim i mëvonshëm ka të ngjarë që është i duhuri, sepse kupat në fund të degëve dhe në majë të boshtit kryesor përdoren për të mbajtur llambat e vajit. Por, prapëseprapë, sugjerimi që kupat u prodhuan si “lule bajameje” është mjaft i arsyeshëm, sepse të pesta petalet e një lule bajameje thuhet që janë si lule në formë kupe.³

Të metat e pikëpamjes së shumicës

Edhe pse pikëpamja e shumicës është e arsyeshme, ajo ka dy të meta. Së pari, përkthimi “kupa në formë të lules së bajames” nuk është i padebatueshëm. Carol L. Meyers këmbëngul që hebraishtja mund të përkthehet si “kupa të bëra si bajame”; “një mundësi tjetër që nuk duhet të anashkalohet është se fjala është një term teknik, e cila lidhet me ndonjë punim të stampuar apo ndoshta si një lloj pune me veshje në formën e bajames.”⁴ Përkthimi anglez NIV lë të nënkuptohet kjo gjë. Në versionin e saj Bibla e Studimit, në shënimin në fund të faqes për Eksodin 25:31, thotë: “Kupa të shandanit i ngjajnë ose një kupe luljeje

³ Shih Sterry, *British Trees*, 240.

⁴ *Tabernacle Menorah*, 23.

(pjesa e poshtme e lules) apo një lëvozhgë bajameje.”

Së dyti, fjala hebraike *kaphtôr*, për të cilën shumica e versioneve moderne përdorin “kupë” apo “zhguall”, përdoret gjetkë në lidhje me boshtin kryesor, d.m.th. trungun e kësaj “peme bajameje”. Aty thuhet se duhet të ketë një *kaphtôr* nën secilën nga tre çiftet e degëve në pikën ku ato dalin prej boshtit kryesor (25:35). Nga ana botanike, nuk ka shumë të ngjarë që secili krahë i dy degëve të paraqitet duke çelur prej një kupe apo zhgualli. Nga ana praktike, edhe mund të mendohet që *kaphtôrim* u vendosën atje ku takohen degët me boshtin kryesor që është edhe vendi më i dobët. Po të jetë kështu, çdo *kaphtôr*, duke qenë në formën e një kapiteli, do të paraqitet më shumë si një gungë (një pjesë e trashë e trungut nga dalin degët) sesa si një kupë apo një boçe.

Çfarë ndryshimi sjellin të gjitha këto gjëra?

Sa mirë që jo shumë! Nëse ka të drejtë shumica, Shandani përfaqëson bukurinë dhe potencialin e jetës së re; përderisa pema e bajames në Lindjen e Mesme është e para që lulëzon pas shterpësisë së dimrit, ajo mbart më shumë se një aludim për jetën e ringjallur.

Por nëse, siç mendojnë edhe të tjerët, motivet dekorative të Shandanit përfshijnë kokrrat e bajames, atëherë kjo Pemë simbolike e Jetës, paraqet jo vetëm potencialin e jetës, sythet dhe bukurinë e jetës, por edhe frytin e pjekur të jetës, kokrrën e bajames, dhe të tre fazat e saj njëherazi.

MANUAL STUDIMI

Këto pyetje mund të përdoren për studim vetjak ose në grup. Personat që e përdorin këtë manual mund ta kenë më të lehtë t'i referohen këtyre pyetjeve në fund të secilit kapitull, ndonëse të tjerë mund të dëshirojnë që të presin derisa ta kenë lexuar të gjithë librin dhe pastaj të përdorin këto pyetje për të përsëritur materialin.

Për studimet biblike, seminarët apo grupet e shtëpisë, porositë e mëposhtme jepen si sugjerim për përdorimin e këtyre pyetjeve:

1. Koha për diskutim të jetë të paktën 45 min.
2. Hidhini një sy pyetjeve qoftë vetë, qoftë me grupin para se të lexoni kapitullin që të njiheni me pikat kryesore të shtruara aty.
3. Lexoni kapitullin duke mbajtur shënim pasazhet biblike që përmenden aty.
4. Lexoni pasazhet kryesore biblike që përmenden.
5. Përgjigjuni me radhë çdo pyetjeje. Kur jeni grup, drejtuesi duhet të sigurohet që secila pyetje është trajtuar dhe që diskutimi i bërë lidhet me të.

6. Kur jeni grup, do të ishte e dobishme që në fillim të sesionit të caktonit një pyetje për një person të grupit, i cili do të ketë më pas përgjegjësinë të drejtojë atë pjesë të diskutimit. Drejtuesi duhet të garantojë që u ka dhënë kohë të mjaftueshme të gjithëve.

Hyrja e librit, si edhe kapitulli përmbyllës, i nxit të gjithë ata që përdorin këto pyetje të kujtojnë këshillat dhe përkrahjen e dhënë në to. Fryma e Shenjtë na bën thirrje të rritemi në mençuri dhe ta përdorim atë mençuri me këmbëngulje ndërsa u afrohem Shkrimeve (1 Kor 14:20). Por nuk jemi vetëm kur studiojmë; vetë Zoti ynë u hapi mendjet dishepujve të tij që ata të mund të kuptonin Shkrimet (Luka 24:45).

PJESA E PARË

Pyetje për Kapitullin 1

1. ‘Ungjilli i krishterë nuk është një numër të vërtetash të përjetshme dhe as një sistem filozofik.’ Por çfarë është atëherë?
2. Si lidhet Dhiata e Vjetër me vlefshmërinë e të vërtetave të Krishtërit?
3. Cila është domethënia e pohimeve të Mateut që Jezus Krishti është biri i Davidit dhe biri i Abrahamit?
4. Gjenealogjia e Mateut përmban tri periudha kryesore të historisë. Në ç’mënyrë dhe në ç’skallë ka kontribuar secila prej këtyre periudhave historike, në përgatitjen e Izraelit për ardhjen e Krishtit?

Pyetje për Kapitullin 2

1. Në ç’drejtime kryesore shfaq Dhiata e Re vazhdimësi me të Vjetrën?
2. Kur Dhiata e Re shfuqizon disa nga institucionet e përcaktuara në mënyrë hyjnore të Dhiatës së Vjetër, si e përlij këtë shfuqizim?
3. Cili është thelbi kryesor i ligjëratës së Stefanit para Këshillit (Veprat 7) dhe si lidhet ai me akuzën kundër tij?
4. Me ardhjen e Krishtit, dhe pastaj me atë të Frymës së Shenjtë ditën e Rrëshajëve, lindi një epokë e re shpirtërore. Cilat qenë tiparet kryesore të asaj epoke?
5. Shkruani një ese me temën “Shkëputjet e Dhiatës së Re nga e Vjetra”

Pyetje për Kapitullin 3

1. 1 Timoteut 3:15–17 dhe 2 Pjetrit 1:20–21 pohojnë të dyja

frymëzimin hyjnor të Dhiatës së Vjetër; por cili është theksi i veçantë në secilin prej këtyre pasazheve?

2. E kujt ishte përgjegjësia kryesore për t’ua mësuar fëmijëve Biblën në Izraelin e lashtë?
3. Në ç’mënyrë dhe ç’skallë është e dobishme Dhiata e Vjetër për ungjillëzimin e krishterë?
4. Cilat janë tiparet kryesore të doktrinės së krijimit në Dhiatën e Vjetër?
5. Cilat janë ato pasazhe nga Dhiata e Vjetër që Dhiata e Re u apelohe për të mbështetur doktrinat e saj të Rënies, Shlyerjes zëvendësuese dhe Jetës pas Vdekjes?
6. Përmendni shembuj nga Dhiata e Re ku Zoti ynë zbaton Dhiatën e Vjetër me vetë sjelljen e tij.
7. ‘Dhiata e Re është pjesë e së njëjtës shpresë për të ardhmen si edhe Dhiata e Vjetër.’ Komentoni.
8. Sakrificat e Dhiatës së Vjetër tani janë vjetëruar, duke qenë se janë tejkaluar nga sakrificat e Krishtit. Çfarë mësimesh, nëse ka ndonjë, mund të nxjerrim nga këto sakrificat të Dhiatës së Vjetër?
9. ‘Shenjtëria dhe dashuria janë dy mësimet madhore të mësuar nga libri i Levitikut.’ Përdorni njohurinë tuaj të Levitikut për të ilustruar dhe përligjur këtë pohim.

Pyetje për Kapitullin 4

1. Krahasoni mënyrën që apostujt kuptuan Dhiatën e Vjetër para vdekjes dhe ringjalljes së Krishtit me mënyrën që e kuptuan pas ringjalljes. Si shpjegohet ky ndryshim?
2. Në ç’mënyrë ndryshimi midis dy mesazheve të Nathanit për Davidin (2 Sam 7) ilustron deklaratat negative dhe pozitive për profecinë e frymëzuar në mënyrë hyjnore te 2 Pjet 1:21?
3. Shkruaj një ese me titullin “Problemi i dukshëm që ngrihet prej interpretimit të 2 Sam 7:14 të dhënë prej shkrimtarit të Hebrenjve (1:5); dhe zgjidhja e atij problemi”.

PJESA E DYTË

Pyetje për Kapitullin 6

1. Në sinagogën e Nazaretit (Luka 4) Krishti lexoi prej Isaia 61. Cila është domethënia e faktit që ai e ndaloj leximin e tij atje ku e la?
2. Çfarë ka parasysh Isaia me “ditën e hakmarrjes”?
3. Për ç’arsye e citoi Krishti te Mateu 22:41–46, Psalmin 110:1?
4. Në ç’vend tjetër e citon Dhiata e Re Psalmin 110 dhe për çfarë arsye?
5. Cilat janë të përbashkëtat që kanë Mateu 13:30, 39 me Psalmin 110:1?
6. Çfarë është i ashtuquajturi Problem i së Keqes?

Pyetje për Kapitullin 7

1. Diskutoni, duke dhënë shembuj, kuptimet e ndyrshme sipas të cilave Dhiata e Re përdor fjalën *u përmbush*.
2. Në ç’kuptim është përdorur termi *prototip* në këtë kapitull?
3. Në shikim të parë, pohimi i Mateut se Osea 11:1 u përmbush kur fëmija Jezus u kthye nga Egjipti përbën një problem. Cili është ky problem? Si ndihmon koncepti i *prototipit* për ta zgjidhur atë vështirësi?
4. Shpjegoni si një studim i konteksteve të Jeremias 31:15 dhe Mateut 2:17-18 na ndihmon të kuptojmë domethënien e ngjashmërive mes këtyre dy pasazheve.
5. Cili është kuptimi i plotë i termit *Nazareas* që zbatohet për Jezusin te Mateu 2:23? A përshkruan ai vetëm vendin ku jetoi për 30 vite?
6. Diskutoni kuptimet e ndryshme të fjalës greke *τύπος* (*typos*), ashtu si përdoret në Dhiatën e Re.
7. Në ç’kuptim Krishti erdhi të përmbushë Ligjin dhe Profetët?
8. “Dashuria është përmbushja e Ligjit”. Çfarë do të thonit

për mbështetësit e etikës që argumentojnë se motivimi prej dashurisë për të tjerët mjafton si parim për etikën, dhe që ne nuk kemi nevojë për ligje definitive dhe të pandryshueshme si ato të Dhjetë Urdhërimeve?

9. Diskutoni strategjinë e Perëndisë që në fillim jep premtime dhe më vonë i plotëson. Pse premtim në fund të fundit? Pse nuk i bën gjërat pa i shpallur ato më parë - ndonjëherë shekuj më parë?
10. Çfarë do të thotë te 1 Timoteut 4:8 shprehja “perëndishmëria ... përmban *premtimin* e jetës së tashme”?

Pyetje për Kapitullin 8

1. Cili është kuptimi i termit shfaqësor te Romakëve 3:19–4:5?
2. Pse është e nevojshme që shpëtimi të arrihet mbi një bazë të shëndoshë ligjore?
3. Diskutoni kur Pali përdor (Rom 4:2) rastin e Abrahamit si tregohet te Zanafilla 15:6. Çfarë autoriteti i shton ai argumentit të tij në kapitullin pararendës (Rom 3:19–31)?
4. Pali qartazi argumenton se rendi kronologjik i ngjarjeve të treguara te Zanafilla 15–17 është i besueshëm dhe domethënës nga ana ligjore. Pse argumenton kështu ai?
5. Cila është natyra e besimit të Abrahamit?
6. Cila është ngjashmëria mes besimit të Abrahamit dhe atij tonit?

Pyetje për Kapitullin 9

1. Si e përdori Krishti rrjedhimin ligjor për të mbrojtur veten kundër akuzës së blasfemisë?
2. Si e kuptoni shprehjen Latine a minore ad maius? Ilustrojeni përgjigjen tuaj përmes një shembulli nga Dhiata e Re.
3. Ç’lidhje kishte ligji për sjelljen e priftërinjve hebrenj në tempull ditën e Shtunë me sjelljen e apostujve të

Krishtit?

4. Si lidhet ligji i Dhiatës së Vjetër për qetë me punëtorët e krishterë?
5. Si e kuptoni shprehjen paradigme ligjore?
6. Pse është e rëndësishme të kuptosh qëllimin e një ligji? A është e mundur të shkelësh një ligj duke e zbatuar atë?

Pyetje për Kapitullin 10

1. Kujtoni dy besëlidhjet e Zanafillës 15 dhe Jeremias 34:8–22; pastaj përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:
 - (a) Cilat janë të përbashkëtat e tyre?
 - (b) Pse është i rëndësishëm identiteti i atij “që eci mes pjesëve të kurbanit”?
2. Cili është dallimi mes besëlidhjes njëpalëshe dhe asaj dypalëshe?
3. Cili është kuptimi i fjalës *premtim*? A mund të ketë ajo dy kuptime të ndryshme? Nëse po, cilat janë ato, pse është e rëndësishme që të bësh dallimin mes tyre?
4. Cilës praktikë të shëndoshë ligjore të ditëve tona i bën thirrje Pali te Gal 3:15?
5. Pse kushtet e besëlidhjes së Sinait nuk mund t’i shtohen thjesht besëlidhjes së Perëndisë me Abramit dhe farën e tij?
6. A ishte besëlidhja që bëri Perëndia me Izraelin në malin Sinai një besëlidhje njëpalëshe apo dypalëshe? Nga se e kuptojmë këtë?
7. A priste Mosiu se Izraeli, mbështetur në kushtet e besëlidhjes së Sinait dhe nën udhëheqjen e Jozueut, do të zotëronte vendin e tij në mënyrë të përhershme dhe përfundimtare?
8. A ishte rimëkëmbja e Izraelit nën Ezdrën dhe Nehemian në tokën e premtuar e përhershme? Nëse jo, pse?
9. Fjala farë në frazën “Abrahami dhe fara e tij” mund të ketë kuptime të ndryshme. Cili është kuptimi që Pali i vesh asaj kur bën fjalë për besëlidhjen Perëndisë me Abrahamin (Zan 15)?
10. Si dhe në ç’kuptim munden të gjithë besimtarët

sot, qofshin hebrenj apo johebrej, të quhen fara e Abrahamit?

11. Pse interpretimi që Pali i bën fjalës farë është e vetmja mënyrë që garanton shpresë për zotërimin e përhershëm të vendit që iu premtua Abrahamit, Isakut dhe Jakobit?
12. Çfarë funksionesh kishte ligji në periudhën mes besëlidhjes së Perëndisë me Abrahamin dhe farës së tij dhe mishërimit të Krishtit?
13. Për çfarë trashëgimie bëhet fjalë kur Shkrimet thonë që të gjithë besimtarët në Krishtin janë “trashëgimtarë sipas premtimit” (Gal 3:29)?
14. Kur u themelua besëlidhja e re?
15. Cilat janë premtimet më të mira mbi të cilat është themeluar besëlidhja e re?
16. Pse është më e lavdishme besëlidhja e re sesa e vjetra?

Pyetje për Kapitullin 11

1. Dhiata e Vjetër e hebrenjve përbëhet nga tri pjesë: Ligji (*Torah*), Profetët (*Nebiim*) dhe Shkrimet (*Kethubim*). Hartoni një listë për të treguar se Dhiata e Re citon nga të tria këto pjesë të Dhiatës së Vjetër.
2. Sillni të paktën një shembull të ndryshëm nga ato të dhëna tashmë në këtë kapitull për secilën kategori citimesh dhe përmendjesh.
3. A na mjafton të dimë se autorët e Dhiatës së Re e njihnin mirë Dhiatën e Vjetër dhe na kanë thënë ato gjëra që duhet të dimë rreth saj? Nëse duhet ta njohim mirë për veten tonë Dhiatën e Vjetër, si mund të sigurohemi që nuk po e keqpërdorim atë? Diskutoni.

Pyetje për Kapitullin 12

1. Klasifiko figurat letrare të përdorura te 2 Kor 3:13–18. Sfondi i këtij fragmenti është Eksodi 34:29–35. Shpjegoni si na ndihmon kur kuptojmë atë që ndodhi në Dhiatën e Vjetër të kapim atë që fragmenti i Dhiatës së Re po thotë.

2. Shpjegoni këto: krahasime formale, krahasime të thjeshta dhe metafora të përdorura në këto fragmente:
 - (a) 2 Kor 11:2–3
 - (b) Gjoni 6:48–50, 58
3. Cila është rëndësia e të krahasuarit mes Krishtit dhe Jonës te Luka 11:29–30; Mat 12:39–40?
4. Shpjegoni figurat letrare të përdorura te 1 Kor 5:6–8. Çfarë mësimi praktik kërkon që të japë Pali përmes këtyre?

Pyetje për Kapitullin 13

1. Çfarë kuptoni me fjalën *aludim*? Si na ndihmon zbërthimi i aluzioneve që Dhiata e Re i bën Dhiatës së Vjetër të kuptojmë atë që Dhiata e Re po thotë?
2. Çfarë kanë të përbashkët Kaini, Koreu dhe Balaami? Ku dallojnë ata nga njëri-tjetri?
3. Pse Perëndia pranoi sakrificën e Abelit dhe jo atë të Kainit?
4. Duke filluar nga kapitulli 11 e në vazhdim libri i Numrave dokumenton disa rebelime kundër Perëndisë. Gjejini ato dhe thoni pastaj sa prej tyre janë përmendur dhe trajtuar në Dhiatën e Re. Çfarë mësimesh jep Dhiata e Re prej këtyre incidenteve dhe si i zbaton për lexuesit e saj?

Pyetje për Kapitullin 14

1. Çfarë është një ‘aludim i tërthortë’? Jep një shembull. Cili është qëllimi i këtyre aludimeve?
2. Diskutoni dhe shtjelloni premtimin e Krishtit “Kush ka veshë, le të dëgjojë atë që u thotë Fryma kishave: kujt fiton do ti jap të hajë nga pema e jetës, që është në mes të parajsës së Perëndisë” (Zbul 2:7).
3. Në çfarë kuptimi e përdor apostulli Gjon fjalën “botë” në letrën e tij të parë?
4. Në ç’mënyrë Egjipti i Faraonit mund të bëhet një tablo e botës dhe princit të saj?

5. Shkruani me fjalët tuaja një ese të quajtur “Libri i Eksodit si një maket idesh për të kuptuar ungjillin e Gjoni”.

Pyetje për Kapitullin 15

1. Si kuptohet zakonisht termi “alegori”?
2. Pse shumë studiues nuk e pëlqejnë interpretimin alegorik të Biblës?
3. Cili është kuptimi i drejtpërdrejtë i shëmbëlltyrës së Samaritanit të mirë?
4. Çfarë është një argument *ad hominem*? A është Gal 4:21–31 një shembull i këtij argumenti? Nëse jo, pse jo?
5. Cilat janë shenjat që Pali, kur interpretoi ndodhinë Agar–Ismael–Sara–Isak, e trajtoi atë si histori dhe jo thjesht si një alegori?
6. Çfarë ka parasysh Pali kur përdor termin *mish*, kur thotë që lindja e Ismaelit ishte “sipas mishit”?
7. Në ç’kuptim janë besimtarët “fëmijë të premtimit” sipas Palit (Gal 4:28)?
8. Komentoni këtë ide: “Dallimi mes qëndrimit të Palit për shpëtimin para se të bëhej besimtar dhe atij kur u bë, mund të shprehet në termat e mishit dhe frymës.”
9. Kujt po i referohej Krishti kur foli për “fëmijët” e Jerusalemit (Luka 13:34)? A qenë ata fëmijë biologjikë, metaforikë apo alegorikë? Cili është dallimi mes metaforës dhe alegorisë?
10. Çfarë do të thotë Pali me shprehjen se Ligji që u dha nga mali Sinai ngjiz fëmijë “për skllavëri”? Ku është e meta, te Ligji apo te keqpërdorimi i tij nga ana e njerëzve (Gal 3:19, 21, 23–29; 4:1–7, 24)?
11. Çfarë funksioni të përkohshëm plotësoi Ligji në historinë e Izraelit (Gal 3:19; 4:1–7)?
12. Çfarë nëkupton shprehja “Jerusalemi nga lart” (Gal 4:26)?
13. Shprehni me fjalët tuaja dallimin e përshkruar te Heb 12:18–24, mes Malit Sinai dhe Jerusalemit qiellor.
14. Pse disa njerëz përndjekin të tjerët që mendojnë ndryshe nga ata për çështjet e fesë? A është e drejtë që një i

krishterë të veprojë kështu?

Pyetje për Kapitullin 16

1. Pse Pali thekson shumë te Rom. 4:10–12 rëndësinë që kishte momenti kur u rrethpre Abrahami?
2. Komentoni shprehjen: “Rrethprerja e Abrahamit pati një domethënie të dyfishtë.”
3. Cila ishte rëndësia parësore e rrethprerjes për pasardhësit dhe familjen e Abrahamit?
4. Në një nivel rrethprerja ishte një simbol. Për çfarë? A kishte vlerë ky simbol kur mungonte realiteti për të cilin qe dhënë? Çfarë mësimi mund të nxjerrin të krishterët prej funksionit të rrethprerjes në këtë nivel?
5. Shpjegoni me fjalët tuaja domethënien që Pali i jep rrethprerjes te Filip 3:1–9.
6. Si e kuptoni shprehjen “rrethprerja e Krishtit” (Kol 2:11–13)?
7. Shpjegoni idenë: “Ndodhia e krijimit të Evës gjen zbatim te Dhiata e Re në dy nivele të ndryshme.”

Pyetje për Kapitullin 17

1. Në ç’përfundim arrin autori i Hebrenjve duke u nisur nga Psalmi 40, vargjet 7-8, në rrjedhën e mendimit të shprehur në kontekstin e tij të ngushtë?
2. Çfarë i tërhoqi vëmendjen sipas jush autorit të Hebrenjve drejt Ps 110:1–4?
3. Çfarë ka dashur të thotë autori i Hebrenjve kur është shprehur se Melkisedeku, që përshkruhet te Zanafilla 14, “është i ngjashëm” me Birin e Perëndisë?

Pyetje për Kapitullin 18

1. Cili prej dy pasazheve të Dhiatës së Vjetër formon bazën e mesazhit të predikuar te Heb 3:7–4:16?
2. Cilën pikëpamje të autoritetit të Dhiatës së Vjetër mbështet autori ynë kur zbaton këto dy pasazhe të

Dhiatës së Vjetër për lexuesit e tij?

3. Çfarë ngjashmërie sheh autori ynë mes sjelljes së izraelitëve në shkretëtirë dhe asaj të lexuesve të tij? Cilat janë ato ngjashmëri që ai thekson?
4. Mbi çfarë baze argumenton autori ynë që Psalm 95 u bën lexuesve të tij premtimin e hyrjes në pushimin e Perëndisë?
5. Në çfarë termash e përshkruan autori ynë shkakun e dështimit të Izraelit për të hyrë në pushimin e tyre të premtuar? Si t’i kuptojmë ato terma?
6. Mbi ç’baza hyjnë sot besimtarët në prehjen e Perëndisë sipas asaj që deklaron autori ynë?
7. Çfarë do të thotë fraza “pushimi im” tek Ps 95:11? Krhs. Heb 4:3–5.
8. A “është hyrja në prehjen e Perëndisë” një përvojë e tashme apo e ardhshme?
9. Cili është funksioni i vargjeve 11-16 te Hebrenjve 4 në fund të predikimit të autorit tonë?

Pyetje për Kapitullin 19

1. Cili qe τύπος që Perëndia i tregoi Moisiut në Malin Sinai?
2. Cili është kuptimi i fjalës ἀντιτύπος te Heb 9:24?
3. Shandani i tabernakullit u bë që të ishte i ngjashëm me një pemë të vërtetë. A bini dakort që ai ishte simbolikisht një pemë e jetës? A ka një pemë të jetës në qiell (Zbul 2:7)?
4. Çfarë përfaqësonin çyrekët mbi Tryezën e Bukëve të Paraqitjes? Pse ishin dymbëdhjetë dhe pse duhej të shoqëroheshin me temjan?
5. Cila ishte domethënia e të djegurit temjan para Perëndisë?
6. Pse i duhej Aaronit të digjte temjan kur ai përgatiste llambat dhe i ndizte ato?
7. Pse duheshin spërkatur me gjak brirët e altarit? Me gjakun e kujt?

Pyetje për Kapitullin 20

1. Si na ndihmon të kuptojmë Gjonin 1:14 kur kuptojmë si funksionon tabernakulli?
2. Cili është kuptimi i ngushtë i termit teknik “tabernakull”? Çfarë nënkuptohet kur thuhet se qe një shumicë në unitet? A mendoni se kjo ilustron ndonjë realitet të sotshëm shpirtëror?
3. Cili është mësimi që Fryma e Shenjtë i komunikoi Izraelit përmes Velit?
4. Në ç’mënyrë ishte Veli një instrument i hirit? A funksionoi Krishti si një Vel? A vazhdon të funksionojë ende ashtu?
5. Tabernakulli mundësonte pastrimin përmes gjakut dhe përmes ujit. A ofron të njëjtën gjë edhe ungjilli i krishterë? Pse na duhen të dyja llojet e pastrimit?
6. Në ç’mënyrë tregon Shandani drejt Krishtit?
7. Tryeza e Bukës së Paraqitjes ishte një vend miqësie mes Perëndisë dhe priftërinjve të tij. Si e ilustron këtë 1 Gjoni 1:2–4?
8. Tryeza ishte përballë Shandanit. Si ndikonte kjo praktikisht te priftërinjtë? A ka këtu ndonjë mësim për ne?
9. Avokati ynë tek Ati është shlyesi i mëkateve tona (1 Gjoni 2:1–2). A ju sjell në mendje kjo ndonjë rit të tabernakullit?
10. Shandani dhe Tryeza prezanton llambat dhe çyrekët para Perëndisë. Shqyrtoni se çfarë thotë Dhiata e Re për paraqitjen tonë para Perëndisë.

Pyetje për Kapitullin 21

1. Cilat janë disa nga tiparet e tabernakullit të përmendura te Zbul 4:1–11; 8:1–5; 11:19; 15:5–8?
2. Cila është domethënia e pohimit se për çdo rast këto tipare ngrenë skenën për atë që vijon?
3. A bini dakort që këto tipare na ndihmojnë të shpjegojmë pse gjykimet e Perëndisë duhet të bien mbi tokë dhe

banorët e saj?

4. Çfarë kuptimi ka fraza “të drejtat e fronit si krijues”?
5. Çfarë kuptoni me “problemi i së keqes”? Si lidhet me lutjet e shenjtorëve?
6. A është e duhur që të krishterët të luten që Perëndia të ndërhyjë dhe të bëjë drejtësi për popullin e tij?
7. Cila është lidhja e titullit të dhënë Arkës te Zbul 11:19 me atë që vijon më pas?
8. Pse kur hapet tempulli i tabernakullit te Zbul 15:5, nuk shohim asnjë orendi të tabernakullit në të? Cila është domethënia e tymit?
9. Çfarë ka të pazakontë përdorimi i simbolizmit të tabernakullit te Zbulesa?

PJESA E TRETË

Pyetje për Kapitullin 22

1. Shpjegoni me fjalët tuaja pse ideja që interpretimi ynë duhet të jetë ose i fjalëpërfjalshëm ose tipologjik është tepër e thjeshtë.
2. Çfarë kemi parasysh kur themi që duhet marrë në konsideratë “natyra” e analogjisë?
3. Cilin rrjedhim etik synon Krishti në mësimet e tij për dy ardhjet e Mesias?

Pyetje për Kapitullin 23

1. Çfarë e përcakton kuptimin parësor të një rrëfenje kur Dhiata e Re e përmend atë rrëfenjë?
2. Cilat janë shenjat se një shpjegim i interpretimit që Dhiata e Re i bën një rrëfenje të Dhiatës së Vjetër është i dobët dhe jo i besueshëm?
3. A mund të sillni ju shembuj të tjerë për të treguar se

Dhiata e Re nënkupton se rrëfenjat e Dhiatës së Vjetër nuk bien ndesh me njëra-tjetrën?

4. Çfarë duhet të mbajmë parasysh nga Dhiata e Re nëse duam që interpretimi ynë i një fragmenti nga Dhiata e Vjetër të jetë i plotë?
5. Si mundet studimi i kontekstit fillestar të një rrëfenje të Dhiatës së Vjetër, që përmendet dhe zbatohet për ne nga Dhiata e Re, e përforcon të kuptuarit tonë për zbatimin që i bën Dhiata e Re asaj? Diskutoni shembuj të tjerë të mundshëm përveç këtyre.
6. Çfarë duhet të mbajmë parasysh kur themi që duhet të trajtojmë të gjithë rrëfenjën e Dhiatës së Vjetër seriozisht si një të tërë?
7. A duhet të marrim parasysh domethënien prototipike të mundshme të një rrëfenje? Nëse po, në ç'pikë duhet të futet ajo në studimin tonë?

Pyetje për Kapitullin 24

1. Kur përpiqemi të interpretojmë një rrëfenjë të Dhiatës së Vjetër për të cilën nuk komenton Dhiata e Re, nga duhet t'ia fillojmë?
2. Në ndodhinë e Davidit dhe Goliathit, si ndihmon në përcaktimin e synimit të autorit rrjedha e mendimit brenda kontekstit të rrëfenjës? Merrni një shembull tjetër të një ndodhie të njohur nga Dhiata e Vjetër dhe shqyrtoni si konteksti i ngushtë mund të ndihmojë në të njëjtën mënyrë.
3. Çfarë duam të themi kur pohojmë se duhet të peshojmë rëndësinë relative të një mësimi që kemi nxjerrë prej një rrëfenje të Dhiatës së Vjetër?

Pyetje për Kapitullin 25

1. Cilat janë rrjedhojat teologjike të interpretimeve të shumicës në rastin e gabaonitëve?
2. Si mundet përvijimi i një libri të tërë dhe përcaktimi i temave kryesore të tij të provojë ose jo që e kemi

interpretuar atë saktë?

3. A mund të provojë ndonjë gjë raporti i hapësirës që u është dhënë temave të ndryshme për vetë interpretimin tonë të asaj rrëfenje? Nëse po, si?

Pyetje për Fjala përmbyllëse

1. Kur Fryma e Shenjtë po fliste shekuj më parë përmes profetëve, çfarë qëllimi të madh parësor kishte në mendje për ne?
2. Po qëllimi i dytë madhor cili qe?
3. Cilat janë rrjedhojat e secilit prej këtyre qëllimeve për jetët tona si të krishterë sot?
4. Caktoni një kohë kur mund të falënderoni Perëndinë dhe lavdërojeni atë për Fjalën e tij.

Bibliografia¹

- Allen, Ronald B. 'Numbers.' In vol. 2 of Expositor's Bible Commentary. Edited by Frank E. Gaebelin. Grand Rapids: Zondervan, 1990.
- Arndt, William, F. Wilbur Gingrich, Frederick W. Danker, and Walter Bauer. *A Greek-English Lexicon of the New Testament and Other Early Christian Literature: A Translation and Adaptation of the Fourth Revised and Augmented Edition of Walter Bauer's Griechisch-Deutsches Wörterbuch Zu Den Schriften Des Neuen Testaments Und Der Übrigen Urchristlichen Literatur*. Chicago: University of Chicago Press, 1979.
- Beale, G. K. *The Right Doctrine from the Wrong Texts? Essays on the Use of the Old Testament in the New*. Grand Rapids: Baker Academic, 1994.
- Beale, G. K. and D. A. Carson, eds. *Commentary on the New Testament Use of the Old Testament*. Grand Rapids: Baker Academic, 2007.
- Bengel, J. A. *Gnomon of the New Testament*. 3d ed. Translated by James Bryce. Edinburgh: T. & T. Clark, 1890.
- Bruce, F. F. *The Epistle to the Hebrews*. Grand Rapids: Eerdmans, 1964.
- Carson, D. A. *Matthew*. The Expositor's Bible Commentary 8. Grand Rapids: Eerdmans, 1984.
- Carson, D. A., et al. *New Bible Commentary: 21st Century Edition*. Leicester: IVP, 1994.
- Carson, D. A. and John D. Woodbridge, eds. *Hermeneutics, Authority and Canon*. Leicester: IVP, 1986.
- Daube, D. 'Rabbinic Methods of Interpretation and Hellenistic Rhetoric.' *Hebrew Union College Annual* XXII (1949), pp. 239–64.
- Durham, J. I. *Exodus*. Word Biblical Commentary 3. Dallas: Word, 1987.
- France, R. T. *The Gospel According To Matthew: An Introduction and Commentary*. Tyndale New Testament Commentaries. Leicester: IVP, 1985.

1 Në marrëveshje me grupin redaktorial dhe botuesin, është menduar që autorët dhe veprat e tyre të lihen të pashqipëruara për lehtësi reference në studimin personal online ose jo.

- Gooding, David W. *An Unshakeable Kingdom*. Leicester: IVP, 1989.
- Goppelt, Leonhard. *Typos: The Typological Interpretation of the Old Testament in the New*. Translated by Donald H. Madvig. Grand Rapids: Eerdmans, 1982. trans. of *Typos: die typologische Deutung des Alten Testaments im Neuen* (Gütersloh: C. Bertelsmann, 1939).
- Harris, R Laird, et al. *Theological Wordbook of the Old Testament*. Chicago: Moody Press, 1980.
- Kierkegaard, Søren, *Fear and Trembling; Repetition*. Princeton: Princeton University Press, 1983.
- Kitchen, K. A. *On the Reliability of the Old Testament*. Grand Rapids: Eerdmans, 2003.
- Lightfoot, J. B. *Saint Paul's Epistle to the Galatians*. London: MacMillan, 1890.
- Marshall, I. Howard. *The Gospel of Luke*. Exeter: Paternoster Press, 1978.
- Meyers, Carol L. *The Tabernacle Menorah*. American Schools of Oriental Research Dissertation Series, No. 2. Missoula: Scholars Press, 1976.
- Millard, A. R. *Treasures from Bible Times*. Oxford: Lion Publishing, 1991.
- Moo, Douglas J. 'The Problem of Sensus Plenior'. Pages 175–212 in *Hermeneutics, Authority and Canon*. Edited by D. A. Carson and John D. Woodbridge. Leicester: IVP, 1986.
- Oxford English Dictionary*, 2d ed. Oxford: University Press, 1989.
- Smit, Daan. *Plants of the Bible*. Oxford: Lion Publishing, 1992.
- Sterry, Paul, *Collins Complete Guide to British Trees*. London: Harper Collins, 2007.
- Wenham, Gordon J. *Genesis 16–50*. Word Biblical Commentary 2. Dallas: Word, 1994.
- _____. *The Book of Leviticus*. New International Commentary on the Old Testament. Grand Rapids: Eerdmans, 1979.
- Westcott, B. F. *The Epistle to the Hebrews*. London: MacMillan, 1903.

Botime nga David Gooding

Punimi i doktoraturës

‘The Greek Deuteronomy’, PhD thesis, University of Cambridge, 1954.

Librat

- Recensions of the Septuagint Pentateuch*. Cambridge: Tyndale Press, 1955.
- The Account of the Tabernacle: Translation and Textual Problems of the Greek Exodus*. Texts and Studies: Contributions to Biblical and Patristic Literature, ed. C. H. Dodd, no. 6. Cambridge: Cambridge University Press, 1959.
- edited *The Text of the Septuagint: Its Corruptions and Their Emendation* by Peter Walters (formerly Katz). Cambridge: Cambridge University Press, 1973.
- Studies in Luke's Gospel*. Bible Study and Discussion Papers 1–3. Dublin: Biblical Studies Institute, 1973.
- An Unshakeable Kingdom: The Letter to the Hebrews for Today*. Scarborough, Ontario: Everyday Publications, 1975; [in German] *Ein unerschütterliches Reich: 10 Studien über d. Hebräerbrief*. Dillenburg: Christliche Verlagsgesellschaft, 1987; rev. ed. Leicester: Inter-Varsity Press/Grand Rapids: Eerdmans, 1989; repr. Port Colborne, Ontario: Gospel Folio Press, 1989; [in Hungarian] *Rendithetetlen királyság*, Stuttgart: Evangéliumi Kiadó, 1991; [in Bulgarian] *Посланието към Евреите*, Sofia: Нов човек, 1995; [in Russian] *Осуществление Ожидаемого: Посланце к Евреям*, Moscow, 1996; [in Vietnamese] 2003; [in Spanish] *Según Hebreos: Un reino incommovible*, Barcelona: Publicaciones Andamino, 2008; repr. Coleraine, N. Ireland: Myrtlefield House, 2013.
- Relics of Ancient Exegesis: A Study of the Miscellanies in 3 Reigns 2*. Society for Old Testament Study Monograph Series, 4. Cambridge: Cambridge University Press, 1976.
- According to Luke: A new exposition of the Third Gospel*. Leicester: Inter-Varsity Press, 1987; [in Polish] *Według Łukasza: nowe spojrzenie na Trzecią Ewangelię*. tr. Witold Gorecki. Wydawnictwo Ewangeliczne, 1992; [in Spanish] *Según Lucas: una nueva exposición del tercer Evangelio*. Editorial Clie/Publicaciones Andamino, 1996; [in

Russian] *Новый взгляд на Евангелие от Луки*. Duncanville, USA: World Wide Printing, 1997; repr. Port Colborne, Ontario: Gospel Folio Press, 2002; repr. Eugene, Origen: Wipf and Stock, 2005; repr. as *According to Luke: The Third Gospel's Ordered Historical Narrative*. Coleraine, N. Ireland: Myrtlefield House, 2013.

True to the Faith: A fresh approach to the Acts of the Apostles. London: Hodder & Stoughton, 1990; [in Spanish] *Según Hechos: permaneciendo fiel a la fe*. Editorial Clie/Publicaciones Andamio, 1990, 2008; [in Russian] *Верные вере: Новый подход к Деяниям святых Апостолов*. Duncanville, USA: World Wide Printing, 1994, 1998; repr. Port Colborne, Ontario: Gospel Folio Press, 1995; [in Romanian] Cluj: Editura Logos, 1995; repr. as *True to the Faith: Defining and Defending the Gospel*. Coleraine, N. Ireland: Myrtlefield House, 2013.

In the School of Christ: A Study of Christ's Teaching on Holiness. John 13–17. Port Colborne, Ontario: Gospel Folio Press, 1995, 2001; [in Spanish] *Según Juan: En la escuela de Cristo. Juan 13-17*. tr. Roger Marshall, Barcelona: Publicaciones Andamino, 1995, 2012; [in Hungarian] *Krisztus iskolájában*. Budapest: Evangéliumi Kiadó, 1996; [in Russian] *В Школе Христа (Учение Христа о святости)*. Newtownards, Myrtlefield Trust, 1997; [in Bulgarian] *В училището на Христос*. Sofia: Veren, 2000; [in Polish] *W szkole Chrystusa: studium nauczania Chrystusa na temat świętości, Ewangelia Jana 13-17*. tr. Adam Mariuk. Areopag, 2010; [in Burmese] 2013; repr. as *In the School of Christ: Lessons on Holiness in John 13–17*. Coleraine, N. Ireland: Myrtlefield House, 2013.

Windows on Paradise. Port Colborne, Ontario: Gospel Folio Press, 1998, 2001; [in Spanish] *Ventanas al paraíso: Estudios en el evangelio de Lucas*. Talleres Gráficos de la M.C.E. 1982; [in Russian] *Окно в рай. Исследование Евангелия от Луки*. Newtownards: Myrtlefield Trust, 1993; [in Malay] *Jendela Syurga*. 2008; [in Bulgarian] *Прозорец към рая*. Sofia: Veren, 2011; [in Burmese] 2012; [in Vietnamese] 2013.

The Riches of Divine Wisdom: The New Testament's Use of the Old Testament. Coleraine, N. Ireland: Myrtlefield House, 2013.

Libra të botuar me John Lennox

Christianity: Opium or Truth? Port Colborne, Ontario: Gospel Folio Press, 1997; [in Russian] *Христианство: опиум или истина?* Duncanville, USA: World Wide Printing, 1991; *Keresztelyenség: illúziók vagy tények?* Budapest: Evangéliumi K. és Iratmisszió, 1998; [in Bulgarian] *Христианството: опиум или истина?* Sofia: Veren, 2004; [in German] *Opium fürs Volk?* Bielefeld: Christliche Literatur-Verbreitung, 2012; [in Portuguese] *Cristianismo: Ópio do Povo?* Porto Alegre: A. Verdada, 2013.

Worldview I: The Human Quest for Significance: Forming a Worldview. [in Russian] Minsk, 1999.

The Definition of Christianity. Port Colborne, Ontario: Gospel Folio Press, 2001; [in Russian] *Определение Христианства*. 1997, 1999, 2005; [in Polish]

Definicja chrześcijaństwa. tr. Przemysław Janikowski. Areopag, 2001; [in Spanish] *Una definición del cristianismo para el siglo XXI : un estudio basado en los hechos de los Apóstoles.* Editorial Clie; [in Bulgarian] *Дефиниция на християнството.* Sofia: Veren, 2004; repr. Coleraine, N. Ireland: Myrtlefield House, 2014.

Key Bible Concepts. Port Colborne, Ontario: Gospel Folio Press, 2001; [in Russian] *Ключевые понятия Библии.* 1997; [in Bulgarian] *Ключови библейски понятия.* 1997, 2004; [in Malay] *Konsep Utama Dalam Alkitab;* [in Spanish] *Conceptos bíblicos fundamentales.* Barcelona: Editorial Clie/Publicaciones Andamio, 2001; [in Polish] *Kluczowe koncepcje biblijne.* Areopag, 2001; [in German] *Schlüsselbegriffe der Bibel.* Bielefeld: Christliche Literatur-Verbreitung, 2013; [in Portuguese] *Conceitos-Chave da Bíblia.* Porto Alegre: A. Verdada, 2013; [in Burmese]; repr. Coleraine, N. Ireland: Myrtlefield House, 2013; [in Swahili] *Lulu za Biblia: Dhana halisi za Biblia.* Nairobi: Kanisa la Biblia Publishers, 2014.

Worldview II: The Search for Reality (1). [in Russian] Minsk, 2004.

Worldview III: The Search for Reality (2). [in Russian] Minsk, 2004.

The Bible and Ethics: Studies for Group and Individual Work. Coleraine, N. Ireland: Myrtlefield Trust, 2011; [in Russian] *Библия и нравственное воспитание.* 1997, 1999; repr. Port Colborne, Ontario: Gospel Folio Press, 2011.

Leksione dhe fletushka të botuara

The inspiration and authority, canon and transmission of Holy Scripture. Edinburgh: Darien Press, 1961.

How to Teach the Tabernacle. Dublin: Merrion Press, 1970; repr. Port Colborne, Ontario: Everyday Publications, 1977; [in Spanish] *Cómo enseñar el tabernáculo.* Port Colborne, Ontario: Everyday Publications, 1977.

Current Problems and Methods in the Textual Criticism of the Old Testament. Belfast: Queen's University, 1979.

How? The Search for Spiritual Satisfaction. Leicester: Inter-Varsity Press, 1980.

Freedom under God. Bath: Echoes of Service, 1985.

Unfettered Faith: The Promotion of Spiritual Freedom. Coleraine, N. Ireland: Myrtlefield Trust, 1986.

Wer glaubt muß denken. Bielefeld: Christliche Literatur-Verbreitung, 1998.

Die Bibel—Mythos oder Wahrheit? Gibt es eine echte Erfüllung? Dillenburg: Christliche Verlagsgesellschaft, 1993; 2nd ed. Bielefeld: Christliche Literatur-Verbreitung, 2001.

The Bible: Myth or Truth. [in Bulgarian: *Библията: мит или истина*] Coleraine, N. Ireland: Myrtlefield Trust, 2001.

How about God? Four broadcast talks (Belfast: Graham & Heslip, n.d.).

Kapituj dhe artikuj kryesorë

'The Text of the Psalms in two Durham Bibles.' *Scriptorium* 12:1 (1958): 94–6.

'Aristeas and Septuagint Origins: A review of recent studies.' *Vetus Testamentum* 13:4 (1963): 357–379.

'Ahab According to the Septuagint.' *ZAW* 76 (1964): 269–80.

'Pedantic Timetabling in 3rd Book of Reigns.' *Vetus Testamentum* 15:2 (1965): 153–66.

'The Septuagint's Version of Solomon's Misconduct.' *Vetus Testamentum* 15:3 (1965): 325–35.

'An Impossible Shrine.' *Vetus Testamentum* 15:4 (1965): 405–20.

'Temple Specifications: A Dispute in Logical Arrangement between the MT and the LXX.' *Vetus Testamentum* 17:2 (1967): 143–72.

'The Septuagint's Rival Versions of Jeroboam's Rise to Power.' *Vetus Testamentum* 17:2 (1967): 173–89.

'The Shimei Duplicate and its Satellite Miscellanies in 3 Reigns II.' *Journal of Semitic Studies* 13:1 (1968): 76–92.

'Problems of Text and Midrash in the Third Book of Reigns.' *Textus* 7 (1969): 1–29.

'Text-Sequence and Translation-Revision in 3 Reigns IX 10 – X 33.' *Vetus Testamentum* 19:4 (1969): 448–63.

'Observations on Certain Problems Connected with the So-called Septuagint.' *TSF Bulletin* 56 (1970): 8–13.

'Jeroboam's Rise to Power: A Rejoinder.' *Journal of Biblical Literature* 91:4 (1972): 529–33.

'Two possible examples of midrashic interpretation in the Septuagint Exodus' in *Wort, Lied, und Gottesspruch: Festschrift für Joseph Ziegler* (ed. Josef Schreiner; Echter Verlag: Katholisches Bibelwerk, 1972), 39–48.

'On the use of the LXX for dating Midrashic elements in the Targums.' *Journal of Theological Studies* ns 25:1 (1974): 1–11.

'A Recent Popularisation of Professor F. M. Cross' Theories on the Text of the Old Testament.' *Tyndale Bulletin* 26 (1975): 113–32.

'An Appeal for a Stricter Terminology in the Textual Criticism of the Old Testament.' *Journal of Semitic Studies* 21 (1976): 15–25.

'Tradition of interpretation of the circumcision at Gilgal.' Jerusalem: World Union of Jewish Studies, 1977.

'Structure littéraire de Matthieu 13:53 à 18:35.' *Revue biblique* 85:2 (1978): 227–52.

'Demythologizing, Old and New, and Luke's Description of the Ascension: A Layman's Appraisal.' *Irish Biblical Studies* 2 (1980): 95–119.

- 'The Literary Structure of the Book of Daniel and its Implications' (The Tyndale Old Testament Lecture, 1980). *Tyndale Bulletin* 32 (1981): 43–79.
- 'Demythologizing the Ascension: A Reply by D. W. Gooding.' *Irish Biblical Studies* 3 (1981): 45–54.
- 'A Sketch of Current Septuagint Studies.' *Proceedings of the Irish Biblical Association* 5 (1981).
- 'The Composition of the Book of Judges.' *Eretz-Israel*, H. M. Orlinsky Volume. Jerusalem: 1982.
- 'Philo's Bible in the *De Gigantibus* and *Quod Deus*.' in *Two Treatises of Philo of Alexandria: A Commentary on De Gigantibus and Quod Deus Sit Immutabilis*, with V. Nikiprowetzky (ed. D. Winston and J. Dillon; BJS 25; Chico, Calif.: Scholars Press, 1983), 89–125.
- 'The Problem of Pain.' *Journal of the Irish Christian Study Centre* 1 (1983): 63–9.
- The Bible and Moral Education for Schools*, with John Lennox. Moscow: Uchitelskaya Gazeta (Newspaper for Teachers), 1993–5; repr. as *The Bible and Ethics*.
- Articles in *New Bible Dictionary* on 'Bezalel, Bezaleel'; 'Capital' [in tabernacle]; 'Censer'; 'Gershom, Gershon'; 'Kaiwan'; 'Kohath, Kohathites'; 'Merari, Merarites'; 'Oholiab'; 'Rephan'; 'Snuffers'; 'Tabernacle'; 'Texts & Versions 2. The Septuagint'; 'Trays'. Leicester: Inter-Varsity Press, 1996.
- 'The tabernacle: no museum piece' in *The Perfect Saviour: Key themes in Hebrews* (ed. Jonathan Griffiths; Nottingham: Inter-Varsity Press, 2012), 69–88.

Artikuj kritikë

- Review of Ilmari Soisalon-Soininen, *Der Charakter der asterisierten Zusätze in der Septuaginta*. *Gnomon* 33:2 (1961): 143–8.
- Review of Joost Smit Sibinga, *The Old Testament Text of Justin Martyr*. *Journal of Theological Studies* ns 16:1 (1965): 187–92.
- Review of Ilmari Soisalon-Soininen, *Die Infinitive in der Septuaginta*. *Journal of Theological Studies* ns 18:2 (1967): 451–5.
- Review of James Donald Shenkel, *Chronology and Recensional Development in the Greek Text of Kings viii*. *Journal of Theological Studies* ns 21:1 (1970): 118–31.
- Review of Adrian Schenker, *Hexaplarische Psalmenbruchstücke: Die hexaplarischen Psalmenfragmente der Handschriften Vaticanus graecus 752 und Canonicianus graecus 62*. *Journal of Theological Studies* ns 27:2 (1976): 443–5.
- Review of Raija Sollamo, *Renderings of Hebrew Semiprepositions in the Septuagint*. *Journal of Semitic Studies* 25:2 (1980): 261–3.
- Review of John W. Olley, "Righteousness" in the Septuagint of Isaiah: A Contextual Study. *Journal of Theological Studies* ns 32:1 (1981): 204–12.
- Review of J. H. Charlesworth, *The Pseudographa and Modern Research*. *Irish*

- Biblical Studies* 4:1 (1982): 46–49.
- Review of Anneli Aejmelaeus, *Parataxis in the Septuagint*. *Journal of Semitic Studies* 28:2 (1983): 369–71.
- Short Notice on Joseph A. Fitzmyer, *An Introductory Bibliography for the Study of Scripture*. *Journal of Theological Studies* ns 34:2 (1983): 693.
- Review of Homer Heater, *A Septuagint Translation Technique in the Book of Job*. *Journal of Theological Studies* ns 35:1 (1984): 169–77.
- Review of Roger Beckwith, *The Old Testament Canon of the New Testament Church*. *Irish Biblical Studies* 8:4 (1986): 207–211.
- Review of George Alexander Kennedy, Duane Frederick Watson (eds.), *Persuasive Artistry: Studies in New Testament Rhetoric in Honour of George A. Kennedy*. *Evangelical Quarterly* 64 (1992): 264–8.

Artikuj jo kritikë

- 'The True Peacemaker and Benefactor of the People.' *Precious Seed* 3:7 (1950).
- 'Modern Translations—Their Use and Abuse.' *Precious Seed* 7:8 (1956).
- 'New Testament Word Studies.' *Precious Seed* 12:1–4 & 13:1–6 (1961–62).
- 'How do you relate and reconcile the teaching on women in 1 Corinthians 11 and 14?' *The Word* (Belfast, 1994).
- 'Symbols of Headship and Glory.' *The Word* (Belfast, 1980); [in German] 'Symbole oder Zeichen von Autorität und Herrlichkeit' tr. von G. Giesler. *Verlegerbeilage zu Die Wegweisung* 6/87 (Dillenburg, Christliche Verlagsgesellschaft, 1987).

Indeksi i Shkrimeve

DHIATA E VJETËR

Zanafilla

1:1-2:3 51-2	15 21-2, 108, 109, 145,	18:16-19:38 227
2-4 197-9	149, 154 n., 218, 228,	20 227
2-3 209	230, 237-8, 245, 246, 336	21 227, 228, 337
2:3 272	15:1-4 333	21:8-12 336
2:5 197	15:2-8 147	21:9-14 246
2:7 197	15:2-6 133	21:9 239
2:8-9 209	15:2 227	21:10 226, 334
2:15 197	15:5 24, 160	21:12 227, 228
2:22-24 244	15:6 34, 129, 131-2, 136-	21:18 239
3 52	7, 227, 230, 328, 330,	21:21 237
3:5 213	332-3	21:22-34 337
3:15 162	15:7-9 24	22 84, 330-42
3:17-19 197-8	15:7 164, 236	22:17 24
3:20 198	15:8-21 150, 237	22:18 24
3:21 196, 198	15:13-16 24-5, 151, 218	22:19 337
3:22-24 209	15:13 108, 164	25 334
3:23 197	15:16 108, 163, 367	26:2-3 46
4 194-5	15:17-20 151	29:31 339
4:6-7 198	15:18-21 24	30:29-43 4
4:11-14 197-8	15:18-20 151	32:24-30 256
4:13 199	15:18 35, 164	34 4
4:16 197, 199	16 154 n., 227, 228, 230-	37:5-7 151
9:6 52	1, 238	41 24
12:1-3 146	16:10 239	44:2-5 379
12:1 24	16:16 132	46:1-4 110
12:2 24	17 44, 227, 239, 245-8	46:8-27 24
12:3 24, 78	17:10 154 n.	46:14 108
12:5 147	17:15-22 231	
12:7 147	17:15-21 228	
13:14-18 24	17:15-19 134	
13:14-17 147	17:16 24, 239	
14 257	17:18-21 227, 334	
14:18-20 254	17:23-24 132	
15-21 226-7, 238	17:23 227	
	17:25 154 n.	
	18:1-15 227	

Eksodi

libri 210-21
1:8-14 218
1:11 219
1:15-22 218
3:1-15 53
3:1-10 216
3:2-8 331
3:2-6 9

3:2-4 151	26-31 216	16:12 290
3:8 269	26:1-6 298	16:13 292
3:10 210, 216	26:11 298 n	16:16 292
3:13-4:9 216	26:15 298	16:17 205
3:13-15 210	27:1-8 302 n.	16:18 311
3:13-14 210	27:1-2 290	17:11 34
3:14 210, 216	28-29 40	18:5 124, 234
4:1-9 210	28:36-38 295	19:2 57
4:1-8 216	29:4 305	19:18 54, 57
4:13 210	30:1-10 290-5	20:7 57
4:27-31 216	30:6-8 283	20:8 57
4:28-31 210	30:6 315	20:26 57
5:1-19 218	30:17-21 302 n.	21:8 57
8:1 25	30:19-21 305	21:15 57
8:19 216	30:34-38 294	21:23 57
8:22 216	30:36 293	22:9 57
9:11 216	30:37-38 293	22:16 57
9:27 216	30:38 291	24:1-9 283
12 25, 186, 210	31:18-34:28 210	24:2 293
12:11 189	32 262	26:31 294
12:21-23 58	32:1-5 295	
12:23 104, 216	32:21 295	
12:29-36 216	33:20 293	
12:38 262	34:6-7 121 n.	
12:46 210	35-40 216	
15 262	40:6-12 302 n	
16 210, 216	40:26-27 290-5	
17:2-4 262	40:34-35 297, 298 n.	
19-24 210		
19:5-6 156		
19:18 320		
20:1 319		
20:2 210, 218		
20:3 318		
20:4-5 318		
24 2		
24:1-8 155-6, 318		
24:7-8 186		
25-31 38		
25:8 210, 281, 296		
25:9 281-2, 296-7		
25:22 292		
25:23-30 286-90		
25:31ff 379		
25:31-40 283-6		
25:31 380		
25:33 379		
25:35 380		
25:40 40, 281-2		

Levetiku

1:1-6:7 58
1:4 52, 59
1:9 58
4:1-35 60
4:7 290, 311
4:18 290, 311
4:20 301
5:1-6:7 60
6:7 61
6:8-7:38 58
6:26 59
7:1-10 59
7:15-20 59
8-9 40
10:1-3 295
11:44 57
11:45 57
16 61, 64-5
16:2 300 n.

Numrat

4:7 286
11 202
11:4-35 190
12:6-8 204
12:7 180
13-14 202, 258-75
14:11 203
14:20-24 266
14:24 266
14:28-31 266
14:31 266
14:32-35 264
16-18 40
16-17 202-7
16 194
16:3 204
16:13 205
16:14 205
16:35 290
16:36-40 206
16:46-49 291
17:1-11 207
17:8 377
20:1-13 202
20:12-13 295
20:23-29 202, 295
21:4-9 182-5

22-24 194, 200-2
 22:7 200
 22:8-12 200
 22:15-19 200
 22:20 200
 22:23-35 200
 22:23 203
 22:35 200, 201
 22:37 200
 23:1-3 201
 23:5 200
 23:16 200
 23:20 200
 23:26 200
 24:4 200
 24:10-13 200
 25 202
 25:1-15 137
 25:1-9 201
 25:1-2 200
 25:1 203
 25:6-8 203
 25:11 203
 28:2 287
 31:8 202
 31:15-16 200, 201
 32 202

Ligji i Përtërirë

1:8 186
 2:14-15 264
 4:25-27 158
 5:16 175
 6:5 54, 59
 6:6-7 50
 6:13 54
 6:16 54, 175
 8:1 157
 8:3 54
 18:10 84 n.
 18:15 37
 20:10-18 354
 20:10-11 365
 20:15-18 358
 20:16-18 359
 20:17-18 366
 25:1 123
 25:4 141-3
 27:26 125

28:15 157
 28:63-64 157
 29:1 157
 30 250
 30:1-5 159
 30:6 250
 31:16-17 158
 31:29 158

Jozueu

libri 163
 1:1-4 38
 1:5 176
 2 364
 2:2-7 360
 2:9-11 363
 2:12-13 360, 362-3
 2:16 363-4
 6-8 356, 358
 6 364
 6:1 362
 6:17-21 359
 6:17 360
 6:24 359
 6:25 361, 366 n.
 9:1-10:27 354-67
 11:23 271
 14:10 361
 20:9 361
 22:4 271
 24:2-3 23

Gjyqtarët

13:3-22 256
 18-21 4

1 Samuelit

8 348-9
 9:1-10:1 80
 10:23 350
 11:1-15 350
 12:6-13 349
 13:13-14 80
 13:14 83
 15:26-29 80
 16 349
 17 343-53
 19:11-17 4

21:1-6 9
 27:7-12 4

2 Samuelit

3:26-29 84 n.
 4 80
 5:1-5 25
 5:4-10 26
 7 21-2, 71-7, 83, 109, 349
 7:6 271
 7:12-16 27, 68-9, 80
 7:15 80
 11 26
 12:31 26
 14ff 84 n.
 18:5-17 84 n.
 19:11-13 84 n.
 20:4-12 84 n.
 21 366
 24:1-17 84 n.
 24:2-4 4

1 Mbretërve

4:20 27
 4:25 27
 4:29-34 27
 5:4 27
 5:5 69
 8:17-20 69
 8:18 71
 8:22-53 27
 10:1-25 27
 10:27 27
 11:1-13 28
 12:1-4 28
 12:25-33 28
 18:13-19:2 193
 18:46 189
 21:25-26 193

2 Mbretërve

15:9 28
 15:18 28
 15:24 28
 15:28 28
 16:3 84 n.
 17 28

1 Kronikave

13:6 315
 22:9-10 69
 28:5-7 69
 28:6 69

2 Kronikave

6:8-10 69
 6:41 271
 26:16-21 40
 28:3 84 n.
 36:11-21 28
 36:22-23 29

Ezdra

1:1-11 29
 3:1-6:22 29

Nehemia

1:1-13:31 29

Jobi

libri 83

Psalmet

2 67
 2:8-9 163
 7:11 33
 16:8-11 67, 76
 32 301
 32:1-2 131
 32:5 131
 34:12-16 176
 40:6-8 39, 253, 373
 40:7 253
 51 26
 69:25 67
 82:6 140
 83:6 237
 89 28
 94:1-7 97-8, 316
 95 258-75
 95:7-11 77
 96 99
 96:11 98
 96:13 98
 98 99

98:7-9 98
 103:8-18 121 n.
 103:8-17 33
 106 203
 106:30-31 137-8
 109:8 67
 110 98
 110:1 26, 40, 67, 92-4, 98, 254-5
 110:4 26, 36-7, 40, 255-7
 118:22 9, 67
 132:11 76
 141:2 310
 143:2 125
Fjalët e urta
 libri 83
 3:11-12 176

Predikuesi

libri 83

Kantiku i Kantikëve

libri 83

Isaia

1:1-31 28-9
 2:1-4 27
 5:23 123
 9:1-7 113
 9:6-7 75
 10:5-15 74
 11:1 113
 11:10 43
 25:6-8 27-8
 35 112
 41:8-10 23
 41:8-9 34
 41:8 308
 42:9 73
 43:1, 10-12 23
 46:9-10 73
 49:6 43
 49:14-21 236
 51:1-2 238
 51:9-11 105, 109
 52:3-12 109
 52:13 308
 53 20, 29

53:3 113
 53:6 52, 127
 53:7 186
 53:8 308
 53:10 127, 308
 53:11 308-9
 53:12 101
 54:1 238-9
 56:7 10
 57:3-4 160-1
 61:1-4 99-100
 61:1-2 8
 62:5 236
 63:1-6 97
 63:4 100
 63:11-19 105
 65:5 294
 65:17 177

Jeremia

2:2 320 n.
 6:10 247
 7:1-34 28
 9:23-24 352
 25:11-12 29
 29:10-14 29
 29:10 112
 30:1-22 29
 31:15 111-2
 31:16-17 112
 31:31ff 2, 371, 374
 31:31-34 13, 39, 168
 31:31-32 36
 31:32 169
 31:33-34 170
 32:36-41 112
 33:1-26 29
 33:25-26 112
 34 168
 34:8-22 149
 36:1-32 19

Ezekieli

16 320
 23 320
 26-27 320
 36:16-37:28 112
 36:25 182
 37:14 182

Danieli

1:1–7 29
2 31
2:25–45 30
7 31, 55–6
7:1–14 94
7:1–12 30
7:9–14 30
7:11–14 91, 92, 94–6
7:13–14 30, 56
7:16–28 94
7:18 94
7:21–22 95
7:21 94
7:22 94
7:25–27 95
7:25 94
7:27 94
8:21–22 94
9 29
9:2 19
11:34 30

Osea

6:6 9, 55
8:13 108 n.
9:3 108 n.
11:1–11 108–9
11:1–3 42
11:1 106–10

Joeli

2:28–32 67
2:28–29 38, 103

Amosi

3:1–2 28
9:11–12 76–7

Jona

libri 179 n.

Mikea

5:2 102, 109
6:7 84 n.

Habakuku

2:4 176

Zakaria

9:9 12, 26, 91, 103
14:1–2 159

DHIATA E RE**Mateu**

1:1–17 22–31
1:1 109
2:2–3 109
2:4–6 102, 109
2:13–15 106
2:13 110
2:14–15 111
2:15 107–8
2:17–18 111
2:19–23 106, 113
2:19–21 112
2:19–20 111
3:17 309
4:4 8, 54, 233
4:7 8, 54, 175, 233
4:10 8, 54, 233
4:13–16 113
5:17–18 12
5:17 114
5:43–48 115
7:12 114
8:20 163
9:13 9, 55
10:5–6 43
11:13 114
11:28–29 274
11:28 270
12:1–8 139–40
12:5–6 140
12:5 115 n.
12:6 206
12:7 55
12:22–37 178
12:41–42 178
12:42 27
13:3–30 142
13:30 99
13:39–43 99
15:24 43
16:18 79
16:21–23 67
19:3–6 52
19:4–6 244

19:28 95
21:1–11 12, 26, 92
21:12–13 10
21:42 9
22:29–32 53
22:32 54
22:34–40 54
22:37–40 115
22:37 14
22:40 114
22:41–46 92, 254
24:30 56
25:31–32 95
26:25 93
26:41 341
26:51–52 39, 329
26:53–54 8–9
26:63–64 92
26:64 56, 93
27:51 299
28:18–20 43

Marku

2:25 9
2:27 144
7:1–23 44
7:8–11 10
10:45 52–3, 101
12:24–26 9
14:62 93, 103

Luka

1:10–13 311
1:27 79
1:31–33 75
1:35 75
4:16–30 50
4:16–21 8, 100
4:23 143
4:24–27 177
7:29 124 n.
8:13–15 263
9:45 67
10:25–28 54
10:30–37 – 224
12:8–9 341
12:32 95

13:10–17 144
13:34 236
14:26 339
17:24 100
17:25 100–1
17:26 180
17:32 177
18:1–8 316
18:7–8 100
18:31–34 67
19:10 329
20:13–15 163
21:24 159
21:25–28 163
21:27 30, 43, 103
22:14–16 104
22:20 2, 13, 35, 168, 371
22:28–30 95
22:31–34 342
22:31–32 270
22:37 101
22:54–62 342
22:69–70 30
23:39–43 17
23:42–43 270
23:43 209
24:13–35 20–1
24:25–27 12–13
24:27 10, 35, 68
24:44–47 68
24:44 11
24:45 14
24:47 26–7

Gjoni

libri 210–21
1:1–4 221
1:1–2 217
1:1 52, 309
1:4 307
1:10–11 163
1:14 217, 297
1:17 210
1:18 217
1:29 26–7, 210, 217
1:33 37
1:45–46 113

2:19–22 38
2:19–21 45
3 181–5
3:5 306
3:16 221
3:17 210, 217, 329
4:20–24 45
4:34 217
4:35–38 142
5:22–23 178
5:24–25 307–8
5:24 17–18
5:26 307–8
5:28–29 308
5:36–37 217
5:36 210, 217
5:38 210
5:46–47 10
5:46 35
6:31–33 210
6:38 217
6:39 217
6:48–58 217
6:48–51 210
6:48 217
6:57 217
6:58 210
6:63 13
7:18 217
7:23–24 140
7:28 217
7:29 217
7:39 38
8:12 217, 308
8:16 210, 217
8:18 210, 217
8:24 210, 217
8:26 217
8:28 210
8:37–44 161
8:51 308
9:4 210
10:32 217
10:34–36 140
10:36 210, 217
10:37–38 217
11:25 217, 308
11:43 308
12:13–16 103

12:31–32 217
12:31 105, 210
12:34 184
12:45 302
13 306 n.
13:1–11 305
14:1–3 18, 65, 221
14:3 217
14:6 18, 217
14:9 302
14:13–14 311
14:19 308
14:21–24 14
14:23 210, 217, 221
14:30 210
15:1 217
15:18–25 214
15:18–19 210
15:22–25 179
15:25 126
16:7 38
16:8–11 210
16:11 105, 210, 217
16:14 14
16:23–24 311
16:28 220
17:1–3 221
17:2–3 53–4
17:5 221
17:6–8 217
17:6 170, 210
17:14–16 210
17:14 214
17:15 210
17:24 217, 221
17:26 170, 210, 217
18:36–37 329
18:36 39
19:22 8 n. 2
19:31–36 217
19:33 210
19:36 210
20:30–31 210, 217

Veprat

1:3 68
1:4–5 37–8
1:6–8 98

1:8 38
 1:20–26 67
 2:1–18 38
 2:1–4 37
 2:16–17 43
 2:17–36 67
 2:25–31 76
 2:20 43
 3:21 83, 98
 3:22 37, 206
 4:1–21 67
 4:13 67, 68
 4:18–31 67
 4:25–27 163
 6:8–7:60 46
 7:2–8 46
 7:6–8 46
 7:9–16 46
 7:17–44 46
 7:37 37
 7:45–46 46
 7:47–50 47
 8 51
 10 44, 115
 10:43 35
 13:14–16 50
 13:22 83
 13:27–30 21 n.
 13:27 50
 13:38 136
 13:47 43
 15:1–11 44
 15:1–5 124
 15:1 132
 15:13–18 76
 17:31 98 n.
 26:12–18 229

Romakëve
 1:1–4 19
 1:3–4 76
 1:3 79
 1:17 176
 1:18 33–4
 1:32 33–4
 2:23–29 44
 2:25–27 247
 3–4 121–38
 3:19–31 274

3:19–26 123
 3:19 125, 250
 3:20 125
 3:21–28 270
 3:24 122 n.
 3:26 123
 3:27–31 128–9
 3:28 34
 4:1–8 2
 4:1–5 330
 4:3 34
 4:5 124
 4:9–16 154 n.
 4:9–12 132
 4:9–10 44
 4:11 132, 245
 4:12 133, 166, 246
 4:13–16 133
 4:13 151
 4:14 151
 4:16–25 328
 4:16–18 239
 4:16 151, 164
 4:17–22 133–4
 4:18–25 232
 4:19 229
 4:20 151
 4:21 151
 4:23–25 135
 5:1–11 274
 5:1 18, 135
 5:2 122 n.
 5:6–11 374–5
 5:12–19 244
 5:14 117
 5:15 52
 5:17 52
 5:19 52, 117
 5:20 122 n.
 6:1–4 248
 Romakëve
 6:14 122 n.
 7:7–24 125
 8:1 256
 8:3–4 170
 8:3 169
 8:4–9 250
 8:13 306
 8:14–17 41

8:17 163
 8:23 65
 8:31–39 274
 9:1–5 128
 9:6–7 246
 9:30–10:4 235
 10:17 196
 11:1 35, 167
 11:2 35
 11:11 35
 11:12–27 239
 11:25–27 169
 11:25–26 35
 12:2 304
 13:8–10 55
 13:10 115
 14:17 143
 15:4 3, 55, 82
 15:8 35
 15:12 43

1 Korintasve

1–3 352
 1:11–13 352
 1:13 352
 1:18–31 352–3
 1:23–25 184
 2:5 352–3
 3:1–9 352
 3:6–8 142
 3:11 38
 3:16–17 38, 45
 3:21 352–3
 4:6 352
 5:7 25, 105
 6:16 244
 6:19 45
 8:3 53–4
 9:8–10 141
 9:9 143
 10:1–13 54
 10:6 116
 10:8 203
 10:11 116
 10:13 340
 10:21–22 203
 11:25 35, 169
 11:27–32 117, 247
 11:30–32 203

12:12–13 299
 12:13 37
 14:20 14
 15:1–4 19
 15:3–4 91
 15:3 1
 15:14–17 136
 15:20–23 91
 15:23 163
 15:35–49 53
 15:45–49 244
 15:51–52 163

2 Korintasve

3 36
 3:3 170, 371
 3:6 371
 3:7–11 171
 3:17–18 371
 4:16–5:5 373
 5:1–8 274
 5:21 185
 7:1 306
 10:4 39
 11:2–3 203, 320 n.

Galatasve

1:11–12 229
 2:21 128
 3:6 225
 3:8–14 146
 3:8 78, 225
 3:9–10 235
 3:10–12 153
 3:10 125, 225
 3:11 176, 225, 235
 3:12 225, 234
 3:13 225, 235
 3:14 151, 235
 3:15–29 228
 3:15–18 2, 228, 246
 3:15–16 35
 3:15ff 148
 3:15 154
 3:16–17 225
 3:16 151, 161, 228, 237
 3:17 151, 154, 228
 3:18 151, 152–3
 3:19–20 156

3:19 154, 161, 166, 167
 3:20–21 166
 3:21 151, 167, 235
 3:22 165
 3:24 125, 151
 3:27–29 162
 3:29 145, 237
 4:1–7 41, 167, 234
 4:1–4 115
 4:1–3 294
 4:3–7 41–2
 4:21–22 233
 4:22 228
 4:23 228, 229
 4:24–31 222–40
 4:24 232–5, 237
 4:25 235–7
 4:26 237–8
 4:28 151
 4:29–31 228
 4:29 229, 239
 4:30 226, 227
 5:1–6 44
 5:2–4 248
 5:6 248
 6:14 184

Efesianëve

1:4 312
 1:7 34, 122 n.
 1:13–14 268
 2:6 312
 2:7–10 270
 2:7–8 122 n.
 2:11–12 162
 2:12–22 169
 2:14–15 38
 2:15–22 79
 2:15–16 299
 2:21–22 45, 299 n.
 3:1–13 38
 3:6 162
 3:9–10 312
 3:10 86
 5:8 312
 5:25–27 303
 5:29–32 244
 6:2 175
 6:10–20 344

Filipianëve

2:15 312
 3:2–9 249–50
 3:3–9 230
 3:4–7 129
 3:5–12 230
 3:9 126
 3:17 116
 3:21 53
 4:18 289, 294

Kolosianëve

1:13–14 268
 1:13 105
 2:9 297
 2:11–13 250–1
 3:10 52

1 Thesalonikasve

1:9 363
 4:13–18 274
 4:16 65

2 Thesalonikasve

1:4–10 95 n.
 1:5–10 96
 1:6–12 163
 1:7–12 274
 2:3–12 43

1 Timoteut

2:5–6 53
 2:5 33
 6:13–16 96
 6:17 213, 321

2 Timoteut

1:5 50
 2:8 79
 3:14–17 49–50
 3:15–17 39
 3:16–17 48

Titit

1:12 304
 2:13 – 65
 3:3 304
 3:5–6 304

Hebrenjve

1:1-3 37	7:23-24 37	10:32-35 270
1:1-2 32, 206	7:25-28 311	10:35-39 268
1:2 42, 163	7:25 171	10:35-36 336
1:5-13 69	8-9 268	11:3 52
2:1 270	8:1-5 282	11:4 195-6
2:3 268	8:1-2 41	11:9 162, 164
2:5-18 244	8:2 282	11:13-16 268
2:9-10 24	8:4 40	11:17-19 333-5
2:14-15 344-5	8:5 40, 62, 117, 282	11:31 360, 363
3-4 203	8:6-13 39, 155	11:32 177, 343
3:1-6 79	8:6 2, 168, 169, 170	12:1 343
3:1 206	8:9 2, 169	12:2-3 206
3:2 180	8:10-12 170	12:5-6 176
3:7-4:16 258-75	8:12 33	12:22-29 268
3:14 263	8:13 2, 36, 169	12:24 168, 170
3:15 263	9:2 300 n.	12:28-29 295
3:16 264	9:3 299, 300	13:5 176
3:17 264	9:8-12 61-2	13:14 268
3:18 203, 265	9:8 300	
3:19 203, 265	9:9 36, 300, 301, 303	Jakobi
4:1 265	9:12 62	2:10 125
4:2 203	9:13-14 303	2:13 364
4:3 270	9:14 36, 306	2:14-17 335
4:6 265 n.	9:15-26 36	2:20-22 85
4:8-9 38	9:15 168, 170	2:21-25 176
4:11 265 n.	9:16-17 1	2:21-24 138
4:12 77	9:22 292	2:21 330
5:1-3 290	9:23-28 64-5	2:22 332
5:5-6 37	9:23 62, 282	2:23 176, 332
5:7-14 18	9:24 40, 62, 118, 282	2:25 360, 364
6:1-12 336	9:26 42	3:1 60
6:1 268	10 252-4, 268	4:4 321
6:11-12 336	10:1-3 36	5:11 177
6:13-14 335	10:1 63	
6:15 336	10:4 36	1 Pjetrit
6:17-20 336	10:5-18 373-5	1:1-2 187
6:18-20 270	10:5-10 39	1:3-4 38, 186, 268
6:20-7:28 36-7	10:5 40 n.	1:5-7 190
7 254-7, 268	10:12-22 301	1:6 371
7:1-3 254	10:13 103	1:10-12 14, 371
7:6-7 255	10:14-18 169	1:11 372
7:11-28 206	10:14 36	1:12 372
7:12 40	10:17-18 36	1:13-15 190
7:13-14 36	10:18-22 62	1:13 187, 188-91
7:16 79, 207	10:19-22 61	1:14-16 58
7:20-22 37	10:19-20 301-2	1:18-20 25
7:20-21 255	10:19 300 n.	1:18-19 185
7:22 168, 171	10:21 79	1:19-20 42, 105
7:23-25 270	10:22 306	1:21 372

2:4-7 38	8 311
2:4-5 45	
2:5 38	8:1-11:18 313, 315-7
2:20 371	
2:21-25 24	8:3-5 311
2:21-23 186	
3:10-12 176	11:19-15:4 313, 318-9
3:17 371	
4:12-16 371	14:13 274
	15:5-19:10 314,
2 Pjetrit	319-23
1:20-21 49	
1:21 70-3, 370	17 320-21
3:9-10 99	
3:13 177	18 320, 321-2
1 Gjonit	
1:2-3 309	19:1-8 322
1:2 309	
1:3 309	19:11-21 97
1:5-7 310	
1:7 302, 310	19:15 163
1:9 33, 310	
2:1-2 310-11	21:2-3 323
2:15-17 213-4, 322	
2:16 213	22:2 209
3:2-3 190	
3:11-12 180	22:14 209
3:12 195-6, 214	
3:13-15 214-5	
4:8 33	SHKRIME TË TJERA
4:10 33	
5:3-4 215	TË LASHTA
Juda	
4 193-4	Cicero, Orator
11 193-207	27.94 222
Zbulesa	
1:5-7 30	Homer, Iliad 211;
1:7 91, 100	
1:18 79	Book 3 345;
2:5 209	
2:7 208-9	Book 7 345
2:14-16 202	
2:20 192	Odyssey 211
3:15-16 59	
4:1-7:17 313, 314-5	Táin, The 345
6:1-8 316	
6:10 316	Virgil, Aeneid 211
6:12-17 317	

Indeksi i fjalëve greke dhe hebraike

Grequisht

ἀλληγορέω, allēgoreō
 ἀλληγορία, allēgoria
 ἀντιλογία, antilogia
 ἀντίλυτρον, antilytron
 ἀντιτύπος, antitypos
 ἀπειθέω, apeitheō
 ἄτινά ἐστιν ἀλληγορούμενα,
 hatina estin allēgoroumena
 γέγραπται, gegraptai
 γράφω, graphō
 δωρεάν, dōrean
 διαθήκη, diathēkē
 ἐσκήνωσεν, eskēnōsen
 ἐξεχύθησαν, exechythēsan
 ἐρεῖτε, ereite
 εὐαγγελίζομαι, euangelizomai
 ἦ, hē
 ἦτις, hētis
 κόνδυ, kondy
 κρατῆρες, kratēres
 ὁλοκαύτωμα, holokautōma
 παιδαγωγός, paidagōgos
 πάντως, pantōs
 παράδειγμα, paradeigma
 παράδεισος, paradeisos

παροίκησις, paroikēsis
 πλάνη, planē
 σαββατισμός, sabbatismos
 σκηνή, skēnē
 συστοιχεῖ, systoichei
 τελειόω, teleioō
 τύπος, typos

Hebraisht

לֶהֱלֵךְ, 'ōhel
 אֲזַכְרָהּ, 'azkarah
 בָּנָהּ, bānāh
 גְּבִיִּים, gēbiīm
 וַיִּגְמֹל שְׁקָדִים, wayyigmōl shēqēdīm
 וַיַּצֵּטְסָם, wayyātsēts tsīts
 כַּפְתֹּרִים, kaphtōrīm
 מָסַךְ, māsāk
 מִשְׁכָּן, mishkān
 אֵלָה, ōlāh
 פָּרַח, pārach
 פֶּרַח, perach
 פֶּרָאֲחִים, pērāchīm
 פָּרוּכֶת, pārōketh
 שָׁאֵן, shākan
 תַּבְנִית, tabnīth
 תָּמִיד, tāmīd

Indeksi i Përgjithshëm

<i>a minore ad maius</i>	Ajaksi
Aaron	Akan
rendi i	Akish
shkopi/bastuni i	alegori
Abel	“Allen, Ronald B.”
besimi i	Altar
sakrifica e	i bronzhtë
Abimelek	i artë
Abner	aludim
Abraham	i drejtëpërdrejtë
rrethprerja e	i tërthortë
besëlidhja me	Amasa
besimi i	analogji
trashëgimtari i	antitipi
si një precedent ligjor	Arabia
dhe Melkisedeku	Arka e Besëlidhjes
sakrifikimi i Isakut	ateizmi
fara e	Babilonia
Absalom	kurva
ad hominem (argument)	bajame
Adam	Balaami
besimi i	Baraku
në genealogjinë e Krishtit	“Beale, G. K. ”
ndëshkim dhe falje	“Bengel, J. A. ”
mëkati i	besëlidhje
si një tip i Krishtit	me Abrahamin
Agar	e kushtëzuar
Agustini	garantues
Ai	ndërmjetësi

e Moisiut	Dhiata e Re
e re	Dhiata e Vjetër
e vjetër	Dhjetë Urdhërimet
njëpalëshe	Dhjetë Urdhërimet
sakrifica e	Dita e Rrëshajëve
Sinait	Dita e Shlyerjes
dypalëshe	djali
e pakushtëzuar	<i>shih edhe</i> SATANI
me qytetet e huaja	domethënia e shumëfishtë
me gabaonitët	drejtësia
besimi	“Durham, J. I. ”
i Abelit	Dymbëdhjetë Pllakat
i Abrahamit	E Shtuna
i Adamit	Egjipti
në Krishtin	Eliezeri
i Davidit	Elija
i Pjetrit	Eliseu
forcim i	Eva
<i>shih edhe</i> shfajësimi me anë të	evolucioni i fesë
besimit	faj
betimi	ofertë e
Biri i Njeriut	falje
bota	Faraoni
“Bruce, F. F. ”	femohim
“Carson, D. A. ”	Ferdia
Ciceroni	figura letrare
citimet	Filo
citimet shih citimet	filozofia
Cúchulainn	Fineasi
Darka e Zotit	“France, R. T. ”
dashuria	froni i Perëndisë
për Perëndinë	Fryma e Perëndisë shih Fryma e
për të afërmin	Shenjtë
“Daube, D. ”	Fryma e Shenjtë
David, mbreti i Izraelit	ardhja e
sjellja e	dëshmia personale e
<i>David, mbreti i Izraelit</i>	rilindja prej
dinastia e	gabaonitët
besimi i	garantuesi
falja e mëkateve të	Gideoni
dhe Goliathi	Gilgali

gjuhë e figurshme	Johebrenjtë
gjykimi	ungjilli i
përfundimtar	Jona
<i>shih edhe</i> gjykimi i Perëndisë;	Jozefi (bir i Helit)
zemërimi i Perëndisë	Jozefi (bir i Jakobit)
Goliathi	hije e Krishtit
Gomora	Jozueu
“Goppelt, Leonhard “	jurist
Hektor	Kaini
heshtja (në rrëfenjë)	mëkati i
hir	rruga e
Homeri	Kaleb
Horeb <i>shih</i> Sinai	Keturau
i Lashti i Ditëve	“Kierkegaard, S?ren “
ilustrime	Kiri
Teze Matilda	“Kitchen, Kenneth A. “
babai që i premton të birit para	koherencë
fëmija romak	konceptet ligjore
kufijtë e shpejtësisë dhe urgjenca	konteksti
vizitë në një galeri arti	Koperniku
interpretimi	Koreu
i rrëfenjës së Dh.V	dhe Moisiu
i rrjedhimeve teologjike	rebelimi i
Isaku	krahasime
sakrifica e	krahasimi
Ishboshethi	krijimi
Ishmaeli	qëllimi i
rrethprerja e	Krishti
Jeftu	si avokat
Jeriko	lartësimi i
Jerusalemi	lindja e
prej së larti	vdekja e
hyrja në	hyjnia e
<i>shih gjithashtu</i> tempull	besimi në
jeta	lavditë e
Krishti si burim	mishërimi i
e përjetshme	qëndrimi i Krishtit ndaj Dh.V
pema e	priftëria e
jetë e përjetshme	si profet
Jezus Krisht <i>shih</i> Krisht	si Shpengues
Joabi	shpengimi në

ringjallja e	metafora
kthimi i (ardhja e dytë)	metoda gramatiko-historike
sakrifica e	“Meyers, Carol L. “
Sansoni si tip	“Millard, Alan R. “
si farë e Abrahamit	miqësi
si burim i jetës	mishi
vuajtjet e	modernizëm
tundimet e	Moisiu
<i>shih edhe</i> Qengji i Perëndisë	monoteizëm
kryepriifti	“Moo, Douglas J. “
kundërshti	mosbesimi
Legeni	Naamani
“Lightfoot, J. B. “	Natan
ligjet	ndërgjegje
ligjet e ushqimit	ndërmjetës
ligji	ngjarjet
jurisprudenca	Nineveja
ceremonial	nxitjet
pasoja e	ofertat
themelimi i	Origen
pëmbushur nga Krishti	pagëzimi
pëmbushur nga ne	paradigma ligjore
funksioni	parajsa
i Moisiut	paraqitja ndaj Perëndisë
qëllimi i	Paridi (Trojani)
Loti	parimet
lufta	Parousia
lutja	Pashka
Mali Sinai	pastrim
mana	nga gjaku
“Marshall, I. Howard “	i ndërgjegjes
Mbretëresha e Jugut/Sheba	me ujë
mëkati	pavdekësia
Melkisedeku	Pema e Jetës
dhe Abrahami	Perëndia
rendi i	banesa e
Menelau	shtëpia e
mërgimi	xhelozia e
mëshira	gjykimi i
Mesia	dashuria për
mësuesit e rremë	betimi i

paraqitja tek	me anë të veprave
premtimi i	Shkrimet
pushimi i	shlyerja
froni i	shlyerje
zemërimi i	zëvendësuese
personazhet	shpengimi
politeizmi	shpresa
precedent ligjor	shtëpia e Perëndisë
predikimi	“shtjellimit, parimet e”
prehja	Sidoni
premtimet	siguri e përjetshme
priftëria	simbolizmi
profecia	“Smit, Daan “
prototipi shih tipologjia	Sodoma
qal wahomer	“Serry, Paul “
Qengji i Pashkës	synimi
Qengji i Perëndisë	synimi i autorit
Rahab (prostituta)	tabernakulli
rebelimi	të besuarit
Rënia në mëkat	temat
rilindja	tempulli
ringjallja	testamentum
rrëfenja(t)	themeli
rrethprerja	tipologjia
rrjedha e mendimit	trashëgimia
rrjedhim ligjor	qiellore
sakrifica(t)	Tryeza e Bukës së Paraqitjes
“Salomoni, mbreti i Izraelit “	udhëzime
Samueli	listë e
Sansoni	ungjilli
Sara	drejtësia e
Satani	për johebrenjtë
“Sauli, mbreti i Izraelit”	urrejtja
Shandani (në tabernakull)	veli i dytë (p?r?keth)
ngjashmëria me një pemë ba- jameje	Vendi i Shenjtë
shëmbëlltyrat	Vendi Shumë i Shenjtë
shenjtëria	veprat shih shfajësimi me anë të ve- prave
shfajësim	Virgjili
kushtet e	vuajtjet
me anë të besimit	Zarefathi

zbatueshmëria e
zemërimi i Perëndisë
“Waltke, B. K. “
“Wenham, Gordon J. “
“Westcott, B. F. “

Mbaj mend që u takova njëherë me një specialist vere që e dinte se nga cila provincë në Francë e kishte origjinën rrushi që përdorej për verën që ai provonte. Ai shpjegoi që shija dhe aroma karakteristike ishte pasojë e truallit të veçantë në të cilin rritej vreshti. Edhe unë kam zbuluar, përmes qiellzës të sofistikuar të Profesor Gooding, sesi pjesët e ndryshme të Shkrimeve Hebraike kanë lënë shenjat e tyre dalluese në frutin e prodhuar nga shkrimtarët e Dhiatës së Re. Pasuritë e Diturisë Hyjnore është dukshëm një kryevepër akademike por e shkruar që të afrojë me një fushë përgjithësisht të panjohur, këdo që është i përkushtuar ndaj Biblës, për një studim të dobishëm dhe të kënaqshëm.

—**J. B. Nicholson**, President, Uplook Ministries, USA

Çfarë thesar pasurish shpirtërore – të nxjerra nga një jetë e tërë studimi të Shkrimeve. Lexoni këta libra dhe do të ushqeheni, sfidoheni dhe ndriçoheni siç më ndodhi mua.

—**Dr Lindsay Brown**, Drejtori Ndërkombëtar i Lëvizjes së Lozanës

Nuk është se e përdor kollaj këtë fjalë, por kjo është realisht një “Gooding klasik”. Të gjitha cilësitë për të qenë e tillë janë të pranishme: aftësia e tij e veçantë për të dalluar strukturën letrare të librave dhe pasazheve, dashuria e tij për Biblën si Fjala e Perëndisë, aftësia e tij për të shprehur çdo copë të vërtete me saktësi, qartësi dhe për dobinë e përbashkët. Nëse nuk keni kohë të lexoni gjithë librin më mirë mos e filloni. Nuk do ta shqisni nga duart që pasi të keni lexuar faqen e parë, siç edhe më ndodhi mua. Nuk doja të më shkiste qoftë edhe një fjali apo faqe e vetme. Edhe pse nëntitulli që Gooding i ka vënë librit të tij është “Përdorimi nga Dhiata e Re i Dhiatës së Vjetër”, ai në fakt na ka dhënë një paraqitje të plotë (dhe shumë të lexueshme) të parimeve themeltare të interpretimit biblik.

—**Alec Motyer**, ish rektori i Trinity College, Bristol

Unë e shoh që ky libër do të bëhet shumë shpejt një burim kryesor për ata që kërkojnë të kuptojnë dhe shijojnë mënyrën

në të cilën Dhiata e Re shpalos kuptimin e Dhiatës së Vjetër. Analiza që David Gooding i bën teksteve që shpesh janë të vështira është edhe e mprehtë edhe e lexueshme. Unë për veten time kam përfituar jashtëzakonisht shumë prej materialit në këtë vëllim.

—**John C. Lennox**, Profesor i Matematikës, University of Oxford; Anëtar nderi i Mathematics and Philosophy of Science, Green Templeton College

Kam lexuar me kujdes nga fillimi deri në fund dy librat e mëparshëm në këtë seri: Luka dhe Veprat. Po bëj të njëjtën gjë me këtë libër për të njëjtat arsye: po më jepet mundësia për të fituar mendime të thella për të vërtetat biblike që vetëm një mjeshtër i Shkrimeve mund t'i transmetojë dhe të pasurohem shpirtërisht ndërsa i mësoj ato. Ky libër është sidomos i veçantë sepse ai prek qartazi dhe me mjeshtri një fushë kyç të interpretimit biblik për të cilën të gjithë studiuesit e sinjertë të Fjalës duhet të zhvillojnë aftësitë e tyre për ta zotëruar më mirë. Kam rafinuar disa nga pikëpamjet e mia për mënyrën si duhet t'i afrohem Dhiatës së Vjetër ndërsa lexoj këtë libër, dhe kam mësuar, mësuar, mësuar kaq shumë....

—**Ajith Fernando**, Teaching Director, Youth for Christ, Sri Lanka; Author, Deuteronomy: Loving Obedience to a Loving God

Ky libër është një përsosuri e David Gooding – i përqëndruar në Krishtin, edhe akademik por edhe një shtjellim jashtëzakonisht i lexueshëm. Me energji dhe mjeshtëri, ai prek një nga çështjet më sfiduese me të cilën përballet çdo student i Biblës, duke paraqitur shumë prej zbulimeve të thella nga shërbesa e tij e mësimdhënies. Kjo është një ndihmesë e rëndësishme. Unë vetë u nxita dhe u mpreha edhe më shumë në të menduarit tim ndërsa e lexova atë.

—**Alan Gamble**, Mësues Bible, Glasgow, Scotland

Pasuritë e Diturisë Hyjnore është një paraqitje mjeshtërore. Shumë të krishterë nuk e marrin seriozisht Dhiatën e Vjetër. Të

tjerët e shohin si problematike përdorimin e Dhiatës së Vjetër nga Dhiata e Re. Në këtë vepër profesor Gooding jep udhëzime të shëndosha për të dyja këto grupe me elokuencë dhe qartësi. Ai na tregon si vetë Dhiata e Re na udhëzon si të interpretojmë të Vjetrën. Mësuesit, predikuesit dhe të gjithë studentët seriozë të Biblës do ta kenë këtë si një burim të paçmueshëm.

—**Gordon J. Wenham**, Lektor i Dhiatës së Vjetër, Trinity College, Bristol; Profesor Emeritus i Dhiatës së Vjetër, University of Gloucester

Në këtë studim me gamë të gjerë, ne përballemi me tipologjinë, alegorinë dhe “përmbushjen” në nivelet e ndryshme ku ajo ndodh. Kujtohem se besnikëria e verbër qoftë ndaj leximit letraro-historik apo qoftë ndaj atij tipologjik të Shkrimeve na kthen në fanatikë. Edhe pse duhet ta fillojmë gjithmonë bashkëveprimin tonë me tekstet në nivelin letraro-historik (apo gramatiko-historik), ky është shpesh vetëm hapi i parë në shpalosjen e asaj që ata na përçojnë... David Gooding e paraqet këtë volum të shkëlqyer si një lloj manuali për interpretimin e Shkrimeve dhe na tregon se kur marrim paraysh ndërveprimin mes dy Dhiatave kjo mund të informojë përpjekjet tona në interpretimin dhe shtjellimin e tyre.

—**Robert P. Gordon**, Profesor Regius i Hebraishtes (Emeritus), University of Cambridge (prej parathënies)

Në këtë libër jashtëzakonisht informues, Prof. David Gooding adreson me qartësi të madhe detyrën sfiduese e të shpjeguarit se si autorët e Dhiatës së Re shfrytëzojnë Dhiatën e Vjetër. Si një mësues Bible dhe studiues akademik me përvojë dhe shumë i talentuar, ai ka shkruar një udhëzues shumë ndihmues por edhe jashtëzakonisht të lexueshëm për këtë temë komplekse. Duke u fokusuar në përdorimin e Shkrimit për të interpretuar Shkrimin, Prof. Gooding aftëson mjeshtërisht lexuesin këmbëngulës për të parë me qartësi “pasuritë e diturisë hyjnore”. Kushdo që dëshiron të kuptojë më mirë unitetin e Biblës, ky libër është një domosdoshmëri.

—**T. Desmond Alexander**, Lektor kryesor për Studimet Biblike, Union Theological College, Belfast

Pasuritë e Diturisë Hyjnore është plot me një analizë të kujdesshme, me përmbledhje ndihmuese dhe dëngas me shembuj. Nuk di të ketë ndonjë vepër tjetër kaq të plotë dhe praktike në përvijimin e saj të mënyrave sipas të cilave Dhiata e Re përdor Dhiatën e Vjetër dhe si të shtjellojmë Dhiatën e Vjetër sot. Niveli akademik është dukshëm i lartë por nuk kthehet në mburrje prandaj kjo vepër është e përshatshme për një kategori të gjerë lexuesish. Të gjithë ata që e lexojnë atë dhe ndjekin udhëzimet e tij do të pasurohen.

—**John W. Olley**, Kërkues i përkohshëm në fushën e studimeve të Dhiatës së Vjetër dhe ish rektor i Vose Seminary, Perth

URTËSIA E PERËNDISË ËSHTË ZBULUAR si në Dhiatën e Vjetër, ashtu edhe në të Renë, por nuk do të jetë e mundur ta vlerësojmë plotësisht këtë dituri nëse ato të dyja lexohen ndaras njëra-tjetrës. Disa herë Dhiata e Re citon të Vjetrën si të autoritetshme. Disa herë ajo anulon gjërat që e Vjetra thotë. Herë të tjera ajo tregon se e Vjetra ilustron doktrinën e Dhiatës së Re. Si ta kuptojmë dhe zbatojmë mësimin e saj? A po tregohet arbitrare Dhiata e Re kur na tregon si të kuptojmë të Vjetrën, apo interpretimet e saj të kujdesshme na mësojnë si duhet të kuptojmë Dhiatën e Vjetër? A mundet që mënyrat e shumta dhe të ndryshme të Dhiatës së Re në përdorimin e disa prej pasazheve të saj të na pajisin me udhëzime për leximin, studimin dhe zbatimin e të gjithë Dhiatës së Vjetër?

Duke përdorur kërkimet dhe mësimdhënien e tij shumëvjeçare, profesor Gooding prek këto çështje duke shtjelluar pasazhe kyç nga Dhiata e Re kur ajo përdor Dhiatën e Vjetër. Së pari, ai shqyrton rëndësinë e marrëdhënies së përgjithshme mes dy dhiatave. Pastaj shqyrton pesë kategori konceptuale të dalë prej interpretimit të Dhiatës së Re, të cilat përfshijnë shumë zbulime që mund të përdoren si mjete për të vjelë nga pasuria e Dhiatës së Vjetër. Në përfundim, ai formulon udhëzime për të interpretuar rrëfenjat e Dhiatës së Vjetër dhe i ilustron ato me tre pasazhe të njohura. Të marra së bashku, këto zbulime janë një ndihmë e çmueshme për të vlerësuar pasurinë e diturisë së shumëllojtë të Perëndisë, e cila ka mbërritur deri te ne si një akumulim i të gjitha epokave.

DAVID W. GOODING është profesor nderi i greqishtes së Dhiatës së Vjetër në Universitetin e Queens-it, Belfast dhe anëtar i Akademisë Mbretërore të Shkencave të Irlandës. Shërbesa e tij ndërkombëtare e mësimdhënies spikatet prej shtjellimeve të reja dhe të kujdesshme që u bënë të dy dhiatave. Ai ka botuar studime akademike rreth Septuagintit dhe rrëfenjave të Dhiatës së Vjetër, si edhe shtjellime për Lukën, Gjonin 13-17, Veprat dhe Hebrenjvë.